

Asllan Hamiti

FONETIKA DHE FONOLOGJIA
E GJUHËS STANDARDE SHQIPE
(Botimi III)

\

Redaktor:

Prof. dr. Ajten Hajdari - Qamili

Recensues:

Prof. dr. Agim Poloska

Prof. dr. Ismet Osmani

Kopertina dhe realizimi teknik:

Besnik Ibrahim

Copyright ©: Autor

Të gjitha të drejtat e riprodhimit janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë mjet apo në asnjë formë (as me fotokopje), pa lejen me shkrim të autorit.



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

MINISTRIA **MAJ** E KULTURËS

Libri u botua me përkrahjen financiare të Ministrisë së Kulturës të
Republikës së Maqedonisë së Veriut

Asllan Hamiti

**FONETIKA DHE FONOLOGJIA
E GJUHËS STANDARDE SHQIPE**
(Botimi III)

Shkup, 2020

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

811.18'342(075.8)

811.18'344(075.8)

HAMITI, Aslan

Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe / Aslan Hamiti. -
botimi 3. - Shkup : A. Hamiti, 2020. - 288 стр. : илустр. ; 24 см

Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 351-356

ISBN 978-608-66268-2-2

а) Албански јазик -- Фонетика -- Високошколски учебници б) Албански
јазик -- Фонологија -- Високошколски учебници

COBISS.MK-ID 52247301

Shtypur në shtypshkronjën "GRAFODEN" – Shkup, 2020
Tirazhi: 500 kopje

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	9
SHENJA PLOTËSUERE DHE DIAKRITIKE NGA ATO TË ALFABETIT TË GJUHËS SHQIPE.....	13
KREU I	15
1. OBJEKTI I FONETIKËS	15
1.1. DEGËT DHE LLOJET E FONETIKËS	18
1.2. LIDHJET E FONETIKËS ME SHKENCAT E TJERA.....	22
1.3. RËNDËSIA TEORIKE DHE PRAKTIKE E FONETIKËS	26
1.4. FONETIKA NYJËTIMORE	29
1.4.1. APARATI I TË FOLURIT.....	29
1.5. FONETIKA AKUSTIKE	38
1.5.1. TIPARET AKUSTIKE TË TINGUJVE	39
1.5.2. KLASIFIKIMI AKUSTIK I ZANOREVE.....	50
1.6. ZANORET DHE BASHKËTINGËLLORET	53
KREU II	57
2. KLASIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I ZANOREVE	57
2.1. KLASIFIKIMI I ZANOREVE	57
2.2. PËRSHKRIMI NYJËTIMOR I ZANOREVE TË SHQIPES STANDARDE	62
2.3. TOGJET E ZANOREVE DHE DIFTONGJET	66
2.4. GJATËSIA E ZANOREVE NË GJUHËN SHQIPE.....	69
KREU III	77
3. BASHKËTINGËLLORET E SHQIPES STANDARDE	77
3.1. KLASIFIKIMI I BASHKËTINGËLLOREVE	77
3.2. PËRSHKRIMI I BASHKËTINGËLLOREVE	85
3.2.1. BASHKËTINGËLLORET BUZORE	85
3.2.2. BASHKËTINGËLLORET PARAGJUHORE	86
3.2.3. BASHKËTINGËLLORET MESGJUHORE.....	92
3.2.4. BASHKËTINGËLLORET PRAPAGJUHORE	94
KREU IV	97
4. FONETIKA KOMBINATORE.....	97
4.1. NDRYSHIMET KOMBINATORE TË TINGUJVE	98
4.2. AKOMODIMI	102

4.3. PËRNGJASHMIMI DHE SHPËRNGJASHMIMI	104
4.3.1. ZËSHMIMI DHE SHURDHIMI	107
4.4. SHTIMI I TINGUJVE	108
4.5. RËNIA E TINGUJVE.....	111
4.6. HAPLOGJIA	113
4.7. ELIZIONI	114
4.8. METATEZA	116
4.9. SHKRIRJA E TINGUJVE	116
4.10. ROTACIZMI NË TOSKËRISHTE DHE NË SHQIPEN STANDARDE	117
KREU V	123
5. FONOLOGJIA	123
5.1. NOCIONI I FONEMËS.....	125
5.2. VARIANTET E FONEMËS.....	130
5.3. TIPARET PËRBËRËSE TË FONEMAVE DHE KUNDËRVËNIET E TYRE	134
5.4. KUNDËRVËNIET NYJËTIMORE TË FONEMAVE ZANORE.....	138
5.5. KUNDËRVËNIET E ZANOREVE SIPAS TIPAREVE AKUSTIKE	142
5.6. KUNDËRVËNIET E FONEMAVE BASHKËTINGËLLORE.....	144
5.7. DENDURIA E PËRDORIMIT TË FONEMAVE	150
KREU VI.....	155
6. NDËRRIMET E FONEMAVE	155
6.1. QIELLZORËZIMI I FONEMAVE.....	157
6.2. METAFONIA	160
6.3. APOFONIA.....	161
6.4. NDËRRIME TË TJERA MORFONOLOGJIKE	162
KREU VII.....	167
7. RROKJA	167
7.1. TEORITË KRYESORE TË RROKJES.....	170
7.2. FJALËT E SHQIPES NGA PIKËPAMJA E NUMRIT TË RROKJEVE.....	174
7.3. RREGULLAT E NDARJES SË FJALËVE NË RROKJE	175
7.4. NDARJA E FJALËVE NË FUND TË RRESHTIT	177
KREU VIII.....	179
8. PROZODIA	179
NJËSITË MBISEGMENTORE (FONOTAKTIKE APO PROZODIKE) TË LIGJËRIMIT	179
8.1. THEKSI	179
8.1.1. FUNKSIONET E THEKSIT TË FJALËS.....	180
8.2. THEKSI MUZIKOR DHE THEKSI DINAMIK	181
8.3. GJUHËT ME THEKS TË NGULITUR DHE ME THEKS TË LIRË	182
8.4. GJUHËT ME THEKS TË LËVIZSHËM DHE TË PALËVIZSHËM.....	184

8.5. TIPARET FONETIKE TË THEKSIT NË GJUHËN SHQIPE	185
8.6. VENDI I THEKSIT NË FJALËT E GJUHËS SHQIPE	188
8.7. RREGULLAT E THEKSIMIT TË FJALËVE NË SHQIPEN	193
8.8. TËRËSITË THEKSORE NË FJALI.....	194
8.8.1. FJALËT E PATHEKSUARA.....	197
8.8.2. FJALËT E THEKSUARA DOBËT DHE FJALËT ME THEKS DYTËSOR	199
8.9. THEKSI LOGJIK.....	201
8.10. THEKSI EMOCIONAL.....	203
8.11. INTONACIONI.....	204
8.11.1. FUNKSIONET E INTONACIONIT	205
8.11.2. LAKORET MELODIKE TË FJALIVE	207
KREU IX	213
9. ALFABETIZIMI, STANDARDIZIMI, MODRNIZIMI I SHQIPES DHE PËRKUJDESJA PËR TË	213
9.1. PLANIFIKIMI I SHQIPES.....	213
9.2. ALFABETI I GJUHËS SHQIPE	215
9.3. SHQIPJA NË PROCESIN E GLOBALIZIMIT	225
9.4. GJUHA SHQIPE NË INTERNET	230
9.5. KËSHILLI NDËRAKADEMIK PËR GJUHËN SHQIPE	233
9.6. SHOQATA E GJUHËSISË SHQIPTARE	234
9.7. GJUHA SHQIPE DHE KOMPJUTERI.....	235
9.8. STATUSI I SHQIPES NË MAQEDONINË E VERIUT	237
9.9. AGJENCIA E ZBATIMIT TË GJUHËS	238
KREU X	241
10. DREJTSHQIPTIM DHE DREJTSHKRIM	241
10.1. TIPARE FONETIKE, MORFOLOGJIKE E LEKSIKORE TË GEGËRISHTES NË SHQIPEN STANDARDE.....	241
10.2. BAZA NYJËTIMORE E SHQIPES STANDARDE DHE E FOLËSVE TË SHQIPES ..	249
10.3. TË FOLURIT DHE TË SHKRUARIT ËSHTË PROCES I NDËRLIKUAR	255
10.4. NDËRLIDHJA E SHQIPTIMIT ME SHKRIMIN.....	259
10.5. DREJTSHQIPTIMI	262
10.6. SHKAQET E THYERJES SË NORMËS GJUHËSORE	265
10.7. PARIMET E PËRGJITHSHME TË DREJTSHKRIMIT TË SHQIPES	268
10.8. PARIMI FONETIK DHE MORFOLOGJIK BASHKËVEPROJNË.....	272
10.9. TË SHKRUARIT DREJT NUK ËSHTË TRANSKRIPTIM I TË FOLURIT	274
10.10. SHQIPJA STANDARDE NUK TRASHËGOHET – MËSOHET	277
10.11. SI TA PËRVETËSOJMË LIGJËRIMIN LIBROR	279
10.12. LIGJËRIMI LIBROR PËRVETËSOHET ME PËRKUSHTIM	281
10.13. SI TË PREZANTOJMË ME GOJË NJË PUNIM.....	283
LITERATURA E SHFRYTËZUAR	285

PARATHËNIE

Botimi i tretë i ndryshuar i këtij teksti mësimor që e keni në dorë mbështetet në versionet e mëparshme: në botimin e parë të librit *"Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe"*, Interdiskont, Shkup, 2005 si dhe në botimin e dytë, Selektor, Shkup, 2011. Për nevojat e studentëve joshqiptarë të Degës së Përkthimit e të Interpretimit në Fakultetin e Filologjisë "Bllazhe Koneski" në Shkup si dhe për të gjithë të interesuarit e tjerë, librin e Fonetikës e ripunuam, e përshtatëm, e ndryshuam, e pasuruam edhe me disa elemente të fonetikës krahasuese dhe e botuam në maqedonisht, Menora, Shkup, 2008 dhe më pas me rekomandimin e Universitetit "Shën Kirili e Metodi" në Shkup, libri u ribotua nga ky universitet (me disa ndryshime) më vitin 2011.

Ky tekst universitar u mirëprit dhe ishte shumë i kërkuar nga studentët, pedagogët si dhe lexuesit e tjerë në Maqedoninë e Veriut, por edhe në Kosovë e në Shqipëri, andaj e pamë të arsyeshme të bëjmë botimin e tretë të ndryshuar e të përditësuar me zhvillimet e reja shoqërore si dhe me prurjet e reja në fushën e fonetikës e të fonologjisë, të drejtshkrimit e të praktikës gjuhësore.

Teksti është hartuar për nevojat e studentëve të Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare, por mund ta shfrytëzojnë edhe studentët e mësuesisë si dhe të fakulteteve të tjera, pedagogët e gjuhës shqipe në shkollat e mesme dhe në filloret; gazetarët, përkthyesit, intelektualët dhe përgjithësisht të gjithë ata që dëshirojnë të njihen me sistemin fonetik e fonologjik të shqipes standarde, me disa çështje që lidhen me drejtshkrimin e drejtshkrimit etj.

Në këtë libër universitar jemi përpjekur të pasqyrojmë përvojën tonë kërkimore e pedagogjike si titullar shumëvjeçar i kësaj lëndeje, duke shfrytëzuar rezultatet e arritura deri më sot në gjuhësinë shqiptare dhe në gjuhësinë e përgjithshme. Për mbarështrimin e këtij teksti mësimor kemi konsultuar e shfrytëzuar një numër të madh monografish, studimesh e artikujsh gjuhëtarësh shqiptarë e të huaj, veçanërisht ndihmesat e vyera të Eqrem Çabejt, Shaban Demirajt, Androkli Kostallarit, Anastas Dodit, Kolec Topallit, Bahri Becit, Rami Memushajt, Emil Lafes, Xhevat Lloshit, Jorgji Gjinarit, Gjovalin Shkurtajt, Rexhep Ismajlit; Bertil Malmbergut, Andre Martinesë, N. S. Trubeckoit, Milivoje Minoviqit, Irena Savickës e Ludmill Spasovit, Ranko Bugarskit, Antica Antoshit, Rudolf Filipoviqit, Damir Horgës etj. Në poshtëshënime shpeshherë janë dhënë emrat e autorëve bashkë me veprat dhe punimet e konsultuara, ndërsa si rëndom, veprat e punimet e shfrytëzuara i kemi shënuar në bibliografi.

Sigurisht se kemi konsultuar edhe tekste mësimore me vlerë të

pamohueshme e të qëndrueshme për fonetikën e shqipes, si Anastas Dodi *"Fonetika e gjuhës së sotme shqipe"*, Prishtinë, 1970; Anastas Dodi - Jorgji Gjinari *"Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe I, Fonetika"*, Tiranë, 1985; Anastas Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004; Bahri Beci *"Fonetika"*, Prishtinë, 2004; Hajredin Xhaferi, *"Leksione dhe ushtrime për fonetikën"*, Elbasan, 2008; Rami Memushaj, *"Fonetika e shqipes standarde"*, Tiranë, 2009 etj.

Ashtu si edhe në versionet paraprake të librit, edhe tani nuk e kemi ndryshuar konceptin dhe qëllimin e librit. Teksti mësimor hartohet për nivelin e përdoruesve, sipas një plani e programi mësimor të miratuar.

Megjithëkëtë, botimi i tretë i Fonetikës dallon nga dy botimet e mëparshme jo vetëm në mënyrën e mbarështrimit të çështjeve, por edhe në përmbajtje. Vëmendje më të madhe i kemi kushtuar drejtshqiptimit e më pak drejtshkrimin. Kemi hequr dy kapituj (Gjuha e komunikimi, bashkë me Fonostilistikën) dhe kemi shtuar dy kapituj të tjerë, përkatësisht kapitujt nëntë dhe dhjetë. Në kreun e nëntë, të titulluar alfabetizimi, standardizimi, modernizimi i shqipes dhe përkujdesja për të, kemi trajtuar nëntë tema: planifikimi i shqipes, alfabeti i gjuhës shqipe, shqipja në procesin e globalizimit, gjuha shqipe në internet; duke folur shkurtimisht edhe për Këshillin Ndërkademiq për Gjuhën Shqipe, Shoqatën e Gjuhësisë Shqiptare, për projektin ndërkombëtar pesëvjeçar "Gjuha shqipe dhe kompjuteri", për statusin e shqipes në Maqedoninë e Veriut si dhe për Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës.

Në kapitullin e dhjetë kemi përfshirë trembëdhjetë leksione kushtuar çështjeve të drejtshqiptimit e të drejtshkrimin, si tiparet fonetike, morfologjike e leksikore të gegërishtes në shqipen standarde; baza nyjetimore e shqipes standarde dhe e folësve të shqipes, të folurit dhe të shkruarit është proces i ndërlikuar, drejtshqiptimi dhe ndërlidhja e shqiptimit me shkrimin, shkaqet e thyerjes së normës gjuhësore, parimet përgjithshme të drejtshkrimin të shqipes dhe bashkëveprimi i parimit fonetik me parimin morfologjik. Në këtë vazhdë, e kemi parë të arsyeshme të japim edhe disa njohuri, udhëzime, këshilla e rekomandime për përvetësimin e shqipes standarde, se: të shkruarit drejt nuk është transkriptim i të folurit, se shqipja standarde nuk trashëgohet, por mësohet; si ta përvetësojmë ligjërimin libror dhe si të prezantojmë me gojë një punim. Temat e tilla mendojmë se do të ngjallin kërshtërinë jo vetëm të studentëve, por edhe të lexuesve të tjerë.

Ngulitja e normave të gjuhës, veçmas atyre drejtshkrimore e drejtshqiptimore te studentët, që është qëllimi praktik i këtij kursi, nuk duhet të përfundojë vetëm me përvetësimin e rregullave, por duhet të vazhdojë me formimin e shkathtësive dhe kthimin e tyre në shprehje. Udhëzimet për drejtshqiptimin e drejtshkrimin jo vetëm që duhet të mësohen, por edhe të zbatohen e të bëhen praktikë e përdorimit gjatë studimeve themelore, në punën e tyre intelektuale, përkatësisht gjatë gjithë veprimtarisë së tyre si pedagogë të shqipes (për shqiptarë e për të huaj), përkthyes, gazetarë,

administratorë, politikanë etj. Në përvojën tonë pedagogjike kemi vërejtur se disa studentë nuk arrijnë të mënjanojnë shprehitë nyjetimore krahinore, që nuk përkojnë me shqiptimin letrar; si hundorësinë dhe gjatësinë fonologjike të zanoreve, zhburorëzimin e /y/-së në /i/, përdorimin e pavend të /ë/-së, afrikatizimin e mesgjuhoreve etj.

Sigurisht se jashtë tekstit janë lënë edhe shumë tema të rëndësishme të fonetikës e të fonologjisë së shqipes standarde, por këtu kemi bërë përzgjedhjen e atyre çështjeve që mendojmë se janë të domosdoshme për mësuesit e ardhshëm të shqipes. Për këtë kemi konsultuar edhe programet mësimore të gjuhës amtare për shkollimin fillor e të mesëm. Jemi përqendruar kryesisht në fonetikën nyjetimore, fonetikën kombinatorë e në çështjet themelore të fonologjisë, përfshirë ndërrimet morfonologjike, theksin e intonacionin. Këto i kemi ndërlidhur me praktikën gjuhësore me qëllim të ngritjes së kulturë së gjuhës së studentëve, sidomos për të fituar shprehitë e të folurit dhe e të shkruarit drejt.

Për të siguruar një tekst themelor për këtë kurs, jemi përpjekur të bëjmë përzgjedhjen e materialit të fonetikës e të fonologjisë së shqipes së sotme me gërshetim çështjesh të morfonologjisë, të drejtshqiptimit e të drejtshkrimit; ndonjëherë të pasuruar me elemente krahasuese me gjuhë të tjera, me shpjegime të shkurtra të dialektologjisë si dhe të fonologjisë historike dhe ta paraqesim atë në një botim. Kuptohet se ata që dëshirojnë të fitojnë njohuri më të thella sesa ato që janë paraqitur në këtë tekst, mund të shfrytëzojnë artikuj e studime të veçanta nga këto fusha.

Kemi zgjedhur këtë mënyrë të gërshetuar të paraqitjes së gjërave, për qëllime praktike dhe për t'i ndërlidhur çështjet, sepse sistemet e rrafshëve të ndryshme gjuhësore vështirë se mund të kuptohen drejt po të merren të shkëputura e të pakushtëzuara njëra nga tjetra; madje, vetë fonetika e fonologjia kanë lidhje shumë të ngushtë me një varg disiplinash gjuhësore e shkencash natyrore.

Nga ana tjetër, kemi ndjekur këtë rrugë nga synimi që të sigurojmë për studentët njohuritë themelore dhe një gamë më të gjerë diturish, që do të jenë bazë e shëndoshë për përvetësimin e rregullave kryesore të drejtshqiptimit e të drejtshkrimit të shqipes standarde, rrjedhimisht edhe zbatimin praktik të tyre.

Përveç kësaj, mëtojmë të japim paranjohuritë elementare për nxënien e dialektologjisë shqiptare, morfologjisë, sintaksës, gjuhëve të huaja etj. Jemi përcaktuar që të shtjellojmë edhe ndërrimet historike të fonemave, siç janë qiellzorëzimi, metafoia, apofonia si dhe disa dukuri të tjera me vlerë morfologjike, sepse ato përgjithësisht pasqyrohen jo vetëm në shqipen e sotme dialektore, por edhe në shqipen standarde.

Kemi bërë fjalë edhe për ndryshimet kombinatorë të tingujve, variacionet e gjatësisë së zanoreve, togjet e zanoreve e të bashkëtingëlloreve, diftongjet, akomodimet, zëshmimin dhe shurdhimin e tingujve, shkrirjen etj.,

ngase këto dukuri fonetike realizohen në shqiptim. Edhe pse rotacizmi është dukuri dialektore e toskërishtes, por shumë forma fjalësh me rotacizëm janë pjesë e leksikut të shqipes standarde. Jemi përcaktuar të përmendim shkurtimisht edhe disa dukuri të tjera fonetike, që kryesisht veprojnë në rrafshin dialektor, me qëllim që studentët tanë t'i mënjanojnë shprehitë individuale të shqiptimit krahinor.

Falënderoj gjithë ata që ndihmuan daljen në dritë të këtij teksti: redaktorin, recensentët, përpunuesin teknik e shtëpinë botuese. Jam mirënjohës Ministrisë së Kulturës të Republikës së Maqedonisë së Veriut për mbështetjen financiare të botimit të librit.

Mirëpresim mendimet, vlerësimet, sugjerimet, vërejtjet, propozimet e lexuesve. Ato mund t'i dërgoni në e-mailin: asllan_hamiti@yahoo.com ose t'i postoni në emrin tim në adresën: Fakulteti i Filologjisë "Bllazhe Koneski", Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Shkup, tetor 2020

Autori

Shenja plotësuese dhe diakritike të dallueshme nga ato të alfabetit të gjuhës shqipe

- [] - kllapa katrore për të shënuar tingujt (p.sh. tingulli [a])
- / / - kllapa të pjerrëta për të shënuar fonemat (p.sh. fonema /p/)
- < > - shenjë konvencionale për të shënuar shkronjat (p.sh. shkronja <t>)
- ~ - kundërvënie fonologjike midis dy gjymtyrëve të kundërvënies
(p.sh. /a/ ~ /e/: dash ~ desh)
- : - zanore e gjatë (p.sh. /a:/ pla:k “plakë”)
- ^ - zanore hundore (p. sh. â ose â:, kâ:m “këmbë”)
- í - zanore e theksuar (p.sh. lirí)
- ì - zanore me theks dytësor (p.sh. lirìdâshës)
- ŋ - bashkëtingëllore mbylltore, prapagjuhore, sonante, hundore
(p.sh. ngat > ŋat)
- [...] - forma shqiptimore e fjalës (p.sh. shkruhet: <pedagogia>, lexohet [pedagog-ja])
- > - forma në të majtë kalon fonetakisht në formën në të djathtë
(p.sh. shtëpi > shpi)
- < - forma në të djathtë kalon fonetakisht në formën në të majtë
(p.sh. rryp < rrip)
- âj- diftong (p.sh. mâjir < mirë)
- / - shënon një ndërprerje të shkurtër në rrjedhën e të folurit (presjen), si
(p.sh. Agroni/ shoku im ...)
- // - shënon një pushim të gjatë, të ngjashëm me pikën
(p.sh. Unë jam student//)

KREU I

1. OBJEKTI I FONETIKËS

Termi *fonetikë* rrjedh nga greqishtja e vjetër: φωνή, *phōnē* = tingull, zë; nga kjo pastaj *phōnētikos* “e tingullit a tingullore, e zërit”, që do të thotë shkencë e tingujve, shkencë për tingujt. Fonetika është degë e gjuhësisë që studion tingujt e ligjërimit: veçoritë fiziologjike e akustike të tyre, ndryshimet që pësojnë tingujt në pozicione të ndryshme, theksin, rrokjen dhe intonacionin. Sistemi fonetik është sistemi bazë i gjuhës, mbi të cilin ngrihen sistemet e tjera të saj. Fonetika është degë e rëndësishme e gjuhësisë. Kjo shkencë merret me studimin e mjeteve tingullore të gjuhës nga pikëpamja e realizimit të tyre në rrjedhën e të folurit, me ndryshimet që pësojnë ato në pozicione të caktuara etj.

Vala tingullore e të folurit është e zërthyeshme në njësi, por edhe njësitë e saj janë të bashkueshme në tërësi. Të folurit shpjegohet si vargua tingujsh me të cilët formohen njësi më të mëdha: rrokje, fjalë, fjali e periudha të shoqëruara me theks e intonacion. Tingujt nuk varen vetëm nga vetitë e tyre nyjëtimore e akustike, por edhe nga raportet që vënë ata me tingujt e tjerë në rrokje, në fjalë e në fjali.

Fonetika trajton një rreth të gjerë problemesh, i cili zgjerohet vazhdimisht. Deri më tani janë dhënë disa përkufizime (definicione) për fonetikën. Përveç përkufizimeve të mësipërme, kemi sjellë edhe disa të tjerë.

Fonetika merret me studimin e anës fiziologjike dhe akustike të ligjërimit. Njësia bazë e fonetikës është *tingulli* - zëri i nyjëtuar i të folurit të njeriut.¹ Tingujt krijohen gjatë aktit të të folurit. Folësi e kodon mesazhin e vet në tinguj, kurse dëgjuesi, duke e përkapur (perceptuar) me vesh rrjedhën tingullore dhe duke e analizuar atë në sistemin nervor, nxjerr prej saj përmbajtjen e mesazhit. Fonetika merret me mënyrën e nyjëtimimit,²

¹ Njeriu mund të prodhojë zëra të ndryshëm, të artikuluar e të paartikuluar. Nga të gjithë zërat e këtyllë, vetëm një pjesë e tyre marrin pjesë në krijimin e fjalëve të një gjuhe. Zërat e tillë të nyjëtuar quhen tinguj dhe përbëjnë sistemin tingullor a inventarin tingullor të një gjuhe. Vetëm qindra tinguj është shuma e përgjithshme e tingujve të nyjëtuar të të gjitha gjuhëve të botës. Tingujt e paartikuluar nuk janë objekt studimi i fonetikës.

² Termet *nyjëtim*, *artikulim* dhe *shqiptim* kanë kuptim të njëjtë (janë sinonime). Këto emërtojnë veprimin e organeve të të folurit dhe mënyrën e prodhimit të një tingulli të ligjërimit.

përshkrimin dhe klasifikimin e tingujve të të folurit, përcjelljen e tyre me anë të valëve të ajrit si dhe përkapjen apo identifikimin e tyre.

Objekt të fonetikës duhet të konsiderojmë gjithë mjetet tingullore të të folurit, sido që të shfaqen dhe çfarëdo roli që të luajnë. Fonetika është degë e gjuhësisë e cila merret me studimin e tingujve të ligjërimit. Fonetika përkufizohet edhe si shkencë e anës materiale të ligjërimit.³ Fonetika është dije e sistemit tingullor të të folurit.

Objekti i gjerë i fonetikës mund të përfshihet edhe me këtë përkufizim: *Fonetika është degë e gjuhësisë që studion sistemin tingullor të ligjërimit: nyjëtimin e tingujve, veçoritë akustike të tyre, klasifikimin, dukuritë dhe rregullat e ndryshimit të tingujve në pozita të ndryshme; theksin, rrokjen, intonacionin si dhe çështjet e drejtshqiptimit dhe të alfabetit.*

Fonetika studion njësitë **vijore** (lineare, segmentore) të ligjërimit si dhe njësitë **jovijore** (jolineare, mbisegmentore, prozodike) të ligjërimit.

Ç'janë njësitë vijore dhe jovijore të ligjërimit?

Çdo gjuhë manifestohet në formë vijore thëniesh, që përfaqësojnë atë që shpesh quhet *rrjedhë e të folurit*. Kjo formë lineare e ligjërimit njerëzor, del nga *karakteri i tij tingullor*: thëniet tingullore ndodhin domosdo në kohë dhe përkapen me veshë si rrjedhë. Krejt tjetër është gjendja kur komunikimi është i tipit piktoral, të kapur me shikim, kur shikuesi e percepton mesazhin si një të tërë, ose duke përqendruar vërejtjen suksesivisht mbi elementet e mesazhit sipas një rendi a një tjetri, pa u prekur fare vlera e mesazhit. Një sistem vizual i komunikimit, si ai i kodit të shenjave rrugore, nuk është linear, por dy dimensionesh.

Karakterit vijor i thënieve shpjegon suksesivitetin e monemave dhe të fonemave: shenja *asht* përmban të njëjtat fonema si dhe *tash*, por nuk përzihet me të, si dhe një varg fjalësh të tjera, si *maj ~ jam, ty ~ yt, ai ~ ia* etj. Në këtë suksesion *rendi i fonemave ka vlerë dalluese*, si dhe zgjedhja e kësaj apo asaj fonemeje. Gjendja ndryshon pakëz për sa u përket monemave. Vërtet, *një gjuetar vrau një luan* është tjetër gjë nga *një luan vrau një gjuetar*, por jo rrallë ndodh që një shenjë mund ta ndërrojë vendin në thënie pa e ndërruar kuptimin: *Do të jetë atje të martën* dhe *Të martën do të jetë atje*.⁴

Mendimet tona rëndom i shprehim me një varg fjalësh e fjalish që janë të lidhura midis tyre dhe vijojnë njëra pas tjetrës. Këto njësi tingullore përbëjnë rrjedhën e të folurit. Njësitë tingullore ndjekin njëra-tjetrën në formë vijore, në formë rrjedhe; për shkak të karakterit tingullor të ligjërimit. **Njësi vijore të gjuhës janë tingujt (fonemat)**. Tipari vijor i ligjërimit lidhet me vetinë e mekanizmit psikofiziologjik të njeriut. Impulset që u dërgohen nga truri organeve të të folurit që të lëvizin për të prodhuar tingujt, ndjekin

³ N. S. Trubeckoi, *Parime të fonologjisë*, Prishtinë, 1985, f. 50.

⁴ Andre Martine, *Elemente të gjuhësisë së përgjithshme*, Prishtinë, 1983, f. 47.

gjithashtu njëri-tjetrin në kohë: nuk mund të dërgohen dy impulse njëherësh dhe as të nyjëtohen dy tinguj në të njëjtën kohë.

Karakteri linear duket qartë sidomos kur e ngadalësojmë ritmin e të folurit. Kjo veti segmentore mundëson edhe shkrimin e gjuhës. Duke i ndarë tingujt themelorë-fonemat që vijnë njëra pas tjetrës me anë të shkrimit, bëjmë regjistrimin e të folurit. Kështu, shkronjat përfaqësojnë fonemat e gjuhës. Mbulesat tingullore të fjalëve përbëhen prej një, dy, tre, katër, pesë e më shumë tingujsh, të cilët bashkohen e kombinohen në mënyra të ndryshme. Nga 36 tinguj-fonema të gjuhës shqipe janë formuar dhjetëra e qindra mijë fjalë. P.sh: nga tingujt *t, a, p, a* mund të formohen këto fjalë të kuptimshme në gjuhën shqipe: *tapa, pata, pa ta*.

Përveç njësive vijore, gjuha ka edhe **njësi jovijore** ose **mbisegmentore**. Njësi të tilla janë **theksi** dhe **intonacioni**. Këto njësi nuk mund të ekzistojnë si të veçanta, pa mbulesën materiale të të folurit. Njësitë jovijore mbishtresohen në njësitë vijore, duke u lidhur me fjalët dhe fjalitë. D.m.th., elementet mbisegmentore nuk mund të shqiptohen veças nga mbulesa materiale e fjalëve dhe e fjalive. Kështu, tingulli mund të shqiptohet edhe i veçuar, ndërsa theksi nuk mund të shqiptohet i ndarë nga rrokja dhe fjala.

Bazën materiale të gjuhës e përbëjnë tingujt. Tingulli artikullohet me vënien në lëvizje të organeve të të folurit, kumbimit në zgavrën e gojës dhe përhapjes përmes valëve të ajrit me shpejtësi prej 340 m/s. Këto valë të zërit pranohen si ngacmime nga veshët e njeriut, përcohen deri në trurin e tij dhe atëherë kuptohet mesazhi i kësaj përbërjeje tingullore nëse bashkëbiseduesit kanë kod të njëjtë gjuhësor. Tingulli grafiksht mund të paraqitet me anë të tri shtresave:⁵




Fig. 1. Shtresshmëria e zërit

⁵ Dr. Žarko Muljačić, *Opća fonologija i fonologija suvremenoga talijanskog jezika*, Zagreb, 1972, f. 43.

Shpjegim për shtresshmërinë (stratifikimin) e zërit të paraqitur me numrat 1, 2 dhe 3:

1. Bërthama paraqet tiparet dalluese a identifikuese të tingullit. Sipas këtyre veçorive thelbësore përcaktohen tingujt themelorë apo varianti themelor i tingullit; përkatësisht fonemat e një gjuhe.

2. Variantet e ndryshme të tingujve themelorë gjatë lidhjes së tyre në fjalë e fjali, përkatësisht alofonet e fonemave. Në saje të kësaj shqiptojmë sasi të pakufizuar tingujsh, por numër të vogël fonemash. P.sh. në fjalët *ne, nga* (n_1 -paragjuhore, n_2 -prapagjuhore); *motër, amfiteatër* (m_1 -dybuzore, m_2 -buzore-dhëmbore).

3. Tipare ose veçori individuale – identifikimi i gjinisë së folësit: femër ose mashkull; moshës: plak ose i ri; identifikimi i zërit të këngëtar/ëve,-eve, spikerëve; dallimi i zërit të ndonjë të njohuri edhe pa e parë kur flet me ne në telefon, kur thërret dikush te dera etj.

Ana tingullore e gjuhës është dukuri e ndërlikuar, sepse tingujt kanë natyrë të ndryshueshme dhe shpeshherë janë të paqëndrueshëm. Ata pësojnë ndryshime, përkatësisht modifikohen: varësisht nga pozita e tyre në fjalë (në fillim, në mes, apo në fund të fjalës a fjalisë), varësisht nga tingujt që gjenden pranë, nga vendi i theksit, nga ritmi i ligjërit, nga qëllimi i thënies etj.

1.1. DEGËT DHE LLOJET E FONETIKËS

Njësia më e vogël e të folurit është tingulli. Tingujt lindin gjatë akteve të ligjërit. Folësi e shpreh mendimin nëpërmjet tingujve, kurse dëgjuesi, duke e përkapur me vesh valën tingullore, pranuar e analizuar atë në sistemin nervor, e kupton folësin. Në këtë mënyrë mendimi nga truri i folësit bartet në trurin e dëgjuesit. Po ta analizojmë nga pikëpamja fonetike procesin e komunikimit me anë të gjuhës, do të dallojmë anën *fiziologjike* ose *nyjëtimore, akustike, kombinatorë, dëgjimore* dhe anën *funksionale*.

Rrjedhimisht, tingujt mund të trajtohen në katër aspekte themelore: (1) në vështrimin e mënyrës sesi prodhohen nga organet e të folurit; (2) në vështrimin akustik të valëve tingullore, që lëvizin nga folësi te dëgjuesi; (3) në ndryshueshmërinë e tingujve gjatë kombinimit të tyre për të krijuar fjalë e fjali, dhe (4) në përkapjen e tingujve nga veshët, përcjelljen deri në trurin e njeriut dhe identifikimin e tij.

Secila nga këto anë studiohet nga degë të veçanta të fonetikës: (1) nga fonetika nyjëtimore (artikulative), (2) akustike, (3) kombinatorë dhe (4) dëgjimore (auditive). **Fonetika dëgjimore**, që shqyrton përkapjen e valëve tingullore me vesh nga ana e dëgjuesit, edhe sot e kësaj dite nuk ka përparuar shumë. **Fonetika funksionale** që merret me vlerën gjuhësore të këtyre

tingujve, d.m.th. rolin që luajnë në ndërtimin dhe dallimin e njësive me kuptim, është zhvilluar në disiplinë më vete që quhet fonologji. Ndaj, praktikisht mund të thuhet se fonetika përbëhet nga tri degë themelore, nga:

- a) **fonetika nyjëtimore,**
- b) **fonetika akustike** dhe
- c) **fonetika kombinatorë.**⁶

Fonetika nyjëtimore (fonetika artikulative, fonetika fiziologjike) përshkruan aparatën e të folurit, mënyrën e nyjëtimit të tingujve, bën klasifikimin dhe përshkrimin e tyre.

Fonetika akustike shqyrton veçoritë fizike të tingujve të të folurit.

Fonetika kombinatorë shtjellon modifikimin e tingujve themelorë, dukuritë dhe rregullat e ndryshimit të tyre në pozita të ndryshme.

Ligjërimi ynë përbëhet nga tingujt (si njësi më të vogla) që grupohen për të ndërtuar njësi më të mëdha (rrokje, fjalë, fjali e periudha). Duke u bashkuar kështu në njësi më të mëdha, tingujt ndikojnë në njëri-tjetrin, ndryshojnë nyjëtimin dhe veçoritë akustike.

Megjithatë, këto degë nuk duhet menduar si të ndara me thikë e pa lidhje midis tyre. Në praktikën e studimit të tingujve këndvështrimi fiziologjik, akustik, kombinator e fonologjik përforcojnë e mbështesin në mënyrë të ndërsjellë njëri-tjetrin.⁷

Studimet tradicionale të fonetikës janë bërë pa mjete teknike. Në studimet e sotme, përveç veshit, gjatë hulumtimeve të tingujve të të folurit shfrytëzohen edhe aparate të teknikës e të teknologjisë bashkëkohore. Nga kjo metodë e re e studimit u zhvillua **fonetika eksperimentale** (instrumentale, laboratorike). Aparatë më të shpeshta teknike që përdoren për studime fonetike janë: *spektrografi*, aparat që “fotografon” të folurit, duke e regjistruar në mënyrë grafike në *spektrogram* kohën, frekuencën dhe intensitetin e zërit. Me teknikën tradicionale të *palatografisë* përcaktohet vendi i prekjes së gjuhës me qiellzën gjatë nyjëtimit të disa tingujve, ndërsa tani *elektropalatografia* mundëson që këto kontakte të ndiqen suksesivisht në rrjedhën e të folurit. Me ndihmën e *labiografisë* vështrohen lëvizjet e buzëve, ndërsa *elektrolaringografia* jep mundësi për të parë aktivitetin e laringut etj.

Tani kemi disa programe kompjuterike që shfrytëzohen për hulumtime fonetike. Për anglishten është punuar shumë në këtë drejtim. Sot ka programe të posaçme kompjuterike si dhe të instaluar në telefonat celularë që teksti lexohet po edhe e folmja shkruhet. Edhe për gjuhën shqipe, në të ardhme të afërt planifikohet që programimi përmes inteligjencës artificiale “Artificiall

⁶ John Lyons, *Hyrje në Gjuhësinë teorike*, Londër, 1968 (përkthyer dhe botuar në shqip, Dituria, 2001), f. 106.

⁷ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 62-63.

Intelligence Programming” të mundësojë shndërrimin e të folurit në tekst (Speech to text), si dhe të tekstit në të folur (Text to speech).

Varësisht nga materiali që studiohet, fonetika mund të jetë:

- a) *fonetikë e përgjithshme* dhe
- b) *fonetikë e veçantë*.

Fonetika e përgjithshme studion mundësitë nyjetimore të aparatit të të folurit, mundësitë e ndryshme të përdorimit në gjuhët e botës, dukuritë dhe ligjësitë e përgjithshme tingullore etj.; ndërsa **fonetika e veçantë** studion sistemin tingullor të një gjuhe, p.sh. fonetika e gjuhës shqipe studion inventarin e tingujve të shqipes, mënyrën e nyjetimit, klasifikimin, ndryshimet e tingujve, rregullat e ndryshimit të tyre etj.

Si çdo dukuri tjetër me karakter historik, gjuha ka të tashmen dhe të kaluarën e vet. Si rrjedhim, gjuhëtari mund të shohë gjuhën e një bashkësie në një epokë të dhënë, si diçka të përfunduar, pa lidhje me të shkuarën e saj; por edhe etapat që ka kaluar kjo gjuhë në zhvillimin e vet. Kjo lejon që çdo fakt gjuhësor të vendoset në dy boshte të ndryshme: në boshtin horizontal, që quhet boshti i *sinkronisë* (greq. e vj. *syn* “bashkë”, *kronos* “kohë”, d.m.th. bashkëkohësi, njëkohësi; një fazë e caktuar e zhvillimit) dhe në boshtin vertikal a të *diakronisë* (greq. e vj. *dia* “nëpër”, *kronos* “kohë”), d.m.th. zhvillimin historik të një gjuhe; dukuri e ngjarje që ndodhin nëpër kohë të ndryshme. Pra, në bazë të asaj se a merret me studimin e tingujve në një periudhë të caktuar të zhvillimit gjuhësor (p.sh. me gjendjen e sotme të tingujve të shqipes) ose me zhvillimin historik të tingujve në periudha të ndryshme kohore, fonetika ndahet në:

- a) *fonetikë përshkruese*, deskriptive ose sinkronike dhe
- b) *fonetikë historike* (më drejt fonologji historike) apo diakronike.

Fonetika përshkruese dhe fonetika historike dallohen midis tyre si me burimet, ashtu edhe me metodat që përdorin. **Fonetika përshkruese** studion tingujt e shqipes standarde, me anë të vëzhgimit të drejtpërdrejtë si dhe me anë të aparateve të ndryshme teknike.

Fonetika historike studion zhvillimin historik të tingujve në rrjedhë të kohës. Material bazë i saj janë mbishkrimet, tekstet e vjetra, dokumentet e dëshmitë e gjuhës, dialektet, marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera etj.; duke përdorur metodën historike-krahasuese. Ajo ngjitet shkallë-shkallë nga gjendja e sotme në periudhat më të hershme të gjuhës, duke shkuar nga e njohura tek e panjohura.

Gjuha ndryshohet në rrjedhë të kohës. Sistemi fonologjik dhe gramatikor ndryshon shumë më ngadalë (mund të kalojnë dhjetra ose qindra vjet derisa të hetohet një ndryshim i tillë). Ndryshimi gjuhësor kushtëzohet nga faktorë brenda dhe jashtëgjuhësorë. Me fjalë të tjera, procesi i ndryshimit historik të gjuhës është i përherëshëm, por mjaft i ngadalshëm. Ky ndryshim në rrjedhë të kohës bëhet për shkak se ndërrohen edhe njerëzit që e flasin atë si

dhe kushtet në të cilat jetojnë. Gjuhët kështu hapërojnë me ndryshimet shoqërore, të cilat sjellin nevoja të reja dhe mundësi të reja për komunikim dhe krijimtari.

Fonetika përshkruese dhe ajo historike ndërlidhen midis tyre. Sistemi tingullor, si edhe çdo rrafsh tjetër gjuhësor, gjendet në zhvillim të pandërprerë dhe ka të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen. Në çdo fazë të saj, gjuha krahas dukurive të qëndrueshme, ka edhe elemente të vjetra që janë duke u zhdukur, por edhe elemente të reja që sapo kanë lindur. Përshkrimi i gjendjes së sotme të sistemit tingullor ndonjëherë është e dobishme të gërshetohet edhe me elemente historike, mirëpo duhet të udhëhiqemi sipas parimit të përgjithshëm: historia në shërbim të së tashmes.⁸

Fonetika funksionale (fonologjia). Nga studimi i tingujve në aspektin funksional, që zbulon rolin e tingujve në funksionin e gjuhës si mjet komunikimi, lindi, u veçua dhe u zhvillua një degë e fonetikës e quajtur *fonetikë funksionale*. Fonetika në kuptimin e ngushtë të fjalës, që studion njësitë tingullore të ligjëritimit në aspektin nyjetimor e fizik dhe fonologjia, që i studion këto njësi nga ana funksionale, përbëjnë dy aspekte studimi të një disipline të vetme gjuhësore. Me termin tradicional fonetikë përfshihen të dyja këto pikëpamje studimi. Nuk mund të bëhet asnjë studim i vërtetë i fonetikës pa pikësnyime të qarta fonologjike, funksionale. Tiparet fizike dhe nyjetimore të tingujve në fonetikë vështrohen si mjete, me anë të të cilave ata realizojnë funksionin e tyre shoqëror në gjuhë.⁹

Me zgjerimin dhe thellimin e studimeve për rolin e tingujve në procesin e komunikimit kjo fonetikë funksionale tanimë quhet fonologji. Gjuhëtarët amerikanë këtë bijë të fonetikës e quajnë *fonematikë*. Fonetika si shkencë është shumë e vjetër, ndërsa fonologjia është dije e re. Statusin e shkencës e mori në vitet e tridhjeta të shekullit XIX, sidomos me strukturalizmin e gjuhëtarit të madh Ferdinand de Sossyr.

Drejtshqiptimi (fonetika normative). Njohuritë e fonetikës, si mënyra e nyjetimit të tingujve, rregullat e ndryshimit të tingujve në fjalë, shqiptimi i zanoreve si të gjata, të mesme ose të shkurtra; theksi, rrokja, intonacioni etj. gjejnë zbatim praktik sidomos në drejtshqiptim. Prandaj, drejtshqiptimi (ortoepia) quhet edhe “fonetikë normative”, sepse përfshin rregullat e shqiptimit të drejtë në shqipen standarde. Nga ana tjetër, drejtshqiptimi ka lidhje të ngushtë me drejtshkrimin. Fonetika merret edhe me çështjet e paraqitjes me shkrim të njësive tingullore.

Dallohen edhe disa lloje të tjera të fonetikës, siç janë *fonetika krahasimtare* (komparative), e cila bën krahasimin e sistemeve tingullore të dy apo më shumë gjuhësh; *fonetika kontrastive* që merret me dallimet tingullore të gjuhëve etj.

⁸ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 58.

⁹ Anastas Dodi – Jorgji Gjinari, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 18.

1.2. LIDHJET E FONETIKËS ME SHKENCAT E TJERA

Gjuha është një sistem sistemesh të lidhura midis tyre shkallë-shkallë, ku sistemet e shkallës më të ulët janë pjesë e një sistemi të një shkalle më të lartë dhe ky, nga ana e vet, përfshihet në një sistem tjetër të një shkalle edhe më të lartë e kështu me radhë. Nga kjo pikëpamje, nënsistemet e gjuhës mund të përfytyrohen si një radhë *rrafshesh hierarkike*. Secili nga këto rrafshje ka njësitë e veta bazë, të cilat ndryshojnë cilësisht nga njësitë bazë të rrafshjeve të tjera.

Njësitë bazë të gjuhës janë *fonema, morfema, fjala, togfjalëshi dhe fjalia*. Nga pikëpamja e ndërtimit, fonema është njësia më e vogël e pandashme më tej, ndërsa njësitë e tjera mund të ndahen në njësi më të vogla. Sipas funksionit, njësitë e gjuhës ndahen në njësi **ndërtuese**: fonema, morfema dhe sintagma, që shërbejnë si material ndërtimi për njësitë e tjera më të mëdha dhe që nuk mund të përdoren më vete; njësi **quajtëse**: fjala, e cila emërton diçka dhe njësi **kumtuese**: fjalia, njësia që shpreh një mendim të caktuar.

Për të bërë të mundur përdorimin e gjuhës si mjet komunikimi, njësitë e saj duhet të hyjnë në lidhje e bashkëveprim midis tyre. Kështu, fonemat zanore e bashkëtingëllore bashkohen sipas rregullave të caktuara, duke na dhënë morfema dhe këto bashkohen për të na dhënë fjalë; pastaj fjalët hyjnë në lidhje midis tyre dhe krijojnë fjali, me bashkimin e fjalive formohen paragrafët e me ndërlidhjen e tyre krijohet teksti etj.

Pra, gjuha në tërësi përbën një sistem, ndërsa anët e veçanta të saj, si ana tingullore, leksiku etj., janë nënsisteme. Në përgjithësi, pranohet se sistemi gjuhësor përbëhet nga këto nënsisteme: *ana tingullore* (fonetika), *leksiku* dhe *gramatika*. Por kur kalojmë nga sistemi i gjuhës në pjesët përbërëse të tij, termat “sistem” dhe “nënsistem” ndërkëmbehen. Kështu, ana tingullore është nënsistem i gjuhës, por, e parë veçmas, si tërësi e elementeve tingullore dhe e lidhjeve midis tyre, ajo formon një sistem më vete.

Më tej, tërësia e fonemave të një gjuhe dhe tërësia e mjeteve prozodike të saj janë dy nënsisteme të sistemit tingullor, por, të marra më vete, ato formojnë sistemin e fonemave dhe sistemin e mjeteve prozodike. Në mënyrë të ngjashme edhe në leksik, fjalëformim e gramatikë mund të flasim për sisteme e nënsisteme më të mëdha ose më të vogla. Kjo shpjegohet me vetë ndërtimin e gjuhës, e cila nuk mund të mendohet si një shumë e thjeshtë elementesh, por si një lidhje hierarkike e tyre.

Për të gjitha këto sisteme gjuhësore ka shkenca të veçanta, por ndërlidhjet e ngushta midis rrafshjeve të gjuhës kushtëzojnë edhe lidhjen e ndërsjellë midis disiplinave që studiojnë këto rrafshje. Në këtë shumësi elementesh, tingulli është njësia më e vogël materiale e strukturës gjuhësore, që e studion fonetika. Ajo është shkencë më vete, sepse ka objektin (lëndën) dhe metodat e saj të studimit. Fonetika materie studimi ka njësitë segmentore dhe mbisegmentore të gjuhës.

Të gjitha gjuhët kanë tre komponentë bazë: *sistemin tingullor, fjalorin* dhe *sistemin gramatikor*. Sistemi tingullor është inventari i tingujve (zanoreve e bashkëtingëlloreve) si dhe i kombinimit të tyre. Fëmijët e marrin modelin fonetik duke dëgjuar, provuar e dëgjuar përsëri. Mësimi i tingujve nuk bëhet i shkëputur nga mësimi i fjalëve dhe i gramatikës.

Nga shpjegime e mësipërme kuptohet se fonetika ka lidhje të ngushtë me shkencat e tjera të gjuhës (fonologjinë, leksikologjinë, morfologjinë, sintaksën, dialektologjinë, historinë e gjuhës, stilistikën etj.); por edhe me shkencat natyrore (fizikën, fiziologjinë, neurologjinë, informatikën etj.), si dhe me shkencat shoqërore (sociologjinë, psikologjinë etj.).

a) **Lidhjet e fonetikës me fonologjinë.** Fonetika dhe fonologjia janë shumë të ndërlidhura dhe e plotësojnë njëra-tjetrën. Nuk mund të bëhet asnjë studim i tingujve pa synime të qarta fonologjike, funksionale. Për shkak të lidhjes së drejtpërdrejtë të fonetikës me fonologjinë, deri vonë është menduar se këto dy disiplina kanë lëndë të njëjtë studimi, pra tingujt e ligjërimit; por këndvështrime të ndryshme. Kështu, fonetika studion tingujt nga aspekti fiziologjik dhe akustik, ndërsa fonologjia nga aspekti funksional. Andaj, fonologjinë e kanë marrë si nëndegë të fonetikës të quajtur fonetikë funksionale.

Me fjalë të tjera, fonetika studion mënyrën e nyjëtimit të tingujve dhe vetitë akustike të tyre, ndërsa fonologjia studion funksionin e tyre në procesin e komunikimit. Me zgjerimin e njohurive për to, tani fonetika dhe fonologjia janë dy dije më vete, por me ndërlidhje shumë të ngushtë e të pandashme. *Fonetika studion tingujt e të folurit, ndërsa fonologjia studion fonemat e gjuhës.*

b) **Ndërlidhja e fonetikës me drejtshqiptimin (ortoepinë) dhe drejtshkrimin (ortografinë).** Fonetika ka lidhje të ngushtë me drejtshqiptimin. Rrjedhimisht, një degë e fonetikës quhet *fonetikë normative*. Mënyra e nyjëtimit të drejtë të tingujve në gjuhët standarde, ndryshimet e tyre në fjalë, rrokja, theksi, intonacioni etj., që paraqesin lëndë të fonetikës, janë njëkohësisht edhe normë letrare për shqiptim të drejtë.

Midis shqiptimit letrar dhe drejtshkrimit fonetik ka një lidhje të ndërsjellë. Siç dihet, drejtshkrimi i shqipes mbështetet në parimin fonetik (më drejt në atë fonologjik), sipas të cilit fjalët shkruhen ashtu siç shqiptohen (me pak përjashtime).

Mësimi i tingujve nuk bëhet i shkëputur nga fjala e fjalia. Shkronjat janë shenja të caktuara të shkrimit, me anën e të cilave paraqiten grafikisht tingujt themelorë. Tingujt themelorë apo fonemat e gjuhës kanë shkronjat e veta.

c) **Lidhja e fonetikës (më saktë e fonologjisë) me morfologjinë.** Fonetika e fonologjia kanë lidhje të ndërsjellë me morfologjinë. Në bazë të kësaj ndërlidhjeje është formuar një disiplinë e ndërmjetme e quajtur **morfologji** (morfologji+fonologji). Këmbimet e tingujve janë lëndë e fonetikës, ndërsa këmbimet e fonemave janë çështje të fonologjisë, por disa

ndërrime fonemash kanë vlerë morfologjike. Me fjalë të tjera, disa ndërrime fonetike historike tani kanë vlerë morfologjike. Kështu, p.sh. një numër i konsiderueshëm emrash shumësin e bëjnë me metaforë, si: *plak ~ pleq, dash ~ desh*; disa me qiellzorëzim: *ujk ~ ujq, kungull ~ kunguj, lepur ~ lepuj* etj. Këmbime fonemash kemi edhe në shumë raste të tjera, si *derë ~ dyer*; unë *dal*, ti *del* (koha e tashme), unë *dola* (e kryer e thjeshtë), *dalë* (pjesore) etj.

Këto ndërrime dikur janë kryer nga kushtëzime fonetike, d.m.th. janë realizuar si variante kombinatorë të fonemave, por tani plotësisht janë morfologjizuar. Duke u marrë me studimin e veçorive dhe të rregullsive të përdorimit të mjeteve fonologjike për ndërtimin e morfemave dhe për dallimin e kuptimeve gramatikore, morfonologjia luan rolin e një hallke lidhëse midis fonologjisë dhe morfologjisë.¹⁰

ç) **Lidhjet e fonetikës me sintaksën.** Lidhjet e fonetikës me sintaksën vërehen sidomos në intonacion. Theksat e ndryshëm (i fjalës, i togfjalëshit, i fjalisë, i periudhës), pauzat, ngritja dhe ulja e zërit në ligjërimin e folur e veçojnë kumtimin në fjalë e togfjalësha, por edhe e lidhin atë në njësi më të mëdha, në fjali e periudha, që për nga qëllimi dhe përbërja mund të jenë të ndryshme. Kjo në të shkruar pasqyrohet deri diku me shenjat e pikësimit. P.sh. kur përbërja dhe radhitja e fjalëve në fjali është e njëjtë, ato mund të dallohen nga qëllimi i thënies (si fjali dëftore, pyetëse ose thirrmore) vetëm nga intonacioni: *Erdhi. Erdhi? Erdhi!*

Edhe theksi logjik i fjalisë dëshmon për ndërlidhje të këtyre dy dijeve. Bie fjala, me mjete të ndryshme fonetike: me intonacion të ngritur, me ngadalësimin e të folurit etj., veçojmë një pjesë të fjalisë si më të rëndësishme: *Artani* punon në fabrikë (vihet në pah kryesi i veprimit, kryefjala). *Artani punon* në fabrikë (dalohet veprimi, folja). *Artani punon në fabrikë* (vihet në spikamë vendi, rrethanori i vendit).

Lidhja e fonetikës me sintaksën shprehet edhe në fonetikën sintaksore. Ndryshimet e fjalëve në ligjërimin e lidhur janë ndryshime me karakter fonetik, por shkaqet e krijimit të tyre janë kryesisht sintaksore; prandaj dukuritë e përfutuara në këto raste kanë lidhje me fonetikën dhe me sintaksën, gjë që përlligj edhe termin *fonetikë sintaksore*.

d) **Lidhjet e fonetikës me leksikologjinë, semiologjinë dhe me semantikën.** Tingujt në gjuhë përmbushin dy funksione: perceptiv dhe shenjuese (sinjifikative). Funksioni perceptiv i bën njësitë gjuhësore të kapshme për ne (tingujt t'i dëgjojmë, ndërsa shkronjat t'i shohim). Funksioni shenjues (diferencues) apo kuptimdallues bën që në bazë të përbërjes tingullore të dallojmë kumtimin e njërive gjuhësore. Lidhja tinguj-kuptim është e pamotivueshme, prandaj gjëja e parë që duhet të bëjë folësi është kodimi semantik.¹¹ Tingujt që nuk kanë kuptim të mëvetësishëm janë material ndërtimor për njësitë me kuptim (morfemat, fjalët). Ata radhitën linearisht, por

¹⁰ Rahmi Memushaj, *Morfonologji e eptimit ...*, f. 8-40.

¹¹ Nuri Gokaj, *Baza të gjuhësisë së përgjithshme*, Shkodër, 1997, f. 18.

çdo kombinim tingujsh nuk paraqet fjalë apo njësi të kuptimshme. Në të vërtetë, vetëm një numër i vogël kombinimesh tingullore në një gjuhë shprehin fjalë të kuptimshme, khs. *laps – sapl, apls, aslp; libër – bilër, rilëb, ëlirb* etj. Disa tinguj, p.sh., parashtesat *sh, zh, ç* nistore i japin kuptim të kundërt fjalës, si *fryj – shfryj; dredh – zhredh; organizoj – çorganizoj* etj. Kjo lidhje shihet edhe në vendin e theksit në disa fjalë me përbërje të njëjtë tingullore, por me kuptim tjetër: *arí – ári, barí – bári, argjentári – argjentarí, drejtóri – drejtorí* e të ngjashme. Modeli i gjuhësisë me ndërlidhjet e shkencave gjuhësore mund të paraqitet si vijon:¹²




Fig. 2. Modeli i gjuhësisë (sipas S. Ullmann-it)

dh) **Lidhjet e fonetikës me letërsinë dhe me stilistikën.** Roli i theksit, i ritmit dhe i elementeve të tjera prozodike në poezi studiohen në kuadër të metrikës, veçmas në aspektin e strukturës së strofave, vargënimit - *versifikacionit*. Këtu gjen shprehje edhe *simbolika tingullore* - lidhja e drejtpërdrejtë e vlerave tingullore me vetitë, ndjenjat dhe mbresat e botës jashtëgjuhësore. Siç është ligjërimi gjithnjë shprehje e mendimit dhe e ndjenjave, studimi i afektivitetit në ligjërim paraqet çështje themelore e studimit për stilin.

Ligjërimi ynë realizohet në stile të ndryshme dhe secili prej tyre i ka, përveç tipareve të tjera dalluese (leksikore dhe gramatikore), edhe tiparet e veçanta të të shqiptuarit.

Fonetika e gjuhës së sotme shqipe ndërlidhet edhe me:

Dialektologjinë. Nëpër të folmet tona shihen më së miri realizimet e ndryshme të të njëjtës fonemë apo variantet kombinatorë e pozicionale të

¹² S. Ullmann, *The Principles of Semantics*, Glasgow – Oxford, 1957, f. 39.

tingujve, si edhe disa dukuri të tjera, siç janë shtimi e rënia e tingujve, rotacizmi në toskërishten etj.

Historinë e gjuhës. Lidhja e fonetikës me historinë e gjuhës vërehet sidomos në disa dukuri fonetike historike që tanimë janë fonologjizuar, të cilat kanë përfshirë mbarë shqipen, si metafoia, apofonia, qiellzorëzimi etj.

Fonetika ka lidhje të ngushtë edhe me *sociologjinë* (saqë është krijuar një disiplinë e përbashkët: sociolinguistika), *psikologjinë* (duke formuar një disiplinë të ndërmjetme: psikolinguistikën), *neurologjinë* (neurolinguistikën); por edhe me shkencat natyrore: *fiziologjinë* (në përcaktimin e mënyrës së nyjëtimimit të tingujve); *fizikën* (për të hulumtuar vlerën akustike të tingujve); *rentgenografinë*, *kinematografinë* (për të parë lëvizjet e organeve të të folurit me anë të mjeteve teknike) etj.

1.3. RËNDËSIA TEORIKE DHE PRAKTIKE E FONETIKËS

Të parashtruarit e pyetjes për dobinë praktike të kësaj ose asaj dijeje do të ishte në kundërshtim me frymën shkencore. Dobia a zbatimi praktik i ndonjë diturie është i mirëseardhur, por ky nuk është qëllimi kryesor i hulumtimit. Shkencëtari hulumton që të thellojë e zgjerojë njohuritë për natyrën dhe shoqërinë. P.sh. zbulimet shkencore të fizikës ose të mjekësisë, kanë gjetur zbatim praktik të drejtpërdrejtë, atëherë kur ndoshta më së paku është menduar për dobinë praktike të tyre. Zbatimi praktik shpeshherë ka qenë rrjedhje e papritur e hulumtimit teorik. Në këtë kuptim, fonetikani bën vëzhgime që të njohë sa më mirë të folurit, por, shumica e arritjeve teorike në fushën e fonetikës gjejnë edhe zbatim praktik.¹³

Fonetika ka rëndësi teorike, sepse me anën e gjurmimeve dhe të analizave fonetike kuptohet në baza shkencore struktura e njësive vijore (segmentore) dhe jovicore (mbisegmentore) dhe të gjuhës – baza materiale e saj. Pa njohjen e përbërjes fonetike të gjuhës, për shembull, nuk mund të përpiloheshin e as të përpilohen alfabetet e gjuhëve që ende nuk i kanë.

Kuptohet se fonetika si degë e gjuhësisë ka rëndësi të veçantë për shkencat e tjera gjuhësore. Çdo gjuhëtar duhet të jetë i pajisur edhe me njohuritë për bazën materiale të gjuhës. Kështu, për të studiuar historinë e gjuhës, duhet të dihet mirë fonetika, përkatësisht fonologjia historike dhe ajo përshkruese. Për dialektologun, fonetika është e domosdoshme. Fonetika ka rëndësi parësore edhe për teorinë linguistike.¹⁴

Në ditët e sotme forma e folur e komunimit ka rëndësi të veçantë. Falë zbulimeve teknike, siç janë telefoni, radioja, magnetofoni, televizori, kamera, filmi etj. të folurit gjithnjë e më shumë po e zëvendëson të shkruarit. Andaj, duhet të flasim shumë mirë nëse dëshirojmë të lëmë përshtypje të mirë te

¹³ Bertil Malmberg, *Fonetika*, Sarajevë, 1974, f. 107.

¹⁴ Po aty, f. 109.

publiku dhe që të ndikojmë tek ai. Mënyra e të folurit tanimë nuk është çështje individuale e njeriut, atë e vlerësojnë të gjithë ata që dëgjojnë mesazhin e politikanit, shkencëtarit, artistit dhe përfaqësuesve shtetërorë të shoqërisë. Opinionin nuk e përbëjnë si dikur vetëm rrethi i ngushtë familjar, shokët ose fqinjët e tubuar rreth folësit më së largu disa metra. Të folurit publik tani e dëgjojnë mijëra e miliona njerëz. Prandaj, edhe nevoja që të flasim bukur është shtuar.

Diksioni - mjeshtëria e të folurit të mirë - zë vend të rëndësishëm në arsimimin bashkëkohor dhe, pa dyshim, meriton vëmendje edhe më të madhe. Fonetika është bazë e domosdoshme e të mësuarit të diksionit. Frymëmarrja e parregullt, zëri i turbullt dhe diksioni jo i mirë neveritin dëgjuesit. Është e nevojshme të njohim mekanizmin e punës së organeve të të folurit, veçmas të gjuhës, buzëve, qiellzës së butë etj., që të jemi në gjendje të përmirësojmë gabimet e ndryshme shqiptimore që dëgjohej te fëmijët dhe te të rriturit.

Logopedia merret me dukuritë patologjike si ato të natyrës artikulative (që janë pasojë e të metave anatomike ose shprehive të këqija), ashtu edhe ato të çrregullimeve të sistemit nervor qendror (dukuritë e afazisë) apo të dëgjuarit të dobët. Për mënjanimin e dukurive fonetike patologjike gjithsesi duhet ditur fonetika normale.

Fonetika siguron bazë normative edhe për shqiptimin dhe shkrimin e drejtë të gjuhës standarde. Bie fjala, ai që dëshiron të shmangë nyjëtimin e parregullt të tingujve mesgjuhorë [q, gj], përkatësisht shqiptimin më të përpamë të tyre si paragjuhorë afrikatë [ç, xh], këtë mund ta arrijë vetëm nëse di tiparet fiziologjike e akustike të nyjëtimit normativ të këtyre bashkëtingëlloreve. Me shqiptimin e rregullt të tingujve arrihet edhe shkrimi i drejtë i tyre.

Edhe **mësimi i gjuhëve të huaja** paraqet fushë, në të cilën fonetika ka rol të madh praktik. Ai që do të mësojë të flasë si duhet një gjuhë të huaj, para së gjithash duhet të zotërojë një numër të madh shprehish të reja nyjëtimore (një bazë të re artikulative). Ky sistem i ri shprehish artikulative, përveç nyjëtimit të rregullt të të gjithë tingujve të gjuhës së huaj, përfshin edhe theksin, intonacionin etj. Pa njohjen solide edhe të fonetikës së gjuhës së huaj edhe të gjuhës amtare, arsimtari i gjuhës së huaj asnjëherë nuk do të arrijë që t'i mësojë nxënësit e vet ta flasin ashtu siç duhet gjuhën e huaj.

Me probleme thuajse të njëjta përballet edhe ai që flet gjuhën dialektore apo ai që dëshiron të çlirohet nga shqiptimi territorial ose jonor-mativ dhe të përvetësojë shqiptimin letrar. Sa më i madh të jetë dallimi ndërmjet artikulimit vendor dhe normës shqiptimore letrare, aq më të mëdha janë vështirësitë, ndërsa njohja e fonetikës bëhet edhe më e domosdoshme.

Përmbledhtas, mund të themi se, përveç rëndësisë teorike, **fonetika ka rëndësi të madhe praktike**. Ajo:

- Paraqet bazë për drejtshqiptimin dhe drejtshkrimin.

- Siguron njohuri për metodikën e mësimdhënies së leximit dhe të shkrimit.
- E ndihmon ndreqjen e të metave në shqiptim (logopedi).
- E ndihmon metodën e të mësuarit për të folur shurdhmemecët (surdopedagogji).
- Për mësimin e gjuhëve të huaja është e domosdoshme njohja e fonetikës së gjuhës amtare si dhe e gjuhës së huaj. Me krahasimin e tyre më shpejt dhe më lehtë përvetësohet gjuha e huaj.
- Njohuritë e fonetikës ndihmojnë për analizën e gjuhës dhe të stilit të shkrimtarëve.
- Të dhënat e fonetikës ndihmojnë për automatizimin e makinave të prodhimit, mjeteve të informimit, makinave të përkthimit, telefonisë, radioteknikës, kompjuteristikës etj. Nga ana tjetër të gjitha këto mjete teknike shfrytëzohen për hulumtime fonetike.

Perceptimi i të folurit sot studiohet edhe me ndihmën e *sintezës së të folurit*, përkatësisht prodhimit të tingujve artificialë me rrugë elektronike. Me këtë ka lidhje edhe *identifikimi automatik* i të folurit, si pjesë e ndërveprimit të njerëzve me makinat. Sigurisht se në një të ardhme të afërt do të kemi makina, të cilat të folurit do të mund ta shkruajnë dhe anasjelltas, që shkrimin ta lexojnë. Sa u përket makinave që edhe vetë flasin, rezultate të dukshme janë arritur në robotikë, që deri diku shfrytëzohen edhe në praktikë. Hulumtimet teorike në fushë të re të *intelegjencës artificiale* premtojnë zbulime të reja dhe zgjidhjen e çështjes, e cila njeriun qëmoti e mundon: vallë makinat mund ta prodhojnë dhe ta kuptojnë ligjërimin njerëzor.

Për shkak të mungesës së shtetit të përbashkët dhe të njësisë fetare, gjuha ka shërbyer dhe do të shërbejë për shqiptarët si tipar themelor i identitetit kombëtar. Ajo do të mbetet një nga mjetet kryesore për ruajtjen e njësisë kombëtare edhe në kohët moderne të integritimit dhe të globalizmit. Për një komb si yni, me dy shtete, me troje etnike jashtë kufijve të tyre politikë dhe me diasporë të madhe e shumë të shpërndarë, si dhe me rreth një të tretën e popullsisë në emigracion, gjuha standarde mbetet nyja kryesore lidhëse.

Prandaj, zotërimi i normave të gjuhës standarde, përveçse domosdoshmëri, përbën dhe një detyrim atdhetar. Për të gjitha këto arsye, mësuesi i gjuhës shqipe dhe i letërsisë duhet jo vetëm *ta njohë teorikisht sistemin fonetik të gjuhës standarde*, por edhe *ta zotërojë praktikisht normën e saj drejtshqiptimore*. Vetëm në këtë mënyrë ai do të jetë në gjendje të bëhet vetë shembull i shqiptimit korrekt, por edhe të ndreqë shqiptimet jonormative të nxënësve për t'i përgatitur ata të marrin pjesë si të barabartë në jetën kombëtare.¹⁵

¹⁵ Rami Memushaj, *Fonetika e shqipes standarde*, Toena, Tiranë, 2009, f. 15.

1.4. FONETIKA NYJËTIMORE

Fonetika nyjëtimore studion mënyrën e prodhimit të tingujve të ligjërimimit. Ajo merret edhe me përshkrimin e aparatit të të folurit të njeriut dhe lëvizjet e pozicionet organeve të caktuara për të nyjëtuar tingujt. Për t'i përshkruar tingujt nga ana nyjëtimore, duhet njohur ndërtimi i aparatit të të folurit dhe mënyra se si funksionon ai për prodhimin e tingujve.

1.4.1. APARATI I TË FOLURIT

Ligjërimi i njeriut është proces artikullativ, që kryhet nëpërmjet lëvizjeve përkatëse të organeve të të folurit. Ligjërimi me gojë realizohet me punën e koordinuar të të gjitha organeve të të folurit nga sistemi nervor. Me fjalë të tjera, të folurit tonë është proces i ndërlikuar fiziologjik, që vë në veprim organet e shtytjes së ajrit (mushkëritë), organet dridhëse (pejzat e zërit), zgavrat rezonatore (zgavrën e laringut, e gojës dhe e hundës) dhe sistemin nervor, që komandon dhe harmonizon lëvizjet e organeve të aparatit të të folurit.

Për t'i studiuar tingujt në këtë aspekt, është e nevojshme të njohim ndërtimin e aparatit të të folurit si dhe mënyrën e funksionimit të tij. Këto njohuri do të shërbejnë për klasifikimin e tingujve si dhe për shqiptimin e drejtë të tyre.

Aparatin e të folurit e përbëjnë të gjitha organet që marrin pjesë në prodhimin e tingujve. Të gjitha së bashku, nga mushkëritë e deri te goja, formojnë tërësi të pandërprerë, që gjenden në kafazin e krahavorit, qafë dhe kokë. Organet e të folurit kryejnë funksione fiziologjike, që janë jetësore: frymëmarrja, marrja e ushqimit, shijimi (me gjuhë) dhe nuhatja (me hundë). Por, te njeriu këto organe kanë fituar edhe një funksion të dytë: nyjëtimin e tingujve. Kur flasim për aspektin anatomo-fiziologjik, e kemi parasysh kryesisht punën e organeve të caktuara të organizmit të njeriut, të cilat marrin pjesë në prodhimin e tingujve të të folurit. Aparatin e të folurit e përbëjnë:

1. Aparati i frymëmarrjes;
2. Aparati i fonacionit (laringu);
3. Aparati artikullativ (zgavrat e mbilaringut);
4. Aparati i të dëgjuarit;¹⁶ dhe
5. Sistemi nervor.

¹⁶ Duke pasur parasysh ndërlidhjen e të dëgjuarit me të folurit dhe faktin se pa dëgjuar njeriu nuk mund të flasë, disa gjuhëtarë në organet e të folurit përfshijnë edhe aparatit e të dëgjuarit. Shih: Л. Р. Зиндер, *Общая фонетика*, Москва, 1979, 1979, f. 95.




Fig. 3. Pamje në profil e organeve të të folurit

1. Në **organet e frymëmarrjes** bëjnë pjesë: diafragma, kafazi i krahavorit, mushkëritë, bronket dhe trakeja (gabzherri). *Diafragma* dhe *kafazi i krahavorit* me muskujt e tyre bëjnë zmadhimin dhe zvogëlimin e vëllimit të zgavrës së gjoksit dhe të mushkërive. Mushkëritë luajnë rolin e një pompe, që e shtynë ajrin lart, drejt trakesë dhe laringut, duke i dhënë ajrit energjinë e nevojshme për prodhimin e tingujve.¹⁷

Frymëmarrja (respiracioni) nënkupton dy faza: thithjen e ajrit (frymëthithjen) dhe nxjerrjen e tij (frymëqitjen). Gjatë frymëthithjes diafragma ulet dhe me ngritjen e brinjëve mushkëritë zgjerohen së bashku me kafazin e krahavorit. Zmadhimi i vëllimit sjell rënien e shtypjes së ajrit në mushkëri. Meqë shtypja e ajrit në natyrë është më e madhe sesa trysnia brenda mushkërive kur janë të zgjeruara, mushkëritë tërheqin ajër dhe mbushen me të.

Gjatë frymënxjerrjes diafragma ngrihet përpjetë dhe brinjët lëshohen, që ka për pasojë zvogëlimin e vëllimit të mushkërive, rritjen e trysnisë dhe nxjerrjen jashtë të një pjese të ajrit. Ajri që del nga mushkëritë, kalon në bronke, pastaj në trake, laring dhe nëpër zgavrat e hundës ose nga goja del jashtë. Kjo sasi e ajrit që nxirret jashtë shfrytëzohet për të folur.

Rëndom, cikli i frymëmarrjes përsëritet në çdo pesë sekonda. Kur nuk flasim, frymëthithja dhe frymëqitja bëhet në kohë afërsisht të barabarta. Gjatë ligjërimin thithja e ajrit shpejtohet, kurse nxjerrja e tij ngadalësohet mjaft.

¹⁷ Rami Memushaj, *Fonetika e shqipes standarde*, Toena, Tiranë, 2009, f. 20.

2. **Aparati i fonacionit** përbëhet nga *laringu* (lat. larynx, fyti). Laringu përbën pjesën e sipërme të zgjeruar të trakesë. Ai është një gyp kërcor me përmasë 2 cm, që ndodhet para ezofagut, në nivelin e fikthit (mollës a mollëzës së Ademit apo siç e quajnë ndryshe edhe mollëza e fytit, arrëza e fytit), i cili dallohet qartë sidomos te meshkujt. Laringu formohet nga katër kërcë të lidhura me njëra-tjetrën me fije muskulore të shkurtra dhe elastike. Më e madhja prej tyre është kërcja *tiroide*, që, e parë nga lart, ka formën e shkronjës V. Kjo kërcë është vendosur në pozicion të rrafshët në laring, kulmi i saj formon fikthin, kurse brinjët shkojnë prapa. Te pjesa e përparme e kërcës tiroide janë ngjitur dy tufa muskujsh elastikë që quhen tejsat e zërit (lat. plicae vocales; që quhen edhe pejza, korde të zërit, korde vokalike). Nga ana e prapme, tejsat e zërit lidhen me dy kërcë në formë piramide, të cilat janë të lëvizshme. Këto janë kërcetë aritenoide, që rrotullohen në rrafshin horizontal si krahët e një gërshëre, duke i ndarë ose puqur tejsat e zërit.

Gjatë të të ushqyerit laringun e mbulon kapaku i tij, epiglota (mbishtëkthi, ashti i nëngjuhës), që të mos depërtojë ushqimi në trake, më pas në bronke e mushkëri. Nëse ndodh kjo, atëherë mund të ngulfatemi; prandaj të flasim me ushqim në gojë është jo vetëm e pahijshme, por mund të jetë edhe e rrezikshme për shëndetin e jetën.

2.1. **Tejsat e zërit** janë pjesa më e rëndësishme e laringut, organ pa të cilin nuk mund të krijohen tingujt. Ato janë dy fije (palosje) muskulore elastike në formën e buzëve me gjatësi rreth 17-22 mm te meshkujt dhe 11-16 mm te femrat. Hapësira midis tejsave të zërit quhet shtegth i zërit ose *glotë*. Falë lëvizjeve të kërcëve aritenoide, tejsat mund të afrohen ose të largohen, duke ndryshuar kështu madhësinë dhe formën e shtegthit të zërit.¹⁸




Fig. 4. Tri pozicionet e glotës:

a) gjatë frymëmarrjes normale, b) gjatë të folurit dhe c) gjatë pëshpëritjes.

Skicat na paraqesin tri konfiguracione të glotës, që varen nga pozicioni i tejsave. Në pozicionin (a) nga rrotullimi së jashtmi i kërcëve aritenoide tejsat e zërit janë të larguara dhe glota e hapur në formë trekëndëshi. Rryma e ajrit kalon pa i dridhur tejsat, si në frymëmarrjen e qetë ose kur shqiptojmë tingullin [h]. Zhurma e prodhuar nga kalimi i ajrit në këtë mënyrë quhet *zhurmë laringale*. Në pozicionin (b), si rrjedhim i lëvizjes së përkundërt të

¹⁸ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 63-64.

aritenoidëve, tejsat e zërit puqen dhe tendosen, duke e mbyllur glotën. Nën shtypjen e ajrit nënglotal tejsat e zërit dridhen në mënyrë ritmike. Këto dridhje prodhojnë *zërin* ose *tonin laringal*, që është elementi bazë i tingujve të zëshëm. Në pozicionin (c) glota është e mbyllur në pjesën e saj të përparme dhe e hapur në formën e një trekëndëshi të vogël në pjesën e saj të prapme (si rrjedhim i një rrëshqitjeje prapa të aritenoidëve). Rryma e ajrit, duke kaluar përmes saj, shkakton dridhje joritmike të tejsave të zërit. Zhurma e përftuar në këtë mënyrë është karakteristike për pëshpëritjen.

Për nyjetimin e tingujve të ligjërimit me rëndësi janë dy pozicionet e para të tejsave. Ato janë burimi dhe shkaku i ndarjes së tingujve të ligjërimit në dy klasa të mëdha: në të shurdhët dhe të zëshëm.

Tejsat e zërit me shpejtësinë dhe forcën e lëkundjes përcaktojnë lartësinë dhe qartësinë e të folurit. Nga dridhjet e tejsave të zërit fitohen tinguj të ndryshëm, që përcaktojnë lartësinë (regjistrin) e të folurit. Shkalla e tendosjes së tejsave, gjatësia dhe elasticiteti i tyre, përveç karakterit të përgjithshëm në një gjuhë, pjesërisht varen edhe nga veçoritë individuale (varet nga gjinia, mosha, anatomia e aparatit të të folurit etj.).

Sa më të shkurtra dhe më të holla të jenë tejsat, frekuenca e zërit është më e madhe dhe anasjelltas. Prandaj, është krejt normale që gratë dhe fëmijët flasin e këndojnë me regjistër më të lartë sesa meshkujt. Zakonisht **femrat këndojnë për një oktavë** (tetë nota) **më lart se meshkujt**. Shpejtësia mesatare e dridhjes së tejsave të meshkujt është 100-150 Hz, ndërsa të gratë dyfish më i madh, gjegjësisht 200-300 Hz.¹⁹

Ndërmjet meshkujve dhe femrave ka edhe dallime të tjera fiziologjike në organet e të folurit. Për shkak të vëllimit më të vogël të mushkërive, frymëmarrja dhe frymëqitja të femrat (dhe të fëmijët) është më e shpeshtë sesa të meshkujt. Prandaj, përgjithësisht femrat flasin më shpejt, me artikulum më të butë; ton më të lartë dhe më melodik në krahasim me meshkujt.

Procesi i krijimit të tingujve fillon në laring, por përfundon në zgavrat e mbilaringut, meqë toni apo zhurma laringale pëson modifikime në aparatit artikullativ.

3. **Aparatin artikullativ** e përbëjnë zgavrat e mbilaringut, që janë sistem rezonatorësh, ku krijohen tonet ose zhurmat e ndryshme plotësuese, që i mbishtresohen tonit a zhurmës së prodhuar në laring. Katër *rezonatorët kryesorë të aparatit të të folurit* janë: 1) zgavra e faringut, 2) zgavra e gojës, 3) zgavra e hundës, dhe 4) zbrazëtira midis dy buzëve (të paraqitura në figurën e mëposhtme):

¹⁹ Por, duhet thënë se gjatë të kënduarit sopranët mund të arrijnë edhe deri më 1300 Hz, ndërsa basët vetëm deri më 80 Hz.




Fig. 5. Katër rezonatorët kryesorë të aparatit artikullativ: 1) zgavra e faringut, 2) zgavra e gojës, 3) zgavra e hundës dhe 4) zbraçëtira midis dy buzëve

3.1. **Faringu** është një gyp muskolor në formë hinke, që në të dy skajet ndahet më dysh: nga poshtë lidhet me laringun dhe me ezofagun, kurse në pjesën e sipërme me zgavrën e gojës dhe të hundës. Në faring ndodhen dy valvula, poshtë *epiglota* (mbishtëgthi), e cila nuk lejon kapërcimin në laring të lëngjeve ose të ushqimit, kurse lart *uvula* (njerithi), që mbyll ose lejon kalimin e ajrit në zgavrën e hundës. Përgjithësisht, faringu shërben si rezonator ku formohen tone plotësuese të tingujve, pasi aty nuk formohen tinguj të shqipes.

3.2. **Zgavra e gojës** është vazhdim i zgavrës së faringut, që fillon nga njerithi dhe mbaron te buzët. Ajo përbën organin nyjëtitor më të rëndësishëm, sepse aty ndodhen organet e të folurit që u japin tingujve formën përfundimtare. Goja me organet e saj bëjnë prodhimin përfundimtar të tingujve. Në të janë të vendosura: njerithi (lat. *uvula*), qiellza (lat. *palatum*), dhëmbët (lat. *dentes*), trysat a hojëzat (alveolat, lat. *alveolus*) dhe gjuha (lat. *lingua*). Pjesa e përparme e gojës mbyllet me buzët (lat. *labia*).

Uvula (njerithi) është pjesa e fundit e qiellzës së butë. Gjatë frymëmarrjes, uvula qëndron e varur teposhtë. Kur flasim, ajo mund të ngrihet dhe ta mbyllë zgavrën e hundës, si rrjedhim i gjithë ajri kalon nga goja; ose mund të ulet, duke e lënë ajrin të kalojë edhe nga hundët edhe nga goja.

3.3. **Buzët** kanë rol mjaft të rëndësishëm në formimin e tingujve. Ato marrin pjesë në nyjëtimin e tingujve *buzorë* (labialë, bashkëtingëlloreve buzore) dhe të *buzorëzuar* (të labializuar, zanoreve të buzorëzuara). Falë lëvizshmërisë dhe elasticitetit, ato mund të rrumbullakosen, të tërhiqen përpara apo të puthiten dhe kështu të modifikojnë gjatësinë dhe vëllimin e zgavrës së gojës. Veç kësaj, ato mund të formojnë mbyllje të plotë (te bashkëtingëlloret dybuzore) apo buza e poshtme t'u afrohet dhëmbëve të sipërm dhe të formojë shteg (te bashkëtingëlloret buzore-dhëmbore). Nga të dyja buzët, e poshtmeja është më aktive. Vlen të përmendet edhe rëndësia e buzëve si organ i vetëm i dukshëm i aparatit të të folurit për komunikimin gojor. Në shumë raste, kur ka zhurmë apo kur bashkëbiseduesi nuk dëgjon

mirë, dikush flet me zë të ulët etj., dëgjuesi përcjell me sy lëvizjen e buzëve që të kuptojë më mirë.

3.4. **Dhëmbët** nuk janë të parëndësishëm, sepse marrin pjesë në formimin e pengesës gjatë shqiptimit të disa bashkëtingëlloreve (bashkë me majën e gjuhës ose të buzës së poshtme: të bashkëtingëlloret ndërthëmbore dhe buzore-dhëmbore).

3.5. **Gjuha** përbëhet nga rrënja (lat. radix), trupi dhe maja (lat. apex): *rrënja* është e palëvizshme, pasi është e lidhur me ashtin e nëngjuhës; pjesa e sipërme e gjuhës quhet *shpinë* (lat. dorsum). Gjuha është organi më i lëvizshëm i aparatit të të folurit. E përbërë nga muskujt, mund të lëvizë para, të tërhiqet prapa, të ngrihet përpjetë etj.

Duke ndryshuar formën dhe vëllimin e rezonatorit të gojës, gjuha luan rol vendimtar në nyjetimin e zanoreve dhe, duke mbyllur plotësisht ose pjesërisht kalimin e ajrit nga zgavra e gojës, gjuha luan rol jo më pak të rëndësishëm në formimin e bashkëtingëlloreve. Roli i saj në ligjërim është aq i madh sa që emri “gjuhë” pothuaj në të gjitha gjuhët e botës ka marrë kuptimin edhe të ligjërimin (lat. lingua, fr. language; në gjuhët sllave jehzik, jazik, ezik).

Në pikëpamje fonetike, gjuha ndahet në tri pjesë: pjesën e përparme (lat. praelingua), pjesën e mesme (lat. mediolingua) dhe pjesën e prapme (lat. postlingua).

3.6. **Qiellza** formon kubënë e zgavrës së gojës dhe bën ndarjen e rezonatorit të gojës dhe të hundës. Pjesa e përparme e saj është *qiellza e fortë* (lat. palatum), që mbaron aty ku fillojnë dhëmballët, kurse pjesa e prapme është *qiellza e butë* (lat. velum). Fonetikisht, edhe qiellza ndahet në pjesën e përparme, të mesme dhe të prapme. Në pjesën e përparme të qiellzës së fortë gjenden *hojëzat a alveolat* (mishrat e dhëmbëve), që vijnë menjëherë pas dhëmbëve dhe kanë formë të mysët.

Qiellza e butë në pjesën e prapme ka një zgjatje muskulore që quhet *njerith* (uvulë). Pra, uvula është pjesa e fundit e qiellzës së butë. Gjatë frymëmarrjes së zakonshme, ajo qëndron e varur poshtë. Kur flasim, uvula mund të ngrihet dhe të mbyllë zgavrën e hundës, duke bërë që e tërë rryma e ajrit të kalojë nga goja, ose mund të ulet poshtë e ta lejojë rrymën e ajrit të kalojë edhe nga hunda, edhe nga goja.

Lëvizja e njerithit mundëson që tingujt të jenë gojorë (oralë), hundorë (nazalë) ose të hundorëzuar (të nazalizuar). Në shqipen standarde të gjitha zanoret janë gojore si edhe 26 bashkëtingëllore. Bashkëtingëllore hundore janë tri: [m], [n] dhe [nj].




Fig. 6. Me numra janë shënuar: 1. qiellza e fortë; 2. qiellza e butë; 3. maja e gjuhës; 4. pjesa e përparme e gjuhës; 5. pjesa e mesme e gjuhës; 6. pjesa e prapme e gjuhës; 7. rrënja e gjuhës.

3.7. **Zgavrat e hundës** gjatë formimit të tingujve në shqipen standarde kanë rol të kufizuar. Këto shërbejnë si rezonator dhe ndikojnë në strukturën akustike të disa tingujve, duke e bërë tingullin hundor ose të hundorëzuar.²⁰

Organet e lëvizshme dhe të palëvizshme. Organet e të folurit, sipas lëvizshmërisë/palëvizshmërisë, ndahen në dy grupe: organe të lëvizshme (aktive) dhe të palëvizshme (pasive). Organe të lëvizshme janë: tejtat e zërit, guha, buzët, qiellza e butë dhe njerithi; ndërsa organe të palëvizshme janë: qiellza e fortë, dhëmbët dhe alveolat, pasi shërbejnë si vende ku mbështeten ose afrohen organet e lëvizshme.

4. **Sistemi nervor qendror.**- Gjithë punën e aparatit të të folurit për prodhimin dhe përkapjen e tingujve e drejton sistemi nervor qendror, i cili u dërgon komanda organeve të të folurit dhe kontrollon e bashkërendon veprimtarinë e tyre. Truri është pjesë e sistemit nervor. Ai është qendra e

²⁰ Gegërishtja, përveç zanoreve gojore, ka zanore të hundorëzuara si dhe zanore hundore me vlerë fonologjike. Zanore të hundorëzuara ndonjëherë mund të dëgjojnë edhe në të folmet toske dhe në shqipen standarde. Por, vetëm në pak gjuhë të Evropës hundorësia ka funksion gjuhësor: në frëngjishte, portugalishte, polonishte e në dialektin Verior të shqipes. Në gjuhët e tjera ndonjëherë dëgjojnë zanore me timbër hundor, nën ndikimin e përngjashmimit prapavajtës në takim, d.m.th. të njëres nga hundoret [m, n, nj] që shqiptohet pas zanores, por ky hundorëzim i zbehtë i zanores nuk luan rol gjuhësor (nuk është as bartës i dallimeve semantike e as atyre gramatikore).

kontrollit të trupit që kryen mijëra detyra për funksionimin e trupit pa vetëdijen tonë si dhe kryen funksione të tjera që i bëjmë me vetëdije.

Pra, të gjitha lëvizjet e organeve të të folurit drejtohen nga *qendra motore* e të folurit (qendra e Brokës). Nga ana tjetër, impulset që lindin në vesh nga përkapja e tingujve të dëgjuar, përcillen me anë të nervave ndijore në *qendrën dëgjimore* (në qendrën e Vernikut), ku bëhet zbërthimi i mesazhit të marrë. Të dyja këto qendra, që ndodhen në hemisferën e majtë të trurit (qendra e Brokës në pjesën e përparme, e Vernikut në pjesën e prapme të trurit), janë të lidhura ngushtë midis tyre.²¹

Vendi i nyjëtimit të tingujve si dhe mënyra e formimit të tyre ka qenë dhe është kriter kryesor për klasifikimin dhe emërtimin e tingujve. Metoda më e vjetër dhe ende më e përhapur e trajtimit fonetik është ajo që nisët nga artikulimi. Prandaj, tingujt emërtohen dhe klasifikohen rëndom sipas rolit që luajnë organet e të folurit në nyjëtimin e tyre. Kështu, edhe përsëri zhvillimit të fonetikës akustike dhe fonetikës eksperimentale (laboratorike), terminologjia e fonetikës nyjëtimore edhe sot e kësaj dite është më e përhapura dhe më praktikja jo vetëm në shqipen, por edhe në gjuhët e tjera. Kësisoj, mbizotëron emërtimi për bashkëtingëlloret: tinguj paragjuhore, mesgjuhore dhe prapagjuhore; dybuzorë, buzoro-dhëmborë, ndër dhëmborë, alveolarë etj.; ose bashkëtingëllore mbylltore, shtegore a fërkimore, afrikate, dridhëse.

Organet e të folurit funksionojnë si sistem i njësuar dhe i ndërvarur. Ndryshimet individuale në organet e të folurit, në thelb, nuk ndikojnë në mënyrën e prodhimit të tingujve. Ndryshimi midis zërit të një djali dhe të një burri, ose midis zërit të një burri dhe të një gruaje për ligjërimin, në përgjithësi, nuk ka rëndësi. Nuk është i drejtë, gjithashtu, pohimi se baza artikulative e disa popujve është e paracaktuar, përkatësisht se organet e të folurit të racave të caktuara fizikisht janë të përshtatshme vetëm për prodhimin e një klase të caktuar tingujsh. "Paaftësia" për të prodhuar tinguj të caktuar, në përgjithësi, është rezultat i ndikimit të gjuhës së mjedisit gjatë periudhës së fëmijërisë, kurse faktori bazë është mësimi i gjuhës amtare, ashtu siç dëgjohej.²²




Fig. 7. Përhapja e valëve të zërit

²¹ Rami Memushaj, *Fonetika e shqipes standarde*, Toena, Tiranë, 2009, f. 24.

²² John Lyons, *Hyrje në Gjuhësinë Teorike*, Londër, 1968 (botuar në shqip më, 2001, f. 106-107).

Si dëgjojmë?

Valët e tingujve janë lëkundje (oscilime) të cilat përçohen nëpër ajër. Si i përkap (percepton) a regjistron veshi këto valë?

Organi i dëgjimit (veshi) është detektori ynë i valëve tingullore. Në fotografi është paraqitur struktura e veshit.

- Lapra e veshit valët e ajrit i orienton në daullen e veshit, që fillon të dridhet.
- Oscilimet e daulles barten në tri kocka të vogla.
- Ashti më i vogël dridhjet i bart deri te kërmilli (koklea), një gyp i lakuar i mbushur me lëng.
- Lëkundja e lëngut në kërmill i ngacmon qelizat nervore në brendinë e tij. Këta receptorë nervorë përcjellin sinjale deri në tru.




Fig. 8. Struktura e veshit të njeriut

Pra, valët e zërit pranohen nëpërmjet **veshit** të jashtëm, të mesëm dhe të brendshëm (ajo që kemi dy veshë është në dobi të lokalizimit më të saktë të burimit të zërit pa e kthyer kokën; ata që kanë një vesh të shurdhër mund të kenë probleme të kësaj natyreje). Zëri i pranuar që këndeje përmes nervave bartet në **tru**.

Edhe sot e kësaj dite pak dihet për **përkapjen e të folurit** – për atë se si në të vërtetë veshët dhe truri përpunojnë ngacmimin e pranuar, në ç'mënyrë vazhdimësia e valëve të zërit analizohet në elemente diskrete, si në atë rrjedhë të pandërprerë identifikohen tingujt dhe kombinimet e tyre që bartin kuptim. Çështje më vete është se si truri identifikon tingullin “e njëjtë”, kur me metoda akustike mund të tregohet se çdo realizim i ndonjë njësie, fizikisht përherë dallohet me diçka nga të gjitha të tjerat; ose si truri bën seleksionimin, dhe nga gjithë ajo që veshët pranojnë, përzgjedh e dëgjon vetëm atë që “dëshiron”, ndërsa anashkalon atë që “nuk i duhet”. Në dallim nga mundësia e vrojtimit të gojës gjatë prodhimit të tingujve të të folurit (me mjete të ndryshme teknike),

përkapja (perceptimi) e të folurit nga veshët dhe truri nuk mund të vëzhgohet drejtpërdrejt, por duhet studiuar me metoda të tërthorta.²³

Ç'është baza artikulative?

Tërësia e të gjitha artikulimeve të nevojshme për nyjëtimin e tingujve në një gjuhë quhet *bazë artikulative*. Po të krahasohet baza artikulative ndërmjet gjuhëve të veçanta standarde, vërehet se ajo pak a shumë është e ndryshme. E dallueshme është edhe baza artikulative e varianteve territoriale të një gjuhe të përbashkët.

Të folurit është proces i shndërrimit të mendimeve në zë. Të folurit fillon me qëllimin tonë për të komunikuar. Ne i zgjedhim idetë që dëshirojmë t'i shprehim. Zgjedhim fjalët e duhura për t'i transmetuar ato ide. Ne e dimë se si ato fjalë do të tingëllojnë. Qendra të caktuara të trurit krijojnë *programe motorike* neurologjike për lëvizje të caktuara gjatë prodhimit të të folurit. Përmes procesit që quhet *akordim neuromotorik*, truri përgatit muskujt e duhur për të reaguar kur ata pranojnë sinjalin për lëvizje të caktuara.

1.5. FONETIKA AKUSTIKE

Fonetika *akustike* (< greq. e vjetër *acusticos* "të dëgjuar") është degë e fonetikës e cila merret me shpjegimin e natyrës fizike të tingujve të ligjërit. Ndryshe nga fonetika nyjëtimore, ajo është degë e re, e lidhur ngushtë me zhvillimin e shkencave të sakta, të fizikës dhe të matematikës.

Fillimet e fonetikës akustike i përkasin fundit të shek. XIX, por zhvillimet më të mëdha në këtë fushë janë bërë pas Luftës së Dytë Botërore, me përdorimin e aparateve të posaçme, të cilat regjistrojnë me saktësi të madhe veçoritë fizike të tingujve. Karakteri objektiv i të dhënave të nxjerra nga analizat akustike të tingujve është provuar me anë të procesit të kundërt, *sintezës* së tingujve ose *ligjërit sintetik*, që është rindërtim i të folurit.

Këto arritje të fonetikës akustike kanë rëndësi të madhe jo vetëm për gjuhësinë dhe fonetikën në veçanti, por edhe për fushën e zbatimeve praktike, si për telekomandimin, makinat elektronike folëse etj. Për sa i takon gjuhësisë, përdorimi i metodave dhe i mjeteve të fonetikës akustike bën të mundur thellimin në studimin e disa dukurive fonetike që kanë rëndësi të madhe për gjuhën, saktësimin e njohurive tona mbi anën tingullore, të fituara me anën e studimit fiziologjik dhe verifikimin e vërtetësisë së shumë përfundimeve të arritura nga fonetika nyjëtimore. Njohja me parimet kryesore të fonetikës akustike është e domosdoshme për fonetikanin. Për këtë, duhen kuptuar disa nocione themelore të akustikës, që qëndrojnë në bazë të prodhimit dhe të përkapjes (perceptimit) së tingujve të ligjërit.²⁴

²³ Dr. Ranko Bugarski, *Uvod u opštu lingvistiku*, Beograd – Novi Sad, 1991, f. 78.

²⁴ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 87.

1.5.1. TIPARET AKUSTIKE TË TINGUJVE

Tingujt janë valë që shkaktohen nga dridhja e një trupi fizik në një mjedis me ajër, të cilat përhapen në të gjitha drejtimet, falë lëkundjeve të grimcave të ajrit. Tingulli bartet (përcillet) nëpër ajër si dhe nëpër materiale të ndryshme. Tingujve u nevojitet hapësirë materiale nëpër të cilën përcillen që të mund t'i dëgjojmë. Lëkundja e trupave në natyrë shkakton edhe lëkundjen e valëve të ajrit. Në hapësirë pa ajër (vakuum) lëvizjen e trupave nuk e dëgjojmë, sepse nuk ka grimca ajri që ta përcjellin dridhjen. Lëkundjet tingullore në materiale të ndryshme përhapen në mënyra të ndryshme. Disa materiale janë përcjellës shumë më të mirë të tingullit sesa të tjerat. Lëkundjet e ajrit mund të jenë *ritmike ose joritmike, të thjeshta ose të përbëra*.

Zëri përbëhet nga valët që shpërndahen nëpër ajër me shpejtësi prej 340 m/s. Në të folurit, valët shkaktohen nga dridhjet (përsëritja e lëkundjes) e tejkave të zërit. Dridhjet e tejkave të zërit mund të jenë:

1. *periodike ose joperiodike* (ritmike ose joritmike) dhe
2. *të thjeshta ose të përbëra*.

Zgjedhëm lavjerrësin si shembull për të paraqitur lëvizjen e thjeshtë periodike:





Fig. 9. Lëvizja e thjeshtë periodike e lavjerrësit

Lëvizja e thjeshtë periodike mund të paraqitet me një vijë të valëzuar (sinusoidale):



t - boshti i dridhjes;
d-e - amplituda. Amplituda është largimi më i madh i valës (d-e) nga pozita e qetë (t).
a-c - një periodë ose dridhje e dyfishtë (cikël).

Fig. 10. Paraqitje skematike e lëvizjes periodike

Çdo trup që gjendet në gjendje dridhjeje ka frekuencën e tij specifike, që përcaktohet nga veçoritë e trupit. Trupi më i rëndë dridhet më ngadalë sesa i lehti, trupi me vëllim të madh dridhet më ngadalë sesa trupi me vëllim të vogël. Sa më e vogël të jetë hapja e një zbrazëtire, frekuenca është më e ulët. D.m.th., toni karakteristik i ndonjë zbrazëtire, mund të ngritet nëse vëllimi i zbrazëtirës zvogëlohet, ndërsa hapja e saj zmadhohet. Këto ligje fizike gjejnë zbatim të madh në formimin e zanoreve.²⁵

Të folurit nga pikëpamja akustike nuk është tjetër veçse një tërësi lëkundjesh ritmike, lëkundjesh joritmike dhe pauzash me gjatësi të ndryshme, të cilat prej dëgjuesit interpretohen si kombinime zanoresh e bashkëtingëlloresh dhe pauzash midis fjalëve dhe njësive më të mëdha.

Tingujt e të folurit janë tinguj të përbërë nga: toni themelor - që përftohet nga dridhja e tejkave të zërit në tërësi, dhe nga tonet pjesore, ose harmonikët - që janë rezultat i dridhjes së pjesëve të tejkave. Veçoritë akustike të tingujve kushtëzohen nga shpejtësia, amplituda dhe zgjatja në kohë e dridhjeve të tejkave si dhe nga modifikimi që pëson në zgavrat e mbilaringut toni laringal. Këto lëkundje të ajrit përkapen nga organet e dëgjimit si tinguj me *lartësi, forcë, gjatësi* dhe *timbër* të caktuar.

Tingujt e ligjërimit janë të përbërë, sepse shkaktohen nga dridhje të përbëra, nga shkakku se tejkat e zërit dridhen (po kështu edhe telat e një vegle muzikore) me tërësinë e gjatësisë së tyre dhe në pjesë të veçanta: 1/1, 1/2, 1/3, 1/4 etj. Gjysma e tejkës së zërit dridhet dy herë më shpejt se gjithë tejkja, një e treta - tri herë më shpejt, një e katërta - katër herë më shpejt e kështu me radhë. D.m.th. dridhja e tejkave krijon jo vetëm **tonin themelor** - që shkaktohet nga dridhja e tejkave në tërësi, por edhe një seri të tërë **tonesh pjesore** (harmonike) - që shkaktohen nga dridhjet e pjesshme të tejkave, frekuencat e të cilave përfaqësojnë shumën e përgjithshme të frekuencës së tonit themelor. TONI themelor është më i ulëti, ndërsa tonet pjesore janë më të larta.




Fig. 11. Pasqyrë grafike e lëkundjes së tejkave të zërit. Vizatimi i parë tregon dridhjen e tërësishme të tejkave që formojnë tonin themelor. I dyti paraqet

²⁵ Bertil Malmberg, *Fonetika*, Sarajevë, 1974, f. 6.

dridhjen e gjysmës ($1/2$), ndërsa i treti të $1/3$ së pejzave që japin tonet pjesore (harmonike).

Lartësia e tingullit të përbërë, si tërësi, përcaktohet nga toni themelor, që është më i fuqishmi. Këtë grafikisht mund ta paraqesim kështu:²⁶




Fig. 12. Lakore e përbërë e formuar nga tri lakore sinusoidale

Çdo tingull, përfshirë këtu edhe tingujt e të folurit, në aspektin akustik karakterizohen nga: **lartësia** (frekuenca), **forca** (intensiteti), **gjatësia** (kuantiteti) dhe **timbri** (ngjyrimi).

1. **Lartësia** (frekuenca) e tingullit përcaktohet nga shpeshtësia e lëkundjeve të tejkave të zërit në një sekondë. Me fjalë të tjera, frekuenca është numri i periodave në sekondë.

Lartësia e tingullit është në përpjesëtim të drejtë me shpeshtësinë. Sa më e madhe të jetë shpejtësia e dridhjeve të trupit, valët e ajrit do të jenë më të shpeshta dhe më të shkurtra, prandaj edhe tingulli do të ketë tonalitet më lartë dhe anasjelltas. Kështu ndodh edhe me zërin e njeriut: sa më të tendosura të jenë tejkave të zërit dhe sa më e fuqishme të jetë trysnia e rrymës së ajrit që del jashtë, numri i dridhjeve të tejkave të zërit do të jetë për aq më i madh, rrjedhimisht edhe lartësia e zërit do të jetë më e madhe.

Kur muzikantët interpretojnë në ndonjë instrument me tela, ata i shtypin telat që ta ndryshojnë gjatësinë e tyre. P.sh. në kitarë teli më i gjatë e më i trashë prodhon tingull më të ulët, ndërsa teli më i shkurtër e më i hollë prodhon tingull më të lartë. Duke krijuar tinguj me lartësi të ndryshme formohet melodia.²⁷

Është përdëftuar se njerëzit me tejkave të zërit më të gjata dhe më të trasha kanë zë më të ulët dhe anasjelltas. P.sh. dallohet zëri i femrave dhe i fëmijëve nga zëri i meshkujve të moshës madhore, sepse femrat dhe fëmijët kanë tejkave më të holla dhe më të shkurtra, ndërsa meshkujt kanë tejkave më të gjata dhe më të trasha. *Femrat dhe fëmijët rëndom flasin e këndojnë për një oktavë (tetë nota) më lart sesa meshkujt.*

²⁶ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 88.

²⁷ Teli i kitarës bën 250 oscilime për një sekondë.

Diapazoni i dëgjimit. Numri i dridhjeve të zërit në sekondë quhet frekuencë. Lartësia e tingullit (frekuenca) matet me periodat në sekondë ose me herc (Hz),²⁸ që është baras me një dridhje të plotë (periodë) në sekondë. Tejtat e zërit mund të kryejnë prej 40 deri më 1700 dridhje në sekondë, por në të folur shfrytëzohen një pjesë e vogël e këtij diapazoni: *te burrat lartësia e zërit në të folur është afërsisht 80-250 Hz, ndërsa te gratë gati dyfish më e madhe: 200-450 Hz.*

Veshi i njeriut mund të dëgjojë tinguj me frekuencë prej 20 deri më 20.000 Hz. Mirëpo, të folurit tonë zakonisht realizohet në frekuencën themelore midis 100 dhe 8.000 Hz. Te njeriu, me kalimin e viteve të dëgjuarit dobësohet. Dridhjet me denduri më të vogël se 20 Hz (infratingujt) dhe ato me denduri më të madhe se 20.000 Hz (ultratingujt) veshi i njeriut nuk mund t'i përkapë. Disa gjallesa orientohen nëpërmjet ultratingujve. P.sh. lakuriqi dëgjon ultratingujt e vet që përthehen (reflektohen) nga objektet e natyrës dhe me saktësi përcakton largësinë e tyre.




Fig. 13. Diapazoni i të dëgjuarit të njeriut. Frekuencat e ndryshme janë paraqitur në apshiza, duke filluar nga kufiri i poshtëm (16 Hz) deri në kufirin e sipërm (rreth 6000 Hz); forca është dhënë në ordinata.

Lartësia e tingujve ndryshon pandërprerë gjatë ligjërimit dhe këto ndryshime të lartësisë luajnë një rol të rëndësishëm në gjuhë, pasi përbëjnë bazën e melodisë së të folurit.

Vizualizimi i valës tingullore me osciloskop. - Lartësia dhe intensiteti i zërit matet me ndihmën e një aparati që quhet osciloskop, duke shfaqur në ekran lakoren e dy vlerave, siç thuhet shpesh “fotografinë” e valës tingullore. Lartësia tregon se toni është i lartë apo i ulët. Te tonet më të larta valët janë më afër njëra-tjetrës. Kjo tregon se frekuenca është më e madhe. Molekulat e ajrit oscillojnë më tepër herë në një sekondë. Te tonet më të ulëta valët janë më të gjera. Frekuenca është më e vogël.

²⁸Për njësi matjeje e frekuencës së valëve të ajrit në një sekondë, përkatësisht e një periode në sekondë merret herci (shkurtimisht Hz), sipas emrit të fizikanit gjerman H. Hertz.

2. **Forca** ose **intensiteti** i tingullit përcaktohet nga amplituda e dridhjes (largësia e dridhjeve të valëve: shih fig. 10). Zëri është më i fuqishëm, nëse amplituda është më e madhe dhe anasjelltas. Sa më shumë energji bartet përmes lëkundjeve, aq më i fuqishëm do të jetë tingulli. Kur bërtasim, përcjellin më tepër energji në lëkundje sesa kur pëshpërisim ose flasim me zë të ulët.

Gjatë të folurit, shtypja e ajrit mbi tehzat e zërit nuk është e njëjtë. Kur shtypja rritet, amplituda e dridhjeve të tehzave zmadhohet; kur shtypja është më e vogël, edhe amplituda zvogëlohet. Pra, *amplituda* e dridhjeve të tehzave përcakton *intensitetin* e tingujve. Sa më të mëdha të jenë lëkundjet e tehzave, aq më i madh është intensiteti i tingullit të përftuar.

Por, intensiteti, përveç nga amplituda, varet edhe nga shpeshtësia e dridhjeve. Ai është në përpjesëtim të drejtë me katrorin e amplitudës dhe të shpeshtësisë, d.m.th. mund të kemi një intensitet katër herë më të madh ose duke rritur dy herë amplitudën, ose duke rritur dy herë shpeshtësinë e dridhjeve.

Intensiteti fizik i tingullit matet me Vat/cm^2 . Por, në praktikë, për matjen e intensitetit fizik të tingujve përdoret *decibeli* (db). Intensiteti i tingujve matet saktësisht me ndihmën e fonometrit. Zëri në natyrë është me intensitet midis 0-130 db. Njerëzit nuk mund të dëgjojnë zërat nën 0 db. Po sjellim disa vlera numerike të intensitetit të zërave e të zhurmave në natyrë.

Zëra e zhurma	Intensiteti të tingujve i shprehur në decibel (db)
shushurima e gjetheve	10 db
pëshpëritja	20 db
biseda	60 db
zhurma e trafikut	70 db
pluhurthithësja (makina thithëse)	80 db
muzika nëpërmjet kufjeve	100 db
piskama e fëmijëve	110 db
shkakton dhembje në veshë	130 db
aterrimi i avionit	140 db
shurdhim veshësh	160 db e mbi

Tabela 1. Intensiteti i disa zërave dhe zhurmave në natyrë

Nga këto të dhëna mund të nxjerrim këshilla si t'i mbrojmë shqisat e të dëgjuarit: Zhurma është e pakëndshme për ta dëgjuar. Ajo pengon. Tingujt shumë të fortë mund të dëmtojnë shqisat e të dëgjuarit. Zëri i fuqishëm shkakton dhembje në veshë. Mos rrini ku ka shumë zhurmë, mos folni e mos dëgjoni muzikë me zë shumë të lartë. Tingujt me intensitet mbi 160 db shkaktojnë dëmtimin e përhershëm të të dëgjuarit, d.m.th. shurdhim.

Intensiteti i tingullit varet nga amplituda e valëve të tingujve: sa më e madhe është amplituda, aq më i fortë është tingulli. Lartësia e tingullit varet

nga frekuenca e valëve të tingullit: sa më e lartë është frekuenca, aq më i fortë është tingulli. Intensiteti i tingullit të ligjërimit përbën bazën e theksit dinamik, ashtu siç e ka shqipja, ku zanoret e theksuara nyjëtohen me forcë më të madhe sesa të patheksuarat. Por, theksi dinamik lidhet edhe me dukuri të tjera të ligjërimit, si me qartësinë e dëgjimit të sinjalit tingullor etj.

3. **Gjatësia** e tingullit është sasia e kohës që përdoret për artikulin e tij. Sa më shumë të zgjatë nyjëtimi i tingullit, aq më i gjatë është ai. Gjatësia e tingujve të ligjërimit matet me të qindta të sekondës (centisekonda, shkurtimisht qs). Tingujt zgjatin prej 2 deri më 24 qs. Ajo shprehet sidomos gjatë nyjëtimimit të zanoreve si dhe te kundërvënira fonologjike e bashkëtingëlloreve në çiftin: /r/ e shkurtër ~ /rr/ e gjatë.

Gjatësia e tingujve në gjuhën shqipe varet nga faktorë të ndryshëm, si nga shpejtësia e të folurit, theksi, karakteri i rrokjes (e hapur - e mbyllur), numri i rrokjeve në fjalë; fqinjësia tingullore, stili i ligjërimit etj. Kështu, bie fjala, sa më shpejt që flasim, aq më e vogël do të jetë gjatësia e tingujve dhe e kundërta; zanoret e theksuara zakonisht janë më të gjata se të patheksuarat (në përpjesëtim afërsisht 10 : 7),²⁹ sa më shumë rrokje të ketë fjala, aq më të shkurtër do të jenë tingujt dhe anasjelltas; zanoret në rrokje të hapur rëndom janë më të gjata sesa zanoret në rrokje të mbyllur.

Si rrjedhojë e gjithë kësaj, gjatësia e tingujve në gjuhën shqipe standarde nuk përbën një tipar të qëndrueshëm, por ajo lidhet në radhë të parë me kushtet fonetike të tingujve në të cilat ata ndodhen. Gjatësia e zanoreve në shqipen standarde nuk kryen funksion dallues e as gramatikor, por ka rëndësi për normën e shqiptimit letrar.³⁰

4. **Timbri** (ngjyrimi).- Tonet pjesore i japin tingullit ngjyrim karakteristik që quhet *timbër*. Toni laringal i prodhuar nga lëkundjet ritmike të tejzave të zërit përbëhet nga toni themelor (që përftohet nga dridhja e tejzave në tërësi), dhe tonet pjesore, ose harmonikët (që përftohen nga lëkundjet e pjesshme të tejzave). Toni themelor përcakton lartësinë e zërit (lartësinë e tingujve të veçantë dhe intonacionin e frazës) si dhe cilësinë e zërit të folësve, kurse harmonikët përcaktojnë *timbrin* e *tingullit*.

Për formimin e timbrit të tingujve rol të rëndësishëm luan *rezonanca*. Tonet e përbëra që lindin në laring, dallohen nga njëri-tjetri në saje të rezonancës së hapësirave të mbilaringut. Rezonatorët e aparatit të të folurit: hapësira e faringut, e gojës, e hundës dhe e buzëve gjatë shqiptimit të tingujve mund të ndryshojnë vëllimin dhe formën e tyre. Ndryshime më të mëdha ndodhin në rezonatorin e gojës. Zgavrat e mbilaringut veprojnë si një filtër, që përforcon ose shuan harmonikët që kalojnë nëpër ta. Harmonikët që

²⁹ Bahri Beci, *Sistemi fonologjik i gjuhës së sotme letrare dhe ...*, f. 108.

³⁰ Gjatësia e zanoreve në gegërishten ka rol kuptimdallues ose gramatikor, përkatësisht ka funksion fonologjik. Ky funksion del në pah më së miri me anë të kundërvënirave fonologjike të gjatësisë së zanoreve (zanore e shkurtër ~ zanore e gjatë) te disa çifte minimale fjalësh, si *kos* ~ *ko:s*, *plak* ~ *pla:k*, *dyshek* ~ *dyshe:k* etj.

përforcohen nga rezonatorët e kanalit të zërit, quhen *formante* të tingullit. Pikërisht, formantet janë shpesh tërësi që përcaktojnë timbrin e një tingulli dhe e bëjnë atë të dallohet nga tingujt e tjerë. Pra, timbri është *cilësi akustike e tingullit që përfitohet nga përforcimi i disa toneve pjesore gjatë kalimit të tonit laringal përmes zgavrave të kanalit të zërit*.

Që të jemi edhe më të qartë, timbri (ngjyra) i zërit të njeriut varet nga madhësia dhe forma e rezonatorit. Kështu, p.sh. më ndryshe është timbri i zërit të një vegje muzikore krahasuar me veglën tjetër të po të njëjtit lloj (krahaso timbrin e disa violinave, kitareve etj.). Kësisoj, meqë rezonatorët e njerëzve dallohen, të folurit e tyre kanë timbër të ndryshëm.

Shpeshësia e formantit ndryshon vetëm me ndryshimin e konfigurimit të rezonatorit. Për shkak të ndryshimeve të rezonatorëve, disa nga tonet e pjesshme të tingujve të përbërë përforcohen, ndërsa të tjerat dobësohen. Zona e dendurive që përforcohet në bazë të rezonatorëve na jep *formantin e tingullit*. Struktura e formanteve na jep atë që quhet spektër i tingullit. Kur përforcohen tonet pjesore të larta, fitohet një tingull me *timbër të qartë*; ndërsa kur përforcohen tonet pjesore të ulëta, fitohet një tingull me *timbër të errët* ose të rëndë. Analiza e formanteve të tingujve bëhet me aparate të posaçme që quhen spektrografë ose sonografë.

Çdo tingull i të folurit ka disa formante, që shënohen me $F_0, F_1, F_2, F_3, F_4, F_5$ etj. Nga këta, F_1 dhe F_2 përcaktojnë timbrin e tingujve, ndërsa F_3, F_4, F_5 etj. mendohet se karakterizojnë veçoritë individuale të folësve dhe nuk kanë rëndësi për analizën gjuhësore. F_0 (themelori) është toni themelor që përfitohet nga dridhjet tërësore të tejzave. Vlera e F_0 për zërat e meshkujve është 120 Hz, për femrat 220 Hz.

Tërësia e formanteve të tingullit formon *strukturën formantore* të tij. Struktura formantore e një tingulli varet nga konfigurimi i zgavrave rezonatore gjatë nyjëtimin të tij. Në përgjithësi, sot pranohet që vlerat e F_1 varen nga shkalla e hapjes së gojës: sa më e hapur të jetë goja, aq më i lartë është F_1 dhe, sa më e mbyllur të jetë ajo, aq më i ulët është F_1 . Kurse F_2 varet nga pozicioni i gjuhës në gojë, d.m.th. nga radha e zanores: sa më e përparme të jetë zanorja, aq më i lartë është F_2 dhe, sa më e prapme të jetë zanorja, aq më i ulët është F_2 . Pjesëmarrja e buzëve në nyjëtim nuk shton ndonjë formant të ri, veçse ndikon në uljen e F_2 : sa më të rrumbullakuara të jenë buzët, aq më e vogël është vlera e F_2 . Këto lidhje na lejojnë që, duke u nisur nga vlerat e F_1 dhe F_2 , të përcaktojmë radhën dhe hapjen e zanoreve.

Spektri akustik i tingullit. - Në kohën e fundit, në studimin akustik të tingujve gjuhëtarët shfrytëzojnë edhe aparate teknike, që mundësojnë regjistrimin objektiv të disa tipareve të zërit. Me ndihmën e disa mjeteve teknike, siç janë kimografi, oscilografi, spektrograf, sonografi, mengografi etj., përkatësisht në bazë të rezultateve të fituara me ndihmën e tyre, realizimet tingullore studiohen me metoda laboratorike, eksperimentale. Kështu lindi fonetika eksperimentale, si degë e fonetikës. Gjatë vrojtimit eksperimental të

tingujve nuk merret parasysh funksioni i tingujve për dallimin e kuptimit të fjalës. Studimi i këtillë i tingujve i solli shkencës bashkëkohore të gjuhësisë një radhë të dhënash të reja për tingujt e ligjërit njerëzor dhe mekanizmin e të folurit.

Paraqitja grafike e përbërësve të një tingulli quhet spektër akustik i tij. Në spektrin akustik mund të shihet struktura e formanteve të një tingulli, veçanërisht e zanoreve. Ka dy mënyra të paraqitjes së spektrit të tingullit: metoda matematike dhe metoda fizike. Me anë të analizës matematike marrim të dhëna për shpeshtësinë dhe amplitudën e tingullit, duke supozuar një tingull që mbetet i pandryshuar. Një spektër i realizuar me këtë mënyrë ka formën e një grafiku (si në figurën e mëposhtme):³¹




Fig. 14. Spektri matematik i tingullit. Shpeshtësia dhe amplituda e tonit laringal para dhe pasi harmonikët i janë nënshtruar veprimit të rezonatorëve; vertikalisht intensiteti në db, horizontalisht lartësia në Hz. Kulmet e lakores tregojnë formantet.

Në praktikën e përshkrimit akustik të tingujve, përdorim të gjerë ka marrë metoda akustike, e cila lejon të vizualizohen tingujt dhe të përshkruhen gjithë përbërësit akustikë të tyre. Në fillim, analizat akustike janë bërë me anë të *sonografit*, një pajisje tepër e kushtueshme, kurse në ditët tona punën e sonografit e bëjnë programe të posaçme kompjuterike. Spektri akustik i fituar me anë të sonografit quhet *sonogram*. Nga leximi i sonogrameve marrim të dhëna për gjatësinë e tingullit, për vlerat e formanteve dhe për intensitetin e tingullit. Koha jepet horizontalisht, në boshtin e X-ve, shpeshtësia në boshtin e Y-ve, kurse intensiteti shprehet në shkallën e nxirjes së letrës. Formantet shihen në sonogram si fasha të zeza me shtrirje horizontale (fig. 15). Përparësia e kësaj metode është se ajo e jep tingullin në dinamikën e vet, duke lejuar të shihen dallimet në spektrin akustik të tingujve të ndryshëm si dhe ndryshimet e timbrit të tingujve gjatë lidhjes me njëri-tjetrin në të folur.³²

³¹ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 92.

³² Rami Memushaj, *Po aty*, f. 92-93.




Fig. 15. Sonogram i fjalisë Mbroni pyjet nga zjarri: lart - oscilogrami i valëve tingullore; poshtë - struktura formantore.

Por, në qoftë se për veçoritë e ndërtimit e të funksionimit të sistemit fonologjik të gjuhës standarde shqipe janë dhënë ndihmesa me vlerë, për veçoritë e normës së realizimit të fonemave mbetet ende shumë punë për t'u bërë. Nuk është përcaktuar ende mbi bazën e të dhënave të metodave të sotme të fonetikës eksperimentale norma e realizimit të varianteve themelore të gjuhës së sotme letrare kombëtare si edhe norma e varianteve të tyre pozicionale, kombinatorë e stilistike.³³

Të folurit vizual (pamor, e dukshëm) **dhe tingujt sintetikë** (artificialë). – Metoda bashkëkohore elektroakustike fonetikanëve u mundëson që të analizojnë cilindo tingull dhe rezultatet e analizës t'i paraqesin në formë spektri, me forma të ndryshme, varësisht nga mënyra e zgjedhur sipas dëshirës. Spektri i tillë duhet të tregojë strukturën akustike të tingullit: tonet pjesore, frekuencën dhe forcën e tyre. Nëse dëshirohet të paraqitet tingulli në ndonjë moment të caktuar, spektri merr formën e këtillë, të shfaqur në figurat e mëposhtme me frekuencat në apshisë dhe me forcën në ordinata:³⁴




Fig. 16. Një mundësi teknike e paraqitjes së strukturës akustike të tingullit (lart e [i]-së dhe poshtë e [a]-së)

³³ Bahri Beci, *Sistemi fonologjik i gjuhës së sotme letrare dhe ...*, f. 98.

³⁴ Bertil Malmberg, *Fonetika*, Sarajevo, 1974, f. 17.

Por, kur dëshirohet që dy e më shumë tinguj të krahasohen në spektrin e njëjtë, ose nëse dëshirohet të vështrohet sesi natyra e tingullit ndryshon gjatë artikulimit të tij, zgjidhen tipat e pasqyrimit si në dy figurat e mëposhtme:




Fig. 17. Spektrogrami i zanores [i] (majtas) dhe zanores [u] (djathtas) të anglishtes. Në spektrin e zanores [i] shihet se formantet 1 dhe 2 janë mjaft të larguara njëra nga tjetra, ndërsa në spektrin e zanores [u] të dy formantet janë mjaft afër njëra-tjetrës dhe gjenden në zonën e ulët frekuentuese. Formantet e vendosura në pjesën e sipërme të spektrit ndikojnë në tiparet vetanake të zanores, por nuk kanë vlerë gjuhësore.³⁵




Fig. 18. Spektrogramet e dy diftongjeve të anglishtes (ai, majtas dhe oi /boy/, djathtas). Shihet se kalimi nga elementi i parë në të dytin është gradual. Formantet gjithnjë e më tepër largohen njëri nga tjetri. [i]-ja e vërtetë paraqitet vetëm aty nga fundi i elementit të dytë.

Nëse gjatë analizës regjistrohen tingujt e një fjalie, ashtu siç pasojnë në kohë, mund të vështrohen jo vetëm dallimet që ekzistojnë ndërmjet tingujve të ndryshëm, por edhe ndryshimet e ngjyrimit që shkaktohen gjatë nyjetimit të një tingulli të njëjtë, që veshi nuk i dëgjon, si dhe të gjitha ndryshimet që bëhen kur tingujt vijnë në kontakt me tingujt e tjerë. Në kuadër të spektrave tipikë përherë ekzistojnë zona kalimtare (transitive).³⁶ Kësisoj, nga njëra anë mund të shihet si bashkëtingëlloret ndikojnë në zanoret, veçmas në zonat kufitare (në fillim dhe në mbarim të tingullit), e nga ana tjetër, sesi zanoret i japin ngjyrë bashkëtingëlloreve. Bashkëtingëllorja në vete bart ngjyrën e zanoreve përreth (asaj paravajtëse e prapavajtëse). Bie fjala, [k]-ja ose [s]-ja para [i]-së kanë

³⁵ Sipas Potter-it, Kopp-it dhe Green-it, shih: Bertil Malmberg, *Fonetika*, Sarajevë, f. 18.

³⁶ Zona kalimtare (transitive) janë fillimi dhe mbarimi i tingullit që tregojnë ngritje dhe rënie të intensitetit në kohë. Te tingujt dallohen faza nistore dhe përfundimtare. Mbylltoret janë tipike me kalueshmëri të tillë. Shih: Rikard Simeon, *Enciklopedijski rječnik lingvističkih naziva*, pjesa II, Zagreb, 1969, f. 627.

spektër tjetër, ndërsa spektër tjetër kur artikulohej para [u]-së. Krahaso figurën 19 dhe 20:




Fig. 19. Spektrogrami i grupit ki (majtas) dhe ku (djathtas). Zhurma e bashkëtingëllores në spektrogram merr formën e parregullt të vijave të zeza (majtas fotografive). Shihet qartë se zhurma karakteristike për [k]-në dukshëm më tepër zë vend kur artikullohet para zanores së përparme (të mbyllur) [i] sesa para zanores së prapme (të mbyllur) [u]. Në të vërtetë, këtu kemi dy tinguj mjaft të ndryshëm, megjithëqë veshi i njeriut nuk bën dallimin e tyre, por i barazon në një fonemë të vetme /k/.




Fig. 20. Spektrogrami i grupit [si] dhe [su]. Këtu shihet qartas se formantet e dy zanoreve dallohen nga zhurma e bashkëtingëllores paravajtëse, kjo e fundit i jep ngjyrën zanores. Nga ana tjetër, kemi të bëjmë, me dy [s] të ndryshme: një të ngjyrimin e zanores [i] dhe tjetrën me ngjyrimin e zanores [u].

Por, prapëseprapë, secili tingull ka spektrin e vet specifik. Meqenëse çdo tingull ka spektrin vetanake, të folurit, në parim, mund të paraqitet edhe në mënyrë vizuale nëpërmjet filtrave akustikë. Çdonjëri që di si duket spektri i tingullit, mund ta “lexojë” atë tingull në çastin kur spektri i tij shfaqet në ekranin e aparatit që bën analizën (shih figurën 17). Në zanafillë aparatet e këtij lloji (sonografët) përdoren për qëllime praktike: me ndihmën e tyre janë bërë përpjekje që shurdhmemecëve në mënyrë vizuale t’u pasqyrohet të folurit. Kjo metodë e njohur, e quajtur “të folurit vizuel” është mjeti më i vlefshëm për analizën akustike të tingujve.

Spektrin e fituar ose varguan e spektrave, teknikët kanë mundësi rishtas ta shndërrojnë në zë. Kjo do të thotë se ekziston mundësia të prodhohet të folurit sintetik. Kur dihet spektri i tingullit, grafikisht mund të vizatohet fotografia përkatëse ose e ngjashme spektrale dhe të prodhohet tingulli i vizatuar. Në këtë patën sukses një grup teknikësh dhe fonetikanësh që punojnë për përkryerjen e të folurit sintetik në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

1.5.2. KLASIFIKIMI AKUSTIK I ZANOREVE

Tiparet akustike të zanoreve lidhen ngushtë me nyjëtimin e tyre. Në spektrat e zanoreve zakonisht dallohen disa formante, që tregohen me shifra: formanti i parë F_1 , formanti i dytë F_2 etj. Përveç këtyre, dallohet edhe toni themelor F_0 . Për tiparet e zanoreve rol vendimtar luajnë dy formantet e para.

Ekziston një varësi midis dendurisë së formanteve dhe tipareve nyjëtimore të zanoreve. F_1 lidhet me ngritjen e gjuhës, me lëvizjen vertikale të saj. Sa më e hapur të jetë zanorja, aq më e lartë është F_1 ; kurse F_2 lidhet me lëvizjen horizontale të gjuhës, me radhën e zanoreve. Sa më e lartë të jetë F_2 , aq më e përparme është zanorja. Përveç kësaj, për vlerat e formanteve luajnë rol edhe disa tipare të tjera, si p.sh. buzorëzimi. Nga analiza akustike e tingujve del se te zanorja e buzorëzuar e përparme /y/ formanti i dytë është më i ulët se te zanorja jobuzore /i/ që i përgjigjet asaj.

Lidhja e tipareve akustike dhe nyjëtimore duket më qartë po të vendosim vlerat e F_1 dhe F_2 në boshtin e koordinatave, në mënyrë të tillë: vlerat e F_1 vendosen në boshtin e ordinatave nga lart poshtë (vlerat më të vogla lart, më të mëdhatë poshtë), kurse vlerat e F_2 vendosen në boshtin e abshisave nga e majta në të djathtë (më të voglat në të majtën dhe pastaj duke u rritur në të djathtë).

Përshkrimi akustik i zanoreve mbështetet në dallimet në pozicionin e F_1 dhe F_2 në spektrin akustik të tyre. Kështu, sipas pozicionit të F_1 e F_2 në spektrin akustik, dallohen zanore:

1) **kompakte** dhe **difuze** (të shpërhapura): [a] ~ [i, y, u] (zanore të hapura ~ zanore të mbyllura);

2) **të mprehta** (akute) dhe **të rënda** (gravis): [i ~ u] (të përparme ~ të prapme);

3) **bemole** dhe **të thjeshta** (jobemole): [y, u, o ~ i, a, e, ë] (të buzorëzuara ~ të pabuzorëzuara).

Te zanoret *kompakte* F_1 gjendet në pjesën qendrore të spektrit dhe afër F_2 . Pra, energjia tingullore përqendrohet në një zonë të ngushtë dhe qendrore të spektrit. Te zanoret *difuze* energjia tingullore shpërndahet në skajet e spektrit, d.m.th. F_1 është shumë më i ulët, kurse F_2 mund të jetë larg ose afër tij (tek [i]-ja ndodhet larg, tek [u]-ja afër). Zanore tipike kompakte është [a]-ja, kurse difuze zanoret [i, y, u], d.m.th. zanoret e mbyllura.

Dallimi i zanoreve të mprehta nga ato të rënda mbështetet në vlerat e F_2 . Zanoret e *mprehta* kanë F_2 të lartë, d.m.th. energjia tingullore përqendrohet në zonat e larta të spektrit të tyre; zanoret e *rënda* e kanë F_2 të ulët, pasi energjia tingullore përqendrohet në pjesën e poshtme të spektrit. Zanore tipike e mprehtë është [i]-ja, e rëndë [u]-ja, kurse [a]-ja zë një pozicion të ndërmjetëm. Në të dëgjuar zanoret e rënda kanë një timbër të errët dhe të paqartë, pasi në to mbizotërojnë tonet pjesore me shpeshtësi të ulët.

Zanoret bemole dallohen prej të thjeshtave (jobemoleve) gjegjëse vetëm nga vlera e F_2 , që te bemolet është më e ulët se te të thjeshtat. Kjo ulje e

vlërës së F_2 shkaktohet nga zgjatja e rezonatorit, si rrjedhim i pjesëmarrjes së buzëve në nyjëtimin e zanoreve. Bemole është [y]-ja, jobemole zanorja [i].³⁷

Themelore në përcaktimin e timbrit të zanoreve janë frekuencat e dy formanteve të para (F_1 , F_2). Për këtë qëllim shfrytëzohen të dhënat e fonetikës eksperimentale. Këto vlera deri më tani janë dhënë nga dy gjuhëtarë, por me shifra që dallohen. Po paraqesim vlerat e F_1 dhe F_2 të zanoreve të theksuara e të patheksuara sipas prof. Bahri Becit:

Zanoret e theksuara	F_1	F_2	Zanoret e patheksuara	F_1	F_2
i	256	2111	i	266	2097
y	273	1613	y	281	1650
u	300	796	u	325	845
e	476	1777	e	436	1630
ë	486	1346	ë	426	1367
o	473	944	o	456	971
a	651	1238	a	583	1345

Tabela 2. Vlerat akustike të dy formanteve (F_1 , F_2) të zanoreve të theksuara e të patheksuara të gjuhës së sotme shqipe

Nga krahasimi midis zanoreve të theksuara dhe të patheksuara, del se **zanoret e patheksuara kanë prirje të bëhen më qendrore**: zanoret e përparme bëhen më të prapme, të prapmet kanë nyjëtim më të përparmë, të hapurat bëhen më të mbyllura, ndërsa të mbyllurat më të hapura. Kjo duket qartë në tabelat e mësipërme, që paraqesin vlerat e formanteve si dhe nga paraqitja grafike e trekëndëshit akustik të zanoreve të theksuara në përqasje me të patheksuarat (shih fig. 23).

Fiziologjikisht kjo dukuri shpjegohet me zhvendosjen e shtegut nga para prapa dhe me ndryshimin e përmasave të shtegut për kalimin e rrymës së ajrit. Ka pra lidhje të drejtpërdrejtë dhe të qëndrueshme ndërmjet artikulimit dhe efektit akustik. Kështu, lartësia e formantit të parë (F_1) lidhet me hapjen e gojës: sa më shumë zbret gjuha, aq më të larta janë frekuencat dhe anasjelltas. Lartësia e formantit të dytë (F_2) ka lidhje të përkundërt me gjatësinë e hapësirës së rezonatorëve të gojës...³⁸

Sipas vendit të të dy formanteve në shkallën muzikore, zanoret mund të vendosen në mënyrë që të fitohet figurë gjeometrike (që merr formën e trekëndëshit, katërkëndëshit, trapezit, konit etj. varësisht për cilën gjuhë bëhet fjalë). Klasifikimi akustik i zanoreve të shqipes përputhet me klasifikimin nyjëtimor:³⁹

³⁷ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 93-94.

³⁸ P. Delatre, *Un triangle acoustique des voyelles orales du fran]ais*, *The French Review*, May, 1948, f. 477-484.

³⁹ Bahri Beci, *Sistemi fonologjik i gjuhës së sotme letrare dhe ...*, f. 99.




Fig. 21. Trekëndëshi akustik i zanoreve të theksuara të shqipes




Fig. 22. Trekëndëshi akustik i zanoreve a) të theksuara (vija e plotë) dhe b) të patheksuara (vija e ndërprerë) të shqipes

Krahasuar me vlerat e formanteve të zanoreve themelore,⁴⁰ zanoret e shqipes standarde kanë vlera më të vogla të F_1 dhe F_2 , gjë që mbështet përfundimin e arritur nga fonetika nyjëtimore se zanoret e shqipes janë më pak të ndera nga zanoret themelore. Siç shihet në figurën e mëposhtme, trekëndëshi akustik i zanoreve të shqipes standarde brendashkruhet trapezit të zanoreve themelore, gjë që provon se zanoret e shqipes janë të zhvendosura drejt qendrës.⁴¹

⁴⁰ Se ç'janë zanoret themelore (kardinale) lexo në leksionin 2.2. Përshkrimi nyjëtivor i zanoreve të shqipes standarde.

⁴¹ Rami Memushaj, *Fonetika e shqipes standarde*, Toena, Tiranë, 2009, f. 46-47.




Fig. 23. Zanoret themelore (trapezi) dhe zanoret e shqipes (trekëndëshi).

1.6. ZANORET DHE BASHKËTINGËLLORET

Sasia e tingujve që shqipton njeriu dhe që mund t'i shqiptojë është shumë më e madhe sesa numri i tingujve që në gjuhë të caktuara funksionojnë si njësi gjuhësore, përkatësisht si pjesë përbërëse të fjalëve. Fonetika studion vetëm tingujt që kanë rol në komunikim.

Përshkrimi dhe klasifikimi nyjetimor i tingujve, edhe sot e kësaj dite zë vendin kryesor, sepse ai është më praktik, më i kapshëm. Ky përshkrim tradicional i tingujve të të folurit, që mbështetet në kritere fiziologjike, tani plotësohet edhe me disa tipare akustike dhe funksionale të tingujve.

Midis përshkrimit që mbështetet në tiparet nyjetimore dhe përshkrimit që mbështetet në tiparet akustike, nuk ka dhe nuk mund të ketë kundërshti. Të dyja këto mënyra përshkrimi dhe klasifikimi plotësojnë njëra-tjetrën. Metodat e sotme të studimit të tingujve, metodat instrumentale, kanë çuar në afrimin e mëtejshëm të këtyre dy mënyrave të studimit.

Kur flasim për tingujt themelorë apo për fonemat e shqipes, kemi parasysh gjithnjë ato të gjuhës standarde shqipe.⁴²

Për prodhimin e tingujve të të folurit janë të domosdoshëm dy faktorë: *rryma e ajrit* dhe *kanali zanor* (pjesa e trupit të njeriut nga laringu deri te buzët). Mënyra se si krijohet rryma e ajrit dhe si depërton nëpër kanal in zanor, përbën bazën për klasifikimin e tingujve. Domethënë, dallimi i klasave të ndryshme të tingujve kushtëzohet nga një varg faktorësh fiziologjikë.

⁴² Numri i tingujve themelorë në gjuhë dhe dialekte të ndryshme nuk është i njëjtë. P.sh. shqipja standarde ka 36 tinguj themelorë (përkatësisht fonema), maqedonishtja 31, rumanishtja 27, bullgarishtja 45; serbishtja, kroatishtja 32, greqishtja e spanjishtja 30; italishtja 28, anglishtja 49, gjermanishtja 39, frëngjishtja 35 etj.

Gjatë nyjëtimit, organet e zgavrave të mbilaringut mund të zënë pozicione të ndryshme, duke e lënë të hapur kanalën e zërit ose duke e ngushtuar apo mbyllur plotësisht në ndonjë pikë të saj. Si rrjedhim, rryma e ajrit mund të kalojë lirisht nëpër kanalën e zërit ose të pengohet diku në të. Prandaj, pavarësisht nga sasia e tyre, tingujt e ligjërit në të gjitha gjuhët klasifikohen në dy grupe të mëdha, në:

- a) **zanore** (vokale) dhe
- b) **bashkëtingëllore** (konsonante).

Zanoret dhe bashkëtingëlloret dallohen midis tyre nga tipare nyjëtimore, akustike dhe funksionale. Në bazë të këtyre pikëpamjeve, midis zanoreve dhe bashkëtingëlloreve ekzistojnë këto dallime themelore:

1. Kur i shqiptojmë zanoret, rryma e ajrit depërton lirisht nëpër kanalën frymëqitës, duke prodhuar tingull të pandërprerë. Përkundrazi, kur i shqiptojmë bashkëtingëlloret, në rrugën e kalimit të ajrit krijohet pengesa në vende të ndryshme, dhe këto pengesa kapërcehen në disa mënyra. Nga ky shkak me lehtësi dhe me saktësi më të madhe mund të përcaktohet vendi i formimit të bashkëtingëlloreve, zakonisht në vendin e formimit të pengesës. Kështu, bashkëtingëlloret formohen në vende të ndryshme të aparatit të të folurit dhe sipas vendit emërtohen në: buzore, dhëmbore, alveolare, paraqijllzore, qijllzore e prapaqijllzore. Mirëpo, rol të rëndësishëm ka edhe mënyra e formimit të pengesës ose e kapërcimit të saj.

Dallojmë katër lloje pengesash që formohen nga organi aktiv: 1) *mbyllje* (ose okluzion) kur organi aktiv puqet me organin pasiv dhe e mbyll plotësisht rrugën e kalimit të ajrit; 2) *shteg*, kur organi aktiv i afrohet organit pasiv dhe midis tyre mbetet një shteg ku fërkohet ajri; 3) *mbyllje-shteg*, kur në fazën e parë të nyjëtimit formohet mbyllje, ndërsa në fazën e dytë mbyllja shndërrohet në shteg; dhe 4) *dridhje*, kur organi aktiv afrohet dhe largohet nga organi pasiv, duke krijuar lëkundje:




Fig. 24. Skemat tregojnë: kalimin e lirë të rrymës së ajrit (1); depërtimin e ajrit nëpër shteg (2) dhe mbylljen e plotë (3). Vizatimet paraqesin prerjen në profil të zgavrës së gojës të drejtuar në të majtë, me qiellzën (lart), gjuhën (poshtë).

Ndërkaq, vendi i formimit të zanoreve përcaktohet më me vështirësi dhe me saktësi më të vogël. Rëndom, si vend i formimit të zanoreve merret ngushtimi më i madh, që krijohet midis sipërfaqes së gjuhës dhe të qiellzës, përkatësisht të hapësirës së mbilaringut.

Nga kjo del se **zanoret janë tinguj të palokalizuar, ndërsa bashkëtingëlloret janë tinguj të lokalizuar**. Kur nuk formohet pengesë në zgavrën e gojës dhe rryma e ajrit kalon lirshëm nëpër aparatën e të folurit, formohen tinguj të palokalizuar, përkatësisht tinguj që nuk mund të përcaktojmë me saktësi vendin e formimit të tyre. Tinguj të tillë janë zanoret. Kur në organet e të folurit krijohet pengesë gjatë kalimit të ajrit (mbyllje, shteg ose mbyllje-shteg) krijohen tinguj të lokalizuar, d.m.th. tinguj që dihet vendi se ku formohen. Tinguj të lokalizuar janë bashkëtingëlloret. Kur rryma e ajrit kalon nëpër shteg ose pengesë të çlirtë atëherë formohen tinguj të gjysmëlkalizuar (tingëllueset, sonantet).

2. Kur i shqiptojmë zanoret, i gjithë aparati i të folurit është i tendosur (i shtrënguar), ndërsa kur i shqiptojmë bashkëtingëlloret është e tendosur vetëm një pjesë e këtij aparati, gjegjësisht pjesa ku formohet pengesa. Cilësia e zanores përcaktohet nga forma dhe madhësia e hapësirave të mbilaringut në tërësi.

3. Bashkëtingëlloret shqiptohen me rrymë më të fuqishme ajri sesa zanoret.

4. Edhe në bazë të tipareve akustike, zanoret dallohen nga bashkëtingëlloret. Zanoret janë tone (zëra muzikorë që përbëhen nga dridhjet periodike), ndërsa bashkëtingëlloret janë zhurma (zëra jomuzikorë të prodhuar nga dridhjet joperiodike). Pra, bashkëtingëlloret nuk janë tone të pastra, por tone me zhurmë të dobët (sonoret), zhurma me tone të dobëta (bashk. e zëshme), apo vetëm zhurma pa tone (bashk. e shurdhëta).

Me fjalë të tjera, nga pikëpamja akustike, zanoret përgjithësisht janë tinguj të zëshëm, ndërsa bashkëtingëlloret janë më pak të zëshëm, përkatësisht pjesa më e madhe e tyre janë zhurma:




Fig. 25. Lakorja e tingullit muzikor (lëkundjes periodike, lart) dhe zhurmës (lëkundjes joperiodike, poshtë - incizim i zhurmës së rrugës).

Megjithatë, duhet thënë se për nga zëshmëria edhe bashkëtingëlloret nuk janë të njëllorja: ato ndahen në të zhurmëta dhe të tingullta (sonore). Këto të fundit për nga tiparet akustike afrohen me zanoret, sepse kanë strukturë formanti, ashtu si edhe zanoret. Por, sonoret dallohen nga zanoret nga

pikëpamja e intensitetit, e forcës: zanoret janë tingujt më intensivë, më të fortë; pastaj vijnë sonoret dhe në fund bashkëtingëlloret e zhurmëta, që janë tingujt më pak intensivë.

5. Dallimet funksionale të zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve lidhen me rolin e tyre në rrokje: zanoret janë tinguj rrokjeformues, të cilat formojnë kulmin e rrokjes; ndërsa bashkëtingëlloret hyjnë në përbërjen e rrokjes, por ato vetvetiu (pa zanore) në gjuhën shqipe nuk mund të krijojnë rrokje. Andaj, numri i rrokjeve në fjalë përcaktohet nga numri i zanoreve. Vetë termi "bashkëtingëllore" (konsonante, nga lat. *con* - me, *sonans* - tingull = bashkë+tingull, tingull që shqiptohet vetëm bashkë me një tingull tjetër të zëshëm, me zanore, maq. *самогласка* = vetëtingull, zanore; *огласка* - me tingull, bashkë me një tingull tjetër, bashkëtingëllore) tregon rolin e tyre në rrokje, si shoqëruese e zanores. Pra, bashkëtingëlloret nuk mund të jenë të theksuara dhe nuk formojnë rrokje më vete. Rrokje formojnë vetëm së bashku me zanore.

6. Zanoret dhe bashkëtingëlloret dallohen midis tyre edhe me tiparin e bashkueshmërisë. Përgjithësisht, zanoret mund të bashkohen me cilëndo bashkëtingëllore ose zanore, ndërsa bashkëtingëlloret kanë kufizime në bashkim, sidomos në formimin e grupeve të bashkëtingëlloreve. P.sh. në gjuhën shqipe janë të shpeshta dhe të pajtueshme grupet e bashkëtingëlloreve *mb, nd, ng* etj., por janë të papajtueshme dhe nuk përdoren togjet *thdh, rrth, shzh, kg, hth, zhth* etj.

Në disa gjuhë, përveç zanoreve të thjeshta - monoftongjeve (shih spektrogramin e zanoreve [i] dhe [u] në fig. 17), ekzistojnë edhe zanore të përbëra - diftongje (shih spektrogramin e diftongjeve [ai] dhe [oi] të anglishtes në fig. 18). Diftongjet krijohen me bashkimin e dy zanoreve, njëres rrokjeformuese dhe tjetrës jorrokjeformuese, në një rrokje të vetme. Në të vërtetë, diftongjet janë tingujt të përbërë që nyjëtohen me lëvizje të pandërprera, duke kaluar nga një zanore në gjysmëzanore tjetër ose anasjelltas.

KREU II

2. KLASIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I ZANOREVE

Zanoret janë tinguj të zëshëm, për nyjëtimin e të cilëve toni laringal kalon nëpër faring dhe gojë pa hasur në ndonjë pengesë; ndryshe nga bashkëtingëlloret, që prodhohen nga kalimi i ajrit përmes një pengese. Akustikisht, zanoret janë tone, që prodhohen nga kalimi i lirë i tonit laringal nëpër kanalën e zërit, kurse bashkëtingëlloret janë zhurma. Pra, veçoritë nyjëtimore dhe akustike të zanoreve varen nga trajtimi që u bëhen valëve të ajrit të përfutuara nga dridhjet ritmike të tejzave, në zgavrat e mbilaringut, të cilat shërbejnë si rezonatorë të tonit laringal.

Nga katër rezonatorët kryesorë të kanalit të zërit (faringu, goja, zgavra e hundës dhe zgavra e buzëve: shih fig. 5), goja është rezonatori më i rëndësishëm, ku formohen cilësitë kryesore të zanoreve. Në thelb, zanores ia japin ngjyrën karakteristike vëllimi dhe forma e zgavrës gojore. Falë lëvizshmërisë së madhe të gjuhës, zgavra e gojës mund të ndryshojë formën dhe vëllimin e saj në lloj-lloj mënyrash. Rezonatorët e tjerë nuk mund të formojnë zanore në mënyrë të pavarur, ata vetëm shoqërojnë rezonatorin e gojës, duke i shtuar cilësi të tjera tingullit zanor të formuar aty.

2. 1. KLASIFIKIMI I ZANOREVE

Klasifikimi i zanoreve bëhet duke u mbështetur në formën, vëllimin dhe numrin e rezonatorëve të kanalit zanor. Ky vëllim dhe kjo formë varen nga tre faktorë: pozita e gjuhës, pozita e buzëve dhe shkalla e hapjes së gojës.

Gjuha standarde shqipe ka një inventar vokalik që përbëhet nga shtatë tinguj themelorë ose fonema zanore gojore /a, e, ë, o, i, y, u/. Gjatë nyjëtimin të zanoreve gojore qiellza e butë është e ngritur dhe drejton në hapësirën e gojës gjithë ajrin që vjen nga mushkëritë. Në shqipen standarde nuk ka zanore hundore dhe nuk ka dallim fonologjik të gjatësisë së zanoreve (me vlerë kuptimdalluese ose gramatikore, përkundër gegërishtes që ka një inventar vokalik prej tri seri zanoresh: a. zanore të shkurtra, b. të gjata dhe c. hundore).

Zanoret mund të jenë të theksuara ose të patheksuara. Shqipja standarde nuk ka zanore që dalin vetëm në pozitë të theksuar, as të tilla që dalin vetëm në pozitë të patheksuar.⁴³

⁴³ Në të folmet e gegërishtes zanorja [ë] asnjëherë nuk del në pozitë të theksuar, por vetëm në pozitë të patheksuar.

Sistemi zanor i gjuhës shqipe, ashtu si i gjithë sistemi i saj fonologjik, është rezultat i një evolucioni të pandërprerë, që e ka bërë atë të ndryshojë shumë në krahasim me tipin e lashtë indoevropian. Në shqipen e dokumentuar ndeshen shtatë zanore kryesore: /a, i, e, o, u, y, ë/, të cilat deri disa shekuj më parë dëshmoreshin edhe me shkrim si të shkurtra dhe të gjata. Pesë të parat nga këto shtatë zanore, në thelb, janë të trashëguara nga një fazë më e lashtë indoevropiane, kurse /y/-ja dhe /ë/-ja janë përfutur gjatë evolucionit historik të shqipes.⁴⁴

Klasifikimi dhe përshkrimi nyjëtitor i zanoreve zakonisht bëhet duke u mbështetur në zanoret e theksuara, ndërsa për zanoret e patheksuara flitet sidomos kur bëhet fjalë për tiparet e tyre akustike.

Zanoret nuk kanë vend të caktuar të nyjëtimit, siç kanë bashkëtingëlloret. Vendi i formimit të tyre konstatohet sipas lëvizjes së gjuhës dhe sipas fushës së përqendrimit të rrymës së ajrit në zgavrën e gojës (në pjesën e përparme, të mesme a të prapme, më poshtë ose më lart), repektivisht sipas formanteve (kryesisht sipas F₁ dhe F₂).

Klasifikimi i zanoreve bëhet sipas lëvizjes së gjuhës dhe sipas formës së buzëve. Tiparet e përgjithshme nyjëtimore të zanoreve janë **radha**, **ngritja** dhe **buzorëzimi**. Gjuha dhe buzët luajnë rolin kryesor për formimin e timbrit të zanoreve, prandaj klasifikimi i zanoreve mbështetet pikërisht në pozicionin e tyre. Pozicioni i gjuhës përcakton *radhën* dhe *ngritjen* e zanoreve, ndërsa pjesëmarrja e buzëve në nyjëtimin e disa zanoreve përcakton *buzorëzimin* e tyre.

Gjuha mund të lëvizë në dy drejtime kryesore: para - prapa (lëvizje horizontale) dhe lart - poshtë (lëvizje pingule, vertikale). Nga lëvizja horizontale e gjuhës përcaktohet radha e zanoreve, ndërsa nga lëvizja pingule e gjuhës varet shkalla e hapjes apo e ngritjes së zanoreve. Me fjalë të tjera, zanoret e shqipes klasifikohen

- a) sipas *vendit të ngritjes së gjuhës drejt qiellzës*,
- b) sipas *shkallës së ngritjes*, si dhe
- c) sipas *pjesëmarrjes ose mospjesëmarrjes së buzëve* në artikulimin e tyre.

a) Sipas lëvizjes horizontale të gjuhës, përkatësisht sipas vendit të ngritjes së gjuhës drejt qiellzës, dallojmë:

- **zanore të përparme** ose zanore të radhës së përparme: [i, y, e];
- **zanore të prapme** ose zanore të radhës së prapme: [u, o] dhe
- **zanore qendrore** ose zanore të radhës së mesme: [a, ë].⁴⁵

Te zanoret e *përparme* trupi i gjuhës shtyhet përpara, ndërsa pjesa e mesme e shpinës së gjuhës ngrihet drejt qiellzës së fortë. Gjatë nyjëtimit të zanoreve të *prapme* trupi i gjuhës tërhiqet prapa, ndërsa pjesa e prapme e

⁴⁴ Shaban Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996, f. 47.

⁴⁵ Në gjuhë të ndryshme zanorja [a] konsiderohet si qendrore (e radhës së mesme) ose si e prapme. P.sh. në maqedonishten, kroatishten e serbishten merret si qendrore, në anglishten – zanore e prapme. Kjo larmi klasifikimi është rrjedhojë e vështirësisë së përcaktimit të vendit të nyjëtimit të kësaj zanoreje për shkak të hapjes maksimale të gojës në nyjëtimit.

shpinës së gjuhës ngrihet drejt qiellzës së butë. Kemi zanore *qendrore* (disa gjuhëtarë përdorin edhe termet zanore të radhës së mesme, centrale, të radhës së përzier) atëherë kur gjuha zë një pozicion të ndërmjetëm midis zanoreve të përparme dhe të prapme.




Fig. 26. Pozita e gjuhës gjatë nyjëtimit të zanores së përparme [i] (vija e plotë) dhe zanores së prapme [u] (vija e ndërrerë)

Nga lëvizja pingule e gjuhës, d.m.th. nga shkalla e ngritjes së gjuhës drejt qiellzës, përcaktohet **ngritja** e zanoreve; ose nga shtegu që mbetet midis sipërfaqes së gjuhës dhe qiellzës përcaktohet shkalla e **hapjes së zanoreve**. Kjo në të folurit e rëndomtë, mund të vërehet edhe nga shkalla e hapjes së gojës, sepse te një zanore ajo hapet më së shumti, te tri të tjera fare pak dhe te disa të tjera mesatarisht, megjithëqë kjo pak a shumë varet edhe nga përkatësia territoriale e folësit të shqipes, shprehitë individuale, gjendja emocionale e njeriut etj. Sidoqoftë, kriter bazë për klasifikimin e zanoreve sipas ngritjes është lëvizja vertikale e gjuhës, përkatësisht gjerësia e hapësirës midis sipërfaqes së gjuhës dhe qiellzës.

Kemi **zanore të hapur** ose **zanore të ngritjes së ulët**, kur gjuha ngrihet fare pak drejt qiellzës. Zanore e tillë në gjuhën shqipe është [a]-ja. Kjo quhet **zanore e hapur** ose e **gjerë**, meqë largësia midis sipërfaqes së gjuhës dhe qiellzës është e madhe, zaten më e madhe se te çdo zanore tjetër.

Për nyjëtimin e **zanoreve të mbyllura** ose **zanoreve të ngritjes së lartë** gjuha ngrihet më lart se te zanoret e tjera dhe i afrohet qiellzës. Zanore të ngritjes së lartë në gjuhën shqipe janë [i], [y] dhe [u]. Këto ndryshe quhen edhe **zanore të mbyllura**, të **ngushta**. Zanoret [i] dhe [y] quhen edhe **qiellzore** (palatale), sepse gjuha gjatë nyjëtimit të këtyre zanoreve afrohet te qiellza e fortë. Te [u]-ja pjesa e prapme e gjuhës tërhiqet dhe ngrihet drejt qiellzës së butë, vëllimi i zgavrës së gojës zmadhohet; prandaj ajo mund të quhet edhe **velare**.

Kemi zanore **gjysmë të hapura**, ose **zanore të ngritjes së mesme** kur gjuha ngrihet mesatarisht drejt qiellzës. Të tilla në shqipen standarde janë zanoret [e], [ë] dhe [o]. Ato shpeshherë emërtohen edhe si **zanore gjysmë të mbyllura**. Pra, kemi:

- **zanore të hapura** a zanore të ngritjes së ulët (të gjera): [a];

- **zanore gjysmë të hapura** a të ngritjes së mesme (gjysmë të mbyllura): [e], [ë] e [o]; dhe

- **zanore të mbyllura** ose të ngritjes së lartë (të ngushta, qiellzore): [i], [y] dhe [u] (velare).

Me anë të vizatimeve skematike po paraqesim pozitën e gjuhës dhe madhësinë e rezonatorëve gjatë nyjëtimit të zanores së hapur [a], zanores gjysmë të hapur [e] dhe zanores së mbyllur [i]:




Fig. 27. Vizatimet skematike tregojnë pozitën e gjuhës dhe madhësinë e rezonatorëve gjatë nyjëtimit të zanoreve [a], [e] dhe [i]

Klasifikimi dhe përcaktimi si: zanore e hapur, gjysmë e hapur dhe zanore e mbyllur bëhet mbi bazë të varianteve themelore të zanoreve. Për variant themelor të tingullit merret nyjëtimi i tij i veçantë (i izoluar).

Si[dihet, tingujt, si njësi segmentore të ligjërimin, për të krijuar fjalë e fjali përdoren njëri pas tjetrit dhe kështu gjenden në rrethime e kushte të ndryshme fonetike, prandaj edhe si zanoret, ashtu edhe bashkëtingëlloret modifikohen (pësojnë ndryshime, përshtaten). Kështu, p.sh. kemi raste kur një [i] është më pak e mbyllur sesa një [i] tjetër, që gjendet në një pozicion tjetër fonetik, që mund të jetë më shumë e mbyllur.

Sipas pjesëmarrjes ose mospjesëmarrjes së buzëve në nyjëtimin e tyre, zanoret e gjuhës shquhen në:

- **zanore të buzorëzuara** (labiale, buzore): [y], [u] dhe [o]; ose
- **zanore të pabuzorëzuara** (jolarbiale, jobuzore): [a], [i], [e] dhe [ë].

Në nyjëtimin e zanoreve të buzorëzuara buzët zgjaten dhe rrumbullakohen, ndërsa te zanoret e pabuzorëzuara buzët nuk marrin pjesë në nyjëtim; pra, ato janë asnjëse.

Vendi i nyjëtimin të zanoreve në gojën e njeriut, në fonetikë zakonisht paraqitet në mënyrë skematike me ndonjë trup gjeometrik: në trekëndësh, në formën e një trapezi ose të një elipseje, për shkak të paraqitjes grafike më të lehtë e më praktike. Këtë mënyrë të paraqitjes i pari e praktikoi fonetikani anglez Daniel Xhounz (Daniel Jones) dhe, që atëherë kjo mënyrë zbatohet në të gjitha gjuhët e botës. Diagrami duhet kuptuar si paraqitje skematike e prerjes së zgavrës së gojës së njeriut që shikon në të majtë, ku pikat tregojnë vlerat optimale të zanoreve dhe si orientim edhe pozitën më skajore që ndonjë pjesë e gjuhës e arrin gjatë artikulimit të zanoreve themelore (kardinale, bazë). Në të mund të shënohen zanoret e cilësdo gjuhë.

Kështu duket diagrami i zanoreve të shqipes standarde të paraqitur në trekëndëshin akustik:




Fig. 28. Trekëndëshi akustik i zanoreve të shqipes letrare

Sistemin e zanoreve të gjuhës standarde shqipe mund ta paraqesim me anë të kësaj tablele:

	Të përparme		Qendrore	Të prapme
	të pabuzor.	të buzorëz.	të pabuzor.	të buzorëz.
Të mbyllura	i	y		u
Gjysmë të mbyllura	e		ë	o
Të hapura			a	

Tabela 3. Tabela e klasifikimit të zanoreve të shqipes standarde

Klasifikimi i zanoreve në mënyrë grafike mund të paraqitet me diagrame të ndryshme (në trekëndësh akustik, në trapez, në elipsë):




Fig. 29. Diagramet e zanoreve të shqipes standarde

Tiparet e radhës, të ngritjes dhe të buzorëzimit të zanoret nuk paraqiten të vejuara, por të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Bashkëlidhjen e këtyre tipareve po e paraqesim në tabelën e mëposhtme; ku me shenjën plus (+) shënohet prania e tiparit. Tabela paraqet tiparet e pavarura nga pozicioni, që shfrytëzohen në kundërvëniet e fonemave:

tipari fonema	të përparme	të mesme	të prapme	të mbyllura	gjysmë të hapura	të hapura	të buzorëzuara	të pa-buzorëzuara
/i/	+			+				+
/y/	+			+			+	
/e/	+				+			+
/ë/		+			+			+
/a/		+				+		+
/u/			+	+			+	
/o/			+		+		+	

Tabela 4. Tiparet kundërvënëse të fonemave zanore të shqipes

2.2. PËRSHKRIMI NYJËTIMOR I ZANOREVE TË SHQIPES STANDARDE

Për përshkrimin dhe krahasimin e zanoreve të gjuhëve të ndryshme përdoret sistemi i zanoreve themelore (kardinale), i krijuar nga fonetikani anglez Daniel Xhounz (Jones). Këto zanore shërbejnë si një normë ideale, si një etalon, me të cilin përqasen zanoret e një gjuhe të dhënë. Zanoret themelore nuk janë tinguj realë, por tinguj të përfytyruar, se realizohen në pozicionet më skajore që mund të zërë gjuha në zgavrën e gojës, tej të cilave nuk mund të nyjëtohen tinguj të ligjërimit ose kalohet në bashkëtingëllore. Sistemi i zanoreve themelore përbëhet nga tetë zanore: [i], [e], [ɛ], [a], [u], [o], [ɔ], [ɑ].




Fig. 30. Zanoret themelore të të gjitha gjuhëve

Duke iu referuar zanoreve themelore, në trapezin vokalik mund të vendosen zanoret e çdo gjuhe. Nga përqasja e këtyre me zanoret themelore zbulohen veçoritë e sistemeve vokalice të gjuhëve të ndryshme. Kështu, më afër pozicioneve të zanoreve themelore janë zanoret e frëngjishtes e të italishtes. Për zanoret e këtyre gjuhëve themi se janë të *ndera*, d.m.th. shqiptohen me një nderje (tension) më të madhe të organeve të gojës.

Zanoret e shqipes realizohen gjithashtu si të ndera, por jo aq sa zanoret e frëngjishtes ose zanoret themelore: ato janë më qendrore. Zanoret e anglishtes dhe të rusishtes, përkundrazi, janë më të *labërguara*, d.m.th. nyjëtohen me një tension më të vogël të organeve të gojës. Pra, shkalla e nderjes muskulore të organeve të gojës është një faktor tjetër që ndikon në cilësinë e zanoreve.⁴⁶

Përshkrimi më praktik i zanoreve është ai që bëhet në bazë të tipareve të tyre nyjëtimore. Për një përcaktim më të përpiktë të këtyre tipareve, zanoret e shqipes standarde krahasohen me etalonet nyjëtimore, përkatësisht me zanoret themelore (kardinale). Të tilla në gjuhën shqipe janë zanoret e mbyllura [i], [u] dhe zanorja e hapur [a]:




Fig. 31. Zanoret themelore të shqipes

Pozicioni i nyjëtimimit të zanoreve [i], [u] dhe [a] shënon kufirin e fundit të mundshëm të lëvizjes së gjuhës për shqiptimin e zanoreve. Ngritja e mëtejme e gjuhës nuk është e lejueshme, sepse bëhet një ngushtim i madh i hapësirës nga kalon ajri dhe si rrjedhim fitohet një zhurmë, d.m.th. bashkëtingëllore (p.sh. i > j: ai > aj, i vëllai > i vëllaj). Më shumë se te zanorja themelore e hapur [a] ulja e mëtejme e gjuhës, në të folur po kështu nuk është e mundshme. Zaten goja mund të hapet edhe më shumë se te [a]-ja, ndonëse jo për të folur, por për t'ia treguar mjekut fytin ose dhëmbët. Zanoret e ndërmjetme a zanoret gjysmë të hapura [e, ë, o] ndajnë në mënyrë të barabartë largesën midis zanoreve themelore të mbyllura [i, u] dhe zanores së hapur [a].

Në rrjedhën e të folurit (në fjalë e fjali) fonemat zanore realizohen si nuanca fonemash përkatëse. Në fjalë duke u përdorur në afërsi bashkëtingëlloresh ose zanoresh, zanoret mund të modifikojnë radhën, hapjen, shkallën e buzorëzimit; ato mund të hundorëzohen etj., rrjedhimisht

⁴⁶ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 72-73.

ndryshohet edhe struktura formante e tyre. Ndërkaq, në pozitën e izoluar zanoreve nuk u ndryshohen as karakteristikat nyjëtimore e as akustike.

Në tekstet e fonetikës, variantet e tingujve të nyjëtuar në pozitë të izoluar quhen nuanca themelore ose **variante themelore**, ndërsa ato të nyjëtuar në rrethe të caktuara fonetike quhen **variante pozicionale** ose **kombinatorë**.⁴⁷ Kurdo që përshkruhet nyjëtimi i fonemave zanore, zakonisht merret parasysh *nyjëtimi i varianteve themelore* të tyre.⁴⁸

Nyjëtimi i variantit themelor të zanores [i]

Zanorja [i] në pozitë të izoluar shqiptohet me një hapje të vogël të gojës. Trupi i gjuhës shtyhet mjaft përpara, është i mbledhur; kështu që në zgavrën e faringut formohet një hapësirë e madhe rezonuese. Pjesa e përparme dhe e mesme e shpinës së gjuhës ngrihen lart në drejtim të qiellzës së fortë, porse mbetet një shteg i ngushtë për të kaluar ajri. Anët e gjuhës ngrihen dhe mbështeten në qiellzën e fortë, më shumë se te të gjitha zanoret e tjera. Maja e gjuhës është e ulur dhe prek dhëmbët e poshtëm. Buzët nuk marrin pjesë në nyjëtimin e kësaj zanoreje; pra ato janë asnjënjë.

Rrjedhimisht [i]-ja është zanore *e përparme, e mbyllur dhe e pabuzorëzuar*.

Shqiptimi i variantit themelor të zanores [y]

Variante themelor i zanores [y], ashtu si edhe [i]-ja, shqiptohet me një hapje të vogël të gojës. Buzët marrin pjesë aktive në nyjëtim: ato zgjaten dhe rrumbullakohen më shumë se te të gjitha zanoret. Trupi i gjuhës zhvendoset përpara (por më pak se tek [i]-ja), kështu që hapësira e faringut zgjerohet. Pjesa e përparme dhe e mesme e shpinës së gjuhës ngrihen drejt qiellzës së fortë, por jo aq lart sa tek [i]-ja. Pra, [y]-ja është më e hapur dhe më e prapme se [i]-ja.

Në përgjithësi variante themelor i [y]-së është zanore *e mbyllur, e përparme, e buzorëzuar*.

Nyjëtimi i variantit themelor të zanores [u]

Ashtu si [i]-ja dhe [y]-ja, zanorja [u] në pozitë të izoluar shqiptohet me një hapje të vogël të gojës. Buzët marrin pjesë aktive: zgjaten dhe rrumbullakohen, duke formuar një kalim të ngushtë për ajrin. Trupi i gjuhës tërhiqet prapa, kështu që hapësira e faringut ngushtohet. Maja e gjuhës është e ulur poshtë, por zakonisht nuk i prek dhëmbët, sepse është e tërhequr prapa. Pjesa e përparme dhe e mesme e shpinës së gjuhës janë të ulura dhe nuk ngriten drejt qiellzës. Pjesa e prapme e shpinës së gjuhës ngrihet lart drejt

⁴⁷ Zeqir Sadiku, *Fonetika e gjuhës së sotme letrare ruse*, Prishtinë, 1981, f. 32.

⁴⁸ Anastas Dodi – Jorgji Gjinari, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 33.

qiellzës së butë (prandaj quhet edhe velare). Shkalla e ngritjes së gjuhës drejt qiellzës është pothuaj e njëjtë me atë të [i]-së.

Mund të përfundohet se [u]-ja e shqipes është zanore **e prapme, e mbyllur, e buzorëzuar**.

Formimi i variantit themelor të zanores [o]

Zanorja [o] shqiptohet me një hapje mesatare të gojës. Buzët zgjaten pak dhe rrumbullakohen; kështu [o]-ja është një tingull me buzorëzim të dobët. Ashtu si edhe te [u]-ja, kur shqiptojmë zanoren [o], trupi i gjuhës tërhiqet prapa. Pjesa e përparme dhe e mesme e gjuhës janë të ulura poshtë dhe zakonisht maja e gjuhës nuk i prek dhëmbët. Pjesa e prapme e gjuhës ngrihet mesatarisht drejt qiellzës së butë. Anët e gjuhës janë të ulura, nuk ngrihen drejt qiellzës e dhëmbëve të sipërm.

Në përgjithësi varianti themelor i [o]-së është zanore **gjysmë e hapur, e prapme, e buzorëzuar**.

Artikulimi i variantit themelor të zanores [e]

Edhe zanorja [e] shqiptohet me një hapje mesatare të gojës. Trupi i gjuhës zhvendoset përpara, por më pak se tek [i]-ja, kështu që hapësira e faringut zgjerohet. Maja e gjuhës është e ulur dhe prek dhëmbët e poshtëm. Anët e gjuhës prekin qiellzën e fortë, por sipërfaqja e kontaktit është më e vogël se tek [i]-ja. Pjesa e mesme e shpinës së gjuhës ngrihet mesatarisht drejt qiellzës së fortë. Buzët nuk marrin pjesë në nyjëtim.

Rrjedhimisht, varianti themelor i zanores [e] mund të karakterizohet si zanore **gjysmë e hapur, e përparme, e pabuzorëzuar**.

Në shqiptimin e zanores [a] goja hapet më shumë se te të gjitha zanoret e tjera. Gjuha zë një pozicion të ndërmjetëm midis zanoreve të përparme dhe të prapme. Pjesa e prapme e shpinës së gjuhës ngrihet fare pak në kufirin midis qiellzës së butë dhe qiellzës së fortë.

Trupi i gjuhës tërhiqet pak prapa (por jo sa te zanoret e prapme), kështu që hapësira e faringut ngushtohet. Buzët nuk marrin pjesë në nyjëtim, qiellza e butë është e ngritur.

Për shkak se ngritja e gjuhës drejt qiellzës është fare e vogël, si edhe tërheqja e gjuhës prapa; zanorja [a] mund të konsiderohej e palokalizuar nga pikëpamja e radhës. Por, duke u mbështetur edhe në pozicionin e gjuhës në zgavrën e gojës, pozicion që i ngjan atij të qetësisë, kjo nuancë e [a]-së përcaktohet si qendrore (e radhës së mesme).

Në përgjithësi, varianti themelor i [a]-së përcaktohet si zanore **e hapur, qendrore** (e radhës së mesme), **e pabuzorëzuar**.

Nyjëtimi i variantit themelor të zanores [ë]

Varianti themelor i zanores [ë] shqiptohet me një hapje mesatare të gojës. Buzët nuk marrin pjesë në nyjëtimin e kësaj zanoreje. Trupi i gjuhës në zgavrën e gojës zë një pozicion qendror, që i ngjan atij të qetësisë absolute, d.m.th. kur njeriu është në qetësi, nuk flet. Maja e gjuhës është e ulur dhe zakonisht prek dhëmbët e poshtëm. Gjithë trupi i gjuhës është i ngritur mesatarisht drejt qiellzës.

Në përgjithësi ky variant i [ë]-së është zanore **qendrore** (e radhës së mesme), **gjysmë e hapur, e pabuzorëzuar**.

2.3. TOGJET E ZANOREVE DHE DIFTONGJET

Siç dihet, gjuhët e botës kanë zanore të mirëfillta (të thjeshta, monoftongje, njëzëshe), ngjyra akustike e të cilave për veshin e njeriut mbetet gjithnjë e njëjtë gjatë gjithë kohës së artikulimit; dhe diftongje (dyzëshe), që gjatë nyjëtimin ndryshojnë ngjyrimin (shih fig. 19 me spektrogramin e dy diftongjeve). Në fillim të diftongut dëgjohet timbër i një zanoreje, ndërsa nga fundi timbër i një zanoreje tjetër. Gjuhë tipike me shumë diftongje është anglishtja, po edhe gjermanishtja. Gjuhët që kanë diftongje karakterizohen me artikulum të shtendosur, përkundër gjuhëve që nuk kanë diftongje, që dallohen me artikulum të tendosur.

Në gjuhën e sotme shqipe, në rrjedhën e të folurit ndodh që të shqiptohen njëra pas tjetrës dy a më shumë zanore, si p.sh *përrua, kuadër, kuotë, mësuës, diell, kau, punoi, aeroplan, teori* etj.

Po qe se dy zanore në kontakt shqiptohen veçmas, duke formuar secila rrokje më vete, kemi **tog a grup zanoresh**. Të tilla janë p.sh. zanoret që janë pranë njëra-tjetrës në fjalët *grua, ftua, muaj, duar, mësuës, përkthyes, krye, arsye, fyell* etj. Në këto raste secila nga zanoret ruan pavarësinë e vet dhe formon rrokje më vete. Me fjalë të tjera, në shumicën e fjalëve të shqipes standarde, në përbërjen e të cilave ka dy zanore që vijnë njëra pas tjetrës, asnjëra nga zanoret e njëpasnjëshme nuk bëhet gjysmëzanore, rrjedhimisht formohen togje zanoresh. Te togjet e zanoreve theksi zakonisht bie në zanoren e parë.

Ndryshe ndodh në raste të tilla si *opiúm, akuárium, herbaríum, kuárc, kuótë, materíe, peizazh, kuálifikoj* etj., ku të dy zanoret formojnë një rrokje të vetme. Ato fonetikiisht formojnë një **diftong** (< gr. *dis* "i dyfishtë" + *phthongos* "tingull" = dytingullsh, tingull i dyfishtë). Pra, diftong formojnë dy zanore, po qe se shqiptohen me një rrokje të vetme. Dy zanore për të formuar një rrokje të vetme, e patheksuara duhet ta humbasë aftësinë rrokjeformuese, të reduktohet dhe të shndërrohet në gjysmëzanore a të konsonantizohet. Këtë aftësi rrokjeformuese e humbin zakonisht zanoret e mbyllura [i, u, y] kur janë të patheksuara, si ai [aj]: *babai, vëllai*; au [av]: *thau, kau, lau*; éu: *préu, théu, kréu*; úá: *skuádër, kuádër, kuálifikoj*; ói: *punói, shkói, ftói* etj., ku dy zanore formojnë

një diftong, sepse zanoret e mbyllura shndërrohen në gjysmëzanore. Shqiptohet si diftong edhe togu *ia* në raste të tilla si *ia dha* ëja dha], *ia thashë* [ja thashë] etj. Kur zanorja e mbyllur është e theksuar, atëherë s’kemi diftong, por tog zanoresh.

Nga pikëpamja fiziologjike, diftongjet kanë njëtim të përbërë, elementet e të cilave janë të lidhura ngushtë midis tyre. Për njëtimin e tyre organet aktive kalojnë me rrëshqitje nga njëtimi i njërës zanore në tjetrën, dhe me gjithë ndryshimin e timbrit, veshi i përkap ato si një njëtim të vetëm. Për sa i përket gjatësisë, diftongjet dalin 1.5 deri 2 herë më të gjata se zanoret e thjeshta, por më të shkurtra se togjet e zanoreve gjegjëse.

Diftongjet e shqipes janë natyrash të ndryshme. Ndonjë prej tyre është i vjetër, i formuar nga zbrërthimi i një zanoreje, si p.sh. diftongu *ie*; një pjesë tjetër kanë hyrë nëpërmjet huazimeve, ndërsa disa janë krijuar si rrjedhim i takimit brenda fjalës në kufij morfemash apo në kushtet e sandhisë sintaksore, si te *shtëpia*, *shkoi*, *shtyu* etj.

Në gjuhën shqipe janë të mundshme vetëm grupe dyshe zanoresh; por edhe nga kombinimet dyshe jo të gjitha janë të mundshme. Kështu, nga 49 grupe zanoresh teorikisht të mundshme, në leksikun e shqipes standarde hasen vetëm 22 grupe:

	a	e	ë	i	o	u	y
a	aa	ae	aë	ai	ao	au	ay
e	ea	ee	eë	ei	eo	eu	ey
ë	ëa	ëe	ëë	ëi	ëo	ëu	ëy
i	ia	ie	ië	ii	io	iu	iy
o	oa	oe	oë	oi	oo	ou	oy
u	ua	ue	uë	ui	uo	uu	uy
y	ya	ye	yë	yi	yo	yu	yy

Tabela 5. Kombinimet e mundshme të grupeve dyshe të zanoreve

Por, edhe nga këto grupe, vetëm një pjesë e vogël e tyre mund të gëzojnë edhe statusin e diftongut. Vetëm grupet **ai**, **au**; **ei**, **eu**; **ia**, **ie**, **io**, **iu**; **oi**, **ou**; **ui**, **uo** dhe **yu** mund të jenë edhe diftongje në gjuhën standarde shqipe.⁴⁹

Meqë zakonisht zanorja rrokjeformuese e diftongut është e theksuar, sipas vendit ku bie theksi (në zanoren e parë apo në të dytën), dallojmë diftongje zbritëse dhe diftongje ngjitëse. Kur zanorja e theksuar ndodhet në fillim, diftongu quhet *zbritës*, si p.sh. *káu*, *théu*, *kréu*, *aríu*, *fshúu*, *babái*, *vëllái*; ndërsa kur vjen pas, kemi diftong *ngjitës*, si në fjalët *kuótë*, *kuádër*, *kuárc*, *piáno* etj. Por, ka edhe diftongje në të cilat të dyja zanoret janë të patheksuara (mjauállín). Këto quhen duftongje të *ekuilibruara*.

⁴⁹ Rami Memushaj, *Diftongjet e shqipes standarde*, Eqrem Çabej dhe kultura shqiptare, Universiteti Eqrem Çabej, Gjirokastrë, Tiranë, 2004, f. 233-244.

A ka gjuha shqipe diftongje nga pikëpamja fonetike dhe nga pikëpamja fonologjike (diftongje njëfonemëshe)?

Përgjithësisht zanoret e shqipes standarde, pavarësisht nga rrethimi tingullor (edhe sikur para ose pas tyre të kenë cilëndo zanore ose bashkëtingëllore që lejon parimi i bashkëlidhjes) karakterizohen me qëndrueshmëri (stabilitet) nyjetimore. Për këto zanore thuhet se kanë stadium gojor dhe janë zanore të thjeshta. Por megjithkëtë, nganjëherë ka edhe raste kur ndonjëra nga zanoret në kontakt me zanoren tjetër e humb stadiumin gojor. Stadium gojor do të thotë të qëndruarit për një kohë të caktuar (disa të qindta të sekondës) në një formë e pozitë të caktuar të aparatit të të folurit. Kjo është veçori e zanoreve.

Mungesa e stadiumit gojor është tipar i diftongjeve dhe i diftongoideve. Gjatë kohës së nyjetimit të diftongjeve kemi ndërrimin e pozitës së organeve të të folurit (sidomos të gjuhës), gjatë së cilës në këtë tërësi artikuluese shfaqen dy faza të shkrira nyjetimi, rrjedhimisht edhe dy fragmente. Zakonisht në fillim të diftongut dëgjohet një timbër i një zanoreje, ndërsa në fund një timbër i ndonjë zanoreje tjetër.⁵⁰

Pra, nga pikëpamja nyjetimore diftongjet janë tinguj të përbërë. Për prodhimin e tyre, organet e të folurit kalojnë me rrëshqitje nga pozicioni i nyjetimit të një zanoreje në pozicionin e nyjetimit të zanores tjetër. Ndryshimi i vëllimit dhe i formës së rezonatorit të gojës në këto lëvizje bëjnë që gjatë prodhimit të diftongut të përkapen dy timbra të ndryshëm. Si gjithë tingujt e përbërë, diftongjet në disa gjuhë mund të funksionojnë si fonema më vete, krahas fonemave të tjera zanore. Në gjuhën shqipe diftongjet janë variante kombinatorë (alofone) të fonemave zanore përkatëse dhe nuk konsiderohen si fonema të veçanta.

Të folmet shqipe nga pikëpamja fonetike kanë diftongje, sidomos gegërishtja qendrore. Denduria e diftongjeve në të folmet e gegërishtes qendrore, për dallim nga të folmet e tjera të shqipes, qëmoti është shtuar nga shpërbërja (diftongimi) e zanoreve të mbyllura (/i, u, y/) në një numër të madh fjalësh në pozicione të caktuara fonetike. Kështu, në pozitë të theksuar, /i/-ja e gjatë e theksuar (í:) shpërbëhet në diftongjet *âi, êi, êi, ôi*: *shpí* > *shpâi, shpêi, shpêi, shpôi*; /y/-ja është zhbuzorëzuar në /i/ dhe më vonë ka pasur të njëjten rrugë zhvillimi, është diftonguar si edhe /i/-ja parësore: *sy* > *si* > *sâi, sêi, sêi, sôi*; ose /u/-ja në *âu, ôu, êu*: *núse* > *nâuse, nôuse, nêuse* e në shumë fjalë të tjera.

Gjuha standarde shqipe nga pikëpamja fonetike ka diftongje, si në fjalët *babái, vëllái, ái, punói; dhéu, préu* etj. Në fjalët e këtilla zanoret e patheksuara fundore konsonantizohen dhe shqiptohen si gjysmëzanore ([i]-ja nyjtohet afërsisht si [j]-ja, ndërsa [u]-ja si [v]-ja).

Si njësi fonetike të përbëra nga dy elemente, diftongjet vështrohen edhe nga pikëpamja fonologjike, d.m.th. a përbëjnë një fonemë të vetme apo paraqiten si bashkim i dy fonemave të veçanta. Parashtrohet pyetja:

⁵⁰ Ирена Савицка – Људмил Спасов, *Фонологија на македонскиот стандарден јазик*, Скопје, 1997, f. 24.

A ka diftongje shqipja standarde nga pikëpamja fonologjike?

Pyetjes se a ka diftongje njëfonemëshe shqipja standarde, prof. Rami Memushaj i përgjigjet duke u mbështetur në kriteret e përcaktuara qartë nga N. Trubeckoi.

Ai arrin të konstatojë se *diftongjet e shqipes standarde janë fonetike*.⁵¹

Togjet e zanoreve, që përbëjnë modelin më të përhapur në gjuhën tonë, vetvetiu nuk mund të vështrohen si njësi monofonematike, sepse ato përbëhen nga dy elemente të ndryshme, që rrinë njëri pranë tjetrit dhe formojnë dy rrokje.

Diftongjet fonematike, si njësi të pandashme (njëfonemëshe) në sistemin e gjuhës standarde shqipe, paraqiten në disa fjalë të huazuara (kryesisht të burimit latin), relativisht të pakta në numër, si *kuadër, kuarc, kuotë, akuarium, kolokuium, kuorum, sanduiç* (ang. sandwich) e ndonjë tjetër.

Si përfundim mund të nxirret se: gjuha standarde shqipe ka togje zanoresh me përdorim mjaft të dendur; nga pikëpamja fonetike ka diftongje, ndërsa nga pikëpamja fonologjike nuk ka diftongje njëfonemëshe (me përjashtim të pranisë së tyre në një numër të kufizuar fjalësh të huazuara, si ato që u shënuan më lart).

Diftongoidet. Të ngjashme me diftongjet janë edhe një kategori tingujsh që quhen *diftongoide* (nga greq. *diphthongos* + *eidōs* “i ngjashëm me diftongun”). Diftongoidet janë zanore që kanë në fillim ose në fund një element të paktë të ndonjë zanoreje tjetër. Ky timbër i ndryshëm që merr zanorja në fillim ose në fund shkaktohet nga ndryshimi i formës dhe i vëllimit të zgavrës së gojës gjatë kohës që zgjat prodhimi i tingullit, gjë që shkakton kalimin nga një nyjëtim më i mbyllur në një më të hapur ose anasjelltas. Por ky tingull i shkurtër përbën vetëm një ngjyrim plotësues ndaj timbrit themelor të zanores, prandaj diftongoidet nuk janë tinguj të përbërë.⁵² Gjuha standarde shqipe nuk ka diftongoide, por ato dëgjohen në të folmet e gegërishtes, si [m^uolla] “molla”, [n^aana] “nana”, [b^aab] “babë”, [d^uora] “dora”, [lⁱepër] “lepur”, [lⁱetër] “letër” etj.

2.4. GJATËSIA E ZANOREVE NË GJUHËN SHQIPE

Kuantiteti (gjatësia) përkufizohet si kohë e nevojshme për artikulimin e një tingulli. Gjatësia e tingujve, d.m.th. sasia e kohës që përdoret për shqiptimin e tyre, është dy farësh: *absolute* dhe *relative*.

⁵¹ Rami Memushaj, *Diftongjet e shqipes standarde*, Eqrem Çabej dhe kultura shqiptare, Universiteti Eqrem Çabej, Gjirokastër, Tiranë, 2004, f. 233-244.

⁵² Tingullthi (tingulli i shkurtër) i jep zanores së plotë karakter heterogjen, por nuk krijohet përshtypje e diftongut që ka dy gjymtyrë, sepse njëra zanore mbizotëron bindshëm ndaj zanores tjetër. Diftongoide hasen në gjuhën ruse. Shih: Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 74.

Gjatësia absolute varet drejtpërdrejt nga ritmi apo shpejtësia e të folurit. Kështu, sa më shpejt të flasim, aq më pak kohë zgjat nyjëtimi i çdo tingulli në krahasim me një të folur të ngadalshëm. Por, gjatësia e këtillë nuk paraqet shumë interes për gjuhësinë.

Me interes për gjuhësinë është gjatësia relative e tingujve. Kur flasim me të njëjtin ritëm (tempo), tingujt nuk i shqiptojmë me të njëjtën gjatësi, për shkak të faktorëve të ndryshëm.

Këta faktorë i ndajmë në dy grupe: në faktorë fonetike dhe në fonologjike, që përfaqësojnë dy lloj gjatësish:

I. **gjatësi fonetike** (që varet nga faktorët pozicionalë e kombinatorë), dhe

II. **gjatësi fonologjike** (që nuk varet nga faktorët pozicionalë e kombinatorë, por gjatësia ka karakter të qëndrueshëm dhe shërben për dallimin e kuptimit të fjalëve ose të formave gramatikore).

I. **Gjatësi fonetike** kemi atëherë kur gjatësia ose shkurtësia e tingujve varet nga një radhë shkaqesh të kushtëzuara fonetike, siç janë karakteri i rrokjes (e hapur – e mbyllur), numri i tingujve në fjalë, rrethimi fonetik i tingullit (tingujt që gjenden para e pas), pozicioni ndaj theksit etj. P.sh. në rrokje të hapur (që mbaron me zanore) zanoret janë më të gjata sesa zanoret në rrokje të mbyllur (që mbarojnë me bashkëtingëllore): krahaso fjalët *ha - hap, ka - kam, rri - rrip, mi - mik* etj. Sa më e shkurtër të jetë fjala, zanoret kanë kushte për shtrirje më të madhe dhe anasjelltas, sa më e gjatë të jetë fjala mundësia e shtrirjes së zanoreve zvogëlohet. Krahaso: *bashkë, tingull - bashkëtingëllore; krye, qytet - kryeqytet; zëvendës, drejtor - zëvendësdrejtor; mirë, sjellje - mirësjellje; farë e fis - farefis* etj.

Edhe karakteri i bashkëtingëlloreve, që e rrethojnë zanoren, sidomos i bashkëtingëllores që vjen pas, ndikon në gjatësinë e zanores. Kështu, është përdëftuar se zanoret që gjenden para bashkëtingëlloreve të tingullta (sonoreve) janë më të gjata sesa ato që përdoren përpara bashkëtingëlloreve të tjera. Zanoret në pozitë para sonoreve *-r, -ll* janë të gjata (khs. *shqipta:r, bi:r, ma:ll, y:ll, qu:ll* etj.). Përpara bashkëtingëlloreve shtegore, zanoret janë diçka më të gjata se para mbylltoreve. Po kështu, para bashkëtingëlloreve të zëshme zanoret janë më të gjata sesa para të shurdhëtave. Kur pas zanores vjen një grup bashkëtingëlloresh, zanorja është zakonisht më e shkurtër sesa kur pas saj vjen vetëm një bashkëtingëllore.

Në të gjitha këto raste, kemi të bëjmë me gjatësi jofonologjike ndërmjet zanoreve normale që zhvillohen plotësisht dhe zanoreve të shtypura, të penguara në zhvillimin e tyre me nisjen e bashkëtingëllores vijuese. Ndaj, në shqipen standarde (si dhe në shumë gjuhë të tjera) gjatësia dhe shkurtësia e zanores është tipar i bashkëlidhjes së fonemave në vargun e ligjërit.

Në gjatësinë e zanoreve, rol të rëndësishëm luan edhe theksi. Po të krahasojmë gjatësinë e zanoreve të theksuara dhe të patheksuara, kur kushtet e tjera fonetike janë të njëjta, del se të theksuarat janë relativisht më të gjata

sesa të patheksuarat. Raporti ndërmjet zanoreve të theksuara dhe të patheksuara në shqipen standarde është **10/7**.

Zgjatja e zanores së theksuar ndikon jo vetëm në shkurtimin e zanoreve të tjera të patheksuara, por edhe në shkurtimin e bashkëtingëlloreve në rrokje të patheksuara. Përveç kësaj, vlen të thuhet se sa më larg theksit të jenë zanoret, aq më të shkurtra janë.

Për çdo gjuhë gjatësia relative mesatare e një zanoreje në një pozicion të caktuar është një madhësi pak a shumë e caktuar.

Meqë gjatësia e tipit të këtyllë varet nga faktorë të jashtëm fonetikë, ajo nuk është e qëndrueshme, nuk është tipar i vazhdueshëm apo i përhershëm i tingujve. Prandaj, dallimi i gjatësisë nga kushtet e ndryshme fonetike nuk mund të formojë kundërvënien fonologjike, të dallojë seri tingujsh (zakonisht zanoresh) që t'i vihen përballë njëri-tjetrit, për të dalluar njësi semantike a gramatikore.

Toskërishtja dhe gjuha standarde shqipe ka gjatësi zanoresh të tipit fonetik. Zanoret e gjata janë nuanca kombinatorë dhe përgjithësisht mungon kundërvënien fonologjike të shkurtra ~ të gjata.

Sistemi fonetik i gjuhës letrare, edhe pse përbëhet vetëm nga një seri zanoresh gojore me gjatësi të kushtëzuar fonetike, i plotëson funksionet e veta të gjuhës. Funksionin kuptimdallues të zanoreve të gjata ajo e mbulon në të shumtën e rasteve me mjete të tjera fonetike e gramatikore. Kështu, mbajtja e zanores /ë/ të patheksuar në fund të fjalës zhduk homofoninë ndërmjet emrave të gjinisë femërore e atyre të gjinisë mashkullore (*plakë ~ plak*), shumësit nga forma e njëjësit (*shok ~ shokë*) etj.

Në bazë të kundërvënies fonologjike të gjatësisë së zanoreve (e shkurtër ~ e gjatë) te pak çifte minimale fjalësh edhe në shqipen standarde bëhet dallimi kuptimor i fjalëve, khs. *dhe* (lidhëz) ~ *dhe:* (emër), *bar* (lokal i vogël ku pihet në këmbë) ~ *ba:r* (bimë njëvjeçare), *para* (parafjalë) ~ *para:* (paraja, emër) etj.

Por, megjithëkëtë, mund të përfundohet se kuantiteti i zanoreve të shqipes së sotme është kthyer në gjatësi pozicionale dhe mund të shpjegohet me këto tri rregulla bazë (mund të ketë ndonjë rast të veçantë që u bie ndesh rregullave të mëposhtme):

1. *zanoret e shkurtra ndodhen në rrokje fundore të mbyllura;*
2. *zanoret e gjata gjenden në rrokje fundore të hapura;*
3. *zanoret e gjatësisë së mesme ndodhen në rrokje jofundore.*⁵³

II. **Gjatësi fonologjike** kemi atëherë kur gjatësia a shkurtësia e zanoreve nuk varet nga faktorë thjesht fonetikë, por është tipar i vazhdueshëm i fonemave, sepse vetëm në bazë të gjatësisë fonemat e shkurtra i vihen përballë fonemave të gjata, duke krijuar opozicion fonologjik. Kundërvënien

⁵³ Kolec Topalli, *Theksi në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1995, f. 94.

(opozicioni) e këtu e fonemave, në mungesë të treguesve të tjerë, përdoret për dallimin e kuptimit të fjalëve ose të formave gramatikore. Kjo bën që zanoret e shkurtra nga gjegjëset e tyre të gjata të luajnë rolin e fonemave të veçanta në gjuhë. Rrjedhimisht, kështu dalin dy seri fonemash zanore në rrokje të theksuar: fonema të shkurtra /a/, /e/, /i/, /o/, /u/, /y/ dhe fonema të gjata /a:/, /e:/, /i:/, /o:/, /u:/, /y:/.

Gjatësia fonologjike e zanoreve është tipar i vokalizmit të gegërishtes. Porse kjo vihet re edhe në disa krahina skajore të toskërishtes, si në Labëri, në Bregdet dhe në Çamërishten. E gjejmë dhe tek Arbëreshët e Italisë e të Greqisë së sotme. Kjo dëshmon se dallimi i zanoreve sipas kuantitetit, përkatësisht kundërvënia fonologjike zanore të shkurtra ~ zanore të gjata ka qenë i mbarë shqipes. Por, në një periudhë të hershme të zhvillimit kjo në dialektin e Jugut është mënjeluar e ka mbetur vetëm në Veri. Gjatësia e zanoreve në toskërishte ka karakter pozicional dhe kombinator e jo fonologjik.

Edhe brendapërbrenda gegërishtes dallimi fonologjik i zanoreve nuk është dukuri e përgjithshme, sepse nëpër të folme ka larmi. Ajo ka filluar të lëkundet dhe gjithnjë e më pak mund të gjenden çifte minimale fjalësh që dallohen për nga përbërja fonematike vetëm me zanore të gjatë ose të shkurtër që të dallohet kuptimi i tyre. Në të vërtetë, edhe në të folmet e gegërishtes mbizotëron gjatësia fonetike e tingujve, por në një numër të konsiderueshëm fjalësh ka edhe gjatësi fonologjike.

Siç dihet, gjatësia e zanoreve të gegërishtes varet nga shumë faktorë. Më së shpeshti ajo përcaktohet nga faktorë të jashtëm fonetikë dhe ndryshon së bashku me ndryshimin e vetë faktorëve: *gjăk - gja.ku*, *ka: - kău*, *me la: - lău*, *mĭk - mi.ku*, *mi: - mĭu* etj. Nganjëherë gjatësia është tipar i vazhdueshëm i zanores. Kjo tregon se gegërishtja është në një fazë kalimtare (tranzitore). Megjithatë, gjendja e vjetër, kur gjatësia ishte tipar fonologjik, ruhet ende.

Gjatësia në të folmet e gegërishtes edhe sot e kësaj dite përdoret për të diferencuar kuptimin e fjalëve dhe të formave gramatikore. Të tri gjatësitë fonetike (të shkurtra, të mesme dhe të gjata) përbëjnë vetëm një opozicion: të shkurtra e të mesme ~ të gjata. Pra, në aspektin fonologjik dallohen dy shkallë: **të shkurtra ~ të gjata**, nga se kuptimi i fjalëve apo i formave gramatikore te disa jifte minimale fjalësh dallohen vetëm nga ky tipar. Zanoret me gjatësi të mesme, në të vërtetë janë neutrale, ato nuk kundërvihen.⁵⁴ Bëhet fjalë për një asnjësim të gjatësisë së zanoreve të theksuara, sepse gjatësia e tyre fonetiki është e kushtëzuar. Kështu, gjatë eptimit të disa fjalëve, gjatësia e caktuar e zanores e bjerr funksionin semantik ose gramatikor dhe ky funksion bartet në mbaresë. P.sh.: Fjalët *plak* dhe *plakë* në toskërishten dhe në shqipen standarde dallohen fonetiki me anë të zanores fundore [-ë].

Në të folmet gege rënia e [-ë]-së fundore ka shkaktuar zgjatje kompensatore të zanores paraprirëse, në këtë rast të [a]-së. Kështu që emri i

⁵⁴ Rexhep Ismajli, *Rreth kuantitetit të zanoreve të theksuara në gjuhën shqipe*, Artikuj mbi gjuhën shqipe, Prishtinë, 1987, f. 193-200.

gjinisë mashkullore në trajtën e pashquar shqiptohet me [ã] të shkurtër (plãk), ndërsa ai i gjinisë femërore me [a:] të gjatë (pla:k). Në trajtën e shquar kemi [pla.k-u, (-i) ~ pla.k-a] ku edhe zanorja e shkurtër edhe zanorja e gjatë shndërrohen në zanore me gjatësi të mesme, nga shkaku se gjatësitë më nuk kanë asnjë rol të bartjes së informacionit (nuk është më tregues distinktiv i gjinisë), por rolin e tyre e kryejnë morfemat (mbaresat), përkatësisht fonemat /u/ ose /i/ për gjininë mashkullore dhe /a/ për gjininë femërore. Kalimet e të shkurtrave në të mesme dhe të gjatave në të mesme e anasjelltas, për shkak të kushteve të jashtme fonetike, e lëkundin dhe e ngatërrojnë vlerën fonologjike të gjatësisë.

Megjithkëtë, gjatësia shërben shpesh si mjet fonologjik për të dalluar kuptimin e disa çifteve minimale fjalësh, e sidomos për diferencimin e formave morfologjike të fjalëve. Po sjellim disa shembuj nga të folmet e gegërishtes ku gjatësia ka vlerë fonologjike, sepse kuptimi i fjalëve dhe i formave dallohet vetëm nga ky tipar:

1. **Gjatësia e zanoreve ka funksion leksikor** (semantik), si në çiftet *maz ~ ma:z* (mëz - ajkë), *çaj ~ çaj* (pije e nxehtë freskuese - çaj dru), *kos ~ ko:s* (kosi - kosa), *boll ~ bo:ll* (mjaft - lloj gjarpri), *kot ~ ko:t* (pa dobi - dremit), *shpat ~ shpa:t* (shpati - shpata), *mall ~ ma:ll* (malli - mallëngjim), *hall ~ ha:ll* (brenge - hallë-a), *shtat ~ shta:t* (trup - shtatë), *boj ~ bo:j* (trup - ngjyrë) etj.

2. **Gjatësia si mjet fonologjik ka përdorim të dendur, sidomos për dallimin e formave morfologjike.** Më të shumta janë fjalët, në përbërjen e të cilave kundërvënia e zanores së shkurtër ndaj zanores së gjatë bart me vete funksion gramatikor sesa karakter leksikor. Kështu, disa emra dallohen sipas gjinisë apo numrit, si dhe disa folje dallohen në mënyrë, kohë dhe vetë.

Përgjithësisht, në çiftet e fjalëve me kundërvënie fonologjike të gjatësisë së zanoreve të theksuara, emrat në numrin njëjës dhe ata të gjinisë mashkullore shqiptohen me zanore të shkurtër, ndërsa shumësi i tyre dhe gjinia femërore përkatëse me zanore të gjatë.⁵⁵ Edhe disa folje në mënyrën dëftore nyjëtohen me zanore të gjatë, ndërsa po këto folje me formë të njëjtë në mënyrën urdhërore dalin me zanore të shkurtër. Në të mirë të këtij konstatimi mund të sjellim disa shembuj:

a) *Dallim në gjini* (mashkullore ~ femërore): *plak ~ pla:k*, *kunat ~ kuna:t*, *krushk ~ kru:shk* etj.

b) *Dallim në numër* (njëjës ~ shumës): *vesh ~ ve:sh*, *dham ~ dha:m*, *fyshek ~ fyshe:k*, *dyshek ~ dyshe:k*, *oxhak ~ oxha:k*, *baxhanak ~ baxhana:k*, *dollap ~ dolla:p* etj.

⁵⁵ Çifte leksikore me dallim kuptimor dhe dallime gramatikore të fjalëve në bazë të gjatësisë së zanoreve në gegërishten janë krijuar sidomos **me rëniën e /ë/-së fundore**. Në dialektin e Veriut rënia e /ë/-së fundore ka shkaktuar **zgjatje kompensatore të gjatësisë** në zanoren që gjendej para saj. Prandaj, emrat në numrin njëjës dhe të gjinisë mashkullore shqiptohen me zanore të shkurtër, ndërsa po të njëjtit emra në shumës dhe në gjininë femërore dalin me zanore të gjatë.

c) *Dallim në mënyrën e foljes* (dëftore ~ urdhërore): Siç dihet, mënyra urdhërore ka forma gramatikore të vetat vetëm për vetën e dytë njëjës e shumës. Në vetën e dytë shumës të gjitha foljet dalin me të njëjtën formë si në vetën e dytë shumës të kohës së tashme të mënyrës dëftore. Këto dy forma homonime dallohen midis tyre vetëm nga intonacioni.⁵⁶

Megjithë përputhjet e këtilla të formave të foljeve në këto dy mënyra në aspektin morfologjik, vështruar nga ana fonetike e fonologjike në të folmet geqe format e njëjta dallohen sipas gjatësisë së zanores së theksuar: zakonisht zanorja e gjatë në përbërjen e foljes së mënyrës dëftore korrespondon me zanoren e njëjtë të shkurtër të mënyrës urdhërore. Falë kësaj dukurie, te foljet e këtilla pamundësohet homofonia e tyre në format e mënyrës urdhërore me gjeget e tyre të mënyrës dëftore.⁵⁷ Krahaso shembujt:

mënyra e foljes			
dëftore	urdhërore	dëftore	urdhërore
(ti) <i>he:c</i>	<i>hec!</i>	(ju) <i>he:cni</i>	<i>hecni!</i>
<i>ma:t</i>	<i>mat!</i>	<i>ma:tni</i>	<i>matni!</i>
<i>me:rr</i>	<i>merr!</i>	<i>me:rrni</i>	<i>merrni!</i>
<i>hi:p</i>	<i>hip!</i>	<i>hi:pni</i>	<i>hipni!</i>

Përmbledhje:

Nga gjithë sa u tha, del se gjatësia e tingujve të shqipes së sotme (dialektore dhe standarde) është përzierje e sistemit të vjetër me gjatësi fonologjike të zanoreve me tipin e ri të gjatësisë së shkaktuar nga faktorë të jashtëm fonetikë (gjatësi fonetike). Në ndërgjegjen e folësve nuk është gjithnjë e qartë vlera e gjatësisë. Kjo tregon se shqipja në Jështjen e gjatësisë së zanoreve gjendet në një fazë kalimtare: toskërishtja dhe shqipja standarde kanë evoluar në tipin fonetik të gjatësisë, ndërsa gegërishtja (edhe pse me mbizotërim të gjatësisë fonetike) ende e ruan tipin fonologjik të gjatësisë. Edhe atje ku ruhet dallimi fonologjik i gjatësisë së zanoreve në sajë të traditës, vlera fonologjike po zbehet. Në mjaft krahina të gegërisë gjatësitë e tilla janë rrafshuar. Fjalët janë kthyer në homofone, duke ia lënë kontekstit diferencimin e kuptimit.

Bashkëtingëlloret gjithashtu dallohen nga pikëpamja e gjatësisë: të shkurtra ~ të gjata. Edhe kjo gjatësi mund të ketë vlerë fonetike ose fonologjike.

Në shqipen dallohen dy fonema bashkëtingëllore që i kundërvihen njëra-tjetrës në gjatësi me vlerë fonologjike (kuptimdalluese): /r/ ~ /rr/. Kjo më së miri mund të shihet në Jifte minimale fjalësh, si: *ara* ~ *arra*, *ruaj* ~ *rruaj*,

⁵⁶ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Vëllimi I, Morfologjia, Tiranë, 1995, f. 297.

⁵⁷ Zakonisht, përveç me gjatësi të zanoreve dhe me intonacion, këto dy mënyra të foljeve dallohen edhe me ritmin (tempon) e të folurit. Rëndom, në mënyrën dëftore ritmi i të folurit është më i ngadalshëm, ndërsa në mënyrën urdhërore ritmi është më i shpejtë.

var ~ varr etj. Karakteri fonologjik /r/ ~ /rr/ ruhet mirë në gegërishten, ndërsa në toskërishten është bërë rrafshimi i kësaj gjatësie, duke u shndërruar /rr/-ja në /r/.

Gjatësia e bashkëtingëlloreve mund të shërbejë edhe si tregues morfologjik. Në këtë rast gjatësia vjen nga takimi i dy bashkëtingëlloreve të njëjta në formim fjalësh a trajtash: *kënddrejtë, nënndarje, kundërrevolucionar, kundërreformë, mossulmim, zëvendëssekretar; në arittë, në mos e godittë; e gjettë e mira; në u mbyttë; në më prittë* etj.; në gegërishte *ditt* (ditët), *nett* (netët), *blett* (bletët) etj. Bashkëtingëlloret e tilla shqiptohen si geminate (dykulmore), me një dobësim të tensionit muskolor në mes, aty ku kalon kufiri morfologjik. Kuptohet, bashkëtingëlloret e tilla janë dyfonemore (bifonematike).

Në fund mund të thuhet se njësia prozodike e kohëzgjatjes së nyjetimit të tingujve në shqipen standarde është çështje komplekse, sepse varet nga faktorë gjuhësorë e jogjuhësorë. Rëndom, gjatësia (zanorja e gjatë) është shprehje e zhvillimit të tërësishëm dhe të papenguar të zanores, ndërsa shkurtësia (zanorja e shkurtër) është shprehje e pengueshmërisë në zhvillimin e zanores, e shkaktuar nga bashkëtingëllorja që vjen pas.⁵⁸ Pra, përgjithësisht në shqipen standarde kohëzgjatja e nyjetimit të zanoreve modifikohet nga konteksti.

Përveç ndryshueshmërisë së kohëzgjatjes së nyjetimit të zanoreve sipas kontekstit (karakterit të rrokjes: e hapur ose e mbyllur), numrit të tingujve në një fjalë (në fjalët e shkurtra zanoret janë më të gjata dhe anasjelltas), fqinjësia e tingujve (në fqinjësi të sonoreve zanoret janë më të gjata sesa në fqinjësi të mbylltoreve), vendit të theksit (të theksuarat janë më të gjata se të patheksuarat) etj.; gjatësia e zanoreve varet edhe nga faktorë të tjerë: nga ritmi (tempoja) i të folurit (gjatë të folurit e ngadalshëm zanoret janë më të gjata dhe anasjelltas), nga gjendja psikike dhe emocionale e folësit, nga qëllimi dhe dedikimi i të folurit (pse dhe kujt i flitet), nga situata konkrete e realizimit të të folurit, përkatësia territoriale e folësit, nga ve|oritë individuale, nga stili i të folurit etj.

Njohja e variacioneve të gjatësisë së zanoreve ka rëndësi për normën e shqiptimit letrar. Është shumë e rëndësishme njohja dhe përcaktimi i shkallës së ndikimeve të faktorëve të tillë, siç janë nga njëra anë shkalla e hapjes së zanoreve dhe nga ana tjetër karakteri i rrokjes, pozita në raport me theksin si dhe natyra e tingujve përreth.⁵⁹

⁵⁸ N. S. Trubeckoi, *Parime të fonologjisë*, Prishtinë, 1985, f. 131.

⁵⁹ Bahri Beci, *Sistemi fonologjik i gjuhës së sotme letrare dhe norma fonetike*, SF 1, Tiranë, 1985, f. 104.

KREU III

3. BASHKËTINGËLLORET E SHQIPES STANDARDE

Bashkëtingëlloret dallohen qartas nga zanoret në pikëpamje nyjëtimore, akustike dhe funksionale. Ndryshe nga zanoret, bashkëtingëlloret formohen nga pengimi i rrymës së ajrit në një pikë të kanalit të zërit, ato janë zhurma dhe në shqipen nuk kanë aftësi rrokjeformuese. Quhen bashkëtingëllore tingujt që nuk përkapen (perceptohen) mirë pa përfshirjen e një zanoreje parashkuese ose prapashkuese.

Shqipja standarde ka 29 bashkëtingëllore: /b/, /c/, /ç/, /d/, /dh/, /f/, /g/, /gj/, /h/, /j/, /k/, /l/, /ll/, /m/, /n/, /nj/, /p/, /q/, /r/, /rr/, /s/, /sh/, /t/, /th/, /v/, /x/, /xh/, /z/, /zh/. Në klasën e bashkëtingëlloreve përfshihen tinguj mjaft heterogjenë si nga ana nyjëtimore, ashtu edhe nga ana akustike.

3.1. KLASIFIKIMI I BASHKËTINGËLLOREVE

Klasifikimi fiziologjik i bashkëtingëlloreve rëndom bëhet duke marrë parasysh: vendin e formimit të pengesës, mënyrën e formimit (llojin e pengesës) dhe punën e tejzave të zërit. Bashkëtingëlloret klasifikohen në bazë të këtyre parimeve:

1. sipas **vendit të formimit**: a) sipas organit aktiv, dhe b) sipas organit pasiv;
2. sipas **mënyrës së formimit të pengesës** (apo sipas llojit të pengesës);
3. sipas **shkallës së zëshmërisë** (pjesëmarrjes së zërit apo të zhurmës), dhe
4. sipas **rezonancës hundore**.

1. Klasifikimi i bashkëtingëlloreve sipas vendit të formimit

Meqenëse bashkëtingëlloret formohen nga pengimi i zhurmës ose i tonit laringal në një pikë të kanalit të zërit, ato kanë vend të caktuar formimi. Vendet e formimit të bashkëtingëlloreve duhet kuptuar jo si pika, por si zona nyjëtimi. Në disa nga këto zona (dhëmbët, alveolat dhe qiellza), zgjedhja e pikave të ndryshme të nyjëtimit formon bashkëtingëllore cilësisht të ndryshme.

Për klasifikimin e bashkëtingëlloreve sipas vendit të formimit, mund të mbështetemi a) në organin aktiv që merr pjesë në nyjëtim dhe b) në organin pasiv ku formohet pengesa.

a) *Klasifikimi i bashkëtingëlloreve sipas organit aktiv*

Sipas organit aktiv, bashkëtingëlloret e shqipes ndahen në tri grupe të mëdha: *buzore*, *gjuhore* dhe *glotale*. Dy të parat kanë nëndarjet e tyre:

I. **Buzore** (labiale): 1) *dybuzore* (bilabiale): [p, b, m];
2) *buzore-dhëmbore* (labiodentale): [f, v].

II. **Gjuhore** (linguale):

1) *paragjuhore* (prelinguale): [t, d, n, s, z, sh, zh, th, dh, l, ll, c, x, ç, xh, r, rr]:

a) majore (apikale): [t, d, n, s, z, sh, zh, th, dh, c, x, ç, xh];
b) kulmore (kakuminale): [l, ll; r, rr].

2) *mesgjuhore* (mediolinguale): [q, gj; j, nj].

3) *prapagjuhore* (grykore, velare, postlinguale): [k, g].

III. **Glotalë** (faringale e poshtme, laringale): [h].

Bashkëtingëlloret buzore nyjëtohen me pjesëmarrjen aktive të buzëve. Këto bashkëtingëllore ndahen në dy grupe: a) *dybuzore*, kur të dy buzët formojnë mbyllje: [p, b, m]; b) *buzore-dhëmbore*, kur buza e poshtme afrohet te dhëmbët e sipërm: [f, v].

Duke marrë parasysh se cila pjesë e gjuhës merr pjesë në nyjëtim, bashkëtingëlloret gjuhore ndahen në: a) *paragjuhore*: [t, d, n, s, z, sh, zh, th, dh, l, ll, c, x, ç, xh, r, rr]; b) *mesgjuhore*: [q, gj; j, nj]; c) *prapagjuhore*: [k, g].

Sipas pozicionit të majës së gjuhës, bashkëtingëlloret paragjuhore të shqipes ndahen në: a) *majore* (apikale): [t, d, c, x, ç, xh, th, dh, s, z, sh, zh, n]; dhe b) *kulmore* (kakuminale): [l, ll; r, rr]. Majore ose apikale (lat. *apex* = majë) quhen bashkëtingëlloret që nyjëtohen duke ngritur majën e gjuhës së bashku me shpinën e saj dhe duke formuar pengesë tek alveolat, dhëmbët etj. Apikale janë shumica e paragjuhoreve të shqipes (13 bashkëtingëllore). Kulmore ose kakuminale (lat. *cacumen* = kulm) quhen ato bashkëtingëllore, që nyjëtohen duke ngritur majën e gjuhës përprjetë, në mënyrë paralele me alveolat ose qiellzën.

Bashkëtingëlloret mesgjuhore dhe prapagjuhore karakterizohen nga nyjëtimi shpinor, dorsal (lat. *dorsum* = shpinë). Te bashkëtingëlloret mesgjuhore pengesa formohet me pjesën e mesme të gjuhës, ndërsa te prapagjuhoret me pjesën e prapme të shpinës së gjuhës, ndërsa maja është e ulur te dhëmbët e poshtëm.

b) *Klasifikimi i bashkëtingëlloreve sipas organit pasiv*

Edhe sipas organit pasiv mund të përcaktohet vendi i formimit të bashkëtingëlloreve. Pengesa formohet në vende të ndryshme: 1. te zona e

alveolave dhe dhëmbët e sipërm; 2. te alveolat; 3. midis dhëmbëve të sipërm dhe të poshtëm; 4. në kufirin e alveolave dhe fillimin e qiellzës së fortë; 5. në mesin e qiellzës, dhe 6. në qiellzën e butë ose pas saj.

Për këtë arsye, në bazë të organit pasiv bashkëtingëlloret emërtohen dhe degëzohen në:

1. *alveolare-dhëmbore* (alveodentale): [t, d, ll].
2. *alveolare*: [c, x, s, z, n, l, r, rr].
3. *ndërdhëmbore* (interdentale): [th, dh].
4. *paraqiellzore* (alveolare-qiellzore, alveopalatale): [ç, xh, sh, zh].
5. *qiellzore* (palatale): [q, gj, j, nj] dhe
6. *prapaqiellzore* (postpalatale): [k, g, h].⁶⁰




Fig. 32. Vendet e nyjetimit të bashkëtingëlloreve në gjuhë të ndryshme: 1. dybuzoret, 2. buzore-dhëmboret (majedhëmboret), 3. ndërdhëmboret, 4. dhëmboret, 5. pasdhëmboret, 6. alveolaret, 7. kakuminalet, 8. qiellzo-alveolaret, 9. qiellzoret, 10. velaret, 11. uvularet, 12. faringalet, 13. glotalet (laringalet).

2. Klasifikimi i bashkëtingëlloreve sipas mënyrës së formimit

Siç dihet, bashkëtingëlloret, ndryshe nga zanoret, formohen nga pengimi i rrymës së ajrit diku në kanalën e zërit. Pengesa e formuar nga organet e të folurit mund të jetë e ndryshme: a) mbyllje e plotë, b) ngushtim i kanalit, duke krijuar një shteg, c) mbyllje që shndërrohet në shteg, ose c) mbyllje dhe hapje shumë të shkurtra, përkatësisht dridhje.

⁶⁰ Për [h]-në pengesa formohet në laring, në shtegthin e zërit, ndaj kjo quhet *glotale* ose *laringale*.

Rrjedhimisht, sipas mënyrës së formimit të pengesës ose llojit të pengesës, shpesh thuhet sipas mënyrës së kapërcimit të pengesës, bashkëtingëlloret ndahen në:

- a) **mbylltore** -11 (okluzive, shpërthyesë, pëlcitëse, të çastit): [p, b, m, t, d, n, q, gj, nj, k, g];
- b) **shtegore** -12 (fërkimore, frikative): [f, v, s, z, sh, zh, th, dh, l, ll, j, h];
- c) **afrikate** - 4 (të shkrira, mbylltore-shtegore, shpërthyesë-fërkimore, gjysëmbylltore): [ç, x, ç, xh], dhe
- ç) **dridhëse** - 2 (vibrante): [r, rr].

a) Për nyjëtimin e bashkëtingëlloreve **mbylltore** organi aktiv puqet me organin pasiv, duke mbyllur plotësisht rrugën e kalimit të ajrit. Nyjëtimi i mbylltoreve përbëhet nga tri faza: (1) *mbyllje* (implozion), (2) *qëndrim* (pozicion) dhe (3) *shpërthim* (eksplozion). Zhurma prodhohet nga lëshimi i vrullshëm i ajrit të grumbulluar pas pengesës me hapjen e menjëhershme të saj. Për arsye se rryma e ajrit del me shtytje të përnjëhershme, bashkëtingëlloret mbylltore quhen edhe *shpërthyesë* (eksplozive) ose *pëlcitëse a të çastit*. Të tilla janë 11 bashkëtingëllore: [p], [b], [t], [d], [q], [gj], [k], [g]; [m], [n] dhe [nj].

Një nënklasë e mbylltoreve janë hundoret, të cilat disa fonetikanë i marrin si klasë më vete. Për nyjëtimin e hundoreve, gjuha mbyll një pikë të zgavrës së gojës, kështu që ajrit i duhet ta shpërthejë pengesën. Ndërkaq, njerithi është i ulur poshtë, duke lejuar që rryma e ajrit të kalojë gjatë tri fazave nga zgavra e hundës. Në këtë mënyrë, zhurmës së shpërthimit të prodhuar në vendin e pengesës i shtohet edhe një timbër hundor. Hundore në gjuhën standarde shqipe janë bashkëtingëlloret [m], [n] dhe [nj]. Pikërisht, ngaqë në zgavrën e gojës nyjëtohen me mbyllje, hundoret përfshihen në mbylltoret.⁶¹

b) Për nyjëtimin e bashkëtingëlloreve **shtegore** ose *fërkimore*, quhen edhe *frikative* (lat. *fricare* = fërkoj) organi aktiv afrohet me pasivin, duke formuar kështu një shteg të ngushtë, nëpërmjet të të cilit del rryma e ajrit. Duke kaluar nëpër shteg, rryma e ajrit fërkohet në anët e tij, kështu që fitohet zhurma karakteristike e këtyre bashkëtingëlloreve. Duke u mbështetur në kalimin e ajrit me fërkim, shtegoret quhen edhe *spirante* (lat. *spirare* “marr frymë”, të frymëtuara). Meqë te shtegoret ajri i grumbulluar rrjedh nëpër zgavrën e gojës gjatë gjithë kohës së nyjëtimin të tingullit, si dhe për shkak se nyjëtimi i tyre mund të zgjatet, këto bashkëtingëllore quhen edhe *të zgjatshme*. Gjuha shqipe ka 12 bashkëtingëllore shtegore: [f], [v], [s], [z], [sh], [zh], [h], [th], [dh], [l], [ll] dhe [j].

Forma e shtegut te këto bashkëtingëllore mund të jetë:

a) e rrafshët, andaj bashkëtingëlloret e tilla quhen *shtegrrafshta*: [f], [v], [th], [dh], ose b) e lugejt, e rrumbullakët, andaj këto bashkëtingëllore quhen *shtegrrumbullakëta*: [s], [z].

⁶¹ Po aty, f. 76-77.

Te bashkëtingëlloret me shteg të lugët organi aktiv formon shteg jo në gjithë gjerësinë e tij, por vetëm në pjesën e mesit.

Sipas vendit të shtegut, bashkëtingëlloret shtegore janë:

a) *mesore* (10): [f], [v], [s], [z], [sh], [zh], [h], [th], [dh] e [j]; ose

b) *anësore* (laterale) (2): [l] dhe [ll].

Në shtegoret *anësore* rryma e ajrit detyrohet të dalë nga njëra ose nga të dy anët e gjuhës, sepse trupi i gjuhës ulet poshtë, anët e saj mbështeten te dhëmbët anësorë, kurse maja vendoset te alveolat ose dhëmbët e sipërm, duke krijuar një pengesë si te mbylltoret. Bashkëtingëllore anësore ose *laterale* (lat. *lateralis* “anësor”) në gjuhën shqipe janë [l]-ja dhe [ll]-ja. Bashkëtingëlloret e tjera shtegore janë *mesore*, sepse përgjatë zgavrës së gojës formohet një kanal i gjatë nëpër të cilin kalon rryma e ajrit.

c) **Bashkëtingëlloret afrikate** (lat. *affricare* “fërkoj lehtë”) kanë dy faza nyjetimi: ato kanë fillim mbylltor dhe përfundim shtegor. Në fazën e parë organi aktiv i afrohet pasivit dhe formon mbyllje të plotë. Në fazën e dytë, organet që formojnë mbyllje largohen ngadalë, duke kaluar nga mbyllja në shteg për të kaluar ajri nëpër të. Po të vlerësohet edhe pozicioni i mbylljes së shtegut si fazë e ndërmjetme e nyjetimit të afrikateve, atëherë kemi tri faza: mbylljen, pozicionin dhe shtegun (shih figurën e mëposhtme):




Fig. 33. Nyjetimi i përbërë i afrikateve: 1. mbyllja, 2. pozicioni, 3. shtegu.

Shqipja ka katër bashkëtingëllore afrikate: [ç], [x], [ç] dhe [xh]. Këto ndryshe quhen edhe *shpërthyes-fërkimore* ose të *shkrira*, sepse në pikëpamje nyjetimore afërsisht [ç = t + s]; [x = d + z]; [ç] = t + sh] dhe [xh = d + zh]. Afrikatet e shqipes janë tinguj kompleksë (së bashku me shtegoren /zh/) dhe për nga denduria zënë pesë vendet e fundit të sistemit.

Meqë ndërthejnë në vetvete dy apo tri mënyra nyjetimi, afrikatet janë tinguj të përbërë, ndryshe nga mbylltoret e tjera, që janë tinguj të thjeshtë. Pra, afrikatet përbëhen nga një element mbylltor i ndjekur nga një element shtegor me të njëjtin vend formimi, si në rastin e shqiptimit të shpejtë të grupit /tsh/ si /ç/ tek *i soçëm* (< i sotshëm), por kalimi nga njëri element te tjetri bëhet pa u ndier.

ç) **Në nyjetimin e bashkëtingëlloreve dridhëse** apo vibrante (lat. vibrare = dridhje) maja e gjuhës dridhet, d.m.th. afrohet dhe largohet tek organi pasiv nën shtytjen e rrymës së ajrit. Maja e gjuhës mund të dridhet një

ose më shumë herë. Numri i dridhjeve ka rëndësi për shqipen, sepse ai është një nga tiparet që dallon fonemën njëdridhëse /r/ nga shumëdridhësja /rr/.

3. Klasifikimi i bashkëtingëlloreve sipas shkallës së zëshmërisë (pjesëmarrjes së zërit apo të zhurmës)

Bashkëtingëlloret mund të klasifikohen edhe duke marrë si *kriter themelor* efektin akustik në vendin e pengesës dhe si *kriter ndihmës* pjesëmarrjen e tejzave. Sipas efektit akustik që krijohet në vendin e pengesës, bashkëtingëlloret ndahen në:

- a) 8 bashkëtingëllore **të tingullta** (sonante, sonore), dhe
- b) 21 bashkëtingëllore **të zhurmëta**.

Nga 29 fonema bashkëtingëllore që ka shqipja standarde, 8 janë *të tingullta*: [m], [n], [nj], [j], [l], [ll], [r] dhe [rr]; ndërsa 21 janë *të zhurmëta*: [b], [c], [ç], [d], [dh], [f], [g], [gj], [h], [k], [p], [q], [s], [sh], [t], [th], [v], [x], [xh], [z], [zh]. Bashkëtingëlloret e zhurmëta degëzohen në të zëshme dhe të shurdhëta.

Po të radhiten bashkëtingëlloret sipas shkallës së zëshmërisë, duke filluar nga më të zëshmet, kemi këtë renditje: a) bashkëtingëllore të tingullta, b) bashkëtingëllore të zëshme, dhe c) bashkëtingëllore të shurdhëta.

Më të zëshme nga të gjitha bashkëtingëlloret janë *sonoret* (sonantet, të tingulltat): [m], [n], [nj], [j], [l], [ll], [r], [rr]; të cilat për nga zëshmëria afrohen shumë me zanoret. Por duhet thënë se në bashkëlidhjen e fonemave bashkëtingëllore të shqipes sipas zëshmërisë nuk marrin pjesë bashkëtingëlloret sonore. Sonoret në gjuhën shqipe nuk kanë përgjegjëset (korrespondueset) e tyre të pazëshme.

Të tingulltat, si edhe bashkëtingëlloret e zhurmëta, përftohen nga pengimi i tonit laringal në një pikë të kanalit të zërit, d.m.th. veç tonit kanë edhe zhurmë. Por, forca e zhurmës i dallon sonoret nga të zhurmëtat e zëshme. Te të zëshmet zhurma është e fortë dhe e ngulfat zërin, kështu që këto bashkëtingëllore dëgjojnë si zhurma. Te të tingulltat pengesa është e dobët dhe, si rrjedhim, edhe zhurma është e dobët. Meqë toni laringal është përbërësi kryesor i tyre, kurse zhurma element shoqërues, sonoret përkapsen kryesisht si zëra, prandaj marrin edhe emrin të tingullta. Mbizotërimi i zërit i afron të tingulltat me zanoret, aq sa në disa gjuhë ato kanë aftësi të formojnë rrokje (në disa gjuhë, p.sh. në gjuhët sllave në fjalë ku nuk ka zanore, sonoret /r, l/ janë rrokjeformuese).

Bashkëtingëlloret e *tingullta* ndahen në:

- a) *hundore* (nazale) (3): [m], [n], [nj];
- b) *dridhëse* (vibrante) (2): [r], [rr], dhe
- c) *lëngëzore* (likuide) (2): [l], [ll].

Bashkëtingëlloret e zhurmëta, degëzohen në të zëshme dhe në të shurdhëta. Bashkëtingëlloret e shurdhëta janë zhurma të thjeshta, kurse të zëshmet janë tone të shoqëruara me zhurma. Pra, sipas dridhjeve glotale

dallohen dy grupe bashkëtingëlloresh. Pjesëmarrja ose mospjesëmarrja e tejzave të zërit në nyjetim përbën tiparin kryesor për ndarjen e bashkëtingëlloreve të zhurmëta në:

- a) **të zëshme**: [b], [d], [dh], [g], [gj], [v], [x], [xh], [z], [zh], dhe në
 b) **të shurdhëta** (të pazëshme): [p], [t], [th], [k], [q], [f], [c], [ç], [s], [sh], [h].

Në nyjetimin e bashkëtingëlloreve të zëshme tejzat e zërit tendosen dhe dridhen. Përkundrazi, te bashkëtingëlloret e shurdhëta tejzat e zërit nuk tendosen dhe nuk dridhen.

Bashkëlidhja sipas zëshmërisë përbëhet nga dhjetë çifte: bashkëtingëllore të zëshme [b], [d], [dh], [g], [gj], [v], [x], [xh], [z], [zh] ~ bashkëtingëllore të shurdhëta (të pazëshme): [p], [t], [th], [k], [q], [f], [c], [ç], [s], [sh], [h];⁶² të paraqitura si në tabelë:

të zëshme	b	d	dh	g	gj	v	x	xh	z	zh	
të shurdhëta	p	t	th	k	q	f	c	ç	s	sh	h

Tabela 6. Çiftet e bashkëtingëlloreve të zhurmëta për nga zëshmëria

Shënim: Vetëm bashkëtingëllorja e shurdhët [h] nuk ka përgjegjëse të zëshme. Bashkëtingëlloret e shurdhëta quhen edhe *të pazëshme*.

Bashkëtingëlloret e shurdhëta dhe të zëshmet dallohen midis tyre edhe nga shkalla e tendosjes së organeve të të folurit, që përbën një dallim plotësues ndërmjet tyre. Të shurdhëtat shqiptohen në mënyrë më energjike, me një tendosje më të madhe të aparatit të të folurit në krahasim me bashkëtingëlloret e zëshme. Rryma e ajrit në nyjetimin e bashkëtingëlloreve të pazëshme është më e fuqishme, prandaj ato karakterizohen nga një zhurmë më e madhe se të zëshmet.

Metodat e statistikës fonologjike japin të dhëna se në gjuhën shqipe bashkëtingëlloret e zëshme përdoren më shumë sesa të pazëshmet.

4. Klasifikimi i bashkëtingëlloreve sipas rezonancës hundore

Gjatë nyjetimit të shumicës së bashkëtingëlloreve i gjithë ajri del jashtë vetëm nga goja, ndërsa te një numër i vogël bashkëtingëlloresh një pjesë e ajrit del edhe nga zgavrat e hundës. Varësisht nga ky shqiptim johundor ose hundor, që përcaktohet nga pozicioni i ngritur ose i ulur i qiellzës së butë, bashkëtingëlloret ndahen në:

⁶² Dridhjen e tejzave mund ta hetojmë në disa mënyra: a) duke zënë veshët me duar gjatë nyjetimit të tingujve; b) duke vënë pëllëmbën te “ujët e kokës”; c) duke e kapur fikthin (arrëzën e fytit, mollëzën e fytit) nga njëra anë me gishtin e madh dhe nga ana tjetër me dy gishtat e tjerë. Nëse gjatë nyjetimit të një bashkëtingëlloreje do të ndiejmë dridhje të pjesës që prekim ose një gumëzhimë, atëherë bashkëtingëllorja është e zëshme; nëse nuk do të ndiejmë as dridhje, as gumëzhimë, atëherë bashkëtingëllorja është e shurdhët. Shih: Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 135.

- a) bashkëtingëllore **johundore**: 26 bashkëtingëllore, dhe
 b) bashkëtingëllore **hundore** (nazale) (3): [m], [n], [nj].

Kur qiellza e butë është e ulur, një pjesë e rrymës së ajrit kalon nëpër zgavrën e hundës, që i jep bashkëtingëllores rezonancë hundore. Kështu nyjëtohen bashkëtingëlloret [m], [n] dhe [nj]. Në nyjëtimin e këtyre bashkëtingëlloreve në zgavrën e gojës kemi mbyllje, por nyjëtimi i plotë i tyre lidhet me hapjen e pengesës së krijuar në gojë dhe me daljen e rrymës së ajrit si nga goja ashtu edhe nga vrimat e hundës.

Bashkëtingëlloret hundore janë të zëshme dhe nyjëtohen me tendosje të dobët të organeve të shqiptimit. Rryma e ajrit që del nga goja është e dobët. Te këto bashkëtingëllore mbizotëron zëri, kurse zhurma është e dobët. Për këto arsye hundoret janë bashkëtingëllore sonore.

Kur qiellza e butë është e ngritur, mbyllet kalimi i rrymës së ajrit për në zgavrën e hundës, kështu që ajri del vetëm nga goja. Kështu formohen 26 bashkëtingëlloret *johundore* të shqipes standarde: [b], [c], [ç], [d], [dh], [f], [g], [gj], [h], [j], [k], [l], [ll], [p], [q], [r], [rr], [s], [sh], [t], [th], [v], [x], [xh], [z] dhe [zh].

Po paraqesim përmbledhtas një pasqyrë të tipareve kryesore nyjëtimore dhe akustike të bashkëtingëlloreve të shqipes standarde:

- [p]: dybuzore, mbylltore (shpërthyese), e shurdhët;
 [b]: dybuzore, mbylltore (shpërthyese), e zëshme;
 [m]: dybuzore, mbylltore (shpërthyese), sonore, hundore;
 [f]: buzore-dhëmbore, shtegore, e shurdhët;
 [v]: buzore-dhëmbore, shtegore, e zëshme;
 [t]: paragjuhore (majegjuhore), alveolare-dhëmbore, mbylltore, e shurdhët;
 [d]: paragjuhore (majegjuhore), alveolare-dhëmbore, mbylltore, e zëshme;
 [n]: paragjuhore, kulmore (kakuminale), alveolare, mbylltore, sonore, hundore;
 [s]: paragjuhore (majore), alveolare, shtegore, fishkëlluese, e shurdhët;
 [z]: paragjuhore (majore), alveolare, shtegore, e zëshme;
 [sh]: paragjuhore, qiellzore-alveolare, dyvatërshe, shtegore, shushuritëse, e shurdhët, me buzorëzim të dobët;
 [zh]: paragjuhore, qiellzore-alveolare, dyvatërshe, shtegore, shushuritëse, e zëshme, me buzorëzim të dobët;
 [th]: paragjuhore, ndërthëmbore, shtegore (frikative), e shurdhët, jobuzore;
 [dh]: paragjuhore, ndërthëmbore, shtegore (frikative), e zëshme, jobuzore;
 [l]: paragjuhore, alveolare, kulmore, shtegore, anësore, lëngëzore, sonore;
 [ll]: paragjuhore, alveolare-dhëmbore, kulmore, shtegore, anësore, lëngëzore, sonore;
 [ç]: paragjuhore, alveolare, afrikate (shpërthyese-fërkimore), e shurdhët;
 [x]: paragjuhore, alveolare, afrikate (shpërthyese-fërkimore), e zëshme;
 [ç]: paragjuhore, alveolare, afrikate, e shurdhët;
 [xh]: paragjuhore, alveolare, afrikate, e zëshme;

- [r]: majegjuhore, alveolare, njëdrindhëse, sonore;
 [rr]: majegjuhore, alveolare, shumëdrindhëse, sonore;
 [q]: mesgjuhore, qiellzore (palatale), mbylltore, e shurdhët;
 [g]: mesgjuhore, qiellzore (palatale), mbylltore, e zëshme;
 [nj]: mesgjuhore, qiellzore (palatale), mbylltore, sonore, hundore;
 [j]: mesgjuhore, qiellzore (palatale), shtegore, sonore;
 [k]: prapagjuhore, shpinore, velare (postpalatale), mbylltore, e shurdhët;
 [g]: prapagjuhore, shpinore, velare, mbylltore, e zëshme;
 [h]: glotale, shtegore, e shurdhët (nuk ka korresponduese të zëshme).

3.2. PËRSHKRIMI I BASHKËTINGËLLOREVE

Siç dihet, varësisht nga realizimet konkrete të tyre, tingujt shfaqen me nuanca të ndryshme. Mirëpo, nga kjo shumësi laramanish tingullore është e nevojshme të përcaktohet njëri nga ta si variant përfaqësues apo variant bazë, siç thuhet më së shpeshti variant themelor i tingullit. **Variant themelor i tingullit** konsiderohet nyjetimi i tij i veçuar, i izoluar, ai i cili më së paku varet nga faktorët e jashtëm fonetikë. Prandaj, si gjatë klasifikimit dhe përshkrimit të zanoreve, ashtu edhe gjatë klasifikimit dhe përshkrimit të bashkëtingëlloreve mbështetemi në variantin themelor të tingujve. Meqë bashkëtingëlloret nuk mund të nyjëtohen pa zanore, atëherë për variant themelor të bashkëtingëllores konsiderohet shqiptimi i tij bashkë me zanoren [ë] të shqiptuar dobët, si b-ë, c-ë, ç-ë, d-ë etj.

3.2.1. BASHKËTINGËLLORET BUZORE

Quhen buzore tingujt që nyjëtohen me puthitjen e të dy buzëve ose me afrimin e buzës së poshtme me dhëmbët e sipërm. Sipas mënyrës së formimit, bashkëtingëlloret [p], [b] dhe [m] janë mbylltore; ndërsa [f] dhe [v] janë shtegore. Sipas vendit të formimit, ato degëzohen në:

- a) **dybuzore** (3): [p], [b], [m], dhe
- b) **buzore-dhëmbore** (2): [f], [v].

Dybuzoret mbylltore [p], [b]

Në nyjetimin e bashkëtingëllores [p] të dyja buzët mbyllen plotësisht. Hapja e pengesës bëhet me shpërthim. Gjuha zë pozicion të ngjashëm me atë të zanores [a]. Anët e gjuhës janë të ulura te dhëmbët e poshtëm. Qiellza e butë është e ngritur, kështu që rryma e ajrit del vetëm nga goja (prandaj këto janë bashkëtingëllore johundore). Tejzat e zërit nuk marrin pjesë në nyjetim.

Në artikulimin e bashkëtingëllores [b] buzët dhe qiellza e butë zënë po atë pozicion si te [p]-ja. Tejzat e zërit tendosen dhe dridhen, prandaj [b]-ja është bashkëtingëllore e zëshme. Ashtu si edhe bashkëtingëlloret e tjera të zëshme, [b]-ja shqiptohet me rrymë ajri më të dobët se [p]-ja. Edhe mbyllja është pak më e dobët, nuk është aq energjike sa te [p]-ja, sepse

bashkëtingëlloret e shurdhëta shqiptohen me tendosje më të madhe të aparatit të të folurit.

Nga këto tipare nyjetimore e akustike del se bashkëtingëlloret [p] e [b] janë **dybuzore, mbylltore, të zhurmëta**; [p]-ja është e **shurdhët**, ndërsa [b]-ja e **zëshme**.

Dybuzorja mbylltore e tingullt [m]

Në nyjetimin e kësaj bashkëtingëlloreje pozicioni i buzëve, i gjuhës dhe i tejzave të zërit është sikurse te [b]-ja. Por, qiellza e butë te [m]-ja është e ulur, kështu që një pjesë e rrymës së ajrit del nga zgavra e hundës, duke i dhënë tingullit timbër hundor. Bashkëtingëllorja [m] shqiptohet me rrymë ajri të dobët dhe me zhurmë të dobët. Ajo është e tingullt.

Nga kjo që u tha, del se bashkëtingëllorja [m] është **dybuzore, mbylltore, shpërthyes, sonore dhe hundore**.

Buzore-dhëmboret shtegore [f] dhe [v]

Për nyjetimin e këtyre bashkëtingëlloreve buza e poshtme u afrohet dhëmbëve të sipërm. Midis dhëmbëve dhe buzëve formohet një shteg i rrafshët, nga i cili del ajri, që drejtohet në sipërfaqen e brendshme të buzës së sipërme. Pra, shtegu formohet ndërmjet majës së dhëmbëve të sipërm dhe buzës së poshtme. Qiellza e butë është e ngritur, prandaj këto bashkëtingëllore nuk janë hundore. Në shqiptimin e [f]-së, tejzat e zërit nuk marrin pjesë, prandaj kjo është e shurdhët; ndërsa [v]-ja nyjtohet me pjesëmarrjen e tejzave të zërit, ndaj kjo është e zëshme. Bashkëtingëlloret [f], [v] në gjuhën shqipe nyjtohen me tendosje relativisht të dobët të organeve të të folurit.

Nga kjo mund të përfundojmë se [f]-ja dhe [v]-ja janë **buzore-dhëmbore, shtegore, të zhurmëta, johundore**; [f]-ja është e **shurdhët**, ndërsa [v]-ja e **zëshme**.

3.2.2. BASHKËTINGËLLORET PARAGJUHORE

Bashkëtingëllore paragjuhore janë ato që nyjtohen me pjesën e përparme të gjuhës. Rikujtojmë se paragjuhore në gjuhën standarde shqipe janë 17 bashkëtingëllore: [t, d, l, ll, c, x, s, z, n, r, rr, ç, xh, sh, zh, th, dh]. Këto ndahen në dy nëngrupe:

a) 13 majore (apikale): [t, d, c, x, s, z, n, ç, xh, sh, zh, th, dh], dhe

b) 4 kulmore (kakuminale): [l, ll; r, rr].

Për nga mënyra e formimit, bashkëtingëlloret paragjuhore janë mjaft heterogjene, sepse ato nyjtohen me katër lloje pengesash: mbyllje, shteg, mbyllje-shteg dhe dridhje. Kështu, 3 janë mbylltore: [t, d, n], 8 shtegore: [s, z, sh, zh, l, ll, th, dh], 4 afrkate: [c, x, ç, xh] dhe 2 dridhëse: [r, rr]. Sipas organit pasiv, këto bashkëtingëllore janë: 3 alveolare-dhëmbore [t, d, ll], 10 alveolare [n, s, z, l, c, x, ç, xh, r, rr], 2 qiellzore-alveolare [sh, zh] dhe 2 ndër-dhëmbore [th, dh].

Paragjuhoret mbylltore [t], [d]

Kur nyjëtojmë këto bashkëtingëllore, maja e gjuhës ngrihet dhe i prek alveolat ose edhe rrënjët e dhëmbëve të sipërm. Meqë pengesa formohet në zonën e trysave dhe të dhëmbëve të sipërm, tingujt [t] dhe [d] zakonisht përcaktohen si alveolaro-dhëmborë. Mbyllja që formon gjuha hapet me shpërthim.

Për artikulimin e [t]-së tejzat e zërit nuk dridhen, ndaj kjo bashkëtingëllore është e shurdhët. Te [d]-ja tejzat e zërit dridhen, rrjedhimisht ajo është e zëshme. Si bashkëtingëllore e shurdhët, [t]-ja nyjëtohet me tendosje më të madhe të organeve të të folurit dhe me rrymë ajri më të fuqishme se [d]-ja. Qiellza e butë është e ngritur, kështu që ajri kalon vetëm nga goja.

Po të përmbliidhet ajo që u tha, mund të thuhet se tingujt [t] dhe [d] janë: **paragjuhore** (majegjuhore), **alveolaro-dhëmborë**, **mbylltorë**, **johundurë**, **të zhurmët**; [t]-ja **e shurdhët**, ndërsa [d]-ja **e zëshme**.

Paragjuhorja mbylltore e tingullt [n]

Varianti themelor i bashkëtingëllores [n] nyjëtohet duke mbështetur majën e gjuhës në trysa. Gjuha nuk i prek dhëmbët, andaj [n]-ja është më e prapme se [t]-ja dhe [d]-ja. Qiellza e butë është e ulur, kështu që një pjesë e rrymës së ajrit kalon nga zgavra e hundës, duke i dhënë tingullit timbër hundor. Tejzat e zërit dridhen. [N]-ja e gjuhës shqipe nyjëtohet me tendosje të dobët të organeve të të folurit. Edhe mbyllja që formon gjuha me hojëzat është e dobët.

[N]-ja është bashkëtingëllore e tingullt majore, ndërsa nga vendi i formimit është alveolare. Mbyllja rëndom bëhet në kulmin e trysave dhe në këtë rast ky tingull është kulmor, duke u afruar kështu nga vendi i formimit me bashkëtingëlloren [r]. Por mbyllja mund të bëhet edhe në pjerrësinë e brendshme të trysave, kështu që realizohen edhe variante më të prapme të këtij tingulli sesa varianti themelor i tij. Nuk mungojnë edhe variantet më të përparme të [n]-së, kur maja e gjuhës formon mbyllje tek alveolat, duke i prekur njëkohësisht edhe dhëmbët.

Pavarësisht nga vendi i formimit të mbylljes së plotë (por gjithnjë maja e gjuhës prek alveolat) dhe variantet e ndryshme të [n]-së, mund të thuhet se [n]-ja është **paragjuhore** (më saktësisht majegjuhore), **kakuminale** (kulmore), **alveolare**, **mbylltore**, **sonore** dhe **hundore**.

Paragjuhoret shtegore njëvatërshe [s] dhe [z]

Për nyjëtimin e këtyre bashkëtingëlloreve pjesa e përparme e shpinës së gjuhës afrohet në zonën e alveolave, por nuk i prek ato. Maja e gjuhës është e mbledhur dhe e tendosur. Anët e gjuhës mbështeten në dhëmbët anësorë dhe në një pjesë të qiellzës, duke formuar shteg në formë lugu, përkatësisht *shteg* të rrumbullaktë. Rrjedhimisht bashkëtingëlloret [s], [z] quhen *shtegrrumbullakëta*. Rryma e ajrit, që kalon nëpër këtë shteg të ngushtë, krijon zhurmë që i ngjan fishkëllimës. Për këtë arsye këto dy bashkëtingëllore quhen edhe tinguj *fishkëllues* ose *sibilantë*.

Bashkëtingëlloret [s] dhe [z] kanë vetëm një vatër formimi të zhurmës: në pjesën e përparme të zgavrës së gojës, në zonën e alveolave. Në nyjëtimin e këtyre bashkëtingëlloreve qiellza e butë është e ngritur (janë tinguj johundorë), ndërsa buzët nuk marrin pjesë (tinguj jobuzorë). Gjatë nyjëtimimit të [z]-së tejzat e zërit dridhen, prandaj kjo është e zëshme; ndërsa [s]-ja është bashkëtingëllore e shurdhët, meqë tejzat e zërit nuk dridhen. Si të gjitha bashkëtingëlloret e shurdhëta, edhe [s]-ja karakterizohet me rrymë të fuqishme ajri dhe me zhurmë të madhe, krahasuar me bashkëtingëlloren e zëshme që i përgjigjet asaj, respektivisht [z]-në.⁶³

Po të përmbliidhen veçoritë nyjëtimore e akustike të këtyre dy tingujve, del se bashkëtingëlloret [s] dhe [z] janë tinguj **paragjuhorë** (majorë), **alveolarë**, **shtegorë** (shtegrumbullakët), **njëvatërshe**, **fishkëllues**, **të zhurmët**, **johundorë**; [s]-ja është e **shurdhët**, ndërsa [z]-ja e **zëshme**.

Paragjuhoret shtegore dyvatërshe [sh] dhe [zh]

Në nyjëtimin e këtyre bashkëtingëlloreve maja dhe pjesa e përparme e gjuhës afrohet në zonën e alveolave. Anët e gjuhës janë të ngritura dhe mbështeten në hojëza e në qiellzën përballë dhëmbëve anësorë, ndërsa në gjatësinë e mesit të gjuhës formohet një shteg i lugët, nga kalon rryma e ajrit. Duhet vënë në dukje se te [sh, zh]-ja shtegu është më i rrafshët se te [s, z]-ja. Pjesa e mesme e shpinës së gjuhës ngrihet gjithashtu drejt qiellzës së fortë, prandaj në nyjëtimin e këtyre bashkëtingëlloreve formohen *dy vatra zhurme*. Vatra e parë, që është kryesorja dhe që përcakton vendin e formimit të këtyre dy bashkëtingëlloreve, formohet me majën dhe pjesën e përparme të gjuhës; ndërsa vatra e dytë formohet me pjesën e mesme të shpinës së gjuhës. Megjithëse ngushtimi i kanalit të ajrit është më i madh në vatrën e parë, ngritja plotësuese e pjesës së mesme të shpinës së gjuhës krijon tingëllimin karakteristik të këtyre bashkëtingëlloreve, prandaj quhen edhe *shushuritëse*, sepse zhurma e tyre i ngjan shushurimës. Duke marrë parasysh rolin që luajnë në nyjëtim të dy vatrave të formimit të zhurmës, për nga vendi i formimit këto bashkëtingëllore mund të përcaktohen si *palatalo-alveolare*.

Gjatë nyjëtimimit të këtyre bashkëtingëlloreve buzët zgjaten pak përpara; pra, këta tinguj karakterizohen nga buzorëzimi i dobët. Qiellza e butë është e ngritur, prandaj rryma e ajrit del vetëm nga goja. Bashkëtingëlloret [sh] është e shurdhët, ndërsa [zh]-ja është e zëshme. Nyjëtohen me ndemje të dobët të gjuhës dhe me rrymëtim relativisht më të fuqishëm se shtegoret e tjera.⁶⁴

Mund të përfundohet se bashkëtingëlloret [sh] e [zh] janë: **paragjuhore**, **qiellzore-alveolare**, **shtegore**, **dyvatërshe**, **të zhurmëta**, **shushuritëse**, me buzorëzim të dobët; [sh]-ja e **shurdhët**, ndërsa [zh]-ja e **zëshme**.

Ndërdhëmboret [th, dh]

Në nyjëtimin e këtyre bashkëtingëlloreve maja e gjuhës futet midis dhëmbëve të përparmë (të poshtëm dhe të sipërm), duke dalë pak jashtë tyre.

⁶³ Anastas Dodi – Jorgji Gjinari, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 64.

⁶⁴ Po aty, f. 65-66.

Midis majës së gjuhës dhe dhëmbëve të sipërm formohet shtegu i rrafshët, nga del rryma e ajrit. Trupi i gjuhës shtyhet pak përpara, ndërsa anët e saj ngrihen fare pak në alveolat e dhëmbëve anësorë. Qiellza e butë është e ngritur, buzët janë asnjëherë. Në nyjetimin e [dh]-së marrin pjesë edhe tehzat e zërit, të cilat dridhen, prandaj kjo është bashkëtingëllore e zëshme; kurse [th]-ja është e shurdhët. [Th]-ja shqiptohet me tendosje më të madhe të organeve të folurit dhe me zhurmë më të madhe se [dh]-ja, gjegjësjë e saj e zëshme.

Bashkëtingëlloret [th, dh] janë ndër dhëmbore majegjuhore. Por duhet thënë se përdorimi i termit *ndërdhëmbore* (interdentale) është konvencional, sepse megjithëqë maja e gjuhës futet midis dhëmbëve të përparmë, shtegu formohet midis majës së gjuhës dhe dhëmbëve të sipërm. Dhëmbët e poshtëm nuk luajnë rol në nyjetim. Prandaj këta tinguj quhen edhe *dhëmborë*.⁶⁵ Përveç variantit themelor, ekzistojnë edhe variante të tjera të këtyre tingujve, që nyjtohen duke afruar majën e gjuhës në anën e brendshme të dhëmbëve të përparmë. Karakteristikë e shqiptimit të tingujve [th, dh] është shtegu i rrafshët e i gjerë si dhe mungesa e tendosjes së majës së gjuhës.

Përmbledhtas mund të thuhet se bashkëtingëlloret [th, dh] janë **paragjuhore, shtegore** (shtegrrafshta), **të zhurmëta, ndërdhëmbore**, johundore, jobuzore; [th]-ja është **e shurdhët**, ndërsa [dh]-ja **e zëshme**.

Sonantja anësore alveolare [l]

Për nyjetimin e kësaj bashkëtingëlloreje maja e gjuhës mbështetet në zonën e trysave, zakonisht në pjesën më të ngritur të tyre. Trupi i gjuhës është i ngritur në drejtim të qiellzës së fortë, por prapa takimit me trysat ai vjen duke u ulur, duke filluar që nga pjesa e përparme e shpinës së gjuhës. Në pjesën e përparme të shpinës së gjuhës zakonisht vihet re një thellim. Anët e pjesës së përparme të gjuhës ngrihen dhe mbështeten në alveolat e dhëmbëve anësorë. Anët e pjesës së mesme dhe të prapme të gjuhës janë të ulura, kështu që rryma e ajrit këtu shtegun e kalimit e ka të lirë. Meqë rryma e ajrit kalon nga anët e gjuhës, kjo quhet bashkëtingëllore *anësore* (ose laterale). Rryma e ajrit mund të dalë nga të dy anët e gjuhës ose vetëm nga njëra anë (kjo është shprehje individuale që nuk ndikon në cilësinë e tingullit).

[L]-ja dhe [ll]-ja dallohen nga të gjitha shtegoret e tjera, ngase te këto bashkëtingëllore rruga e kalimit të ajrit në mesin e gjuhës është e mbyllur, por kalimet anësore janë të depërtueshme; ndërsa te shtegoret e tjera është e kundërta: shtegu i kalimit të ajrit në mesin e gjuhës është i hapur, por kalimet anësore janë të mbyllura.

Qiellza e butë në nyjetimin e këtij tingulli është e ngritur, tehzat e zërit dridhen. [L]-ja shqiptohet me rrymë të dobët ajri, që jep zhurmë të dobët. Bashkëtingëllorja [l] e shqipes nuk karakterizohet as nga palatalizimi, as nga velarizimi.⁶⁶

⁶⁵ Sipas këtij tipari nyjetimor, [th]-ja e [dh]-ja mund të quhen tinguj majegjuhore-dhëmborë.

⁶⁶ Po aty, f. 67-68.

Nga kjo del se bashkëtingëllorja [l] e shqipes është **paragjuhore, alveolare, kulmore** (kakuminale), **anësore** (laterale), **shtegore, lëngëzore** (likuide) dhe **sonore**.

Anësorja e tingullt alveodhëmbore [ll]

Gjuha shqipe ka dy bashkëtingëllore anësore: [l] dhe [ll]. Në nyjëtimin e bashkëtingëllores [ll] maja e gjuhës mbështetet në kufirin midis trysave dhe dhëmbëve të përparmë. Trupi i gjuhës është i ulur dhe zë pozicion horizontal ndaj qiellzës, duke zmadhuar kështu rezonatorin e gojës. Pjesa e mesme e shpinës së gjuhës është e ulur, ndërsa pjesa e prapme e saj është disi e ngritur. Kjo ngritje në drejtim të qiellzës së butë krijon velarizimin, si nyjëtim plotësues të tingullit. Rrënja e gjuhës është e tërhequr pak prapa në hapësirën e faringut, duke ngushtuar kështu hapësirën e tij.

Anët e gjuhës (të dyja ose njëra nga to) janë të ulura, duke lejuar kalimin e rrymës së ajrit. Tejzat e zërit dridhen. Ashtu si edhe [l]-ja, sonorja [ll] shqiptohet me rrymë ajri të dobët dhe me zhurmë të dobët.

[ll]-ja nyjëtohet me tendosje më të madhe të gjuhës sesa [l]-ja. Njëfarë ndemjeje vihet re edhe në qiellzën e butë. Sonorja [ll] është bashkëtingëllore majore; nga vendi i formimit është alveodhëmbore. Ekziston edhe një variant më i përparmë i nyjëtimin të [ll]-së, ku kjo paraqitet si dhëmbore. Ky variant nuk përputhet me normën e shqiptimit të shqipes standarde.⁶⁷

Rrjedhimisht mund të thuhet se bashkëtingëllorja [ll] është **paragjuhore, alveodhëmbore, kulmore** (kakuminale), **shtegore, anësore** (laterale), **fërkimore, lëngëzore** (likuide) dhe **sonore**.

Nga çifti i bashkëtingëlloreve /l/ dhe /ll/ kjo e fundit ka nyjëtim kompleks, sepse në krahasim me /l/-në ka plus velarizim. Prandaj /l/-ja përdoret afër 4 herë (3,7 herë) më shumë se /ll/-ja.

Afrikatet alveolare [c, x]

Në nyjëtimin e këtyre bashkëtingëlloreve maja e gjuhës, e cila është e mbledhur dhe e zgjeruar; së bashku me pjesën më të përparme të saj, mbështeten në zonën e alveolave deri aty ku fillojnë dhëmbët e përparmë, zakonisht duke mos i prekur këta të fundit. Nga pikëpamja e vendit të formimit, këto bashkëtingëllore janë më të prapme se tingujt [ç, xh]. Shkurtimisht mund të thuhet se pjesa e përparme e gjuhës mbështetet tek alveolat për një kohë të shkurtër dhe më pas largohet, duke formuar shteg. Te bashkëtingëlloret afrikate (të shkrija) mbyllja nuk hapet me shpërthim, por kalon në shteg.

Bashkëtingëlloret [c] dhe [x] nyjëtohen në dy faza: ato kanë fillim mbylltor dhe mbarim shtegor. Në fazën e parë të nyjëtimin të [c]-së, gjuha zë një pozicion të afërt me nyjëtimin e [t]-së; pastaj, në fazën e dytë, mbyllja kalon në shteg të ngjashëm me shtegun e shqiptimit të [s]-së. Në shqiptimin e [x]-së faza e parë është e ngjashme me [d]-në, ndërsa faza e dytë me shtegoren [z]. Kushtimisht, dy fazat e nyjëtimin të mbylltore-shtegoreve [c, x] mund t'i

⁶⁷ Anastas Dodi – Jorgji Gjinari, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 69.

paraqesim kështu: [c] = [t] + [s]; [x] = [d] + [z]. Por, këto janë dy faza të një nyjëtimit të vetëm, prandaj [c]-ja dhe [x]-ja nuk paraqiten si bashkim mekanik i shqiptimit të [t] + [s]-së dhe [d] + [z]-së, por janë tinguj me një nyjëtim të vetëm kompleks a të shkrirë, me fillim mbylltor dhe me mbarim shtegor.

Kur shqiptohen afrikatat [c] dhe [x] qiellza e butë është e ngritur, prandaj ajri kalon vetëm nga goja, buzët nuk marrin pjesë. Varësisht nga mospjesëmarrja apo pjesëmarrja e tejzave të zërit në nyjëtim, përcaktohet zëshmeria e këtyre dy çifteve: [c]-ja është e shurdhët, ndërsa [x]-ja e zëshme.⁶⁸

Mund të nxjerrim si përfundim se bashkëtingëlloret [c, x] janë **paragjuhore, alveolare, afrikate** (të shkrira, mbylltore-shtegore), **të zhurmëta**; [c]-ja e **shurdhët**, ndërsa [x]-ja e **zëshme**.

Paragjuhoret afrikate [ç, xh]

Bashkëtingëlloret [ç, xh], si edhe [c]-ja dhe [x]-ja, nyjëtohen në dy faza. Në fazën e parë maja dhe pjesa e përparme e gjuhës mbështeten në alveolat dhe në fillimin e qiellzës së fortë, ndërsa pjesa e mesme e shpinës së gjuhës ngrihet drejt qiellzës së fortë. Në fazën e dytë pjesa e përparme e gjuhës largohet ngadalë nga alveolat dhe qiellza e fortë, përkatësisht ulet dhe formon shteg për të kaluar rryma e ajrit. Gjatë nyjëtimit të këtyre bashkëtingëlloreve, ashtu si edhe të dy afrikateve të tjera [c, x], mbyllja nuk hapet me shpërthim, por shndërrohet në shteg. Pra, dallohen dy faza: mbyllja dhe shtegu, d.m.th. kanë fillim mbylltor dhe mbarim shtegor. Faza e parë i përgjigjet mbylljes së përafërt me artikulimin e [t, d]-së, ndërsa faza e dytë i përgjigjet shtegut si te tingujt [sh, zh].

Në mënyrë të thjeshtuar artikulimin e këtyre bashkëtingëlloreve mund ta paraqesim si vijon: [ç] = [t] + [sh], ndërsa [xh] = [d] + [zh]. Megjithkëtë, edhe këto bashkëtingëllore afrikate në gjuhën shqipe nuk paraqiten si bashkim i dy tingujve, por si tingull njëfonemësh me nyjëtim të vetëm të përbërë.

Në grupin [tsh], përkundrazi, kemi dy nyjëtime të dallueshme, që ndjekin njëri-tjetrin. Bie fjala, duke krahasuar fjalët në përbërjen e të cilave ka [ç] me ato të cilat kanë grupin bashkëtingëllor [tsh], të tipit *çel, çaj...* dhe *i përbotshëm, i përshtatshëm...* del qartë se afrikatja [ç] dallohet në shqiptim nga grupi [tsh], si nga kohëzgjatja e nyjëtimit, lidhjet e dallueshme të fazave të nyjëtimit, ashtu edhe nga shkalla e ndryshme e përqendrimit të energjisë. Kështu, gjatësia e fazës shtegore të afrikateve është më e vogël se te bashkëtingëlloret shtegore. Është tjetër gjë fakti që në pak fjalë grupi [tsh] gjatë përdorimit në rrjedhë të kohës është shkrirë në afrikate të vetme [ç], në fjalë të tilla si *i moçëm* (< i motshëm), *(shtatë) vjeç* (< vjetsh), *paça* (< patsha) etj.

Nga kjo që u tha, del se bashkëtingëlloret [ç, xh] janë **paragjuhore, alveolare, afrikate, të zhurmëta**; [ç]-ja e **shurdhët**, ndërsa [xh]-ja e **zëshme**.


⁶⁸ Anastas Dodi – Jorgji Gjinari, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 70.

Sonoret dridhëse [r, rr]

Gjuha standarde shqipe ka dy fonema bashkëtingëllore dridhëse: /r/ dhe /rr/. Në nyjetimin e bashkëtingëllores [r] maja e gjuhës, që është e tendosur dhe e kthyer pak përprjetë, afrohet shumë në kulmin e hojzave. Në pjesën e përparme të shpinës së gjuhës vihet re një e thelluar e vogël. Rryma e ajrit bën që të dridhet maja e gjuhës, e cila nganjëherë i prek lehtë trysat. Maja e gjuhës rëndom dridhet 1-2 herë, prandaj kjo mund të quhet njëdridhëse. Qiellza e butë është e ngritur, tejsat e zërit dridhen. Kjo bashkëtingëllore karakterizohet nga tendosja e dobët e organeve të të folurit dhe nga rryma e dobët e ajrit, që shkakton zhurmë të dobët; por megjithatë, më të madhe se te sonoret e tjera jodridhëse.

Gjatë nyjetimit të [rr]-së një masë më e madhe e majës së gjuhës (krahasuar me nyjetimin e [r]-së) afrohet në pjerrësinë e brendshme të alveolave dhe fillimin e qiellzës së fortë. Pra, [rr]-ja është më e prapme se [r]-ja, ndonëse vendi i formimit të pengesës nuk luan ndonjë rol të rëndësishëm në dallimin e [r]-së dhe të [rr]-së. Te [rr]-ja maja e gjuhës dridhet 3-4 herë, kështu që kjo mund të quhet shumëdridhëse. [Rr]-ja karakterizohet nga tendosja e përgjithshme e organeve të të folurit. Tejsat e zërit dridhen.⁶⁹

Rrjedhimisht, bashkëtingëlloret [r] dhe [rr] janë **majegjuhore** (e para nyjëtohet me majën e gjuhës, ndërsa e dyta me një masë më të madhe të pjesës së përparme të gjuhës, por këto dallime fonologjikisht nuk janë të rëndësishme); **alveolare, sonore, dridhëse**: [r]-ja është **njëdridhëse**, ndërsa [rr]-ja **shumëdridhëse**.



Tingulli [r]

Tingulli [rr]

Fig. 34. Pamje në profil e pozitës së organeve të të folurit gjatë nyjetimit të bashkëtingëlloreve dridhëse

3.2.3. BASHKËTINGËLLORET MESGJUHORE

Janë mesgjuhore bashkëtingëlloret që nyjëtohen me pjesën e mesme të sipërfaqes së gjuhës. Të tilla në shqipen janë 4 bashkëtingëllore: [q, gj; j, nj].

⁶⁹ Anastas Dodi – Jorgji Gjinari, *Fonetika*, Tiranë, 1983, f. 72-74, 87-88.

Mesgjuhoret mbylltore [q, gj]

Në nyjetimin e bashkëtingëlloreve [q] dhe [gj] pjesa e mesme e sipërfaqes së gjuhës mbështetet në zonën e përparme të qiellzës së fortë, deri në pjesën e ngritur të alveolave; duke formuar mbyllje të plotë. Gjuha shtyhet përpara, ndërsa maja e gjuhës është e ulur dhe prek dhëmbët e poshtëm. Pjesa e mesme e gjuhës nuk është shumë e tendosur, kështu që edhe mbyllja është deri diku e çlirtë, duke u afruar nga kjo pikëpamje me afrikatet.

Bashkëtingëlloret [q] dhe [gj] të shqipes, megjithëse janë tinguj mbylltorë, karakterizohen nga një shpërthim i dobët dhe nga një afrikim i lehtë, i cili deri diku shtohet në të folurit e shpejtë dhe në nyjetimin energjik. Por, mbylltoret [q] dhe [gj] dallohen qartë nga afrikatet [ç], [xh] jo vetëm për nyjetimin mesgjuhëor shpinor, por edhe për hapjen e pengesës me shpërthim.

Për nyjetimin e [q]-së tejzat e zërit nuk marrin pjesë, kurse te [gj]-ja ato dridhen.⁷⁰ Rrjedhimisht, bashkëtingëlloret [q] dhe [gj] janë tinguj **mesgjuhëorë, mbylltorë, qiellzorë** (palatalë), **të zhurmët**; [q]-ja është **e shurdhët**, ndërsa [gj]-ja **e zëshme**.




Fig. 35. Pozita e organeve të të folurit gjatë nyjetimit të mesgjuhoreve [q] dhe [gj]

Mesgjuhëorja e tingullit hundorë [nj]

Për nyjetimin e kësaj bashkëtingëlloreje pjesa e mesme e sipërfaqes së gjuhës mbështetet në qiellzën e fortë, ndërsa maja e gjuhës është e ulur te dhëmbët e poshtëm. Anët e gjuhës ngrihen dhe mbështeten në qiellzë, përballë dhëmbëve anësorë në sipërfaqe më të gjerë se te tingujt [q] e [gj]. Trupi i gjuhës shtyhet përpara, duke zgjeruar hapësirën rezonuese të faringut, sidomos në pjesën e tij të sipërme. Qiellza e butë është e ulur, që lejon kalimin e një sasive të ajrit në zgavrën e hundës dhe kështu tingulli fiton rezonancë hundore. Tejtat e zërit dridhen, buzët nuk marrin pjesë në nyjetim.

Te [nj]-ja mbyllja formohet me sipërfaqe më të gjerë të mesit të gjuhës sesa te bashkëtingëlloret [q, gj]. Me fjalë të tjera, këtu aktivizohet gjithë pjesa e

⁷⁰ Anastas Dodi – Jorgji Gjinari, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 71-72; 74, 75.

mesme e shpinës së gjuhës, e cila mbështetet në qiellzën e fortë (jo vetëm në pjesën e përparme të saj, si te [q]-ja e [gj]-ja), duke filluar nga alveolat.

Në nyjetimin e [nj]-së gjuha mbështetet më fort në qiellzë, prandaj mbyllja nuk është aq e çlirtë sa te [q]-ja e [gj]-ja. Si te të gjitha sonoret e tjera, edhe te bashkëtingëllorja [nj], tendosja e përgjithshme e organeve të shqiptimit nuk është aq e madhe.⁷¹

Rrjedhimisht, bashkëtingëllorja [nj] është **mesgjuhore**, **mbylltore**, **qiellzore** (palatale), **hundore** dhe **sonore**.

Mesgjuhorja e tingullt shtegore [j]

Në nyjetimin e bashkëtingëllores [j] pjesa e mesme e sipërfaqes së gjuhës ngrihet drejt qiellzës së fortë, duke formuar një shteg jo shumë të ngushtë. Dihet se bashkëtingëllorja [j] nga pikëpamja e nyjetimit është e afërt me zanoren [i]. Por te [j]-ja sipërfaqja e shtegut ku fërkohet ajri është më e madhe se te [i]-ja. Trupi i gjuhës shtyhet përpara, pjesa e përparme e shpinës së gjuhës është e ulur, ndërsa maja e gjuhës mbështetet te dhëmbët e poshtëm. Në nyjetimin e [j]-së pjesa e mesme e sipërfaqes së gjuhës dhe qiellza e fortë janë të tendosura. Anët e gjuhës janë të ngritura dhe mbështeten në të dy anët e qiellzës së fortë, duke filluar prej alveolave. Tejzat e zërit dridhen. Buzët nuk marrin pjesë në nyjetim. Rryma e ajrit kalon përmes shtegut të rrafshët, që formon gjuha me qiellzën e fortë; prandaj [j]-ja quhet bashkëtingëllore mesore. Sonorja [j] shqiptohet me një rrymë ajri mjaft të dobët, prandaj edhe zhurma e saj është fare e dobët.⁷²

Bashkëtingëllorja [j] është **mesgjuhore** (qiellzore, palatale), **shtegore** (fërkimore), **tingëlluese** (sonante).

3.2.4. BASHKËTINGËLLORET PRAPAGJUHORE

Janë prapagjuhore bashkëtingëlloret [k, g] që nyjtohen me pjesën e prapme të shpinës së gjuhës.

Prapagjuhoret mbylltore [k, g]

Në nyjetimin e këtyre bashkëtingëlloreve pjesa e prapme e shpinës së gjuhës ngrihet dhe mbështetet në qiellzën e butë, ndonëse jo në zonë të thellë të saj, por shkon afër kufirit të qiellzës së fortë. Pjesët e mesme dhe të përparme të gjuhës janë të ulura.

Gjithë gjuha është e tërhequr prapa, maja e saj është e ulur dhe rëndom largohet nga dhëmbët e përparmë të poshtëm. Në këtë mënyrë ngushtohet hapësira e faringut. Anët e gjuhës prekin pak pjesën e prapme të qiellzës së

⁷¹ Anastas Dodi – Jorgji Gjinari, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 76.

⁷² Po aty, f. 77.

fortë. Buzët janë asnjëherë, qiellza e butë është e ngritur, duke mbyllur kështu rrugën e ajrit për në zgavrën e hundës.

Në nyjëtimin e [k]-së tejzat e zërit nuk dridhen, ndërsa te [g]-ja ato dridhen. Prandaj, [k]-ja është e shurdhët, ndërsa [g]-ja e zëshme.

Te bashkëtingëlloret prapagjuhore mbyllja hapet me shpërthim jo aq të mprehtë e të qartë si te paragjuhoret. Bashkëtingëlloret [k, g] janë shpinore, ndërsa nga vendi i formimit janë velare ose postpalatale.⁷³

Rrjedhimisht, këto bashkëtingëllore janë **prapagjuhore, shpinore, mbylltore, velare** (postpalatale), **të zhurmëta**; ato formojnë çift korrelativ për nga zëshmeria: [k]-ja **e shurdhët**, ndërsa [g]-ja **e zëshme**.

Glotalja shtegore e shurdhët [h]

Ky tingull i shqipes bën pjesë në grupin e atyre bashkëtingëlloreve që njihen me termin glotale. Ajo është shtegore që shqiptohet me rrymë mjaft të dobët ajri.

Për nyjëtimin e kësaj bashkëtingëlloreje maja e gjuhës është e ulur, gjuha nuk është e tendosur, tejzat e zërit nuk marrin pjesë në nyjëtim, buzët janë asnjëherë. Gjuha zë pozicion të ngjashëm me atë të qetësisë, kështu që rryma e ajrit nuk ndesh në asnjë pengesë në hapësirën e gojës. Pengesa formohet poshtë hapësirës së gojës. Për tingujt e këtij tipi shumica e fonetikanëve mendojnë se ngushtimi bëhet në shtegthin e zërit, prandaj [h]-në e përcaktojnë si glotale (d.m.th. laringale).

Bashkëtingëllorja [h] njihet me vetitë se është **glotale, shtegore, e shurdhët** (pa korresponduese të zëshme).

⁷³ Anastas Dodi – Jorgji Gjinari, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 78.

KREU IV

4. FONETIKA KOMBINATORE

Në përshkrimin dhe klasifikimin e deritashëm të tingujve të shqipes standarde janë dhënë tingujt bazë, përkatësisht variantet themelore të tingujve (fonemat), të njëjtuar si të shkëputur (të izoluar) nga tingujt e tjerë. Thjesht, tingujt janë trajtuar si segmente të pavarura njëra nga tjetra, nuk janë marrë parasysh ndërndikimet tingullore. Megjithkëtë, do të ishte gjë e gabuar të mendohej se zanoret dhe bashkëtingëlloret janë njësi të ngurosurra dhe të pandryshueshme kur radhiten njëra pas tjetrës për të krijuar fjalë e fjali. Siç dihet, nyjetimit themelor të tingujve në vargun e ligjërit, varësisht nga konteksti, i shtohet edhe një artikulum plotësues.

Përshkrimi i tingujve si njësi të veçanta akustike dhe nyjetimore, përgjithësisht bëhet për qëllim pedagogjik. Por, për t'u njohur një tërësi, është e nevojshme që më parë të dihen pjesët e asaj tërësie. Në të folur, tingulli rrallë paraqitet i shkëputur nga tingujt e tjerë.

Me variantet e shumta të fonemave, që realizohen në ligjërim, gjegjësisht me modifikimin e tingujve në rrjedhën e të folurit, dukuritë dhe rregullat e ndryshimit të tyre në pozita të ndryshme, merret **fonetika kombinatorë** a *fonetika modifikuese*.

Në çdo gjuhë kombinimet e fonemave u nënshtrohen ligjeve të veçanta. Rregull e përgjithshme është se fonemat, të cilat gjenden pranë njëra-tjetrës duhet të kenë njëfarë minimumi të dallimit. Rregullat kombinuese i japin çdo gjuhë fizionomi të veçantë në pjesën e fjalorit. Madje edhe fjalët e huaja u përshtaten e u nënshtrohen rregullave kombinuese normale, që vlejné për fjalët autoktone.⁷⁴

Dukuritë e shumta që veprojnë në tingujt e ligjërit, dëshmojnë se inventari i fonemave nuk mund të kuptohet si një bashkim mekanik i tyre, por si një organizëm i gjallë veprues, gjithnjë në lëvizje e në ndryshim, një tërësi organike, ku elementet e saj përbërëse marrin jetë kur hyjnë në lidhje me njëri-tjetrin. Tingujt krijojnë lidhje të njëpasnjëshme në formë zinxhiri, në mënyrë që veprimi i njëres krijon kushte për një dukuri tjetër.

⁷⁴ N. S. Trubeckoi, *Parime të fonologjisë*, Prishtinë, 1985, f. 375-390.

4.1. NDRYSHIMET KOMBINATORE TË TINGUJVE

Në rrjedhën e të folurit, tingujt ndikojnë mbi njëri-tjetrin, duke bërë që çdo fonemë në pozicione të caktuara të ketë realizime të ndryshme fonetike (alofone). Në gjuhë ka dy grupe ndryshimesh: a) *ndryshime alofonike të fonemave* dhe b) *ndërrime morfonologjike të fonemave* (për këto të dytat u bë fjalë në kreun VII). Ndryshimet alofonike janë ndryshime në realizimin e fonemës, të kushtëzuara nga rrethimi fonetik ose nga pozicioni i saj në fjalë. Në pikëpamje nyjëtimore, ato na paraqiten si ndikim i nyjëtimit të një tingulli mbi nyjëtimin e tingullit tjetër, d.m.th. si përshtatje të ndërsjella nyjëtimesh. Këto modifikime të fonemave janë të domosdoshme për folësit, prandaj quhen edhe ndryshime automatike ose mekanike. Sipas kushtëzimit ndahen në: (a) kombinatore dhe (b) pozicionale.

Me metoda eksperimentale janë dalluar tipare të tingujve që vrojtimi më i vëmendshëm nuk mund t'i vërejë. Të shumta janë laryshitë e tingujve në kushtet e rrethimit fonetik: të kontekstit dhe të veçorive prozodike. Të dhënat për variantet na i jep spektrografia. Është përdëftuar se në gjuhë ka aq variante fonemash sa ka edhe kombinime të mundshme fonemore.⁷⁵

Mekanizmi fiziologjik i ndryshimeve kombinatore kuptohet lehtë, po të kemi parasysh se tri fazat e nyjëtimit të tingullit *-ekskursi, pozicioni* dhe *rekursi-* realizohen të plota vetëm kur tingulli shqiptohet i veçuar. Por në rrjedhën e të folurit ndodh ndryshe. Folësi e përqendron vëmendjen në anën përmbajtësore të thënies dhe fjalët i shqipton si diçka tërësore dhe të gatshme, pa u menduar për realizimin e fonemave, d.m.th. të gjitha lëvizjet nyjëtimore kryhen automatikisht. Si rrjedhim, nyjëtimi i tingullit ndjekës duhet të parapërgatitet që më parë dhe, nga ana tjetër, nyjëtimi i tingullit paraardhës shtrihet edhe mbi nyjëtimin e tingullit pasardhës. *Parapërgatitja* dhe *plogëtia* e nyjëtimit bëjnë që në rrjedhën e të folurit fazat e çdo tingulli të mos realizohen të plota, por të përzihen midis tyre, veçanërisht faza e parë dhe e tretë.⁷⁶

Duke u bashkërenditur në njësi më të mëdha (morfema, fjalë e fjali), tingujt ndikojnë në njëri-tjetrin, pra përshtaten a modifikohen në variante të ndryshme (p.sh. krahasuar me variantin themelor të cilësdo zanore: në zanore më të hapur ose më të mbyllur, më të përparme ose më të prapme, më të gjatë ose më të shkurtër, më pak ose më shumë buzore etj.), saqë ndonjëherë kalojnë edhe në ndonjë tingull krejtësisht tjetër.

Pas shqiptimit të çdo tingulli organet e të folurit nuk kthehen në pozicionin e qetësisë, por kalojnë drejtpërdrejt nga shqiptimi i një tingulli në shqiptimin e tingullit të ardhshëm. P.sh. kur shqiptojmë fjalën *hëna*, para se të mbarojmë së shqiptuari tingullin e parë [h], organet e të folurit parapërgatiten, pra fillojnë të zënë pozicionin e nevojshëm për shqiptimin e tingullit [ë], që vjen pas; dhe, kështu në mënyrë të njëpasnjëshme shqiptohen të gjithë tingujt

⁷⁵ Nuri Gokaj, *Baza të Gjuhësisë së Përgjithshme*, Shkodër, 1997, f. 98.

⁷⁶ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 125-126.

e fjalës. Kështu, në fjalën *hëna*, [h]-ja në pjesën e fundit ka disa veçori edhe të [ë]-së, [n]-ja të [a]-së.⁷⁷ Krahaso edhe variantet e ndryshme të të njëjtës fonemë në fjalët: (unë) *ha*: - (ti) *ha*, (unë) *pi*: - (ti) *pi*, *mik* - *mi*; *motër* - *amfiteatër*, *na* - *nga*; *s'punon* - *z'dua* (s'dua), *mesnatë* - *mezditë* (mesditë); *nāna* - *na^ona*, *nona*; *hāna* - *ha^ona*, *hona* ...

Në modifikimin e tingujve bashkëveprojnë njëkohësisht dy faktorë: faktori fiziologjik me faktorin fonematik. Mekanizmi i ndikimit të një tingulli mbi një tingull tjetër ka natyrë fiziologjike, sepse organet e të folurit janë të prirura të bëjnë përshtatjen e tingujve, veçmas të tingujve fqinjë. Po të vepronte lirshëm kjo përshtatje fiziologjike e artikulimit të tingujve, do të prishej vlera kuptimdalluese e fonemave, bashkë me këtë kuptimi i fjalëve, rrjedhimisht edhe funksioni komunikativ i gjuhës. Mirëpo, këtij procesi rrafshues i bie ndesh faktori fonematik, i cili e pengon faktorin fiziologjik që të mos e prish kuptimin e fjalës, d.m.th. nuk lejon që të bëhen ndryshime aq të mëdha modifikuese të tingujve sa të shpërbënin strukturën fonematike të fjalës deri në prishjen semantike të saj.

Lëvizjet e nevojshme gjatë të folurit njeriu i bën automatikisht: krijon modelin e fjalës në tërësi e pastaj sipas këtij modeli artikulon tingujt përkatës. Përshtatjen e nevojshme nyjetimore të tingujve nuk e pengon faktori fonematik. P.sh. kur shqiptojmë fjalën *gur*, buzët i kemi zgatur që kur shqiptojmë [g]-në, si përgatitje për tingullin [u], që është buzor. Veç kësaj, ky buzorëzim i [g]-së nuk pengohet nga kriteri fonematik, sepse në shqipen nuk kemi kundërvënie të [g]-së së buzorëzuar me [g] të pabuzorëzuar, prandaj edhe kuptimi i fjalës nuk ndryshon.

Prirja e përgjithshme e kombinimit të tingujve në ligjërimin e lidhur është **ekonomizimi i gjuhës** dhe **lehtësimiti i shqiptimit**.

Ekonomizimi i gjuhës. - Duke nyjetuar tingujt, njeriu është i prirur që sa me më pak mund të arrijë efekte maksimale. Pikërisht për këtë, gjatë kombinimit të tingujve të të folurit përpiqemi që për sa është e mundur t'u shmangemi atyre lëvizjeve nyjetimore, të cilat nuk janë të domosdoshme për arritjen e efekteve të nevojshme akustike. Pra, ekonomizimi i gjuhës (që e quajmë edhe ekonomia e gjuhës) udhëhiqet nga ligji "*sa më pak mund*".

Të folurit drejtohet nga kundërshtia e përhershme midis nevojave komunikative të njeriut dhe tendencës së tij për ta rrudhur në minimum veprimin mendor dhe fizik.⁷⁸ Nëse, fjala vjen, duhet të nyjetojmë dy /t/ njëren pas tjetrës (si në fjalët në *arrittë*, në mos e *godittë*; e *gjettë* e mira; në u *mbyttë*; *ndrittë*; në më *prittë*; në *pyettë*; në u *trettë* etj.), për shqiptimin e dy /t/-ve është e nevojshme të bëjmë së pari mbyllje e pastaj shpërthim (për njëren /t/) si dhe rishtas mbyllje - hapje (për /t/-në e dytë), sepse kanë të njëjtin vendformim dhe mënyrë formimi. Megjithatë, pas /t/-së së parë nuk bëjmë hapje të gojës, por mbyllja mbetet deri në fundin e artikulimit të /t/-së së dytë. Në këtë

⁷⁷ Anastas Dodi, *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë, 1970, f. 101.

⁷⁸ Andre Martine, *Elemente të gjuhësisë së përgjithshme*, Prishtinë, 1983, f. 229.

mënyrë u shmangemi dy lëvizjeve artikulative: hapjes te /t/-ja e parë dhe mbylljes te /t/-ja e dytë. Ky është vetëm një shembull i ekonomizimit të të folurit, që bëhet gjatë vijimësisë së dy tingujve të njëjtë (tingujt e dyzuar njihen me termin *geminatë*). Përgjithësisht, takimet e dy bashkëtingëlloreve apo të dy zanoreve të njëjta nuk shqiptohen me përpikëri, por zakonisht me një zgjatje më të madhe sesa të tingujve kur nuk ka dyzime të tilla.

Parimi për ekonomizimin e të folurit në gjuhën shqipe zbatohet edhe në takimet e të gjitha bashkëtingëlloreve të tjera, si *kënddrejtë, nëndarje, mossulmim, mishshitës, veshshkutër*; si edhe të bashkëtingëlloreve me nyjëtim të përafërt, si *i argjendtë, i njëqindtë, mendtë, nuk mundte, tundte* etj.; ndërsa zanoret *geminatë* zakonisht shqiptohen me një shkrirje relativisht të vogël nyjëtimore, nga që ato janë dykulmore, khs. *i paaftë, paanësi, alkool, autoofjinë, joobjektiv* etj.

Të folurit në ligjërimin e shkujdesur bëhet më ekonomik e më i lehtë edhe kur togjet e bashkëtingëlloreve a të zanoreve përngjashmohen, rrëgoohen apo njëra nga elementet e tyre nuk shqiptohet (khs. *mbaj > maj, vend > ven; grue > gru, ftue > ftu* etj.), ndonjë nga tingujt e nevojshëm të fjalëve nuk shqiptohet (khs. *shtëpi > shpi, luftëtar > luftar,...*) etj. Mosshqiptimi i njëres bashkëringëllore ose zanore në grupet e formuara prej tyre, ose përngjashmimi i togjeve të zanoreve e të bashkëtingëlloreve është shprehur nyjëtimore sidomos e folësve gegë.

Lehtësimi i shqiptimit.- Me rastin e kalimit nga një tingull në një tjetër, për të lehtësuar shqiptimin ndonjëherë është e nevojshme të bëhen më shumë lëvizje nyjëtimore, përkatësisht të shqiptohet edhe ndonjë tingull tjetër si shtesë për ndërkalim më të lehtë nga një tingull në tjetrin, që quhen tinguj parazitë (khs. *puno-v-a, la-h-asha, nxënës-i-t*). Këta tinguj joetimologjikë ([v, h, i]) kanë luajtur rol të rëndësishëm në fonologjinë historike të gjuhës shqipe dhe tani janë mishëruar me tingujt etimologjikë e janë bërë të domosdoshëm për normën drejtshqiptimore dhe drejtshkrimore të disa fjalëve.

Analiza e dukurive të ndryshme fonetike, që kanë vepruar në (sand'hi), në kufijtë e leksemave ose të morfemave, japin të dhëna me interes për vetë ndryshimet e sistemit tingullor, për pajtueshmërinë ose papajtueshmërinë e tingujve në rrjedhën e të folurit. Dihet se *arsyeja kryesore e veprimit të dukurive të ndryshme fonetike në ligjërimin e lidhur është vështirësia që krijohet nga lidhjet e tingujve me njëri-tjetrin*. Por, vështirësitë nuk krijohen në çdo lidhje tingujsh; prandaj edhe dukuritë fonetike nuk veprojnë në të gjitha bashkimet në sand'hi.

Lidhje më të qëndrueshme të tingujve janë ato, në të cilat bashkohet një bashkëtingëllore me një zanore ose anasjelltas. Në rrokje të tilla, përgjithësisht, nuk ndodhin ndryshime; prandaj bashkimet e këtyre tingujve janë të pajtueshëm ose të qëndrueshëm. Bashkime të tjera të qëndrueshme janë edhe diftongjet, ku lidhet një zanore me një gjysmëzanore; madje, edhe lidhjet e diftongjeve me një bashkëtingëllore formojnë, përgjithësisht, bashkime të pajtueshme. Përkundrazi, lidhjet e dy zanoreve janë bashkime të

papajtueshme. Në grupet bashkëtingëllore, të papajtueshëm janë sidomos bashkimet e tri bashkëtingëlloreve.

Prirja e përgjithshme e gjuhës është që vështirësitë e krijuara në rrjedhën e të folurit, nga krijimi i grupeve të papajtueshme të tingujve, t'i mënjanojë me mënyra të ndryshme për të kaluar nga grupe të papajtueshme në grupe të pajtueshme. Mënyrat kryesore që përdoren për këtë qëllim, janë:

a) rënia e njërit tingull në grupet e papajtueshme, që përbëhen nga dy zanore ose nga dy a më shumë bashkëtingëllore, dhe

b) ndërputja e një tingulli tjetër në një grup të papajtueshëm për të kaluar në grup të pajtueshëm. Me këtë rrugë, në grupet e bashkëtingëlloreve të papajtueshme hy në mes një zanore (anaptiksi), kurse në grupin e zanoreve ndërkallet një bashkëtingëllore për të zhdukur hiatin.⁷⁹

Shumica e varianteve fonetike kombinatorë ose pozicionale të fonemave kanë mbetur në nivelin dialektor, asnjë prej tyre nuk ka arritur të ngritet në nivelin e normës letrare. Ato dalin si tipare të kufizuara nga pikëpamja gjeografike dhe janë të shpërndara në zona të ndryshme (si përngjashmimi i grupeve të zanoreve e të bashkëtingëlloreve, rënia e tingujve, neutralizimi i kundërvënies së bashkëtingëlloreve të zëshme me korrespondueset e tyre të shurdhëta në fund të fjalës, këmbimi i [h]-së me [f]-në para [t]-së etj.). Është e kuptueshme se variantet fonetike të fonemave nuk pasqyrohen në normën drejtshkrimore, sepse ato lidhen me variacione të timbrit të fonemave në kushte të caktuara fonetike.⁸⁰ Por, ndërrimet kombinatorë dhe pozicionale janë të rëndësishme që të dihen, nga njëra anë, për shkak të njohjes së funksionimit të sistemit të fonemave të gjuhës shqipe dhe nga ana tjetër, për përvetësimin e drejtshqiptimit të shqipes standarde.

Krahas ndryshimeve kombinatorë ka edhe ndryshime pozicionale. Këto shkaktohen nga pozita e një foneme në lidhje me theksin ose fundin e fjalës. Në gjuhën standarde shqipe ndryshim pozicional është vetëm rënia e [ë]-së së patheksuar në disa pozita të caktuara, si *lakër - lakra, femër - femra, emër - emri, ëndërr - ëndrra, kokërr - kokrra, mjekërr - mjekrra, kapitalizëm - kapitalizmi, i sotëm - e sotme, i sjellshëm - e sjellshme* etj. Një numër ndryshimesh të tjera pozicionale ose kanë kaluar në ndryshime historike, ose kanë fituar karakter dialektor. Ndryshime historike janë rënia e /e/-së së patheksuar para mbaresës -ja (*lule - lul#-ja, dele - del#-ja*; por i, e (një) *lule-je, dele-je*), kthimi i /a/-së dhe /e/-së në /ë/ kur dalin në rrokje të patheksuar (*gaz - gëzój, cen - cënój* etj.). Ndryshim historik me karakter dialektor, tani më joveprues, është ndërrimi i [n]-së ndërzanore, që e ka pasur shqipja e moçme (tani që e ruan vetëm gegërishtja) në [r] në dialektin toskë. Shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës mbetet si ndryshim fonetik me karakter dialektor (sepse vepron vetëm në toskërishten) dhe jonormativ për

⁷⁹ Kolec Topalli, *Theksi në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1995, f. 419.

⁸⁰ Jorgji Gjinari – Gjovalin Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë, 1997, f. 204-205.

shqiptimin letrar, ngase mosshurdhimi i të zëshmeve në fund të fjalës përbën normë letrare shqiptimi.

Me dukurinë e ndërndikimit, të ndërndërrimit dhe të proceseve të tjera të tingujve në rrjedhën e të folurit merret fonetika kombinatorë a fonetika modifikuese.

Dukuri më të shpeshta që shfaqen gjatë kombinimit të tingujve në shqipen janë: **akomodimi**, **përngjashmimi**, **shpërngjashmimi**, **zëshmimi** (sonorizimi) i tingujve, **shurdhimi** (desonorizimi) i tingujve, **metateza**, **shtimi** dhe **rënia** e tingujve, **elizioni** i tingujve, **shkrirja** e tingujve, **haplologjia** etj.

4.2. AKOMODIMI

Duke u gjendur në fqinjësi me tinguj të tjerë, te çdo tingull, përveç tipareve parësore (primare) nyjëtimore e akustike, duke u përshtatur me tingujt para dhe pas tij hetohen edhe veçori dytësore (sekondare). Pra, nyjëtimi themelor i tingujve merr nuanca plotësuese, varësisht nga rrethimi tingullor. *Akomodime* (lat. *accommodatio*, -nis “përshtatje, përkim, adaptim”) *quhen përshtatjet nyjëtimore të bashkëtingëlloreve nën ndikimin e zanoreve dhe anasjelltas*, d.m.th. janë të tipit BZ ose ZB. Ato janë më të shpeshta në rrokjet e tipit BZ, në të cilat lidhjet e ndërsjella mes bashkëtingëllores dhe zanores janë më të ngushta se në rrokjet e mbyllura. Duke qenë se parapërgatitja e nyjëtimimit është më e përhapur se plogëtia e nyjëtimimit, varësia e bashkëtingëllores nga zanorja ndjekëse është më e madhe se e kundërta.

Në sistemin tingullor të shqipes, alofonia e zanoreve është më e madhe sesa e bashkëtingëlloreve. Por, edhe realizimet e ndryshme alofonike të zanoreve kushtëzohen ose nga rrethimi tingullor ose nga pozicioni. Sa i përket ndikimit të kontekstit tingullor të drejtpërdrejtë ndaj ngjyrës së zanoreve, në gjuhë të ndryshme shqyrtohen dukuri të tilla, si *ndryshimi i lartësisë së nyjëtimimit, zhvendosja nyjëtimore para/prapa, qiellzorëzimi, buzorëzimi, velarizimi, hundorëzimi* i zanoreve etj.

Qiellzorëzim (palatalizim) quhet nyjëtimi i bashkëtingëlloreve me një timbër qiellzor, kur gjenden në kontakt me ndonjë zanore të përparme. Kështu, prapagjuhoret /k, g/ shqiptohen si më të përparme kur ndodhen para zanoreve të përparme /i, y, e/, duke u afruar me qiellzoret, si *gisht* [g'isht] (në gegërishten qendrore *gjisht*), *kemi* [k'emi]. Në disa të folme të gegërishtes /e/-ja bëhet edhe më e përparme, përkatësisht nis me tingullthin [i], kur vjen pas një bashkëtingëllores qiellzore: *qeth* [q'eth], *lepur* [l'epër], *gjeth* [gj'eth], *gjel* [gj'el] etj.

Buzorëzim (labializim) quhet shqiptimi i tingujve jobuzorë me nuanca buzorëzuese. Buzorëzimi ndodh gjatë kontaktit të ndonjë bashkëtingëllores ose zanoreje jobuzore me një tingull tjetër buzor. Kjo dukuri është mjaft e shpeshtë në të folmet e gegërishtes, si p.sh. *shkolla* [shk^uolla], *lo:p* [l^uop]; *nāna* > *na^ona*, *nona*; *hāna* > *ha^ona*, *hona* etj.

Velarizim quhet shqiptimi më i prapmë i bashkëtingëlloreve, kur ndodhen në kontakt me zanoret e prapme, sidomos me /u/-në. Kjo mund të hetohet po të krahasojmë variantin e /k/-së kur gjendet para /u/-së, si *ku, kur, kumbull, kusi* etj. me variantet kur gjendet para zanoreve të tjera, si *ka, kam, kemi, këmbë, kishte* etj.

Hundorëzimi (nazalizimi) është dukuri fonetike e shqiptimit të ndërhuandshëm të zanoreve. Hundorëzimi i zanoreve ka ndodhur kur ato janë gjetur apo edhe sot gjenden para bashkëtingëlloreve hundore /m, n, nj/, si *hû, sÿ, pê, frê; hûni, sÿni, pêni, frêni* etj. Ky lloj akomodimi është shumë i përhapur dhe ende i gjallë në dialektin e gegërishtes dhe si rezultat i tij janë zanoret hundore në këtë dialekt të shqipes. Shkalla e hundorësisë së zanoreve në të folmet geqe është e larmishme: në veri është më e lartë, ndërsa sa më në jug që shkohet, hundorësia e zanoreve zvogëlohet. Kjo dukuri nuk i ka përfshirë të gjitha të folmet e gegërishtes: diku kemi zanore hundore me vlerë fonologjike, ndërsa diku hundorësia është defonologjizuar dhe dëgjohen zanore të hundorëzuara. Në shqipen standarde zanoret hundore nuk bëjnë pjesë në inventarin e fonemave zanore.

Të gjitha këto dukuri shfaqen edhe në shqipen, por përgjithësisht shkalla e modifikimeve të tilla në shqipen standarde është aq e vogël saqë nuk jep bazë për të vënë rregulla gjegjëse të akomodimit. Në shumicën e rasteve, modifikimet në shqipen standarde, në thelb, janë ndërlidhje të nevojshme gjatë nyjëtimin të fonemave në rrjedhën e të folurit. Krahasuar me disa gjuhë të tjera, p.sh. me rusishten ose polonishten, që janë gjuhë akomoduese; mund të konstatojmë se **shqipja standarde** (si edhe maqedonishtja e shumë gjuhë të tjera) **bën pjesë në grupin e gjuhëve pa përshtatje të theksuar të tingujve, pra është gjuhë joakomoduese.**

Gjendja është pak më tjetër në të folmet dialektore të shqipes, sepse te to shkalla e alofonisë së fonemave, veçmas e zanoreve, është shumë më e madhe sesa në shqipen standarde: aty kemi hundorëzim të zanoreve (pëni - në të folmet geqe), rotacizëm ([n] > [r]: sÿni - syri, në toskërishten), buzorëzim të zanoreve në shkallë të ndryshme (zāni > za^oni > zoni - në të folmet geqe), diftongim (mirë > mâir - në të folmet e gegërishtes qendrore), shqiptim të zanoreve të mirëfillta si diftongoide (lepur > lëpër), nyjëtim më të përparmë dhe më të mbyllur të disa zanoreve të patheksuara (flutur > flutër - në dialektin verior), qiellzorëzim të bashkëtingëlloreve (gojë > gjo:j - në gegërishten qendrore), afrikatizim të bashkëtingëlloreve mesgjuhore (qen > çen, gjak > xhak - në shumicën e të folmeve të gegërishtes veriore), përngjashmim të grupeve të zanoreve e të bashkëtingëlloreve (mësues > msus, mbaj > maj - në shumë të folme të gegërishtes veriore), metatezë (lëshoj > shloj - dukuri e disa të folmeve të gegërishtes), shurdhim të bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës (zog > zok - në toskërishte), haplologji (i një deleje - i një dele) etj.

Shumica e këtyre dukurive dialektore me të drejtë nuk janë normuar në shqipen standarde. Dukuri të rregullta në shqipen standarde janë vetëm rotacizmi, njësimi i bashkëtingëlloreve në zëshmëri kur janë në kontakt

(zëshmimi dhe shurdhimi), shtimi i tingujve antihijatizues (j, h, v) dhe i [i]-së ndërmjet dy bashkëtingëlloreve, shkrirja në disa raste e [ë]-së dhe [e]-së në [a], elizioni i [ë]-së (më i > m'i), rënia e [ë]-së në pozitë të patheksuar para sonanteve (si emër > emri, vegël > vegla) dhe shumë rrallë ndonjë dukuri tjetër (si përngjashmimi: mbrenda > brenda, haplologjia: morfofonologji > morfonologji etj.).

4.3. PËRNGJASHMIMI DHE SHPËRNGJASHMIMI

Formimi i zinxhirit nyjëtimor është proces i ndërlikuar fiziologjik, gjatë të cilit vetitë e çdo tingulli janë të kushtëzuara, sepse në masë të madhe varen nga tingujt e tjerë fqinj. Ndikimi i tingujve në njëri-tjetrin në parim është **prapavajtës** (regresiv), d.m.th. tingulli që pason kushtëzon shqiptimin e tingullit pararendës, por nuk është i pamundshëm edhe ndikimi i anasjelltë. Gjatë lidhjes, p.sh. të bashkëtingëllores [t] me zanoret [i, u, y] krijohen fjalët *ti, tu, ty* dhe për shkak të ndikimit të zanoreve prapavajtëse shqiptohen variante të ndryshme të [t]-së.

Ndërrimet e tingujve në vargun e të folurit kryesisht janë dy llojesh: *kombinatorë*, si pasojë e përshtatjes nyjëtimore të organeve të të folurit ndaj kombinimeve të ndryshme që marrin tingujt për të formuar fjalët; dhe *pozicionale*, që kushtëzohen nga pozita e tingullit që ka në fjalë (pozitë nistore, mesore ose fundore). Përngjashmimi, shpërngjashmimi dhe metateza janë ndryshime kombinatorë që ndodhin midis tingujve homogjenë, d.m.th. ndodhin në shoqërimet BB ose ZZ.

Përngjashmimi është bashkëpërshtatje e tingujve zanorë ose bashkëtingëllore, gjatë të cilit njëri tingull merr tiparet e tingullit tjetër ose të dy shkrihen në një tingull të vetëm. Më rrallë ndeshet shpërngjashmimi, që është përpjekje për të bërë dallimin nyjëtimor të tingujve të përafërt nga shqiptimi. Proceset asimiluese dhe disimiluese veprojnë edhe kur thjeshtohet apo ndërlikohet shqiptimi i grupeve të zanoreve apo të bashkëtingëlloreve, si p.sh. gjatë elizionit, sinkopës, epentezës, haplologjisë etj.

Adaptimi i bashkëtingëlloreve fqinje nga pikëpamja e zëshmërisë së tyre është mjaft i përhapur në gjuhën shqipe si edhe në shumë gjuhë të tjera.⁸¹ Këto janë ndryshime të kushtëzuara fonetike, sepse kushtëzohen nga përshtatja sipas zëshmërisë e bashkëtingëllores së parë me bashkëtingëlloren e dytë, me të cilën gjendet në kontakt. Ato shpjegohen me rregullsitë fonetike që veprojnë në gjuhën e folur, janë ndryshime të pashmangshme kombinatorë për ligjërimin e folur.

⁸¹ Përshtatje të tillë në zëshmëri ka edhe maqedonishtja, e emërtuar si *едначење по здушност* (ednaçenje po zvučnost, unifikim në zëshmëri). Б. Видоески, Т. Димитровски, К. Конески, К. Тошев, Р. Угринова – Скаловска, *Правопис на македонскиот литературен јазик*, Скопје, 1988, f. 21-22.

Kushtëzimi fonetik i dukurisë së zëshimit dhe i shurdhimit të bashkëtingëlloreve është i gjallë (është veprues) në gjuhën shqipe, ka karakter automatik dhe për pasojë nuk kryen as funksione kuptimdalluese e as gramatikore. Rrjedhimisht, këtu nuk kemi ndërrime fonemash, por variante fonetike (alofone) të të njëjtës fonemë.

Përngjashmim a asimilim (lat. *assimilatio,-nis* “përngjashmim”) është ai ndryshim kombinator kur një tingull bëhet plotësisht i njëjtë ose i ngjashëm me një tingull tjetër të fjalës.

Kur dy tinguj bëhen plotësisht të njëjtë kemi **përngjashmim të plotë**, ndërsa kur tingujt vetëm përafrohen, bëhen të ngjashëm, kemi **asimilim të pjesshëm**. Në të dy rastet, dukurinë kur tingulli i parë ndikon mbi të dytin e quajmë **asimilim paravajtës** (progresiv), ndërsa kur tingulli i dytë ndikon në të parin quhet **asimilim prapavajtës** (regresiv). *Përngjashmimi është reciprok*, kur secili nga elementet ndikon mbi tjetrin dhe si rezultat fitohet një tingull që ndryshon nga të dytë, pra bëhet një shkrirje e tyre dhe fitohet në një tingull i vetëm. Shembull tipik i përngjashmimit reciprok është asimilimi i grupit bashkëtingëllor [ng] në [ŋ] në shumë të folme të gegërishtes veriore, si p.sh. *ngat* > *nat*, *ngel* > *nel*, *mos u nguc* > *mos u ŋuc*, *kanga* > *kaŋa*, *deng* > *deŋ* etj. Nga shkrirja (bashkëdyzimi) e [n]-së me [g]-në është përfutur një bashkëtingëllore prapagjuhore, sonore, hundore [ŋ]; e cila për shkak të kundërvënies fonologjike në disa çifte minimale fjalësh është edhe fonemë më vete në inventarin bashkëtingëllor të disa të folmeve gege.

Dy fonema mund të përshtaten sipas mënyrës së nyjetimit, sipas organit aktiv ose sipas pjesmarrjes së tejzave të zërit. Asimilim sipas mënyrës së nyjetimit kemi në trajtat dialektore *fshanë* < *fshatnë*, *mbemë* < *mbetmë* etj. ku nën ndikimin e hundoreve /n/ dhe /m/, fonema /t/ ndryshoi në [n], përkatësisht [m] e pastaj u zhduk. Përngjashmim sipas organit aktiv kemi për shembull, në grupet *nk* dhe *ng* në shqipe dhe në shumë gjuhë të tjera (në anglishte), në të cilat alveolarja /n/ realizohet si velare [ŋ] nën ndikimin e bashkëtingëlloreve velare: *kongres* [koŋgres]

Dukuria e përngjashmimit mund të jetë dy llojesh, varësisht nga ajo se tingujt në vargun e ligjërit që ndikojnë në njëri-tjetrin a përdoren njëri pas tjetrit ose janë të ndarë njëri nga tjetri: *përngjashmim në kontakt* dhe *përngjashmim në largësi*. Zakonisht përngjashmimi në gjuhën shqipe ndodh midis tingujve që janë pranë: në këtë rast kemi **asimilim në kontakt** (i quajtur edhe asimilim i mirëfilltë). Në shqipen standarde disa fjalë që përbëhen nga tinguj të afërt për nga vendi i nyjetimit përngjashmohen në shqiptim. Të tilla janë fjalët që në të shkruar pasqyrohen në formën e tyre të plotë, si <lagjja, ndërgjegjja, pajisje, paqja> etj., ndërsa përngjashmohen në formën e folur, si [*lagja, ndërgjegja, paisje, paqa*]. Në qoftë se përngjashmimi ndodh midis elementesh që nuk janë në kontakt të drejtpërdrejtë, por midis tyre ka ndonjë tingull tjetër, atëherë kemi **asimilim në largësi** (i quajtur edhe asimilim në distancë ose harmonik).

Mund të përngjashmohen si bashkëtingëlloret ashtu edhe zanoret. Shumica e përngjashmive kanë karakter dialektor, nuk pasqyrohen në shkrim dhe nuk parapëlqehen në drejtshqiptim. Fjalë me përngjashmive tingujsh dëgjohen si në të folmet e gegërishtes ashtu edhe në të folmet e toskërishtes, por edhe në ligjërimin e shkujdesur. Po sjellim disa shembuj me përngjashmim të plotë në kontakt: **ng > k, ŋ, g:** *nga* > ka, ŋa, kah; *ngat* > ŋat, gat; *ngutu* > *gutu*; **nd > n, d:** *vend* > ven, *ndaje* > *daje*; **mb > m:** *mbush* > *mush*, *tambël* > *tamël*, *dhamb* > *dham*; **tj > q:** *tjetër* > *qetër*; **dj > gj:** *djalë* > *gja:l*; **pl > q:** *plak* > *qak*; **mj > m:** *mjegëll* > *megëll*; **vj > v:** *vjehërr* > *vehërr* etj. Ja edhe disa fjalë me përngjashmim të plotë në largësi: *kushuri* “kushëri”, *qumusht* “qumësht”, *dallap* “dollap”, *çarapa* “çorape”, *axhak* “oxhak”, *gurubi* “gurabi”, *Asman* “Osman” etj.

Në pak raste fjalët me përngjashmive tingujsh (të shënuara me shkronja të pjerrëta) janë bërë normative. Të tilla janë fjalët ndëgjoj > ddëgjoj > dëgjoj; mbrenda > bbrenda > *brenda*; mbasi > bbasi > basi > *pasi*.

Shpërngjashmimi (disimilimi < lat. *dissimilatio* - dallueshmëri, ndryshueshmëri, diferencim) është dukuri e kundërt e përngjashmimit. Kemi disimilim atëherë kur dy tinguj të njëjtë ose të ngjashëm bëhen të ndryshëm ose më shumë të dallueshëm. Edhe ky proces vepron në zanore e në bashkëtingëllore, mund të jetë paravajtës e prapavajtës, në kontakt dhe në distancë.⁸² Fjalët ku vepron kjo dukuri fonetike, si motor > *matorr*, telefon > *telifun*, xhamadan > *xhemadan*, lodroj > *ladroj*, tamam > *taman*, *tamëm*; oborr > *aborr*, sheqer > *shiqer*, flutur > *flutër*, kumbull > *kumëll*, uthull > *ufëll*, pluhur > *pluhën*, doktor > *daktor*, aksham > *akshëm*; gjarpër > *gjalpër*, bilbil > *birbil*, kolonel > *koronel*, etj. kanë shtrirje relativisht të ngushtë dialektore dhe nuk kanë arritur të depërtojnë në gjuhën standarde. Zakonisht, trajtat me disimilime janë karakteristike për thjeshtligjërimin.

Dukuria e përngjashmimit, mund të thuhet, *ndikon si proces rrënues në gjuhë*. Ajo është e prirur për të zvogëluar ose rrafshuar gjithnjë e më shumë dallimet midis fonemave. Kur kjo tendencë do të vepronte lirshëm, ajo do të rrafshonte dallimet ndërmjet fonemave, dallime këto që janë të domosdoshme për komunikim, sepse komunikimi është i mundshëm vetëm nëpërmjet dallimeve fonemore.

Pra, përngjashmimi dhe shpërngjashmimi janë në kundërshti të përhershme. Në të vërtetë, tingujt që i shqiptojmë janë rezultat i kompromisit midis tendencës asimiluese – përtacisë njerëzore (zgjedhjes së rrugës më të lehtë) dhe disimilimit (nevojës që t'i shqiptojmë fonemat me tiparet e tyre

⁸² Disa gjuhëtarë dallojnë *disimilimin* nga *diferencimi* i tingujve. *Disimilim* e quajnë ndryshimin e dy tingujve të ndarë njëri nga tjetri, që nuk janë në kontakt; ndërsa *diferencim* e quajnë ndryshimin e dy tingujve që gjenden në kontakt. Në traditën tonë gjuhësore, zakonisht, nuk bëhet dallim kuptimor ndërmjet këtyre dy termave dhe me disimilim nënkuptohet shpërngjashmimi i tingujve pa dallim se a janë në kontakt apo në distancë.

dalluese), në mënyrë që të na kuptojnë të tjerët kur flasim. Me fjalë të tjera, prirjes për shkurtimin e fjalëve, për shqiptimin jo të mirëfilltë të tingujve, për rrafshimin e dallimeve fonemore etj., i kundërvihet tendenca që të folurit tonë të mund ta kuptojnë (dekodojnë) të tjerët, d.m.th. fjalët që i shqiptojmë të kenë kuptim dhe me këtë të realizojmë funksionin kryesor të gjuhës - komunikimin.

4.3.1. ZËSHMIMI DHE SHURDHIMI

Mjaft i përhapur është përngjashmimi i bashkëtingëlloreve sipas zëshmërisë. Kështu, në gjuhën shqipe një bashkëtingëllore e zëshme dhe një e shurdhët në takim (kontakt) bëhen ose të dyja të shurdhëta, ose të dyja të zëshme. Ky njëjtësim (unifikim) në zëshmërinë e tingujve e bëhet në të gjitha gjuhët e botës në formën e folur. Kjo përshtatje në zëshmërinë e bashkëtingëlloreve shpjegohet me atë që në grupet bashkëtingëllore *e zëshme + e shurdhët* dhe anasjelltas është e vështirë të kombinohet dridhja e tejkave të tingulli paraprak me mungesën e dridhjeve të tingulli pasues, kështu që në mjaft raste dridhja e tejkave vijon edhe gjatë nyjetimit të bashkëtingëllores së dytë të shurdhët; në raste të tjera, mungesa e dridhjes së tejkave shtrihet gjatë nyjetimit të të gjithë grupit bashkëtingëllor.⁸³ Rregull i përgjithshëm i përshtatjes në zëshmëri të bashkëtingëlloreve të shqipes (si edhe i shumë gjuhëve të tjera) është: *kur vijnë njëra pas tjetrës, e shurdhëta para të zëshmes zëshmohet, ndërsa e zëshmja para të shurdhëtës shurdhohet*. Ky ligj i përshtatjes në zëshmëri nuk pasqyrohet në shkrim. P.sh.:

z ë s h m i m		
	 <i>shkruhet</i>	 <i>shqiptohet</i>
[s] > [z]	s'di	[z'di]
	s'dua	[z'dua]
	s'dëgjoj	[z'dëgjoj]
	s'bën	[z'bën]
	s'guxoj	[z'guzoj]
	s'gjej	[z'gjej]
	s'vjen	[z'vjen]
	asgjë	[azgjë]
	mesditë	[mezditë]
	mesdhetar	[mezdhetar]
[k] > [g]	ekzistencë	[egzistencë]
	ekzekutiv	[egzekutiv]
sh u r d h i m		
	<i>shkruhet</i>	<i>shqiptohet</i>
[d] > [t]	i njëmendtë	[i njëmenttë]

⁸³ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 127-128.

	e argjendte	[e argjenttë]
	i njëqindte	[i njëqinttë]
[b] > [p]	absolut	[apsolut]
	absolvent	[apsolvent]
	abstenim	[apstenim]

Tabela 7. Zëshmimi dhe shurdhimi i bashkëtingëlloreve

Format e zëshmuara ose të shurdhuara të bashkëtingëlloreve në pak raste janë bërë edhe norma drejtshkrimore (format e nënvizuara). Kështu, nga mbiemrat *i kuq*, *i bardhë* me parashtesën *s-* janë formuar foljet *skuq*, *sbardh* > *zbardh*. Kjo vlen edhe për foljet *s + but* > *sbut* > *zbut*, *s + vogëloj* > *svogëloj* > *zvogëloj*. Edhe përdorimi i tingujve *sh-/zh* dhe *ç-* nistorë, që përfaqësojnë një parashtesë të vetme të shfaqur në tri variante fonetike, kushtëzohet nga zëshmëria e tingullit që pason. Kështu, është normë drejtshkrimore dhe drejtshqiptimore që e pazëshmja [sh] të përdoret para bashkëtingëlloreve të shurdhëta (shfaq, shfryj, shkoq, shkul, shthur), [zh]-ja si e zëshme përdoret para bashkëtingëlloreve të zëshme (zhvendos, zhduk, zhdredh, zhgënjej), ndërsa [ç]-ja para zanoreve e bashkëtingëlloreve të tingullta, me pak përjashtime (çarmatos, çnderoj, çliroj).

4.4. SHTIMI I TINGUJVE

Si rrjedhim i ndërveprimit në nyjetimin e tingujve fqinjë, sidomos në ligjërime nëndialektore ose te individë të veçantë, në fillim, në mes ose në fund të fjalës mund të lindin tinguj parazitë (joetimologjikë), më shpesh si elemente që lehtësojnë kalimin nga një nyjetim në tjetrin. Kështu, ka dallim rrënjësor ndërmjet tingujve që shtohen, pa ndonjë vlerë kuptimore; krahasuar me fonemat - morfemat, që shërbejnë për të krijuar fjalë të reja. P.sh.: për fjalën *i drejtë* nëse themi *i ndrejte*, [n]-ja është shtesë fonetike, sepse nuk e ndryshon kuptimin e fjalës; ndërsa në fjalët *dritë* - *ndrit*, /n/-ja është parashtesë, që na jep një fjalë të re. Tingujt mund të shtohen në të gjitha pozicionet e fjalës:

- në fillim të fjalës** (protezë), tingujt që shtohen quhen tinguj protetikë;
- në mes të fjalës** (epentezë), tingujt që shtohen quhen tinguj epetentikë, dhe
- në fund të fjalës** (epitezë), tingujt që shtohen quhen tinguj epitetikë.

Përgjithësisht, fjalët me tinguj të shtuar kanë përhapje të ngushtë dialektore. Kur ndonjë tingull i panevojshëm shtohet në fillim të fjalës, kemi procesin e **protezës** (nga greq. e vj. *pro* “para” + *tithenai* “fut, vë”). Vetë tingulli quhet *protetik* (tingull i paravënë). P.sh.: *bletë* > **mbletë**, *gjetkë* > **ngjetkë**, *plak* > **mplak**, *këthehet* > **nkëthehet**, *i ati* > **i jati**, *e ëma* > **e jëma** etj.⁸⁴

⁸⁴ Nganjëherë shtimi i tingujve nuk lidhet vetëm me fjalën, por me gjithë fjalinë dhe me

Po qe se tingulli shtohet në mes të fjalës, kemi procesin e **epentezës** (nga greq. e vj. *epi* “midis” + *tithenai* “fut, vë”, brendashtesë), ndërsa tingulli i tillë quhet **epentetik** (tingull i brendashtuar, i ndërfitur). P.sh.: në disa të folme toske përdoren format e dyta me brendashtesë, si *zemra* > *zëmbra*, *mrekulli* > *mbrekulli*, *emri* > *embri*, *numri* > *numbri*, *misri* > *mistri*, *ymri* > *ymbri*, *qepalla* > *qerpalla*, *u kënaqa* > *u kërnaqa*, *paloj* > *paltoj*, *përdorim* > *përndorim*, *e majtë* > (*dora*) *e majsh* etj.; ose në të folmet geqe *veton* > *vepton*, *lakuriq* > *laskuriq* etj.

Po qe se tingulli shtohet në fund të fjalës pa ndonjë bazë etimologjike, atëherë kjo dukuri fonetike quhet **epitezë** (<greq. e vj. *epi* “pas” + *tithenai* “fut, vë”, shtojcë, shtesë në fund), ndërsa tingulli i shtuar quhet tingull **epitetik** (tingull i prapashtuar, i prapavënë). Rastet e këtilla në gjuhën dialektore shqipe nuk janë të shpeshta, por nuk mungojnë plotësisht, si *tym* > *tymb*, *kallëm* > *kallëmb*; *da:jxh* (dajë); *ëshën*, *oshtën* (është), *termale* (tërma:, përpjetë), *pe këtush* (prej këtu), *pe atysh* (prej aty) në të folmet shqipe të Maqedonisë; *kam* > *kam-te*, *jam* > *jam-te*, *bëj* > *bëj-te* (Vlorë); *u bë* > *u bë-ti*, *u mbarua* > *u mbarua-ti* (Berat) etj.

Duhet pasur parasysh se disa nga tingujt e shtuar joetimologjikë gjatë zhvillimit historik të shqipes, tani janë mishëruar aq shumë me tingujt etimologjikë saqë janë bërë pjesë e domosdoshme përbërëse e disa fjalëve, që kanë jo vetëm shtrirje mbarëshqiptare dialektore, por janë ngritur në forma normative edhe në shqipen standarde.

Në gjuhën shqipe, mbi të gjitha, janë më të shpeshta rastet e ndërfitjes të një bashkëtingëlloreje mes dy zanoresh, si tingull **eufonik** (bukurtingëllues) ose **kundërhijatizues** (lat. hiatus - e çarë, grykë, hapje). Këta tinguj lindin për të zhdukur hiatin, d.m.th. për të mënjanuar shqiptimin e dy zanoreve të njëpasnjëshme për të cilat goja hapet dy herë. Me fjalë të tjera, këta tinguj shërbejnë për të lehtësuar ndërkalimin shqiptimor nga një zanore në tjetrën dhe për ta bërë fjalën më të këndshme për dëgjim. P.sh.: trajta e shquar e disa emrave të tipit *ve + a = vea* > *ve-j-a*, *kafe + a = kafea* > *kafe-j-a*, *lule + a = lulea* > *lul-j-a* etj. përdoren me [-j-] të ndërfitur.

Në të folmet tona përhapje të gjerë në dialektin e gegërishtes kanë trajtat e shquara të emrave me [-v-] të ndërfitshme midis dy zanoresh, si *ka + i = kai* > *ka-v-i*, *shi + i = shii* > *shi-v-i*, *thi + i = thi-v-i* etj.; ndërsa format e tipit *prro-v-i*, *fto-v-i*, *gru-v-a*, *kru-v-a*, *mu-v-e*, *kre-v-i*, *shko-v-i*, *puno-v-i*, *shkro-v-i* kanë përhapje të ngushtë dialektore. Format e tilla dialektore nuk janë normative (por normative janë format *kau*, *shiu*, *thiu*, *përroi*, *ftoi*, *grua*, *krua*, *mua*, *kreu*, *shkoi*, *punoi*, *shkroi* etj.).

Vështirësia që krijohet në shqiptimin e dy zanoreve të njëpasnjëshme më së shpeshti shmanget me ndërhyrjen e një tingulli bashkëtingëllor. Bashkëtingëllore të tilla, që shtohen për lehtëshqiptim në trup të fjalës midis

proceset që zhvillohen në të. Proceset fonetike që bëhen në fjali i studion *fonetika sintaksore* ose *sand'hi*, emërtuar sipas gramatikës hebraike (*sand-hi*, në sanskritisht ka kuptimin lidhje, bashkim).

dy zanoresh në gjuhën dialektore si dhe në shqipen standarde (edhe në disa gjuhë të tjera), janë tingujt [-j-], [-h-] dhe [-v-]. Ata shërbejnë si mjete lidhëse të ligjërimit, duke kryer funksion të njëjtë me zanoret anaptitike.

/-j/-ja shtohet për të zhdukur hiatin, që shkaktohet nga dy zanore të njëpasnjëshme tek emrat e gjinisë femërore që mbarojnë me zanore të theksuar, me përjashtim të /i/-së,⁸⁵ në emërore në trajtën e shquar. P.sh.: *kala + a > kalaa > kala-j-a*; *bela + a > belaa > bela-j-a*; *ide + a > idea > ide-j-a*; *gjë + a > gjëa > gjë-j-a*; *byro + a > byroa > byro-j-a*, *ani/-j-e, -j-a*; *hi/-j-e, -j-a*; *di/-j-e, -j-a*; *pi/-j-e, -j-a*; *le-j-e, ro-j-e* etj.

Në mes të fjalës /-j/-ja shtohet edhe te të gjithë emrat që në trajtën e pashquar dalin me /e/ të patheksuar: *dele - delja*, *lule - lulja*, *nuse - nusja*, *punëtore - punëtorja* etj. Tingulli /-j-/ përdoret edhe në rasat e zhdrejta (gjinore, dhanore e rrjedhore) të emrave të gjinisë femërore, duke hyrë ndërmjet zanores fundore të temës dhe mbaresës rasore: *rrufe-j-e*, *kala-j-e*, *grua-j-e* etj.

Tingulli /-h-/ u shtohet foljeve që dalin me temë në zanore në diatezën pësore e vetvetore në të tashmen, si: *afroj - afro-h-em*, *bëj - bë-h-em*, *laj - la-h-em*, *mësoj - mëso-h-em* etj. Foljet *pohoj* (po-h-o-j) dhe *mohoj* (mo-h-o-j) janë formuar nga pjesëzat e pohimit *po*, përkatësisht *mo* me prapashtesën -o- dhe me një -h- kundër hiatit.

Në sistemin foljor, tingulli /-v-/ përdoret dendur në të kryerën e thjeshtë të foljeve që mbarojnë me zanore (në të dyja diatezat), si p.sh.: *unë afro-v-a* dhe *unë u afro-v-a*; *ti afro-v-e* dhe *ti u afro-v-e*; *unë mendo-v-a* dhe *unë u mendo-v-a*, *ti mendo-v-e* dhe *ti u mendo-v-e*; *la-v-a*, *la-v-e*, *u la-v-a*, *u la-v-e*; *pre-v-a*, *kërko-v-a* etj.

Për të mënjeluar keqtingëllimin, midis dy zanoresh të një fjale është shtuar një /-v-/ edhe në format gramatikore të rasave gjinore e dhanore shumë të tipit: *(i) male-v-e*, *(i) fusha-v-e*, *(i) lisa-v-e*, ...

Vështirësia që krijohet në procesin e ligjërimit nga bashkimi i dy a tri bashkëtingëlloreve mund të shmanget me ndërhyrjen e një tingulli zanor (që quhet zanore *anaptitike* (< greqishtja e vjetër *anaptyxis* "zhvillim"),⁸⁶ ndërmjet bashkëtingëlloreve. Zanoret që kryejnë këtë funksion janë /ë/-ja dhe /i/-ja e më rrallë /e/-ja dhe /a/-ja. P.sh. zanorja /ë/ ndërhyr në trajtat e shumësit, kur

⁸⁵ Dihet se [-j-] epentitike në shqipen standarde nuk marrin emrat e gjinisë femërore që mbarojnë me /-i/ të theksuar: *liri+a = liria*, *riní+a = rinía*, *shtëpí a = shtëpía*, *agjencí a = agjencía*, *biografí+a = biografia*, *punëtorí+a = punëtoría* etj. Këtë [j] nuk e marrin as emrat e gjinisë mashkullore, ku nyjat shquese -i dhe -u u ngjiten drejtpërdrejt temave që mbarojnë me zanore, pa ndërmjetësinë e tingujve të tjerë (*ftoi*, *vëllai*, *dheu*). Arsyeja e mosndërhyrjes së tingullit [j] në këto raste duhet kërkuar në përbërjen fonetike të mbaresave shquese -i dhe -u, të cilat, mund të kalojnë në gjysmëzanore dhe të formojnë diftongje me zanoret fundore të temës së emrave, duke shmangur kështu vështirësinë që krijohet në shqiptimin e dy zanoreve të njëpasnjëshme.

⁸⁶ Kolec Topalli, *Theksi në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1985, f. 299-304.

bashkëtingëllorja e fundit e rrënjës është e njëjtë me atë të mbaresës: trajta e pashquar shumë *lot* - e shquar *lot-ë-t*, *dit* - *dit-ë-t*, *vjet* - *vjet-ë-t* etj.

Ndërmjet dy ose tri bashkëtingëlloresh bëhet e domosdoshme ndërfitja e një [-i]-je anaptitike që zhduk vështirësinë e krijuar nga takimi i bashkëtingëlloreve. Kjo bëhet te trajtat rasore të shumësit të disa emrave dhe mbiemrave, khs. *bujq* - *bujq-i-t*, *bujq-i-sh*; *krushq* - *krushq-i-t*, *krushq-i-sh*; *peshq* - *peshq-i-t*, *peshq-i-sh*; *ujq* - *ujq-i-t*, *ujq-i-sh*; *nxënës* - *nxënës-i-t*, *nxënës-i-sh*; *njerëz* - *njerëz-i-t*, *njerëz-i-sh*; i egër - *të egr-i-t*, *të egr-i-sh*; i bukur - *të bukur-i-t*, *të bukur-i-sh* etj.

4.5. RËNIA E TINGUJVE

Gjatë të folurit, një tingull ose një grup tingujsh mund të bjerë, pra të mos shqiptohet. Mosshqiptimi i tingujve të nevojshëm gjatë të folurit quhet **rënie tingujsh**.⁸⁷ Rënia e tingujve është e kushtëzuar nga ana fiziologjike, ndaj bëhet me qëllim që të ekonomizohet të folurit dhe lëvizjet nyjetimore të zvogëlohen.

Për shkak të ekonomizimit të të folurit, njeriu në gjuhën e përditshme, fjalët e gjata anon t'i shkurttojë, si *metro*, *velo*, *tele*, *te-ve*, *foto* etj. Edhe emrat e institucioneve, të partive politike, të shoqatave dhe titujt e tjerë të gjatë shumë më shpesh përdoren në formë të shkurtuar sesa në formën e tyre të plotë: RMV (Republika e Maqedonisë së Veriut), AShASH (Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Shqipërisë), IGJL (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë), ITShKSh (Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve), ShShShMV (Shoqata e Shkrimtarëve Shqiptarë të Maqedonisë së Veriut), SF (Studime filologjike) etj.

Me rënien e tingujve cungohet fjala, por zakonisht në kontekst ruhet kuptimi i saj. Po të vepronte lirshëm procesi fonetik i rënies së tingujve, do të prishej kuptimi (semantika) i fjalëve, rrjedhimisht edhe procesi i komunikimit do të çrregullohej e do të pamundësohej. Mirëpo, këtij procesi shkatërrues i bie ndesh nevoja e ruajtjes së strukturës tingullore të fjalës, me qëllim që kuptimi i fjalës të mos priset. Fjala *vjen*, emri *shtëpi* është cunguar deri në formën *shpi*, por shkurtimi i mëtejshëm nuk është i mundshëm, sepse do të krijoheshin fjalët *shi* (shiu) ose *pi* (folje); pra do të ndryshohej edhe kuptimi i fjalës *shtëpi*.

Edhe emrat vetjakë ndër shqiptarët, përveç në formën e tyre të plotë, përdoren edhe në formë të shkurtuar. Krijimi i trajtave të dyta të cunguara të emrave vetjakë (që lindin së pari në mjedise të ngushta familjare, rëndom në moshën e hershme të fëmijëve) ndonjëherë të shoqëruara edhe me ndërrime tingullore, kushtëzohet nga faktorët jashtëgjuhësorë (socialë) e gjuhësorë: nga

⁸⁷ Rrokjet e theksuara, meqë shqiptohen me forcë dhe intensitet më të madh, janë më të gjata dhe më të qarta sesa rrokjet e patheksuara, andaj ato janë të mbrojtura dhe zakonisht nuk i nënshtrohen rrëgjimit apo rënies. Si rregull, sa më larg theksit të jetë ndonjë tingull ose rrokje, mundësia e rënies së tyre është aq më e madhe.

përkëdhelia si edhe nga përpjekja për të shmangur emrat e gjatë ose të vështirë për t'u shqiptuar.⁸⁸

Sipas vendit (pozitës) ku bie tingulli ose grupi i tingujve, kemi:

- a) **rënie tingujsh në fillim të fjalës** (*aferezë* nga gr. e vj. *aphairesis* "rënie");
- b) **rënie tingujsh në mes të fjalës** (*sinkopë* nga gr. e vj. *synkopé* "pres"), dhe
- c) **rënie tingujsh në fund të fjalës** (*apokopë* nga gr. e vj. *apokopé* "shkurtim").

Dukuria e rënies së tingujve është e shpeshtë në të folmet tona, si dhe në ligjërimin bisedor e të shkujdesur, por mjaft e rrallë në stilin letrar. Rëndom bien zanoret e patheksuara ose bashkëtingëlloret që gjenden në rrokje të patheksuar. P.sh.:

a) **rënie tingujsh në fillim të fjalës**: vështirë > *shti:r*, shtëllungë > *shllu:ng*, tashti > *shti*, haber > *aber*, hanë > *anë*, hak > *ak*, hekur > *ekur*, italian > *taljan*, automobil > *tomobil*; mbështetu > *shtetu*; (te disa emra njerëzish janë krijuar trajtat e dyta të cinguar, si Ibrahim > *Brahim*, Mehmet > *Met*, Ramadan > *Dan*, Agim > *Gim*, Burbuqe > *Buqe*, Halide > *Li:d*, Shkëlzen > (*Zen*) *Xen*, Hasan > *Asan*, Halit > *Alit* etj.

b) **rënie tingujsh në mes të fjalës**: shqiptar > *shiptar*, shqip > *ship*, *shyp*; krejt > *kejt*, mëndafsh > *mnash*, vjehërr > *vjeërr*, *veërr*; shahist > *shaist*, afrohet > *afroet*, ndahet > *ndaet*, pihet > *piet*, laheni > *lahi*, mësoheni > *msohi*, pastaj > *pasaj*, tashti > *tashi*, *tash*; sahan > *saan*, prandaj > *pandaj*, kështu > *kshu*, ashtu > *ashu*; krahët > *kraët*, fëmijë > *fmi*, atëherë > *ater*, fluturojnë > *fjaro:jn* etj.; te emrat vetjakë Ahmet > *Amet*, Rrahman > *Raman* etj.

c) **rënie tingujsh në fund të fjalës**: mos > *mo*, s'mund erdha > *s'un* erdha, *është* > *ësh*, *a*, *o*; prej > *pi*, *pe*; erdhi > *erdh*; mjaft > *mja:*, drapër > *drap*, andej > *ande:*; te disa emra njerëzish, si Ismail, Islam, Isuf, Ismet, Isah, Isak etj. > *I:s*, Nexhmedin > *Ne:xh*, Zejnullah > *Ze:jn*, Hajrullah > *Ha:jr*, Bejtullah > *Be:jt*, Fatime > *Fa:t*, Shukri > *Shu:k*, Lutfi > *Lu:t*, Sadullah > *Sadulla (Du:ll)*, Salih > *Sali*, *Sa:l* etj.

Në të folurit afektiv, kur u drejtohem njerëzve të afërt, kryesisht atyre të rrethit të ngushtë familjar, miqësor a shoqëror, ndonjëherë emrat vetjakë, përveç rasteve që i përmendëm, i përdorim me tinguj të rënë në dy pozita njëherazi apo edhe me ndërrime tingujsh: *Du:ll* < Abdullah, *Bi:b* < Habibe, *Sha:h* < Hanëmshahe, *Di:* < Miradije; *Dy:l* < Dylberie; *Dal*, *Tal* < Mehmedali, *Lim* < Urim, Lirim; *Vel* < Enver, *Cen* < Hysen etj.

Rënia e tingujve është e shpeshtë në një grup prej tri bashkëtingëlloresh, ku vështirësia e shqiptimit të tyre është më e madhe. Ky grup mund të formohet nga takimi i dy fjalëve (sand'hi i jashtëm, si *darzezë* < dardhë e zezë) ose dy morfemave (sand'hi i brendshëm, si *lashtë* < lagshtë). Në sand'hin e jashtëm rënia e tingujve është e zakonshme edhe në fjalët e përngjitura, antroponime e patronime të përbëra, që marrin një theks të vetëm

⁸⁸ Gjovalin Shkurtaç, *Sociolinguistika*, Tiranë, 1999, f. 286.

sintagmatik, sipas tipit *sivjet* < sikur vjet, *Tungjatjeta!* < Tu ngjattë jeta!, *gomadare* < gomë detare, *Mazallah* < Mos Allah, *Marlekaj* < Mark Lekaj, *Margjini* < Mark Gjini; në toponime: *Lugi*∪*Spicave* < Lugi i Spicave, *Roga*∪*Çikave* < Roga e Çikave, *Ara*∪*Madhe* < Ara e Madhe e të ngjashme.

Për shkak të vështirësive shqiptimore, fëmijët nyjëtojnë fjalë me rënie tingujsh (të tipit të apokopës, sinkopës), sidomos fjalët shumëerrokëshe, si p.sh.: *çapat* (çorapet), *misha* (këmisha), *shesh* (përshesh), *bia* (gurabia), *mele* (karamele), *zori* (televizori) etj.

Për fëmijët, të vështira për shqiptim paraqiten edhe fjalët në përbërje të të cilave ka grupe me dy ose tri bashkëtingëllore, si p.sh.: *fl, bl, rt, ngr, pr, dj, gr, jk, shk* etj. Në shumicën e rasteve, fëmijët e moshës së njomë këto grupe nuk i shqiptojnë dot, prandaj ngjet dukuria e rënies të ndonjërit nga përbërësit e tyre, duke zëvendësuar ndonjë bashkëtingëllore të vështirë për shqiptim me ndonjë më të lehtë. Khs. *shpitin* a *pitin* (shpirtin), *futuron* (fluturon), *futurim* (fluturim), *fokat* (flokët), *hanga* (hangra), *ngiu* (ngriu), *da:l* (djalë), *uk* (ujk), *pit* (prit), *peva* (preva), *kova* (shkova, shkrova), *si:k* (thikë), *lla:m* (dhëmb) ...

4.6. HAPLOLOGJIA

Dukuria që emërton rënien e rrokjes së patheksuar, kur kemi dy rrokje të njëllorja në të njëjtën fjalë quhet shpërngjashmim (disimilim) rrokjesor ose haplologji (nga greqishtja *haplos* = i thjeshtë dhe *logos* = fjalë, që do të thotë thjeshtim i fjalës). Pra, rënia e njëres nga rrokjet e njëjta të fjalës quhet haplologji.

Haplologjia shpeshherë vërehet në ligjërimin dhe shkrimin e shkujdesur, kur në vend të formës së drejtë të trajtës së pashquar njëjës, tek emrat femërorë që mbarojnë me **e** të patheksuar (të tipit lule, anije, fitore, mësuese,...) në rasat e zhdrejta: gjinore, dhanore dhe rrjedhore, me përsëritje të rrokjeve **-jeje**, përdoren gabimisht rasat e drejta (emërore e kallëzore) vetëm me rrokjen **-je**,⁸⁹ si p.sh.:

rasat e zhdrejta: gjinore, dhanore dhe rrjedhore	
Drejt	gabim
<i>(i) një ajrosjeje</i>	<i>(i) një ajrosje</i>
<i>(i) një anijeje</i>	<i>(i) një anije</i>
<i>(i) një çështjeje</i>	<i>(i) një çështje</i>
<i>rëndësia e kësaj çështjeje</i>	<i>rëndësia e kësaj çështje</i>
<i>(i) një mësueseje</i>	<i>(i) një mësuese</i>
<i>(i) një studenteje</i>	<i>(i) një studente</i>

Tabela 8. Forma e drejtë dhe e gabueshme e emrave në rasat e zhdrejta

⁸⁹ *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, Tiranë, 1976, f. 43.

Pra, si rregull, tek emrat femërorë, të cilët kanë një **-e** fundore të patheksuar në trajtën e pashquar të njëjësit, në emëroren e shquar bie **-e-ja**, ndërsa në rasat e tjera ajo shkruhet e shqiptohet: *artiste - artistja, artisteje; fitore - fitorja, fitoreje; nxënëse - nxënësja, nxënëseje, studente - studentja, studenteje; rrokje - rrokja, rrokjeje etj.*

Me haplologji janë formuar edhe disa fjalë të përbëra (kompozita) në gjuhën shqipe, si: tragjik + komik > tragjikokomik > *tragjikomik*; morfologji + fonologji > morfofonologji > *morfonologji*; mineralo + logji > mineralologji > *mineralogji* etj. Format e fundit të fjalëve (shembujt me shkronja të pjerrëta) të krijuara me haplologji përdoren edhe në gjuhën standarde shqipe.

Me veprimin e haplologjisë brenda togfjalëshit shpjegohen rastet e shpeshta të rënies së nyjës së përparme të emrave të rasës gjinore apo dhanore ose të mbiemrave, kur ka përbërje të njëjtë me nyjën e prapme shquese; khs. *djali mirë* (< djali i mirë), *djalit mirë* (< djalit të mirë); *Hani Elezit* (< Hani i Elezit), *Hanit Elezit* (< Hanit të Elezit); *njeri mirë* (< njeri i mirë), *njerit mirë* (< njeriut të mirë); *vajzës vogël* (< vajzës së vogël), *kalit zi* (< kalit të zi) etj. Kjo dukuri, e gjallë në ditët tona në të folurit e përditshëm nuk është pasqyruar në drejtshkrim, për hirë të ruajtjes së formës gramatikore. Edhe në ngërthim të fjalisë ka fjalë që shpjegohen me veprimin e haplologjisë. Khs. *ndjezot* (ndjeje Zot), *dorasi* (dorë vrasësi) etj.

Shembujt e dhënë më sipër bëjnë të qartë se prirja për të thjeshtuar fjalët, me anë të haplologjisë, ka vepruar gjithnjë në gjuhë, duke prekur rrokjet në pozicione të ndryshme të fjalës, në fillim, në mes e në fund. Në të gjitha rastet, rrokja që ka rënë, ka qenë e patheksuar, gjë që lidhet me dinamizmin e theksit të gjuhës shqipe. Duke pakësuar numrin e rrokjeve të një fjale, pa dëmtuar aftësinë e saj kumtuese, haplologjia është një shfaqje e ekonomisë gjuhësore. Krahas kësaj, me zhdukjen disimilatore të njëjës prej dy rrokjeve të njëjta, haplologjia merr edhe karakter eufonik, duke shmangur kakofoninë që krijon shqiptimi i dy rrokjeve me përbërje të njëjtë fonetike.⁹⁰

4.7. ELIZIONI

Kur bie zanorja fundore e një fjale nën ndikimin e zanores nistore të fjalës ndjekëse, kemi dukurinë e *elizionit*, që është e kundërta e aferezës. Termi *elizion* rrjedh nga latinishtja: *elisisio* = heqje, rënie, zhdukje. *Elizion quhet zhdukja e zanores fundore të patheksuar të një fjale para një zanoreje tjetër të fjalës që vjen pas.*

Në shqipen elidohet zanorja fundore e patheksuar [ë]: (shkruhet) *ditë e re* (shqiptohet) [dit'e re], *në agim* [n'agim]; shkruhet e shqiptohet: *m'i tregoi* < më i tregoi, *m'u afrua* < më u afrua, *t'ia jap* < të ia jap etj.⁹¹ Rënia e zanores [-ë]

⁹⁰ Kolec Topalli, *Theksi në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1995, f. 309-313.

⁹¹ Elizioni haset edhe në gjuhë të tjera, si p.sh. në ital. *l'uomo* < *lo uomo* "njeriu"; në frëngj. *l'académie* < *la académie* "akademia", *l'oiseau* < *le oiseau* "zogu" etj. Shih: Rami

fundore të patheksuar bëhet për shkak të synimit për të lehtësuar shqiptimin e njësisë fonetike (sintagmës) dhe për ta bërë atë më të këndshme për ta dëgjuar. Megjithëse në të folur rënia e [ë]-së në këtë pozicion është pothuajse një rregull fonetike, në drejtshkrimin e shqipes kjo dukuri pasqyrohet vetëm në pak raste.

Në shqipen standarde shpeshherë bie zanorja [-ë] te pjesëza **të**, te nyjat **të**, **së** si dhe te trajtat e shkurtra **më**, **të**. Kjo rënie pasqyrohet edhe në të shkruar: në vend të zanores [-ë] që elidohet, vihet apostrofi: *t'i dha* (të i dha), *m'i dha* (më i dha), *t'i them* (të i them), *t'u thuash* (të u thuash), *t'ua thuash* (të ua thuash) etj. [-ë]-ja bie:

a) te pjesëza **të** e mënyrës lidhore (të punoj, të mësoj, të shkoj, ...) të kohës së ardhme e të paskajores kur përdoret para trajtave të shkurtra të përemrave **i**, **ia**, **ju**, **jua**, **u**, **ua** dhe të pjesëzës **u** të formës joveprore të foljeve, si p.sh.: Duhet *t'i* (të i) ndihmohet shokut dhe *t'ia* (të ia) shpjegosh mësimet që *t'i* (të i) kuptojë. Dua *t'ju* (të ju) them diçka. Për *t'u* (të u) edukuar si duhet dhe për *t'u* (të u) pajisur me kulturë të shëndoshë, duhet të lexojmë shumë libra. Me *t'u* (të u) kthyer nga rruga, filloi *t'i* (të i) nxjerrë sendet nga valixhja dhe *t'ua* (të ua) tregojë të afërmeve.

b) te trajtat e shkurtra të përemrave vetorë **më**, **të** kur gjenden para trajtave të shkurtra **i**, **u** dhe pjesëzës **u** të formës joveprore të foljeve. P.sh.: *M'i* (më i) jep librat, pasi *t'i* (të i) lexoj, do *t'i* (të i) kthej. *M'u* (më u) plotësuan dëshirat. *T'u* (të u) dha rasti *t'ia* (të ia) shpërblesh shokut të mirën që ta bëri.

c) te nyjat **të** dhe **së** para emrave *i ati*, *e ëma*: Porosinë e *t'et s'e* harron kurrë. Kujtimin e *s'ëmës* e ruante si sytë e ballit.⁹²

Për shkak të bukurtingëllimit (eufonisë) a për ta zhdukur hiatin, apo ndonjëherë me qëllim që poetët t'i përmbahen një metri të caktuar (p.sh. tetërrokëshit, dhjetërrokëshit) ose një ritmi të caktuar, në poezi shpesh përdoret elizioni, si:

*Përtëritet njeriu
N'ato lule, n'atë bar
Dit' e natë fryn veriu
Dhe zëmra bëhet behar...*
(Çajupi)

*Gjon Kastrioti nga helmi
për të bijtë e sëmurë
n'Adrianopojë. E turku
po kërkon prej Arianitit
fortesën n'Ulqin, të verë
ushtëri, q'anijet turke
lirisht të shesin, të blejnë...*

(De Rada)

Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 131.

⁹² Remzi Nesimi, *Gramatika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme I*, Shkup, 1997, f. 28-29.

Elizioni është shumë i shpeshtë në të folmet popullore. Zanorja [ë] e patheksuar zhduket jo vetëm para zanores, por edhe para bashkëtingëllores së fjalës që vjen pas. P.sh.:

<i>Grave t'veta u kishin pa thanë:</i>	<i>N'dash me t' kallxue ...</i>
<i>Kem' me u vnue n'vorr për t'gjallë</i>	<i>M'ka bi n'bark</i>
<i>Nana e djelve n'kamë na u çue</i>	<i>Me t'pas lyp, s't'kisha gjet</i>
<i>M'u met djelve buka pa çue!</i>	<i>N'fill t'kmishës</i>
(Ura e fshajtë)	<i>M'i ra n'kit faqe, tjetra i pëlset.</i>
	(Nga të folmet gege)

Elizioni ka lidhje me veçorinë që ka shqipja për t'i bashkuar fjalët me njëra-tjetrën. Në drejtshkrimin e gjuhës së sotme, për hirë të ruajtjes së normës, kjo dukuri pasqyrohet vetëm në pak raste (m'i, t'i, m'u, t'u, t'et, s'ëmës), por gjuha e folur elizionin e zbaton në masë të madhe.

4.8. METATEZA

Në vargun e ligjërimit shpeshherë ndodh që fonemat, rrokjet ose fjalët të ndërrojnë vendet nga radhitja e tyre e rregullt. Në qoftë se fonemat fqinje i ndërrojnë vendet, atëherë bëhet fjalë për **interversion**. Por nëse fonemat që nuk janë në kontakt i ndërrojnë vendet, atëherë fjala është për **metatezë**. Termet *interversion* dhe *metatezë* ndonjëherë përdoren si sinonime. Rëndom, me fjalën **metatezë** kuptohen të dy tipat e ndërrimeve të tingujve, qofshin ata njëri pranë tjetrit ose në largësi. Pra, me *metatezë* (< gr. e vjetër *metathethis* "ndërrim vendi") zakonisht emërtohet ndërrimi i vendeve të fonemave brenda fjalës.⁹³

Kjo dukuri fonetike është shumë e shpeshtë në të folmet popullore, por hetohet edhe në ligjërimin e shkujdesur. Raste më të shpeshta të *metatezës* gjejmë te togjet e bashkëtingëlloreve që janë të vështira për shqiptim, prandaj të folmet popullore zgjedhin variantin më të lehtë. P.sh.: *ldir* (< *dilir*, *dëllir*), *pritoj* (< *përtoj*), *thke:ll* (< *kthjellë*), *thkej* (< *kthej*), *uha* (< *hua*), *shloj* (< *lëshoj*), *elbebi* (< *leblebi*), *murall* (< *mullar*), *pshtoj* (< *shpëtoi*), *s'ëm* (< *s'më*), *elvia* (< *evlia*); *u xrova*, *u zdrova* (< *u rrëzova*) etj. Format *metatetike* të fjalëve (të shënuara me shkronja të pjerrëta) nuk janë normative. Fjalë me ndërrime vendesh ndërmjet tingujve dëgjohet shpesh edhe në të folurit e fëmijëve.

4.9. SHKRIRJA E TINGUJVE

Krasisi është dukuri fonetike e shkrirjes së dy tingujve që vijnë njëri pas tjetrit, në një tingull të vetëm. Gjatë evolucionit historik të gjuhës shqipe në disa raste nga shkrirja e zanoreve [ë] dhe [e] kur janë gjetur afër njëra-tjetrës është përfutuar [a]-ja ([ë] + [e] = [a]).

⁹³ Në kuptim më të gjerë, mund të thuhet se si *metateza* ashtu edhe *interversioni* emërtojnë çrregullim vendesh të fonemave (shkronjave), rrokjeve të së njëjtës fjalë, të fjalëve në fjali ose të fjalive në periudha.

Kjo shkrirje hetohet te trajtat e shkurtra të bashkuara të përemrave vetorë (trajtat e patheksuara): **më + e = ma, të + e = ta**.⁹⁴

Trajta e shkurtër e dhanores në njëjës	Trajta e shkurtër e kallëzores në njëjës	Trajta e bashkuar	Shembuj
v. I: më (mua) +	veta III: e (atë)	= ma	Ma (< më + e) dha librin.
v. II: të (ty) +	veta III: e (atë)	= ta	Ta (< të + e) dha librin.

Tabela 9. Trajatat e shkurtra të bashkuara të përemrave vetorë

Shkrirja (greq. krasisi) e zanoreve [ë + e > a] bëhet edhe kur pas pjesëzës **të** të lidhore (të lexoj,...) përdoret **e**-ja, që është trajtë e shkurtër e përemrit vetor e vetës së tretë njëjës e rasës kallëzore (atë, e), si: Dua **ta** (të dëgjoj + atë, e = ligjëratën) dëgjoj ligjëratën. Do **ta** (të + e) dëgjoj ligjëratën. Kam për **ta** (të + e) dëgjuar ligjëratën.⁹⁵

Nga shkrirja e grupit bashkëtingëllor [**tsh**] në disa fjalë është përfutur tingulli i vetëm [ç],⁹⁶ si: i motshëm > *i moçëm*, (pesë) vjetsh > *vjeç*, i sotshëm > *i soçëm* (forma e fundit nuk është normative) etj. Kjo shkrirje është bërë normë drejtshqiptimore dhe drejtshkrimore edhe te koha e tashme e mënyrës dëshirore e foljes *kam*:

unë patsha > <i>paça</i>	ne patshim > <i>paçim</i>
ti patsh > <i>paç</i>	ju patshi > <i>paçi</i>
ai (ajo) > <i>pastë</i>	ata (ato) patshin > <i>paçin</i>

Rrallëherë [t] + [s] shkrihen në [ç]: petësi > petsi > *Peci*.⁹⁷

4.10. ROTACIZMI NË TOSKËRISHTE DHE NË SHQIPEN STANDARDE

Në ndryshimet jomorfologjike hyjnë edhe ndryshimet e fonemave që vërtetohen duke përqasur sisteme gjuhësore të ndryshme (dy gjuhë ose dialekte të së njëjtës gjuhë) apo prerje të ndryshme sinkronike të së njëjtës

⁹⁴ Në numrin njëjës në vetën e parë dhe të dytë [ë]-ja e trajtave të shkurtra të rasës dhanore e vetës së parë, respektivisht të dytë (**mua** dhe **të**) shkrihen me [e]-në e trajtës së shkurtër të vetës së tretë të kallëzores dhe japin trajtën e bashkuar **ma**, përkatësisht **ta**.

⁹⁵ Format **ma**, **ta** duhet të shkruhen të bashkuara e pa apostrof, sepse apostrofi shënon rënie tingulli, ndërsa te këto kemi shkrirje e jo rënie.

⁹⁶ Të rikojtojmë se [t]-ja është mbylltore, ndërsa [sh]-ja shtegore. Varianti kryesor i [ç]-së është mbylltor-shtegor (afrikat, i shkrirë) me fillim si të [t]-së dhe me mbarim të [sh]-së: [t] + [sh] = ç].

⁹⁷ Në të folmen e Karadakut të Gjilanit dhe në shumicën e të folmeve të gegërishtes verilindore (kosovarishtes) togu bashkëtingëllor [ts] është shkrirë në [ç] në mbiemrin (dardha) *ujtse* > *ujce* (dardhë e lëngshme, në disa të folme të tjera: dardha langshe > langçe > lançe, lançe).

gjuhë, d.m.th. ato që zakonisht quhen “kalime tingullore” ose “korrespondime fonemash”. Në rrafshin dialektor të shqipes, përkatësisht në dallimet dialektore midis gegërishtes e toskërishtes të tilla janë, p.sh. kalimi i [ã]-së hundore të theksuar të gegërishtes në [ë] në toskërishte (zã – zë), rotacizmi [n] > [r] (zãni – zëri), kalimi i togut zanor [uo] të shqipes së vjetër në [ue] në gegërishte dhe [ua] në toskërishte etj.

Rotacizëm është ndërrimi i [n]-së ndërzanore të mbarë shqipes (tani vetëm e gegërishtes) me [r] në toskërishten. Quhet rotacizëm nga emri i shkronjës <r>- rhota në greqishte. Edhe pse ky term ka prejardhje greke, greqishtja nuk e njuh këtë dukuri, prandaj rotacizmi mendohet se është zhvillim i pavarur i shqipes me karakter dialektor. Rotacizmi është dukuri edhe e rumanishtes (ka vepruar në dakorumanishte e istrorumanishte), prandaj ky bashkëpërkim nuk mund të lihet jashtë paraleleve të këtyre dy gjuhëve, që kanë pasur kontakte të gjata në një periudhë të hershme të historisë së tyre.⁹⁸

Rotacizmi, kthimi i bashkëtingëllores [n] në [r] në pozicion ndërzanor, është dukuri e rregullt e toskërishtes, që ka vepruar para më se 1300-1500 vjetësh, ndërsa nuk del në asnjë të folme të gegërishtes.

Megjithëse rotacizmi, ashtu si hundorëzimi i zanoreve dhe shfaqja e zanores /ë/ të theksuar, ka tërhequr vëmendjen e shumë gjuhëtarëve shqiptarë dhe të huaj, prapë kanë mbetur pa u sqaruar përfundimisht disa çështje të rëndësishme të kësaj dukurie. Është fjala për pyetje të tilla si: Përse kjo dukuri është përftuar vetëm në dialektin jugor të shqipes? Ç’lloj tingulli ka qenë /n/-ja, që iu nënshtrua rotacizmit dhe përse kjo dukuri u përftua vetëm kur /n/-ja ndodhej midis dy zanoresh? etj.

Pyetja përse kjo dukuri është shfaqur vetëm në dialektin jugor të shqipes e bashkë me këtë edhe pyetja e dytë vështirë se mund të sqarohen, ashtu siç kanë mbetur pa sqaruar pyetje të ngjashme edhe për dukuri të tjera dialektore ose nëndialektore. Gjithsesi, duhet supozuar që për arsye sot për sot të panjohura, [-n]-ja ndërzanore në dialektin jugor të shqipes në një fazë të dhënë të evolucionit të atij dialekti ka qenë shqiptuar disi ndryshe nga ç’shqiptohej në dialektin verior. Prandaj, nëse [n]-ja e shqipes në përgjithësi paraqitet me një shqiptim të labërguar (të shtendosur), atëherë duhet pranuar që në kohën e shfaqjes së rotacizmit, shqiptimi i [n]-së ndërzanore në dialektin jugor do të ketë qenë edhe më shumë i labërguar.⁹⁹

Mendohet se alternimi [n]/[r] fonetiki ka gjetur mbështetje në mënyrën e nyjetimit të të dy tingujve. Ata janë të dy paragjuhorë, alveolarë, sonorë; por [n]-ja është hundore me mbyllje të dobët (gjuha vetëm sa e prek

⁹⁸ Kolec Topalli, *Sonantet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2001, f. 167-68.

⁹⁹ Shaban Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996, f. 241.

qiellzën e fortë), ndërsa [r]-ja është johundore, njëdridhëse. Duke u ndodhur [n]-ja midis dy zanoresh, mbyllja nuk është kryer dhe me humbjen e hundorësisë ajo ka kaluar në [r]. Rikujtojmë se [r]-ja shqipe, megjithëse dridhëse, nyjëtohet me 1-2 goditje të majës së gjuhës në trysa.¹⁰⁰ Atëherë ishte normë fonetike kthimi i [n]-së në [r]. Pra, në sistemin e të folmeve të Jugut [n]-ja nuk mund të shqiptohet kur dilte ndërmjet dy zanoreve; në këto kushte fonetike ajo shqiptohet afërsisht si [r]-ja ose më mirë të themi si një variant fonetik i fonemës /n/, që më vonë u njëhua plotësisht me /r/-në edhe nga ana tingullore, edhe nga ana funksionale brenda sistemit të fonemave bashkëtingëllore.¹⁰¹

Shkaqet e rotacizmit lidhen ngushtë me hundorësinë e zanoreve, që ka shërbyer si shkak për të, dhe, në pikëpamje kohore këmbimi i [n]-së në [r] është zhvilluar para çhoundorëzimit të zanoreve. Kjo arsye, sipas të gjitha gjasave, duhet kërkuar në intensitetin e ndryshëm të veprimit të hundorësisë në të dy dialektet. Dihet se aty ku hundorësia vepron me një intensitet më të madh, shkakton edhe ndryshime më të mëdha të tingujve. Shembull për këtë është frëngjishtja, gjuhë me hundorësi të fuqishme, që ka sjellë ndryshime të mëdha në nyjëtimin e tingujve. Në shqipen e lashtë, nga dy dialektet e shqipes, duket se toskërishtja ka pasur një veprim më të fuqishëm të hundorësisë, gjë që e dëshmojnë ndërrimet e zanoreve hundore [ã] dhe [ẽ] në [ë]. Ndryshimi i nyjëtimin të zanoreve hundore mund të ketë sjellë si pasojë edhe ndryshimin e nyjëtimin të bashkëtingëllores /n/, që ndodhej pranë tyre.

Historikisht, **rotacizmi ka lidhje të ndërsjellë me hundorësinë e zanoreve**, sepse, nga njëra anë, bashkëtingëllorja [n] ka hundorëzuar zanoret që ndodheshin para saj; kurse, nga ana tjetër, zanoret e hundorëzuara, nyjëtimi i të cilave ndryshonte nga zanoret gojore, kanë ndikuar në kthimin e bashkëtingëllores [n] në [r]. Pas këtij procesi, zanoret hundore, duke mos pasur më pranë tyre tingullin [n], e kanë humbur karakterin hundor e janë kthyer në zanore gojore. Me këtë mund të kuptohet edhe përse zanoret hundore u ruajtën vetëm në gegërishte, ku nuk ka vepruar rotacizmi.

Rrjedhimisht, ruajtja e bashkëtingëllores [n] ka ndikuar në ruajtjen e karakterit hundor të zanores; kurse në Jug, veprimi i rotacizmit, që zëvendësoi [n]-në [r] në pozicion ndërzanor, ndikoi në humbjen e karakterit hundor të zanores. Pra, rotacizmi i të folmeve të Jugut ka shkaktuar edhe çhoundorëzimin e zanoreve hundore. Një gjë e tillë nuk ka ndodhur në Veri, ku zanoret hundore e ruajnë karakterin e tyre, meqenëse kanë vijuar të kenë pranë bashkëtingëlloren [n], që ka shkaktuar hundërëzimin e zanoreve.¹⁰²

Dukuria e rotacizmit është shfaqur kryesisht në fjalët e trashëguara si dhe në huazimet nga greqishtja e vjetër dhe nga latinishtja. P.sh.: *venë - verë*,

¹⁰⁰ Anastas Dodi, *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë, 1970, f. 83.

¹⁰¹ Jorgji Gjinari, *Rotacizmi në dialektet dhe në gjuhën letrare*, Gjuha jonë, 2/1986, Tiranë, f. 36.

¹⁰² Koleç Topalli, *Sonantet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2001, f. 127-152.

peni - peri, druni - druri, freni - freri, syni - syri, zani - zëri, vuna - vura, zuna - zura, bana - bëra, emën(ë) - emër(ë), dimën(ë) - dimër(ë); lakën(ë) - lakër(ë), pjepën(ë) - pjepër(ë); ranë - rërë, kunorë - kurorë, femën(ë) - femër(ë), lini - liri, i varfën(ë) - i varfër(ë) etj.

Sot në toskërishte në formë të rotacizuar përdoren edhe fjalët *drapër, dhelpër, emër, femër, lakër, dimër* etj., sepse edhe te këto fjalë [-n-]-ja është gjendur midis dy zanoresh si në trajtën e shquar, ashtu edhe në të pashquarën: *drapënë - drapëre, drapëni; dhelpënë - dhelpëre, dhelpëna; emënë - emëre, emëri; femënë - femëre, femëra; lakënë - lakëre, lakëra; dimënë - dimëre, dimëri* etj. Kështu ka ndodhur edhe me pjesoret e foljeve *ardhur* (nga ardhurë < ardhunë), *hapur* (nga hapurë < hapunë), *mbyllur* (nga mbyllurë < mbyllunë) etj.

Ky këmbim i [n]-së intervokalike në [r] në të folmet toske është i vjetër dhe fillet e tij nuk dihen, por mendohet se ka pushuar së vepruari aty nga shekulli VII-VIII,¹⁰³ sepse këtij shndërrimi nuk i janë nënshtruar huazimet sllave si dhe huazimet e mëvonshme nga turqishtja, greqishtja e re, italishtja etj. Bie fjala, edhe në toskërisht thonë *inat* (e jo irat), *stan, stopan, çekan, hosten, koçan* (< huazime nga gjuhët sllave); *kanun* (< nga turqishtja.), *manar, lehonë, kanistër, fron, pronë* (< nga greqishtja); *balonë, fanelë, sapuni, kapiteni* (< nga italishtja) etj. me [n] midis dy zanoresh e jo me [r]. Sipas këtyre dëshmime gjuhësore, rotacizmi është një dukuri që i përket mijëvjeçarit të parë, duke u shtrirë deri në periudhën e kontakteve të hershme të shqipes me sllavishten e italishten.

Në prag të kontakteve të shqiptarëve me sllavët, me ndryshimet që ndodhën në sistemin fonetik në gjithë truallin e gjuhës shqipe, sidomos me ndryshimet që pësoi një variant tjetër i fonemës /n/ (n < n + bashkëtingëllore), norma fonetike e rotacizmit pushoi së vepruari; pas kësaj /n/-ja filloi të dilte edhe ndërmjet dy zanoreve.¹⁰⁴

Është fakt se në toskërishten dhe në gjuhën standarde shqipe ka mjaft fjalë të hershme në shqipen, në të cilat [n]-ja ndërzanore nuk është rotacizuar, si p.sh.: *hënë, nënë, punë, unazë, anë, enë, e shtunë, dhunë, unë, tanë, tona*; disa pjesore të foljeve të tipit *zënë, thënë, lënë, qenë, vënë* etj.

Historikisht kjo shpjegohet me faktin se kur ka vepruar kjo dukuri fonetike, bashkëtingëllorja [n] burimisht s'ka qenë në pozitë midis dy zanoresh, por ka qenë e prirë ose e ndjekur nga ndonjë bashkëtingëllore tjetër, e cila e ka penguar rotacizimin. Nën ndikimin e përngjashmimit, te grupi bashkëtingëllor /-nd-, -nt-; -dn- apo -tn-/ bashkëtingëllorja më pak sonore (/t/-ja ose /d/-ja) ose ka rënë ose grupi ka evoluar në geminaten */-nn-/¹⁰⁵ dhe në kohën kur më

¹⁰³ Rotacizmi është një ndër dukuritë më të hershme të dialektit toskë, me një veprim të zgjatur kryesisht në mijëvjeçarin e parë të erës sonë. Shih: Kolec Topalli, *Sonantet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2001, f. 160.

¹⁰⁴ Jorgji Gjinari, *Rotacizmi në dialektet dhe në gjuhën letrare*, Gjuha jonë, 2/1986, Tiranë, f. 36.

¹⁰⁵ Ylli i shënuar në krye (si ky këtu *) tregon se forma e fjalës ose e tingujve të dhënë

nuk vepronte rotacizmi është thjeshtuar në /-n-/. P.sh: **spudna* > *punna* > *puna* (lat. pondus); **nusend* > *nusenn* > *nusen*; *hënna* > *hëna* etj.¹⁰⁶

Mungesa e rotacizmit te format e përngjitura të pronorëve të vetës së parë shumë: *y-në, jo-në, ta-në, to-n-a, ti-në, si-në* etj., dëshmon se përngjitja e të dy elementeve përbërëse të këtyre përemrave është kryer pas ndalimit të rotacizmit në dialektin jugor.¹⁰⁷ Edhe zgjerimi i përemrit vetor të vetës së parë njëjës të rasës emërore /u-/ me elementin e shtuar /-në/ (khs. trajtën burimore **u** me më të renë *unë*) është kryer në një kohë kur nuk vepronte më rotacizmi.¹⁰⁸

Format e pakta të rotacizuara në gegërishte, si *vner* (tosk. vrer) < lat. venenum, *kuno:r* (tosk. kurorë) < lat. corona janë pasojë e shpërngjashmimit (disimilimit).

Në fushën e fonetikës, rotacizmi përbën një nga dallimet themelore ndërmjet toskërishtes dhe gegërishtes: [n]-ja midis dy zanoresh ruhet në gegërishte, ndërsa kjo është shndërruar në [r] në toskërishte. Por, kjo dukuri nuk sjell as dallime në organizimin e fonemave, as dallime kuptimore. Si rrjedhim, ai është një dallim sasior e jo cilësor, d.m.th. lidhet vetëm me përndarjen e fonemave /r/ dhe /n/, ose me dendurinë e përdorimit të njëjës e të tjetrës fonemë, pa ndonjë kushtëzim fonetik. Të dyja fonemat përdoren në të dy dialektet, veçse si pasojë e rotacizmit të dikurshëm, në Jug ka denduri më të madhe /r/-ja, kurse në Veri ka denduri më të madhe /n/-ja.

Kjo gjendje e sotme e rotacizmit në dialektet e shqipes ka rëndësi të madhe për sistemin fonologjik të shqipes standarde. Fjalët me rotacizëm (ashtu siç janë në dialektin jugor) përbëjnë normë të ngulitur në shqipen standarde. Prandaj, çdo përdorim i varianteve dialektore fonetike, pa ndonjë funksion leksikor, gramatikor ose stilistik, përbën shkelje të kësaj norme.

Por, duke qenë se **rotacizmi nuk prek sistemin e fonemave**, kjo e ka lënë rrugën të hapur që gjuha letrare të marrë edhe fjalë të tjera që nuk i ka, me /n/ nga gegërishtja për pasurimin e fjalorit të vet, p.sh. *zanë-zana, zanore, zanafillë; vranësi, (i, e) vranët; krenar, kryeneç, grunore, ranishte, drenushë, rrypinë, barnatore, emnak, kodrinë, rini* etj. Gjuha letrare nuk do të pranonte fjalë me rotacizëm si trajta hiperkorrekte, për të cilat nuk ka nevojë. Bie fjala, nuk ka nevojë të përdorim barëratore (për *barnatore*), hapësirore (për *hapësinore*), drerushë (për *drenushë*) e të ngjashme.¹⁰⁹

është e supozuar ose e rikrijuar.

¹⁰⁶ Te Buzuku gjejmë disa fjalë të shkruara me <n> të dyzuar: *hanna, enni*; te Variboba: *enni* etj.

¹⁰⁷ Shaban Demiraj, *Fonologjia ...*, f. 240-241.

¹⁰⁸ Përemri vetor **u** edhe sot e kësaj dite ruhet në shumë të folme të gegërishtes.

¹⁰⁹ Jorgji Gjinari - Gjovalin Shkurtaj, *Dialektologjia*, Tiranë, 1997, f. 200-201; Jorgji Gjinari, *Rotacizmi në dialektet dhe në gjuhën letrare*, Gjuha jonë, 2/1986, Tiranë, f. 35-37.

KREU V

5. FONOLOGJIA

Studimi i tingujve në aspektin nyjëtimor, akustik dhe dëgjimor nuk do të kishte asnjë vlerë për gjuhësinë, po të mos i shërbente zbulimit të funksionit në gjuhë. Ajo degë e fonetikës që merret me studimin e mjeteve tingullore të gjuhës nga pikëpamja e funksionit të tyre, u quajt fonetikë funksionale, e cila më pas u zhvillua në degë të veçantë të gjuhësisë që quhet fonologji. Pra, fonologjia merret me funksionin e tingujve në procesin e komunikimit, ndaj edhe quhet **fonetikë funksionale**.

Fonema, morfema dhe fjala. Gjuha përbëhet nga tinguj themelorë të të folurit që quhen fonema. Me studimin e tingujve të të folurit merret fonetika, ndërsa me studimin e fonemave të gjuhës merret fonologjia. Bashkimi i fonemave formon morfemat, njësitë më të vogla me kuptim të një gjuhe.¹¹⁰ Shumica e fjalëve mund të ndahen, të zbërthehen, në njësi më të vogla, bartëse të kuptimeve leksikore ose gramatikore, në morfema, si *qytet-ar*, *pun-ishte*, *mal-or*, *hekur-os*, *luft-o-j*, *sh-thur*, *mal-i*. Pra, morfema është njësia më e vogël e kuptimshme e fjalës. Dallojmë dy lloje morfemash: morfema rrënjore (rrënja e fjalës që ka kuptim të mëvetësishëm) dhe morfema ndajshitesore (parashtesat, prapashtesat, mbaresat dhe nyjat, që u shtohen morfemave rrënjore dhe me to formojnë fjalë të tjera).¹¹¹ Morfemat zbërthehen në fonema. Shkronjat janë tregues i mirë i ndarjes së morfemave në fonema (s-t-u-d-e-n-t, sh-q-i-p-t-a-r).

Ka edhe fjalë që përbëhen vetëm prej një morfeme, meqë janë të pazbërthyeshme. Të tilla janë pjesët e pandryshueshme të ligjëratës: ndajfoljet, parafjalët, lidhëzat e pjesëzat e thjeshta, si *lart*, *drejt*, *në*, *me*, *për*, *e*, *por*, *një*, *të* etj. Në shqipen, me kombinimin e 36 fonemave në mënyra të ndryshme formohen mijëra morfema, ndërsa me bashkimin e tyre krijohen mijëra fjalë.¹¹²

¹¹⁰ Disa gjuhë kanë vetëm 15 fonema, ndërsa disa të tjera kanë deri më 85 fonema. Shih: Bourne, L., Dominowski, R., Loftus, E., & Healy, A. (1986). *Cognitive processes*. Englewood Cliffs, Nj: Prentice-Hall.

¹¹¹ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia)*, AShSh, IGJL, Tiranë, 1995, f. 43-49.

¹¹² Me kombinime të ndryshme të 40 fonemave në anglishten janë krijuar 100.000 morfema, të cilat mund të bashkohen për të krijuar mbi 500.000 fjalë.

Fonologjia është shumë më e re se fonetika. Ajo është bijë e fonetikës, sepse nga studimi i tingujve në aspektin funksional, si degë e fonetikës e quajtur fonetikë funksionale, u veçua dhe u zhvillua në dije më vete. Fonologjia në të vërtetë filloi të zhvillohet që me konceptin e fonemës, me të cilën doli Nikollai Sergejeviç Trubeckoi (Nikolai Sergejevich Trubetzkoy) dhe Roman Jakobsoni, themeluesit e Shkollës Gjuhësore të Pragës në vitet e 30-ta të shekullit XX.

Objektin kryesor të fonologjisë e përbën studimi i *fonemave*, d.m.th. i tingujve të parë nga pikëpamja e funksionit të tyre gjuhësor, por ajo merret edhe me studimin e funksioneve të mjeteve *prozodike*: të theksit, të intonacionit etj.

Tingujt e ligjërimit që i studion fonetika kanë një numër të madh veçorish akustike dhe artikulative, që të gjitha për fonetikën janë të rëndësishme. Por, për fonologjinë shumica e këtyre veçorive janë të dorës së dytë, sepse ato nuk funksionojnë si shenja dalluese të fjalëve.

Parimisht është e nevojshme dhe praktikisht është e realizueshme që të bëhet dallimi mes fonologjisë e fonetikës.¹¹³ Ky dallim është në interesin e të dy shkencave. Natyrisht, kjo nuk pengon që secila prej këtyre dy shkencave të përfitojë nga rezultatet e fituara nga tjetra. Porse, aq sa është vështirë të shkëputet plotësisht gjuha nga ligjërimit, aq është e vështirë të përcaktohet një kufi i prerë midis fonetikës e fonologjisë. Në të vërtetë, fonologjia nuk mund të ndahet plotësisht nga fonetika, pasi ajo nuk mund të ekzistojë pa njohuri të hollësishme të tipareve fiziologjike e akustike të tingujve. Por, edhe studimi fiziologjik e akustik i tingujve nuk do të kishin vlerë, në qoftë se nuk do t'i shërbente anës funksionale.¹¹⁴

Meqë njësia bazë e fonetikës është tingulli, ndërsa njësia bazë e fonologjisë është fonema, duhet të bëhet një dallim ndërmjet termit “tingull” dhe termit “fonemë”. Tingull i ligjërimit quhet çdo njësi tingullore fonetike dhe dallueshme, d.m.th. çdo njësi tingullore e prodhuar nga organet e të folurit, të cilën fonetikani mund ta dallojë nga të gjitha njësitë e tjera të prodhuara nga organet e të folurit.¹¹⁵

Rryma zanore të cilën e studion fonetika është tërësi e pandërprerë, që mund të copëtohet sipas dëshirës në një numër të madh pjesësh. Përpjekjet e disa fonetikanëve për të veçuar në brendinë e kësaj tërësie të pandërprerë “tinguj të ligjërimit”, mbështetet në disa shfaqje fonologjike (me ndërmjetësimin e shembëlltyrës së shkruar).¹¹⁶ Meqë është vështirë të bëhet një veçim i tingujve të ligjërimit, disa fonetikanë dallojnë “tinguj të

¹¹³ Tradicionalisht me termin fonetikë nënkuptohet edhe aspekti funksional i tingujve, pra fonetika funksionale, përkatësisht edhe fonologjia.


¹¹⁴ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 97.

¹¹⁵ John Lyons, *Hyrje në Gjuhësinë Teorike*, Londër, 1968; Dituria, 2001, f. 104-105.

¹¹⁶ Për t'i dalluar në transkriptim tingujt nga fonemat, të parat shkruhen midis kllapave katrore ([t]), ndërsa të dytat mes vijave të pjerrëta (/t/).

qëndrueshëm”, që u përgjigjen inventarit fonologjik dhe që përshkruhen hollësisht; si dhe “tinguj kalimtarë”, të cilët gjenden ndërmjet të parëve dhe rëndom nuk përshkruhen, sepse trajtohen si më të parëndësishëm.¹¹⁷

Ashtu siç ka dallim ndërmjet gjuhës dhe të folurit, ashtu ka dallim edhe ndërmjet fonemës dhe tingullit. Kjo grafikisht mund të paraqitet edhe kështu:



5.1. NOCIONI I FONEMËS

Dy pikëpamjet e vështruara të tingujve të të folurit (ai nyjetimor dhe akustik) shpjegojnë veçoritë nyjetimore dhe akustike të tingujve, anën materiale të ligjërimit. Por tingujt kanë edhe *funksion gjuhësor* (linguistik), i cili realizohet gjatë komunikimit. Me funksion gjuhësor të tingujve të nyjetuar nënkuptohet aftësia për t'i dalluar morfemat, format e fjalëve dhe kuptimin e tyre gjatë aktit të komunikimit.

Tingulli në vetvete nuk ka asnjë kuptim, por në komunikimin gjuhësor kanë rolin e dallimit të kuptimit të fjalëve. Fonologjia vëzhgon tingullin në funksionin e tij, d.m.th. si fonemë. Fonema është pikërisht tingulli që përdoret në funksion të komunikimit. Është njësi gjuhësore që nuk ka kuptim të mëvetësishëm, por mundëson dallimin e kuptimeve leksikore dhe morfologjike.

Deri më tani janë dhënë disa përkufizime për fonemën: Tingujt që e dallojnë kuptimin e një fjale nga tjetra quhen fonema. Fonema është njësi më e vogël fonematike e fjalës që shërben për të diferencuar kuptimin e saj. Fonema është njësi më e vogël e gjuhës që ka vlerë kuptimdalluese ose gramatikore. Fonemat janë tipare dalluese të siluetave të fjalëve.¹¹⁸ Fonema përkufizohet edhe si njësi minimale e vargut tingullor (si njësi që nuk mund të ndahet në njësi më të vogla) që shërben për të ndërtuar dhe për të dalluar format tingullore të njësive të kuptimshme të gjuhës.¹¹⁹ Fonema është njësi më e vogël me funksion dallues e planit të shprehjes, e cila nga pikëpamja lineare nuk mund të ndahet në njësi më të vogla.¹²⁰

Mendojmë se përkufizim mjaft i qëlluar është ky: **Fonema është njësi më e vogël e gjuhës e cila më vete nuk ka kuptim, por kur bashkohet me fonema të tjera krijon fjalë me kuptime e forma gramatikore të ndryshme.**

¹¹⁷ N. S. Trubeckoi, *Parime të fonologjisë*, Prishtinë, 1985, f. 37-55.

¹¹⁸ Po aty, f. 81-83.

¹¹⁹ Anastas Dodi – Jorgji Gjinari, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 20.

¹²⁰ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 99.

Nga shumësia e tingujve të nyjëtuar ne dëgjojmë vetëm ata që dallojnë kuptimin e fjalëve, pra fonemat. Tingujt që shërbejnë për dallimin e kuptimit të fjalëve si dhe të formave gramatikore janë fonema. Shikuar nga aspekti akustik dhe fiziologjik në të folur nyjëtojmë numër të pakufizuar tingujsh me të cilët realizohen sasi e caktuar fonemash (30-50). Fonema janë vetëm tipet tingullore që i formojnë dhe i dallojnë fjalët dhe trajtat e tyre. Se fonemat janë tinguj që kanë funksion kuptimdallues ose gramatikor më së miri dëshmohet me kundërvënien kuptimore të fjalëve që dallohen vetëm me një tingull funksional (fonemë) në çifte minimale fjalësh të tipit: *di ~ ti, kam ~ jam, dorë ~ derë, erë ~ urë, si ~ sy, pulë ~ pullë, arë ~ arrë; dash ~ desh, zog ~ zogj, dal ~ del* etj.

Tipe tingullore i quajmë realizimet e ndryshme të të njëjtës fonemë. Analiza fonetike tregon se nuk mund të gjenden kurrë dy tinguj plotësisht të njëjtë si nga ana fiziologjike, ashtu edhe akustike. I njëjti folës nuk mund të shqiptojë dy herë njëloj një zanore ose bashkëtingëllore, jo vetëm në rrethime të ndryshme fonetike, por edhe në të njëjtën fjalë. Si rrjedhim, lartësia, forca, gjatësia dhe timbri i tingujve ndryshojnë nga një realizim në tjetrin. Për shembull, në fjalët *kap, kánë, ka, ára* etj. [a]-të janë tinguj akustikisht të ndryshëm: [a]-ja e fjalës *ka* është më e gjatë se [a]-ja e fjalës *kanë*, [a]-ja e theksuar e fjalës *ára* është më e gjatë dhe më e nderë se [a]-ja e patheksuar e kësaj fjale etj.

Realizimet e veçanta fonetike të të njëjtës fonemë janë *nuanca fonemore* apo *alofone*. Të gjitha alofonet varen nga rrethimi konkret fonetik. Disa prej tyre varen më pak nga rrethimi fonetik e disa më shumë. Nuancat fonemore që varen më së paku nga rrethimi fonetik i quajmë *nuanca themelore (variant themelor i tingullit)*. Nuanca themelore janë ato kur tingulli shqiptohet i veçuar, pa ndonjë tingull tjetër. Variant themelor i zanores është zanorja e shqiptuar më vete, e veçuar, e izoluar nga tinguj të tjerë; ndërsa variant themelor i bashkëtingëllores është nyjëtimi përkatës me zanoren [ë] pas saj (në shqipen b-ë, c-ë, ç-ë, d-ë etj.).

Po t'i shënojmë me numra të gjitha nuancat fonemore të [a]-ve që nyjëtojnë folësit e shqipes, do të kemi formulën:

/A/ => [a₁, a₂, a₃, a₄ a_n] dhe, në përgjithësi, për çdo tingull:

/X/ => [x₁, x₂, x₃, x₄ x_n], ku n (x_n) tregon një madhësi të pafund.



Fig. 36. Qarku komunikativ i të folurit

Këtu lind pyetja: përse folësit e shqipes nuk i përkapin dallimet akustike e fiziologjike midis këtyre tingujve, por i perceptojnë si një njësi të vetme, si fonemë /a/ me funksion gjuhësor, të cilën e paraqesin në shkrim me <a>? Arsyeja është se ndryshimet midis [a]-së së gjatë, [a]-së së shkurtër dhe [a]-së gjysmë të gjatë, [a]-së të nderë dhe [a]-së të labërguar, [a]-së me timbër hundor etj. në fjalët e mësipërme nuk luajnë ndonjë rol në dallimin e kuptimit të fjalëve. Kështu, kuptimi i fjalës *kap* nuk do të ndryshonte, në qoftë se midis bashkëtingëlloreve do të ishte e mundur të përdorej çdonjëri nga tingujt e serisë [a₁, a₂, a₃, a₄, ..., a_n]. Por, po të zëvendësojmë /a/-në me /e/-në, kemi fjalën *kep*; po ta vëmë në vend të /k/-së një nga tingujt e serisë /j/, na del fjala *jap* etj. Pra, tingujt e këtyre serive ([a₁, a₂,]) nuk luajnë rol në ndryshimin e kuptimeve të fjalëve ose të formave të tyre, pasi dallimet midis tyre nuk kanë funksion gjuhësor.

Kjo do të thotë që shumësia e tingujve të të folurit, nga pikëpamja e funksioneve të tyre gjuhësore, reduktohet në gjuhë në një numër të kufizuar njësisish tingullore, për të cilat është i vetëdijshëm çdo folës. Këto tipa tingullore, që funksionojnë si njësi të gjuhës, quhen *fonema*. Kështu, elementet e serisë [a₁, a₂, a₃, a₄, a_n] janë realizime konkrete të fonemës /a/ në rrjedhën e të folurit. Pra, fonema /a/ realizohet nga tingujt [a₁], [a₂], [a₃].... Këta tinguj përfshihen në një fonemë, falë ngjashmërisë së tyre fonetike dhe funksionit të njëjtë.

Tërësia e fonemave të një gjuhe formon sistemin fonologjik të saj. Sistemet fonologjike të gjuhëve të ndryshme dallojnë midis tyre jo vetëm nga numri i fonemave që përfshihen në to dhe nga raportet që vendosen mes fonemave të një sistemi, por edhe nga substanca fonetike e tyre. Kështu, nuk mund të themi se fonema /e/ e shqipes është e ngjashme me fonemën /e/ të frëngjishtes, pasi fonema /e/ e shqipes mund të realizohet si [e] (e mbyllur) ose si [ɛ] (e hapur), kurse në frëngjishte /e/ dhe /ɛ/ janë dy fonema të ndryshme.

Që të ketë dallim, duhet të ketë kundërvënie. Kundërvënia (opozicioni) është veti themelore e strukturës së gjuhës. P.sh. fjalët *borë* dhe *dorë*, *kam* dhe *jam*, *di* dhe *dy* etj. nuk do të dalloheshin nga kuptimi, nëse nuk do të kishin

kundërvënie të segmenteve /b ~ d/, /k ~ j/, /i ~ y/¹²¹ etj. Nuk do të dalloheshin as edhe fjalët *ty* dhe *yt*, *jam* dhe *maj*, *sa* dhe *as*, *libër* dhe *rëbil* etj. nëse njësitë tingullore që i përbëjnë fjalët nuk do të radhiteshin në mënyrë përkatëse.

Përveç kësaj, nga kundërvënia e melodikës së fjalive të tipit *Bie shi. Bie shi? Bie shi! Bie shi?! etj.* ndryshohet mesazhi (konstatojmë, pyesim, habitemi, pyesim me habi). Edhe çiftet minimale të fjalëve, si *líri ~ lírí*, *bári ~ barí*, *drejtóri ~ drejtorí* etj. dallohen për nga kuptimi në saje të kundërvënies: zanore e patheksuar ~ zanore e theksuar.

Do përmendur se nuk ka funksion kuptimdallues apo gramatikor çdo realizim i ndryshëm i tingullit. P.sh. /d/-ja dhe /t/-ja, /g/-ja dhe /k/-ja janë tinguj dhe fonema të ndryshme, por ndonjëherë edhe kur ato këmbehen, kuptimi i fjalës nuk ndryshon, si *vend - vent* ose *vënt*, *zog - zok*, *shteg - shtek* etj.; ose /s/ dhe /z/, /h/ dhe /f/: *s'di - z'di*, *mesditë - mezditi*; *i ftohtë - i ftoft*, *njoh - njof* etj.; /u/ dhe /ë/, si *kumbull - kumëll*, *flutur - flutër*, *petull - petëll*, *tingull - tingëll* etj., /sh/ dhe /ç/ *shliroj - çliroj*, *shlyej - çlyej*, *shkul - çkul* etj.¹²²

Kur në një pozicion fonik takohen vetëm njëra nga dy fonemat që formojnë një kundërvënie, që mbështetet në një tipar korrelativ, thuhet se *kundërvënia* midis tyre *asnjanësohet* (neutralizohet). Asnjanësimi i një kundërvënieje nuk do të thotë zhdukje e një tingulli, por kufizim në përndarjen (distribucionin) e disa fonemave në pozicione të caktuara fonetike. P.sh. në shumicën e të folmeve të toskërishtes kundërvëniet /d ~ t/ e /g ~ k/ në fund të fjalës nuk realizohen, sepse bashkëtingëlloret e zëshme nuk përdoren në këtë pozicion. Në rastet e këtilla bëhet *asnjanësimi* (neutralizimi) i kundërvënies fonologjike dhe kemi alofone të të njëjtës fonemë në pozitë të dobët.

Pozitë e fortë e fonemës konsiderohet ajo, në të cilën realizohet diferencimi maksimal i fonemës, ndërsa pozitë e dobët është ajo ku diferencimi fonemor është i zvogëluar, i zbehur ose është e pamundshme që të hetohet. Pozita e dobët ku nuk vjen në shprehje kundërvënia fonemore quhet pozitë e *asnjanësimit* (e *neutralizimit*). Bie fjala, në gjuhën shqipe, zanoret e theksuara janë në pozitë të fortë, ndërsa të patheksuarat gjenden në pozitë të dobët. Vlen të thuhet se të patheksuarat, si dhe bashkëtingëlloret, sa më afër theksit të jenë, janë më të mbrojtura dhe anasjelltas.

Tingulli që ta ketë *statusin e fonemës*, *detyrimisht duhet të japë ndonjë informatë kuptimore ose gramatikore*. Bazë e identifikimit dhe e diferencimit të segmenteve tingullore është aftësia që t'i dallojnë ose të mos i dallojnë morfemat dhe fjalët në komunikimin gjuhësor. Tingujt që e kanë mundësinë e

¹²¹ Kundërvënia fonologjike e fonemave rëndom shënohet me shenjën tilda ~ (/a ~ o/, /t ~ d/, ...).

¹²² Asnjanësimi apo zhdukja e një dallimi fonologjik quhet *defonologjizim* (ose zhvlerësim fonologjik), kurse formimi i një dallimi fonologjik quhet *fonologjizim* (ose vlerësim fonologjik).

dallimit të tillë janë **fonema**, ndërsa ata që nuk e kanë këtë veçori janë **variante të fonemave** (alofone).

Funksionet dalluese (distinktive) të segmenteve tingullore provohen dhe vërtetohen me kundërvëniet e tyre, e quajtur **kundërvënie fonologjike** (opozicion fonologjik), ndërsa pjesët e këtij opozicioni janë **njësi fonologjike**. Fonemat që formojnë kundërvënien quhen **gjymtyrë të kundërvënies**.

Përveç tipareve dalluese, me të cilat fonemat u kundërvihen të tjerave, ato kanë edhe tipare jodalluese ose të parëndësishme (redondante) në pikëpamje fonologjike. P.sh. kundërvënia /k ~ g/ në shqipen karakterizohet nga tipari dallues i zëshmërisë, sepse kemi bashkëtingëllore e shurdhët ~ korresponduese e zëshme. Por /k/-ja dhe /g/-ja dallohen edhe nga fakti se e para nyjëtohet me një forcë më të madhe se e dyta. Ky tipar është redondant, por mungesa e zëshmërisë kundruall (~) pranisë së zëshmërisë siguron funksionin dallues të kundërvënies /k ~ g/. Segmentet tingullore, p.sh. /p/ dhe /b/ kanë funksion distinktiv, sepse dallojnë fjalët, si p.sh. *pi ~ bi, pjeshkë ~ bjeshkë, pas ~ bas, pishë ~ bishë, pesë ~ besë* etj.

Funksioni dallues i fonemave duket qartë në çifte fjalësh, që në përbërjen e tyre dallohen vetëm nga një element. Të tillat quhen çifte minimale fjalësh. Për të provuar funksionin dallues të fonemave, përdoret **metoda e zëvendësimit** (komutacioni) të një fonemeje me një tjetër. Përveç shembujve të dhënë, po sjellim edhe disa kundërvënie fonemash në disa çifte minimale fjalësh:

Kundërvënie fonologjike me vlerë kuptimore:

- /i/ ~ /y/: di ~ dy, si ~ sy, pikë ~ pykë, mik ~ myk;
- /e/ ~ /u/: pelë ~ pulë, ke ~ ku, te ~ tu, je ~ ju, era ~ ura, enë ~ unë,
verë ~ vurë;
- /b/ ~ /d/: borë ~ dorë, bimë ~ dimë, bac ~ dac;
- /m/ ~ /v/: mes ~ ves, muaj ~ vuaj, mi ~ vi, mjelë ~ vjelë, mjet ~ vjet,
mend ~ vend;
- /f/ ~ /v/: faj ~ vaj, fashë ~ vashë, fise ~ vise;
- /f/ ~ /g/: fushë ~ gushë, furrë ~ gurrë;
- /t/ ~ /d/: tash ~ dash, tru ~ dru, ti ~ di, tu ~ du, tel ~ del;
- /d/ ~ /sh/: di ~ shi, derr ~ sherr, duaj ~ shuaj, desh ~ shesh,
dënim ~ shënim,
dëmtoj ~ shëmtoj;
- /d/ ~ /v/: derë ~ verë, duaj ~ vuaj, degë ~ vegë, desh ~ vesh;
- /n/ ~ /m/: nënë ~ nëmë, han ~ ham, ne ~ me, kan(ë) ~ kam;
- /r/ ~ /rr/: ara ~ arra, ruaj ~ rruaj, rasë ~ rrasë;
- /s/ ~ /z/: sot ~ zot, sanë ~ zanë;
- /s/ ~ /sh/: masë ~ mashë, pres ~ presh, situr ~ shitur;
- /s/ ~ /l/: sot ~ lot, sopatë ~ lopatë;
- /c/ ~ /l/: copë ~ lopë;
- /c/ ~ /gj/: cak ~ gjak;

/ç/ ~ /b/: çatall ~ batall, çaj ~ baj, çeli ~ beli;
 /xh/ ~ /sh/: xhami ~ shami;
 /l/ ~ /ll/: plakë ~ pllakë, pulë ~ pullë, mal ~ mall, palë ~ pallë;
 /l/ ~ /p/: lus ~ pus, lis ~ pis;
 /ll/ ~ /k/: llullë ~ kullë;
 /th/ ~ /dh/: thi ~ dhi etj.

Në çiftet e fjalëve të sjella, këmbimet e fonemave dallojnë njëren fjalë nga tjetra dhe kanë vlerë kuptimdalluese. Por, përveç vlerës leksikore, kundërvënia fonologjike shpeshherë është mjet i vetëm gramatikor me të cilat bëhet dallimi i numrit të emrave, i vetës së foljeve etj. te disa fjalë, si p.sh.:

Kundërvënie fonologjike me vlerë gramatikore:

/a/ ~ /e/: dash ~ desh, dal ~ del, marr ~ merr;
 /k/ ~ /q/: mik ~ miq, fik ~ fiq, armik ~ armiq, bujk ~ bujq, ujk ~ ujq,
 ka ~ qe;
 /r/ ~ /j/: flamur ~ flamuj, lepur ~ lepuj;
 /ll/ ~ /j/: kungull ~ kunguj, grumbull ~ grumbuj etj.

Numri i çifteve minimale që ekzistojnë në gjuhë përcakton *ngarkesën funksionale* (ose rendimentin funksional) të kundërvënies. Sa më tepër çifte minimale të ekzistojnë, aq më e madhe është ngarkesa funksionale e kundërvënies.

5.2. VARIANTET E FONEMËS

Siç u tha edhe pak më parë, në rrjedhën e të folurit, fonema realizohet nga tingujt e ligjërimit. Pra, ajo është një invariant që ekziston në formën e varianteve. *Variante* në të cilët shfaqet fonema /x/, janë tingujt e ndryshëm të vargut [x₁, x₂, x₃, x₄,...,x_n] që e realizojnë atë. Shfaqja e njërit apo tjetrit variant të fonemës varet nga faktorë të ndryshëm, nga të cilët më të rëndësishëm janë faktorët fonetikë. Për shembull, fonema /n/ e shqipes realizohet në tri variante kryesore: si [n] alveolare, si [n] qiellzore dhe si [ŋ] velare.¹²³

Variant quhet cilido realizim konkret i fonemës në kontekste të ndryshme. Një fonemë ka aq variante sa ka edhe realizime kontekstuale. Pra, **me variante të fonemave kuptohet realizimi i tingujve me veçori të ndryshme fizike, që në aktin e komunikimit kanë të njëjtin funksion, d.m.th. bashkohen dhe përbëjnë një fonemë. Variantet e fonemave quhen alofone:**

¹²³ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 100.




Fig. 37. Larmi alofonesh të fonemave zanore

Që të përcaktohet se në një pozicion të caktuar funksionon një fonemë e vetme ose dy fonema të ndryshme, përdoret metoda e zëvendësimit reciprok e segmenteve tingullore. Meqë tingujt përdoren në fjalë, ata ndikojnë mbi njëri-tjetrin. Kështu, /a/-të e fjalëve *tapa, qaj, kali, balli, kam, jam, fat* etj. nga pikëpamja akustike nuk janë të njëjllotja. Tërësia e varianteve të tilla përbëjnë fushën e përndarjes së fonemës /a/. Kjo mund të paraqitet kështu:




Fig. 38. Fusha e përhapjes së varianteve të fonemave zanore. P.sh.: $[a_1] + [a_2] + [a_3] + [a_4] \dots = /a/$, ku $[a_1], [a_2] \dots$ përbëjnë variantet e fonemës (alofonet), ndërsa /a/-ja është fonemë

Pra, kjo e fundit (/a/-ja) është tip tingujsh, është shuma e gjithë llojeve të [a]-ve që paraqiten në gjuhë. Të gjithë këta tinguj të ndryshëm që realizojnë të njëjtën fonemë quhen variante fonetike të fonemës në fjalë. Tingujt konkretë që paraqiten në ligjërime në të vërtetë janë simbole të thjeshta materiale të fonemave. Nga kjo del se një fonemë mund të realizohet prej shumë tingujsh të ligjërimit që dallohen njëri prej tjetrit. Por, të gjitha këto lloje tingujsh kanë një funksion të përbashkët, që i lidh të gjitha së bashku. Tërësia e të gjitha alofoneve përbëjnë fonemën. Nga kjo mund të përfundohet se ligjërime ynë ka

numër të pakufizuar tingujsh, por gjuha ka numër të caktuar fonemash (p.sh. shqipja standarde ka 36 fonema).

Me rëndësi për përshkrimin fonologjik është koncepti i pozicionit të fonemës në fjalë, që quhet *rrethim fonetik* a *rrethim tingullor*. Tërësia e rrethimeve fonetike (tingullore) në të cilat realizohen variantet e fonemës, përbën **përndarjen** (distribucionin) e saj.

Siç dihet, **fonemat** ekzistojnë në formën e **varianteve kombinatorë, pozicionale, krahinore, individuale** e **stilistike**.¹²⁴ E shprehur me terma artikulative dhe akustike kjo do të thotë që çdo fonemë zanore ose bashkëtingëllore ka një zonë artikulative dhe akustike karakteristike brenda së cilës realizohen variantet e saj. Kjo quhet **pushë e përhapjes** (fr. *champ de dispersion*) së fonemave.

Sipas pamundësisë ose mundësisë që të përdoren në të njëjtin rrethim fonetik, variantet e fonemës janë dy llojesh:

1) **variante të detyrueshme**: me kushtëzim *kombinator* ose *pozicional* dhe

2) **variante të lira** (ose fakultative): me kushtëzim *social, krahinor, individual* etj.

1) **Variante të detyrueshme** janë variantet kombinatorë ose pozicionale të fonemave, të cilat kushtëzohen nga konteksti tingullor i tingujve fqinjë, d.m.th. nga tingujt që gjenden para ose prapa, nga ndikimi i tyre mbi tingullin e dhënë ose nga pozicioni i tyre në fjalë (në fillim ose në fund të fjalës, në rrokje të hapur ose të mbyllur, në rrokje të theksuar ose të patheksuar etj.).

Quhen të detyrueshme, sepse në një pozicion të dhënë mund të përdoret vetëm një variant i caktuar, nuk mund të përdoret varianti tjetër, zgjedhja e të cilit bëhet automatikisht, në përputhje me shprehitë nyjetimore të gjuhës (zakonisht për shkak të akomodimit të organeve të të folurit), kështu që ky variant është i detyrueshëm për të gjithë folësit e saj. Për shembull, [n] alveolare, [n] qiellzore dhe [n] velare janë tri variante të detyrueshme të fonemës /n/ të shqipes, sepse [n]-ja shqiptohet si qiellzore detyrimisht kur gjendet përpara bashkëtingëlloreve mesgjuhore /q, gj/ si te *qengji, ngjit*; velare para velareve /k, g/, si tek *enkas, kongres*; kurse [n] alveolare në të gjitha rrethimet e tjera tingullore: *nëna, nder, nuse, vend, ne* etj.¹²⁵

Në varësi nga lloji i kushtëzimit, variantet e detyrueshme nëndahen në (a) variante kombinatorë dhe (b) variante pozicionale.

a) **Variante kombinatorë** janë ato modifikime fonemore që varen nga konteksti a rrethimi tingullor. Nga variantet kombinatorë varet gjatësia e zanoreve, shqiptimi më i përparmë a më i prapmë, më i hapur apo më i mbyllur sesa varianti kryesor i tyre etj. Kështu, fonema /a/ realizohet si [ã] (e shkurtër)

¹²⁴ Л. Р. Зиндер, *Общая фонетика*, Москва, 1979, f. 47.

¹²⁵ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 101.

në fjalën *plāk*, [a:] (e gjatë) në *pla:kë*, ndërsa [a.] e mesme në *plaku, plaka*. Në këto raste, [ã], [a.] dhe [a:] në shqipen standarde janë variante kombinatorë të fonemës /a/. Gjithsesi, variante të detyrueshme kombinatorë janë modulimet e zëshmërisë së çifteve të bashkëtingëlloreve [t]/[d], [p]/[b], [th]/[dh], [k]/[g], [f]/[v], [s]/[z], [sh]/[zh], [ç]/[xh], sepse të shurdhëtat kur gjenden para të zëshmeve zëshmohen dhe anasjelltas, të zëshmet në pozitë para të shurdhëtave shurdhohen. Khs. shqiptohet [z'di] por shkruhet *s'di*, shqiptohet [apsolvent], shkruhet *absolvent*, shqiptohet [egzistoj], shkruhet *ekzistoj* etj.¹²⁶

b) **Variante pozicionale** të fonemave janë ato që varen nga pozicioni i fonemës në fjalë, d.m.th. nga vendi që ka fonema në një fjalë: në fillim ose në fund të fjalës, në rrokje të hapur ose të mbyllur, në rrokje të patheksuar ose të theksuar. P.sh. në rrokje fundore bashkëtingëlloret e zëshme në dialektin jugor kanë prirje të shqiptohen si të shurdhëta: *zog - zok, shteg - shtek; vend - vent ose vënt* etj. (por kur nuk janë në pozitë fundore shqiptohen të zëshme: *zogu, vendi*), ku [k]-ja dhe [t]-ja janë alofone pozicionale të [g]-së, respektivisht të [d]-së, sepse të zëshmet në fund të fjalës janë shurdhuar. Në gjuhën shqipe, zanoret në rrokje të hapur janë më të gjata se në rrokje të mbyllur. Khs. [kãm] ([ã] e shkurtër) – [ka:] ([a:] e gjatë), [mĩk] ([ĩ] e shkurtër) – [mi:] ([i:] e gjatë), [trẽg] ([ẽ] e shkurtër) – [tre:] ([e:] e gjatë) etj.

2) **Variante të lira** të së njëjtës fonemë kemi atëherë kur dy tinguj fonetikiqist të ngjashëm mund të përdoren në të njëjtin rrethim fonetik, pa sjellë ndryshime kuptimore. Variantet e lira nuk kanë kushtëzim fonetik, por ato kushtëzohen nga faktorë jashtëgjuhësorë, që mund të jenë territorialë, shoqërorë ose individualë. P.sh., variante të lira me kushtëzim territorial janë realizimet e fonemave /t/ dhe /d/ në dialektet e shqipes: në gegërishte këto fonema realizohen si dhëmbore, kurse në toskërishte si alveodhëmbore. Edhe fonemat /n/, /r/, /rr/, në të njëjtat kushte fonetike, nga folës të ndryshëm mund të nyjëtohen jo vetëm si tinguj apikalë, por edhe si kakuminalë, sipas shprehive individuale të folësve. Shpesh variantet e lira kanë konotacion gjeografik e dialektor, sepse tregojnë prejardhjen krahinore të folësit me tipare dialektore të shqiptimit.

Variantet krahinore lidhen drejtpërdrejt me përkatësinë territoriale të folësit. Në bazë të këtyre modulimeve pa ndonjë vështirësi mund të identifikojmë njeriun cilës të folme, krahine apo dialekti i përket. P.sh. fonemat e theksuara /í/ dhe /ú/ në të folmet e gegërishtes qendrore realizohen si diftongje: *âi, êi, ôi, êi* (*mírë > mâir, mêir, môir, mêtir*), respektivisht *âu, êu* (*nuse > nâuse, nêuse, të monoftonguar edhe në náse*), në shumë të folme të gegërishtes numërori pesë shqiptohet me [e] të gjatë të hapur shkallësh të ndryshme (*pɛ:s, pɛ:s, pɛ:s* etj.). Të gjitha këto janë alofone të fonemave /i/, /u/, /e/. Me variantet krahinore të fonemave do të njoftohemi më gjerësisht në lëndën e Dialektologjisë.

¹²⁶ Variantet kombinatorë të fonemave janë shtjelluar në kreun IV.

Variantet e lira që kushtëzohen nga veçoritë vetanake të folësve ose nga situata e të folurit, janë **variante individuale** të fonemave. Ato pasqyrojnë dallimet midis folësve në realizimin e fonemave: dallime që varen nga gjinia, mosha, gjendja emocionale, defekte të shqiptimit etj. dhe, meqenëse janë gjuhësisht të parëndësishme, nuk studiohen nga fonologjia.¹²⁷

Fonema mund të realizohet edhe në variante të ndryshme stilistike. **Variantet stilistike** shprehin ndjenja emocionale e stilistike dhe në rrjedhën e të folurit mund të realizohen në mënyra të shumta, si me ngritjen e tonit, zgjatjen e zanores dhe me mjete të tjera, si p.sh. *punë e maadhe, njeri i çudiiitshëm, sa miirë* etj.

5.3. TIPARET PËRBËRËSE TË FONEMAVE DHE KUNDËRVËNIET E TYRE

Variantet e fonemës janë tinguj fiziologjikisht dhe fizikisht të ndryshëm nga njëri-tjetri. Po si shpjegohet që folësit nuk i përkasin të gjitha dallimet tingullore dhe cilat prej këtyre dallimeve i përkasin? Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve, duhet parë si janë ndërtuar tingujt e ligjërimit. Çdo tingull i ligjërimit përbëhet nga veçori akustike dhe fiziologjike të caktuara. Këto veçori nuk janë njëloj të rëndësishme nga pikëpamja e funksioneve gjuhësore: disa janë rëndësore, disa jorëndësore. Kuptohet që veçoritë jorëndësore nuk vihen re nga folësit. Kurse veçoritë rëndësore përkapen prej tyre, sepse shërbejnë si bazë për bashkimin e një vargu tingujsh në një fonemë. Kështu, variantet bashkohen në një fonemë, pasi kanë të njëjtat veçori rëndësore, kurse dallimi mes tyre vjen ngaqë kanë veçori jorëndësore të ndryshme. P.sh. zanorja /a/ e fjalëve *kap, ka, kanë, ara* etj., me gjithë ndryshimet fizike e fiziologjike të tingujve në të cilët realizohet, përkapet si e njëjta fonemë, ngaqë këta tinguj kanë veçori rëndësore të përbashkëta.

Ndonëse nga pikëpamja lineare fonema paraqitet si njësi e pandashme më tej, nga pikëpamja e veçorive përbërëse ajo mund të ndahet më tej në njësi më të vogla që quhen **tipare përbërëse**. Pra, fonemat mund të shihen si *tufa tiparesh përbërëse të njëkohshme*. Disa prej tipareve të fonemës janë një realitet fizik që mund të përshkruhet duke përdorur terma nyjëtimorë ose akustikë, si: e zëshme, alveolare, shtegore, e hapur, kompakte, difuze etj. Por fonemat mund të karakterizohen edhe negativisht, siç ndodh në ato raste kur një tipar pozitiv që e ka një fonemë mungon te gjegjësjë e saj. P.sh., /b/ është buzore, e zëshme, mbylltore dhe johundore. Tri tiparet e para janë fizike, kurse tipari johundore është i pamatshëm, pra negativ: ai del vetëm nga kundërvënia e kësaj fonemeje me hundoren /m/.

Tiparet përbërëse të fonemës mund të jenë **dalluese** (distinktive) ose **jodalluese** (tepruese, redondante). Dalluese janë ato që e dallojnë një fonemë nga fonemat e tjera të një gjuhe, kurse jodalluese janë tiparet fizike që nuk

¹²⁷ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 100.

luajnë rol në dallimin e fonemave. P.sh., tiparet dalluese të fonemës /d/ të shqipes janë: (1) mbylltore, (2) alveolare ose alveolare-dhëmbore, (3) e zëshme dhe (4) johundore. Tipari i zëshmërisë e dallon atë nga e shurdhëta /t/ dhe johundorësia nga hundorja /n/.

Tiparet tepruese janë tipare fizike, por pa funksione dalluese. P.sh., fonemat /t/ dhe /d/ të shqipes dallohen nga tipari i zëshmërisë, por ky dallim, si rregull, shoqërohet edhe me një ndryshim në forcën e shqiptimit: /t/-ja nyjëtohet me një forcë më të madhe se /d/-ja; pra, sipas tiparit të forcës, /t/-ja është e fortë, kurse /d/-ja e butë. Megjithatë, edhe të mungojë tipari i forcës, këto dy fonema dallohen qartë; ndërsa, po të shurdhohet /d/-ja, d.m.th. po të mos realizohet tipari i zëshmërisë, [t]-ja e fortë dhe [t]-ja e butë nuk do të përkapen si dy fonema, por si dy variante të fonemës /t/. Pra, tipari i forcës në shqipe është teprues.

Dy fonema mund të dallohen midis tyre me një ose me disa tipare dalluese. Tipari i vetëm që dallon një çift fonemash, që gjithë tiparet e tjera dalluese i kanë të njëjta; quhet tipar korrelativ. Për shembull, fonemat /t/ dhe /d/ dallohen midis tyre vetëm nga pjesëmarrja e zërit. Tipari i zëshmërisë në këtë rast është tipar korrelativ. Në kundërvënien /i/ ~ /y/ të shqipes, tipar korrelativ është buzorëzimi: /i/ është jobuzore, kurse /y/ buzore. Dy tiparet e tjera, e përparme dhe e mbyllur, të cilat janë të përbashkëta për këtë çift fonemash, quhen *tipare jokorrelative*. Rëndësi të veçantë për ekzistencën e fonemave ka tipari korrelativ. Realizimi i tiparit korrelativ është i domosdoshëm për dallimin e dy fonemave nga njëra-tjetra; përkundrazi, shuarja e tij shpie në shkrirjen e dy fonemave.¹²⁸

Dallimet tingullore të pavarura nga pozicioni apo konteksti janë tipare dalluese, sepse ato shërbejnë për të dalluar njëren fonemë nga tjetra. Tiparet dalluese nxirren për gjuhën si tërësi nga sistemi i inventarit të fonemave, pavarësisht nëse ka apo jo jifte fonemash që kundërvihen vetëm me një tipar.¹²⁹

Të gjitha sistemet e tipareve dalluese që përdoren sot mbështeten në parimin jakobsian të *binarizmit*. Sipas këtij parimi, të gjitha tiparet fonologjike janë dyvlerëshe, gjë që kushtëzohet nga ajo që folësi, për të identifikuar praninë e një tipari, mbështetet në zgjedhje dyshe të tipit *po* ose *jo*. Pra, çdo fonemë karakterizohet me praninë (+) ose mungesën (-) e një tipari të caktuar. P.sh., nëse [\pm e zëshme] është një tipar dallues binar që lidhet me gjendjen e glotës, atëherë /t/ dhe /d/ dallojnë në tiparin [- e zëshme], përkatësisht [+ e zëshme].

Tiparet binare mund të përdoren për të përshkruar sistemin e bashkëtingëlloreve dhe të zanoreve të çdo gjuhe. Tiparet binare ndahen në grupe kryesore:

¹²⁸ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 100.

¹²⁹ Anastas Dodi – Jorgji Gjinari, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 20-25.

1. Tiparet e klasave kryesore të fonemave (që lidhen me dallimin e dy grupeve kryesore të fonemave: zanoreve dhe bashkëtingëlloreve).

2. Tiparet e vendit të formimit: [+ koronale] (majegjuhore), [+ të përparme], [+ të prapme];

3. Tipare të shkallës së hapjes: [+ e lartë], [+ e ulët];

4. Tiparet e mënyrës së formimit, që dallojnë nga njëra-tjetra mbylltoret, shtegoret dhe afrikatat: [+ e zgjatshme], [+ lëshim i vonuar], [+ e qartë], [+ e zëshme], [+ laterale].

Tiparet binare të fonemave të shqipes standarde në mënyrë tabelare duken kështu:¹³⁰

	zanoret	shtegoret e tingullta	hundoret	bashk. e zhurmëta
[+ konsonantike]	-	+	+	+
[+ silabike]	+	-	-	-
[+ sonorante]	+	+	+	-
[+ hundore]	-	-	+	-

Tabela 10. Tiparet binare të fonemave të shqipes standarde

Brenda një sistemi çdo fonemë dallohet nga fonemat e tjera, duke iu kundërvënë atyre në një ose në më shumë tipare. Dallimi midis dy fonemave të një sistemi quhet **kundërvënie fonologjike** (opozicion fonologjik). Kundërvënia fonologjike është një dallim fonetik me vlerë gjuhësore. P.sh., dallimi midis /p/ dhe /b/ lejon të kundërvihen fjalët *pesë* dhe *besë*, *pjeshkë* dhe *bjeshkë*, *pimë* dhe *bimë* etj. Fonemat që marrin pjesë në një opozicion quhen *gjymtyrë* të tij.

Çdo sistem fonologjik karakterizohet nga një numër i madh kundërvëniesh fonologjike. Por kundërvëniet që shfrytëzon një sistem fonologjik, nuk janë krejt të ndryshme nga njëra-tjetra. Midis tyre ka ngjashmëri e lidhje të caktuara, të cilat zakonisht karakterizohen në dy mënyra: (1) sipas raporteve midis gjymtyrëve të një çifti dhe (2) sipas raporteve midis një kundërvënieje me kundërvëniet e tjera të sistemit.

Sipas kriterit të parë, dallohen kundërvënie mungesore dhe jomungesore. Kundërvëniet janë *mungesore* (privative) atëherë kur njëra gjymtyrë e një jifti fonemash dallohet nga gjymtyra tjetër prej pranisë ose mungesës vetëm të një tipari dallues, d.m.th. kur njëra gjymtyrë e kundërvënies e ka atë tipar, kurse tjetra jo. P.sh., në kundërvënien /i/ ~ /y/, gjymtyrët dallohen vetëm nga tipari i buzorëzimit, i cili është i pranishëm te gjymtyra e dytë, por mungon tek e para; gjymtyrët e kundërvënies /f/ ~ /v/ dallohen nga tipari i zëshmërisë, që mungon te gjymtyra e parë.

¹³⁰ Po aty, f. 104.

Kundërvënie jomungesore kemi atëherë kur gjymtyrët e një jifti dallohen midis tyre në dy ose më shumë tipare. P.sh., në kundërvënien /p/ ~ /d/, gjymtyrët dallohen në dy tipare: për nga vendi i formimit dhe zëshmëria.

Sipas kriterit të dytë, dallohen kundërvënie të vejuara dhe përpjesëtimore. Kundërvëniet janë të vejuara kur tipari dallues i një jifti fonemash nuk përsëritet në kundërvënie të tjera. P.sh., kundërvënia /i/ ~ /y/ në shqipe është e veçuar, pasi tipari i buzorëzimit nuk gjendet në çifte të tjera fonemash.

Kur tipari dallues i një kundërvënieje përsëritet edhe në kundërvënie të tjera, d.m.th. kur gjenden dy a më shumë çifte fonemash që dallohen nga i njëjti tipar, kemi kundërvënie *përpjesëtimore*. Përpjesëtimore është kundërvënia e bashkëtingëlloreve të shqipes sipas tiparit të zëshmërisë: /p/ ~ /b/, /t/ ~ /d/, /q/ ~ /gj/, /k/ ~ /g/, /f/ ~ /v/ etj.

Tërësia e kundërvënieve që karakterizohen nga i njëjti tipar dallues, formon një bashkëlidhje. Çdo kundërvënie e bashkëlidhjes formon një *çift bashkëlidhës*. Në disa raste i njëjti tipar shërben për të dalluar disa fonema, me të cilin ato u kundërvihen fonemave të tjera. P.sh. fonemat si /d/, /g/, /b/, /v/ etj. karakterizohen nga tipari i përbashkët dallues - *të zëshme*, me të cilin ato u kundërvihen fonemave /t/, /k/, /p/, /f/ etj. që janë *të shurdhëta* në çiftet korrelative /t ~ d/, /k ~ g/, /p ~ b/, /f ~ v/ etj. Sipas këtij tipari, këto formojnë një *radhë korrelative* (tufë të bashkëlidhjes).

Tërësia e këtyre kundërvënieve quhet *bashkëlidhje* (korrelacion) e *zëshmërisë*. Në sistemin bashkëtingëllor, shqipja njeh edhe bashkëlidhje të tjera, si atë *të vendformimit* (të lokalizimit), korrelacionin e *mënyrës së formimit* (/p ~ f/, /b ~ v/, /t ~ th/, /d ~ dh/), *hundorësisë* (/b ~ m/, /d ~ n/, /gj ~ nj/).

Në sistemin zanor shqipja standarde ka bashkëlidhjen e *shkallës së hapjes*: zanore të mbyllura (/i, y, u/ ~ gjysmë të mbyllura (/e, ë, o/ ~ zanore të hapur /a/; *bashkëlidhjen e lokalizimit* (vendit të formimit): të përparme (/i, y, e/) ~ të mesme (/ë, a/) ~ dhe të prapme (/u, o/); *bashkëlidhjen e buzorëzimit*: zanore jobuzore (/a, e, i, ë/) ~ zanore buzore (/y, u, o/.

Fonemat sipas korrelacioneve bashkohen në tufë bashkëlidhjesh, po qe se një varg fonemash varen nga dy bashkëlidhje. Bashkëtingëlloret e shqipes formojnë tufë korrelacionesh katrore, meqë korrelacioni i mënyrës së formimit kryqëzohet me atë të zëshmërisë, p.sh.:




Fig. 39. Tufë korrelacionesh katrore të fonemave bashkëtingëllore

5.4. KUNDËRVËNIET NYJËTIMORE TË FONEMAVE ZANORE

Raportet e përbashkëta të fonemave formojnë strukturën fonologjike të gjuhës, d.m.th. sistemin e kundërvënieve të elementeve të saja. Një opozicion përcaktohet si raport që vihet midis dy njësisve. Për këtë kundërvënie duhet të ketë ndonjë bazë të përbashkët si dhe ndonjë tipar dallues për të hyrë në opozicion. Pa bazë të përbashkët nuk mund të ketë opozicione, por përkundrazi do të ketë vetëm kontraste. Që të mund të përcaktohet sistemi fonologjik, është e domosdoshme të njihen tipet e kundërvënieve ndërmjet fonemave.

Klasifikimi i zanoreve (që është paraqitur në figurat 30, 31, 32 etj.) që mbështetet në tiparet nyjëtimore të radhës, të ngritjes dhe të buzorëzimit njëkohësisht pasqyron edhe marrëdhëniet e sistemit të fonemave zanore të gjuhës standarde shqipe.

Tri shkallët e hapjes, tri radhët e formimit dhe mungesa ose prania e buzorëzimit të zanoreve në gjuhën shqipe përbëjnë **tipare dalluese të qëndrueshme**, që nuk varen as nga pozicioni as nga përndarja e tyre. Këto tipare realizojnë kundërvënien e të gjitha fonemave zanore të gjuhës shqipe. Por tiparet dalluese i nxjerrim nga kundërvënien e fonemave. Prandaj përmbajtja linguistike e këtyre tipareve nuk barazohet me veçoritë nyjëtimore të tingujve. P.sh. zanoret /i/ dhe /y/ janë të përparme e të mbyllura, kështu që formojnë vetëm një kundërvënie: atë të pjesëmarrjes së buzëve në nyjëtimin e tyre: /i/-ja është e pabuzorëzuar, ndërsa /y/-ja është e buzorëzuar. Edhe pse nga pikëpamja nyjëtimore midis [i]-së dhe [y]-së ka edhe dallime të tjera (që u përshkruan më parë), si p.sh. shkalla relativisht më e ulët e ngritjes tek [y]-ja sesa tek [i]-ja si dhe pozicioni më qendror i gjuhës të zanorja e parë; por, megjithëkëtë nga pikëpamja fonologjike këto dallime në gjuhën shqipe nuk përdoren për të dalluar njësi gjuhësore.

Veçoritë nyjëtimore që nuk përfshihen në tiparet dalluese përbëjnë karakteristikën fonetike integrale të fonemës, që përfshin tiparet dalluese dhe jodalluese, të cilat e përcaktojnë normën e realizimit të saj. Kështu, në sistemin e fonemave zanore hetohen:

- **tipare të përbashkëta** (bazë e përbashkët, tipare identifikuese por jodalluese) apo karakteristika të përbashkëta për dy e më shumë fonema dhe

- **tipare jo të përbashkëta** (tipare dalluese), në bazë të të cilave ato dallohen midis tyre. P.sh.:

Në kundërvënien (opozicionin) /i/ ~ /y/ bazë e përbashkët është radha e përparme dhe ngritja e lartë; ndërsa tipar dallues është mungesa, përkatësisht prania e buzorëzimit.

Në kundërvënien /e/ ~ /ë/ bazë e përbashkët është shkalla e hapjes (të dyja janë gjysmë të hapura) si dhe mungesa e buzorëzimit, ndërsa tipar

dallues është vendi i formimit, përkatësisht radha, sepse /e/-ja është e përparme, ndërsa /ë/-ja është qendrore.

Në kundërvënien /ë/ ~ /u/ bazë e përbashkët për të dy këto fonema është tipari se janë "zanore", kurse tipare dalluese janë hapja (gjysmë e mbyllur ~ e mbyllur), radha (qendrore ~ e prapme) dhe mungesa, përkundër pranisë së buzorëzimit (jobuzore ~ buzore).

Brendapërbrenda sistemit të fonemave zanore të shqipes standarde realizohen tri kundërvënie: **kundërvënia e shkallës së hapjes**, **kundërvënia e vendit të formimit** (apo e radhës së formimit) dhe **kundërvënia e buzorëzimit**.

1. Kundërvënia e shkallës së hapjes. Sipas tiparit të ngritjes së gjuhës, përkatësisht sipas gjerësisë së shtegut që krijohet midis pjesës më të ngritur të gjuhës dhe qiellzës, shqipja ka një sistem vokalik tri shkallësh: kundërvihen zanorja e hapur /a/ ~ zanoret gjysmë të hapura /e, ë, o/ ~ zanoret e mbyllura /i, y, u/.

Kundërvënia sipas tri shkallëve të hapjes mbështetet në sistemin e fonemave zanore të shqipes, sepse gjithë zanoret gjysmë të hapura u kundërvihen zanoreve të të dy hapjeve të tjera në bazë të këtij tipari.

Tipari i shkallës së hapjes shërben si i vetmi mjet për të dalluar fonemat në çiftet /i ~ e/, /u ~ o/, /ë ~ a/. Ndonëse, tiparin "e mbyllur" e ka edhe fonema /y/, porse kjo fonemë nuk merr pjesë në këtë kundërvënie, sepse shqipja nuk ka asnjë zanore tjetër të përparme të buzorëzuar. Grafikisht kundërvëniet sipas tipareve të shkallës së hapjes mund të paraqiten kështu:




Fig. 40.
zanore të shqipes
së hapjes

Kundërvëniet e fonemave
standarde sipas shkallës

2. Kundërvënia e vendit të formimit apo e radhës. Kundërvëniet që mbështeten në tiparin e radhës a të vendit të formimit në gjuhën shqipe janë trigjymtyrëshe: kundërvihen zanoret e përparme ~ zanoret qendrore ~ zanoret e prapme, përkatësisht /i, y, e/ ~ /ë, a/ ~ /u, o/. Edhe dallimi i tri radhëve të zanoreve në sistemin e fonemave zanore të shqipes mbështetet jo vetëm në tiparet nyjetimore, por pasqyron edhe marrëdhëniet e fonemave brenda këtij

sistemi. Bie fjala, zanorja qendrore /ë/ i kundërvihet zanores së prapme /o/ me tiparin e vendit të formimit.

Tipari i radhës shërben si i vetmi mjet për të dalluar fonemat në jiftet /y ~ u/ dhe /e ~ ë/. Ndonëse e përparme është edhe zanorja /i/, prapëseprapë ajo nuk merr pjesë në këtë kundërvënie, sepse në gjuhën shqipe nuk ka fonemë tjetër të prapme jobuzore, me të cilën /i/-ja do të formonte një jift fonemash, që të dalloheshin vetëm nga tipari i radhës (në kundërvëniet /i ~ u/ këto dy fonema dallohen nga dy tipare: nga radha dhe buzorëzimi). Për këto arsye, kanë tiparin e radhës së prapme fonemat /u/ dhe /o/.

Fonema /a/ është asnjë, nuk merr pjesë në kundërvëniet e vendit të formimit. Kundërvëniet sipas tiparit të vendit të formimit grafikisht mund t'i paraqesim kështu:




Fig. 41. Kundërvëniet e fonemave zanore të shqipes standarde sipas tiparit të vendit të formimit a radhës së formimit

3. Kundërvënia e buzorëzimit. Sipas tiparit të buzorëzimit kemi kundërvënien e zanoreve të buzorëzuara e të pabuzorëzuara.

Tipari i buzorëzimit është i vetmi mjet për t'i dalluar fonemat e jiftit /y ~ i/. Në të vërtetë, tiparin e buzorëzimit e kanë edhe fonemat /u/ dhe /o/, por megjithkëtë gjuha shqipe nuk ka zanore të tjera të prapme të pabuzorëzuara as të mbyllura e as gjysmë të mbyllura, andaj nuk formojnë jift fonemash të dallueshme vetëm nga ky tipar.

Fonema /a/ nuk merr pjesë në kundërvëniet e buzorëzimit. Te zanoret e mbyllura ekziston kjo lidhje e tiparit të vendformimit (të radhës) dhe të buzorëzimit, përkatësisht zanore e prapme ~ zanore e përparme: e buzorëzuar ~ e pabuzorëzuar.

Pra, zanoret /y/ ~ /i/ formojnë një kundërvënie mohore, gjymtyrët e së cilës karakterizohen njëra nga prania, tjetra nga mungesa e tiparit të buzorëzimit. Këto dy fonema formojnë një çift korrelativ, i cili në sistemin e zanoreve të shqipes është i papërsëritshëm, paraqitet i veçuar; sepse tipari dallues i buzorëzimit që karakterizon këtë kundërvënie nuk përsëritet në asnjë nga kundërvëniet e tjera të këtij sistemi.

Ngarkesa funksionale e kundërvënies së fonemave /i/ ~ /y/ në gjuhën shqipe nuk është e madhe, sepse me këtë kundërvënie dallohen një numër jo i madh fjalësh. Të tilla janë: /mik/ ~ /myk/, /pika/ ~ /pyka/, /di/ ~ /dy/, /rrymë/ ~

/rrimë/, /ti/ ~ /ty/, /mbill/ ~ /mbyll/, /sitë/ ~ /sytë/, /si/ ~ /sy/, /shita/ ~ /shyta/, /krihet/ ~ /kryhet/, /hija/ ~ /hyja/, /ndrij/ ~ /ndryj/, /hiri/ ~ /hyri/, /pije/ ~ /pyje/, /shtihem/ ~ /shtyhem/, /lihet/ ~ /lyhet/, /lihej/ ~ /lyhej/, /lira/ ~ /lyra/, /kiç/ ~ /kyç/ etj. Kjo shpjegohet me faktin që fonema /y/ përdoret në një numër relativisht të vogël fjalësh (në shumicën e rasteve si zanore e theksuar). Por duhet thënë se, megjithëqë përhapja e kësaj foneme është më e vogël se ajo e fonemave të tjera, denduria e përdorimit të saj nuk është e parëndësishme, meqë /y/-ja bën pjesë në disa nga fjalët më të përdorshme të gjuhës sonë, si p.sh. *sy, dy, ynë, yt, aty, pyll, yll, mbyll, hyj, shtyj, thyej, lyej* etj. Grafikisht kundërvënien sipas tiparit të buzorëzimit mund t'i paraqesim kështu:




Fig. 42. Kundërvënia e fonemave zanore të shqipes standarde sipas buzorëzimit

Nga ato që u thanë këtu, vokalizmi i shqipes nga pikëpamja fonologjike ka këto tipare:


a) **Paraqitet në formë trekëndëshi, sepse ka vetëm një zanore të hapur;**

b) **veprimi i kombinuar gjuhë-buzë është tri tipesh: /i, y, u/;**

c) **ka tri shkallë të hapjes dhe tri radhë formimi;**

d) **dallimet në hapjen dhe në vendin (radhën) e formimit vlejné si për zanoret e theksuara, ashtu edhe për të patheksuarat.**

Lidhjen e tri llojeve të kundërvënies (kundërvënien e shkallës së hapjes, të radhës dhe të buzorëzimit) në sistemin e fonemave zanore mund ta paraqesim kështu:



Tregues i llojit të vijave të përdorura për të shënuar kundërvëniet:

1. sipas tiparit të hapjes _____
2. sipas tiparit të vendformimit -----
3. sipas tiparit të buzorëzimit

Fig. 43. Kundërvënia e vendit të formimit, e hapjes dhe e buzorëzimit në sistemin e fonemeve zanore të shqipes standarde

Duke u mbështetur në kundërvëniet e sistemit të zanoreve të shqipes, mund të përcaktojmë tiparet dalluese të fonemave, që dalin nga jiftet bashkëlidhëse.

Fonema /i/ merr tiparet: "e mbyllur" (sepse ka /e/ që është gjysmë e mbyllur) dhe "e pabuzorëzuar" (sepse ka /y/ që është e buzorëzuar); ndërsa tipari "e përparme" nga kjo pikëpamje konsiderohet jodallues, për shkak se vetëm me këtë tipar ajo nuk i kundërvihet asnjë foneme tjetër.

Fonema /e/ ka tiparet dalluese: "e përparme" (sepse ka /ë/ që është qendrore) dhe "gjysmë e hapur" (sepse ka /i/ që është e mbyllur). Tipari i mungesës së buzorëzimit vlerësohet si jodallues.

Fonema /a/ merr si tipar dallues: "e hapur" (sepse /ë/-ja është gjysmë e hapur). Tiparet se është "qendrore" dhe "e pabuzorëzuar" vlerësohen si jodallues.

Fonema /y/ merr tiparet dalluese: "e përparme" (sepse /u/-ja është e prapme"), "e buzorëzuar" (sepse /i/-ja është e pabuzorëzuar). Tipari se është "e mbyllur" vlerësohet si jodallues, sepse me këtë tipar ajo nuk i kundërvihet ndonjë foneme tjetër.

Fonema /u/ ka si tipar dallues "e prapme" (sepse ka /y/ që është e përparme), "e mbyllur" (sepse ka /o/ gjysmë të mbyllur). Prania e buzorëzimit vlerësohet si tipar jodallues.

Fonema /o/ ka si tipar dallues "gjysmë e hapur" (sepse ka /u/ që është e mbyllur). Tiparet "e prapme" dhe "e buzorëzuar" vlerësohen si jodallues.

Fonema /ë/ ka si tipare dalluese: "gjysmë e hapur" (sepse ka /a/ që është e hapur) dhe "qendrore" (sepse /e/-ja është e përparme). Mungesa e buzorëzimit konsiderohet si tipar jodallues.

Nxjerrja në dukje e këtyre tipareve ka rëndësi për kufijtë e variacionit të fonemave.¹³¹

5.5. KUNDËRVËNIET E ZANOREVE SIPAS TIPAREVE AKUSTIKE

Kundërvëniet e zanoreve mund të përcaktohen edhe mbi bazën e tipareve akustike. Për këtë kundërvënie shfrytëzohen formantet e zanoreve, d.m.th. denduria dhe vendosja e tyre në zona të ndryshme të spektrit. Përshkrimi akustik i zanoreve mbështetet në dallimet në pozicionin e F_1 dhe F_2 në spektrin akustik të tyre.

¹³¹ Anastas Dodi – Jorgji Gjinari, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 45-51.

Fonemat zanore të shqipes formojnë kundërvënie sipas këtyre tipareve akustike:

- 1) **kompakte dhe difuze**;
- 2) **të mprehta dhe të rënda**;
- 3) **bemole dhe të thjeshta** (*jobemole*).

1. *Kundërvënia kompakte ~ difuze* (nga pikëpamja nyjëtimore: të hapura ~ të mbyllura).- Te zanoret kompakte të dy formantet përqendrohen në një zonë të ngushtë dhe qendrore të spektrit, në zonën rreth 1000 hc, në sajë të ngritjes së vlerave të F_1 . Te difuzet energjia tingullore shpërndahet në skajet e spektrit, d.m.th. F_1 është shumë e ulët, kurse F_2 mund të jetë larg ose afër tij (tek [i]-ja ndodhet larg, tek [u]-ja afër). Pra, formantet janë të larguara nga njëra-tjetra ose të vendosura në skajet e spektrit, qoftë edhe afër njëra-tjetrës.

Nga pikëpamja nyjëtimore, dallimi kompakte ~ difuze i përgjigjet tiparit të ngritjes së gjuhës, që përcaktohet me shkallën e hapjes së zanoreve: zanoret e hapura janë kompakte, ndërsa të mbyllurat janë difuze. Në sistemin e zanoreve të shqipes, si] duket edhe nga tabelat e paraqitura më parë, zanore tipike kompakte është /a/-ja. Zanoret e mbyllura /i, y, u/ konsiderohen difuze, duke u mbështetur në largesën e formanteve dhe në përqendrimin e energjisë në skajet e spektrit. Zanoret gjysmë të mbyllura /e, o, ë/ janë më difuze se zanoret e hapura (/a/-ja), por më kompakte se të mbyllurat (/i, u, y/).

2. *Kundërvënia të rënda ~ të mprehta* (nga pikëpamja nyjëtimore: të prapme ~ të përparme).- Te të parat energjia përqendrohet në zonën me denduri të ulët, te të dytat në zonën me denduri të lartë. Dallimi ndërmjet zanoreve të mprehta dhe të rënda mbështetet në vlerat e F_2 . Zanoret e rënda e kanë F_2 të ulët, pasi energjia tingullore përqendrohet në pjesën e poshtme të spektrit; ndërsa zanoret e mprehta e kanë F_2 të lartë, ngase energjia tingullore përqendrohet në zonat e larta të spektrit të tyre. Zanore tipike e mprehtë është [i]-ja, e rëndë [u]-ja, kurse [a]-ja zë një pozicion të ndërmjetëm. Përgjithësisht, zanore të rënda janë /u, o, ë/, ndërsa të mprehta /i, e, y/. Në të dëgjuar zanoret e rënda kanë një timbër të errët dhe të paqartë, pasi në to mbizotërojnë harmonikët me shpeshësi të ulët.

3. *Kundërvënia bemole ~ të thjeshta* – jobemole (i përgjigjet dallimit: të buzorëzuara ~ të pabuzorëzuara). Zanoret bemole karakterizohen nga një ulje e dendurive të larta, d.m.th. të F_2 (në krahasim me formantin F_2 të zanoreve të thjeshta). Zanore bemole është /y/-ja, jobemole /i/-ja. Si bemole merren edhe /u, o/-ja, ndërsa jobemole /a, e, ë/.

Opozicionet që u paraqitën më parë janë kundërvënie dyshe, binare. Por, në sistemin fonologjik të shqipes sipas tiparit të vendit të formimit dhe të hapjes, kundërvëniet kanë nga tri gjymtyrë: të përparme, qendrore, të prapme dhe të hapura, gjysmë të hapura, të mbyllura. Sipas kundërvënieve binare këto mund t'i paraqesim kështu: të përparme ~ jo të përparme, të prapme ~ jo të prapme dhe të hapura ~ jo të hapura, të mbyllura ~ jo të mbyllura.

Duke u përpjekur për të kombinuar tiparet nyjetimore dhe akustike, që shërbejnë si dalluese për çdo fonemë, sistemi i zanoreve të shqipës mund të paraqitet me tabelën e mëposhtme, ku shenjat plus (+) dhe minus (-) janë tipare dalluese, mbi të cilat mbështetet kundërvënia. Mungesa e shenjës tregon se ky tipar nuk është dallues për fonemën e dhënë në kundërvëniet mungesore.¹³²

Fonemat zanore	Të përparme ~ jo të përparme (të mprehta ~ jo të mprehta)	Të prapme ~ jo të prapme (të rënda ~ jo të rënda)	Të hapura ~ jo të hapura (kompakte ~ jo kompakte)	Të mbyllura ~ jo të mbyllura (difuze ~ jodifuze)	Buzore ~ jobuzore (bemole ~ të thjeshta)
/i/	+			+	-
/e/	+		-	-	
/a/			+		
/y/	+				+
/u/		+		+	
/o/			-	-	
/ë/	-		-	-	

Tabela 12. Paraqitje tabelare e kundërvënieve nyjetimore dhe akustike të zanoreve të gjuhës standarde shqipe

5.6. KUNDËRVËNIET E FONEMAVE BASHKËTINGËLLORE

Shqipja standarde ka një inventar të përbërë nga 29 fonema bashkëtingëllore, që lidhen midis tyre në mënyra të ndryshme, duke formuar një sistem mjaft të qëndrueshëm.

Kundërvënia e fonemave bashkëtingëllore përbrenda sistemit mbështetet në tiparet nyjetimore, akustike (që u shpjeguan) dhe funksionale. Bërthama e sistemit formohet nga 21 bashkëtingëllore të zhurmëta, ndërsa bashkëtingëlloret sonante formojnë katër grupe: hundore, dridhëse, anësore dhe mesore.

Mbi bazën e tipareve nyjetimore, sipas vendit të formimit, në gjuhën shqipe bashkëtingëlloret fonologjikiisht klasifikohen në *gjashtë radhë*: 1) buzore, 2) dhëmbore, 3) alveolare, 4) qiellzore-alveolare, 5) qiellzore, 6)

¹³² Zanorja /i/ si difuze i kundërvihet /e/-së si jodifuze, si edhe /u/-ja /o/-së. Por /e/, /o/ dhe /ë/ në sistem funksionojnë si jodifuze dhe jokompakte (në raport me /i/-në dhe /a/-në). Shih: Fonetika dhe ... I, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 51-53.

grykore, si edhe në *katër seri*: 1) mbylltore të shurdhëta, 2) shtegore të shurdhëta, 3) mbylltore të zëshme, 4) shtegore të zëshme.¹³³

Duke u mbështetur në bashkëlidhjet, fonemat bashkëtingëllore të shqipes standarde formojnë bashkëlidhjen e:

- a) **vendit të formimit,**
- b) **mënyrës së formimit,**
- c) **zëshmërisë dhe**
- ç) **të hundorësisë.**

a) **Kundërvënia e vendit të formimit.** Sipas vendit të formimit dallohen nëntë grupe bashkëtingëlloresh, që ndërmjet tyre formojnë kundërvënie: *buzore* /p, b, m/ ~ *buzore-dhëmbore* /f, v/ ~ *ndërdhëmbore* /th, dh/ ~ *alveodhëmbore* /t, d, ll/ ~ *alveolare* /n, l, c, x, s, z, r/ ~ *qjellzore-alveolare* /sh, zh, ç, xh, rr/ ~ *qjellzore* /q, gj, j, nj/ ~ *prapaqjellzore (grykore)* /k, g/ ~ *glotale (laringale)* /h/.

b) **Kundërvënia e mënyrës së formimit.** Tiparet e mënyrës së formimit lejojnë të dallojmë njërën nga tjetra bashkëtingëlloret mbylltore, shtegoret dhe afrikatat: *mbylltore* /p, b, t, d, q, gj, k, g/ ~ *shtegore* /f, v, s, z, sh, zh, h, th, dh, l, ll, j/ ~ *afrikate* /c, x, ç, xh/.

Kundërvëniet sipas radhës dhe mënyrës së formimit lidhen midis tyre, sepse një bashkëtingëllore, p.sh., /b/-ja bën pjesë në radhën /p, b, f, v/, si mbylltore që është i kundërvihet /v/-së (që është shtegore). Këtë lidhje mund ta paraqesim në këtë mënyrë:¹³⁴

	buzore	dhëmbore	alveolare	qjellzore- alveolare	qjellzore	grykore
	I	II	III	IV	V	VI
Mbylltore a) të shurdhëta	p	t	c	ç	q	k
e afrikate ¹³⁵ b) të zëshme	b	d	x	xh	gj	g
Shtegore: a) të shurdhëta	f	th	s	sh		h
b) të zëshme	v	dh	z	zh		-

Tabela 13. Kundërvëniet sipas vendit dhe mënyrës së formimit

¹³³ Anastas Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 94.

¹³⁴ Anastas Dodi – Jorgji Gjinari, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 81-82.

¹³⁵ Edhe afrikatat [c, x; ç, xh] për shkak se kanë fillim mbylltor (por mbarim shtegor) në shumë tekste janë trajtuar si mbylltore.

c) **Kundërvënia e zëshmërisë:** bashkëtingëllore të zëshme ~ të pazëshme. - Një nga bashkëlidhjet më të rëndësishme që e përshkon sistemin e fonemave bashkëtingëllore është korrelacioni i zëshmërisë. Ky vihet re te bashkëtingëlloret e zhurmëta, të cilat formojnë 10 çifte, të cilat dallohen sipas tiparit **e shurdhët ~ e zëshme**: /p ~ b/, /f ~ v/, /t ~ d/, /s ~ z/, /c ~ x/, /ç ~ xh/, /sh ~ zh/, /th ~ dh/, /q ~ gj/ dhe /k ~ g/. Siç duket edhe nga tabela që do të japim më poshtë, nga gjithë bashkëtingëlloret e zhurmëta, vetëm /h/-ja mbetet jashtë këtij korrelacioni, sepse nuk ka gje gjëse të zëshme.¹³⁶

bashkëtingëlloret e zhurmëta (obstruentet)											
të shurdhëta	p	f	t	s	c	ç	sh	th	q	k	h
të zëshme	b	v	d	z	x	xh	zh	dh	gj	g	-

Tabela 14. Kundërvënia e zëshmërisë

Korrelacioni i mënyrës së formimit lidhet me atë të zëshmërisë, duke formuar kështu një tufë katrore. Sipas tiparit të vendit të formimit, mënyrës së formimit dhe të zëshmërisë, sistemin e 21 fonemave jasonore të shqipes (të gjitha bashkëtingëlloret e tjera, përveç 8 sonanteve /m, n, nj, j, r, rr, l, ll/) mund ta paraqesim me tri përmasa në formën e një trupi gjeometrik, përkatësisht të një paralelopipedi të shtrirë:




Fig. 44. Korrelacioni i vendit të formimit, i mënyrës së formimit dhe i zëshmërisë

Dihet se sipas pjesëmarrjes së zhurmës, në sistemin e bashkëtingëlloreve dallojmë të zhurmëta dhe **sonore**. Nga 29 fonema bashkëtingëllore që ka shqipja standarde, 21 janë të zhurmëta dhe 8 sonore: /b, c, ç, d, dh, f, g, gj, h, k, p, q, s, sh, t, th, v, x, xh, z, zh/ ~ /m, n, nj, j, l, ll, r, rr/.

¹³⁶ Siç ka arabishtja p.sh. tri lloje të /h/-ve, që shqiptohen në thellësi të ndryshme të faringut: tingulli **he** shqiptohet lehtë prej thellësisë së krahërorit e për afërsisht i përgjigjet tingullit tonë h; tingulli **ha** nuk ekziston në gjuhën tonë, shqiptohet lëmueshëm duke shtrënguar fytyrën. As tingulli **hi** nuk ekziston në shqipen. Shqiptohet me zë të grrithshëm nga thellësia e fytyrës. Shih: Ebu Sakib, *Hyrje në shkronjat e Kur'anit*, Prizren, 2000, f. 36 -39.

Tipar i përbashkët që bashkon grupin e sonoreve dhe i cili e ndan nga grupi i bashkëtingëlloreve të zhurmëta është ai që: sonoret nuk dallohen sipas tiparit e *shurdhët ~ e zëshme*, por ato qëndrojnë jashtë korrelacionit që mbështetet në atë tipar. Bashkëtingëlloret sonore janë vetëm të zëshme dhe nuk kanë gjegjëse të shurdhëta.

Grupi i bashkëtingëlloreve sonore nuk është homogjen. Aty bëjnë pjesë hundoret /m, n, nj/, shtegoret /l, ll, j/ dhe dridhëset /r, rr/. Bashkëtingëlloret hundore /m, n, nj/ lidhen me të zhurmëtat /p-b/, /t-d/, /q-gj/ me bashkëlidhjen e hundorësisë. Në kundërvëniet /d/ ~ /n/ si tipar dallues shfrytëzohet hundorësia, ndërsa ndryshimi në vendin e formimit (/d/-ja dhëmbore, /n/-ja alveolare) fonologjikisht paraqitet si tipar redondant, që shoqëron dallimin e këtyre dy fonemave, të cilat realizohen si johundore ~ hundore. Fonemat /d/ dhe /n/ i kundërvihen njëra-tjetrës si paragjuhore hundore ~ johundore dhe jo (e para ~ të dytës) si dhëmbore ~ alveolare. Fonema /b/ i kundërvihet /m/-së me tiparin buzore ~ hundore, ndërsa /nj/-ja ~ /gj/-së: hundore ~ mesgjuhore.

ç) **Kundërvënia e kumbimit** (hundorësisë): *johundore ~ hundore*.- Një bashkëlidhje tjetër që përshkon sistemin e bashkëtingëlloreve është ajo e hundorësisë. Bashkëtingëlloret /m, n, nj/ me tiparin e hundorësisë u kundërvihen mbylltoreve /p ~ b, t ~ d, q ~ gj/, duke formuar kështu bashkëlidhjen e hundorësisë, e cila mund të paraqitet në këtë mënyrë:




Fig. 45. Kundërvënia e hundorësisë

Ky korrelacion nëpërmjet bashkëtingëlloreve /b, d, gj/ lidhet me bashkëlidhjet e paraqitura më lart, prandaj fonemat /m, n, nj/ janë të përfshira mirë në sistem.

Hundoret /m, n, nj/ bëjnë pjesë në atë që quhet bërthamë e sistemit, sepse lidhen me fonemat e tjera nëpërmjet këtij korrelacioni, në dallim nga sonoret e tjera /l, ll, r, rr/, që bëjnë pjesë në ato që quhen fonema skajore (marginale), sepse nuk kanë lidhje të këtilla me bërthamën.

Për shkak të lidhjes që kanë me bashkëtingëlloret e zhurmëta, hundoret /m, n, nj/ bëjnë pjesë në bërthamën e sistemit bashkëtingëllor dhe jo në fonemat skajore. Sonoret e tjera /l, ll, j, r, rr/ nuk marrin pjesë në korrelacione të rëndësishme, prandaj thuhet se ato qëndrojnë në skajet e sistemit.

/ll/-ja dhe /l/-ja veçohen nga të gjitha fonemat e sistemit, sepse janë të vetmet bashkëtingëllore anësore. Pra, shqipja ka vetëm këto dy bashkëtingëllore anësore. Karakteri fonematik i dallimit të tyre provohet në

çifte minimale fjalësh, si *llumi ~ lumi, thellë ~ thelë, llaku ~ laku, malli ~ mali, dell ~ del* etj. Fonemat /ll/ dhe /l/ dallohen midis tyre në këto tipare: e para e velarizuar ~ e dyta dhëmbore-alveolare. Duke qenë se /ll/-ja mund të nyjëtohet edhe si alveolare (ka variante që realizohen si tinguj alveolarë), megjithkëtë dallimi midis këtyre dy fonemave ruhet, meqë për tipar dallues shërben velarizimi. Pra, /ll/-ja i kundërvihet /l/-së (/l/ ~ /ll/) me tiparin *e velarizuar ~ e pavelarizuar*. Në raport me bashkëtingëlloret e zhurmëta, /ll/-ja afrohet më tepër me /dh/-në, me të cilën edhe mund përzihet në ndonjë të folme (dhallë > lla:ll).

Në grupin e sonoreve shtegore edhe bashkëtingëllorja /j/ zë një vend të veçantë. Është e vetmja sonore mesore. /j/-ja bën pjesë në grupin e bashkëtingëlloreve, megjithëse nga pikëpamja e veçorive akustike dhe nyjëtimore afrohet me zanoren /i/, duke marrë pjesë edhe në ndërrimet e tingujve me këtë zanore, p.sh. *ziej – zjeva, zjefsha; ndiej – ndjeva, ndjefsha; bie – bjer, shpie – shpjer* etj. Veç kësaj, në ndarjen e fjalëve në rrokje, ashtu si zanoret, /j/-ja bashkohet gjithnjë me bashkëtingëlloren paraprirëse, p.sh. *kuj-toj, paj-toj, kuj-des* etj.

Por, përkatësia e /j/-së në fonemat bashkëtingëllore dhe dallimi i saj nga zanorja /i/ provohet me kritere fonologjike, d.m.th. me rolin e tyre në formimin e bërthamës së rrokjes dhe të përndarjes (distribuímit), disa prej të cilave po i paraqesim këtu:

a) /j/-ja është tingull jorrokjeformues, ajo vetë nuk mund të formojë rrokje, kurse /i/-ja formon rrokje, qoftë edhe e patheksuar;

b) Në gjuhën shqipe ekzistojnë grupet **ji** dhe **ij**, p.sh. në fjalë të tilla si *ujit, pajis; fshij, vij* etj. Për shqipen standarde është normë shqiptimi i plotë i këtyre grupeve;

c) Në fund të fjalës janë të mundshme /i/ dhe /j/, p.sh. *ai* dhe *bëj*;

ç) /j/-ja dhe /i/-ja dallohen midis tyre edhe nga përndarja: /j/-ja s'mund të përdoret në fund të fjalës pas bashkëtingëlloreve (d.m.th. grupi bashkëtingëllore + /j/ në pozitë fundore në shqipen nuk është i mundshëm), ndërsa /i/-ja në këtë pozicion përdoret si zanore e theksuar ose e patheksuar, khs. *lirí, máli*;

d) Në pozicion ndërzanor është e mundshme vetëm /j/-ja dhe jo /i/-ja, si *rrufeja, kalaja, lexoja* etj;

dh) Në fillim të fjalës përpara zanoreve përdoret vetëm /j/-ja, ndërsa /i/-ja nuk mund të përdoret; kurse përpara bashkëtingëlloreve përdoret vetëm /i/-ja, ndërsa /j/-ja s'mund të përdoret.¹³⁷

Sistemi i fonemave bashkëtingëllore të shqipes standarde mund të paraqitet në mënyrë tabelore:

¹³⁷ Anastas Dodi – Jorgji Gjinari, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 80-88.

Vendi i formimit		Buzore		Gjuhore					Clotale		
		Dybuzore	Buzore-dhëmbore	Paragjuhore			Mes-gjuhore	Prapa-gjuhore			
Mënyra e formimit				Ndërdhëmbore	Alveo-dhëmbore	Alveolare	alveolare	Palato-	Qiełlzore	Grykore	
		Të zhurmëta	Mbylltore	p			t				q
b					d				gj	g	
Africate							c	ç			
							x	xh			
Shtegore			f	th			s	sh			h
			v	dh			z	zh			
Sonore	Hundore	m					n		nj		
	Anësore				ll	l					
	Mesore								j		
	Dridhëse						r				
						rr					

Tabela 15. Sistemi i fonemave bashkëtingëllore të shqipes standarde

Ky sistem i bashkëtingëlloreve të shqipes standarde grafikisht mund të paraqitet edhe kështu:




Fig. 46. Paraqitje grafike e sistemit të bashkëtingëlloreve të shqipes standarde

5.7. DENDURIA E PËRDORIMIT TË FONEMAVE

Krahas problemeve të inventarit të fonemave, përndarjes së tyre, karakteristikave nyjetimore e akustike të tingujve në pozicione të ndryshme në rrjedhën e ligjërimit, një rëndësi të madhe në studimet e sotme gjuhësore, veçanërisht në fushën e fonologjisë po marrin edhe të dhënat statistikore mbi dendurinë e përdorimit të fonemave të veçanta dhe të kombinimeve të tyre në ligjërimit.¹³⁸ Metodatat statistikore filluan të përdoren gjerësisht sidomos nga gjysma e dytë e shekullit të 20-të.

Është e nevojshme që sistemi i fonemave të studiohet edhe nga pikëpamja sasiore. Problemet që lidhen me anën sasiore të përdorimit të tonemave i takojnë një dege të rëndësishme të fonologjisë, *fonotaktikës*.

¹³⁸ Afërdita Canaj, *Mbi dendurinë e përdorimit të fonemave në shqipe, përjasur me frëngjishten*, në Studime filologjike 1-2, Tiranë, 1999, f. 104.

Fonoraktika merret me kufizimet që veprojnë në një gjuhë lidhur me përndarjen e tonemave në fjalë, me shoqërimet e mundshme të tonemave bashkëtingëllore e zanore, me strukturën rrokjesore të njësive të tilla bazë, si morfema dhe fjala. Pjesë e studimeve sasiore është edhe hetimi i dendurisë së përdorimit të tonemave në gjuhë dhe në ligjërim, me të cilat merret *gjuhësia statistikore*.¹³⁹

Denduria e përdorimit të fonemave në leksikon dhe në ligjërimin libror të gjuhës shqipe është e ndryshme. Njohja e përmasave të përdorimit të fonemave ka rëndësi teorike e praktike për ngarkesën e tyre funksionale për fonologjinë e morfologjinë, për kodifikimin e grafisë në informatikë, për teknikën grafike e mbi të gjitha për perceptimin e drejtë të fjalëve të shkruara. Frekuenca e fonemave zanore e bashkëtingëllore mund të matet në ligjërim, zakonisht në formën e shkruar dhe në fjalorët e shqipes. Deri më tani në gjuhën shqipe janë botuar disa punime me vlerë për dendurinë e fonemave në gjuhën e shkruar.

Metoda e analizës statistikore mund të përdoret për hulumtuar dendurinë e përdorimit të fonemave në tekstet e shkruara, të morfemave, të rrokjeve, të fjalëve etj. Analiza e leksemave shërben për të përcaktuar frekuencën e përdorimit të fonemave në leksik.

Siç dihet, alfabeti i shqipes ka 21 shkronja të thjeshta (a, b, c...) dhe 9 digrafe, shkronja dyshe (th, dh, gj, ll, rr, xh, sh, zh). Shkronjat dyshe zënë 6.4% të teksteve të shkruara, d.m.th. në 1000 fonema 64 janë digrafe.

Stili i shkrimtarit, pasuria leksikore e tij, përsëritja e fjalëve të njëjta, normat drejtshkrimore të papërvetësuara plotësisht te ne etj., janë faktorë që ndikojnë edhe në vlerat sasiore të përdorimit të fonemave dhe dallueshmërisë së një teksti nga teksti tjetër. Për këto arsye, për përcaktimin e dendurisë së fonemave përdoret edhe metoda leksikore.

Në gjuhësinë shqiptare studimet në fushën e fonotaktikës janë të pakta. Studime në këtë fushë kemi nga Faruk Besho, Afërdita Canaj, Agni Dika, Bahri Beci e Ermira Topi si dhe Rami Memushaj. Prof. Rami Memushaj ka bërë një hulumtim të hollësishëm për dendurinë relative të përdorimit të fonemave mbi një korpus të madh fjalësh. Ne po sjellim të dhënat e gjuhëtarit tonë të shquar:

140

bashkëtingëlloret			zanoret	
të pazëshme	të zëshme	të tingullta	e	10,120%
p 2,968%	b 1,156%	m 3,913%	ë	9,735%
f 0,974%	v 1,370%	n 6,043%	i	7,790%
th 0,517%	dh 1,021%	nj 0,652%	a	7,698%
t 8,501%	d 2,576%	j 2,652%	u	4,090%

¹³⁹ Rami Memushaj, *Fonetika e shqipes standarde*, Toena, Tiranë, 2009, f. 214.

¹⁴⁰ Rami Memushaj, *Fonetika e shqipes standarde*, Toena, Tiranë, 2009, f. 216.

s	3,446%	z	0,668%	l	1,551%	o	3,792%
c	0,371%	x	0,57%	ll	0,456%	y	0,753%
ç	0,310%	xh	0,052%	r	6,454%		
sh	2,504%	zh	0,065%	rr	0,451%		
q	0,988%	gj	0,604%				
k	3,458%	g	0,856%				
h	1,399%						
gjithsej:							
25,436%	8,425%	22,145	43,978%				
56,006%			43,978%				

Tabela 16. Denduria e përdorimit të fonemave

Në sistemin e fonemave të gjuhës, problemi i parë është raporti midis zanoreve dhe bashkëtingëlloreve në kuadrin e këtij sistemi. Shtatë fonemat zanore të shqipes përbëjnë 19.44%, ndërsa 29 bashkëtingëlloret 80.56% të inventarit të përgjithshëm të fonemave. Denduria e përdorimit të zanoreve është më e madhe se e bashkëtingëlloreve. Me përjashtim të fonemës /y/ që ka denduri të vogël përdorimi, zanoret e tjera zënë 6 vendet e para në sistemin e fonemave të shqipes.

Megjithëse bashkëtingëlloret përbëjnë 80.6% të numrit të përgjithshëm të fonemave të shqipes, ndërsa zanoret vetëm 19.4%, denduria e përdorimit në ligjëratë të këtyre dy grupeve të tingujve nuk është në përpjesëtim me numrin e tyre. Në një tekst të shkruar zanoret në gjuhën shqipe paraqiten me një denduri prej afër 44%, ndërsa bashkëtingëlloret me 56%. Nga kjo del se koeficienti konsonantik i shqipes është 1.23. Në greqishten e vjetër ky raport ka qenë 46.01% zanore, ndërsa 53.99% bashkëtingëllore; në frëngjishten 55% zanore dhe 45% bashkëtingëllore, në italisht 50% zanore dhe 50% bashkëtingëllore; në kroatisht 46.47% zanore dhe 53.53% bashkëtingëllore; në gjermanisht 38.35% zanore dhe 61.65% bashkëtingëllore.

Midis nyjetimit kompleks të fonemave dhe dendurisë së tyre të përdorimit ka një raport të zhdrejtë, përkatësisht **fonemat më të lehta për shqiptim përdoren më shumë, ndërsa fonemat më komplekse** (më të vështira në shqiptim) **përdoren më pak**.

Kështu, p.sh. të katër afrikatet /c/, /x/, /ç/, /xh/, që janë më komplekse zënë vendet e fundit në dendurinë e përdorimit të fonemave..

Zanoret e pabuzorëzuara /e, ë, i, a/ që konsiderohen jokomplekse zënë 36.56% të një teksti të caktuar, ndërsa të buzorëzuarat /y, o, u/ zënë tre vendet e fundit (vetëm me 8.29%) në dendurinë e përdorimit të zanoreve.

Gjatësia mesatare e një fjale në gjuhën tonë është afërsisht 4 fonema. Kjo gjatësi ndryshon brenda kufijve tek autorë të ndryshëm dhe varet sidomos nga stili funksional. P.sh. në stilin e veprave shkencore dhe teknike përdoren fjalë më të gjata se në stilin e letërsisë për fëmijë. Intelektualizimi i gjuhës letrare zakonisht çon edhe në përdorimin e fjalëve me një numër më të madh rrokjesh. Përgjithësisht, gjatësia mesatare e fjalëve shqipe është 1.77 rrokje.

Në gjuhën shqipe mbizotërojnë fjalët një-e dyrrrokëshe përbëjnë 80,72 të fjalëve të shqipes, kurse pjesën tjetër fjalët me tri e më shumë rrokje. Fjalët më të gjata se shtatërrrokëshe janë të rralla në shqipe. Por, me intelektualizmin e shqipes, me prirjet e reja për formimin e fjalëve të reja me bashkëngjitjen e dy e më tepër temave në një fjalë të vetme, përkatësisht me formimin e kompozitave, numri i fjalëve shumërrrokëshe po shtohet. Kur themi se pjesa më e madhe e fjalëve janë njërrrokëshe, në këtë peshon përdorimi i fjalëve shërbyese, si lidhëzat, nyjat, pjesëzat, parafjalët. Nga fjalët me kuptim leksikor të plotë mbizotërojnë ato që janë dyrrrokëshe.

Duhet përmendur gjithashtu si rregull i përgjithshëm se sa më e gjatë të jetë fjala, aq më pak përdoret. Prandaj shpesh kur fjalët me kuptim të plotë leksikor kthehen në fjalë shërbyese (me denduri të madhe përdorimi), ato zakonisht shkurtohen. Fjalët me denduri më të madhe përdorimi zakonisht kanë një numër më të madh kuptimesh kontekstuale.¹⁴¹

Analiza kombinatorë e fonemave

Studimi fonologjik nuk mund të jetë i plotë, nëse fonemat nuk shihen edhe nga pikëpamja sintagmatike. Studimi i përndarjes së tonemave në njësitë më zëmëdha gjuhësore është gjithashtu objekt i fonotaktikës, e cila mundësitë kombinatorë të fonemave i studion me metoda statistikore. Rezultatet e këtyre studimeve janë me interes për ata që krijojnë emërtime produktesh e markash të prodhimeve industriale, për njohjen automatike të të folurit etj., ato vlejné edhe për praktikën e mësimin të gjuhëve të huaja, pasi gjuha amtare dhe gjuha e huaj që mësohet nuk i kombinojnë njëllor fonemat.¹⁴²

Fonemat nuk kanë përndarje të njëjtë në fjalë, gjë që kuptohet lehtë, po t'i hedhësh një sy fjalorit të shqipes, ku vërehet se me disa fonema, si /ë/, /y/, /x/ e /xh/ fillojnë shumë pak falë. Përgjithësisht, zanoret përdoren shumë më pak se bashkëtingëlloret në fillim të fjalës. Me zanore fillojnë rreth 10,5% e fjalëve të Fjalorit të 2006-ës, dhe nga fjalët që nisin me zanore, më se 50% e tyre fillojnë me fonemën /a/. Sipas Beshos, afro 67% e fjalëve (fjalëformave) mbarojné me zanore. Pra, **shumica e fjalëve në gjuhën shqipe fillojnë me bashkëtingëllore dhe mbarojné me zanore.**

Zanoret përdoren rrallë në fillim të fjalëve. Me to fillojnë vetëm 8.02% e fjalëve, ndërsa me bashkëtingëllore (njëshe ose në grupe) fillojnë 91.98% e fjalëve. Nga bashkëtingëlloret nistore 47.79% janë të shurdhëta, 19.20% janë të zëshme dhe 24.99 % janë sonante.

Nga fonemat fundore të fjalëve më dendur përdoret /ë/-ja (29.23%), shqiptimi i së cilës në mjaft raste është reduktuar. Por, për të pasur një pasqyrë më të qartë të tingujve fundorë mund të përmendim faktin se me dy zanoret /e/ dhe /ë/ mbarojné rreth 44% e fjalëve. Shqipja bën pjesë në grupin e atyre gjuhëve, ku shumica e fjalëve mbarojné me zanore (rreth 67%) dhe vetëm 33%

¹⁴¹ Po aty, f. 203-207.

¹⁴² Rami Memushaj, *Fonetika e shqipes standarde*, Toena, Tiranë, 2009, f. 217.

mbarojnë me bashkëtingëllore. Pra shumica e fjalëve të shqipes nisin me bashkëtingëllore dhe mbarojnë me zanore.¹⁴³

Grupet e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve

Shqipja është gjuhë e pasur në grupe bashkëtingëlloresh e zanoresh. Një nga detyrat kryesore të fonotaktikës është të bëjë inventarin e këtyre kombinimeve dhe të zbulojë kufizimet në shoqërimet e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve. Gjuha shqipe është shumë më e pasur në grupe bashkëtingëlloresh sesa në grupe zanoresh; veç kësaj, në grupet e bashkëtingëlloreve numri i fonemave lëviz nga dy në katër, ndërsa grupet e zanoreve përbëhen vetëm nga dy fonema.

Gjuha shqipe ka vetëm grupe dyshe zanoresh. Kur fjalët e huazuara kanë grupe treshe, njëra nga zanoret e këtyre grupeve shqiptohet si bashkëtingëllore, si p.sh. shkruhet *kolokuium* dhe shqiptohet [kolokvium], shkruhet *herbarium* - shqiptohet [herbarium], shkruhet *kontribuoi* - shqiptohet [kontribuoj] etj.

Ka grupe zanoresh që janë të vetë shqipes, por ka edhe grupe që kanë hyrë bashkë me fjalët e huaja, si në fjalët *aureolë, aksion, kuotë, kaos, aortë, likuidim, asociim* etj. Grupet e zanoreve më të shpeshta në shqipen janë: *ia, ai, ua, ue, eu, iu, ye*; si edhe takimet e dy zanoreve të njëjta. Prej 49 grupeve të mundshme të zanoreve, realizohen vetë pak më shumë se gjysma e tyre.

Grupet e bashkëtingëlloreve

Në gjuhën shqipe kemi grupe bashkëtingëlloresh dyshe e treshe, që gjenden në fillim, në mes e në fund të fjalës. Nga 812 kombinime dyshe të mundshme të 29 bashkëtingëlloreve të shqipes, në morfemat rrënjë të saj dalin vetëm 241 grupe dyshe dhe 61 grupe treshe.

Grupe më të shpeshta dyshe janë: *mb, nd, ng, ngj, ft, fk, fsh, shk, sht, zg, zh, ps, tk, tm, ld* etj., ndërsa treshe janë: *mbl, mbr, mpr, ndr, ngr, skr, shtr, kthj, shpr, zbl, shkll, shtj, mbj, skl, skll, spr* etj. Më shumë grupe treshe dalin në fillim dhe në mes të fjalës, ndërsa grupet fundore janë të pakta dhe gjenden kryesisht në fjalë të huazuara. Nga grupet treshe të fonemave, në pozicion nistor dalin 29 grupe, në mes të morfemës rrënjë 35 grupe dhe në fund të morfemave rrënjë vetëm 8 grupe.¹⁴⁴

¹⁴³ Anastas Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 2004.

¹⁴⁴ Rami Memushaj, *Fonetika e shqipes standarde*, Toena, Tiranë, 2009, f. 224.

KREU VI

6. NDËRRIMET E FONEMAVE

Studimi i ndërrimeve morfologjike të fonemave në fushën e eptimit përbën problemin qendror të morfonologjisë së shqipes. Veç funksioneve të rëndësishme gramatikore, ato kanë një denduri pak a shumë më të madhe, në dallim nga ndërrimet e fjalëformimit, që përgjithësisht kanë një shtrirje më të kufizuar.¹⁴⁵

Gjatë lakimit, zgjedhimit dhe gjatë fjalëformimit e njëjta morfemë mund të paraqitet me dallime në përbërjen fonematike të saj, për shembull: *dash - desh, dal - del - dil*-ni, *plak - pleq, lepur - lepuj, vepër - vepr-a, letër - letr-a, blua*-j - *blo*-va, *zë - zi*-ni, *mbjell - mbill*-ni, *rreth - rrath-ë, derë - dyer, tingull - tingëll*-oj etj.

Ndryshimet fonemore kanë pasur dikur, por tani nuk kanë kushtëzim fonetik (ato quhen edhe “jofonetike”, por fonologjike), sepse nuk mund të shpjegohen me rregullsitë që veprojnë në gjendjen e sotme të gjuhës dhe këto këmbime fonemash kanë vlerë gramatikore ose semantike. Kështu, p.sh. në fjalët *dal, del, dola, dilni!* rrethimi fonetik i fonemave /a, e, o, i/ është asnjanes, përkatësisht i njëjtë (para kanë /d/-në dhe pas /l/-në). Këto ndryshime mund të shpjegohen vetëm me rregullsi fonetike që kanë vepruar në një fazë shumë më të hershme të shqipes. Dukuritë e këtilla janë *ndërrime historike të fonemave. Te ndryshimet fonemore kemi të bëjmë me dy fonema të ndryshme*. Këtu procesi fonetik i dikurshëm ka dhënë si përfundim një fonemë të ndryshme nga e para (ose edhe zero), d.m.th. është shkaktuar fonologjizimi i tyre. Veçori tjetër e ndërrimit të fonemave është edhe ajo se ato pasqyrohen në të shkruar (për dallim nga këmbimet fonetike që përgjithësisht nuk pasqyrohen në shkrim). Si të tilla mund të përmendim ndërrimet: /a ~ e/ (*dash ~ desh*),¹⁴⁶ /a ~ o/ (*dal ~ dol-a*); /k ~ q/ (*mik ~ miq*), /ll ~ j/ (*kungull ~ kunguj*), /e ~ #/¹⁴⁷ (*lule ~ lul#-ja*), /ë ~ #/ (*punë ~ pun#-a*) etj.

Duke u mbështetur në kriterin morfologjik, ndryshimet fonemore ndahen në *morfologjike dhe jomorfologjike*. Ndërrimet morfologjike shërbejnë

¹⁴⁵ Rahmi Memushaj, *Morfonologji e eptimit të gjuhës ...* f. 22.

¹⁴⁶ Shenja tilda ~ tregon ndërrimet e fonemave dhe kundërvëniet morfologjike të fjalëformave: /a ~ e/ (*dal ~ del*). Fonemat që hyjnë në këto kundërvënie quhen gjymtyrë të ndërrimit. Në ndërrimin e dhënë, d.m.th. /a/-ja është gjymtyrë e parë ose e majtë e ndërrimit, kurse /e/-ja është gjymtyrë e dytë ose e djathtë.

¹⁴⁷ Shenja # tregon gjymtyrën që mungon në ndërrimet e fonemave me zero: /e ~ #/ (*dele ~ del#-ja*) etj.

si shënuese të kuptimeve gramatikore, përkatësisht shërbejnë si mjet gramatikor për realizimin e kundërvënieve morfologjike (të numrit, rasës, vetës, kohës etj.). Në grupin e dytë përfshihen ato ndryshime fonemore që nuk kanë funksione morfologjike. Të tilla janë ndryshimet kombinatorë (alofonike dhe kombinatorë), si shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në pozicionin fundor ose para të shurdhëtash, zëshmimi i të shurdhëtave para bashkëtingëlloresh të zëshme, modifikimet e fonemave zanore e bashkëtingëllore etj.

Në gjuhën shqipe, ashtu si edhe në gjuhë të tjera indoevropiane me morfonologji të zhvilluar,¹⁴⁸ hasen:

- a) *ndërrime fonemore që shërbejnë si mjet i vetëm gramatikor dhe*
- b) *ndërrime fonemore që veprojnë krahas me ndajshitesat eptimore.*

Kuptohet që ngarkesa morfologjike e këtyre dy llojeve të ndërrimeve, d.m.th. roli i tyre në shprehjen e kuptimeve morfologjike të fjalëformave nuk është e njëjtë. Ndërrimet morfonologjike të llojit të parë (/a ~ e/ në *dash ~ desh*, /ll ~ j/ në *akull ~ akuj*, /a ~ e/ dhe /s ~ t/ te *ngas ~ nget* etj. dalin si mjet i vetëmjaftueshëm gramatikor, njëlloj si prapashtesat trajtëformuese të shumësit te emrat *gjumash-ë*, *bandill-ë*, *rregull-a* apo mbaresat vetore te folja: *puno-j - puno-n* etj. Këto ndërrime që shprehin kuptime gramatikore në mënyrë të pavarur, i quajmë ndryshe edhe "eptim (fleksion) i brendshëm."¹⁴⁹

Duke u mbështetur në kriterin fonemor dallohen:

- a) *ndërrime zanoresh*: zanore ~ zanore ose zanore ~ tog zanor e anasjelltas, ndërrimet e zanoreve ose të grupeve të zanoreve me zero (Z ~ Z ose Z ~ tog zanor, Z ~ #);
- b) *ndërrime bashkëtingëlloresh* (B ~ B ose B ~ # apo # ~ B);
- c) *ndërrime theksore.*

Në gjuhën shqipe ndryshimet fonemore kanë prekur mesin ose fundin e fjalës. Ndryshimet e fonemave nistore janë tepër të rralla në shqipen e sotme, sepse ato janë më të qëndrueshme ndaj ndryshimeve. Kjo shpjegohet me atë që për ndjenjën gjuhësore të shqipfolësit, ndryshimi i fonemës nistore të një morfeme shpie në prishjen e identitetit (kuptimit) të saj. Këmbime të fonemave nistore janë ndërrimi /a ~ e/ në *at ~ et-ër* dhe korrespondimet /a : e/ në *asht : esht-ra* e *anë : enë* dhe /k : q/ te *ka : qe*.¹⁵⁰ Ndërrimet e fonemave janë të kushtëzuara morfologjikisht, ngase kusht i ruajtjes së tyre në gjuhë janë funksionet morfologjike që kanë fituar.

Në paradigmen e emrit ndeshim këto kundërvëniet morfonologjike:

- Sipas numrit, *njëjës ~ shumë*, si *plak ~ pleq*, *popull ~ popuj* etj.;
- Sipas trajtës, *pashquarsi - shquarsi*: *ftua ~ ftoi*, *krua ~ kroi*;

¹⁴⁸ Gjuhë të tilla janë gjermanishtja, gjuhët sllave etj.

¹⁴⁹ Rahmi Memushaj, *Morfonologji e eptimit ...*, f. 57.

¹⁵⁰ Po aty, f. 70.

- Sipas rasës, rasa të drejta – rasa të zhdrejta ¹⁵¹ (emërore e kallëzore njëjës i pashquar ~ format e gjinore, dhanore e rrjedhore njëjës i pashquar): (një) *ftua* ~ (një) *ftoi*.

Në paradigmën e mbiemrit dallohen veç tjerash edhe ndërrime, që formojnë:

- Kundërvënie sipas gjinisë, *mashkullore – femërore: i ri ~ e re;*
- Kundërvënie sipas numrit, *njëjës – shumës: i madh ~ të mëdh-enj.*

Sistemi foljor i shqipes dallohet për numrin e madh të formave paradigmatiche dhe për larminë e kundërvënieve morfologjike që formojnë.

Këto mund të grupohen në:

- kundërvënie të vetave: khs. (unë) *dal* ~ (ti) *del, marr* ~ *merr;*
- kundërvënie të numrit: khs. (ti) *nxjerr* ~ (ju) *nxirr-ni;*
- kundërvënie të kohëve: khs. (e tashme) *dal* ~ (e kr. e thj.) *dol-a;*
- kundërvënie të mënyrave: khs. (dëft.) *hy-j* ~ (urdh.) *hyr!, vë ~ vër!;*
- kundërvënie të diatezës: khs. (formën veprorë me formën joveprorë) *shkrua-j* ~ *shkru-hem; lye-j* ~ *ly-hem etj.*¹⁵²

Gjatë evolucionit historik të gjuhës shqipe janë zhvilluar disa procese fonologjike me vlerë morfologjike, të cilat zakonisht quhen dukuri morfonologjike (morfologjike + fonologjike > morfonologjike > morfonologjike). Të tilla janë **qiellzorëzimi, metafoia, apofonia** etj.

Ndonjë nga dukuritë morfonologjike është shumë e vjetër, e përfutur qysh në gjuhën “nënë” të shqipes. Por shumica e dukurive të këtilla të shqipes së dokumentuar janë, në thelb, zhvillime të brendshme të vetë kësaj gjuhe, megjithëse procesi për ndonjë prej tyre mund të ketë nisur qysh në gjuhën “nënë” të saj.¹⁵³

6.1. QIELLZORËZIMI I FONEMAVE

Qiellzorëzimi a palatalizimi (lat. palatum = qiellzë) është dukuri morfonologjike e ndërrimit të një foneme joqiellzore në një fonemë qiellzore. Në gjuhën shqipe më së shpeshti qiellzorëzohen bashkëtingëlloret, por nuk janë të paktë edhe rastet e qiellzorëzimit të zanoreve. Nga bashkëtingëlloret qiellzorëzohen /k/-ja në /q/, /g/-ja në /gj/; /ll/-ja, /l/-ja dhe /r/-ja në /j/.

Duke u gjendur në pozitë para zanoreve të përparme, bashkëtingëlloret janë modifikuar: përkatësisht prapagjuhoret [k, g] në ligjërime kanë pasur nyjetim më të përparmë, ndërsa paragjuhoret [ll, l, r] nyjetim më të prapmë. Kështu, nën veprimin e përngjashmimit prapavajtës në kontakt, në rrjedhë të kohës, bashkëtingëlloret joqiellzore gradualisht janë bashkëpërputhur me

¹⁵¹ Rasa të drejta në gjuhën shqipe janë emërorja dhe kallëzorja, ndërsa tri të tjerat: gjinorja, dhanorja dhe rrjedhorja janë rasa të zhdrejta.

¹⁵² Rahmi Memushaj, *Morfonologji e eptimit të gjuhës së sotme ...*, f. 86.

¹⁵³ Shaban Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996, f. 120.

nyjëtimin qiellzor të [i]-së dhe në fund janë zëvendësuar plotësisht me bashkëtingëllore mesgjuhore.

Edhe në aspektin historik të zhvillimit të fonemave të shqipes, është vërtetuar se bashkëtingëlloret /q/ e /gj/ janë përfutur kryesisht nëpërmjet qiellzorëzimit të prapaqiellzoreve /k-/ dhe /g-/ nën ndikimin e gjysmëzanores /-i/, si edhe të zanoreve të përparme /-i/ dhe /-e/.¹⁵⁴ Bie fjala, emrat *peshk*, *kungull*, *lepur* etj. dikur shumësin e kanë formuar me prapashtesën -i: (një) *peshk* ~ (shumë) *peshki*, *kungull* ~ *kungi*, *lepur* ~ *lepri* etj. Këto forma shumësi edhe sot e kësaj dite ruhen nëpër disa të folme të gegërishtes.

Qiellzorëzimi i /k/-së në /q/. Ndërrimin /k/ ~ /q/ e gjejmë tek emrat mashkullorë, kryesisht të burimit shqip, por edhe të huaj. Nga rreth 400 emra që dalin me temë në -k, 87 prej tyre i nënshtrohen ndërrimit /k/ ~ /q/. Kështu, me qiellzorëzimin e /k/-së në /q/ nga forma e njëjësit shumësin e formojnë disa emra mashkullorë, si *ka* ~ *qe*, *mik* ~ *miq*, *peshk* ~ *peshq*, *fik* ~ *fiq*, *plak* ~ *pleq*, *bujk* ~ *bujq*, *ujk* ~ *ujq*, *armik* ~ *armiq*, *krushk* ~ *krushq* etj. Një numër emrash të tjerë, përveç ndërrimit të /k/-së fundore në /q/, marrin edhe mbaresën -e: *bark* ~ *barqe*, *bllok* ~ *blloqe*, *dushk* ~ *dushqe*, *qark* ~ *qarqe*, *rrezik* ~ *rreziqe*, *brisk* ~ *brisqe*, *furrik* ~ *furriqe*, *disk* ~ *disqe*, *hark* ~ *harqe*, *park* ~ *parqe*, *shkak* ~ *shkaqe* etj.; me qiellzorëzim e formojnë të kryerën e thjeshtë disa folje, si *pjek* ~ *poqa*, *ndjek* ~ *ndoqa*, *hjek* ~ *hoqa* etj.

Alternimi /k/ > /q/ është shumë i vjetër. Ai kishte pushuar së vepruari në periudhën e pushtimit turk, bile edhe në kohën e ardhjes së sllavëve në Ballkan (nga shekulli VI, VII). Megjithatë, disa fjalë që kanë hyrë vonë në gjuhën shqipe për analogji e bëjnë shumësin me qiellzorëzimin e /k/ > /q/: *oxhak* ~ *oxhaqe*, *bajrak* ~ *bajraqe*, *turk* ~ *turq*, *çek* ~ *çeqe* (fjalë fare e re në shqipen). Raste formimesh analogjike gjejmë edhe në palatalizimin e bashkëtingëlloreve të tjera.

Qiellzorëzimi i /g/-së në /gj/. Në gjuhën shqipe disa emra shumësin e formojnë duke qiellzorëzuar tingullin e fundit të temës /g/ në /gj/: *zog* ~ *zogj*, *burg* ~ *burgje*, *breg* ~ *brigje*, *shteg* ~ *shtigje*, *lëng* ~ *lëngje*, *varg* ~ *vargje*, *lug* ~ *lugje*, *deng* ~ *dengje*, *treg* ~ *tregje*, *trung* ~ *trungje* etj. I këtillë është edhe mbiemri *i vogël* ~ *të vegjël*. Siç shihet edhe nga shembujt e dhënë, shumica e emrave në shumësin, krahas qiellzorëzimit të tingujve të temës /g/ > /gj/, marrin edhe mbaresën /-e/. Me fjalë të tjera, si tregues i vetëm i shumësit ndërrimi i /g/-së në /gj/ del në pak raste (në pesë emra dhe në mbiemrin *i lig* ~ *të ligj*), por kryesisht e gjejmë të shoqëruar me mbaresën /-e/ (qiellzorëzimi /g/ ~ /gj/ i shoqëruar me /-e/ del në 46 emra). Me ndryshime morfonologjike të tingujve të temës krijohet edhe e kryera e thjeshtë e disa foljeve, si *djeg* ~ *dogja* etj.

Qiellzorëzimi i /ll/-së në /j/. Qiellzorëzohet edhe /-ll/-ja fundore e formës së njëjësit në /-j/ te disa emra mashkullorë, si p.sh.: *buall* ~ *buaj*, *grumbull* ~ *grumbuj*, *kungull* ~ *kunguj*, *portokall* ~ *portokaj*, *shekull* ~ *shekuj*,

¹⁵⁴ Po aty, f. 196.

mashkull ~ mashkuj, yll ~ yje, pyll ~ pyje, kërcell ~ kërcëj, akull ~ akuj, artikull ~ artikuj, djall ~ djaj, hamall ~ hamaj etj.

Qiellzorëzimi i /l/-së dhe i /r/-së në /j/. Me palatalizimin e /l/-së dhe të /r/-së në /j/ shumësin e bëjnë një numër i kufizuar emrash. Ndërrimi /l/ ~ /j/ ndeshet vetëm në pesë raste, ndërsa /r/ ~ /j/ del vetëm në tre emra me temë më -r, si *muskul ~ muskuj, kalë ~ kuaj; lepur ~ lepuj, flamur ~ flamu* (por edhe flamura), *bir ~ bij*; e kryera e thjeshtë e foljes *fle ~ fjeta* etj.

Qiellzorëzimi i zanoreve. Nën ndikimin e përngjashmimit të zanoreve nga bashkëtingëlloret, disa zanore në rrjedhë të kohës kanë fituar nyjëtim më të përparme, saqë tanimë janë shndërruar në zanore të përparme a palatale. Dukuria e kthimit të cilësdo zanore në ndonjë zanore tjetër më të përparme dhe më të mbyllur (zakonisht në /i/ ose /y/) quhet qiellzorëzim i zanoreve. Këtë dukuri disa gjuhëtarë me të drejtë e quajnë edhe metafoni.¹⁵⁵

Në gjuhën shqipe më së shpeshti qiellzorëzohen fonemat /e/ dhe /ë/ në /i/, si p.sh.:

/e/ > /i/: *jemi ~ jini; kemi ~ kini; merr ~ mirrni; dredh ~ dridhni ~ dridhja ~ dridhet; fsheh ~ fshihni ~ fshihja ~ fshihet; flet ~ flisni ~ flisja ~ flitet; pres ~ prisni ~ prisja ~ pritët; vete ~ vini ~ vija ~ vihet; ngre ~ ngrini ~ ngrija ~ ngrihet; fle ~ flini ~ flija ~ flihet* etj. Ndërrimi /e/ ~ /i/ shërben si tregues i mëvetësishëm gramatikor i gjinisë të numërori *tre ~ tri*: forma *tre* përdoret para emrash mashkullorë, kurse *tri* para emrash femërorë.

/ë/ > /i/: *lë ~ lini ~ lija ~ lihet; vë ~ vini ~ vija ~ vihet; zë ~ zini ~ zija ~ zihet* etj.

Vlen të përmendim se në gjuhën shqipe kemi qiellzorëzim të fonemave zanore me vlerë fonologjike, pra gramatikore dhe qiellzorëzim tingujsh pa vlerë fonologjike. Qiellzorëzimi i fonemave zanore në gjuhën shqipe ka karakter morfonologjik (dëshmi për këtë janë shembujt e sjellë).

Në të folmet e shqipes, krahas palatalizimit të fonemave kemi edhe palatalizim të tingujve. Qiellzorëzimi i tingujve zanorë në rrafshin dialektor, veçmas në të folmet e gegërishtes, si dukuri fonetike është e shpeshtë. Zanorja që palatalizohet më shumë është [ë]-ja, sidomos kur është në rrokje të patheksuar: *një > nji* ose *ni, lëkurë > liku:r, qëlloj > qilloj, gjëmoj > gjimuj* etj., por edhe [e] > [i], si *gjendem > gjindem, qengj > kingj, qëndron > çinron, shënik > shinik* etj. Palatalizim kemi edhe në rastet e kthimit të [u]-së në [y], kur ky kthim bëhet për shkak të bashkëtingëlloreve qiellzore, si *grurë > i grunjtë > i gryntë > i gry:t; ushqim > ushqym > yshym* etj.

¹⁵⁵ Anastas Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 120.

6.2. METAFONIA

Fjala *metafoni* rrjedh nga greqishtja: *meta* = parashtesë që tregon zhvendosje, me kuptimin *pas + phon* = tingull (gjermanisht *um-laut*).

Metafonia është ndërrim historik i fonemave, si pasojë e të cilit fitohet një zanore e përparme. Në kuptimin më të ngushtë të fjalës metafoia përfshin shndërrimin e /a/-së së theksuar në /e/ dhe të /e/-së në /i/ (kjo e fundit quhet edhe metafonizim i mëtejme) te disa fjalë. Këto alternime fonologjike historike të shqipes, ashtu si edhe këmbimet e tjera historike të fonemave, janë morfologjizuar.

Ndërrimi /a/ ~ /e/ është një ndër këmbimet më të shpeshta të fonemave. Në "Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe" (Prishtinë, 1981) ky ndërrim ndeshet në 29 raste. Si mjet i vetëm gramatikor del në pak emra (të tipit *cjap ~ cjep, dash ~ desh, vllah ~ vllëh* etj.), në 7 emra të tjerë shoqërohet edhe nga ndërrime bashkëtingëlloresh (*plak ~ pleq*), kurse për formimin e shumësit të disa emrave, krahas metafonisë përdoren edhe prapashtesat e shumësit (më shpesh *-e, -ër, si gardh ~ gjerdh-e, kunat ~ kunet-ër*).¹⁵⁶

Historikisht metafoia ka lindur nga dukuria fonetike e përngjashmimit (asimilimit) prapavajtës (regresiv) në largësi; përkatësisht zanorja e theksuar [a] ose [e] e një fjale nën ndikimin e zanores fundore më të mbyllur se ato, zakonisht nën ndikimin e [i]-së së gjatë të patheksuar, është shndërruar në një zanore të përparme. [i]-ja e gjatë e patheksuar që ka shkaktuar palatalizimin e zanores përpara saj, më vonë ka rënë, duke lënë gjurmë nganjëherë edhe në qiellzorëzimin e bashkëtingëlloreve, pranë së cilës ka qenë. P.sh.: *dash ~ desh* (historikisht nga një *dashi), *plak ~ pleq* (historikisht nga një *plaki), *natë ~ net* (historikisht nga një *nati).

Shndërrimet metafonike i vëmë re në:

a) **Shumësin e disa emrave:** *dash ~ desh, plak ~ pleq, natë ~ net* (të shënuar për herë të dytë), *ka ~ qe, djalë ~ djem, atë ~ etër, asht ~ eshtra, shtrat ~ shtretër, kunat ~ kunetër, mëzat ~ mëzetër* etj.

b) **Në format flektive të disa foljeve,** gjegjësisht në vetën e dytë e të tretë njëjës të kohës së tashme të mënyrës dëftore te një numër i kufizuar foljesh: (unë) *dal ~ (ti; ai, ajo) del, jap ~ jep, marr ~ merr, vras ~ vret, bërtas ~ bërtet, rrah ~ rreh, ngas ~ nget, flas ~ flet* etj.¹⁵⁷

Ndërrimi /e/ ~ /i/, që quhet edhe metafonizim i mëtejme, historikisht është më i vonë se këmbimi i fonemave /a/ ~ /e/; sepse shpeshherë /e/-ja ka dalur nga /a/-ja, si (unë) *vras ~ (ti) vret ~ (ju) vritni, ngas ~ nget ~ ngitni, flas ~ flet ~ flitni, dal ~ del ~ dilni* etj. Megjithatë, shembujt si foljet *heq ~ hiqni, pres ~ prisni, ndez ~ ndizni* dhe shumësi i emrave *breg ~ brigje, shteg ~ shtigje* dëshmojnë se në alternimin /e/ ~ /i/, /e/-ja nuk vjen gjithnjë nga /a/-ja.

¹⁵⁶ Rahmi Memushaj, *Morfologji e eptimit të gjuhës ...*, f. 110-111.

¹⁵⁷ Te ndërrimet e përkundërta /-e-/ > /-a-/ të emrave *rreth ~ rrathë, thes ~ thasë* do pasur parasysh se trajtat me /-e-/ janë forma shumësi të singularizuara. Te foljet *njoh ~ njeh, shoh ~ sheh* është përfutur metafoia /o/ ~ /e/.

Megjithkëtë, shndërrimi /e/ ~ /i/ historikisht është më i vonë se /a/ ~ /e/, sepse në shumë raste metafonia ka kthyer njëherë /a/-në në /e/, ndërsa më vonë /e/-në në /i/.

Megjithëse ka pushuar së qeni prej kohësh dukuri e gjallë (prodhimtare), metafonia, si dukuritë e tjera morfonologjike, ka lënë gjurmë të dukshme në strukturën gramatikore të shqipes dialektore e standarde.

Metafonia ka pushuar së vepruari qysh në periudhën para kontakteve të shqipes me sllavishten e Ballkanit. Kjo dëshmohet me atë se emrat e huazuara në gjuhën shqipe me burim sllav shumësin e formojnë pa metafoni. P.sh.: (një) *çekan* ~ (shumë) *çekanë*, *kovaç* ~ *kovaçë*, *grazhd* ~ *grazhde* etj. Format e shumësit me metafoni të disa huazimeve sllave, si *kulaç* ~ *kuleçë*, *prag* ~ *pregj* (por edhe *prag* ~ *pragje*) janë formime analogjike.¹⁵⁸

6.3. APOFONIA

Termi *apofoni* rrjedh nga greqishtja: *apo* - parashtesë që tregon idenë e shmangies + *phon* - tingull (është kalk i fjalës gjermane *ab-laut*). Është dukuri morfonologjike që shqipja e ka trashëguar nga “nëna” e saj. *Apofonia është ai ndërrim historik, si pasojë e të cilit fitohet një zanore e prapme*. Apofonia në kuptimin e ngushtë të fjalës përfshin ndërrimet e zanoreve /a/ dhe /e/ të theksuara (por edhe /ie ose je/) në /o/.

Këto shndërrime vihen re kryesisht në sistemin foljor. Me këtë ndërrim fonetik historik, tani më të fonologjizuar, në gjuhën shqipe është krijuar kundërvënja e disa foljeve të kohës së tashme (prezent) dhe formave të tyre në të kryerën e thjeshtë (aorist). P.sh.:

koha e tashme		e kryera e thjeshtë	koha e tashme		e kryera e thjeshtë
<i>dal</i>	~	<i>dola</i>	<i>marr</i>	~	<i>mora</i>
<i>bredh</i>	~	<i>brodha</i>	<i>dredh</i>	~	<i>drodha</i>
<i>hedh</i>	~	<i>hodha</i>	<i>heq</i>	~	<i>hoqa</i>
<i>djeg</i>	~	<i>dogja</i>	<i>nxjerr</i>	~	<i>nxora</i>
<i>sjell</i>	~	<i>solla</i>	<i>vjel</i>	~	<i>vola</i>
<i>pjek</i>	~	<i>poqa</i>	<i>mbledh</i>	~	<i>mblodha</i>
<i>ndjek</i>	~	<i>ndoqa</i>	<i>vjell</i>	~	<i>volla</i>
<i>pjell</i>	~	<i>polla</i>	<i>rrjedh</i>	~	<i>rrodha</i> ¹⁵⁹

Tabela 17. Folje apofonike



Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi i foljeve apofonike

Foljet, te të cilat /a/-ja apo /e/-ja e theksuar e rrënjës shndërrohet në /o/ quhen **folje apofonike**. Foljet apofonike që dalin me temë në **-l**, **-ll** dhe **-rr**

¹⁵⁸ Shaban Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996, f. 131.

¹⁵⁹ Në FGjSSH janë shënuar 28 folje me ndërrimin /je/ ~ /o/.

nuk marrin ndajshitesën **-ur** në format e pashtjelluara. Prandaj themi: *për të dalë* (dhe jo për të dalur), *për të marrë* (dhe jo për të marrur), *për të vjelë* (dhe jo për të vjelur), *për të mbjellë* (jo për të mbjellur). Rrjedhimisht, edhe mbiemrat e formuar prej këtyre pjesoreve të foljeve (që quhen mbiemra prejfoljorë, më saktësisht mbiemra prejpjesorë) përdoren pa **-ur**: *i (e) dalë, i (e) marrë, i (e) mbjellë*.

Foljet apofonike që në të tashmen mbarojnë me **-rr**, në të kryerën e thjeshtë shqiptohen dhe shkruhen me **-r**: *bjerr ~ bora, bore, bori, borëm etj.; çjerr ~ çora, çore, çori, çorëm etj.; marr ~ mora, more, mori, morëm etj.; nxjerr ~ nxora, nxore, nxori, nxorëm etj.; tjerr ~ tora, tore, tori, torëm etj.* Foljet e tjera joapofonike e ruajnë **rr**-në edhe në të kryerën e thjeshtë: *korr ~ korra, mburr ~ mburra, tkurr ~ tkurra etj.*¹⁶⁰

Vjetërsia e apofonisë. Foljet apofonike të përmendura i përkasin fondit të trashëguar indoevropian të gjuhës shqipe. Në këtë grup foljesh nuk bën pjesë asnjë fjalë e huazuar. Pra, apofonia është një ndër dukuritë më të moçme të gjuhës sonë, ajo është e periudhës parahistorike të shqipes.¹⁶¹

A ka shqipja apofoni kuantitative apo vetëm apofoni kualitative?

Apofonia është dy llojesh: kualitative (cilësore) dhe kuantitative (sasiore). Me apofoni kualitative (siç mund të shihet nga shembujt e dhënë) kuptojmë ndryshimin e cilësisë së tingujve brenda fjalëve, që shfaqet nëpërmjet ndërrimit të timbrit të zanores, përkatësisht kalimit nga një fonemë zanore në një tjetër; ndërsa me apofoni kuantitative kuptojmë ndryshimin e shkallës së gjatësisë së zanoreve, që shfaqej nëpërmjet kundërvënies fonologjike *zanore e shkurtër ~ zanore e gjatë*. Apofonia kualitative është morfologjizuar, ajo shërben për diferencimin e formave morfologjike të fjalëve.

Në shqipen e dokumentuar ndeshen edhe pak gjurmë të apofonisë së hershme sasiore. Por, përgjithësisht apofonia e hershme kuantitative (që lidhet me theksin muzikor) e indoevropianishtes, në gjuhën shqipe del si apofoni kualitative, ku zanoret kanë të njëjtën gjatësi, por ndryshojnë në llojin e tyre.

Të gjithë shembujt e sjellë deri më tani dëshmojnë për apofoni kualitative.

6.4. NDËRRIME TË TJERA MORFONOLOGJIKE

Në eptimin emëror dhe foljor të shqipes së sotme vërtetohen gjithsej 58 ndërrime fonemore, të cilat shërbejnë si mjet për shënimin e kuptimeve morfologjike në të gjitha kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit (veç kategorisë së shkallës) dhe të foljes. Numri më i madh i ndërrimeve të eptimit dhe roli i tyre i rëndësishëm në formimin e paradigmave emërore dhe foljore e bëjnë shqipen një gjuhë me sistem morfonologjik shumë të zhvilluar, saqë shqipja mund të konsiderohet si një nga gjuhët më morfonologjike të Evropës. Por, shumica dërrmuese e ndërrimeve të eptimit të shqipes dalin si mjete

¹⁶⁰ Remzi Nesimi, *Gramatika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme (fonetika, leksikologjia dhe morfologjia) I*, Shkup, 1997, f. 30.

¹⁶¹ Shaban Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996, f. 123-124.

gramatikore plotësuese, sepse ndërrimet dalin gjithmonë krahas ndajshtesave eptimore, d.m.th. me ngarkesë morfologjike jo të plotë.

Megjithkëtë, ndërrimit të fonemave nuk duhet mohuar funksionet gramatikore, ngaqë ato janë bërë të domosdoshme në paradigmën emërore dhe foljore të shqipes. Në këtë mënyrë, duke qenë se këmbimet e fonemave prekin temën e fjalës, ndërrimet shërbejnë kryesisht si mjete *temëformuese* e *temëdalluese*. Prandaj edhe thuhet shpesh se funksioni i ndërrimeve është t'i bëjnë më të spikatura kundërvëniet e fjalëformave.

Ndërrimet vokalice dhe ato konsonantike të eptimit emëror dallojnë midis tyre nga funksionet gramatikore që kryejnë. *Ndërrimet e zanoreve* shërbejnë si mjet gramatikor në një radhë kundërvëniesh morfologjike, si në *kundërvëniet njëjës ~ shumës, rasa të drejta ~ rasa të zhdrejta, pashquarsi ~ shquarsi* dhe *gjini mashkullore ~ gjini femërore*; kurse *ndërrimet e bashkëtingëlloreve dalin vetëm në kundërvënien sipas numrit*.

Ndërrimet morfonologjike kanë një denduri të madhe në sistemin foljor si në klasat e ndryshme të foljeve, ashtu edhe në thellësi (në paradigmën e zgjedhimit të këtyre foljeve). Atyre u nënshtrohen klasa të tëra foljesh, që arrijnë në disa mijëra, d.m.th. shumica e foljeve të shqipes; ndërsa foljet që e ruajnë të pandryshuar temën e tyre gjatë zgjedhimit përbëjnë vetëm një pjesë të vogël. Kështu, foljet me ndërrime, mbi 3000, përbëjnë më shumë se 2/3 e numrit të përgjithshëm prej rreth 4500 foljesh që jep FGjSSh (Prishtinë, 1981). Pësojnë ndërrime zanoresh ose bashkëtingëlloresh shumica e foljeve që dalin me temë më zanore (rreth 2500, kundërt më pak se 200 foljeve me temë më zanore pa ndërrime) dhe një pjesë jo e vogël e foljeve me temë më bashkëtingëllore (afër 600).

Krahas ndërrimeve të shtjelluara të fonemave zanore e bashkëtingëllore, në sistemin emëror (përfshirë edhe mbiemrat) e foljor të gjuhës shqipe ka edhe një numër të konsiderueshëm këmbimesh të tjera. Të tilla janë këto ndërrime zanoresh:

- 1) /a/ ~ /ua/: *kalë ~ kuaj*;
- 2) /e/ ~ /ye/: *derë ~ dyer*; foljet e tipit (këmbej) *këmbeva ~ këmbyem*, (kursej) *kurseva ~ kursyem*, (rrëmbej) *rrëmbeva ~ rrëmbyem* etj.;
- 3) /i/ ~ /je/: *vit ~ vjet*;
- 4) /o/ ~ /e/: *i vogël ~ të vegjël*;
- 5) /o/ ~ /ua/: *dorë ~ duar*; foljet e klasës *mëso-j ~ mësuva-m, lexo-j ~ lexua-m, përparo-j ~ përparua-m* etj.;
- 6) /ua/ ~ /a/: *grua ~ gra*;
- 7) /ua/ ~ /o/: (një) *ftua ~ ftoi*, (një) *krua ~ kroi*, (një) *përrua ~ përroi*; foljet *blua-j ~ blo-va, shkrua-j ~ shkro-va* etj.;
- 8) /ua/ ~ /u/: *shkrua-j ~ shkru-hem, blua-j ~ blu-het, gjuaj ~ gju-het, qua-j ~ qu-het* etj.;
- 9) /ye/ ~ /y/: *lye-j ~ ly-hem, thyej ~ thy-hem, fyje ~ fy-hem* etj.;
- 10) /a/ ~ /ë/: *i madh ~ të mëdhenj*;
- 11) /e/ ~ /ë/: *i keq ~ të këqinj*;
- 12) /ë/ ~ /u/: *dhëndër ~ dhëndur-ë*;

- 13) /*ë*/ ~ /*#*/: *vegël* ~ *veg#-l-a*, *vepër* ~ *vep#r-a*, *vajzë* ~ *vaj#z-a*; *i sotëm* ~ *e sot#me*, *i sjellshëm* ~ *e sjellsh#m-e*;
 14) /*i*/ ~ /*#*/: *njeri* ~ *njer#-ëz*;
 15) /*e*/ ~ /*#*/: *lule* ~ *lul#-ja*, *e sjellshme* ~ *e sjellshm#-ja*, *e mesme* ~ *e mesm#-ja* etj.

Ndërrimet e bashkëtingëlloreve janë më të kufizuara në numër krahasuar me ndërrimet e zanoreve, por të parat kanë denduri më të madhe dhe disa prej tyre janë edhe vepruese. Më rrallë dalin këto ndërrime:

- 1) /*l*/ ~ /*m*/: *djalë* ~ *djem*;
- 2) *#* ~ /*r*/: (një) *dre#* ~ (një) *drer-i*, (një) *mulli#* ~ (një) *mullir-i*, (një) *pe#* ~ (një) *per-i*, (një) *kufi* ~ (një) *kufir-i*;
- 3) /*s*/ ~ /*t*/: *flas* ~ *flet*, *ngas* ~ *nget*, *vras* ~ *vret*, ... (gjithsej 36 folje);
- 4) /*t*/ ~ /*s*/:¹⁶² *përshëndet-ja* ~ *përshëndes-te*, *kosit-ja* ~ *kosis-te*, *kullot-ja* ~ *kullot-te*, *flit-ja* ~ *flis-te* etj.;
- 5) /*rr*/ ~ /*r*/: *bjerr* ~ *bor-a*, *çjerr* ~ *çor-a*, *kacavirr-em* ~ *u kacavor-a*, *nxjerr* ~ *nxor-a*, *tjerr* ~ *tor-a*, *marr* ~ *mor-a* etj.;
- 6) /*s*/ ~ *#*: *ngas* ~ *nga#-va*, *vras* ~ *vra#-va*, *pres* ~ *pre#-va* etj.

Në ndërrimet e zanoreve shfrytëzohen vetëm një pjesë e mundësive që paraqet sistemi vokalik i shqipes (31 ndërrime nga 110 kombinime të mundshme të zanoreve e të grupeve të zanoreve, ose 27% e mundësive). Në gjuhën shqipe nga zanoret e së njëjtës radhë, këmbehen midis tyre vetëm zanoret gjysmë të hapura (/e ~ o/, /o ~ e/, /e ~ ë/). Nuk ka ndërrime midis zanoreve të mbyllura /i, y, u/.

Ndërrimet e përfuara midis zanoresh të së njëjtës radhë (d.m.th. vetëm midis zanoreve të përparme, vetëm midis të prapmeve ose vetëm zanoreve qendrore), janë të shumta. Veçori e tyre është se gjymtyrët këmbejnë vendet: gjymtyra e dytë del e parë dhe anasjelltas. Kështu, kemi ndërrimet /e ~ i/ dhe /i ~ e/, /a ~ ë/ dhe /ë ~ a/, /o ~ ua/ dhe /ua ~ o/, /e ~ ye/ dhe /ye ~ e/. Por, më të shumta janë ndërrimet e përfuara midis zanoreve të radhëve e hapjeve të ndryshme, si p.sh. /a ~ e/, /a ~ o/, /a ~ ua/, /e ~ a/, /e ~ ua/, /ë ~ i/ etj. Shpesh edhe këtu ndërrimet e zanoreve mund të kenë dy kahje të kundërta (/a ~ e/ dhe /e ~ a/, /ë ~ i/ dhe /i ~ ë/ etj.).

Po të shqyrtohen ndërrimet sipas pozicionit të zanoreve në trekëndëshin vokalik, vërehen dy drejtime kryesore të lëvizjes së zanoreve. Në rastin e parë, zanoret më të prapme ndërrohen me zanore më të përparme ose zanoret më të hapura me zanore më të mbyllura, duke u bërë njëkohësisht më të përparme. Të tilla janë ndërrimet /a ~ e/, /a ~ ë/, /e ~ i/, /e ~ ye/, /ë ~ i/, /ie ~ i/, /je ~ i/, /o ~ e/, /ua ~ e/ dhe /ye ~ y/. Disa nga këto ndërrime, ku zanoret zhvendosen përpara dhe lart në trekëndëshin vokalik, duke synuar nga /i/-ja, si /a ~ e/, /e ~ i/, /ie ~ i/, /je ~ i/ dhe /o ~ e/, njihen tradicionalisht me emrin metafoni.

¹⁶² Me ndërrimin /s ~ t/ kundërvihen foljet e vetës së parë me vetën e tretë njëjës të së pakryerës dëftore. Duhet vënë në pah se ndërrimi i bashkëtingëlloreve del si mjet ndihmës, sepse rolin kryesor në këtë kundërvënie e luajnë mbarestat.

Në rastin e dytë, zanoret më të mbyllura ndërrohen me zanore më të hapura; zanoret më të përparme ndërrohen me më të prapme, ose zanoret e prapme ndryshojnë vetëm shkallën e hapjes, duke u bërë më të hapura ose më të mbyllura. Këto ndërrime janë: /a ~ o/, /a ~ ua/, /e ~ a/, /e ~ ua/, /ë ~ u/, /ë ~ a/, /ie ~ u/, /je ~ o/, /o ~ ua/, /ua ~ a/, /ua ~ o/, /ua ~ u/, /ye ~ e/ dhe /i ~ je/.

Ndërrimet vokalike, përmbledhtas mund të paraqiten në mënyrë tabelore:

a ~ e (dash ~ desh)	a ~ o (dal ~ dol-a)
a ~ ë (i madh ~ të mëdhenj)	a ~ ua (kalë ~ kua-j)
e ~ i (shteg ~ shtigj-e)	e ~ a (thes ~ thas-ë)
e ~ ye (derë ~ dyer)	e ~ ua (them ~ thua)
ë ~ i (lë ~ li-ni)	ë ~ a (lë ~ la-shë)
ie ~ i (shtie ~ shti-ni)	ë ~ u (zë ~ zu-ra)
je ~ i (sjell ~ sill-ni)	i ~ ë (shti ~ shtë-në)
o ~ e (shoh ~ sheh)	ie ~ u (shpie ~ shpu-ra)
ua ~ e (dua ~ de-sha)	je ~ o (sjell ~ soll-a)
ye ~ y (thye-j ~ thy-het)	o ~ ua (dorë ~ duar)
ua ~ a (grua ~ gra)	ye ~ e (lye-j ~ le-va)
ua ~ o (shkrua-j ~ shkro-va)	i ~ je (vit ~ vjet) ¹⁶³
ua ~ u (shkrua-j ~ shkru-hem)	

Tabela 18. Ndërrime fonemash zanore

Në dallim nga ndërrimet vokalike, ku shfrytëzohet gjithë inventari i fonemave zanore të shqipes dhe një numër jo i vogël kundërvëniesh të tyre; në ndërrimet e bashkëtingëlloreve nuk përdoret i gjithë inventari i fonemave konsonantike të shqipes (por vetëm 20 fonema nga 29 bashkëtingëlloret e shqipes) dhe një numër shumë i vogël kundërvëniesh të tyre (vetëm 15 kundërvënie nga 406 kundërvëniet fonologjike të sistemit konsonantik të shqipes). Në këto ndërrime marrin pjesë kryesisht bashkëtingëlloret alveolare, qiellzore dhe velare.

Në ndërrimet konsonantike vërehet se shumica e tyre janë përftuar nga kundërvënia e bashkëtingëlloreve joqiellzore me qiellzoret: gjymtyra e parë e ndërrimit mund të jetë ose alveolare, ose velare; kurse gjymtyra e dytë në të dy rastet është qiellzore. Të tilla janë ndërrimet /k ~ q/, /g ~ gj/, /l ~ j/, /ll ~ j/, /r ~ j/ e /n ~ nj/, të cilat formojnë një korrelacion të vetëm të timbrit sipas tiparit të qiellzorëzimit.

Të dyja gjymtyrët e ndërrimeve vokalike të eptimit, si rregull, janë të theksuara. Për sa i përket pozicionit në temë të fjalës, gjymtyrët e ndërrimeve i përkasin rrokjes fundore të temës.

Një veçori me interes e sistemit morfonologjik të shqipes, që ka tërhequr vëmendjen e studiuesve, është **lidhja e ngushtë midis disa ndërrimeve vokalike e konsonantike**. Kështu, në eptimin emëror ndërrimi

¹⁶³ Rahmi Memushaj, *Morfonologji e eptimit ...*, Tiranë, 1989, f. 220.

/a ~ e/ del shpesh bashkë me ndërrimet /k ~ q/ (*plak ~ pleq*); ndërrimi /e ~ i/ shoqërohet me /g ~ gj/ (*shteg ~ shtigj-e*); ndërrimet /ua ~ o/ e /ye ~ e/ gjenden shpesh krahas ndërrimit /ll ~ j/ (*truall ~ troj-e, fyell ~ fej-e*). Në eptimin foljor, gjithashtu, ndërrimi /a ~ e/ del krahas me /s ~ t/ (*godas ~ godet*); ndërrimet /e ~ i/ dhe /jje ~ o/ në disa nga foljet me temë më -k, -g në kundërvënien e numrit dhe të kohës shoqërohen nga ndërrimet /k ~ q/ e /g ~ gj/ (*pjek ~ piq-ni, poq-a; djeg ~ digj-ni, dogj-a*) etj.

Këto lidhje midis ndërrimesh të caktuara vokaliqe e konsonantike, që kanë një sferë jo të vogël veprimi, nuk mund të mendohen si diçka rastësore, si përputhje të rastit. Me ndonjë përjashtim të rrallë, ato dëshmojnë se këto dukuri janë rrjedhoja të të njëjtit proces asimilimi që ka ndodhur në krye të herës në shqipe. Në atë kohë kur ka nisur në shqipen (dhe në gjuhë të tjera indoevropiane) ky modifikim asimilator i zanoreve kishte natyrën e harmonisë vokaliqe. Siç dëshmohet edhe nga gjuhë të tjera, si p.sh. anglishtja me rastet *foot- (footi >) feet* etj. dhe gjermanishtja me *Gast : Gäst-e*, harmonia vokaliqe e gjuhëve indoevropiane, duke përfshirë këtu edhe shqipen, kishte drejtim të kundërt me harmoninë vokaliqe që e gjejmë sot në gjuhët turke dhe ugrofine.

Në këtë mënyrë, në gjuhën shqipe nën ndikimin e mbaresës vokaliqe /-i/, zanorja e temës realizohej si një variant më i përparmë sesa varianti themelor i fonemës në formën bazë, pra si variant i palatalizuar. Veç kësaj, mbaresa /-i/ bënte që edhe bashkëtingëllorja jopalatale fundore e temës të realizohej gjithashtu si palatale. Me kalimin e kohës, këto variante qiellzore të zanores së temës e të bashkëtingëllores fundore të saj fituan njëfarë pavarësie dhe, me rënien e /-i/-së, përfunduan në fonema palatale, të ndryshme nga fonemat gjegjëse në formën bazë. P.sh. nga forma bazë *plak* është kaluar te forma *pleq* nëpërmjet një faze të ndërmjetme **plaki*, pra: *plak - *plaki - pleq*.¹⁶⁴ Po kështu mund të shpjegohet edhe shoqërimi i ndërrimit /e ~ i/ me /k ~ q/ e /g ~ gj/ tek emri ose tek folja dhe i ndërrimit /a ~ e/ me /s ~ t/ te folja.

Të mbështetur në këto fakte, mund të arrijmë në përfundimin që **metafonia dhe qiellzorëzimi në eptimin emëror e foljor shoqërojnë njëri-tjetrin**, duke qenë se janë pasoja të njëkohshme të të njëjtit proces, i cili ka ndodhur, sigurisht, në ato fjalë që kanë pasur në trup të tyre një zanore jopalatale të ndjekur nga një bashkëtingëllore fundore jopalatale.

Shkaqet e lindjes së dukurive të tjera morfonologjike (përveç qiellzorëzimit dhe metafonisë) janë të ndryshme. Disa prej tyre, siç janë ndërrimet e një zanoreje ose bashkëtingëlloreje me zero (#) ose anasjelltas, kanë lindur si rrjedhim i rënies ose i shtesës së fonemave në formën bazë. Ndonjë dukuri ka lindur nga reduktimi i zanoreve (kryesisht i /a/-së së theksuar) në /ë/, ndonjë nga shkrirja e fonemave, përngjashmimi, shpërngjashmimi, analogjia etj.¹⁶⁵

¹⁶⁴ Eqrem Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, II*, f. 218.

¹⁶⁵ Rahmi Memushaj, *Morfonologji ...*, f. 225-230.

KREU VII

7. RROKJA

Fjalët ndahen në rrokje, që mund të përbëhen nga një zanore e vetme ose nga grupe tingujsh, të formuar nga bashkimi i një ose më shumë bashkëtingëlloreve me një zanore. Kuptohet se rrokjet ndahen më tej në fonema të veçanta, por kjo ndarje lidhet me zotërimin fonologjik të gjuhës. Fëmijët rrokjen e përkapin si njësi tërësore dhe më vonë aftësohen ta ndajnë atë në tinguj.

Koncepti i rrokjes është një nga më themelorët, por edhe më të ndërlikuar të fonetikës e fonologjisë. Në praktikë, nuk është vështirë të përcaktohet numri i rrokjeve të një fjale, edhe kur s'e dimë kuptimin e saj. Por, shpjegimi teorik i natyrës dhe i kufijve të rrokjes përbën një nga problemet më të vështira të fonetikës. Madje, këto vështirësi në përkufizimin e rrokjes i kanë shtyrë disa gjuhëtarë ta mohojnë atë si njësi fonetike. Mirëpo, aftësia e folësve për t'i ndarë fjalët në rrokje si dhe teknika e vjershërimit, që mbështetet në numërimin e rrokjeve dhe në alternimin e rregullt të rrokjeve të theksuara me të patheksuarat, provojnë se folësit janë të vetëdijshëm për të, d.m.th. se rrokja është pjesë e kompetencës gjuhësore e lindur te folësit e një gjuhe.¹⁶⁶

Mossuksesi i gjetjes së korrelatit fizik të rrokjes, ka sjellë lindjen e një varg konceptesh si dhe të disa teorive për rrokjen. Zakonisht thuhet se rrokja është pjesë e fjalës që shqiptohet me një të nxjerrë të frymës. Ky përkufizim mbështetet në pikëpamjen nyjetimore, por jo edhe në atë akustike, prandaj është i padrejtë dhe i vjetëruar.

Parimisht nuk mund të flitet për mënyrë universale të ndarjes së ligjërimin në rrokje, rrjedhimisht edhe nuk ka përkufizim të vetëm për nocionin e rrokjes. Rrokja është varg i caktuar segmentesh. Ajo mund të kuptohet si njësi e të folurit e shqiptuar midis dy prerjesh të rënies së intensitetit. Çdonjëra rrokje ka vetëm një kulm intensiteti, që përfaqëson edhe qendrën e rrokjes. Pra, *rrokje është largësia midis dy minimeve të sonoritetit*. Rrokjet rëndom përbëhen nga dy ose më shumë tinguj. Në rastet e këtilla dallojmë thelbin a

¹⁶⁶ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 110-111.

bërthamën e rrokjes (që e krijon zanorja) dhe periferinë e saj (e përbërë nga një ose disa bashkëtingëllore).

Nga kjo pikëpamje mund të thuhet edhe se rrokja është **një grup fonemash të përqëndruara rreth një zanoreje. Edhe një zanore e vetme përbën një rrokje**. P.sh. në fjalinë *Unë jam nxënës* lehtë mund të dallojmë fonemat, rrokjet e fjalët. Nga radhitja e njëpasnjëshme e fonemave /ë, n, u, a, m, j, x, s/ janë formuar rrokjet *jam, u-në, nxë-nës*; ndërsa me bashkimin e tyre janë përfutur fjalët *jam, unë* dhe *nxënës*. Kështu, nga bashkimi i njërive më të vogla të gjuhës formohen njësi më të mëdha: fonema > rrokje > fjalë > fjali > periudhë > thënie e lidhur. Kjo lidhje është e domosdoshme për të shprehur mendimet. Fonemat grupohen në rrokje, rrokjet në fjalë e fjalët në fjali. Nëse rrokja është grup fonemash, fjala është vargua i mbaruar rrokjesh, ndërsa fjalia është vargua i mbaruar fjalësh. Në të shumtën e rasteve rrokja është një grup fonemash që në vetvete nuk ka kuptim.

Tipi i rrokjes bashkëtingëllore + zanore (BZ) ose zanore + bashkëtingëllore (ZB) çmohet si i përgjithshëm, por ka edhe tipa të tjerë, si Z, BBZ, ZBB, BZB. Bashkëtingëlloret janë elemente shumë të rëndësishme të rrokjes, ndërsa zanorja është bartës vokalik, që organizon dhe përqëndron rrokjen, siguron unitetin dhe sonoritetin e saj. Siç dihet, në shumë gjuhë ngarkesa informative e bashkëtingëlloreve është më e madhe sesa e zanoreve, falë raportit të sasisë midis tyre.

Ndërtimi i rrokjes mbështetet në parimin e kundërshtisë së zanoreve - si tinguj me sonoritet maksimal - me bashkëtingëlloret, si tinguj me sonoritet minimal. Pra, kundërvënja e zanoreve ndaj bashkëtingëlloreve lidhet edhe me rolin që luajnë tingujt a fonemat në rrokje: në gjuhën shqipe zanoret janë rrokjeformuese, ndërsa bashkëtingëlloret nuk mund të formojnë vetë rrokje, pa u bashkuar me zanore.

Si rregull, çdo zanore formon rrokje më vete. Në të gjitha gjuhët e botës zanoret funksionojnë si kulm i rrokjes.¹⁶⁷ Por, duhet thënë se në disa gjuhë, përveç zanoreve, rrokjeformuese mund të jenë edhe bashkëtingëlloret e tingullta (sonoret).¹⁶⁸

Në gjuhën shqipe numri i rrokjeve me numrin e zanoreve të fjalës është në përputhshmëri të plotë, me pak përjashtime. Mospërputhje të numrit të rrokjeve me ato të zanoreve kemi në pak raste (zakonisht në huazimet latine e neolatine, në të cilat [i]-ja a [u]-ja nyjëtohen si gjysmëzanore, ngjashëm me [j]-në, përkatësisht [v]-në), gjegjësisht kur dy zanore formojnë një diftong (duke e humbur aftësinë rrokjeformuese njëra nga zanoret dhe duke kaluar në gjysmëzanore). Në rastet e këtilla diftongu formon një rrokje, d.m.th. numri i rrokjeve në një fjalë të caktuar është i barabartë me numrin e zanoreve të

¹⁶⁷ N. S. Trubeckoi, *Parime të fonologjisë*, Prishtinë, 1985, f. 288.

¹⁶⁸ Në disa gjuhë, si p.sh. në gjuhët sllave në ato fjalë që nuk ka zanore rrokjeformuese janë sonoret, rëndom /r/-ja ose /l/-ja: *trn, srp, shtrk, trl, krt* (трн, срп, штрк, трл, крт në maqedonishte), *vlk* (çekishte) etj.

mirëfillta dhe të diftongjeve. P.sh. *kuádër* [kvá-dër], *kuótë* [kvó-të], *ekuilibër* [ek-vi-lí-bër], *kuárc* [kvárc], *kolokuiúm* [ko-lo-kvi-úm], *akuariúm* [a-kva-ri-úm], *ekuatór* [ek-va-tór], *ekución* [ek-va-ci-ón], *sanduíc* [sand-víç] etj. Siç mund të shihet edhe nga shembujt e sjellë, zanorja e diftongut formon kulmin e rrokjes, ndërsa gjysmëzanorja qëndron në skajet e saj, njëlloj si bashkëtingëlloret jorrokjeformuese.

Çdo rrokje duhet të ketë një *kulm* force (një zanore, në disa gjuhë edhe sonore), i cili mund të paraprihet dhe të ndiqet nga elemente me sonoritet më të ulët (bashkëtingëlloret). Kulmi i rrokjes quhet *bërthamë*, bashkëtingëllorja para bërthamës quhet *fillim*, kurse bashkëtingëllorja pas bërthamës - *bisht* i rrokjes. Kur mbaron me zanore (pa bisht), rrokja quhet *e hapur* (pu-na, në-na, qe-ni, bu-ka, ka-pro-lli), ndërsa kur mbaron me bashkëtingëllore (me bisht), quhet *e mbyllur* (shpër-ngul, kur-sim-tar, kuj-des-tar, shar-toj). Në gjuhën shqipe mbizotërojnë rrokjet e hapura.¹⁶⁹ Por, me kohë numri i rrokjeve të mbyllura ka ardhur duke u shtuar, si rrjedhim i rënies së [-ë]-së fundore që gjendet dy rrokje larg theksit (më parë *ze-më-rë*, *ku-mbu-llë*, *ha-pi-më*, kurse sot *ze-mër*, *kumb-ull*, *ha-pim*) dhe, në ditët tona, i prirjes për të mos e shqiptuar [-ë]-në fundore, edhe kur kjo ndodhet një rrokje larg theksit.

Rrokja paraqitet si një strukturë hierarkike, elementet e së cilës nuk kanë të njëjtën peshë dhe as nuk bashkohen në mënyrë lineare. Në këtë strukturë, *fillimi* është përbërës i drejtpërdrejtë i rrokjes, ndërsa *bërthama* dhe *bishti* formojnë së bashku një strukturë më vete që quhet *rimë*, e cila është përbërësi tjetër i drejtpërdrejtë i rrokjes. Pra, rrokja ka një strukturë trinivelëshe:




Fig. 47. Paraqitje grafike e strukturës së rrokjes: σ - rrokja, R- rima, O- fillimi i rrokjes, N- bërthama dhe C- bishti i rrokjes.¹⁷⁰

Një strukturim i tillë do të thotë që pesha e rrokjes bie mbi *rimën*, meqë kjo ka si përbërës themelor bërthamën. Fillimi i rrokjes është më pak i rëndësishëm dhe, si i tillë, edhe mund të mungojë, ndërsa rima është përbërës

¹⁶⁹ Nga pikëpamja e tingullit nistor, ato që fillojnë me bashkëtingëllore quhen rrokje të mbuluara.

¹⁷⁰ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 112.

themelor dhe i pamungueshëm i rrokjes. Për ta kuptuar më mirë këtë, le të shohim një strofë me rimë të plotë:

*Gjuha jonë
Gjuha jonë sa e mirë,
sa e ëmbël, sa e gjerë,
sa e lehtë, sa e dliërë,
sa e bukur, sa e vlerë!* (Naim Frashëri)

Fjalët e fundit të vargjeve të kësaj strofe të tipit ACBD rimojnë midis tyre duke filluar nga zanorja e theksuar e deri në fund, d.m.th. rimat e rrokjeve të theksuara të fjalëve që rimojnë janë të njëjta, ndërkohë që fillimet e këtyre rrokjeve janë të ndryshme. Kjo është një dëshmi tjetër e asaj që elementi i fillimit të rrokjes nuk ka rëndësi për rimën.¹⁷¹

Rrokja mund të përshkruhet nga pikëpamja fiziologjike, akustike dhe dëgjimore. Nga pikëpamja *fiziologjike*, rrokja lidhet me veprimtarinë e muskujve ndërbrinjorë, të cilët shkaktojnë zmadhimin dhe zvogëlimin e kafazit të kraharorit. Gjatë të folurit, si rrjedhim i punës së këtyre muskujve, vëllimi i kafazit të kraharorit ndryshon pandërprerë. Këto ndryshime i përgjigjen kundërshtisë së zanoreve, që kërkojnë më shumë ajër, me bashkëtingëlloret, që duan një sasi më të vogël ajri.

Pra, kur flasim, kemi një varg impulsesh të tensionit muskolor të aparatit të të folurit. Secilit prej këtyre impulseve i përgjigjet një rrokje. Nga pikëpamja *akustike*, rrokja paraqitet si bashkim i një tingulli me sonoritet maksimal, që përbën *kulmin* e saj, me një a më shumë tinguj me sonoritet minimal, që përbëjnë *skajet* e saj. Në pikëpamje *dëgjimore*, kulmi i rrokjes dallohet nga një forcë më e madhe dhe shpesh edhe nga një lartësi më e madhe e zërit.¹⁷²

7.1. TEORITË KRYESORE TË RROKJES

Në gjuhësi ekzistojnë pikëpamje e teori të ndryshme për mekanizmin e formimit të rrokjeve dhe të ndarjes së fjalëve në rrokje. Ato shpjegojnë aspekte të ndryshme të këtyre problemeve, por asnjë prej tyre nuk mund të konsiderohet pa të meta, sepse asnjëra nuk e zgjidh problemin plotësisht.

Duke synuar që të zbatohen në të gjitha gjuhët, këto teori vetvetiu kanë karakter skematik, nuk marrin parasysh veçoritë e çdo gjuhe, dhe në disa raste çojnë në zgjidhje që bien në kundërshtim me faktet reale të gjuhëve të veçanta.

Disa nga teoritë e rrokjes kanë si të metë themelore se janë të njëanshme: duke u përpjekur të zbulojnë natyrën fonetike të rrokjes, nuk japin


¹⁷¹ Po aty, f. 112.

¹⁷² Po aty, f. 111.

përgjigje për kufijtë e saj. Aspekti i fundit ka rëndësi edhe për anën praktike të problemit.¹⁷³ Teoritë më të njohura të rrokjes janë *teoria e ekspiracionit*, *e tensionit muskolor* dhe *teoria e sonoritetit*.

1. **Teoria e ekspiracionit** (e frymënxjerrjes, e frymëqitjes) mbështetet në kriteret fiziologjike. Ajo e shpjegon rrokjen si një grup tingujsh që shqiptohen me një të nxjerrë të frymës. Kufiri i rrokjes sipas kësaj teorie përcaktohet nga shtytja (impulsi) e re e nxjerrjes së ajrit. Përkrahësit e kësaj teorie mbështeten në faktin se nxjerrja e frymës gjatë të folurit nuk bëhet me rrymë të pandërprerë, por me shtytje, me impulse. Kjo teori sot konsiderohet e vjetëruar, e nuk ka shumë përkrahës. Është përdëftuar se me një të nxjerrë të frymës mund të shqiptohen më shumë se një rrokje, si *ariu* /a-riu/, *njeriu* /nje-riu/, *qiriri* /qi-riri/ etj. Veç kësaj, kjo nuk na jep kriteret objektive për të përcaktuar kufirin e rrokjes, sidomos kur kemi grupe bashkëtingëlloresh midis zanoresh.

2. **Teoria e tensionit muskolor**. - Sipas kësaj teorie, rrokja është e pandashme nga pikëpamja e shqiptimit, sepse ajo artikullohet me një impuls të vetëm të tensionit muskolor të aparatit të të folurit. Kështu, të folurit paraqitet si një varg impulse, që vijnë njëri pas tjetrit pa prerë ose të ndërprerë nga pauza. Çdo impuls mund të ndahet në tri faza: 1) forcimi i tensionit, 2) kulmi i tensionit, dhe 3) dobësimi i tensionit. Grafikisht vargu i rrokjeve mund të paraqitet si një vijë e dallgëzuar. Pjesët më të ngritura të lakores i përgjigjen fazës së dytë dhe përbëjnë kulmet e rrokjeve, kurse thellimet tregojnë minimumin e tensionit muskolor dhe përbëjnë kufijtë midis rrokjeve:¹⁷⁴



Kufiri midis rrokjeve është kufiri midis dy impulseve të tensionit muskolor. Vendi se ku kalon kufiri i rrokjes (para bashkëtingëllores ose pas saj) përcaktohet nga karakteri i bashkëtingëllores. Nëse bashkëtingëllorja është me fillim të dobët dhe fund të fortë, atëherë ajo ndodhet në fillim të impulsit të tensionit muskolor, kështu që i përket rrokjes që vjen pas:




Po qe bashkëtingëllorja me fillim të fortë, kulmi i saj gjendet te kulmi i rrokjes, prandaj i përket rrokjes së mëparshme:

¹⁷³ Anastas Dodi – Jorgji Gjinari, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 106.

¹⁷⁴ Anastas Dodi, *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë, 1970, f. 86.

Edhe kjo te të fortë ose fillim të fonetike në të cilat gjuhë ka shprehinë bashkëtingëlloreve e të grupeve të bashkëtingëlloreve. P.sh. në shqipen bashkëtingëllorja midis dy zanoresh shqiptohet gjithnjë me fund të fortë, rrjedhimisht shkon me zanoren e dytë, ndërkaq në grupet *mb, nd, ng, nc, nx* etj. bashkëtingëllorja e parë shqiptohet me fillim të dobët, ndërsa krijon rrokje me zanoren që vjen pas.



3. **Teoria e sonoritetit** (e zëshmërisë) që mbështetet në kriteret akustike, është edhe sot një nga teoritë më të përhapura të rrokjes, pavarësisht nga kritikrat që i bëhen në disa drejtime. Sipas kësaj, rrokja është bashkim i një elementi më sonor (më tingëllues) me një tjetër më pak tingëllues (kur kemi të bëjmë vetëm me një zanore, çështja është e qartë). Kufiri i rrokjes përcaktohet nga largësia midis dy minimumeve të sonoritetit.

Formimi i rrokjeve, sipas kësaj teorie, lidhet me shkallën e zëshmërisë së tingujve. Nga të gjithë tingujt, më sonorë janë zanoret e hapura dhe më pak tingëlluese janë bashkëtingëlloret mbylltore të shurdhëta. Midis këtyre caqeve, tingujt e tjerë shkallëzohen sipas zëshmërisë. Rrokja formohet prej një kulmi, që përfaqëson elementin më tingëllues, rreth të cilit grupohen tingujt më pak sonorë.

Meqë kjo teori mbështetet në shkallën e ndryshme të sonoritetit të tingujve, në këtë drejtim ato duhen klasifikuar. Gjuhëtari danez Otto Jespersen përcaktoi dhjetë shkallë të sonoritetit të tingujve. Duke filluar nga tingujt më pak sonorë, tingujt e gjuhës shqipe sipas këtij shkallëzimi, rreshtohen kështu:

1. Bashkëtingëlloret mbylltore dhe afrikatat e shurdhëta: [p, t, k, q; c,];
2. Bashkëtingëlloret shtegore të shurdhëta: [f, s, h, th, sh];
3. Bashkëtingëlloret mbylltore dhe afrikatat e zëshme: [b, d, g, gj; x, xh];
4. Bashkëtingëlloret shtegore të zëshme: [v, z, dh, zh];
5. Bashkëtingëlloret hundore: [m, n, nj];
6. Bashkëtingëlloret anësore: [l, ll];
7. Bashkëtingëlloret dridhëse dhe mesore: [r, rr; j];
8. Zanoret e mbyllura: [i, u, y];
9. Zanoret gjysmë të hapura: [e, ë, o];
10. Zanorja e hapur: [a].

Me shkallëzimin e tingujve sipas sonoritetit mund të përcaktohet numri i rrokjeve në fjalë dhe, në shumicën e rasteve, përcaktohet drejt edhe kufiri i ndarjes së fjalëve në rrokje. Numri i rrokjeve përcaktohet nga numri i kulmeve të sonoritetit, ndërsa kufi i ndarjes së rrokjeve konsiderohet vendi ku kemi ulje më të madhe të zëshmërisë.

Po të paraqesim grafikisht ndarjen e tingujve në 10 shkallë, duke i shënuar ato në boshtin vertikal, do të kishim:




Fig. 48. Dhjetë shkallët e zëshmërisë së tingujve

Kjo teori shpjegon kënaqshëm shumicën e rasteve. Megjithatë, në gjuhë të ndryshme paraqiten raste që bien në kundërshtim me të, sepse nuk i tregojnë drejt kufijtë e ndarjes së fjalëve në rrokje. P.sh. në gjuhën shqipe grupet [nd, mb, ng, nt, nk] etj. shqiptohen bashkë, me një nyjetim të vetëm, prandaj edhe në ndarjen e rrokjeve shkojnë patjetër bashkë. Megjithkëtë, sipas teorisë së zëshmërisë, këto grupe duhet të ndahen (si p.sh. *kën-ga, këm-ba, bren-da* etj.). Shqiptimi i këtyre grupeve me një nyjetim të vetëm lidhet me ve]oritë e gjuhës shqipe, me shprehitë e saj nyjetimore, që ndryshojnë nga ato të gjuhëve të tjera. Këto veçori është vështirë të përfshihen në skema të përgjithshme, të përshtatshme për të gjitha gjuhët. Veç kësaj, siç u tha, kjo teori mbështetet në shkallën e zëshmërisë së tingujve, por kjo zëshmëri nuk është karakteristikë e pandryshueshme e tingujve. Zëshmëria e tingujve mund të ndryshojë, prandaj edhe vetë shkallëzimi ka vlerë relative.

Teoria e sonoritetit, me gjithë të metat që ka, është përdorur për studimin e natyrës së rrokjes dhe të kufijve të saj në materialin e gjuhëve të ndryshme, ndonjëherë edhe me disa modifikime. Sipas një varianti të kësaj teorie, në shkallëzimin e tingujve sipas zëshmërisë rëndësi kryesore ka që të dallohen tri kategori të tingujve: a) zanoret, b) bashkëtingëlloret sonore, dhe c) bashkëtingëlloret e zhurmëta.

Në këtë shkallëzim, zanoret janë më afër sonoreve sesa zanoret ndaj të zhurmëtave. Po ta shprehim me numra këtë shkallëzim:

- zanoret (/a, e, o, u, i, y dhe ë/) do të shënoheshin me numrin 4,
- sonoret (/j, r, rr, l, ll, m, n, nj/) me numrin 3, ndërsa
- bashkëtingëlloret e zhurmëta (të gjitha bashkëtingëlloret e tjera, përveç sonanteve të saposhënuara: /b, c, ç, d, dh, f, g, gj, h, k, p, q, s, sh, t, th, v, x, xh, z e zh/) me numrin 1.

Sipas këtij shkallëzimi numerik, me përjashtim të rrokjes nistore, rrokjet e tjera të fjalës ndërtohen sipas parimit të rritjes së zëshmërisë, d.m.th. ndarja në rrokje duhet të bëhet ashtu që tingulli që vjen pas të jetë më sonor se

i mëparshmi. Në këtë mënyrë, kjo rregullsi përcakton edhe kufirin e ndarjes së fjalëve në rrokje (bën përjashtim këtu rrokja nistore e fjalës tek e cila mund të ketë edhe ulje të sonoritetit). Në përputhje me këtë rregullsi, në gjuhën shqipe fjalët *ura, mali, barku, portave, guri, kaprolli* do të ndaheshin *u-ra* (4/31), *ma-li* (34/43), *bar-ku* (143/14), *por-ta-ve* (143/14/14), *gu-ri* (14/34), *ka-pro-lli* (14/134/34).

Ky variant i thjeshtësuar i teorisë së sonoritetit është më praktik, por bart dhe thellon të metat që lidhen me shkallëzimin e zëshmërisë së tingujve në 10 shkallë. Në disa raste edhe ky shkallëzim na]on në zgjidhje të gabuara, ve]mas në ndarjen e togjeve të bashkëtingëlloreve. P.sh. *dhëmbi, vendi, kënga* sipas saj duhet ndarë në *dhëm-bi* (143/14), *ven-di* (143/14), *kën-ga* (143/14) që s'i përgjigjet ndarjes së vërtetë të rrokjeve në gjuhën shqipe.

Nga këto që u parashtruan, del se asnjë nga teoritë për rrokjen dhe kufijtë e saj nuk mund të zbatohet në mënyrë të plotë dhe të zgjidhë drejt të gjitha problemet e rrokjes në gjuhën shqipe. Megjithatë, mbi bazën e këtyre teorisë në mjaft raste mund të arrihen përfundime të drejta e të vlefshme, sidomos mbi bazën e teorisë së sonoritetit.¹⁷⁵

7.2. FJALËT E SHQIPES NGA PIKËPAMJA E NUMRIT TË RROKJEVE

Në këndvështrimin e gjuhësisë sasiore bën pjesë edhe analiza e rrokjeve të fjalës. Dihet se fjalët nuk kanë denduri të njëjtë përdorimi. Sa më e gjatë të jetë fjala, aq më pak përdoret. Për këtë ndikon edhe vjetërsia e saj: fjalët më të vjetra zakonisht përdoren më dendur se fjalët më të reja.

Përdorimi i shpeshtë i fjalëve sjell reduktimin, gërryerjen e tyre, rrjedhimisht i kthen në mjete që shprehin raporte gramatikore. Shqipja është gjuhë sintetike-analitike, që shkon në rrugën drejt analitizmit.¹⁷⁶ Sa më analitike të jetë gjuha, aq më të shkurtra janë fjalët, sepse marrëdhëniet gramatikore shprehen me mjete shërbyese, që janë elemente të reduktuara. Gjuhët sintetike zakonisht i kanë fjalët më të gjata. P.sh. gjatësia mesatare e fjalëve në greqishte është 2.1 rrokje, në rusishte 2.2, në latinishte 2.3; kurse në anglishten analitike është 1.3 rrokje.

Në gjuhën shqipe fjalët mund të kenë 1, 2, 3, 4, 5 e më tepër rrokje. Fjalët që kanë 1 deri më 4 rrokje kanë denduri më të madhe përdorimi, ndërsa ato që përbëhen prej 5, 6, 7 e më tepër rrokjesh përdoren më rrallë. Fjalët

¹⁷⁵ Anastas Dodi – Jorgji Gjinari, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 104-112.

¹⁷⁶ Sipas klasifikimit tipologjik (morfologjik) disa nga gjuhët indoevropiane janë (a) flektive analitike dhe disa të tjera (b) flektive sintetike. Në gjuhët flektive analitike mbizotëron mënyra analitike e shprehjes së raporteve gramatikore (me parafjalë + një emër etj.). Tipike analitike është maqedonishtja. Disa gjuhë, si rusishtja, serbishtja etj., këto i shprehin me rasi, prandaj janë gjuhë analitike. Shqipja raportet gramatikore të pjesëve emërore i shpreh edhe me rasi edhe me parafjalë, andaj është gjuhë sintetike-analitike.

njërrokëshe përbëjnë 46.41 të fjalëve të përdorura në një tekst; 36.31% janë fjalë dyrrrokëshe; 11.87% janë trirrokëshe; 4.60% janë me katër rrokje; 0.70% janë pesërrokëshe; 0.10% janë gjashtërrrokëshe dhe 0.01% 7-rrrokëshe. Fjalë më të gjata përdoren rrallë.

Në ligjëratë përdoren dendur sidomos fjalët njërrrokëshe dhe dyrrrokëshe. Fjalët njërrrokëshe përbëjnë afërsisht gjysmën e fjalëve të një teksti, ndërsa fjalët dyrrrokëshe më tepër se 1/3 e tyre. Gjatësia mesatare e një fjale të gjuhës shqipe është afërsisht dy rrokje. Studimet e statistikës fonologjike saktësojnë se gjatësia mesatare e një fjale në shqipen është 1,77 rrokje (afërsisht 4 fonema 3,97).¹⁷⁷ Me prirjen e shqipes që të krijojë fjalë të reja të prejardhura për ta pasuruar leksikun me parashtesim, me prapashtesim, me parashtesim e prapashtesim njëherazi, me kompozim e përngjitje numri i fjalëve shumërrrokëshe zmadhohet, rrjedhimisht rritet edhe gjatësia mesatare fjalëve nga pikëpamja e numrit të rrokjeve.



Drejtshkrim e drejtshqiptim

7.3. RREGULLAT E NDARJES SË FJALËVE NË RROKJE

Për ndarjen fonetike të fjalëve në rrokje në gjuhën shqipe ka disa rregulla. Rastet më karakteristike të ndarjes së fjalëve në rrokje në gjuhën shqipe janë:¹⁷⁸

1. Një bashkëtingëllore e vetme midis dy zanoresh formon rrokje me zanoren që vjen pas. P.sh. *ara /a-ra/, hëna /hë-na/, puna /pu-na/, djali /dja-li/, drita /dri-ta/, treni /tre-ni/, buka /bu-ka/ etj.*

2. Kur midis dy zanoresh ka grup prej dy bashkëtingëlloresh të zhurmëta (ZBBZ) paraqiten dy mundësi:

a) modeli më i rëndomtë është që të dyja bashkëtingëlloret të shkojnë me zanoren e dytë (Z-BBZ) ose

b) bashkëtingëlloret të ndahen midis dy rrokjeve (ZB-BZ). P.sh. *ka-fsha, dë-fte-sa, vë-shti-rë-si, ko-stu-mi, ngu-shti-ca, pa-ska, da-shka, ku-ptoj, nxe-htë-si, shpre-tka, mu-sta-qe, bri-sku, fo-sfo-ri, ka-shta, vje-shta, u-shta-ri, bo-shti, bre-shka, va-zhdi-misht, dë-shpë-rim, lë-vo-zhga, o-ksi-gje-ni, le-ksi-ku etj.*

¹⁷⁷ Anastas Dodi, *Shqipja si gjuhë ballkanike në vështrimin e gjuhësisë sasiore*, Seminari XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare, Tiranë, 1996, f. 763.

¹⁷⁸ Ndarjen fonetike të fjalëve në rrokje duhet ta dallojmë nga ndarja e fjalëve në fund të rreshtit, sepse këto në disa raste përputhen, në disa raste të tjera dallohen.

Edhe kur kemi dy bashkëtingëllore të tipit e zhurmët + sonore midis zanoresh, të dyja bashkëtingëlloret shkojnë me zanoren e prapme: *pu-pla, la-kra, ve-gla, li-bri, mi-sri, di-plo-ma, di-si-pli-na, ha-pja, ve-pra, ko-prra-ci, tra-ktori, a-ktori, pa-kti, pro-ble-mi, o-bje-kti, fa-bri-ka, a-tla-si, a-tmo-sfe-ra, a-dre-sa, ko-dra, lo-dra, e-tje, de-kla-ra-ta, ba-klla-va, la-kra, the-kra, ko-krra, pa-ra-gra-fi, ma-cja, shpi-fje, a-fri-kan, E-vro-pa, da-sma, a-sfal-ti, le-gji-sla-tu-ra* etj.

3. Në grupin bashkëtingëllore sonore + bashkëtingëllore e zhurmët dallohen dy nëngrupe: a) hundore (/m, n, nj/) + bashkëtingëllore e zhurmët, dhe b) sonantet e tjera (/r, rr, l, ll, j/) + bashkëtingëllore e zhurmët.

a) Grupi bashkëtingëllore hundore + e zhurmët midis zanoresh formon rrokje me zanoren pasuese. P.sh. *ve-ndi, kë-nga, bre-nga, bi-la-nci, qe-ngji, më-ngje-si, thë-ngji-lli, ko-ncer-ti, gje-mbi, shkë-mbi, kë-mba, kri-mbi, ka-mpi, kompa-ni-a, më-ngjes, tru-mca-ku, i-mpe-ri-a-list, me-nsa, di-spe-nsa, re-ce-nsi-mi, be-nzi-na, shpe-nzi-mi, ko-nfe-re-nca, i-nfor-ma-ta, pra-nve-ra* etj.

b) Grupi i krijuar nga sonantet e tjera (përve] hundoreve) + bashkëtingëllore e zhurmët midis zanoresh ndahen në rrokje në atë mënyrë që tingëlluesja shkon me zanoren e parë, ndërkaq bashkëtingëllorja e zhurmët shkon me zanoren pasuese. Ky nëngrup mund të degëzohet në: dridhëse + e zhurmët (/r, rr + .../): *tur-pi, qer-pi-ku, tër-bi-mi, ar-ti-sti, ar-ti-ku-lli, sir-ta-ri, per-dja, ar-gje-ndi, e-ner-gji-a, ar-ka, bar-ku, u-ni-ver-si-te-ti, zar-za-va-te, gër-shë-rët, qer-shi-a* etj.; anësore (/l, ll/) + e zhurmët: *bal-ta, gjil-pë-ra, el-bi, thel-bi, fil-di-shi, shkël-qi-mi, qel-qi, al-ko-o-li, ul-ko-nja, al-fa-be-ti, pul-si, sull-ta-ni* etj.; mesore + e zhurmët: *drej-to-ri, krej-të-sisht, kuj-tesa, kaj-si-a, kuj-de-star, vaj-za, vaj-toj, buj-ku* etj.

4. Kur kemi një grup prej dy sonantesh midis zanoreve, kufiri i rrokjes kalon midis tyre, d.m.th., tingëlluesja e parë krijon rrokje me zanoren prirëse, ndërsa tingëlluesja e dytë me zanoren pasuese, si *gjur-ma, ar-mi-ku, bul-me-ti, aj-ri, i maj-më, akull-na-ja, shkall-moj, ze-mra, fe-mra, nu-mri* etj.

Përrjashtim nga ky rregull bëhet atëherë kur nga dy sonantet e grupit, element i dytë paraqitet tingëlluesja /j/. Në rastet e këtilla grupi nuk ndahet, por shkon së bashku me zanoren pasuese. P.sh. *pa-mje, me-da-lje, va-llja, tharja, sje-llja, mbrë-mje, da-lje, nda-rje, shpa-llje* etj.

5. Grupet prej tri ose më shumë bashkëtingëlloresh midis zanoresh në mes të fjalës në gjuhën shqipe hasen më shpesh në kufirin e morfemave, por nuk mungojnë edhe brenda tyre. Zakonisht, ky grup bashkëtingëlloresh formon rrokje me zanoren që vjen pas, si p.sh.: *lu-ndra, dhë-ndri, ce-ntra-li, ko-ntro-lli, së-mu-ndje, bi-ndja, ko-nkre-ti-zoj, ko-mple-ksi, ko-mpro-mi-si, ko-mpli-me-nti; u-shtri-mi, gë-nje-shtra, ma-shtroj, pa-stri-mi, i-ndu-stri-a* etj.

6. Ndarja e grupeve prej katër bashkëtingëlloresh në trup të fjalës (që përbëjnë dukuri të rrallë në gjuhën shqipe) bëhet mbi bazën e kombinimit të rregullave të mëparme.



Drejtshkrim

7.4. NDARJA E FJALËVE NË FUND TË RRESHTIT

Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit mbështetet kryesisht në ndarjen e fjalëve në rrokje, por merr parasysh edhe strukturën morfologjike të fjalës si dhe disa parime të tjera. Për ndarjen e fjalëve në rrokje ka disa rregulla:

1. Nuk ndahen më dysh në fund të rreshtit:

- a) fjalët njërrrokëshe, si *jam, lis, dash, dru, qen* etj.;
- b) shkronjat e një dyshkronjëshi: *mo-lla* (jo mol-la), *bre-dhi* (jo bred-hi), *bu-rrri* (jo bur-ri) etj.
- c) fjalët e përbëra të shkurtuara: *RMV, ShBA, OSBE, NATO* etj.;
- ç) shkurtime të tipit *b.f.* (bie fjala), *d.m.th.* (domethënë), *e.r.* (era e re), *p.sh.* (për shembull) etj.;
- d) një shkronjë e vetme nuk mund të qëndrojë as në fund të rreshtit, as në fillim të rreshtit të ri: *bu-ka* (jo b-uka ose buk-a), *mu-ri* (jo m-uri as mur-i) etj. Nuk ndahen as edhe fjalët që përbëhen prej një tingulli, siç është pjesëza e mohimit *s'* dhe përemri pyetës *ç*;
- dh) nuk duhet të ndajmë shkurtime të shifrat që tregojnë masë nga shifrat që tregojnë sasinë: *2 m², 5 kg, 100%* etj.;
- e) nuk mund të hapen kllapa a thonjëza në fund të rreshtit e as të mbyllen në fillim të rreshtit tjetër. Nuk mund të kalojnë në rreshtin tjetër as shenjat e pikësimit, me përjashtim të vizës.

2. Dy shkronja të njëlojta që takohen në një fjalë, mund të ndahen në fund të rreshtit: *i pa-anshëm, i pa-arsyeshëm, ko-operativë, vaku-um, kundër-revolucion, hesht-te, e gjet-të* (e mira) etj.

3. Në fjalët me dy ose më shumë rrokje, bashkëtingëllorja që gjendet midis dy zanoresh ndahet në fund të rreshtit ashtu që shkruhet me zanoren që vjen pas, si p.sh.: *dru-ri, bo-ta, mi-ku, qe-ni, u-ji, ba-rra, gë-zim, nje-ri-u, bu-ku-ri-a, li-ri-a* etj.

4. Kur ndërmjet dy zanoresh ndodhen dy a më shumë bashkëtingëllore, atëherë njëra bashkëtingëllore shkon me zanoren e parë, ndërsa tjetra apo bashkëtingëllorja e fundit shkruhet me zanoren që pason. Parapëlqehet ndarja që ruan më qartë kufijtë e pjesëve të kuptimshme të fjalës ose kufijtë morfologjikë: *maj-tas, lo-dra* ose *lod-ra, po-sta* ose *pos-ta, i brend-shëm, për-parim* etj.¹⁷⁹

5. Fjalët e përbëra, fjalët e përngjitura si dhe fjalët e prejardhura ndahen në kufirin e pjesës përbërëse të tyre: *hekur-udhë, bukur-shkrim, gjith-*

¹⁷⁹ Nëse fjalët shumërrrokëshe midis dy zanoresh kanë togjet e bashkëtingëlloreve *dr, dhr, fr, fsh, gl, kr, krr, mb, nd, ng, sp, shk, sht, tr* ndarja në fund të rreshtit është e lirë.

monë, tungjat-jeta, bashk-atdhe-tar, i për-kohshëm, zëvendës-drejtor, nën-oficer, shpër-ngul, mbi-shkrim, për-parim, për-mirë-sim, punë-tor etj.

6. Kur kalon në rreshtin tjetër pjesa e dytë e një fjale a e një emërtimi të përbërë që shkruhet me vizë lidhëse, atëherë në krye të rreshtit përsëritet viza lidhëse, si p.sh.: copa-/-copa, aty-/-këtu, vajtje-/-ardhje, hyrje-/-dalje etj.¹⁸⁰

¹⁸⁰ Viza e pjerrët (/) këtu shënon fundin e rreshtit.

KREU VIII

8. PROZODIA

NJËSITË MBISEGMENTORE (FONOTAKTIKE APO PROZODIKE) TË LIGJËRIMIT

Gjuha e folur realizohet si rrjedhë tingullore, që për nevojat e shprehjes së raporteve të ndryshme kuptimore e sintaksore, ndërpritet herëpashere dhe ka melodikë të caktuar: me ndryshime të lartësisë, të timbrit, të intensitetit dhe të gjatësisë së valëve tingullore. Pra, ligjërimi ynë përbëhet nga njësitë *vijore* (lineare, segmentore): tingujt - fonemat dhe nga njësitë *jovijore* (jolineare, mbisegmentore): theksat e ndryshën (theksi i fjalës së veçuar, i togfjalëshit, i fjalisë, i frazës, theksi logjik, emocional) dhe intonacioni. Mjetet prozodike sikur u mbishtresohen njërive më të mëdha se fonema, si rrokjes, fjalës, fjalisë etj., sepse çdo thënie ka theksin dhe intonacionin e vet. Mjetet mbisegmentore lidhin fjalët e një thënieje në një tërësi fonetiko-kuptimore, duke i shndërruar ato në njësi kumtuëse.

Ajo degë e fonetikës ose e fonologjisë që shqyrton njësitë lineare të ligjëritimit quhet fonetikë apo fonologji segmentore, ndërsa njësitë jolineare i shtjellon fonetika a fonologjia mbisegmentore (prozodia). Njësitë mbisegmentore (fonotaktike apo prozodike) më të rëndësishme të ligjëritimit janë **theksi** dhe **intonacioni**.

8.1. THEKSI

Nocioni i theksit. - Fjalët përbëhen nga rrokjet, që në rrjedhën e të folurit nuk shqiptohen të gjitha njëllor. Kur shqiptojmë fjalë të ndryshme me dy a më shumë rrokje, vëmë re se njëra prej tyre dallohet nga të tjerat. Ky dallim bëhet me anë të theksit. Thjesht, theksi është spikatje e njëres rrokje të fjalës. Megjithëse në shumicën e gjuhëve, dukuritë që lidhen me theksin, kanë të bëjnë me zanoret, ato u përkasin rrokjeve të fjalëve; sepse nga njëra anë, ka zanore që nuk formojnë rrokje dhe nga ana tjetër, veçoritë e theksit shfaqen edhe në grupe fonemash me vlerë polifonematike, siç janë diftongjet, si edhe në rrokje që nuk përmbajnë asnjë zanore, por lidhen me disa bashkëtingëllore të caktuara

rrokjeformuese, siç është rasti i bashkëtingëllores së tingullt /r/ në gjuhët sllave.¹⁸¹

Prandaj, theksi, në kuptimin më të ngushtë, zakonisht përkufizohet si të spikaturit e një rrokjeje me mjete të ndryshme fonetike. **Theksi është të spikaturit e rrokjes me anë të forcës, të gjatësisë dhe të lartësisë së tonit.** Rrokja që veçohet nga të tjerat për nga shqiptimi (me fuqi, gjatësi dhe lartësi më të madhe të tonit) është *rrokje e theksuar*, ndërsa të tjerat janë *rrokje të patheksuara*. Për shkak se njëra nga rrokjet që ka theksin dallohet nga rrokjet e patheksuara, në renditjen vijore të tingujve krijohet një kontrast fonetik. Tingujt e rrokjes së theksuar, veçmas zanoret, dallohen fonetakisht nga tingujt e rrokjeve të patheksuara. Krahasoni zanoret e theksuara nga të patheksuarat në fjalët: *shkóllë, punëtór, përrúa, mësúes, përparimtár, líbër, njerí, lexój, dritáre, studént, pranvérë* etj.

Por, në gjuhë mund të përdoren edhe fjali të formuara prej fjalësh që kanë vetëm rrokje të theksuara, pa formuar kontrast me rrokjet e patheksuara, megjithëqë theksi i këtyre fjalëve kapet nga dëgjuesit, p.sh. *Prit pak lart. Ra mjaft shi. Ik larg nesh* etj.¹⁸²

Kur flasim për theks, kemi parasysh theksin e fjalës, që bie në një rrokje të caktuar të saj, por në ligjërimin e lidhur kemi edhe theksin e togjeve të dy e më tepër fjalëve (togfjalëshave), theksin e fjalisë, theksin logjik si dhe theksin emocional. Prandaj, me theks kuptohet përgjithësisht *shqiptimi i një rrokjeje, i një fjale a i një fjalie me një ton më të fuqishëm, me një intensitet më të madh se rrokjet, fjalët ose fjalitë e tjera të së njëjtës tërësi për ta vënë atë më shumë dukje*.¹⁸³

8.1.1. FUNKSIONET E THEKSIT TË FJALËS

Theksi, si një përbërës i rëndësishëm i anës tingullore të fjalës, kryen një varg funksionesh. Funkzioni më i rëndësishëm i theksit është se ai e **organizon** dhe e **formëson thënien** në njësi fonetiko-gramatikore, në fjalë fonetike, si tërësi rrokjesh të bashkuara nën një theks të vetëm.

Theksi në gjuhën shqipe ka **funkcion kulminativ, demarkativ**, në pak raste edhe **funkcion kuptimdallues**. Ashtu si edhe tingujt, theksi (si njësi prozodike) merr pjesë në ndërtimin dhe formësimin e mbulesës tingullore të fjalës. Duke qenë një kulm spikatjeje, theksi shërben për të na treguar numrin e fjalëve në një thënie. Kulmin e intensitetit e formon rrokja e theksuar, kurse kufijtë e saj shprehen me rënien më të madhe të intensitetit. Ky shkallëzim i intensitetit të rrokjeve e bën fjalën fonetike një strukturë ritmike dhe në këtë mënyrë, i jep thënies një ritëm të caktuar. Prandaj, disa gjuhëtarë fjalën fonetike

¹⁸¹ Kolec Topalli, *Theksi në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1995, f. 39.

¹⁸² Anastas Dodi, *Theksi dhe shkallëzimi i tij...*, f. 12.

¹⁸³ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe (vëllimi II), Sintaksa*, Tiranë, 1996, f. 74.

e quajnë “takt i të folurit” ose “grup ritmik”. Ky është funksioni **kulminativ** i theksit.¹⁸⁴ Kështu, një kompleks tingullor ka poaq fjalë fonetike sa edhe kulme theksore. P.sh. *vëndformími* (ka një theks kryesor = një fjalë), *vénd formími* (kemi dy theksa, prandaj kemi dy fjalë); *sesá* (një theks = një fjalë), *sé sá* (dy theksa = dy fjalë); *çfarëdó* (një theks = një fjalë) *çfarë dó?* (dy theksa = dy fjalë) etj.

Theksi i fjalës shënon gjithashtu edhe kufirin ndarës midis fjalëve, d.m.th. ka funksion **demarkativ** (veçues, ndarës). Kur shqiptohet e vejuar, fjala ka gjithnjë theks, sepse ai është i domosdoshëm për identifikimin e fjalës, për njohjen e saj. Në kufijtë e fjalës, në gjuhën shqipe, përgjithësisht, theksi shërben për të nxjerrë në pah një rrokje të saj, duke krijuar kontrast me rrokjet e tjera.

Në pak raste theksi i fjalës në gjuhën shqipe ka edhe funksion **kuptimdallues** (kuptimor, semantik), meqë vendosja e theksit në njërën (në rrokjen parafundore) apo në tjetrën rrokje (në rrokjen fundore) te disa çifte minimale fjalësh krijon njësi të ndryshme leksikore, si p.sh. *líri - lirí, bári - barí, ári - arí, argjentári - argjentarí, punëtóri - punëtorí, drejtóri - drejtorí* etj. Pra, theksi në gjuhën shqipe përgjithësisht nuk ka vlerë fonologjike, por në një numër të kufizuar çifte fjalësh (si këto) ai fiton vlerë fonologjike, sepse kuptimi i fjalëve identifikohet me vendin e theksit. Rastet edhe më të rralla janë kur theksi ka vlerë gramatikore (zakonisht për të dalluar formën e njëjësit nga shumësi), sepse mbaresave të shumësit i shtohet edhe ndryshimi i vendit të theksit, khs. *njerí - njëréz, lúmë - luménj, gjárpër - gjarpërinj, gísht - gishtërinj* etj.

8.2. THEKSI MUZIKOR DHE THEKSI DINAMIK

Mjetet me anë të të cilave rrokja e theksuar dallohet nga rrokjet e patheksuara janë forca, lartësia e tonit dhe gjatësia. Duhet pasur parasysh se këto mjete bashkëveprojnë, d.m.th. rrokja e theksuar dallohet jo vetëm për një forcë më të madhe, por edhe për një gjatësi më të madhe dhe ton më të lartë. Në gjuhë të ndryshme, sipas mënyrës me të cilën bëhet spikatja e rrokjes së theksuar, dallohen dy lloje theksash: a) theks muzikor dhe b) theks dinamik. Te gjuhët me theks muzikor element mbizotërues i spikakatjes së theksit është toni më i lartë (i shoqëruar me forcë dhe gjatësi), ndërsa te gjuhët me theks dinamik mbizotërojnë forca dhe gjatësia (që shoqërohen me ton më të lartë).

a) **Theks muzikor** (theks tonik apo kromatik) kanë gjuhët ku rrokja e theksuar dallohet nga të patheksuarat për nga numri i dridhjeve në sekondë, domethënë nga toni më i lartë (nga lartësia e tonit); me të cilin shqiptohet zanorja e theksuar, në krahasim me zanoret e patheksuara; duke krijuar kështu, me ngritjet dhe uljet e tonit, elemente të melodive muzikore. Prej kësaj mund të kuptohen edhe termat, me të cilat është emërtuar theksi në gjuhët klasike, gr. *prosodia*, lat. *accentus*, që etimologjikisht lidhen me melodinë, këngën. Në gjuhët

¹⁸⁴ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 117-118.

me theks muzikor lartësia e zanores së theksuar, në krahasim me të patheksuarat, mund të jetë një tercë (tri shkallë) deri në një kuintë (pesë shkallë) më lart. Gjuhë të tilla me theks muzikor kanë qenë në periudhën e tyre më të hershme gjuhët klasike, greqishtja e latinishtja.¹⁸⁵ Madje, ai ruhet edhe në ndonjë gjuhë të sotme, siç është serbishtja. Karakteristikë për gjuhët me theks muzikor është se ato i ruajnë mirë të gjithë tingujt zanorë në çdo pozicion, të theksuar e të patheksuar.

b) **Theksi është dinamik ose intensiv** (i quajtur nganjëherë edhe ekspirator), kur rrokja e theksuar dallohet nga të tjerat për fuqinë dhe intensitetin e shqiptimit; domethënë rrokja e theksuar shqiptohet më fuqishëm sesa rrokjet e patheksuara (të patheksuarat shqiptohen më dobët). Theks dinamik kanë shumica e gjuhëve të sotme të Evropës, si: shqipja, maqedonishtja, anglishtja, frëngjishtja, italishtja, gjermanishtja, greqishtja e re, rusishtja, rumanishtja etj.

Por, ndërmjet këtyre dy tipave të theksit (theksit muzikor dhe theksit dinamik) nuk ekziston një dallim i prerë. Ata nuk e përjashtojnë njëri-tjetrin, pasi fuqia më e madhe e shqiptimit kushtëzon rritjen e numrit të dridhjeve, që përcaktojnë lartësinë e tonit; ashtu si edhe tonet më të larta lojnë në rritjen e intensitetit. Për këtë arsye mund të flitet për gjuhë, në të cilat mbizotëron njëri ose tjetri tip theksimi.¹⁸⁶ Kështu, në gjuhën shqipe rrokja e theksuar jo vetëm që është më e fortë, por edhe me ton më të lartë, më e gjatë dhe më e qartë sesa rrokja e patheksuar. Gjermanishtja e anglishtja kanë theks dinamik, por forca shoqërohet edhe nga lartësia e tonit dhe gjatësia. Madje, nganjëherë, elementet e të dy tipave përzihen bashkë, siç ndodh në norvegjishte dhe suedishte.

Në fjalët e gjata, sidomos në ato që përbëhen nga dy rrënjë, krahas theksit kryesor, mund të ketë edhe një theks tjetër më të dobët, që quhet *dytësor*. Kjo ndodh, sidomos në ato raste kur elementet përbërëse të fjalës e ruajnë pavarësinë e tyre, si p.sh. në kompozitat e shqipes (khs. *syzí*, *bukëshkálë*), por më pak në fjalët e përngjitura, ku elementet përbërëse, duke u ngjitur me njëri-tjetrin, e kanë humbur pavarësinë e tyre (khs. *sivjét*, *pardjé*).

8.3. GJUHËT ME THEKS TË NGULITUR DHE ME THEKS TË LIRË

Sipas vendit të theksit në fjalë, dallohen:

- **gjuhë me theks të ngulitur** (me përcaktueshmëri të përhershme të pozitës së theksit të të gjitha fjalët), dhe
- **gjuhë me theks të lirë** (pa përcaktueshmëri të përhershme të vendit të theksit në fjalë).

¹⁸⁵ Gjatë evolucionit, gjuhët mund ta ndërrojnë tipin e theksit si dhe pozicionin e tij në fjalë. Kështu, theksi muzikor i latinishtes dhe i greqishtes së vjetër është shndërruar më vonë në theks dinamik, sikurse e dëshmojnë gjuhët romane dhe greqishtja e re.

¹⁸⁶ Kolec Topalli, *Theksi në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1995, f. 40.

Në gjuhët me theks të ngulitur theksi në të gjitha fjalët rregullisht bie në të njëjtën rrokje. Kështu, p.sh. çekishtja dhe gjuhët ugrofine e kanë theksin gjithnjë në rrokjen e parë të fjalës (çek. *séstra* “motër”, *dóbrovolnik* “vullnetar”; hung. *Búdapest, mágyar* [magjar] “hungarez” etj.); në polonishte theksi bie në rrokjen e parafundit (*raspráwa* “diskutim”); në maqedonishte rregullisht theksohet rrokja e tretë e fjalës (d.m.th. theksi është tejfundor, po të numërohen rrokjet nga fundi: *sllatkárnica* “ëmbëltoje”, *vodénica* “mulli”, *pllánina* “mal” etj.).

Në turqishte, frëngjishte e armenishte theksi bie në rrokjen e fundit të fjalës, siç ruhet edhe në shumicën e huazimeve prej dy gjuhëve të para në gjuhën tonë (turq. *xhamí, teneqexhí, muhabét, zejtín, amanét*; fr. *byró, depó* etj.). Gjuhë me theks të ngulitur në rrokjen e parafundit (nëse zanorje ishte e gjatë) ka qenë edhe latinishtja: *auróra* “agim”, *lábrum* “buzë”; por në rrokjen e tretë nga fundi kur zanorja e dytë ishte e shkurtër: *lácrima* “lot”, *légere* “mbledh” etj.¹⁸⁷

Në këto gjuhë, vendi i theksit përcaktohet me një rregull të vetme fonologjike. Kur ndryshon gjatësia e fjalës gjatë fjalëndryshimit ose fjalëformimit, theksi rregullohet automatikisht në të njëjtën largësi nga fundi ose nga fillimi i saj. Krahaso: në maqedonishte *úçenik, uçénikot, uçenicite* “nxënës, nxënësi, nxënësit”; *uéniçka, uçeniçkata, uçeniçkite* “nxënëse, nxënësja, nxënëset”; *úçitel, uçítelot, uçítélite* “mësues, mësuesi, mësuesit”; *pródavaç, prodávaçi, prodaváçite* “shitës, shumë shitës, shitësit” etj.).

Pra, gjatë shtimit të numrit të rrokjeve tek e njëjta fjalë (me prapashtesa të ndryshme) theksi e ndërron rrokjen, gjithnjë për ta ruajtur pozitën e caktuar të theksit: në rrokjen e tretë nga fundi i fjalës. Kështu, në maqedonishte, e theksuar gjithnjë mbetet rrokja e tretë nga fundi, me pak përjashtime të tipit *godináva* “sivjet” < *ovaa gódina* [ovagódina] “këtë vit, sivjet” etj., ku theksohet rrokja e dytë; ose te disa fjalë të huazuara nga frëngjishtja, si *byró, depó* etj. te të cilat ruhet theksi fundor nga gjuha dhënëse).

Në gjuhët me theks të lirë në fjalë të ndryshme theksi vendoset në rrokje të ndryshme. Gjuhë të tilla janë shqipja, italishtja, spanjishtja, rusishtja, rumanishtja etj. Kështu, në latinishtje, si rregull, theksi qëndronte në njërin nga dy rrokjet e parafundit; në greqishten e vjetër, greqishten e re e italishte, ai bie në njërin nga tri rrokjet fundore; kurse në serbishte e kroatishte në çdonjërin rrokje të fjalës, me përjashtim të rrokjes së fundit.

¹⁸⁷ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 116

8.4. GJUHËT ME THEKS TË LËVIZSHËM DHE TË PALËVIZSHËM

Edhe ndërmjet gjuhëve me theks të lirë ka një dallim të qenësishëm, lidhur me vendosjen e theksit në pjesët e ndryshme të fjalës, përkatësisht me lëvizjen ose moslëvizjen e theksit brenda të njëjtës fjalë. Rrjedhimisht ka:

- a) *gjuhë me theks të lirë të lëvizshëm*, dhe
- b) *gjuhë me theks të lirë të palëvizshëm*.

Disa prej gjuhëve e lëvizin theksin gjatë procesit të eptimit (lakimit dhe zgjedhimit), pasi theksi nuk mbetet mbi të njëjtën rrokje të fjalës, por e ndryshon vendin, duke kaluar nga tema mbi mbaresën ose anasjelltas. Të tilla janë italishtja, spanjishtja, rusishtja etj. Këto quhen gjuhë *me theks të lirë të lëvizshëm*. Rusishtja, p.sh. e lëviz theksin në lakimin e emrave: khs. *gollová, góllovu, gollóv* dhe në zgjedhimin e foljeve: khs. *pishú, pishesh*. Në spanjishte: paskajore *cantár* “me këndue”, e tashme *cánto* “këndo”, aorist *cantó* “këndo”; në italishte: paskajore *parláre* “me folë”, e tashme *parlo* “unë flas”, aorist *parló* “foli”.¹⁸⁸

Ndërkaq, në disa gjuhë të tjera theksi qëndron i palëvizshëm në procesin e eptimit. Këto quhen gjuhë *me theks të lirë të palëvizshëm*. E këtillë është gjuha shqipe, anglishtja, gjermanishtja etj. Theksi i fjalëve në gjuhët me theks të palëvizshëm qëndron në të njëjtën rrokje edhe kur fjalës së njëjtë i shtohen rrokje të tjera.

Kështu, theksi i shqipes qëndron i palëvizshëm në procesin e eptimit të fjalëve, duke ruajtur pozicionin e tij të formave përfaqësuese (formave bazë të fjalëve), përkatësisht duke e ruajtur pozitën e tij të rasës emërore numër njëjës në lakimin emëror dhe atë të vetës së parë numër njëjës të kohës së tashme të mënyrës dëftore në zgjedhimin foljor. P.sh.: *mál, máli, i málit, málin, mále, málet, málesh, máleve; flútur, flútura, flúturat, flúture, flúturash, flúturave; qytetár, qytetári, qytetárit, qytetárin, qytetárë, qytetárët, qytetárësh, qytetárëve; láj, lán, lájme, láni, lájne; láva, láve, láu, lája, (kam, jam) lárë; punój, punón, punójme, punóni, punójne; punója, punóje, punónite, punónim, punónit, punónin; punóva, punóve, punói, punúam, punúat, punúan; kam punúar etj.*¹⁸⁹

Pra, karakteristikë themelore e gjuhës shqipe është se ajo ka theks të palëvizshëm (të qëndrueshëm), meqenëse gjatë lakimit ose zgjedhimit të fjalëve, theksi mbetet në po atë rrokje.

Përrjashtim nga ky rregull i përgjithshëm bëjnë pak emra që në shumës theksin e zhvendosin nga rrënja mbi prapashtesën trajtëformuese: *dhëndër - dhëndurë, njeri - njerëz, gísht - gishtërinj, gjárpër - gjarpërinj, lúmë - luménj, shkëmb - shkëmbínj* e ndonjë tjetër. Në këto raste, mund të pranojmë që ndryshimi i vendit të theksit shërben, krahas prapashtesave dhe ndërrimit të

¹⁸⁸ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 117.

¹⁸⁹ Te togjet e zanoreve, theksi bie mbi elementin e parë të togut: *i edukúar, grúa, përrúa, thúa, mësúes, i dëgjúeshëm, díell, qíell, fýell, përkthýes etj.*

fonemave, si një mjet redondant për shënimin e shumësit, përgjithësisht të kuptimeve gramatikore. Këto raste të ndryshimit të vendit të theksit gjatë formëformimit quhen *ndërrime theksore* a ndërrime të theksit. Te ndërrimet theksore këmbehen jo dy fonema, por dy skema të ndryshme të vendosjes së theksit të fjalës. P.sh. te *lúmë ~ lum-énj, dhëndër ~ dhëndúr-ë* skema e ndërrimit theksor është *‘ _ ~ _ ‘*. Pikërisht, kjo skemë shërben si gjymtyrë e ndërrimit theksor.

Përmbledhtas mund të thuhet se ndër tiparet themelore të theksit të shqipes, të analizuara e të pranuar nga shumë gjuhëtarë, janë:

- a) lidhur me llojin e theksit: *shqipja ka theks dinamik*;
- b) lidhur me lëvizshmërinë e tij: *shqipja ka theks të ngulitur në paradigmat e eptimit*;
- c) lidhur me vendin e theksit brenda fjalës: *shqipja nuk thekson mbaresat dhe ka prirje të theksojë zanoret parafundore*.

Shqipja është gjuhë me theks dinamik, të lirë dhe të palëvizshëm.

Theksi dinamik i shqipes duket:

1. në ndryshimet kuantitative ndërmjet zanoreve të theksuara e të patheksuara: zanoret e theksuara janë më të gjata sesa të patheksuarat;
2. në tkurrjen, por edhe në rënien e zanoreve të patheksuara;
3. në krijimin e një zanoreje të rrëgjuar [ë], nga zanoret e patheksuara;
4. në krijimin e fjalëve të patheksuara brenda fjalisë (trajtat e shkurtra, parafjalët, pjesëzat etj.).

8.5. TIPARET FONETIKE TË THEKSIT NË GJUHËN SHQIPE

Tiparet që shërbejnë për dallimin e rrokjes së theksuar ndryshojnë sipas gjuhës dhe kombinohen në mënyra të ndryshme.

Theksin, ashtu si edhe elementet e tjera prozodike, mund ta studiojmë: a) në aspektin fiziologjik, b) në aspektin akustik dhe c) në aspektin perceptiv. Dy këndet e para të vështrimit formojnë atë që quhet *prodhimi i theksit*, ndërsa i treti formon *përkapjen* (perceptimin, dëgjimin). Studimet tregojnë se në aspektin fiziologjik prodhimi i theksit lidhet me një forcim të tensionit muskolor, që në planin akustik pasqyrohet në rritjen e intensitetit të tingullit.¹⁹⁰

U konstatua se shqipja ka theks dinamik, meqë forca është elementi mbizotërues që e dallon rrokjen e theksuar nga të tjerat. Por, duhet pasur parasysh se rrokja e theksuar dallohet jo vetëm për forcë më të madhe, por edhe për gjatësi më të madhe, ton më të lartë etj.

Theksi i shqipes karakterizohet nga katër tipare që bashkëveprojnë: **intensiteti, gjatësia, lartësia dhe cilësia e zanores**. Të gjitha këto elemente

¹⁹⁰ Anastas Dodi, *Theksi dhe shkallëzimi i tij ...*, f. 6.

veprojnë së bashku, prandaj është e vështirë të dallojmë ç'rol luan njëri ose tjetri tipar i marrë veças.

1. **Intensiteti** përbën njërin nga parametrat kryesorë të theksit të gjuhës sonë. Rrokjet e theksuara në gjuhën shqipe shqiptohen me një intensitet më të madh se rrokjet e patheksuara. Zanoret e patheksuara janë jo vetëm më pak intensive, por më të shkurtra se zanoret e theksuara. Veç kësaj, ato bëhen më qendrore se zanoret e theksuara.

Zanoret nga natyra e tyre nuk kanë të gjitha të njëjtin intensitet. P.sh. zanoret e hapura janë më intensive se gjysmë të hapurat, ndërsa zanoret e mbyllura kanë intensitet më të vogël.

2. **Gjatësia** është një nga përbërësit kryesorë dhe më të qëndrueshëm të parametrave të theksit të shqipes. Zanorja e theksuar zakonisht është jo vetëm më e fortë, por edhe më e gjatë se e patheksuara. Edhe për gjatësinë (kuantitetin, kohëzgjatjen) e zanoreve, si edhe përgjithësisht për veçoritë e zanoreve të theksuara në përqasje me zanoret e patheksuara, janë shfaqur mendime të ndryshme. Mendohej, përveç tjerash, se zanoret e theksuara shqiptohen gati dy herë më të gjata se korrespondueset e tyre të patheksuara. Por, më vonë me metodën e fonetikës eksperimentale u vërtetua se natyra fizike e theksit në gjuhën shqipe është më komplekse sesa që mendohej.

Nga gjatësia e analizuar e zanoreve në disa jifte fjalësh, nga të cilat njëra shqiptohet me theks në rrokjen parafundore dhe tjetra me theks në rrokjen fundore, si: *kujdestári* (a = 19 qs, i = 8 qs) ~ *kujdestarí* (a = 8 qs, i = 5 qs); *punëtóri* (o = 14 qs, i = 12 qs) ~ *punëtorí* (o = 8 qs, i = 4 qs), *drejtóri* (o = 16 qs, i = 7 qs) ~ *drejtorí* (o = 8 qs, i = 8 qs), *bári* (a = 17 qs, i = 5 qs) ~ *barí* (a = 8 qs, i = 10 qs) është përdëftuar se zanorja e theksuar në gjuhën standarde shqipe herë-herë është më e shkurtër se zanorja e patheksuar.

Megjithëkëtë, përgjithësisht po të krahasojmë gjatësinë e zanoreve të theksuara me po të njëjtat zanore në pozitë të patheksuar, kur kushtet e tjera fonetike janë të njëjta, del se *zanoret e theksuara janë më të gjata sesa zanoret e patheksuara*.

Ja një paraqitje tabelore e gjatësisë së zanoreve në pozicion të theksuar dhe të patheksuar, e shprehur në të qindta të sekondës (qs):¹⁹¹

zanorja	e theksuar në të qs	e patheksuar në të qs	ndryshimi në të qs
[i]	9	7	2
[y]	9	7	2
[e]	11	7	4
[a]	10	8.5	1.5
[o]	11	7	4
[u]	12	7	5
[ë]	10	4.5	5.5

Tabla 19. Gjatësia e zanoreve të theksuara dhe të patheksuara

¹⁹¹ Po aty, f. 108.

Siç duket edhe nga tabela e dhënë, përpjesëtimi në gjatësi ndërmjet zanoreve të theksuara e të patheksuara është **10 : 7**.¹⁹² Po nga e njëjta tabelë del se jo të gjitha zanoret e patheksuara reduktohen njëlloj nga pikëpamja e gjatësisë. Bie fjala, zanoret [ë] dhe [u] rrëgjohen më shumë sesa zanoret e tjera, ndër to më së paku tkurret zanorja [a]. Zgjatja e zanores së theksuar ndikon jo vetëm në shkurtimin e zanoreve të tjera të patheksuara të fjalës, por edhe në shkurtimin e bashkëtingëlloreve të rrokjes së patheksuar. Prandaj thuhet se theksi i fjalës lidhet me rrokjen si tërësi dhe jo vetëm me zanoren e saj.

Do pasur parasysh se gjatësia e zanores nuk varet vetëm nga theksi, por edhe nga faktorë të tjerë gjuhësorë e jogjuhësorë. Rëndom, gjatësia (zanorja e gjatë) është shprehje e zhvillimit të tërësishëm dhe të papenguar të zanores, ndërsa shkurtësia (zanorja e shkurtër) është shprehje e pengueshmërisë në zhvillimin e zanores, e shkaktuar nga bashkëtingëlloret që vjen pas.¹⁹³ Pra, në gjuhën standarde shqipe kohëzgjatja e nyjëtimit të zanoreve modifikohet nga konteksti. P.sh. në rrokje të hapura zanoret janë më të gjata se në rrokje të mbyllura, përpara bashkëtingëlloreve shtegore ato janë më të gjata se përpara mbylltoreve. Gjatësia dhe intensiteti veprojnë së bashku për realizimin e theksit, në mënyrë të tillë që kompensojnë njëri-tjetrin.

Përgjithësisht pranohet që gjatësia nuk ka vlerë funksionale në shqipen standarde. Megjithatë, njohja e variacioneve të gjatësisë ka rëndësi për normën e shqiptimit letrar.¹⁹⁴ Të njëjtat zanore në kushte të ndryshme fonetike kanë edhe gjatësi të ndryshme.

3. Lartësia është parametri i tretë i realizimit të zanoreve të theksuara të shqipes. Zanoret e theksuara janë jo vetëm më të forta dhe më të gjata, por në disa raste shqiptohen edhe me një lartësi më të madhe të tonit. Siç tregojnë të dhënat psikoakustike, veshi i njeriut është më i ndjeshëm për ndryshimet më të vogla të lartësisë së tonit sesa të parametrave të tjerë. Por duhet thënë se në gjuhën shqipe ky parametër është më pak i qëndrueshëm se të tjerët kur bëhet fjalë për theksin e zakonshëm, d.m.th. për theksin joemocional. Lartësia, duke u bashkuar me gjatësinë, luajnë rol të rëndësishëm sidomos për përkapjen e theksit emocional.¹⁹⁵

4. Cilësia e zanores. Cilësia e shqiptimit të zanoreve të thaksuara është parametri i katërt, që luan rol në perceptimin e theksit. Zanoret e theksuara janë jo vetëm më të forta dhe më të qarta, por kanë edhe një timbër më të qartë se të patheksuarat. Kjo lidhet me një nyjëtim më të tendosur të këtyre zanoreve. Megjithëkëtë, gjuha shqipe bën pjesë në grupin e atyre gjuhëve, ku nuk ka dallime të mëdha cilësore midis zanoreve të theksuara dhe të patheksuara. Reduktimi kryesor i zanoreve të patheksuara të shqipes është reduktim sasiar, d.m.th. në gjatësi dhe natyrisht në forcë.

¹⁹² Bahri Beci, *Sistemi fonologjik ...*, f. 108.

¹⁹³ N. S. Trubeckoi, *Parime të fonologjisë*, Prishtinë, 1985, f. 131.

¹⁹⁴ Po aty, f. 104.

¹⁹⁵ Anastas Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 159-166.

Zanoret e rrokjeve të theksuara shqiptohen me një forcë më të madhe, janë relativisht më të gjata e disi më të qarta se të patheksuarat. Prandaj, të theksuarat gjatë ligjërimit janë më të qëndrueshme, më të mbrojtura dhe u nënshtrohen më pak ndryshimeve sesa zanoret e patheksuara.

Në ligjërime, zanoret e theksuara ruhen më mirë, ndërsa të patheksuarat rrëgjohen. Shkalla e tkurrjes së zanoreve të patheksuara varet nga pozicioni i tyre krahasuar me zanoren e theksuar si dhe nga natyra e rrokjes (e hapur ose e mbyllur). Rrokje e fuqishme (e mbrojtur) është rrokja e theksuar, ndërsa shkalla e reduktimit vjen duke u rritur sipas largimit nga rrokja e theksuar. Kështu, sa më larg theksit të jenë rrokjet e patheksuara, aq më shumë rrëgjohen dhe anasjelltas.

Megjithëkëtë, rrëgjimi i zanoreve të patheksuara në shqipen standarde nuk është i madh. Ai është më tepër rrëgjim sasior (kuantitativ, i gjatësisë). Kështu, zanoret e patheksuara humbasin një pjesë të gjatësisë dhe të forcës, d.m.th. shkurtohen dhe dobësohen, por përgjithësisht e ruajnë cilësinë (kualitetin) dhe timbrin e tyre (megjithëse edhe në këtë drejtim vihen re disa përjashtime). Të dhënat eksperimentale provojnë që [-ë]-ja fundore ka prirje të bjerë sidomos në stilin bisedor të gjuhës letrare, pa shkaktuar zgjatimin kompensator të zanores së theksuar para saj (siç ka ndodhur në të folmet e gegërishtes).¹⁹⁶

Në të folmet popullore, veçmas në të folmet gege, rrëgjimi i zanoreve të patheksuara është më i madh. Zanoret e patheksuara në gegërishten jo vetëm që kanë prirje të tkurren, por shpeshherë edhe bien, si p.sh. *flútur* > *flútër*, *përrállë* > *prrá:ll*, *móllë* > *mó:ll*, *shtëpí* > *shpí*, *shtëllúngë* > *shllú:ng*, *bashkëkohór* > *bashkohór* etj. Shembujt e dhënë dëshmojnë se ndonjëherë nuk shqiptohen jo vetëm zanoret e patheksuara, por edhe gjithë rrokja e patheksuar.

8.6. VENDI I THEKSIT NË FJALËT E GJUHËS SHQIPE

Shqipja nuk është gjuhë pa rregulla të theksit të fjalës. Shpeshherë është thënë e shkruar se nuk ka rregullsi në theksimin e fjalëve në gjuhën shqipe; se vendi i theksit në fjalë është i papërcaktuar etj. Ky pohim nuk qëndron as për shqipen e as për cilëndo gjuhë tjetër. Çdo shqiptar i thekson në mënyrë korrekte fjalët e gjuhës së vet. Çdo gjuhë është krijuar mbi sistem rregullash fonetike, morfologjike, leksikore dhe sintaksore. Rrjedhimisht, edhe në theksimin e fjalëve në shqipen ka rregullsi, ndërsa detyrë e gjuhëtarit është që t'i zbulojë e t'i përshkruajë ato.

Në të vërtetë, theksimi i fjalëve në shqipen nuk mund të përfshihet me një rregull të vetëm, si në gjuhët me përcaktueshmëri të përhershme të pozitës së theksit të të gjitha fjalët. P.sh.: në maqedonishte theksi bie në rrokjen e tretë të fjalës; në frëngjishte, turqishte – në rrokjen e fundit, në çekishte e

¹⁹⁶ Bahri Beci, *Sistemi fonologjik ...*, f. 105.

hungarishte – në rrokjen e parë të fjalës etj. Në këto gjuhë, vendi i theksit përcaktohet me një rregull të vetëm fonologjik.

Shqipja përgjithësisht ka theks të lirë të palëvizshëm në rrënjë të fjalës. Në gjuhët me theks të lirë në fjalë të ndryshme theksi vendoset në rrokje të ndryshme. Gjuhë të tilla janë shqipja, italishtja, spanjishtja, rusishtja, rumanishtja etj. Kështu, në latinisht, si rregull, theksi qëndronte në njërin nga dy rrokjet e parafundit; në greqishten e vjetër, greqishten e re e italishte, ai bie në njërin nga tri rrokjet fundore; kurse në serbishte e kroatishte në çdonjërin rrokje të fjalës, me përjashtim të rrokjes së fundit.

Në gjuhën tonë fjalët mund të jenë njërrrokëshe e shumërrrokëshe, deri më dhjetërrrokëshe e më shumë. Për të gjetur rregullën e theksit në shqipe nisemi nga fundi i fjalës. Në vendin e theksit të fjalëve shqipja ngjason shumë me anglishten: të dy gjuhët kanë tri pozicione të mundshme të theksit të fjalës, që përcaktohen nga natyra e rrokjeve.

U përmend se theksi i fjalës është spikatja me mjete fonetike e njëres prej rrokjeve të saj. Forca, lartësia e tonit dhe gjatësia janë mjetet kryesore që dallojnë rrokjen e theksuar të fjalës nga rrokjet e patheksuara. Shqipja ka theks të lirë të palëvizshëm në rrënjë të fjalës. Pra, ajo është pa ndërrime theksore të eptimit (lakimit dhe zgjedhimit), d.m.th. gjatë lakimit ose zgjedhimit theksi mbetet në po atë rrokje të temës së fjalës. Krahaso: *mál, máli, i málit, málin, mále, málet, málesh, máleve; punój, punón, punójmë, punóni, punójnë, punója, punóje, punónte, punónim, punónit, punónin; punóva, punóve, punói, punúam, punúat, punúan; kam punúar* etj.

Megjithëse në shqipen prapashtimet trajtëformuese nuk theksohen, për shkak se theksi mbetet gjithnjë mbi temën, ka do raste, sado të pakta, kur gjatë eptimit theksi zhvendoset mbi prapashtesën trajtëformuese. Kjo ndodh në emrat që e bëjnë shumësin me prapashtesat *-enj* dhe *-inj*: *lúmë - luménj, përrúa - përrénj, lëmë - léménj, i mádh - të mëdhénj, gísht - gishtérínj, gjárpër - gjarpérínj, prift - priftérínj, shkëmb - shkëmbínj, shkóp- shkopínj, drápër - drapérínj* etj.; te shumësi i emrave orientale me mbaresat *-llárë, -lérë*: *babá - baballárë, agá - agallárë, dájë - dajallárë; haxhí - haxhilérë, bėj - bejlérë* etj.; te pak emra ku theksi lëviz brenda temës: *dhëndër - dhëndúrë, njerí - njérëz*; te foljet *bíe - bjérë, shtíe - shtjérë* etj.

Fjalët me lëvizshmëri të theksit në morfema të ndryshme në shqipen janë të pakta dhe përbëjnë përjashtime që nuk e lëkundin rregullën e përgjithshme të palëvizshmërisë së theksit.

Gjuha shqipe bën pjesë në grupin e gjuhëve, ku theksi në fjalë leksikalisht të ndryshme bie në rrokje të ndryshme, përkatësisht më shpesh në njërin nga dy rrokjet e fundit të fjalës (më rrallë në rrokjen e tretë ose në të katërtën). Theksi nuk bie asnjëherë mbi mbaresat rasore të emrave, të mbiemrave dhe të përemrave, as mbi mbaresat vetore të foljeve, mbi nyjat e përparme edhe të

prapme si dhe mbi parashtesat. Mbi prapashtesat e shumësit të emrave dhe të mbiemrave, me disa përjashtime, gjithashtu theksi nuk bie.

Pra, theksi në gjuhën shqipe është i ngulitur mbi një rrokje, ku nuk ndodhen treguesit gramatikorë. Te foljet, qofshin ato të parme, të prejardhura, të përbëra ose të përngjitura, theksi bie gjithnjë në rrokjen e fundit të temës. Por te foljet që kanë në temë një tog zanoresh (si p.sh. *luaj, thyej, ngjyjej, ziej, përziej* etj.) theksi bie mbi rrokjen e parafundit të temës. Te ndajfoljet theksi bie më shpesh në rrokjen e parafundit të temës.

Në fjalët njërrrokëshe theksi bie mbi zanoren e vetme të fjalës: *mík, qén, dé, lësh, lís, mál, plák, fúnd, ménd, shtëg, dréjt, trím, gúr, rrúsh, drú, shkój, mbjéll, sjéll, dál, há, pí* etj.

Në fjalët shumërrrokëshe, theksi bie:

1. **Në pozitë fundore** (në rrokjen e fundit, në rrokjen e parë nga fundi i fjalës; të tillat quhen fjalë **oksitone**): *njerí, qirí, qytét, lirí, babá, shtëpí, ushtrí, barí, folé, puním, mësój, lexój, shikój, mendój* etj. Te foljet, theksi bie rregullisht mbi zanoren e fundit të temës.

Me theks fundor shqiptohen edhe fjalët e prejardhura, të formuara me anë të prapashtesimit (me prapashtesat -ár, -tár, -ór, -tór, -íst, -í, -ít, -iót, -sí, -rí, -ím, -úk, -ëshë, -úshë, -ác, -áč, -ák, -án (-ján), -ér (-iér), -ó-, -só-, -zó-, -ós-, -atë-, -ore, -tore, -ishte, -ishtë, -ajë, -najë, -icë, -izëm, -azëm, -itet, -imisht, -avec etj., të cilat marrin mbi vete theksin e fjalës):¹⁹⁷ *fshát - fshatár, qytét - qytetár, dé - detár, údhtë - udhétár, lúftë - luftétár, lákër - lakrór, dásëm - dasmór, mál - malór, ákull - akullóre, rrégull - rregullóre, bótë - botérór; púnë - puním, punétór, punétorí; árt - artíst, futbóll - futbollíst, spórt - sportíst, mjéshtër - mjeshtrí, drejtór - drejtorëshë, zónjë - zonjushë, i ëmbël - ëmbëlsí, djálë - djaléri, rrúgë - rrugáč, Dúrrës - durrsák, Rómë - romák, Díbër - dibrán, Shkódër - shkodrán, ménd - mendój, flákë - flakérój, shtëg - shtegtój, frikë - frikësój, dórë - dorézój, fúnd - fundós, hékur - hekurós, fjálë - fjalós, alkoól - alkoolík* etj.

Por theksi nuk kalon te prapashtesat: -më (-ëm), -je, -ës, -të, -as, -e, -shëm. Krahaso: *klíth - klíthmë, dal - dálje, mblédh - mblédhës, flákë - i fláktë, fyt - fytas, mík - míke, kënáq - i kënáqshëm, vénd - véndas, Maqedóni - maqedónas, Gjilán - gjilánas; nxë - nxënës, prés - prítës, bléj - blérje, ndjék - ndjékje, përcjéll - përcjéllje* etj.

2. **Në pozitë parafundore** (në rrokjen e dytë nga fundi; të tillat quhen fjalë **paroksitone**): *mótër, aníje, déle, lúle, bésë, shkóllë, fúshë, dárdhë, émër, fémër, létër, móllë, púlë, ...* Shqipja ka prirje për theksimin e zanoreve parafundore.

¹⁹⁷ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe, vëllimi I, Morfologjia*, Tiranë, 1995, f. 100; Anastas Dodi – Jorgji Gjinari, *Fonetika (maket)*, Tiranë, 1983, f. 130.

3. **Në pozitë tejfundore** (në rrokjen e tretë, rrallë edhe në të katërtën nga fundi i fjalës; të tillat quhen fjalë **proparoksitone**): *flútura, kúmbulla, plúhuri, fúshave, ndéshemi, fshehúrazi; punúakëshim, punúakemi* etj.

Do përmendur se numri më i madh i fjalëve që ndonjëherë dalin me theks në pozitë tejfundore, fjalët e njëjta në format e tyre përfaqësuese, në format bazë (trajta e pashquar e rasës emërore e numrit njëjës në lakimin emëror dhe veta e parë numër njëjës të kohës së tashme të mënyrës dëftore në zgjedhimin foljor) janë fjalë me theks në rrokjen parafundore ose fundore. Por, në sajë të palëvizshmërisë së theksit, meqë ai qëndron në të njëjtën rrokje edhe kur fjalës i shtohen rrokje të tjera, ato shndërrohen në fjalë me theks tejfundor. Khs. *flútur - flútura, kúmbull - kúmbulla, plúhur - plúhuri, fúshë - fúshave, ndéshem - ndéshemi; punój - punúakëshim - punúakemi* etj.

Sigurisht, ndarja e fjalëve me theks fundor, parafundor dhe tejfundor është relative, pasi gjatë procesit të eptimit njëri tip mund të kalojë në një tip tjetër. Kështu, emrat me theks fundor të trajtës së pashquar (*mal*), kur shquhen, kalojnë në fjalë me ritëm trokaik;¹⁹⁸ kurse emrat pa mbaresë me ritëm trokaik, kur shquhen kalojnë në fjalë me ritëm daktilik.¹⁹⁹

Përcaktimi i një rregulle të përgjithshme të vendit të theksit në fjalët e gjuhës shqipe (sidomos tek emrat ku dalin më shumë probleme), mund të bëhet duke analizuar tipat kryesorë të fjalëve, sipas pozicionit të theksit.

Për të përcaktuar rregullën e përgjithshme të theksimit të zanoreve në shqipen e sotme, duhet marrë parasysh evolucionin e zanoreve të patheksuara në fjalët daktilike: a) se në temat daktilike, *dimër(ë)*, ose trokaike pa mbaresë, *balshëm*, zanoret pastheksore në trup të fjalës mund të qëndrojnë vetëm në gjendjen e zanores -ë-; përndryshe shpërngulja e theksit mbi këto zanore është e pashmangshme (khs. *nevójë, sokól*); b) zanorja e patheksuar [ë] e ka humbur aftësinë dhe mundësinë për të mbajtur theksin e fjalës; si rrjedhim ajo nuk formon rrokje theksmbajtëse. Pas këtij përjashtimi, rregulla e përgjithshme e vendosjes së theksit mund të përcaktohet si vijon:

Në gjuhën shqipe theksi i fjalës vendoset në zanoren e fundit të parrëgjuar të temës fjalëformuese.

Me këtë rregull pajtohen:

a) temat oksitone pa mbaresë (*mal, qytet*), që e vendosin theksin në zanoren fundore;

¹⁹⁸ Trok/é -u m., trokaik -e mb. fjalë greke; *let.* masë vargu në poezinë klasike, e formuar nga dy rrokje, prej të cilave e para është e gjatë dhe e dyta e shkurtër (_U). (Mikel Ndreca, *Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja*, Prishtinë, 1986, f. 711.).

¹⁹⁹ Daktil-i m., daktilik-e mb. nga greqishtja - gisht, gishtore; *let.* në poezinë greke e latine, këmbë trirrokëshe, në të cilën rrokja e parë është e gjatë, ndërsa dy të tjerat janë të shkurtra. (Mikel Ndreca, *Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja*, Prishtinë, 1986, f. 126.).

b) fjalëformat trokaike (*fushë, lule, qytete, mali, miku, shkolla*), ku zanoret e patheksuara (-ë, -e, -i/-u, -a) janë mbaresa, domethënë nuk bëjnë pjesë në temën e fjalës;

c) temat daktilike *dimër(ë)* ose trokaike pa mbaresë *balshëm*, pasi zanorja -ë- është e patheksueshme; si rrjedhim, zanorja e ballit të fjalës mbetet e vetmja zanore, ku mund të qëndrojë theksi i fjalës;

ç) trajtat gramatikore që formojnë fjalë daktilike (*fushat(ë), maleve*), pasi dy zanoret e fundit bëjnë pjesë në mbaresë e jo në temën fjalëformuese;

d) fjalët që përmbajnë zanore anaptitike²⁰⁰ (*vendësit, të vegjëlit*), pasi ky tingull, i shtuar për lehtësi shqiptimi, nuk bën pjesë në temën e fjalës (ksh. *vendës, të vegjël*).

Me këtë rregull mund të kuptohet edhe karakteri parafundor i theksit. Meqenëse shqipja e ka ruajtur relativisht mirë karakterin sintetik dhe eptimin e fjalëve e bën, përgjithësisht, me një mbaresë; vendosja e theksit në zanoren e fundit të temës krijon, bashkë me mbaresën, fjalë parafundore.²⁰¹

Theksimi parafundor përbën modelin karakteristik të skemës theksore të fjalëve të shqipes, prandaj edhe fjalët e huazuara nga gjuhët e tjera shpesh e rregullojnë theksin sipas natyrës së shqipes me të ashtuquajturin *rregullim mekanik të theksit*, si shprehje e rregullsisë së theksimit të zanoreve në gjuhën shqipe. Sipas këtij procesi, shqipja ka prirje ta vendosë theksin e fjalës në rrokjen parafundore. P.sh. te sllavizmat në gjuhën shqipe theksi nga rrokja e tretë zhvendoset në rrokjen e dytë, si sll. *névolja* - shq. *nevóje*, sll. *lópata* - shq. *lopátë*, sll. *lédina* - shq. *ledínë* etj., por disa fjalë shqiptohen me theks në rrokjen fundore. Disa orientalizma, si *kafe, teneqe, penxhere, Fatime* etj. në toskërishte e ruajnë theksin fundor si në gjuhën dhënëse, ndërsa në gegërishte është bërë rregullimi mekanik i theksit, përkatësisht fjalët e tilla shqiptohen me theks parafundor.

Disa huazime leksikore shqipja i ka përshtatur (adaptuar) sipas natyrës së vendit të theksit në shqipen, ndërsa disa të tjera e ruajnë theksin si në gjuhën dhënëse (prej nga vijnë). Pra, përgjithësisht ato shqiptohen ose me theks parafundor ose me theks fundor. Rol të rëndësishëm për adaptimin e theksit të fjalëve të huazuara luajnë koha (se a janë huazime të vjetra apo të reja) dhe denduria e përdorimit të tyre. Parimisht, sa më gjatë të jenë në përdorim, aq më tepër janë përshtatur; dhe sa më shpesh që përdoren aq më shumë kanë gjasa të adaptohen e anasjelltas.

²⁰⁰Anaptiks-i *m.* (gr. zhvillim); *gjuh.* tingullshtesë, futja e një zanoreje në mes të dy bashkëtingëlloreve, ku etimologjikisht nuk e ka vendin, për shqiptim më të lehtë ose gabimisht.

²⁰¹ Kolec Topalli, *Theksi në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1995, f. 65-67.

8.7. RREGULLAT E THEKSIMIT TË FJALËVE NË SHQIPEN

Për vendin e theksit në fjalët shumërrokëshe në gjuhën shqipe mund të themi se:

1. Në fjalët e parme theksi bie në rrënjën e fjalës (e jo në mbaresë); khs. *djalë, djál-i, djál-in, djál-it, djém, djém-të, djémsh, djém-ve; újk-u, újk-un, újq-it, újq-ve, újq-ish; qén-i, qén-in, qén-it, qén-të, qénsh, qén-ve* etj.);

2. në fjalët me prejardhje prapashtesore (përveç prapashtesave -as, -ës dhe -je), theksi vendoset në prapashtesë; khs. *detár, vreshtár, tetovár, moshatár, gojëtar, mbretërëshë, ulkónjë, djalëri, besnikëri, ahishtë* etj.;

3. në fjalët me prejardhje parashtesore, theksi vendoset në rrënjë; khs. *përplás, përpunój, stërgjýsh, mosbesím, përmbýll, mospërfíllje, mbishkrím, nënkuptój, paramendím* etj.;

4. në fjalët e përbëra (kompozita), theksi vendoset në elementin e dytë formues; khs. *botëkuptím, mirësjéllje, kryeqytét, jetëgjátë, vetëshërbím, syshkrúar, udhëhëqës, bukëpjékës, hekurúdhë, vendbaním, bashkëpunëtór, drejtshkrím, mirëmbáj, buzëqësh, zëvëndës* etj.;

5. në fjalët e përngjitura, theksi bie në elementin e fundit formues; khs. *falemndërit, tungjatjéta, vëréj, atëhërë, farefis, gjëegjézë, lamtumirë, dalëngadálë, ndonjëhërë, gjithmónë, anembánë, atëhërë, menjëhërë, shkeleshkó; numërorët prej 11 deri më 19 (njëmbëdhjëtë, dymbëdhjëtë,...), njëqínd, dyqínd* etj.;

6. fjalët e huazuara i janë përshtatur natyrës së shqipes: ato shqiptohen ose me theks parafundor ose me theks fundor.²⁰²

Vendi i theksit në fjalët me dy e më shumë rrokje, duke u mbështetur në sasinë e përgjithshme të fjalëve të “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe” (1980) paraqitet kështu:

54 % e fjalëve kanë theks parafundor,

44 % kanë theks fundor dhe

2 % kanë theks tejfundor.

Pra, në fjalët e gjuhës shqipe mbizotëron theksi parafundor, pastaj vjen theksi fundor, ndërsa theksat e tjerë zënë një vend të vogël.

Tek emrat e gjinisë femërore mbizotëron theksi parafundor, tek emrat mashkullorë mbizotëron theksi fundor (4 herë më shumë se theksi parafundor).

Foljet që mbarojnë me -oj, të cilat përbëjnë shumicën e foljeve të shqipes, në trajtën përfaqësuese kanë theks fundor, por gjatë zgjedhimit theksi kalon në parafundor (*punój – punóve, punónte, punúar, punóhet*) etj.²⁰³

²⁰² Kolec Topalli, *Theksi në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1995, f. 60-61.

Në gjuhën shqipe, të theksuara mund të jenë zanoret me gjatësi të ndryshme: të gjatat, të mesmet dhe të shkurtrat. Kështu, shqipja njih tre tipa kryesorë fjalësh, që, sipas përbërjes rrokjesore, dallohen edhe nga kuantiteti i zanores së theksuar:

1. fjalë me theks fundor në rrokje të mbyllur, ku zanorja e theksuar është e shkurtër (*qark, mbledh, plep, mik, dash, trim, lis, mal, shok*);
2. fjalë me theks fundor në rrokje të hapur, ku zanorja e theksuar është e gjatë (*shi:, thi:, mi:, liri:, dhe:, folé:, shtëpi:*);
3. fjalë me theks jofundor, ku zanorja e theksuar është e gjatësisë së mesme (*nënë, dímër, dárdha, fúsha, émër, lúlja, létra, mótra*).²⁰⁴

Profesor Rami Memushaj, duke dëgjuar theksime jonormative në shqiptimin e folësve të radiove dhe të televizioneve, jep një këshillë praktike. Shqiptimet e gabuara mund të mënjanoen lehtë, në qoftë se folësi do të zbatojë këtë rregull të thjeshtë:

Theksoji fjalët shqipes ose të huaja në rrokjen e fundit, në qoftë se kjo nuk rrëgohet dhe në rrokjen e parafundit nëse rrokja e fundit rrëgohet.²⁰⁵

8.8. TËRËSITË THEKSORE NË FJALI

Në bazë të veçorive leksikore, pjesët e ligjëratës mund të ndahen në tri grupe të mëdha: në *fjalë kuptimplota*, në *fjalë jokuptimplota* dhe në *fjalë thirrmore*. *Fjalë kuptimplota* janë ato që kanë një kuptim leksikor të plotë, janë të theksuara dhe përdoren si gjymtyrë më vete. Në këtë grup hyjnë:

- a) *fjalët emërtuese*, d.m.th. fjalët që emërtojnë sende (*emrat*), cilësi (*mbiemrat*), veprime si procese (*foljet*) dhe rrethana (*ndajfoljet*);
- b) *fjalët numëruese*, d.m.th. fjalët me të cilat numërojmë (*numërorët*);
- c) *fjalët treguese*, d.m.th. fjalët që tregojnë (pa emërtuar) sende, cilësi ose sasi (*përemrat*).

Fjalë jokuptimplota janë ato që kanë kuptim leksikor të kushtëzuar nga shërbimi që kryejnë në fjali dhe nuk kanë theks. Kuptimi i tyre leksikor në përgjithësi përkon me kuptimin e tyre gramatikor. Të tilla janë: 1. *parafjalët* dhe *lidhëzat* që shprehin lidhje sintaksore midis dy gjymtyrëve (të fjalisë ose të periudhës); 2. *pjesëzat*, që shprehin ngjyrimë kuptimore plotësuese të fjalëve a

²⁰³ Anastas Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 177.

²⁰⁴ Si zanoret e shkurtra, ashtu edhe zanoret e gjata gjatë ndryshimit të formës së fjalës (kur po të njëjtave fjalë u shtohet ndonjë rrokje tjetër) bëhen të mesme, si *qark, mbledh, plep* (zanore të shkurtra) - *qarku, mbledhim, plepi* (zanore të mesme); ose *dhe:, shi:, shtëpi:* (të gjata) - *dheu, shiu, shtëpia* etj. (të mesme).

²⁰⁵ Rami Memushaj, *Për shqipen standarde I - çështje të normës morfologjike dhe drejtshkrimore*, Infbotues, Tiranë, 2012, f. 135.

të togfjalëshave. *Fjalë thirrmore* janë ato që përdoren për të shprehur, në formë thirrjesh, ndjenja të folësit (*pasthrrmat*).

Nga pikëpamja semantike, fjala mund të përkufizohet si njësi e kuptimshme e cila në fjali mund të qëndrojë në vende të ndryshme. Fjalën me saktësi relative mund ta përcaktojmë nëpërmjet shkrimit. Nga këndvështrimi artikullativ, **tërësi theksore** (union theksor) **është rrjedha tingullore që nyjëtohet pandërprerë dhe me një theks të vetëm**.

Nga mënyra e shkrimit, fjala është bashkësi shkronjash brenda dy zbrazëtirash (hapësirash, pauzash: në fillim e në fund), d.m.th. ajo pjesë e fjalisë që shkruhet njësh (bashkë, pa ndërprerje). Në gjuhën shqipe, si dhe në gjuhët e tjera, disa fjalë edhe pse shkruhen ndaras, ato shqiptohen së bashku dhe me një theks të vetëm. Pra, fjalët e patheksuara edhe pse shkruhen ndaras shqiptohen me një theks të vetëm me fjalët e theksuara. Në këtë bashkim të pandërprerë shqiptimor formohet një **njësi theksore, një fjalë fonetike, një tërësi theksore** (union theksi).²⁰⁶

Dy ose më shumë fjalë që shqiptohen me një theks të vetëm (të përbashkët) përbëjnë një **tërësi theksore** (union theksi). Tërësitë theksore në pikëpamje fonetike shqiptohen si një varg i pandërprerë tingujsh, pra si një fjalë e vetme dhe u nënshtrohen po të njëjtave rregulla të theksimit si edhe fjalët kuptimplota (në rrokjen parafundore ose fundore). P.sh.:

<i>Fjalë kuptimplota</i>	<i>Tërësi theksore (shqiptohet)</i>
përparím	im_ bír
kryeqytét	n_ agím
arsimtár	në_ të_ mír
përpunój	kam_ punúar
riatdhesím	për_ të_ mësúar
bibliotékë	shikoj_ é_ ni!

Tabela 20. Theksi në fjalët kuptimplota dhe jokuptimplota

Meqenëse një sasi e madhe e rrymës së ajrit shpenzohet (harxhohet) në rrokjen e theksuar, tingujt e tjerë e po të njëjtës fjalë ose të fjalës tjetër me të cilën krijon tërësi theksore shkurtohen, aq sa mund të ndryshojnë edhe tiparet themelore të tyre, madje edhe të mos shqiptohen fare. Reduktimi (shkurtimi, zvogëlimi i kohëzgjatjes së nyjëtimimit) i rrokjeve të patheksuara është pasojë e sasisë së pamjaftueshme të rrymës së ajrit që do të mund të shpërndahej në mënyrë të barabartë në të gjitha rrokjet. Kjo është arsyeja e lidhjes së dy e më tepër fjalëve me një kulm të vetëm theksi, d.m.th. për krijimin e tërësive theksore. Sa më fuqishëm e me gjatësi më të madhe të shqiptohen rrokjet e theksuara, aq më shumë do të shkurtohen rrokjet e patheksuara.

²⁰⁶ Termin **tërësi theksore** (union theksi) që e kemi krijuar ne, e konsideromë si më të qëlluar sesa *njësi theksore, fjalë fonetike* që janë përdorur deri më tani në gjuhësinë shqiptare. Në kroatisht e serbisht kemi termin 'naglasne cjeline', në maqedonisht акцентска целост 'akcentska celost'.

Tërësi theksore (union theksi) krijohen edhe në gjuhë të tjera. Në gjuhën maqedonase union theksi krijohet jo vetëm nga bashkëlidhja e një fjale jokuptimplote me një fjalë kuptimplote, por edhe nga lidhja sintaksore midis dy pjesëve të kuptimshme, si në sintagmat emër + emër, mbiemër + emër, përemër + emër, numëror + emër, numëror + numëror, ndajfolje + emër, aq sa edhe në një fjali të tërë (Што,мý,рече? - Shto,мý,реçe?). Në maqedonishten edhe në tërësi theksore theksi bie rregullisht në rrokjen e tretë (nga fundi i fjalës): доктор,Áрсов (doktor,Ársov), киселó,млеко (kiselló,mleko), сувó,грозје (suvó,grozje), мóј,човек (móј,çovek), тóј,ден (tóј,den), Газí,Баба (Газí,Баба), братý,чед,ми (bratý,çed,mi), дáj,ми,ги (dáj,mi,gi), не,тý,рече (не,тý,реçe), Кој,гó,видел? (Кој,гó,videl?) etj.²⁰⁷

Aftësinë për të formuar tërësi theksore (union theksi) më vete e kanë vetëm fjalët quajtëse (emërtuese), kurse fjalët shërbyese jo, meqë bashkohen me fjalët quajtëse. Në këtë mënyrë, fjala quajtëse shërben si *bërthamë* e tërësisë theksore. P.sh. në thënien *Sot kam mësuar deri në orët e vona të mëngjesit*; fjalët shërbyese *kam, në, e, të* nuk mund të formojnë tërësi theksore më vete, as të shërbejnë si *bërthamë* e saj, meqenëse shqiptohen të patheksuara. P.sh. fjalia e mëposhtme ka 5 fjalë, por 3 tërësi theksi:

Fjalë

Studentët tanë mësojnë me zell.
 1 2 3 4 5

Tërësi theksi (union theksi)

Studentët,tanë mësojnë me,zell.
 1 2 3

Ligjërimi ynë përbëhet prej fjalësh të bashkuara nga pikëpamja gramatikore dhe kuptimore në togje të ndryshme. Bie fjala, në fjalinë: *Nga dashuria e madhe për atdheun buronin ato fjalë zemre të mërgimtarëve*; mund të dallojmë togëzime të ndryshme fjalësh. Nga fjalia e mësipërme mund të nxjerrim togjet: *nga dashuria e madhe, dashuria për atdheun, buronin fjalë, ato fjalë, fjalë zemre, fjalë të mërgimtarëve*.

Ndryshimet e fjalëve, që ndodhin në ligjërimin e gjallë, nuk pasqyrohen gjithnjë në gjuhën e shkruar; si rrjedhim, kjo e fundit, duke synuar ngulitjen e normës, vepron si një frenues ndaj prirjes për ndryshime të fjalëve në gjuhën e folur. Për këtë mjafton të kihet parasysh grafia e autorëve të vjetër (sidomos e Budit), që, në përgjithësi, ndjekin një drejtshkrim të bazuar në fonetikën sintaksore, duke i shkruar grupe-grupe, sipas ritmikës së fjalisë.²⁰⁸

²⁰⁷ Стојка Бојковска, Лилјана Минова – Ѓуркова, Димитар Пандев, Живко Цветковски, *Македонски јазик за средното образование*, Просветно дело АД, Скопје, 2001, f. 85.

²⁰⁸ Pjetër Budi në *Doktrina e Krishterë* (DC 83), shkruan p.sh. *Exhakoni mbet ejthase, unë mirë edi eembesonj megjithë zemërë*, që, me drejtshkrimin e sotëm, duke respektuar ndarjen morfologjike të fjalëve, do të jepej kështu: *E xhakoni mbet e i tha se unë mirë e di e e mbesonj me gjithë zemërë*. Kolec Topalli, *Theksi në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1995, f. 286.

Shkruhet sipas parimit morfologjik dhe ruajtjes së kufirit të fjalëve::

Ismail Kadare nisi të shkruajë kur ishte ende i ri, fillimisht poezi, me të cilat u bë i njohur, e më pas edhe prozë, duke u bërë prozatori kryesor shqiptar.

Periodha e mësipërme lexohet me fjalë të lidhura grupe-grupe, duke i ndërlidhur fjalët në njësi shqiptimore e unitet theksor, si:

[Ismáil Kadaré nísi të shkrúajë kur íshte endé i ri/ fillimísht poezí/ me të cilát u bë i njóhur/ e më pás edhe prózë/ duke u bërë prozatóri kryesór shqiptár].

Edhe përkaj rregullave të përgjithshme, grupimi i fjalëve në ligjërime nuk bëhet përherë njëloj. Siç modifikohen fonemat në fjalë, ashtu modifikohen edhe fjalët në fjali e fjalitë në periudha. Kjo varet nga shumë faktorë, veçmas nga ritmi i të folurit, qëllimi i thënies, theksi logjik, konteksti i ligjërimit etj. Shikuar nga ky këndvështrim, edhe fjalët në periudhën e dhënë nga folës të ndryshëm mund të ndërlidhen në fjalë fonetike (tërësi theksore) në mënyra të ndryshme.

Marrë në përgjithësi, në ligjërimitonë, disa fjalë e ruajnë theksin (të tillat quhen fjalë akcentogjene, tonike), ndonjëra bëhet fjalë e patheksuar (atone, klitike), ndonjëra shqiptohet me theks të dobësuar, ndërsa ndonjë tjetër me theks dytësor.²⁰⁹

8.8.1. FJALËT E PATHEKSUARA

Siç dihet, çdo fjalë kur shqiptohet e veçuar nga të tjerat ka theksin e vet. Mirëpo, kur ato bashkohen në fjali, disa e humbasin theksin e vet, përkatësisht bëhen të patheksuara. Përgjithësisht, **fjalët emërtuese e ruajnë theksin, ndërsa fjalët shërbyese bëhen të patheksuara**. Si fjalë të patheksuara në fjali paraqiten zakonisht fjalët shërbyese (parafjalët, lidhëzat, pjesëzat, foljet ndihmëse, nyjat, trajtat e shkurtra të përemrave vetorë etj.), por edhe disa fjalë emërtuese, zakonisht njërrrokëshe. Këto fjalë klitike (pa theks, të patheksuara) bashkohen në shqiptim me fjalët emërtuese që kanë theks (fjalët akcentogjene), formojnë me to një grup që shqiptohet me një theks të vetëm, d.m.th. formojnë një **njësi theksore** ose, siç thuhet ndryshe, **një fjalë fonetike**,²¹⁰ një tërësi theksore.

Fjalët që nuk kanë theks quhen *klitike* (fjalë të patheksuara). Fjalët e patheksuara janë fjalëza me kuptim leksikor të dobësuar, që shërbejnë zakonisht për të shprehur marrëdhënie të ndryshme gramatikore. Sipas

²⁰⁹ Kostaq Cipo në tekstin *Fonetika*, Tiranë, 2003, f. 39 thotë se “fjalët ndahen në këto tri kategori: **orthotonike, proklitike** dhe **enklitike**.”

²¹⁰ Anastas Dodi, *Theksi dhe shkallëzimi i tij në gjuhën shqipe*, Gjuha jonë 2/1990, Tiranë, f. 8.

pozicionit ndaj fjalës së theksuar (fjalës bërthamë, quajtëse), fjalët e patheksuara ndahen në:

- **fjalë proklitike** (fjalë paratheksore, që ndodhen para fjalës së theksuar) dhe
- **fjalë enklitike** (fjalë pastheksore, i prapavihen fjalës së theksuar, shqiptohen e shkruhen njësh si një fjalë e vetme).

Në gjuhën shqipe fjalët pastheksore lidhen më ngushtë me fjalët emërtuese sesa fjalët paratheksore (khs. *dërgómë* – *më,dërgó*, *ndréqua* – *ua,ndréq*). Kjo ndodh, sepse enklitiket janë të zhveshura krejtësisht nga kuptimi leksikor, nuk kanë peshë semantike; ndërsa proklitiket mund të kenë një kuptim leksikor të dobësuar, khs. *pàra,shtëpísë*; *ndréqë*, *ndréqjàni* etj.²¹¹

1. **Fjalë proklitike** (nga greq. e vj. *proklino*, “paraprirje, paravendosje”) quhen fjalët e patheksuara që ndodhen përpara fjalëve të theksuara dhe shqiptohen me një theks të vetëm me to. Fjalë paratheksore në gjuhën shqipe janë:

- nyjat e përparme **i, e, të, së**: *mali i,lartë*, *toka të,punuara*, *të,ardhurat*, *fushës së,gjerë* etj.;
- trajtat e shkurtra të përemrave vetorë **më, të, i, na, ju, ua, ia** etj., p.sh. *më,dha*, *u,tha*, *ua,tregova*, *t,ia,japësh* etj.²¹²
- parafjalët njërrrokëshe, si **në, me, më, për, mbi, nën, ndër, nga, te** etj.: *në,shtëpi*, *me,gëzim*, *për,shokun*, *mbi,tavolinë*, *nën,urë* etj.;
- lidhëzat njërrrokëshe: **e, dhe, se, si, kur, ku** etj., si *ujku e,qengji*, *djali dhe,zogu*, *shpreson se,koha ...* etj.;
- disa pjesëza njërrrokëshe: **u, mu, që, po, le, do të, për të** etj., si *u,ngrit*, *mu,te,shtëpia*, *që,të,gjithë*, *po,punon*, *le,të,shkojë*, *do,të,punoj*, *për,të,ditur* etj.;
- përemrat pronorë përpara emrave të farefisnisë, si **im, yt**: *im,vëlla*, *yt,vëlla* etj.;
- foljet ndihmëse që shërbejnë për të krijuar forma foljore të përbëra (analitike) **jam** e **kam**, p.sh. *kam,punuar*, *është,ndrequr*, *kishte,marrë* etj.

2. **Fjalë enklitike** (nga greq. *enklino*, “prirem, shkoj pas, prapavendosje”) janë fjalët e patheksuara, që bashkohen në shqiptim me fjalën e theksuar që është para tyre. Pra, fjalët enklitike i bashkëngjiten fjalës emërtuese. Të tilla janë trajtat e shkurtra të përemrave vetorë si dhe pjesëza **u** e formës joveprore, që vendosen pas foljeve në mënyrën urdhërore. Këto shkruhen dhe shqiptohen bashkë si një fjalë e vetme. Krahaso format enklitike (format pohore) me format përkatëse proklitike (format mohore): *Ndihmo-j-e shokun!* - Mos **e** ndihmo!; *Hiqe!* - Mos **e** hiq!, *Ndreqe...!* - Mos **e** ndreq!,

²¹¹ Anastas Dodi – Jorgji Gjinari, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 131-132. Anastas Dodi, *Theksi dhe shkallëzimi...*, f. 8.

²¹² Trajtat e plota të përemrave vetorë (*mua, ty, atë, ne/neve, ju/juve* etj.) në gjuhën shqipe janë fjalë të theksuara, ndërsa trajtat e tyre të shkurtra janë fjalë të patheksuara (*më, të, e, na, ju* etj.).

Ndrejqa...! - Mos **ia** ndreq!, *Përvishju...!* - Mos **iu** përvish!, *Jepi...!* - Mos **i** jep!, *Merre ...!* - Mos **e** merr!, *Duku...!* - Mos **u** duk!; *Laju!* – Mos **u** lajl!, *Vishu!* – Mos **u** vish!, *Rregullohu!* – Mos **u** rregullo! etj.²¹³ Pozicioni i fjalës enklitike quhet *enklizë*, ndërsa pozicioni i fjalës proklitike quhet *proklizë*.

Mund të përfundohet se:

Në ligjërim theksi i fjalëve shkallëzohet. Ky shkallëzim varet drejtpërdrejt nga desemantizimi i fjalëve. Kështu, fjalët shërbyese njërrrokëshe e humbin plotësisht theksin dhe bëhen të patheksuara, fjalët shërbyese shumërrrokëshe që deri diku e ruajnë edhe kuptimin, shqiptohen me theks të dobësuar; ndërsa në fjalët e përbëra dhe të përngjitura theksin kryesor e bart pjesa e fundit, e të tjerat bëhen me theks dytësor.

8.8.2. FJALËT E THEKSUARA DOBËT DHE FJALËT ME THEKS DYTËSOR

Kur fjalët shërbyese përbëhen jo prej një, por prej dy a më shumë rrokjesh, zakonisht atyre u mbetet një *jehonë e theksit*, ruajnë një theks të dobësuar. Jehonë theksi vihet re te parafjalët që e kanë dobësuar, por nuk e kanë humbur krejt kuptimin leksikor, si p.sh. *anembënë* vëndit, *tatëpjëtë* málit, *kràhas* púnëve, *rròtull* shtëpísë, *sikùr* të-víjje..., *përvèç* nësh, *meqënëse* érdhi etj.

Ruajtja e jehonës së theksit në fjalë të tilla nuk lidhet vetëm me numrin e rrokjeve, por edhe me shkallën e desemantizimit të fjalës shërbyese. Kështu, fjala sa më shumë që e ruan kuptimin leksikor, ajo aq më shumë e ruan edhe theksin; dhe e kundërta: duke humbur kuptimin leksikor, ajo kthehet në një mjet që ndihmon për formësimin gramatikor të fjalës emërtuese, rrjedhimisht shoqërohet me dobësimin dhe humbjen e theksit. Edhe fjalëve të formuara me prapashtesa që tërheqin theksin mbi vete, u mbetet një theks i dobësuar, zakonisht në rrokjen ku e ka pasur theksin fjala e parme, p.sh.: *flùturím*, *ègërsí*, *gjërésí*, *çuditërsisht* etj.²¹⁴

Theksi në fjalët e përbëra dhe të përngjitura. - Shqiptohen me theks të dobësuar jo vetëm fjalët shërbyese në kufijtë e fjalës fonetike, por edhe pjesët e fjalëve të përbëra prej dy a më shumë temash. Kështu, në fjalët e

²¹³ Kur një formë e vetës së dytë njëjës e mënyrës urdhërore mbaron me një tingull zanor dhe ndiqet nga një trajtë e shkurtër përemrash vetorë, shtohet një **-j-** për lehtësi shqiptimi, si: *mëso-j-e*, *shpërble-j-e*. P.sh. **Ndihmo-j-e** shokun! **Rrëfe-j-u** shokëve! **Trego-j-i** të gjitha me radhë! Mirëpo, kur pas urdhërore të këtij tipi vendoset trajta e shkurtër e vetës së tretë njëjës **i**, e ndjekur nga një trajtë tjetër e shkurtër ose nga pjesëza e pësorës **u**, atëherë nuk shtohet ndonjë tingull kundër hiatit, por trajta e shkurtër **i** shkruhet me **-j-**: **Hapja** derën mikut! **Përvishju** punës menjëherë! Këto vërejtje vlejnë edhe për rastet, kur trajtat e shkurtra vendosen midis temës dhe mbaresës së vetës së dytë shumës të urdhërores: **Ndihmo-j-e-ni** shokun! **Trego-ja-ni** shokut të vërtetën! Shih: Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe, Morfologjia*, Tiranë, 1995, f. 298.

²¹⁴ Anastas Dodi, *Theksi dhe shkallëzimi i tij ...*, f. 8.

përbëra prej dy a më shumë temash (kompozitat) si dhe në fjalët e përngjitura që formohen prej dy a më shumë fjalësh, theksin kryesor e marrin gjymtyrët e fundit. Por, në pjesët e tjera emërtuese zakonisht dëgjohej një theks i dobësuar, dytësor (apo mund të themi një gjysmëtheks) te zanorja që ka qenë e theksuar para se të formohej fjala e përbërë ose e përngjitur. P.sh.: kompozita, si *bòtëkuptím* (bótë+kuptím), *kryeqytét* (krýe+qytét), *údhëhéqës* (údhë+héqës), *ármëpushím* (ármë+pushím), *búkëpjékës* (búkë+pjékës), *dítëlíndje* (dítë+líndje), *lirídáshës* (lirí+dáshës), *zémërgúr* (zémër+gúr), *bàshkëbisedím* (bàshkë+bisedím), *frýmëmárrje* (frýmë+márrje), *bàkërpunúes*, *hèkurkthýes*, *lètërkëmbím*, *vëndbaním*, *zémërçelík*, *lùftënxítës* etj.; fjalë të përngjitura, si *àtëhére*, *mirédíta*, *mirëmbrëma*, *fàrefís*, *gjëgjëzë*, *thàshethéme*, *mìrupáfshim*, *pèsëmbëdhjëtë*, *tètëmbëdhjëtë*, *dàlëngadálë* etj.²¹⁵

Por në të gjitha këto raste, duhet të kemi parasysh se ve]ori e gjuhës shqipe është se fjala ka vetëm një theks kryesor, që konsiderohet theks i fjalës, qoftë kjo e përbërë, qoftë e prejardhur. Po qe se në një rrjedhë tingullore gjejmë dy theksa kryesorë, të njëjtë nga intensiteti, kjo do të thotë se aty kemi dy fjalë. Pra, në gjuhën shqipe, çdo fjalë: e thjeshtë, e prejardhur ose e përbërë ka vetëm një theks kryesor. **Në copëzat e ligjërimit ka aq fjalë, sa ka edhe theksa.**

Shkallëzimi theksor në fjalët e përbëra të shqipes, është dukuri e planit tingullor, që s'ka vlerë fonologjike, kuptimdalluese, sepse si] u tha, theksi kryesor bie gjithnjë në gjymtyrën e dytë, ndërsa theksi dytësor në gjymtyrën e parë. Ky rend i theksit të zakonshëm të fjalës mund të ndryshohet, vetëm atëherë kur mbi te bie theksi emocional (ose emfatik).²¹⁶

Për perceptimin e theksit dytësor të shqipes, një rol me rëndësi luajnë tiparet e intensitetit, gjatësisë dhe të lartësisë së zanoreve. Zanoret që bartin këtë theks, dallohen nga zanoret e patheksuara, sepse realizohen me një lartësi dhe gjatësi më të madhe sesa të patheksuarat.

Edhe *theksat e fjalëve në një sintagmë ose në një frazë* nuk janë të njëjlojta nga forca me të cilën shqiptohen: disa fjalë kanë një theks më të fortë se fjalët e tjera. Fjalët që spikaten më shumë, mbajnë theksin e frazës. Dallohen këta tipa theksash të frazës: (1) *theks i grupit kuptimor* (apo mund të quhet *theks sintagmatik*), (2) *theks logjik*, dhe (3) *theks emocional ose emfatik*.

Theksi sintagmatik, bie mbi fjalën e fundit të grupit kuptimor, po aty ku bie edhe theksi i fjalës fonetike. Pra, edhe kur kemi dy fjalë emërtuese, që bashkohen midis tyre me lidhje gramatikore nëpërmjet intonacionit, d.m.th. që

²¹⁵ Jehonën e theksit si edhe theksin dytësor po e shënojmë me shenjën ` (è), për ta dalluar nga theksi kryesor, që jepet me ´ (é). Duke qenë se /ë/-në dhe ndonjëherë /y/-në (veçmas theksin dytësor të kësaj) për shkaqe teknike nuk kemi mundur t'i paraqesim as me theks kryesor e as me theks dytësor, ato i kemi shënuar të nënvizuara (/ë, y/).

²¹⁶ Anastas Dodi – Jorgji Gjinari, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 133; Anastas Dodi, *Theksi dhe ...*, f. 8.

formojnë një sintagmë (me marrëdhënie përcaktore, kundrinore ose rrethanore), në shqiptimin e zakonshëm joemocionues theksin kryesor e merr fjala e fundit (ashtu si te fjalët e përbëra, ku këtë theks e merr gjymtyra e dytë), p.sh. *gùri i fòrtë, djalë trím, atdhèu ýnë, pùnoj tókën, lèxoj líbrin, shètis me shókët, shkòj në shkóllë, punòn shúmë* etj.²¹⁷

Theksi logjik bie mbi atë fjalë që duam ta spikatim më fort nga pikëpamja kuptimore. Krahaso: Dimri po *shkon* (2, 1). Nëna u *kthye* (2, 1). Shkolla po *lyhet* (2, 1). Ndërrimi i këtij shkallëzimi të theksave fiton vlerë për kumtimin dhe ka të bëjë me theksin logjik të frazës, që i jep asaj nuancë të re kuptimore (krahaso me versionet e fjalive të mësipërme: *Dimri po shkon* (1, 2). *Nëna u kthye* (1, 2). *Shkolla po lyhet* (1, 2).].²¹⁸

Theksi emocional përdoret për të shprehur emocionet e folësit.

8.9. THEKSI LOGJIK

Siç u tha, theksi studiohet jo vetëm në kufijtë e fjalës, por edhe të togfjalëshit e të fjalisë. Në togfjalësha, në fjali e periudha vihet re se disa fjalë spikaten më shumë se të tjerat. Të tillat vlerësohen si më të rëndësishme nga pikëpamja kuptimore. Këto fjalë vihen në pah me anë të theksit logjik. Ky theks bie mbi fjalën ku duam ta përqëndrojmë vëmendjen e dëgjuesit apo të lexuesit (kur ne flasim a shkruajmë) ose mbi fjalën ku dikush do ta përqëndrojë vëmendjen tonë.

Theksi logjik nuk duhet ngatërruar me theksin e rëndomtë të fjalës, të sintagmës a të fjalisë. Me theksin logjik spikatet a vihet në dukje fjala më e rëndësishme nga pikëpamja e kuptimit, nga pikëpamja logjike. Ai i mbishtresohet theksit të rëndomtë të fjalisë, pa prishur rregullat e theksimit të saj.

Theks logjik quajmë të spikaturit e njërit nga elementet e thënies, me qëllim që të rritet pesha e tij kuptimore. Theksi logjik përdoret si mjet prozodik për spikatjen e asaj pjese të frazës që mban peshën kuptimore të saj.

Theksi logjik nuk lidhet as me strukturën sintaksore të fjalisë, as me vendin e fjalës në fjali, meqë nga pikëpamja e kuptimit mund të nxirret në pah çdo fjalë e fjalisë.

Theksi i togfjalëshave, domethënë i fjalëve të lidhura midis tyre me një theks të vetëm, ndihmon për të kuptuar drejt përmbajtjen; ndërsa theksi logjik ndihmon për të shprehur nuanca të ndryshme kuptimore, që pasqyrojnë vlerësimin e folësit në rrethanën konkrete. P.sh. le të marrim një fjali të njëjtë (për nga përbërja, lloji i kumtimin – fjali dëftore si dhe me renditje të njëjtë

²¹⁷ Anastas Dodi, *Theksi dhe shkallëzimi i tij ...*, f. 11.

²¹⁸ Me numrin 1 është shënuar theksi kryesor (parësor, primar), ndërsa me 2 theksi dytësor (sekundar).

gjymtyrësh), poqë duke vënë theksin logjik mbi ndonjërin fjalë të fjalisë mund t'i japim asaj një radhë nuancash kuptimore:

1. *Arbeni punon në fabrikë.*
2. **Arbeni** punon në fabrikë.
3. Arbeni **punon** në fabrikë.
4. Arbeni punon në **fabrikë**.

Në shembullin e parë nuk është dalluar nga pikëpamja logjike asnjëra fjalë nga të tjerat, duke theksuar njëllor çdonjërin fjalë me radhë (përveç parafjalës në, që lidhet me emrin fabrikë). Kësisoj, të gjitha fjalëve akcentogjene u kemi dhënë vlerë të njëjtë. Fjalitë e këtilla kanë vlerën e një konstatimi të thjeshtë ose mund të themi se janë asnjënjese (neutrale).

Por, në tri variantet e tjera të të njëjtës fjali, folësi vë në dukje ndonjë rrethanë ku duhet të përqëndrohet vëmendja jonë. Kjo bëhet duke e dalluar fjalën përkatëse me anë të theksit logjik. Kështu, në shembullin e dytë është vënë në pah kryesi apo bartësi i veprimit (Arbeni, kryefjala). Në versionin e tretë rëndësi më të madhe i është kushtuar veprimit (punës, foljes, kallëzuesit). Në shembullin e katërt dallohet nga të tjerat fjala që emërton vendin (fabrikën, rrethanorin e vendit).

*Theksi logjik nuk i jep frazës kuptim krejt të ri, por vetëm nuanca të reja kuptimore, që janë shumë të rëndësishme për situatën konkrete të ligjërimit.*²¹⁹ Ai në ligjërim realizohet me mjete të ndryshme fonetike: duke e forcuar rrokjen e theksuar të fjalës së njëjtë, duke e zgjatur zanoren, duke e shqiptuar fjalën me theks logjik me një ton më të lartë, duke e shqiptuar fjalën që ka theks logjik më ngadalë sesa fjalët e tjera, para dhe pas fjalës me theks logjik duke bërë një pushim të vogël etj. Disa folës, përveç theksit logjik, përdorin dendur edhe gjestet e mimikën, me anën e të cilave sqarohet, përcaktohet ose kompletëhet mendimi, ndjenja e ideja e shprehur me fjalë.

Në të shkruar, theksi logjik mund të shprehet me mjete të ndryshme grafike, si duke e shkruar fjalën me shkronja të pjerrëta (*Sot* do të shkoj në teatër.), me shkronja më të zeza (*Sot do të shkoj* në teatër.), me shkronja të nënvizuara (*Sot* do të shkoj në teatër.), me kombinime të tyre (**Sot** do të shkoj në teatër.), duke i larguar shkronjat (*Sot* do të shkoj në t e a t ë r.), me madhësi shkronjash të ndryshme (*Sot* do të shkoj në teatër.), me tipe shkronjash të ndryshme (*Sot* do të shkoj në teatër.), me shkronja të mëdha (*SOT* do të shkoj në teatër.), duke e hijesuar, duke e shkruar atë me ngjyra të tjera nga shkrimi i rëndomtë etj.

Theksi logjik mund të përputhet me theksin e fjalës ose të togfjalëshit, por kjo nuk është e domosdoshme (p.sh. unë *mendoj*, dhe unë *mendoj*). Zaten, theksi logjik mund të bjerë edhe në fjalë që zakonisht janë të patheksuara, sidomos kur duam të shprehim kontraste, si p.sh. E gjeta *nën* tryezë dhe jo *mbi* tryezë.

²¹⁹ Anastas Dodi, *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe*, 1963, f. 95-96.

Në disa raste, përveç theksit të saj të zakonshëm, fjala mund të marrë edhe një theks të dytë logjik në një rrokje tjetër, si: *Duhani është i pádobíshëm për organizmin dhe jo i dobíshëm, siç thua ti. Këto janë shpenzime të páparashikúara dhe jo të párashikúara, si thua ti. Ai është mósmirënjóhës e jo mirënjóhës, siç thoni. Në fjalët të páparashikúara, i pádobíshëm, mósmirënjóhës theksi logjik bie në parashtesën pá ose mós, që rregullisht janë të patheksuara. Kështu, fjala përveç theksit të zakonshëm mund të marrë edhe një theks plotësues.*

Theksi logjik mund të bjerë në]do fjalë, që folësi e quan më të rëndësishme nga kuptimi në situatën konkrete të ligjërimit. Bile theksi logjik mund të bjerë edhe në fjalë që normalisht nuk kanë theks, d.m.th. janë atone. P.sh: *Ka rënë nën tryezë.*

Shpesh forcimi i zanores së fjalisë që bart theksin logjik shoqërohet edhe me ndryshimin e intervalit të lartësisë së tonit (uljen ose ngjitjen e tonit themelor), d.m.th. zanorja që bart theksin logjik është jo vetëm më e fortë, por shqiptohet edhe me ton më të lartë ose më të ulët. Por duhet thënë se theksi logjik nuk është tipar i domosdoshëm i çdo fjalie. Fjalitë mund të shqiptohen pa theks logjik, kur shprehin pohime të thjeshta, pa nxjerrë në pah ndonjë fjalë të veçantë.

Me anë të theksit logjik çështjeve, ngjarjeve e dukurive gjatë të të shprehurit të mendimeve u japim rëndësinë e dëshiruar dhe njëkohësisht arrijmë që ligjërimi ynë të mos jetë i njëtrajtshëm (monoton), përkatësisht të mbajmë të zgjuar vëmendjen e dëgjuesve. Vendosja e drejtë e theksit logjik ka rëndësi të madhe për leximin shprehës si dhe për interpretimin e pjesëve teatrale. Të kuptuarit e thellë të përmbajtjes bën që të vendosen drejt theksat logjikë. Vendosja e tyre në vende të ndryshme u jep fjalive nuanca të ndryshme kuptimore, prandaj në interpretimin e aktorëve të ndryshëm e njëjta përmbajtje mund të paraqitet me nuanca të shumta. Interpretues i mirë është ai që di ta paraqesë drejt mendimin e autorit.²²⁰

8.10. THEKSI EMOCIONAL

Theksi emocional (quhet edhe emocionues ose emfatik) është një lloj tjetër i theksit të frazës. Ai përdoret kur folësi dëshiron të vërë në dukje qëndrimin emocional të tij (gëzimin, dëshpërimin ironinë, përbuzjen etj.) ndaj dikujt ose ndaj një veprimi të kryer. Pra, theksi emocional është karakteristik për ligjërimit joneutral. Theksi emocional lidhet ngushtë me intonacionin e frazës, duke qenë se ngjyrimin emocional e merr gjithë fraza.²²¹ Ai vihet re në fjali dhe në fjalë, kuptimi leksikor i të cilave zakonisht lidhet me emocione.

²²⁰ Anastas Dodi – Jorgji Gjinari, *Fonetika* (maket), Tiranë, 1983, f. 135-136.

²²¹ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 120.

Fonetikisht, theksi emocional realizohet duke zgjatur zanoren e theksuar dhe duke ngritur tonin e saj (ndonjëherë edhe të rrokjes së parë të fjalës), kur duam të shprehim emocione pozitive (gëzim, admirim etj.). P.sh. *Buukur! Kuujdes! Veç kësaj, gjatë spikatjes emocionale fjala mund të marrë dhe një theks të dytë, që realizohet me ngritje të tonit në rrokjen e parë. Ishte një mrékulli! E kaloi për búkuri! Ínteressant.*

Për të shprehur qëndrime emocionale negative, theksi emocional realizohet me anë të zgjatjes së bashkëtingëllores që është para rrokjes së theksuar, p.sh. *bbukur! faqezziu!* (kur shprehim mospëlqim), ose me zgjatjen e bashkëtingëllores së parë të fjalës: *shshkatarraq!, ççudi!, ttmerr!, ggomar!* Një zgjatim i tillë në shqipen ka dhënë atë që quhet geminacion ekspresiv, që është pasqyruar sidomos në dyfishimin e bashkëtingëllores /r/ > /rr/, në fjalë që nga pikëpamja e prejardhjes historike duhet të dilnin me /r/ (motorr, i errët, horr, derr, ferr etj).

Theksi emocional përdoret për të përforcuar anën emocionale të fjalëve, për t'u dhënë atyre një ngarkesë emocionale më të madhe. Midis theksit logjik dhe emocional nuk ka gjithnjë një ndarje të prerë, sepse shpesh spikatja kuptimore e fjalës shoqërohet edhe me përforcim të anës emocionale të saj. Por mjetet fonetike që përdoren për realizimin e tipave të theksit të ngulmimit nuk janë të njëjta.²²²

Shkallëzimi i theksave sipas forcës është një nga mjetet e rëndësishme për të shprehur nuanca të ndryshme kuptimore. Kjo ka rëndësi sidomos për leximin shprehës, për interpretimin e pjesëve teatrale etj. Po kështu edhe bota shpirtërore, ndjenjat, përbëjnë një pasuri të madhe që shprehet nëpërmjet intonacionit, ku futen edhe theksat e ndryshëm (theksi logjik dhe theksi emocional).²²³

8.11. INTONACIONI

Intonacioni është njësi prozodike e ligjërimit që karakterizon sintagmën, fjalinë e periudhën. Ndryshimet e tonit të rrokjeve në kufijtë e frazës ose të pjesëve të saj, që na japin një lakore melodike, të shoqëruara me ndryshimet e ritmit, të timbrit e të pauzave janë përgjegjëse për intonacionin. Intonacioni përkufizohet zakonisht si *ndryshim i lakores melodike të thënies ose të grupeve kuptimore* që e përbëjnë. Pikërisht, me termin intonacion nënkuptojmë *reliefin tingullor*, që shoqëron njësitë leksiko-gramatikore të strukturës së fjalisë. Ai është tipar i pandarë i gjuhës së folur. Çdo frazë ka intonacionin e vet, fraza pa intonacion nuk ka. Intonacioni i lidh fjalët e një thënieje në një tërësi fonetiko-kuptimore.²²⁴ Në të vërtetë, përmbajtja e thënies

²²² Anastas Dodi, *Intonacioni në gjuhën shqipe, komponentët dhe funksionet e tij gjuhësore*, Shqyrtime albanologjike 6, Shkup, 2000, f. 68.

²²³ Anastas Dodi, *Theksi dhe ...*, f. 13.

²²⁴ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 122.

shprehet me njësitë strukturore të gjuhës (me fjalë e fjali), si dhe me intonacionin, që shërben për të organizuar thënien në mënyra të ndryshme; për të formësuar, kompletuar e plotësuar shprehjen gjuhësore. Tërësia e këtyre mjeteve e formëson frazën në *njësi intonacionore dhe kumtuese*.

Intonacioni përfshin gjithë dukuritë prozodike që veprojnë në nivelin e frazës: (1) ndryshimet e lartësisë së tonit themelor gjatë nyjetimit të frazës, (2) ndryshimet e shpejtësisë (tempit) së ligjërimit, (3) ndryshimet e cilësisë së zërit (timbrit), (4) pauzat e gjatësive të ndryshme dhe (5) shenjat kufitare.

8.11.1. FUNKSIONET E INTONACIONIT

Funksionet themelore të intonacionit janë:

1. funksioni formësues i thënies;
2. funksioni dallues;
3. funksioni i aktualizimit të thënies, dhe
4. funksioni shprehës.

Me **funksionin formësues** të intonacionit kuptohet aftësia që ka ai për ta shndërruar një fjalë a grup fjalësh në frazë. P.sh. kompleksi tingullor *zjarr jashtë* i shqiptuar pa një intonacion, nuk na kumton asgjë, përveçse emërton, pra është vetëm një njësi leksikore. Por, po ta shqiptojmë me një intonacion të caktuar, ky kompleks tingullor kthehet në një thënie, kuptimi i së cilës varet nga ëëojo i lakores melodike me të cilën shoqërohet, si p.sh. *Zjarr. Zjarr!, Zhjarr?, Zjarr!!!*

Në bazë të intonacionit të caktuar bëhet ndarja e të folurit në pjesë kuptimore, në sintagma, formohen ndërtime të ndryshme sintaksore si edhe tipa të ndryshëm fjalish e periudhash. Intonacioni bën pjesë në shprehjen e mendimeve, të ndjenjave duke i dhënë të folurit (ligjërimit) ngjyrë përkatëse emocionale. Lidhja e ngushtë midis intonacionit dhe kuptimit të fjalisë e bën intonacionin një nga mjetet më të rëndësishme të komunikimit. Ai bën integrimin e fjalëve të veçanta në togfjalësja, fjali e periudha. *Intonacioni i kthen fjalët nga njësi apelative në njësi komunikative*. Grupet e fjalëve, edhe kur janë të lidhura midis tyre, kthehen në thënie, vetëm kur shqiptohen me një intonacion të caktuar.

Intonacioni ka **funksion dallues** kur shërben si mjet i vetëm për dallimin e kuptimeve gramatikore të thënieve. Ky funksion bëhet i mundur falë konfiguracionit të lakores melodike, e cila mund të ketë tri lëvizje kryesore: lakore e rrafshtë, ngjitëse dhe zbritëse. Me llojin e intonacionit dallohen fjalitë dëftore, pyetëse, nxitëse, thirrmore si dhe nuanca të ndryshme të tyre. *Ai është student. A është ai student? Student është ai! Student është ai. Student është ai?!*

Aktualizimi i thënies. Funksioni i rëndësishëm i intonacionit është ai i aktualizimit të thënies dhe i ndarjes aktuale të fjalisë. Ky aktualizim i thënies

shpreh qëndrimin e folësit në një situatë konkrete. Aktualizimi i thënies mund të bëhet në planin logjik, intelektual dhe në planin emocional.

Gjatë aktualizimit të thënies identifikohen tema (e dhëna) dhe rema (e reja), topika (sqarimi i temës) dhe komentari (pjesë e remës). Funkzioni rematik realizohet zakonisht me një përforsim të komponenteve intonative, sepse rema paraqet të renë, d.m.th. informacionin e ri për bashkëbiseduesin.

Informimi faktik i fjalive të ndryshme mund të jetë i njëjtë, d.m.th. ato mund të kumtojnë të njëjtën përmbajtje, me të njëjtat fjalë, ndërsa informimi aktual mund të ndryshojë. P.sh.

*Fletoren do t'ia çoj unë/ nesër në drekë.
Nesër në drekë / fletoren do t'ia çoj unë.
Nesër / në drekë / unë do t'ia çoj fletoren.*

Në të trija rastet, informimi faktik është i njëjtë, d.m.th. folësi kumton të njëjtën gjë, por fjalitë kanë nuanca të reja kuptimore, të cilat lidhen me informimin aktual, që realizohet duke spikatur folësi herë njëherë, herë tjetrën rrethanë.

Për informimin aktual luajnë rol jo vetëm intonacioni, pauzat, spikatja e fjalëve të veçanta etj., por edhe mjete të tjera, si rendi i fjalëve, disa mjete leksikore, trajta e shquar dhe e pashquar etj. Disa pjesëza ndihmojnë gjithashtu për të veçuar të renë. P.sh.: *As ata (e reja) nuk dinin gjë (e dhëna)*. Trajta e pashquar në gjuhën shqipe shërben gjithashtu për të paraqitur të renë (remën):

*Një qen (e reja) hyri në dhomë (e dhëna). Krahaso me:
Qeni (e dhëna) hyri në dhomë (e reja).*²²⁵

Një vjetër funksion gramatikor i intonacionit është shprehja e marrëdhënieve nënrenditëse e bashkërenditëse mes fjalive të një periudhe. Kështu, periudha me fjali të nënrenditura kanë skemën intonacionore ngjithe (fjalia kryesore) + zbritje (fjalia e varur). Kurse fjalitë e bashkërenditura karakterizohen nga përsëritja e së njëjtës skemë intonacionore.

Funksioni shprehës. Së fundi, intonacioni kryen edhe *funksione shprehëse*, emocionore, duke shërbyer në këtë rast si mjet për të përcjellë qëndrimet a ndjenjat e folësit ndaj asaj që kumton ose ndaj dëgjuesit. Këto funksione janë të njëjta për të gjitha gjuhët.²²⁶

Ai na jep të dhëna për *gjendjen emocionale* (funksioni afektiv) dhe për cilësi të tjera vetjake të folësve. Mundësitë shprehëse të intonacionit janë të mëdha. Këtë e vërtetojnë shumë studiues. P.sh. janë numëruar 16 intonacione: pyetës, çuditës, habitor, thirrës, vërtetues, bindës, këshillimor, pohor (pozitiv), lutës, vërejtjetërheqës, urdhëror, krahasues, intonacioni i ndërprerjes a i lidhjes, intonacioni numëruar, rrëfimor, indiferent.

²²⁵ Po aty, f. 70.

²²⁶ Rami Memushaj, *Fonetika e shqipes standarde*, Toena, Tiranë, 2009, f. 173.


8.11.2. LAKORET MELODIKE TË FJALIVE

Ngritjet dhe uljet e lartësisë së tonit themelor (F_0) të zanoreve të një fraze japin *lakoren melodike* të saj, ose *melodinë* e frazës. Kur shoqërohet me lakore të ndryshme melodike, i njëjtë kompleks tingullor mund të shprehë një gamë të pafund kuptimesh dhe ngjyrimesh kuptimore.

Fjalitë dëftore dallohen në pikëpamje të intonacionit me ulje të zërit themelor në fund të fjalisë. Fjalitë pyetëse rëndom shqiptohen me ngritjen e zërit në një pjesë të thënies (më shpesh në fillim ose në fund). Por, çdo fjali dëftore mund të bëhet pyetëse në saje të ngritjes së zërit themelor në rrokjen e theksuar të fjalës, me të cilën bëjmë pyetje.²²⁷ Prof. Anastas Dodi ka paraqitur variacione të melodisë në fjalitë e tipave të ndryshëm.²²⁸ Edhe prof. Rami Memushaj shtjellon intonacionin dhe paraqet lakoret melodike të shunë frazave. Ne kemi marrë disa nga to dhe po i japim më poshtë.²²⁹

Ndryshimet e lartësisë së tonit zakonisht paraqiten grafikisht me anë të lakoreve të intonacionit. Për të paraqitur më thjesht tipat e melodisë së frazës, shpesh përdoret një mënyrë konvencionale, sistemi i niveleve të lartësisë. Një paraqitje e tillë i qartëson më mirë konturet melodike të frazave. Në studimet e sotme po përdoret gjithnjë e më shumë ky sistem, për shkak të thjeshtësisë së tij.

Zakonisht për të paraqitur sistemin e intonacionit përdoren 4 regjistra, që i paraqesin të gjitha nivelet e lartësisë së tonit. Këto nivele jepen me vija horizontale, duke i numëruar nga poshtë lart. P. sh.:



Shpjegim: 1. Në vijën e parë shënohet lartësia e të vogël e tonit, që i përgjigjet fundit të fjalisë dëftore. 2. Vija e dytë i përgjigjet mesit të fjalisë dhe që arrihet nga zanoret në rrokje të theksuara. 3. Në vijën e tretë shënohet një nivel i ndërmjetëm, të cilit i përgjigjet zakonisht fundi i një fraze të pambaruar. 4. Në vijën e katërt shënohen lartësi më të mëdha të tonit, që u përgjigjen zakonisht frazave pyetëse pa fjalë pyetëse.


FJALITË DËFTORE karakterizohen nga një melodi zbritëse, d.m.th. që vjen duke u ulur në fund, po qe se aty nuk ka ndonjë fjalë të spikatur me theksin logjik. P. sh.:

²²⁷ Zeqir Sadiku, *Fonetika e gjuhës së sotme letrare ruse*, Prishtinë, 1981, f. 90-93.


²²⁸ Anastas Dodi, *Po aty*, f. 71-73.

²²⁹ Rami Memushaj, *Fonetika e shqipes standarde*, Toena, Tiranë, 2009, f. 169-180.

(a) Fraza dëftore pa theks logjik:



(b) Fraza dëftore me theks logjik:




(ç) Fraza dëftore-thirrmore:




FJALITË PYETËSE janë dy tipash: pa fjalë pyetëse dhe me fjalë pyetëse. Në rastin e parë melodia ngjitëse është më e theksuar, d.m.th. ngjitja në fund të fjalisë është më e madhe, kurse në rastin e dytë ngritja më e madhe bëhet në fazën pyetëse (kur?, pse?, si? etj.):²³⁰

²³⁰ Rami Memushaj, *Fonetika e shqipes standarde*, Toena, Tiranë, 2009, f. 177.


(d) Fjalia pyetëse me fjalë pyetëse




(ç) Fraza pa fjalë pyetëse me rend të përmbysur të gjymtyrëve.



(c) Fjali pyetëse dyshuese:




(dh) Fjali pyetëse e zhdrejtë:



FJALITË NXITËSE mund të shprehin kuptime të ndryshme modale, si urdhër, lutje etj. Skema melodike e tyre karakterizohet nga një vijë zbritëse, e ngjashme me atë të fjalive dëftore. Por ato zakonisht fillojnë me një nivel më të lartë se fjalitë dëftore. P.sh.:²³¹

(a) Fjali nxitëse që shpreh një urdhër kategorik:




(b) Fjali nxitëse që shpreh një urdhër në formë lutjeje:




²³¹ Rami Memushaj, *Fonetika e shqipes standarde*, Toena, Tiranë, 2009, f. 178.

MELODIA E LIGJËRIMIT EMOCIONAL ka disa tipare të veçanta. Ngjyrim emocional mund të marrë çdo tip fjalie. Këtë ngjyrim fjalja e fiton në saje të melodisë, intensitetit dhe timbrit të zërit. Fjalitë me ngjyrim të theksuar emocional quhen edhe **fjali thirrmore**. Fjalitë e tilla shprehin nuanca të ndryshme emocionale dhe mund të shoqërohen me pasthirrma ose me fjalë të tjera, që shprehin emocione. Ato karakterizohen zakonisht nga një regjistër më i lartë dhe nga një vijë zbritëse e melodisë. P.sh.:²³²

(a) Fjali thirrmore pa pjesëza thirrmore:



(c) Fjali nxitëse që shpreh një urdhër të zbutur:



²³² Rami Memushaj, *Fonetika e shqipes standarde*, Toena, Tiranë, 2009, f. 179.

(ç) Fraza dëftore-thirrmore:



Siç shihet, për përshkrimin e tipave të melodisë së ligjërimit, që kap një interval nga një oktavë e gjysmë deri në dy oktava (d.m.th. nga nëntë deri në dymbëdhjetë tone) në mënyrë konvencionale përdoren katër nivele themelore të lartësive. Me këto katër nivele gjuhëtari i shquar, Anastas Dodi ka përshkruar gjithë variacionet e lartësisë së tonit në fjalitë e tipave të ndryshëm.²³³ Përveç në të folurit e përditshëm, intonacioni si mjet shprehës stilistik përdoret edhe në krijimtarinë popullore dhe në letërsinë artistike.

Intonacioni ka karakter universal. Elemente të përbashkëta në gjuhë të ndryshme shfaqen sidomos në melodinë, pauzat, tempin etj. Siç është provuar edhe eksperimentalisht, habia, dyshimi etj. shprehen me të njëjtin intonacion në të gjitha gjuhët.²³⁴

²³³ Po aty, f. 73.

²³⁴ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 123.

KREU IX

9. ALFABETIZIMI, STANDARDIZIMI, MODERNIZIMI I SHQIPES DHE PËRKUJDESJA PËR TË

9.1. PLANIFIKIMI I SHQIPES

Planifikimi gjuhësor si çështje sociolinguistike nënkupton alfabetizimin e gjuhëve, problemet e caktimit të gjuhëve zyrtare, standardizimin e gjuhëve kombëtare dhe modernizimin e tyre. I fundit vjen stadi i modernizimit, që karakterizohet nga përpjekjet për ta bërë gjuhën tashmë të standardizuar të aftë për të përmbushur nevojat e shumëllojshme të një shoqërie të zhvilluar dhe për të konkurruar me sukses me gjuhët më të zhvilluara të botës.

Në përmbajtjen e planifikimit gjuhësor E. Haugeni, i cili e ka krijuar këtë term, përfshin “punën normëzuese të akademive dhe komiteteve gjuhësore, të gjitha format e kultivimit të gjuhës dhe gjithë propozimet për reformën ose standardizimin e gjuhës.”

Planifikimi gjuhësor duhet parë si pjesë e planifikimit shoqëror. Ashtu si planifikimi shoqëror, që në përgjithësi është përcaktimi i qëllimeve dhe i politikave të zhvillimit për një shtet të caktuar, edhe planifikimi gjuhësor është përcaktimi i qëllimeve dhe i politikave gjuhësore për një bashkësi të dhënë.²³⁵

Planifikimi gjuhësor i çdo faze përfshin dy momente: kodifikimin e normës dhe pranimin e saj nga përdoruesit. Përndryshe, çdo nismë për kodifikim pa masa shtetërore për zbatimin e kodit është paracaktuar të dështojë.²³⁶

Gjatë Rilindjes kombëtare u përvijuan dy variante letrare: varianti letrar jugor (toskë) dhe varianti verior (gegë). Në shoqëritë parakombëtare, në të cilat mbizotëronin lidhjet e ngushta me bazë fshati ose krahine, prania e varianteve nuk sillte ndonjë problem. Por, me lindjen e kombit dhe sidomos me krijimin e shtetit kombëtar, përdorimi i shumë dialekteve përbën një pengesë

²³⁵ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 325-326.

²³⁶ Rami Memushaj, *Për shqipen standarde – çështje të normës morfologjike dhe drejtshkrimore*, Infbotues, Tiranë, 2012, f. 212.

për funksionimin e shtetit dhe për tregun kombëtar të punës e të mallrave. Prandaj lind nevoja për një gjuhë zyrtare, pa të cilën nuk mund të funksionojë administrata e shkollat. Kështu, gjuhë zyrtare e shtetit shqiptar para Luftës II Botërore ka qenë elbërishtja,²³⁷ kurse pas Luftës si gjuhë zyrtare në Shqipërinë politike u përdor toskërishtja, ndërsa në trojet shqiptare në ish-Jugosllavi gegërishtja.

Mirëpo, për arritjen e njësisë kombëtare, duhet që njëri nga variantet letrare, zakonisht ai që është më i njësuar dhe me prestigj më të lartë, të marrë funksione më të gjera se gjuha zyrtare dhe shtrirje mbarëkombëtare. Ky varianti i përbashkët i gjuhës së një kombi, që pranohet nga të gjithë anëtarët e një bashkësie kombëtare, është gjuha standarde. Për shqiptarët, gjuha standarde zë fill me Konsultën e Prishtinës (1968), e cila vendosi që gjuha zyrtare e shtetit amë të shërbente si gjuhë letrare edhe për shqiptarët e ish-Jugosllavisë. Por gjuha standarde shqipe u sanksionua përfundimisht me Kongresin e drejtshkrimit (1972). Si rrjedhim i këtij procesi, **toskërishtja nga gjuhë zyrtare e shtetit shqiptar u pranua si bazë e gjuhës standarde**, sidomos në gramatikë e leksik.²³⁸

Kujdesi i vazhdueshëm i shoqërisë sonë për zhvillimin e shqipes standarde dhe për zbatimin e normave të saj ka marrë një hov të ri sidomos pas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (nëntor 1972).²³⁹ Prej atëherë e deri më tani gjuhësia shqiptare ka zhvilluar veprimtari të dendur për të krijuar vepra gjuhësore normative, si “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”, “Fjalori drejtshkrimor”, “Gramatika e gjuhës shqipe” në dy vëllime, “Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe”, “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” dhe “Fjalori i shqipes së sotme”, “Rregullat e pikësimit të gjuhës shqipe”, “Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe”, “Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe”, “Fjalor enciklopedik shqiptar” si dhe një varg fjalorësh terminologjikë dhe veprash të tjera për shqipen e sotme e për kulturën gjuhësore, ndër të cilat edhe një numër tekstesh mësimore universitare.²⁴⁰

²³⁷ Më vitin 1916 në Shkodër u mbledh “Komisija Letrare” për normëzimin e shqipes. Në të morën pjesë Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi, Ndre Mjeda, Mati Logoreci, Aleksandër Xhuvani etj. Të gjithë pranuan propozimin e Luigj Gurakuqit që elbërishtja të shërbente si bazë e gjuhës letrare, meqë ishte një urë mes dy dialekteve, kuptohej mirë dhe mund të përdorej lehtë si nga toskërishtfolësit, ashtu edhe nga gegnishtfolësit. Pra, gjuhë zyrtare e Shqipërisë për rreth 30 vjet (nga viti 1918 e deri më 1946) qe elbërishtja.

²³⁸ Rami Memushaj, *Shqipja standarde – si ta flasim dhe ta shkruajmë*, Infbotues, Tiranë, 2017, f. 41-42.

²³⁹ Androkli Kostallari (kryetar), Emil Lafe, Menella Totoni, Nikoleta Cikuli, *Gjuha letrare shqipe për të gjithë (elemente të normës së sotme letrare kombëtare)*, Tiranë, 1976, f. 3.

²⁴⁰ Konferenca shkencore “Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot” (mbajtur në Tiranë, 11 dhe 12 nëntor 2002), *Studime filologjike* 3-4, 2002, Tiranë, f. 6.

Në kuadër të projektit “Gjuha shqipe dhe kompjuteri” me përkrahje materiale të Qeverisë së Kosovës dhe i mbështetur nga gjuhëtarët më të shquar shqiptarë, në fillim të vitit 2005 u mundësua zbatimi i një program kompjuterik për drejtshkrimin e shqipes AS 2.0. Me këtë program të rëndësishëm edhe gjuha shqipe u fut në mesin e gjuhëve të kompjuterizuara. Kjo shënon një epokë të re për gjuhën shqipe, i bazuar në përvojat që kanë pasur gjuhët e kombeve të zhvilluara.

Me programin për drejtshkrimin e shqipes mund të korrigjohen mbi një milion fjalë e trajta fjalësh, përkatësisht rreth katër milion trajta të përsëritshme. Shfrytëzuesit nuk i duhet trajnim i veçantë për përdorimin e këtij programi, mjaftojnë pesë minuta për përvetësimin e tij. Me përdorimin e këtij programi, ju nuk do të jeni më vëzhgues të rëndomtë të bastardimit të gjuhës amtare, por do të kontribuoni në ngritjen e nivelit të saj çdo ditë e më shumë.

9.2. ALFABETI I GJUHËS SHQIPE

Kongresi i njësimt të alfabetit të gjuhës shqipe, i mbajtur në Manastir prej 14-22 nëntor 1908, është një nga ngjarjet më të rëndësishme të gjuhës, të historisë e të kulturës shqiptare jo vetëm të fillimit të shekullit XX, por edhe të shekujve të mëhershëm e të kohës së mëvonshme.

Përgjithësisht është e njohur se planifikimi gjuhësor përfshin tri faza kryesore: a) alfabetizimin e gjuhës, b) standardizimin dhe c) modernizimin e saj. Në Kongresin e Manastirit u bë njësimi i alfabetit të shqipes, hapi i parë i domosdoshëm për të standardizuar gjuhën shqipe, që u arrit në Kongresin e Drejtshkrimit, Tiranë, 20-25 nëntor 1972, si dhe për të kaluar në fazën e modernizimit që nuk përfundon kurrë. Modernizimin e karakterizon përpjekja për ta bërë shqipen të aftë për të përmbushur nevojat e shumëllojshme të shoqërisë sonë dhe për të konkurruar me sukses me gjuhët më të zhvilluara të botës.

Shpikja e alfabetit merret si një ndër zbulimet më të mëdha të njerëzimit, ndërsa Kongresi i Manastirit mund të vlerësohet si një ndër ngjarjet më të rëndësishme të popullit shqiptar. Njësimi i alfabetit çoi në rrugë të drejtë të gjitha zhvillimet e mëvonshme për ngritjen e vetëdijes dhe formimin e kombit, shuarjen e ndasive krahinore e fetare, hapjen e shkollave në gjuhën amtare, botimin e librave si dhe përhapjen e dijes e të kulturës.

Shkrimi dhe lëvrimi i gjuhës shqipe që për shqiptarët një kusht i domosdoshëm për t'u bërë ballë ndikimeve asimiluese të gjuhëve dhe të kulturave të huaja. “*Një gjuhë që s’shkruhet e s’këndohet*, - thoshte Samiu, - *nuk zihet gjuhë.*” Të folurit dhe të shkruarit në gjuhën amtare është mjet i domosdoshëm për të mbijetuar një komb.

Alfabeti që përdorim sot, i ka fillimet të "Formula e Pagëzimit", e cila deri më sot mbetet dokumenti i parë i shkruar i gjuhës shqipe. Por, nuk mund të thuhet se shkronjat e "Formulës" janë grafema të alfabetit shqip. Ato janë shkronja latine që janë përdorur për të dhënë shqip një formulë pagëzimi e cila deri atëherë thuhej latinisht. Për një alfabet të vërtetë të shqipes mund të flasim duke filluar nga "Meshari" i Buzukut (1555). Pikërisht të Buzuku gjejmë një alfabet të plotë, të bazuar në alfabetin latin, por të plotësuar me kombinime shenjash prej këtij alfabeti ose edhe me shenja të posaçme për të dhënë fonemat e shqipes që i mungojnë latinishtes. Alfabeti i Buzukut u përdor me modifikime edhe nga autorë të tjerë të vjetër të Veriut për gati dy shekuj, megjithatë nuk arriti të përhapej në të gjitha trevat ku flitej gjuha shqipe.²⁴¹

Edhe gjatë shekujve XVIII-XIX shqipja shkruhej me dhjetëra alfabete me bazë latine, greke, arabe e cirilike. Alfabeti cirilik ishte pak i përhapur ndër shqiptarë. Me këtë alfabet Gjorgji Pulevski shkroi dy fjalorët shumëgjuhësh të tij: I. Fjalorin katërgjuhësh: maqedonisht-shqip-turqisht-greqisht, Beograd, 1873; dhe II. Fjalorin bisedimor trigjuhësh: maqedonisht-shqip-turqisht, Beograd, 1875.

Në shkrimin e shqipes që nga fillimi i shek. XVIII u përdor edhe alfabeti arab. Me të u shkruan krijimet letrare të "bejtexhinjve" (Nezim Frakulla, Sulejman Naibi, Hasan Zyko Kamberi etj.). Naum Veqilharxhi hartoi dhe botoi me alfabetin e tij abetaren e parë të gjuhës shqipe "Ëvetari" (një libërth prej 8 faqesh) më vitin 1844. Alfabeti i Jeronim de Radës (alfabeti i Arbëreshëve të Italisë) ishte alfabet latin sipas variantit italian. Konstantin Kristoforidhi në shkrimin e veprave të tij përdori dy alfabete me baza të ndryshme, për shkrimet në gegërishte përdori alfabetin me bazë latine, ndërsa në shkrimet në toskërishte përdori alfabetin me bazë greke.

Alfabeti është tërësia e shkronjave që përdor një gjuhë, të radhitura sipas një rendi të caktuar. Alfabeti i Stambollit ose alfabeti i Sami Frashërit me bazë latine i plotësuar me shkronja greke, respektoi me përpikëri parimin *një tingull = një shkronjë*. Ndonëse nuk u bë kombëtar, u përdor gati për 30 vjet dhe pati përhapje të gjerë sidomos në Shqipërinë e Jugut dhe kolonitë shqiptare të Ballkanit, duke shtypur libra shqip (veprat e Naimit, Samiut etj.). Ky ishte një nga tre alfabetet që u diskutuan në Kongresin e Manastirit.

Përpyekje për krijimin e një alfabeti u bënë edhe në Shkodër. Shoqëria "Bashkimi" krijoi më 1899 një alfabet me bazë latine. Ky alfabet u përdor nga shumica e shkrimtarëve (sidomos të Veriut) dhe me të u botuan 32 vepra në gegërisht. Shumica e shkronjave të sotme të shqipes janë nga alfabeti i "Bashkimit".

Dy-tre vjet më vonë, Ndre Mjeda krijoi një tjetër alfabet po me bazë latine, i cili njihet ndryshe edhe si alfabeti i shoqërisë "Agimi". Dallimi kryesor mes këtyre dy alfabeteve ishte se ai i shoqërisë "Bashkimi" fonemat e shqipes

²⁴¹ Rami Memushaj, *Fonetika e shqipes standarde*, Toena, Tiranë, 2009, f. 204-205.

që i mungonin latinishtes i jepte me dyshkronjësja, kurse alfabeti i Mjedës nuk përdorte dyshkronjësja, po shkronja të thjeshta me shenja diakritike, me përjashtim të grafemave <dz> për /x/-në dhe <dž> për /xh/-në.²⁴²

Përpyekjeve vetjake për një alfabet të shqipes u dha fund Lidhja e Prizrenit, në programin e së cilës, krahas kërkesave politike, një vend të rëndësishëm zinte edhe kërkesa për mësimin e gjuhës shqipe në shkolla. Por që të mësohej në shkolla, shqipja duhet të kishte një alfabet të vetëm dhe të përbashkët. Prandaj, Lidhja ngarkoi “Komitetin e Stambollit për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare” të hartonte alfabetin e shqipes... “Komiteti i Stambollit” krijoi “Alfabetin e Stambollit”, i cili u miratua më 1879.²⁴³

Kongresi i alfabetit u mbajt në Manastir, i cili i filloi punimet më 14 nëntor 1908 dhe vazhdoi deri më 22 nëntor. Delegatët që morën pjesë, ishin kryesisht personalitete të njohura, me një përgatitje të mirë filologjike, të aftë për të zgjidhur këtë problem delikat dhe të vështirë, me një histori të gjatë dhe të mundimshme.

Para këtij Kongresi janë mbajtur disa të tjerë, që kanë pasur të njëjtin qëllim, pra hartimin e një alfabeti të përbashkët. Por, ata kishin karakter regional dhe nuk arritën që të përhapnin një alfabet të gjithë shqiptarët. Në dallim nga Kongreset e tjera, Kongresi i Manastirit ishte i pari me karakter mbarëkombëtar, ku morën pjesë 50 delegatë (32 me të drejtë vote dhe 18 pa të drejtë vote), që përfaqësonin 23 qytete, shoqëri dhe klube të ardhur nga të gjitha trojet tona, si dhe nga kolonitë shqiptare të Rumanisë, Italisë, Greqisë, Turqisë, Egjiptit, Amerikës etj., pjesëtarë të të tri besimeve fetare më të mëdha ndër shqiptarët (muslimanë, katolikë e ortodoksë).



Fig. 49. Shtëpia ku u mbajt Kongresi i Alfabetit

(nga nëntori 2012 kjo shtëpi u shndërrua në Muze të Alfabetit Shqip)

²⁴² Rami Memushaj, *Fonetika e shqipes standarde*, Toena, Tiranë, 2009, f. 205.

²⁴³ Rami Memushaj, *Po aty*, f. 205.

Kongresi u organizua nga shoqëria "Bashkimi" dhe u mbajt në shtëpinë e Fehim Zavalanit, në selinë e kësaj shoqërie. Gjatë dy ditëve të para pati shumë diskutime për të përcaktuar parimet e hartimit të alfabetit dhe zgjedhjen e shkronjave. Në ditën e tretë, pasdreke, me vota të fshehta u zgjodh Komisioni fuqiptotë i alfabetit prej 11 anëtarësh: Gjergj Fishta (kryetar i komisionit), Mit'hat Frashëri (nënkrytar), Luigj Gurakuqi (sekretar), Gjergj Qiriazhi, Ndre Mjeda, Glogor Cilka, Dhimitri Buda, Shahin Kolonja, Sotir Peci, Bajo Topulli dhe Nyz'het Bej Vrioni.



Fig. 50. Komisioni i alfabetit

Në fotografi: 1. Gjergj Fishta (kryetar i komisionit), 2. Mit'hat Frashëri, 3. Luigj Gurakuqi, 4. Gjergj Qiriazhi, 5. Ndre Mjeda, 6. Glogor Cilka, 7. Dhimitri Buda, 8. Shahin Kolonja, 9. Sotir Peci, 10. Bajo Topulli dhe 11. Nyz'het Bej Vrioni.

Në punën e tyre të mundimshme triditëshe, por të frytshme u shqyrtuan tri mundësi:

- a) të përshtatej njëri nga tri alfabetet më të përhapura në atë kohë: alfabeti i Stambollit, i shoqërisë "Bashkimi" ose i shoqërisë "Agimi";
- b) të bëhej kombinimi i këtyre tri alfabeteve, dhe
- c) të hartohej një alfabet i ri.

Pas shumë diskutimesh, u zgjodh varianti i tretë: të përpilohej një alfabet të ri për shqipen. Parimisht u pranua nga të gjithë se alfabeti i shqipes duhet të mbështetej në alfabetin latin. Zgjedhja e alfabetit latin për shkrimin e shqipes ishte edhe një element i emancipimit kulturor të shqiptarëve. Në Kongresin e parë për kodifikimin e alfabetit u përcaktua që shqipja të ketë shkrimin më të përsosur, më të përhapur, më të lehtë e më praktik; pra shkrimin fonetik, më mirë të themi fonologjik. Në këtë lloj shkrimi çdo fonemë jepet me një shkronjë të veçantë, kështu që numri i shenjave është i vogël.

Puna e parë dhe shumë e vështirë për alfabetizimin e gjuhës është përcaktimi i inventarit fonologjik të saj. Hartuesit e alfabetit të sotëm të shqipes me punën e tyre dëshmuuan se kishin përgatitje të lartë gjuhësore

(linguistike). Struktura fonologjike e shqipes standarde me 7 zanore dhe 29 bashkëtingëllore u përcaktua në thelb që me alfabetin e Shoqërisë së Stambollit, të Agimit e të Bashkimit dhe u ruajt me alfabetin e Manastirit. Ata me 36 shkronjat përcaktuan njëkohësisht edhe inventarin e fonemave zanore e bashkëtingëllore të shqipes letrare (36 fonema), prandaj mund të thuhet se njëkohësisht vunë edhe gurthemelin e shqipes standarde. Nga tre alfabetet (e dhëna në formë tabelore) është fare lehtë të krahasohen e të vërehen ngjashmëritë dhe dallimet midis tyre.²⁴⁴

Alfabeti i Agimit (1904)	Alfabeti i Bashkimit (1908)	Alfabeti i Stambollit (1879)	Alfabeti i sotëm i shqipes
a	a	a	a
b	b	b	b
ts	ts	c	c
č	ch	ç	ç
d	h	d	d
d	dh	δ	dh
é	é	ε	e
e	e	e	ë
f	f	f	f
g	g	g	g
ǵ	gh	ǵ	gj
h	h	h	h
i	i	i	i
j	j	j	j
k	k	k	k
l	l	l	l
ł	ll	λ	ll
m	m	m	m
n	n	n	n
ń	gn	η	nj
o	o	o	o
p	p	π	p
k	c	q	q
r	r	r	r
ř	rr	ρ	rr
s	s	s	s
š	sh	σ	sh
t	t	t	t
ṭ	th	θ	th
u	u	u	u
v	v	v	v

²⁴⁴ Rami Memushaj, *Fonetika e shqipes standarde*, Toena, Tiranë, 2009, f. 207-208

dz	z	x	x
dž	xh	ç	xh
y	y	y	y
z	x	z	z
ž	zh	z	zh

Tab. 21. *Abc-ja e Agimit, e Bashkimit, e Stambollit dhe abc-ja e sotme e shqipes*

Kongresi vendosi me marrëveshje të përdorshin dy alfabete: alfabeti i Stambollit, me disa ndryshime që e afronin më shumë me alfabetin latin dhe alfabeti i sotëm, që mungesat e alfabetit latin i plotësoi me dyshkronjësia dhe me shenja diakritike.²⁴⁵

Lënia e mundësisë së përdorimit të dy alfabeve për shkrimin e shqipes nga Kongresi i Manastirit ishte vendim i matur e largpamës, sepse mbylli shtegun e përçarjeve brendashqiptare. Por, për një kohe të shkurtër, alfabeti që e kemi sot u përhap në të gjitha letrat shqipe, si alfabet i njësuar gjithëshqiptar. Nga ana tjetër, me zgjedhjen e variantit latin të shkrimit të shqipes iu dha një grusht i fortë përpjekjeve të disa qarqeve të huaja për ndikim kulturor, e më pas për nënshtrimin dhe shkombëtarizimin e shqiptarëve.

Gjuha shqipe për shkrimin e saj përdor alfabetin latin të përshtatur sipas inventarit fonematik vetanak. Alfabeti i latinishtes u bë bazë e alfabeve të shumë gjuhëve. Gjuha e më se 36 popujve të Evropës dhe i shumë të tjerëve jashtë këtij kontinenti shkruhet me alfabetin latin të përshtatur në mënyra të ndryshme.

Alfabeti latin që ka 26 shkronja (po të përfshijmë edhe <w>, siç e quajmë në shqip v dyfishe), nuk ka mjaftuar për të shënuar 36 fonemat e gjuhës shqipe, andaj 25 shkronjat latine (pa w-në) janë plotësuar me shkronja të tjera. Kjo çështje në Kongresin e Manastirit është zgjidhur në katër mënyra:

1. Duke përdorur të njëjtën shkronjë latine për të shënuar fonemën përkatëse të gjuhës shqipe. Sipas kësaj trajte nga alfabeti latin me të njëjtën vlerë u bartën në alfabetin shqip 20 shkronja: <a, b, d, e, f, h, i, j, l, m, n, a, p, r, s, t, u, v, z, y>.²⁴⁶

2. Duke përdorur të njëjtën grafi latine, por me vlerë fonematike tjetër në gjuhën shqipe, p.sh. <c> = /c/ e jo /k/ si në latinishten, <x> = /x/ e jo /ks/. Kësisoj nga alfabeti latin u bartën në alfabetin shqip 3 shkronja: <c, q, x>.

3. Shkronjat <ë> dhe <ç> janë formuar duke u shtuar shkronjave latine <e> dhe <c> shenja diakritike (dy pika mbi <e>-në dhe një shenjë të ngjashme me presjen (,) nën <c>-në). Shkronja <ë> është marrë nga sistemi grafik i

²⁴⁵ Rami Memushaj, *Fonetika e shqipes standarde*, Toena, Tiranë, 2009, f. 206.

²⁴⁶ Tingujt i shënojmë mes kllapash katrore, si [a], [b]; fonemat mes kllapash të pjerrëta, si /a/, b/; ndërsa shkronjat mes kllapash këndore, si <a>, .

frëngjishtes, për shkak të prestigjit të lartë të kësaj gjuhe; ndërsa vënia e dy pikave si shenjë plotësuese (diakritike) mbi shkronjë që shënon zanore është e njohur edhe në gjuhët e tjera.²⁴⁷

4. Duke përngjitur dy shkronja latine në një shkronjë të përbashkët për të shënuar një fonemë të vetme të shqipes. Përngjitja u bë në tri mënyra:

a) me bashkëngjitjen e dy shkronjave të njëjta <l + l = ll> dhe <r + r = rr>;

b) duke bashkëngjitur dy shkronja të ndryshme kur e dyta është <j>: <gj> (g+j) dhe <nj> (n+j);

c) duke bashkuar një shkronjë me shkronjën <h>. Kështu u përfutuan shkronjat: <dh> (d+h), <sh> (s+h), <th> (t+h), xh (x+h) dhe <zh> (z+h).

U përcaktuan edhe shkronjat <g> dhe <k> për të shënuar dy fonemat prapagjuhore të shqipes: /g, k/.²⁴⁸

Siç dihet, alfabeti i gjuhës shqipe ka 27 shkronja të thjeshta (shënohen vetëm me një shenjë): <a, b, c, ç, d, e, ë, f, g, h, i, j, k, l, m, n, o, p, q, r, s, t, u, v, x, y, z> dhe 9 shkronja të përbëra (dyshkronjështa, digrafe, digrame): <sh, th, zh, dh, xh, gj, nj, rr dhe ll>.²⁴⁹

Kjo zgjidhje e këtillë e grafisë gjen mbështetje edhe në praktikën e shtypshkrimit të tekstit shqip. Alfabeti i thjeshtë latin është homogjen për nga karakteri i shkronjave, i lehtë për t'u shkruar dhe shumë i volitshëm në shtyp. Nuk kërkon shtypshkronja me shenja të posaçme.

A kemi abc-ë ideale?

Shkrimi fonologjik bazohet në parimin e bashkëlidhjes së një foneme me vetëm një shkronjë, por ky është vetëm ideal, sepse në realizim asnjë sistem konvencional i shkrimit nuk është konsekuent dhe plotësisht fonematik. Me fjalë të tjera, dihet se alfabet ideal do të ishte ai që do të kishte vetëm shkronja njëshe e të thjeshta. Një fonemë do të shkruhej gjithnjë dhe në çdo pozicion vetëm me një grafemë. Po alfabet ideal nuk ka. As alfabeti që përdorim sot nuk është ideal. Prandaj, për të përsosur atë, herë pas here janë shfaqur mendime, sugjerime e propozime për shkak se:

²⁴⁷ Njëshkronjështat latine janë modifikuar me shtimin mbi to të disa shenjave plotësuese (diakritike) edhe në disa gjuhë të tjera. P.sh. në alfabetin e turqishtes kemi shkronjat ö, ü, ğ, ç; në kroatishten dhe në alfabetin latin të serbishtes: shkronjat ć, č, š, ž, ĥ; gjermanisht ü, ö etj.

²⁴⁸ Dr. Pajazit Nushi, *Sistemi i grafisë së tingujve të shqipes dhe vetitë perceptive e përmasat e lexueshmërisë së shkronjave të alfabetit të gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1988, f. 51-52.

²⁴⁹ Rrugën e krijimit të digrafeve, trigrafeve por më rrallë edhe tetragrafeve për përpilimin e alfabeteve e kanë ndjekur edhe disa gjuhë të tjera që kanë pasur për bazë alfabetin latin. P.sh. abc-ja latine nuk ka pasur shkronjë për të shënuar fonemën /sh/, rrjedhimisht kjo fonemë në gjuhë të ndryshme shënohet me grafema të ndryshme: ital. me <sc> ose <sci>, frëngj. me <sh>, gjerm. me <sch>, polon. me <sz> etj. Në gjermanisht fonema /ç/ shënohet me katër shkronja <tsch> etj.

- në shkrimin e dyshkronjësive shpenzojmë më shumë kohë, ngjyrë, mund e letër sesa të kishim vetëm njëshkronjësia;
- leximi i dylojtë i shkronjave dyshe (si grafema më vete ose si digrafe);
- vështirësia e alfabetizimit automatik të fjalëve nëpërmjet kompjuterit që nisnin me dyshkronjësia (meqë kompjuteri e identifikon edhe dyshkronjëshin sipas shkronjës së parë);
- vështirësi në shkrimin e <ë, ç> për shkak të mungesës së këtyre dy shkronjave në tastierën joshqip të kompjuterit e të telefonit; si dhe
- <nj>-ja duhet apo nuk duhet të jetë shkronjë më vete?

Me probleme të ngjashme ose tjetërfare përballen edhe gjuhë të tjera me traditë shkrimore shumë të vjetër. Përgjigjet e këtyre mangësive të abc-së së shqipes janë dhënë nga shumë gjuhëtarë. Ne po sjellim disa nga to:

Për t'iu përmbajtur me përpikëri parimit që një fonemë të shkruhet vetëm me një shkronjë, ka mendime se mund të përkryhet dhe ekonomizohet sistemi grafik i gjuhës sonë, sepse sistemi grafik që e kemi në përdorim ka mangësi për shkak të përdorimit të digrameve, nga që nuk përfilllet kërkesa e ligjit të ekonomizimit gjuhësor. Dihet se njeriu gjithmonë përpiqet që me sa më pak mund të arrijë efekte më të mëdha në dhënien e informacioneve. Ky ligj i ekonomizimit në të folur, parimisht duhet të përcillet edhe në transkriptimin sa më ekonomik të ligjërit njerëzor.²⁵⁰

Nëntë dyshkronjëshat janë numerikisht një e katërta e alfabetit të shqipes. Në dukje kjo është një ngarkesë e madhe. Por sipas studimeve statistikore të nëntë shkronjat zënë 6-7% të tërësisë së shkronjave në një tekst të lidhur. Me fjalë të tjera, në çdo njëqind shkronja të një teksti, vetëm 6-7 shenja janë dyshkronjësia. Dendurinë më të madhe ndër këto e ka <sh>-ja me rreth 2.5%, pastaj vjen <dh>-ja me diçka më shumë se 1%, kurse të gjitha të tjerat e kanë dendurinë më pak se 1% (<nj>-ja me 0.67%, <gj>-ja 0.65%, <rr>-ja 0.50%, <ll>-ja me 0.47%, <th>-ja me afër 0.47%, <xh>-ja dhe <zh>-ja me rreth 0.06%. Nga kjo rrethanë sasiore shihet se pesha specifike e dyshkronjësive në të shkruarit e gjuhës shqipe është e vogël dhe praktikisht ato nuk përbëjnë ndonjë mbingarkesë.²⁵¹

Si shkronjë me shenjë diakritike <ë>-ja është nga më të përdorshmet në tekstet e shkruara. Ajo zë vendin e dytë me denduri afër 10%, ndërsa <ç>-ja përdoret pak, zë vendin e 33-të me 0.31%. Mospërdorimi i këtyre dy shkronjave në praktikë nuk arsyetohet me tastierën e kompjuterit si dhe të telefonit, meqë tani kemi mundësi që tastiera të kthehet në shqip e të shkruajmë edhe këto dy shkronja vetëm me një prekje gishti.

Po të krahasojmë shkrimin e shqipes me disa gjuhë të tjera, abc-ja e shqipes ka disa përparësi. Kështu, anglishtja, frëngjishtja, gjermanishtja, italishtja etj., kur paraqesin alfabetin e tyre, rendisin 26 shkronjat e alfabetit

²⁵⁰ Haki Ymeri, *Për një sistem grafik më ekonomik të gjuhës së sotme shqipe*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 85-94.

²⁵¹ Emil Lafe, *Alfabeti i Kongresit të Manastirit ...*, f. 14.

latin, por kombinimet e grafemave për të shënuar fonema të veçanta nuk numërohen si shkronja më vete. Anglishtja, p.sh. si gjuhë mjaft e përpunuar, në shkrim ka disa mangësi, sepse për të shënuar 40 tingujt themelorë të saj përdor mbi 200 kombinime shkronjash. Përkundër këtyre mënyrave të shkrimit të ndërlikuar, gjuha shqipe, për t'i shënuar 36 fonema, përdor 36 shkronja.

Kështu, po të vlerësojmë sistemin grafik të shqipes nga pikëpamja e parimeve të përgjithshme, mund të thuhet se ai është nga më të thjeshtët (krahasuar me abc-në e gjuhëve të tjera) dhe ka zgjedhur mjaft drejt problemin e shkrimit të gjuhës sonë: 36 fonemat e shqipes shënohen me 36 shkronjat e alfabetit, që përbëhen nga 25 shenja të thjeshta, 9 dyshkronjësia dhe dy shkronja me shenja diakritike. Nga kjo pikëpamje në vija të përgjithshme është respektuar parimi themelor i grafisë, që e njëjta fonemë të paraqitet në të gjitha rastet vetëm me një shkronjë të veçantë (të thjeshtë ose dyshkronjësh).

Përdorimi i shkronjave dyshe ka të mirat e veta, ngase me një numër më të vogël shenjash, përkatësisht me 27 shenja të thjeshta (kuptohet dhe me 9 çiftet e tyre) paraqiten 36 fonemat e gjuhës sonë. Por, kjo ka edhe të meta, sepse: 1) dyshkronjëshat zgjatin tekstin e shkruar; 2) krijojnë mundësi që disa çifte shkronjash të lexohen në dy mënyra, d.m.th. si digrafe dhe si shkronja të veçanta që vijnë njëra pas tjetrës, p.sh. *lagje, lagja ose lag'je, lag'ja; Mithat ose Mit'hat; meshollë ose mes'hollë, gazhedhës ose gaz'hedhës* etj. Në mënjanimin e leximin dyfarësh, në shumë fjalë vënia e apostrofit mund të jetë zgjidhje (Mit'hat; mes'hollë, gaz'hedhës etj.).

Në sistemin grafik të gjuhës shqipe grafemat janë të njëvlerëshme, sepse tregojnë gjithnjë të njëjtën fonemë. Shkronja <i> mund të thuhet se është e vetmja me dy vlera në sistemin grafik të shqipes: me të përgjithësisht jepet fonema /i/, por në raste të caktuara edhe fonema /j/. Jo vetëm në rastet *djegie, zënie, pedagogia* etj. (ku shkruhet <i>, ndërsa lexohet [j]), po edhe në një varg fjalësh të huaja që shkruhen me grupet <ia, ie, io, iu> (si *variant, malarie, aksion, stadium* etj.) ajo shqiptohet si [j].²⁵² Në një numër të vogël fjalësh, kryesisht të burimit latin, <u>-ja e ka vlerën e një gjysmëzanoreje (të ngjashme me shqiptimin e [v]-së, respektivisht v-së dyfishe [w] në anglishte), si *kolokujum, akuarium, kuadër, kuarc, kuotë* etj., duke formuar diftong me zanoren tjetër fqinje. Edhe fjalët e tilla ku shkruhet <i> e lexohet /j/ apo shkruhet <u> e lexohen /v/ nuk paraqesin ndonjë vështirësi.

Digrafia <nj> është dhe duhet të jetë shkronjë më vete sepse me të shënohet fonema /nj/ e shqipes. Tingulli e fonema /nj/ nuk është bashkim shqiptimor i dy tingujve të veçantë [n] + [j], por artikullohet si një tingull i vetëm dhe në sistem funksionon si fonemë më vete. Si shkronjë më vete e kanë edhe shumë gjuhë të tjera indoevropiane. P.sh. në maqedonishte e në serbishte (alfabetin cirilik) fonema /nj/ shënohet me <њ> (диња, полиња, дење 'dinja, polinja, denje).

²⁵² Emil Lafe, *Alfabeti i Kongresit të Manastirit ...*, f. 51-56.

Duhet dalluar shkronjat dhe alfabetin që formohet prej tyre me grafemat e gjuhës. Kësisoj, grafemat mund të paraqiten në formën e shkronjave të ndryshme: shkronja të vogla, të mëdha, shkronja të shtypit, të dorës; ato mund të paraqiten me madhësi të ndryshme, me tipe shkronjash të ndryshme, më të zeza, të pjerrëta, të hijesuara etj.

Ashtu si fonema realizohet nga *alofone*, edhe grafema realizohet nga *alografe*. Pra, alografet janë variantet e ndryshme të një grafeme. P.sh. alografe të grafemës janë e vogël e dorës, e vogël e shtypit, e madhe e dorës dhe e madhe e shtypit (shkronjat e mëdha merren edhe si grafema të ndryshme, meqë dallojnë emrat e përveçëm nga emrat e përgjithshëm). Me shpikjen e shtypshkrimit, u shtuan edhe mundësitë e paraqitjes së grafemave. Secili prej varianteve të mësipërme mund të paraqitet në variante të ndryshme: *normal*, *të pjerrëta* (kursive, ose italike), *të holla*, *të trasha* (bold), *normal dhe të trasha*, *të pjerrëta dhe të trasha*, *të nënvizuara* etj. Tani me zhvillimin e kompjuteristikës kemi grafi shkronjash të panumërta (, , , , , , , ...), mirëpo me të gjitha këto laryshi grafike shënojmë vetëm një fonemë. Në këtë mënyrë bëhet formësimi grafik i tekstit.

Me futjen nëpërdorim të kompjuterit, secili nga stilet e mësipërme paraqitet si një paketë më vete, qëpërfshin të gjitha variantet e një grafeme, numrat, simbolet matematike, shenjat e pikësimit dhe shenja të tjera grafike që përdoren në të shkruar. Të gjitha këto formojnë një familje shenjash që në gjuhën e kompjuterit quhen *fonte*.²⁵³

Pothuajse të gjithë janë të mendimit se Kongresi i Manastirit mbylli përfundimisht fazën e parë të planifikimit gjuhësor të shqipes, *alfabetizimin* e saj, të filluar shumë shekuj më parë.²⁵⁴ Me të drejtë është konstatuar se për ne shqiptarët njësimi i alfabetit, njësimi i gjuhës dhe njësimi i kulturës sollën natyrshëm bashkimin e kombit. Njësimi (unifikimi) i alfabeteve që parakusht për bashkimin kombëtar.

Përmbyllje

Për Kongresin e Alfabetit është shkruar e thënë jo pak deri më tani, por për këtë ngjarje shumë të rëndësishme për popullin shqiptar do të flitet edhe në të ardhmen. Padyshim se Kongresi i Manastirit njësoi shkrimin e shqipes, parapriu njësimin e kombit dhe shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, përcaktoi bazën fonologjike të shqipes standarde, duke vënë gurthemelin e saj; dobësoi përçarjen krahinore dhe politikën asimiluese, zgjoi dhe fuqizoi vetëdijen kombëtare, dëshmoi se jemi një komb, që kemi një histori, një gjuhë dhe një alfabet.

²⁵³ Rami Memushaj, *Fonetika e shqipes standarde*, Toena, Tiranë, 2009, f. 203-204.

²⁵⁴ Po aty, f. 208.

Në Kongresin e Manastirit u përcaktua edhe baza fonologjike e shqipes standarde. Shkronjat janë shenja grafike që shënojnë tingujt themelorë ose fonemat e gjuhës. Hartuesit e alfabetit të sotëm të shqipes me punën e tyre dëshmuar se kanë pasur përgatitje të lartë gjuhësore (linguistike). Struktura fonologjike e shqipes standarde me 7 zanore dhe 29 bashkëtingëllore u përcaktua në thelb që me alfabetin e Shoqërisë së Stambollit dhe u ruajt me alfabetin e Manastirit. Ata me 36 shkronjat përcaktuan njëkohësisht edhe inventarin e fonemave zanore e bashkëtingëllore të shqipes standarde (36 fonema), prandaj mund të thuhet se njëkohësisht vunë edhe gurthemelin e gjuhës standarde shqipe.

Në Kongresin e kodifikimit të alfabetit u përcaktua që shqipja të ketë shkrimin më të përsosur, më të përhapur, më të lehtë e më praktik; pra shkrimin fonetik, më mirë të themi fonologjik. Në këtë lloj shkrimi çdo fonemë jepet me një shkronjë të veçantë, kështu që numri i shenjave është i vogël.

Kjo zgjidhje e këtillë e grafisë gjen mbështetje edhe në praktikën e shtypshkrimit të tekstit shqip. Alfabeti i thjeshtë latin është homogjen për nga karakteri i shkronjave, i lehtë për t'u shkruar dhe shumë i volitshëm në shtyp. Nuk kërkon shtypshkronja me shenja të posaçme.

Alfabeti i përbashkët dhe i ndërtuar drejt hapi rrugën për një emancipim kulturor, për një drejtshkrim të përbashkët dhe për një gjuhë standarde për të gjithë shqiptarët, siç e kemi sot.

9.3. SHQIPJA NË PROCESIN E GLOBALIZIMIT

Ç'është globalizimi?

Globalizimi si term ka filluar të përdoret qysh nga viti 1944, mirëpo ekonomistët kanë filluar ta përdorin aty nga viti 1981. Disa autorë në vend të termit globalizim parapëlqejnë termin internacionalizim. Termi *globalizim* është përfutur nga emri *glob-i* që ka kuptimin e parmë rruzulli i tokës, lëmshi tokësor, bota. Fjala global (si mbiemër) ka kuptimin: i përgjithshëm, që përfshin gjithçka, tërësor, i plotë. Pra, me globalizim, mund të kuptojmë ndërlidhjen shoqërore, ndërvarësinë, integrimin, ndërveprimin, kontrollimin dhe koordinimin e të gjitha veprimtarive njerëzore në rruzullin tokësor, veçmas në nivelin ekonomik, kulturor, teknik e juridik.

Thjesht, globalizimi nënkupton “një botë pa kufi”, që çon botën drejt homogjenizimit, drejt një kulture të vetme globale, ku njerëzit në të katër anët e botës jetojnë, punojnë e mendojnë në mënyrë të ngjashme. Ka autorë që mendojnë se globalizimi është duke krijuar një përzierje midis asaj që është globale (universale) dhe asaj që është lokale (të posaçmes). Shtytjen kryesore dukurisë së globalizimit i dha zhvillimi i teknologjisë, sidomos zhvillimi i teknologjisë së komunikimit dhe informimit. Lëshimi në përdorimi i Internetit në fillim të viteve '90 të shekullit XX, bëri që bota ta ketë në dorë mjetin me të

cilin njerëzit në të katër anët e botës ishin më afër se kurrë më parë me njëri-tjetrin. Në këtë mënyrë, bota u bë një hapësirë e vetme për shkëmbime ekonomike, sociokulturore dhe gjuhësore.²⁵⁵

Në literaturën shkencore janë dhënë përkufizime të ndryshme për globalizimin si dukuri shumëdimensionale. Në enciklopedinë www.wikipedia.org globalizimi (ang. globalization) përkufizohet si: “proces i transformimit të gjërave ose të dukurive lokale a regjionale në dukuri globale. Mund të përkufizohet edhe si proces, në bazë të të cilit popujt e botës janë identifikuar në një shoqëri të vetme dhe funksionojnë bashkërisht. Ky proces është kombinim i forcave ekonomike, teknologjike, sociokulturore e politike.”

Në <https://sq.wikipedia.org/wiki/Globalizimi> gjejmë këtë përkufizim për globalizimin: Globalizmi i referohet një dukurie shumëplanëshe ekonomike dhe shoqërore që nisi diku në fillim të viteve '90-të. Termi u fut shpejt në fjalorin e përgjithshëm, duke treguar lidhjen gjithnjë e më të ngushtë midis shteteve nëpërmjet tregtisë në rritje, investimeve, shkëmbimit të informacionit, turizmit, ndikimit kulturor nëpërmjet medieve etj. Globalizimi ka edhe ndikim politik mbi vendet të cilat janë në integrimet ekonomike kryesore në bote, siç janë: Unioni Evropian (EU), Organizata e Vendeve Eksportuese të Naftës (OPEC), etj.

Ekzistojnë tri forma globalizimi:

1. *Globalizimi i ekonomisë*. Shtetet hapin kufijtë në mënyrë që tregtia dhe investimet midis tyre të rriten.

2. *Globalizimi i kulturës*. Mediet moderne dhe marketingu bëjnë që njerëzit të shohin vazhdimisht të njëjtat programe televizive, të veshin rroba të së njëjtës markë, të dëgjojnë të njëjtën muzikë dhe të rrojnë me të njëjtat ideale në gjithë botën.

3. *Globalizimi politik dhe juridik*. Shteti lidhet gjithnjë e më shumë së bashku në një bashkëpunim politik të detyruar. Jo më pak, rrjeti i marrëveshjeve ndërkombëtare dhe rregullat juridike kujdesen që tregtia e lirë tradicionale të kufizohet.

Ideja për globalizim është e kamotshme, mirëpo për të flitet intensivisht dhe sistematikisht që nga vitet e '90-ta të shekullit të kaluar, pra pas falimentimit të sistemit monist të vendeve socialiste të Evropës Lindore. Globalizimi, si pikënisje dhe si bazë, ka konkurrencën dhe mbështetet në shoqërinë demokratike pluraliste, ekonominë e hapur dhe të tregut, duke respektuar edhe të drejtat dhe liritë e njeriut. Globalizimi zvogëlon rolin e kufijve shtetërorë dhe bashkon tregjet kombëtare në një treg të përbashkët dhe unik botëror. Globalizimi është fenomen kompleks i cili ka efekte të dyanshme. Nga njëra anë, globalizimi është një integrim i kapitalit, i teknologjisë dhe i informatave përtej kufijve shtetëror, me qëllim që të krijohet

²⁵⁵ Shkumbin Munishi, *Shqipja në epokën e globalizimit*, Prishtinë, 2015, f. 17.

një treg i madh në botë. Pra, ky fenomen përmban në vete procese të cilat çojnë drejt zvogëlimit të rolit të kufijve shtetërorë dhe të bashkimit të tregjeve kombëtare (shtetërore) në një treg të vetmin global (botëror). Nga ana tjetër, globalizimi akuzohet si një burim i sëmundjeve të ndryshme të shoqërisë bashkëkohore.

Karakteristikat kryesore të globalizimit janë rritja e tregtisë ndërkombëtare, rritja dhe koncentrimi i kapitalit ndërkombëtar, migrimi i popullatës, zhvillimi i teknikës dhe i teknologjisë dhe industrializimi.

Shumë analistë në botë, kur flasin për globalizimin, shpesh potencojnë se globalizimi është një proces human me perspektivë dhe si i tillë është i pashmangshëm. Mirëpo, si çdo fenomen i madh, edhe ai ka dobësitë dhe problemet e veta, që i kategorizon njerëzit në përkrahës dhe kundërshtarë të globalizimit.²⁵⁶

Përkrahësit, globalizimin e konsiderojnë si një proces të paevitueshëm dhe të pakthyeshëm, dhe që do t'i përfshijë të gjitha vendet dhe të tëra fushat e jetës në botë. Kundërshtarët e globalizimit janë kryesisht nga vendet në zhvillim, ithtarë të proteksionizmit dhe të intervencionizmit. Brenda tyre veçohen disa kategori njerëzore, si për shembull, ekologjistë, feministë, anarkistë, të gjelbrit, neokomunistë, etj. Kundërshtarët, globalizimin e shikojnë me skepticizëm dhe dyshojnë në zhvillimin e ardhshëm ekonomik botëror. Madje, globalizimin ata e konsiderojnë si shkaktarin kryesor të pabarazisë dhe të thellimit të hendekut midis shteteve të zhvilluara dhe të atyre në zhvillim, pastaj të shfaqjes së varfërisë, të papunësisë, të sëmundjeve epidemike dhe të ndotjes së ambientit.²⁵⁷

Shqipja në rrafshin global

Pas ndryshimeve ekonomike dhe politike që ndodhën në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoni në fillim të viteve '90 të shekullit XX, pozita e shqiptarëve ka shkuar drejt përparimit. Pas viti 1991, Shqipëria u fut në procesin e tranzicionit ekonomik dhe politik... Në po të njëjtat procese janë futur edhe shqiptarët e Kosovës dhe ata të Maqedonisë së Veriut. Por, gjatë viteve '90 të shekullit XX, Kosova është dashur të përfshihet në luftën çlirimtare për liri dhe për krijimin e shtetit, synim i cili u realizua përfundimisht më 17 shkurt 2008, me shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Rrethanat e reja të krijuara në hapësirat shqiptare në Ballkan kanë mundësuar që shoqëria shqiptare të hapet ndaj dukurive të globalizimit dhe të proceseve të tjera të integritimeve evropiane dhe në NATO. Hapja e tregut shqiptar dhe futja e investimeve të huaja, si dhe zhvillimi marramendës i

²⁵⁶ Dr. Skender Berisha, *Procesi i globalizimit*, në <http://www.scribd.com/doc/12982581/Procesi-i-Globalizimit>.

²⁵⁷ Dr. Skender Berisha, *Po aty*.

teknologjisë së prodhimit, i medieve dhe i teknologjisë informative kanë krijuar hapësira për përparime cilësore në kuadër të bashkësisë shqiptare.

Heqja e barrierave dhe e kufijve, si dhe përmirësimi i infrastrukturës së transportit, po krijon hapësira për komunikim më të afërt midis shqiptarëve. Rritja e komunikimit mund të ndikojë që të futen në përdorim forma të caktuara gjuhësore, të cilat do të konsiderohen si forma të përbashkëta, apo edhe forma kompromisi, për të gjithë shqiptarët në kuadër të stileve të caktuara të komunikimit, sidomos në kuadër të stileve formale.

Bashkëpunimi ekonomik midis Shqipërisë dhe Kosovës, ndonëse në nivele jo të kënaqshme, po vjen duke u shtuar gradualisht. Bashkëpunimi në kulturë, në art dhe në shkencë është po ashtu në nivele që lënë për të dëshiruar. Ndoshta përjashtim bëjnë mediet. Digjitalizimi i programeve televizive dhe Interneti kanë krijuar hapësira të përbashkëta për transmetime televizive të programeve në gjuhën shqipe. Pakoja e programeve televizive DigitAlb tashmë është shtrirë në të gjithë hapësirën fizike shqiptare në Ballkan, por edhe në diasporë përmes transmetimeve satelitore.

Nga ana tjetër, shqiptarët dhe institucionet e tyre qeveritare, si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë e në Maqedoni, janë duke kaluar nëpër procese të njëjta të integritimeve në BE dhe në NATO. Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, pa përjashtim, u nënshtrohen programeve ekonomike dhe monitorimeve nga FMN-ja, Banka Botërore e Komisioni Evropian...

Mund të themi lirisht që edhe shtetet shqiptare janë futur në një proces të rishkallëzimit ose të ripërshtatjes edhe në nivel global, edhe në nivel makrorajonal. Tani do të shohim se si janë duke ndikuar rrethanat e reja në gjuhën shqipe dhe në varietetet e saj dhe cili mund të jetë ndikimi i proceseve të globalizimit në gjuhën shqipe.²⁵⁸

Një prej dukurive kryesore, e cila lidhet me procesin e globalizimit është rrezikshmëria e gjuhëve për t'u zhdukur. Globalizimi dhe përhapja e anglishtes rrezikojnë shumë kultura dhe gjuhë të popujve të vegjël që të zhduken. Shumë autorë dhe organizata ndërkombëtare botërore, si UNESCO, janë ngritur në mbrojtje të gjuhëve të rrezikuara, duke theksuar se të gjitha gjuhët janë të vlefshme dhe të barabarta dhe që diversiteti gjuhësor është vlerë më vete, ngjashëm me biodiversitetin. Sipas tyre, gjuhët e kanë rëndësinë e tyre të veçantë për njerëzit dhe popujt që i flasin, sepse këto gjuhë janë të lidhura me identitetin, me kulturën dhe me memorien e këtyre popujve dhe çdo përpjekje për t'i shtypur këto gjuhë do të paraqiste gjenocid kulturor, apo "linguicid".

Mbrojtja e gjuhëve të rrezikuara dhe gjuhëve minoritare është bërë politikë gjuhësore edhe në Bashkimin Evropian. Përparimi i teknologjisë së

²⁵⁸ Shkumbin Munishi, *Shqipja në epokën e globalizimit*, Prishtinë, 2015, f. 25-26.

informacionit shihet si një mundësi e mirë që do të ndihmonte në ruajtjen e diversitetit gjuhësor.²⁵⁹

Shqipja që flitet në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut aktualisht nuk është futur në grupin e gjuhëve të rrezikuara. Përrjashtim bëjnë variantet arvanitase në Greqi, të cilat në “Librin e kuq të UNESCO-s për gjuhët e rrezikuara” janë futur në kategorinë e “gjuhëve pothuajse të shuara” dhe variantet e arbëreshëve të Italisë, të cilat konsiderohen si gjuhë të rrezikuara. Sa u përket varianteve arvanitase, mund të ndodhë që vendosja e emigrantëve shqiptarë në Greqi, pas vitit 1991, dhe kontaktet e popullatës arvanitase me ta, si dhe përparimi i medieve dhe i Internetit, të kenë ndikim pozitiv në proceset gjuhësore dhe të ndihmojë në ruajtjen e varieteteve arvanitase nga shuarja. **Fakti që shqipja vazhdon të ketë folës të bollshëm burimorë është tregues i qartë se gjuha shqipe nuk ka rrezik që të zhduket.**²⁶⁰

Një tjetër dukuri që është e lidhur ngushtë me përhapjen e proceseve globalizuese është Interneti. Mund të thuhet se Interneti ka krijuar një hapësirë të re virtuale, në të cilën është reflektuar i tërë diversiteti dhe variacioni gjuhësor që ekziston në botën reale, ndërkohë që ky ndikim shkon edhe më tej, në kuptim të krijimit të formave të reja komunikuese, të cilat nuk janë të pranishme në botën reale. Ndonëse nuk dihen saktësisht se sa gjuhë janë të pranishme në Internet, Crystal-i ka arritur të gjejë mbi 1000.²⁶¹

Edhe pse Interneti, nga shumë autorë konsiderohet si mjete kryesor për përhapjen e anglishtes si gjuhë globale dhe për ndikimin e saj në gjuhët e tjera, megjithatë Interneti ka krijuar domene të reja për përdorimin e shqipes. Komunikimi në rrafshin global ka marrë përmasa të gjera dhe bota shqiptare, e izoluar dikur, tashmë është hapur ndaj vetvetes dhe ndaj pjesës tjetër të botës.

Tani nëpërmjet Internetit shqiptarët në cilindo vend të botës që janë po komunikojnë shpesh ndërmjet veti në shqip, por edhe me popuj të tjerë të botës në gjuhë të huaja. Shqipja sot është gjuhë e shumë ueb-faqeve në gjuhën shqipe, e e-mail-ave, e forumeve dhe e blog-ave të ndryshëm në Internet, si dhe e rrjeteve sociale, siç janë Facebook dhe Twinter, në të cilat shqipja del në format e saja të shkruara, herë në formë standarde, herë në forma të varieteteve të tjera të shqipes.

Shqipja është gjithashtu gjuhë e bisedave e dhomave virtuale (ang. chat rooms), e mesazheve për komunikim të çastit (ang. instance messages) në Skype, Hangouts e Snapchat, e statuseve dhe tweet-ëve (cicërrima në Twintter), te të cilat format e të folurit realizohen aty për aty përmes shkrimit. Përdorimi i shqipes në Internet mbetet një fushë pothuajse plotësisht e

²⁵⁹ Po aty, f. 42.

²⁶⁰ Po aty, f. 26-27.

²⁶¹ Po aty, f. 68-69.

paprekur dhe çdo kontribut në këtë drejtim do ta pasurojnë shumë këtë fushë studimore.²⁶²

Përgjithësisht është pranuar se Interneti shihet si një nga mjetet kryesore për përhapjen e proceseve të globalizimit, por edhe të përhapjes së anglishtes si gjuhë globale. Por, nga anat tjetër, Interneti promovon sot një mirëseardhje të gjerë globale për të gjitha gjuhët dhe, mbase, është edhe mjeti kryesor për ruajtjen dhe për përhapjen e diversitetit kulturor e gjuhësor në botë.

Shoqëria shqiptare në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut është duke kaluar nëpër procesin e integritimeve lokale, makrorajonale e globale. Rishkallëzimi ose ripërshtatja në fushën politike, ekonomike, por edhe gjuhësore, është proces që vërehet edhe në hapësirat shqiptare. Ky proces karakterizohet nga përpjekjet për promovimin e ekonomisë së tregut të lirë, për ndërtimin e institucioneve demokratike dhe për integrimet evropiane dhe në NATO. Procesi i rishkallëzimit ose i ripërshtatjes reflekton edhe një prej aspekteve kryesore të ndikimit të globalizimit në proceset gjuhësore. Gjuha shqipe, në përgjithësi, dhe shqipja standarde, në veçanti, janë futur në një proces të rishkallëzimit në kontekste të ndryshme politike, ekonomike e kulturore. Ky rishkallëzim ose ripërshtatje gjuhësore ndodh në tri rrafshe:

- a) në rrafshin vendor, si përshtatje e shqipes me rrethanat e reja shoqërore dhe kulturore;
- b) në rrafshin makrorajonal, si përshtatje e shqipes me integrimet evropiane dhe, në përgjithësi;
- c) në rrafshin global, si përshtatje e shqipes me dukuritë dhe me proceset globalizuese.²⁶³

Ndikimi i globalizimit në shqipe nuk mund të shihet ngushtë si ndikim i anglishtes në shqipe që shprehet përmes huazimeve kulturore në formë të huazimeve të drejtpërdrejta, të kalkeve e të huazimeve hibride. Forma kryesore e ndikimit të proceseve të globalizimit dhe të integritimit në shqipe manifestohet me ndryshimin e diskurseve publike, të zhanreve dhe të stileve... Mjafton të analizohen deklaratat e politikanëve, të biznesmenëve, të bankierëve, të përfaqësuesve të medieve dhe në to do të gjejmë përplot fjalë e togfjalësha ...

9.4. GJUHA SHQIPE NË INTERNET

Interneti në shqipen ka po të njëjtin ndikim, sikurse edhe në gjuhët e tjera. Krahas ndikimit të fuqishëm të anglishtes, ai ka hapur rrugë përdorimit të të gjitha variacioneve gjuhësore standarde, gjysmëstandarde e jostandarde të shqipes. Pra, në Internet gjejmë të gjitha variacionet e shqipes e sotme:

²⁶² Shkumbin Munishi, *Shqipja në epokën e globalizimit*, Prishtinë, 2015, f. 27-28.

²⁶³ Po aty, f. 28-29.

- a) të gjitha ligjërimet e mundshme (formën e folur dhe të shkruar): letrar, bisedor e ligjërimin e shkujdesur;
- b) të gjitha variantet stilistike: stilin shkencor, administrativ, shoqëror e politik, letrar artistik e stilin fetar;
- c) të gjitha variantet shoqërore: ligjërimin e grupmoshave e të njerëzve me profesione të ndryshme.

ç) të gjitha larmitë dialektore, krahinore e lokale e individuale, ndonjëherë edhe në variantin gjysmëdialektor ose një hibrid gjuhësor me një shqipe gjysmake dhe një gjuhe të huaj.

Në përgjithësi, shqipja e Internetit mbushullon me tekste të ligjërimin të shkujdesur, me prirjen e përgjithshme të ekonomisë së gjuhës dhe lehtësimin të ligjërimin (për tiparet e ligjërimin të shkujdesur rilexo tekstin përkatës në leksionin: Ligjërimi i shkujdesur, bisedor dhe ligjërimi libror). Veçmas të rinjtë në shkrimet e tyre elektronike përdorin shkurtesat e tipit: ok = mirë, në rregull; flm = faleminderit, sps = s'ka përse, klm = kalofsh mirë, ntm = natën e mirë etj.

“Gjuha më mirë se gjithçka tjetër jep shpesh dritën ose mjerimin e një kohe”. Janë këto fjalët e Ismail Kadarese që të ftojnë të reflektosh rreth asaj që po ndodh me gjuhën shqipe, e përkufizuar si pasqyra e kulturës dhe kombit tonë. Albanologia Shefkije Islamaj analizon për “Shekullin” disa nga çështjet më kritike që prekin qëndrueshmërinë e gjuhës standarde. Sipas studiueses, për jetëgjatësinë dhe funksionimin sa më të mirë të saj në gjithë territorin shqipfolës, në radhë të parë duhet të përkujdesen institucionet shtetërore, autoritetet arsimore, administrata, përfshirë këtu edhe mjetet publike të informimit.²⁶⁴

Prof. Rami Memushaj, duke iu përgjigjur pyetjes: A po e prish interneti gjuhën shqipe? mendon se “faji nuk mund t’i hidhet internetit, ndonëse nuk mund të mohohet që modelet e këqija të të shkruarit pa dyshim që ndikojnë për keq te lexuesi. Po më shumë interneti na tregon nivelin e ulët të zotërimit të normave të gjuhës standarde në shkollë dhe pikërisht ky fakt duhet të shërbejë si nxitje për Ministrinë e Arsimit që të forcojë kontrollin në shkolla dhe masat për rritjen e cilësisë së mësimdhënies së gjuhës shqipe.”²⁶⁵

I mbetet shoqërisë shqiptare dhe institucioneve që të fillojnë të mendojnë për politikën gjuhësore, të cilat do të jenë në funksion të rregullimit të këtij procesi të rishkallëzimit ose ripërshtatjes së shqipes në shkallë globale e makrorajonale. Kjo veprimtari do të ishte në funksion të kultivimit të vitalitetit dhe të elasticitetit të normës së shqipes dhe do ta bënte shqipen më

²⁶⁴ <http://shekulli.com.al/albanologia-ne-politike-dhe-ne-internet-po-banalizohet-gjuha/>

²⁶⁵ <http://www.faktinews.com/aktualitet-2/analiza/a-po-e-prish-interneti-gjuhen-shqipe/>

të aftë për t'i kryer funksionet e saja komunikuese dhe kulturore në rrethanat e globalizimit.²⁶⁶

Siç dihet, anglishtja është gjuha më dominuese në botë. Globalizimi është rezultat i zhvillimit industrial dhe teknologjik i vendeve perëndimore, sidomos i ShBA-së. Epërsia politike, ekonomike dhe kulturore e ShBA-së, por edhe e Britanisë së Madhe, ka bërë që anglishtja të imponohet si gjuhë e komunikimit masiv në nivel botëror, pra të bëhet një *lingua franca* botërore, ngjashëm me latinishten dikur. Por, për dallim nga kjo e fundit, për shkak të mundësive reale e virtuale për komunikim në rrafshin global, shtrirja e anglishtes i tejkalon përmasat e shtrirjes që kishte latinishtja, apo çfarëdo gjuhe tjetër dikur. Anglishtja është bërë gjuhë kryesore e komunikimit përmes Internetit si dhe midis folësve që për gjuhë amtare kanë gjuhë të tjera.²⁶⁷ Përhapja e anglishtes në katër anët e botës ka për rrjedhojë lindjen e larushive territoriale të anglishtes. Këto “anglishte të reja” janë sikurse dialektet, të cilat i njohim në vendet tona, por që këto “anglishte të reja” janë në shkallë ndërkombëtare, dhe kanë të bëjnë me vende dhe rajone të tëra.

Procesin e përhapjes së anglishtes në dëm të shqipes në Shqipëri, në Kosovë e në Maqedoni po e ndihmojmë dhe po e përshpejtojmë edhe vetë ne. Fatkeqësisht, gjithnjë e më tepër po e bjerrim gjuhën e kulturën shqiptare dhe po vrapojmë pas të huajës. Si duket, ne shqiptarët jemi të parët në Ballkan për adhurimin e të huajës. Bie fjala, mjafton të shëtisim nëpër Tiranë apo Prishtinë e të vërejmë e numërojmë sa tabela e mbishkrime lokalesh afariste janë shkruar shqip e sa anglisht ose në ndonjë gjuhë tjetër.

Në konkurset për zbulimin e talenteve të rinj në këndim, veçmas në Shqipëri rrallëherë mund të dëgjojmë ndonjë këngë shqipe, meqë shumica janë anglisht ose italisht. Jo pak konferenca albanologjike gjuhë pune, përveç shqipes kanë edhe anglishten. Madje, disa parapëlqejnë që kumtesat e tyre edhe në revistat kombëtare t'i botojnë vetëm në anglisht. Në kriteret e zgjedhjes në tituj mësimorë në universitetet tona, një artikull i botuar në anglisht (me pak faqe, 7-8) në ndonjërin nga revistat ndërkombëtare me faktorin impakt mbivlerësohet aq shumë saqë llogaritet më shumë sesa një monografi a studim i thelluar (prej 200-300 faqesh) i shkruar në shqip e me botim vendor.

Një pjesë e konsiderueshme e anglicizmave po futen në shqipe si pjesë e proceseve të globalizimit, ndërsa mediet po shërbejnë si mekanizma kryesorë për futjen e tyre. Anglishtja është duke ndikuar pa përjashtim në të gjitha fushat dhe si rrjedhojë anglicizmat hasen dendur në të gjitha terminologjitë që mbulojnë fushat përkatëse. Teknologjia e informacionit, ekonomia, financat, politika, diplomacia, legjislacioni, sporti, kuzhina, moda, etj. janë vetëm disa nga fushat në të cilat huazimet nga anglishtja janë duke

²⁶⁶ Shkumbin Munishi, *Shqipja në epokën e globalizimit*, Prishtinë, 2015, f. 31.

²⁶⁷ Po aty, f. 33.

depërtuar në masë të madhe.²⁶⁸ Për çdo vit në shtypin ditor në Kosovë hyjnë mesatarisht rreth gjashtëdhjetë anglicizma.²⁶⁹ Interneti mund të ndihmojë edhe për ruajtjen e varieteteve të rrezikuara të shqipes, siç janë arvanitishtja dhe arbërishtja.

Përkthimi dhe përshtatja nga anglishtja në shqip është njëra nga rrugët e ndikimit të anglishtes në shqipen. Ndër anglicizmat më të përdorshëm janë: *bord, grant, inkorporim, menaxhim, subvencion, tender, transparencë, instruksion, auditor, aset, alokim, donacion* etj.

Duhet pasur një politikë të qartë gjuhësore lidhur me mbrojtjen e shqipes nga ndikimi i gjuhëve të huaja, sidomos nga ndikimi që vjen nëpërmjet procesit të komunikimit global. Është e pamundur t'u iket krejtësisht ndikimeve të huaja gjuhësore që vijnë nga gjuhët superiore, sidomos nga anglishtja si gjuhë globale, por mund të merren masa që këto ndikime të jenë të kufizuara, të mos depërtojnë në strukturën e shqipes dhe në njëfarë mënyre të jenë të kontrolluara nëpërmjet mekanizmave të tillë sociolinguistikë, siç janë politika dhe planifikimi gjuhësor.²⁷⁰

Identiteti etnik të shqiptarët është i lidhur ngushtë me gjuhën shqipe. Gjuha shqipe ka shërbyer si strumbullar për krijimin e identitetit etnik dhe kombëtar të shqiptarët dhe ka qenë tipari kryesor unifikues përbrenda grupit dhe tipar diferencues në raport me grupet e tjera etnike. Procesi i konsolidimit të etnisë dhe të kombit shqiptar, i cili ka filluar që nga Rilindja Kombëtare, është ndërlidhur ngushtë me vetëdijen e përkatësisë etnike kombëtare. ***Gjuha shqipe ka qenë, është dhe do të mbetet tipari kryesor i etnisë dhe i kombit shqiptar.***²⁷¹

9.5. KËSHILLI NDËRAKADEMIK PËR GJUHËN SHQIPE

Me nismën e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, në tetor 2004 është themeluar Këshilli Ndërakademik për Gjuhën Shqipe, që funksionon si një forum shkencor kombëtar ndërakademik, i cili bashkërendon dhe orienton përpjekjet institucionale për mbrojtjen, zhvillimin dhe pasurimin e shqipes standarde, si mjet modern i komunikimit e i realizimit të jetës shtetërore, kulturore e shoqërore në hapësirën kombëtare. Këshilli përbëhet nga gjuhëtarë të njohur, specialistë në fushën përkatëse: 7 gjuhëtarë nga Shqipëria, 7 nga Kosova dhe një nga Maqedonia e Veriut. Anëtar i Këshillit nga Maqedonia ishte profesor Remzi Nesimi si dhe autori i këtij libri.

²⁶⁸ Shkumbin Munishi, *Shqipja në epokën e globalizimit*, Prishtinë, 2015, f. 50-56.

²⁶⁹ Shukrane Gërmizaj, *Sfidat dhe rezultatet e kontakteve të shqipes me anglishten*, Studime 20, AShAK, Prishtinë, 2013.

²⁷⁰ Shkumbin Munishi, *Shqipja në epokën e globalizimit*, Prishtinë, 2015, f. 172.

²⁷¹ Shkumbin Munishi, *Po aty*, f. 152-153.

Të dy Akademitë, duke pasur parasysh se gjuha shqipe është tipari kryesor i kombësisë shqiptare, mjeti themelor që siguron ndërlidhjen shpirtërore midis hapësirave e vendeve që flasin shqip përtej ndarjeve administrative-politike, me krijimin e këtij Këshilli synojnë institucionalizimin mbarëkombëtar të kujdesit për shqipen standarde. Ai merret me të gjitha çështjet që dalin në fushën e gjuhës standarde dhe të përdorimit të saj.

Shumica e intelektualëve shqiptarë përkrahin mendimin se duhet bërë përmirësimin e mëtejshëm të rregullave të Drejtshkrimit, duke synuar sidomos mënjanimin e përjashtimeve jo të pakta, që shoqërojnë shpesh rregullat e përgjithshme. E dëshirueshme është që rregullat e Drejtshkrimit të jenë sa më të thjeshta, sa më përgjithësuese e sa më të lehta në përdorim, që nuk kërkojnë shumë mund e energji në përvetësim.

Që nga themelimi e deri më tani Këshilli ka mbajtur disa takime pune, në Tiranë e në Prishtinë dhe deri më tani ka sjellë jo pak propozime për përmirësimin dhe ndryshimin e disa rregullave të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe, si: për drejtshkrimin e disa zanoreve e bashkëtingëlloreve, shumësin e disa emrave, përdorimin e shkronjave të mëdha, për drejtshkrimin e antroponimeve të huaja etj. Këto propozime për ndryshimin e rregullave ekzistuese janë bërë publike. Ato mund t'i shkarkoni nga interneti dhe t'i lexoni.

Shqipja standarde është varietet mbirajonal, e mirë e përbashkët që çdo folës i gjuhës shqipe duhet të synojë ta përvetësojë, mjet i domosdoshëm për jetën e qytetëruar në shoqëri demokratike. Zotërimi i saj duhet të jetë objektiv themelor i mësimdhënies dhe synim kryesor i politikës së integrimeve.

Për të qenë të sigurt për zhvillimin e mëtejshëm dhe rolin e saj në jetën dhe kulturën kombëtare në këtë kohë procesesh shoqërore dinamike, politika e përgjithshme ndaj gjuhës shqipe duhet të marrë parasysh të gjitha aspektet e jetës së saj: rolin afrues shoqëror e kombëtar, përshtatshmërinë optimale për çdo hapësirë shoqërore, pasurimin me krijime të reja, hapjen e saj ndaj varieteteve të ndryshme, zhvillimin në kuadër të teknologjive të reja, si dhe raportet ndaj gjuhëve të tjera.

9.6. SHOQATA E GJUHËSISË SHQIPTARE

Me nismën e një grupi gjuhëtarësh dhe me mbështetjen e gjerë të studiuesve dhe pedagogëve të shkencave gjuhësore në shkollat e larta dhe institucione të tjera në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni, në Malin e Zi dhe në vende të tjera më vitin 2014 u krijua Shoqata e Gjuhësisë Shqiptare (ShGjSh).

Si forum shkencor i një anëtarësie të gjerë të studiuesve në fushën e gjuhësisë në përgjithësi dhe të gjuhës shqipe në veçanti Shoqata synon të luajë rol aktiv integrues dhe zhvillues në gjuhësinë shqiptare në tërësi dhe sidomos

në çështjet e shqipes standarde, në hartimin, diskutimin e në miratimin e veprave kodifikuese.

Shoqata synon:

- të bashkojë dhe të organizojë më mirë forcat shkencore të gjuhësisë shqiptare mbi bazën e parimit të respektimit të lirisë akademike dhe të individualitetit krijues;
- të ndihmojë për zhvillimin e qëndrueshëm të gjuhës shqipe, për mbrojtjen e gjuhës standarde shqipe dhe përhapjen e saj në shtresa të gjera të shoqërisë shqiptare;
- të veprojë dhe të ndikojë për ngritjen e kulturës gjuhësore të shoqërisë shqiptare nëpërmjet një veprimtarie të vijueshme e sistematike të Shoqatës dhe të anëtarëve të saj;
- të ndihmojë institucionet shtetërore dhe joshtetërore me këshillime të rregullta gjuhësore;
- të ndihmojë për ngritjen e kualifikimit shkencor të anëtarëve të shoqatës dhe përparimin e tyre në hierarkinë shkencore, veçanërisht të të rinjve, nëpërmjet veprimtarive të posaçme të shoqatës;
- të ndër marrë projekte studimore mbarëkombëtare veçanërisht në fushën e gjuhës së sotme shqipe;
- të organizojë diskutime, për të shkëmbyer përvojë dhe për të përmirësuar ndjeshëm gjendjen e sotme të mësimin të gjuhës shqipe në shkollat e të gjitha niveleve;
- të vendosë lidhje me shoqata analoge në botën e jashtme për të fituar një njohje më të plotë të arritjeve dhe drejtimeve të reja të gjuhësisë së sotme dhe për të sjellë përvoja të reja në gjuhësinë tonë.²⁷²

Për arritjen e këtyre synimeve, Shoqata organizon veprimtari shkencore të vijueshme dhe ka shtypin e saj shkencor. Kryetar i Shoqatës është profesor Emil Lafe, nënkryetarë: profesorët Rami Memushaj (Shqipëri), Qemal Murati (Kosovë), Ismet Osmani (Maqedoni).²⁷³

9.7. GJUHA SHQIPE DHE KOMPJUTERI

Projekti kombëtar pesëvjeçar “Gjuha shqipe dhe kompjuteri”

Qendra për Edukim dhe Përparim (QEP), nisur nga përvoja paraprake dhe në mbështetje të synimit themelor “**Një komb, një gjuhë, një standard**”, ka vendosur të formojë Këshillin Kombëtar Shkencor për projektin “Gjuha shqipe dhe kompjuteri”. Ky projekt në 5 vitet e ardhshme pritet që do të përmirësojë ndjeshëm përdorimin e gjuhës në arsim, në shtyp e në botime në administratë dhe përgjithësisht, por edhe do të pasurojë e do të përmirësojë dukshëm kulturën gjuhësore të folësve të shqipes. Ky është projekti më i gjerë

²⁷² <https://linguaalbanica.wordpress.com/>, shkarkuar më 20. 80. 2020

²⁷³ Adresa elektronike e shoqatës është: [linguaalbanica <shoqata14@gmail.com>](mailto:linguaalbanica@shoqata14@gmail.com)

dhe më serioz i ndërmarrë ndonjëherë për gjuhësinë kompjuterike, përkatësisht për digjitalizimin dhe teknologjitë gjuhësore në gjuhën shqipe.

Synimi i këtij projekti, përveç të tjerash, është edhe bashkimi i të gjithë shqiptarëve pa dallime rajonale, politike apo fetare rreth pasurisë kombëtare të përbashkët më të çmuar – gjuhës shqipe.

Duke pasur parasysh se gjuha shqipe është tipari kryesor i identitetit shqiptar, mjeti themelor që siguron ndërlidhjen shpirtërore midis shqiptarëve kudo që janë, me krijimin e këtij Këshilli, QEP-i synon rritjen e cilësisë së zbatimit në praktikë të shqipes standarde e njëkohësisht të kujdesit të vijueshëm për të. Këshilli do të ketë fillimisht 9 anëtarë: 4 anëtarë nga Kosova, 4 anëtarë nga Shqipëria dhe 1 anëtar nga Maqedonia e Veriut.

Në bashkëpunim me kompani ndërkombëtare dhe me kompani vendore në Kosovë dhe në Shqipëri e më gjerë, në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës, ky projekt në 5 vitet e ardhshme pritet jo vetëm që ta përmirësojë ndjeshëm përdorimin e gjuhës shqipe në arsim, në shtyp e në botime, në administratë dhe në të gjitha veprimtaritë, por edhe do të pasurojë e do të ngrejë dukshëm kulturën gjuhësore të folësve të shqipes. Qeveria e Kosovës ka vendosur që të mbulojë shpenzimet e licencave për përdorim të shumicës së këtyre softuerëve për të gjithë banorët e Kosovës, duke përcaktuar shumë kriteret teknike dhe gjuhësore për këta softuerë.

Presim nga të gjithë ata që kanë synim përparimin e gjuhës shqipe, si shenjën më të qartë të identitetit kombëtar, të ndihmojnë realizimin e këtij projekti të rëndësishëm në fushën e digjitalizimit të pasurisë sonë gjuhësore, si: institucionet akademike dhe universitare shqiptare, shtëpitë botuese, mediet e shkruar dhe elektronike, shkrimtarët, intelektualët, politikanët, njerëzit e kulturës, të artit e të jetës shoqërore në Kosovë, në Shqipëri dhe në Maqedoninë e Veriut.

Softuerët që do të ofrohen nga viti 2020 deri më vitin 2025

Nga viti 2020 deri më vitin 2025 planifikohet nëpërmjet këtij projekti të ofrohen këta softuerë: Sinonimet në MS Office, Drejtshkrimori i fjalëve, Korrigjuesi sintaksor /morfologjik, Korpusi i gjuhës shqipe, Fjalorët shpjegues, “Testo shqipen tënde!”, “Fillestarja digjitale”, Tastiera shqipe, E folura në tekst (Speech to text), Teksti në të folur (Text to speech), “Si të mësosh shqip?”, “Kulla e shqipes”, Libri i madh.

Si partnerë të Microsoft-it, QEP-i tashmë i ka zhvilluar këta softuerë dhe shumë prej tyre fatmirësisht janë pjesë e paketës MS Office. Kjo paketë është më e përdorura ndër shqiptarët, sidomos MS Word-i. Andaj ka qenë dhe është e domosdoshme që, edhe QEP-i, punën për shumë projekte të tjera ta orientojë drejt kësaj platforme dhe këtij bashkëpunimi.

Pas 20 vjetësh përvoje në programim, në punën e QEP-it, në projektin e madh për gjuhën shqipe, planifikohet që brenda tre vjetësh t'i thuhet lamtumirë programimit të rregullt dhe t'i thuhet mirë se

vjen programimit përmes Inteligjencës Artificiale. Java, Python, Lisp, Prolog dhe C++ synojnë të bëhen gjuhët tona kryesore për “Artificial Intelligence Programming”. Dëshira jonë ka qenë dhe është që gjuha shqipe ashtu si gjuhët e tjera, të përparojë e të ecë në hap me to, thonë nga Qendra për Edukim dhe Përparim.²⁷⁴

9.8. STATUSI I SHQIPES NË MAQEDONINË E VERIUT

Përpyekja e fundit për avancimin e përdorimit të gjuhës shqipe është bërë më 11 janar 2018, kur Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e miratoi Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve. Ndonëse ky ligj nuk e ka barazuar shqipen me maqedonishten (ka bërë emërtimin në kllapa “gjuha shqipe”, ndërsa në tekst akoma mbetet “gjuha të cilën e flasin 20% e qytetarëve”), ai e ka zgjeruar përdorimin e saj zyrtar në organe të pushtetit presidencial, ekzekutiv, legjislativ, gjyqësor, lokal, si edhe në ushtri, në polici dhe në monedha, por edhe në veprimtari të tjera (i mbikëqyrur për herë të parë nga institucionet për mbrojtjen e gjuhës). Por, edhe në këtë ligj mbetet formulimi “*krahas gjuhës maqedonase*”, që nënkupton se shqipja nuk mund të përdoret më vete, pa maqedonishten.

Ligji i miratuar parasheh përdorimin e gjuhës shqipe në të gjitha organet e pushtetit qendror, si në të shkruar, ashtu edhe në të folur, në Kuvend, përfshirë edhe kryesuesin e seancave nëse është shqiptar, në Qeveri, ndërmarrjet publike, agjencitë, drejtoritë, komisionet. Gjuha shqipe do të përdoret edhe në të gjitha mbishkrimet e institucioneve të nivelit qendror, krahas atyre në pushtetin lokal ku gjithashtu gjuha shqipe është zyrtare në komunat ku shqiptarët përbëjnë mbi 20 për qind të numrit të përgjithshëm të popullatës. Përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe është formuluar si “gjuhë të cilën e flasin mbi 20 për qind nga numri i përgjithshëm i popullatës në Maqedoni.”

Ajo që ka ardhur si risi me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve është themelimi i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut (vijon paradoksi që të mos emërtohet Agjencia e Zbatimit të Gjuhës Shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut), si dhe themelimi i Inspektoratit për Përdorimin e Gjuhëve. Roli i agjencisë është ta ndihmojë përdorimin zyrtar të shqipes në bazë të këtij ligji, ndërsa Inspektoratit do t’i duhet të kujdeset për (mos)respektimin e ligjit.²⁷⁵

Maqedonia e Veriut – si kandidatë për anëtarësim në Bashkimin Evropian – nga modeli me një gjuhë shtetërore, do të duhet të kalojë në modelin me dy gjuhë shtetërore. Shembull i mirë është Kosova, ku gjuha shqipe

²⁷⁴ <https://www.rtklive.com/sq/news-single.php?ID=410659>, shkarkuar më 04. 08. 2020.

²⁷⁵ Zeqirija Ibrahim, *Planifikimi gjuhësor në Maqedoninë e Veriut*, Doracak i nëpunësve administrativë lidhur me zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, Shkup, 2020, f. 12-18.

dhe gjuha serbe janë gjuhë zyrtare në nivel nacional, ndërsa gjuhët e minoriteteve janë zyrtare në nivel lokal. (T'ju kujtojmë se serbët në Kosovë, sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011, janë vetëm 1.5 %.) Një model tjetër i mirë është edhe Finlanda, ku suedishtja, edhe pse është gjuhë që e flasin vetëm 5 % e popullatës, gëzon statusin e gjuhës nacionale zyrtare të Finlandës (atje jetojnë 93.4 % finlandezë dhe pak më shumë se 5.6 % suedezë). Natyrisht, që të arrihet kjo, kërkohet më shumë mirëbesim dhe më shumë kohezion shoqëror.

Nisur nga kjo, sipas nesh – thotë Ibrahim, që të zgjidhet ky ngërç, Maqedonia e Veriut do të duhet të bëjë ndërhyrje në kushtetutë, për ta korigjuar statusin e shqiptarëve në të e pastaj të hartojë një politikë tjetër të gjuhëve ose një planifikim tjetër gjuhësor, duke krijuar një institucionalizim gjuhësor, me miratimin e një ligji të vetëm për përdorimin e gjuhëve, ku do të përcaktohej përdorimi i gjuhës së kombit shumicë (maqedonishtes), i gjuhës së kombit të dytë shumicë (shqipes) dhe i gjuhëve të minoriteteve (turqishtes, serbishtes, vllahishtes, boshnjakishtes, gjuhës rome). Kjo do të zgjidhte një problem të gjatë, do ta shtensiononte shtetin, do të krijonte më shumë mirëbesim mes qytetarëve dhe ndaj institucioneve, si dhe do të mundësonte integrimin dhe përfshirjen e shqiptarëve në kuadër të shtetit.²⁷⁶

9.9. AGJENCIA E ZBATIMIT TË GJUHËS

Gjatë viteve që kemi lënë pas, institucionet e larta shtetërore janë angazhuar në mënyrë të vazhdueshme për të krijuar bazën e nevojshme ligjore lidhur me përdorimin zyrtar të gjuhëve, si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal.

Siç dihet, Republika e Maqedonisë së Veriut tanimë ka një legjislacion më të avancuar, i cili rregullon më qartë përdorimin e gjuhëve në institucione. Dhe sado që është kompletuar kjo infrastrukturë ligjore për përdorimin e gjuhëve, prapëseprapë, gjatë zbatimit praktik shfaqen vështirësi dhe sfida të ndryshme.

AZGj-ja kujdeset për zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në tërësi siç është e paraparë në kompetencat e saj në ligj. Merr masat e nevojshme për të siguruar përputhshmërinë, bën rekomandime për sa i përket konsistencës së secilit akt administrativ dhe ofron këshilla ligjore për qytetarët si dhe për institucionet lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tyre që burojnë nga Ligji mbi Përdorimin e Gjuhëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 7/19).

Kompetencat e AZGj:

²⁷⁶ Zeqirija Ibrahim, *Planifikimi gjuhësor në Maqedoninë e Veriut*, Doracak i nëpunësve administrativë lidhur me zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, Shkup, 2020, f. 12-18.

- mbështet institucionet në realizimin e obligimeve që burojnë nga Ligji i Përdorimit të Gjuhëve, duke përfshirë përkthimin dhe lekturimin e dokumenteve;
- lekturon të gjitha aktet që botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- promovon dhe merr masa për avancimin e përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- harton raporte për informimin e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut për zbatimin e kompetencave të saj;
- përgatit materiale analitike-profesionale në kompetencat e saj për nevojat e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- jep mendime profesionale për materialet që janë në funksion të zbatimit dhe avancimit të përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- kryen punë të tjera lidhur me zbatimin e qëllimeve të përcaktuara në këtë ligj.

Inspektorati për Përdorimin e Gjuhëve

Inspektorati për Përdorimin e Gjuhëve kryesisht angazhohet për të gjitha çështjet të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve si dhe të dispozitave kushtetuese nga kjo sferë, punët inspektuese lidhur me zbatimin e përcaktimeve përkatëse nga të gjitha institucionet kompetente. Veprimtaria e Inspektoratit rregullohet me ligj të veçantë, i cili përcakton organizimin, kompetencat dhe realizimin e procedurës së mbikëqyrjes dhe të inspektimit. Në vazhdimësi mbetet sfidë organizimi, konsolidimi i tij me kuadro profesionale, që të mund të realizojë obligimet ligjore.²⁷⁷

Nevoja e miratimit të ligjit për gjuhën edhe në Shqipëri e në Kosovë

Shumë gjuhëtarë janë të mendimit se për mbrojtjen, kujdesin dhe përdorimin e drejtë të shqipes standarde edhe në Shqipëri e Kosovë duhet pasur një politikë shtetërore për gjuhën, përkatësisht duhet sjellë një ligj për mbrojtjen e shqipes. Lidhur me këtë, prof. Rami Memushaj thotë se: “Për shpëtimin e shqipes nga lëngata që e ka zënë dhe për ruajtjen e njësisë së saj në të gjitha shtetet e trevat ku flitet, mendojmë se duhen marrë një varg masash urgjente, ndër të cilat miratimi i *ligjit për gjuhën*, që do të vendoste disiplinën gjuhësore të munguar, është një domosdoshmëri. Se si mund të ndikojë ky ligj në përmirësimin e situatës sonë gjuhësore, mjafton të shohim Maqedoninë Veriore, ku, pas miratimit të ligjit për gjuhën shqipe, është themeluar Agjencia për Zbatimin e Gjuhës, e cila, me ndihmën e gjuhëtarëve shqiptarë të tri shteteve, nisi menjëherë punën për shqyrtimin e normësisë së emërtimeve shqip të institucioneve qendrore e vendore të atij shteti. Programi i kësaj Agjencie të bën optimist se edhe për shqipen në Maqedoninë e Veriut shumë

²⁷⁷ Agjencia e zbatimit të gjuhës, *Doracak për nëpunësit administrativë për zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve*, Shkup, 2020, f. 8.

shpejt do të vihen në zbatim sanksionet e parashikuara nga ligji për maqedonishten, gjë që do të krijojë premisa për një rritje të shpejtë të kulturës gjuhësore të bashkësisë shqiptare të atjeshme”.²⁷⁸

²⁷⁸ Rami Memushaj, *Jo profesorë kinezë për drejtshkrimin, po politika shtetërore për gjuhën*, Gazeta shqiptare, 20. 11. 2019. Kulturë, <http://www.gsh.al/2019/11/20/jo-profesore-kineze-per-drejtshkrimin-po-politika-shteterore-per-gjuhen/>, shkarkuar më 07. 08. 2020.

KREU X

10. DREJTSHQIPTIM DHE DREJTSHKRIM

10.1. TIPARE FONETIKE, MORFOLOGJIKE E LEKSIKORE TË GEGËRISHTES NË SHQIPEN STANDARDE

Shqipja standarde ka për bazë variantin letrar toskë. Nga pikëpamja e burimit, shqipja standarde ka si bazë variantin letrar toskë. Por, sistemi i gjuhës standarde paraqitet si një sistem mbidialektor, më i gjerë nga baza e tij dialektore. Ai është shumë më i pasur në elemente dhe funksionet e tij nuk mund të krahasohen me funksionet e asnjërit prej dialekteve kryesore të shqipes.

Krahas elementeve të përbashkëta të të dy dialekteve dhe elementeve të veçanta të secilit dialekt, gjuha standarde ka edhe elemente që i ka krijuar vetë, që e bëjnë këtë sistem shumë më të pasur nga cilido prej dialekteve të shqipes.

Duke mos qenë sistem i ngrirë dhe i mbyllur, ajo vijon të pasurohet dita-ditës, nga njëra anë, me njësi e gjedhe të reja që i krijon me mjetet e veta, dhe, nga ana tjetër, me elemente që hyjnë në të drejtpërdrejt nga të folmet e shqipes si dhe nga gjuhët e huaja. Grafikisht, elementet përbërëse të sistemit të gjuhës standarde mund të paraqiten si më poshtë:²⁷⁹




Fig. 51. Baza dialektore e shqipes standarde

²⁷⁹ Rami Memushaj, *Fonetika e shqipes standarde*, Toena, Tiranë, 2009, f. 12-13.

Sistemi fonetik e morfologjik i gjuhës standarde ka në bazën e vet sistemin fonetik e morfologjik të toskërishtes verilindore, d.m.th. të nëndialektit toskë që flitet mes Vjosës dhe Shkumbinit.

Është e vërtetë se sistemi tingullor, morfologjik e leksikor i gjuhës standarde mbështetet në shqiptimin, morfologjinë dhe fjalësin jugor; por kjo bazë mbështetëse është zgjeruar edhe me pak tipare fonetike e morfologjike veriore. Leksiku i shqipes standarde është pasuruar me shumë fjalë të gegërishtes, duke plotësuar e pasuruar leksikun letrar, krijuar sinonimi leksikore, fjalëkrijime të reja etj.

Për të shtjelluar këtë temë, në vazhdim do të japim tiparet e dallueshme fonetike-fonologjike e morfologjike të gegërishtes që janë pranuar për normative në shqipen standarde.²⁸⁰

Tipare fonetike-fonologjike të gegërishtes në shqipen standarde

1. Përveç grupit [ua] të toskërishtes, shqipja standarde ka edhe fjalë me togun zanor [ue], të gegërishtes: mësues-e, botues-e, dëgjues-e, edukues-e, gatues-e, ndërtues-e, parashikues-e, pastrues-e, përpunues-e; i afrueshëm, i dëgjueshëm, i gëzueshëm, i paharrueshëm, i papërtueshëm, i pazëvendësueshëm, i shoqërueshëm, i vazhdueshëm. Fondi leksikor i shqipes standarde përveç me fjalë që kanë prapashtesën toske *-uar*, është pasuruar edhe me fjalë që kanë prapashtesën gege **-ueshëm**, që kanë kuptim tjetër ose për të krijuar sinonime, sipas tipit: (kam) *kuptuar* (pjesore) – *kuptueshëm* (ndajfolje); *i kuptuar* – *i kuptueshëm* (mbiemra); *i thyer* (ka kuptimin që sendi është i thyer) – *i thyeshëm* (diçka që mund të thyhet lehtë, por nuk është thyer).

Shpjegim: Dy dialektet e gjuhës shqipe dallohen edhe për togjet e zanoreve, sepse gegërishtja përdor togun zanor *ue*, ndërsa toskërishtja togun *ua*. Togun *ue* shpeshherë e dëgjojmë të monoftonguar në *u*: të gjatë. P.sh. (fjalë të njëjta në gegërishte - toskërishte): *grue, gru*: - *grua*; *mue, mu*: - *mua*; *thue, thu*: - *thua*; *ftue, ftu*: - *ftua*; *due, du*: - *dua*; *u gzue, u gzu*: - *u gëzua*; *shkruej, shkruj* - *shkruaj*; (kam) *shkue, shku*: - (kam) *shkuar, (jam) msue, msu*: - (jam) *mësuar*; *me lexue, me lexu*: - *për të lexuar* etj. (Shih hartat 100, 101, 102, 103, 104, 105, 106, 107, 108, 109, 110, 111, 112 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007). Përgjithësisht, në çiftet e fjalëve të njëjta me grupin *ua* dhe *ue*, në shqipen standarde normative janë format e fjalëve me *ua* (shih shembujt e mësipërm). Togu zanor *ue* i gegërishtes ka hyrë edhe në gjuhën letrare nëpërmjet fjalëve të veçanta, si *mësues, sulmues, e punueshme, i qëndrueshëm, e pabesueshme, e këshillueshme, e parashikueshme* etj.

2. Ka fjalë gege me [-n] ndërzanore

Shpjegim: Në fushën e fonetikës rotacizmi përbën një nga dallimet themelore ndërmjet dy dialekteve të shqipes: /n/-ja midis dy zanoresh ruhet në

²⁸⁰ Asllan Hamiti - Ajten Qamili, *Dialektologjia e gjuhës shqipe*, Shkup, 2014, f. 103-191.

gegërishte, ndërsa kjo është shndërruar në /r/ në toskërishte. Në çiftet e fjalëve të njëjta me variante fonetike, në shqipen standarde parapëlqehen format e rotacizuara, si: *venë - verë, peni - peri, druni - druri, freni - freri, syni - syri, zani - zëri, vuna - vura, zuna - zura, bana - bëra, emën(ë) - emër(ë), dimën(ë) - dimër(ë); lakën(ë) - lakër(ë), pjepën(ë) - pjepër(ë); ranë - rërë, kunorë - kurorë, femën(ë) - femër(ë), lini - liri* etj.

Por, kjo dukuri nuk sjell as dallime në organizimin e fonemave, as dallime kuptimore. Si rrjedhim, ai është një dallim sasior e jo cilësor, d.m.th. lidhet vetëm me përndarjen e fonemave /r/ dhe /n/, ose me dendurinë e përdorimit të njërës e të tjetrës fonemë, pa ndonjë kushtëzim fonetik. Këto fonema përdoren që të dyja në të dy dialektet, veçse si pasojë e rotacizmit të dikurshëm, në Jug ka denduri më të madhe /r/-ja, kurse në Veri ka denduri më të madhe /n/-ja.

Duke qenë se rotacizmi nuk prek sistemin e fonemave, kjo e ka lënë rrugën të hapur që gjuha standarde të marrë edhe fjalë të tjera që nuk i ka, me /n/ nga gegërishtja për pasurimin e fjalorit të vet, p.sh. *zanë-zana, zanore, zanafillë, vranësi, (i, e) vranët, krenar, kryeneç, grunore, ranishte, drenushë, rrypinë, barnatore, emnak, kodrinë, rini* etj.

3. Mosshurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në fundin absolut të fjalës, si në fjalët *vend, kuvend, zog, breg, i madh*.

Shpjegim: Dihet se të folmet e toskërishtes bëjnë shurdhimin e bashkëtingëlloreve të zëshme në fundin absolut të fjalës, ndërsa të folmet e gegërishtes i shqiptojnë të zëshme. Ky mosshurdhim është marrë edhe si normë drejtshqiptimore e drejtshkrimore në shqipen standarde. Pra, kur bashkëtingëlloret e zëshme [b, v, d, z, x, xh, zh, dh, gj, g] ndodhen në pozitë fundore absolute, ato këmbehen me përgjegjëset e tyre të shurdhëta [p, f, t, s, c, ç, sh, th, q, k] në të folmet jugore: *elp 'elb', qelp 'qelb', dif 'div', urof 'urov', funt 'fund', njerës 'njerëz', heth 'hedh', u loth 'u lodh', u doq 'u dogj', brek 'breg'* etj., ndërsa në të folmet veriore e ruajnë zëshmërinë (Shih hartat 44, 45 e Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

Shikuar në aspektin fonologjik, me dukurinë fonetike të shurdhimit asnjëherë kundërvënia e zëshmërisë së fonemave, sepse bashkëtingëlloret e shurdhëta janë variante pozicionale të fonemave të zëshme. Kur të zëshmet nuk gjenden në pozitë fundore, ato e ruajnë zëshmërinë, si *zok - zogu, brek - bregu, vënt - vëndi, u doq - u dogja* etj.

4. Ruajtja e kundërvënies fonologjike /r ~ rr/, si: *ara ~ arra, ruaj ~ rruaj, rasë ~ rrasë, deri ~ derri, rimë ~ rrimë* etj. Në toskërishten si dhe në shumë të folme të gegërishtes jugore, vihet re zbutja e /rr/-së në /r/, përkatësisht humbja, më saktësisht asnjësimi i opozicionit fonologjik /r/ ~ /rr/.

Shpjegim: Në shqipen standarde dhe në të folmet e gegërishtes dallohen dy fonema bashkëtingëllore që i kundërvihen njëra-tjetrës në gjatësi me vlerë

fonologjike (kuptimdalluese): /r/ ~ /rr/. Kjo më së miri mund të shihet në çifte minimale fjalësh, si: *ara* ~ *arra*, *ruaj* ~ *rruaj*, *var* ~ *varr* etj. (Shih hartën 22 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

Karakteri fonologjik i çiftit të bashkëtingëlloreve njëdridhëse /r/ dhe shumëdridhëse /rr/ ruhet mirë në gegërishten, ndërsa në toskërishten është bërë rrafshimi i kësaj gjatësie, duke u shndërruar /rr/-ja në /r/.

5. Ruatja e [h]-së në të gjitha pozitat e fjalës: në fillim, në mes e në fund të fjalës. Siç dihet, [h]-ja, në shqipen përgjithësisht shqiptohet me një rrymë mjaft të dobët ajri. Në të folmet e toskërishtes (si edhe në disa të folme të gegërishtes qendrore) [h]-ja, dëgjohej mjaft dobët ose vende-vende nuk dëgjohej fare. P.sh. *hëna*, *ëna* < hëna; *lahem*, *laem* < lahem; *hundë*, *undë* < hundë; *hak*, *ak* < hak; *hambar*, *ambar* < hambar etj. Dukuria e mosshqiptimit të [h]-së pasqyrohet edhe në disa emra vetjakë të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, si *Alit* < Halit, *Alim* < Halim, *Isen* < Hysen, *Muarem* < Muharrem, *Bejtulla* < Bejtullah etj.²⁸¹

Shpjegim: Në të folmet e dialektit Verior [h]-ja dëgjohej mirë, ndërsa në ato të Jugut shqiptohet si më e dobët ose nuk dëgjohej fare. Bashkëtingëllorja glotale, shtegore, e shurdhët [h] dëgjohej mirë në të folmet e gegërishtes (përveç në pak të folme të gegërishtes jugore), ndërsa në të folmet e toskërishtes shqiptohet me frymëtim (aspirim) më të dobët shkallësh të ndryshme ose nuk dëgjohej fare, me gjithë kufizimet në përndarjen e saj (diku nuk shqiptohet në asnjë pozitë të fjalës, diku nuk shqiptohet në fund e diku në mes të fjalës). P.sh: *ëna* 'hëna', *a* 'ha'; *undë* 'hundë', *laet* 'lahet', *gju* 'gjuha', *i fto* 'i ftohtë'; *kra* 'krah', *pleh* 'ple', *sho* 'shoh', *njo* 'njoh' etj. (Shih hartat 21, 114, 115, 116, 117 122, 123 të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007).

Tipare dialektore morfologjike të përbashkëta e të veçanta në shqipen standarde

Shqipja është gjuhë flektive (me lakim e zgjedhim), fjalët e saj kanë trajta të ndryshme. Vendosja e normës sjell disa variante të quhen krahinore ose të vjetëruara. Por edhe brenda fushës së normës ka variante, ka sinonime gramatikore, disa kategori përdoren në vend të njëra-tjetrës, lindin shmangie të tjera, madje edhe bëhen me qëllim.

Në përgjithësi të dy dialektet e shqipes kanë shumë veçori të përbashkëta morfologjike të të gjitha pjesët e ligjëratës (emri, mbiemri, përemri, folja, numërori, ndajfolja, lidhëza, parafjala, pjesëza, pasthirrma). Pjesët e ndryshueshme kanë po të njëjtat kategori gramatikore dhe lakohen e zgjedhohen me të njëjtat mbarese e prapashtesa trajtëformuese e

²⁸¹ Tek emrat vetjakë të shënuar, përveç rënies së /h/-së, vërehen edhe disa dukuri të tjera fonetike, si zhbuzorëzimi i /y/-së në /i/ dhe këmbimi i /rr/-së në /r/. Në zhvillimet e tilla fonetike ka ndikuar edhe maqedonishtja e folur dhe administrata njëgjuhëshe, vetëm maqedonisht deri pak vitesh në Maqedoninë e Veriut.

formëformuese (me pak dallime morfemore e varietete fonetike), ashtu siç janë të përbashkëta edhe shumica e pjesëve të pandryshueshme.

Edhe në çështjen e ndërrimeve morfonologjike shqipja na del mjaft e njësuar (unike), meqë po të njëjtat këmbime kanë shtrirje të përgjithshme territoriale. Dukuri më të përhapura në të dy dialektet janë qiellzorëzimi, metafoia, apofonia si dhe disa ndërrime të tjera zanoresh e bashkëtingëlloresh.

6. Tipar i dallueshëm morfologjik i gegërishtes në shqipen standarde është prania e përemrave vetvetorë: *vetja, vetvetja; i vet, e vet* që i mungojnë toskërishtes.

Shpjegim: Të folmet e gegërishtes kanë përemra vetvetorë, që tregojnë vetën që kryen veprimin dhe ky veprim bie mbi të. Të tillë janë *vetja, vetvetja*; të cilët lakohen nëpër rasi (vetja, vetes, veten; vetvetja, vetvetes, vetveten). Gjithashtu, gegërishtja ka edhe përemra pronorë vetvetorë: *i vet, e vet, t'vet*, si p.sh. *djali i vet, çika e vet, fmit e vet, fmise t'vet* etj., të cilët nuk i ka toskërishtja, por në vend të tyre përdor përemra pronorë: *i tij, e tij; i saj, e saj, të tij, të saj* etj. Përemrat vetvetorë dhe përemrat pronorë vetvetorë, që i ka gegërishtja, ndërsa mungojnë në toskërishte, kanë hyrë në sistemin përemëror të gjuhës standarde shqipe.

Në përemrat vetorë nuk ka ndonjë dallim të rëndësishëm, sepse në të shumtën e rasteve dallimet janë të natyrës fonetike. Kështu, në dialektin Verior dhe në atë Jugor kemi këto forma të përemrave vetorë në rasën emërore: *üne, ũ:n* ose *ũ: - unë* (forma e vjetër *u*: përdoret ende në të folmet e gegërishtes dhe në Çamërishte); *ti, tãi - ti, tinë; aj - ai, ay, aynë; ajo - ajo; na - ne, neve; ju - ju, juve; ata - ata, ato - ato*.

Leksiku dialektor i shqipes standarde

Siç dihet, shqipja ka mbi 2500 fjalë të trashëguara nga fondi i lashtë indoevropian. Të kësaj lëndeje të lashtë indoevropiane janë ato elemente, të cilat kanë analogji në gjuhët e tjera i.e. P.sh.: numërorët prej 11-19 me sistem mbledhjeje, emrat *ujk, natë, dimër, dhëndër, bir, bijë, vjehërr, motër, ballë, gji, gju, i gjatë, i madh, i lig*; përemrat *ti, mua, imi, ky, kjo*; foljet *bie, jam, rri, shoh, bredh, hedh, mbjell, djeg, mbledh, sjell, mjel, dal, marr, bëj, bind, hap, ha, pi, zë, lë, vë* etj.

Leksiku i gjuhës standarde shqipe përmban si elemente nga më të lashtat e shqipes, ashtu edhe elemente nga më të rejat, si fjalë të mbarë shqipes, ashtu edhe fjalë me prejardhje dialektore e me burim të huaj. Shtresën kryesore të leksikut të shqipes së sotme standarde e përbëjnë fjalët e shprehjet ***që i takojnë gjithë truallit gjuhësor të shqipes***, të cilat nuk mund të cilësohen më si të këtij a si të atij dialekti. Kjo shtresë përfshin pjesën kryesore të fjalëve, të shprehjeve e të frazeologjizmave të mbarë shqipes, pa të cilën nuk do të kishim një gjuhë të përbashkët.

Të tilla janë fjalët që emërtojnë sendet që na rrethojnë, cilësitë, veprimet etj., që janë të përbashkëta për dy dialektet, si *dorë, ditë, diell, punoj, shkruaj lexoj, shoh, eci, i mirë, i kuq, vonë, larg, me, për, ngul këmbë, marr vesh, heq dorë...* Në këtë shtresë përfshihen edhe ato fjalë që në dialekte e në të folme të ndryshme dalin në variante fonetike të ndryshme, si *nëna (nāna, nōna), këmba (kām̄ba, kām̄a, kōma), rëra (rāna, rōna), huri (hūni), druri (drūni), ulliri (ullīni), është (āsht, ōsht, ā:, ō:) etj.*, sepse nga ana leksikologjike këtu kemi një fjalë me trajtat përkatëse fonetike.

Duhet theksuar se mënyrat, modelet dhe mjetet kryesore për formimin e fjalëve, nuk kanë qenë dhe nuk janë vetëm pronë e njërit dialekt, por pronë e mbarë shqipes, e të dy dialekteve. Kështu, në cilëndo të folme të Veriut apo të Jugut, rrjedhimisht edhe në shqipen standarde fjalët krijohen gjithkund njësoj. Kështu, në mbarë shqipen dialektore e standarde, pa përjashtim, mënyrat më produktive të formimit të fjalëve janë: a) fjalëformimi me parashtesim, b) me prapashtesim, c) me mënyrën e dyfishtë (të përzier): me paranyjzëzim dhe prapashtesim, ç) me kompozim dhe përngjitje. Prandaj, **qindra e mijëra fjalë** të tilla, si *këpucar, shqiptar, malësor, pleqësi, orizore, lulishte, kufizoj, përparoj, mendjehollë, mendjelehtë, farefis, flokëgjatë, syzezë...*, **nuk mund t'i cilësojmë si të burimit dialektor.**

Gjuha letrare merr prej dialekteve çdo fjalë e shprehje që i duhet për të plotësuar sistemin dhe që i sjell asaj një pasurim të vërtetë. Kështu, janë bërë pronë e gjuhës standarde një varg fjalësh e shprehjesh nga dialekti i Veriut, si *arushë, argëtoj, befas, cucë, diktoj, doke, fatos, bjeshkë, kacafytem, zanë, i zymtë, zeje, pushtoj, burrneshë, pushtoj, akullnajë, kodër pas bregut etj.* Disa fjalë madje ruajnë edhe trajtën fonetike dialektore, si: *amtare, zanore, zanë, shmang, farefisni, besëtytni, rrënojë, dashnor, shtambë, ranishte, bërthamë, krenar, synoj, barnatore, dhanore, mbeturinë etj.*

Edhe në fushën e formimit të fjalëve gjuha standarde shqipe ushqehet nga dialektet. Kështu, për formimin e disa emrave të vepruesit (si: *mësues, sulmues, ndërtnues, përfaqësues, pastrues etj.*), të disa mbiemrave (si: *kërkues, studime krahasuese, shtëpi botuese etj.*), të disa fjalëve të përbëra (si: *hekurudhë, udhëkryq, mbikëqyrës, udhëpërshkrues, hekurpunues, vetëshkarkues etj.*) dhe të mbiemrave me prapashtesën *-shëm* (si: *i kuptueshëm, i lejueshëm, i pranueshëm, i arsyeshëm etj.*) ka shërbyer si temë prodhuese pjesorja e dialektit të Veriut, që mbaron me togun zanor *-ue* (*mësue, sulmue, rregullue, kuptue*), kurse vetë trajta e pjesores së foljeve dhe trajta e mbiemrave (*punuar, shkruar, mbaruar etj.* dhe *i punuar, i shkruar, i mbaruar etj.*) është ajo e dialektit të Jugut. Ja se si dy mjete me prejardhje dialektore janë ngritur në normë dhe janë bërë pronë e gjuhës letrare.

Edhe pse një pjesë e madhe e leksikut të të dy dialekteve është e përbashkët, megjithatë ka fjalë të cilat dallohen se janë pronë e njërit apo tjetrit dialekt. Shumica e tyre në shqipen standarde krijojnë çifte sinonimike fjalësh dialektore. P.sh. toskërisht - gegërisht: *fshat - katund, vajzë - çikë, qumësht - tambël; fqinj, gjiton - kojshi, komshi; nxjerr - qes, ftoj - thirr, derr - thi, kyç - çelës,*

litar - konop, tërkuzë; rrugë - udhë, kokë - krye, kurriz - shpinë, hap - çel, tërë - gjithë, gjalpë - tëlyen, mëmëdhe - atdhe, ngordhë - cofë, dehem - pihem, dyzet - katërdhet, tigan - fultere, fërtere; fshehurazi - tinëz, gënjeshtër - rrenë, kafshë - gjã, hajvan; mbyll - mshel, rrogoz - hasër, këpucë - kundra, shportë - kosh, kopsht - bahqe, patate - kompir, misër - kallamoq, sopatë - sakicë, kotec - koçak, këndez - knus, gjel; gomar - magar; kërric, pulisht - përllak, kec - edh, bushtër - kuçkë, langua - zagar, luleshtrydhe - dredhëz, xhaxha - mixhë, fik (zjarrin) - shkym (zjarrin), çlodhem - pushoj, dem - m(ë)zat, ajër - frymë, eja - hajde, buf - hut; tregoj, rrëfej - kallëzoi, shikoj - kqyr etj.

Në përgjithësi, në çiftet sinonimike të fjalëve dialektore, praktika e përdorimit të fjalësit të shqipes standarde, e hartimit të fjalorëve shpjegues e normativë del se në ligjërimin libror parapëlqehen fjalët e toskërishtes.

Dialektet e shqipes kanë qenë dhe vijojnë të mbeten ende burim i pashtershëm për pasurimin e leksikut të shqipes standarde me fjalë e frazeologji popullore, kuptime e ngjyime fjalësh, mjete shprehëse si dhe për zhvillimin e normës leksikore. Veprimi pasurues i të dy dialekteve mbi leksikun e gjuhës letrare është i barabartë. Pasuria leksikore e frazeologjike e shqipes, vlerësohet si pasuri e përbashkët kombëtare, pavarësisht nga burimi dialektor.

Shqipja standarde merr prej dialekteve çdo fjalë e shprehje që i duhet për të plotësuar sistemin dhe që i sjell asaj një pasurim të vërtetë. Kështu, janë bërë pronë e gjuhës standarde një varg fjalësh e shprehjesh nga dialekti i Veriut, si *arushë, argëtoj, befas, cucë, diktoj, doke, fatos, bjeshkë, kacafytem, zanë, i zymtë, zeje, pushtoj, burrneshë, pushtoj, akullnajë, kodër pas bregut* etj. Disa fjalë madje ruajnë edhe trajtën fonetike dialektore, si: *amtare, zanore, zanë, shmang, farefisni, besëtytni, rrënojë, dashnor, shtambë, ranishte, bërthamë, krenar, synoj, barnatore, dhanore, mbeturinë* etj.

Ka edhe shumë fjalë e shprehje të tjera nga dialektet që mund të hyjnë në leksikun e gjuhës letrare, sepse e pasurojnë atë, zëvendësojnë fjalët e huaja, sjellin nuanca e ngjyime emocionale etj. Mjafton të përmendim këtu pasurimin e gjuhës standarde nga dialekti i Veriut me vargje sinonimesh të tipit: *grunishtë-grunore-grunajë* "arë e mbjellë me grurë", *tamblak* "qengj pirës"; *tamblatore, tamblore, tamëltore* "lopë që jep shumë qumësht"; *tambloriz, tamëloriz* "oriz me qumësht", *lule a bar tampli; drynoj* "mbyll me dry", *shpeshtinë* "pyll i dendur", *shterpni* "të qenit shterp" etj.

Ky planifikim gjuhësor duhet bërë me ndërgjegje të plotë, për arsye se ndërtimet e huaja gramatikore prekin strukturën e gjuhës, por edhe kur fjalët e huaja kanë denduri të madhe përdorimi, ato çrrënjosen më me vështirësi. Pasurimi i shqipes standarde me fjalë, shprehje e frazeologjizma të reja nga të folmet tona jep ndihmesë të madhe për ruajtjen e pastërtisë së shqipes standarde nga ndikimet e huaja, duke përfshirë edhe zëvendësimin e fjalëve të huaja me fjalë të gurrës shqipe. Gjithsesi edhe fjalët e krijuara nga shkrimtarët tanë janë të dobishme për zhvillimin dhe pasurimin e gjuhës standarde shqipe.

Sinonimet dialektore pasurojnë leksikun e shqipes standarde

Fjalët që kanë kuptime të afërta apo të njëjta, por përbërje të ndryshme tingullore janë sinonime (gr. *sin+onoma* - i njëjti emër, emër i ngjashëm). Sinonimet e pasurojnë gjuhën me nuanca kuptimore e me ngjyrimë emocionale, që mundësojnë të shprehemi më bukur e shprehjet të jenë më të fuqishme. Sa më shumë sinonime të ketë gjuha, aq më i pasur është leksiku i saj. Gjuha shqipe është mjaft e pasur me sinonime.

Në ligjërim ka raste kur kuptimisht njëri sinonim mund të zëvendësohet me tjetrin, por ndonjëherë ky ndërrim nuk mund të bëhet, meqë sinonimet dallohen ndërmjet tyre:

a) nga nuanca kuptimore (shikoj - vërej - vështroj, laps - kalem);

b) nga ngjyrimi stilistik emocionale (p.sh. fjala *mësues* ka kuptim asnjans, ndërsa *dhaskal* kuptim përbuzës, keqësues; si edhe *fytyrë - surrat, tregti - pazarllëk* etj.), dhe

c) nga aftësia për të krijuar fjalë të reja (fjalë të përbëra – kompozita) dhe për t'u lidhur me fjalë të tjera në togfjalësha ose në njësi frazeologjike (p.sh. fjalë të tjera formon emri *kokë*, si *kokëderr, kokëkish, kokëkul, kokëmadh, kokëdrejtues, kokë me rëndësi* “i ditur” etj. dhe të tjera fjalë formon emri *krye*: *kryeqytet, kryeministër, kryeinxhinier, kryetar, kryesues, krye e librit, në krye të javës*. Pra, *kokë* dhe *krye* janë sinonime, por nuk e mbulojnë plotësisht njëri-tjetrin në përdorim (sepse nuk mund të thuhet ‘*kokëqytet, kokëministër*’ etj.).

Sinonimet dialektore janë burim shprehësie

Me qëllim që të shprehin nuanca të holla kuptimore dhe të arrijnë efekte stilistike, sidomos shkrimtarët, përdorin edhe sinonime. Sinonimet, vështruar si burim shprehësie, e japin mendimin me një hijezim tjetër kuptimor, për të dalluar anë më të holla ose për ta saktësuar përshkrimin. P.sh. në një lajm të shkurtër në gazetë, për të thënë se cilët ishin në një mbledhje ka disa mënyra sinonimike: (në mbledhje) *ishin, merrnin pjesë, ishin të pranishëm, kishin ardhur, asistonin, ndodheshin, ishin ftuar* etj.

Përdorimi në të njëjtën fjali të dy sinonimeve i jep thënies fuqi shumë të madhe shprehëse, si p.sh.:

Themi: Eqrem Çabej *rroi* për të *jetuar*. Jo: Eqrem Çabej *jetoi* për të *jetuar*.

Ka dallim kuptimor ndërmjet thënieve: *Rrugëtimi* i një atdhetari dhe *Udhëtimi* i një atdhetari.

Fjalët me prejardhje nga dialektet, huazimet, kalket etj., që krijojnë sinonime, gjithashtu shfrytëzohen si mjete shprehëse: *Një gjel, kokosh a këndes / kur u zgjua në mëngjes; pa një dhaskal që shkante. / Mësonjës i mallëkuar ... (Çajupi)*.

Në vargëzimin e shkallëzuar përfshihen edhe sinonime kontekstuale: *Vrajini ata, prejini, bëjini copa-copa* (I. Kadare, “Ura me tri harqe”). *Psherëti, rënkoj, qau, vajtoj ...* (përkthim i Nolit, “Don Kishoti i Mançës”).

Përsëritja e dendur e po asaj fjale pa ndonjë synim ngjall përshtypje të pakëndshme, prandaj kjo shmanget nëpërmjet sinonimisë. Kështu, fjalët e fjalisë: *Karakteristika kryesore që karakterizon karakterin e njeriut...* do të ishte e udhës të zëvendësohen me: *Tipari themelor që dallon karakterin e njeriut*. Në gjuhën e përditshme dhe shkencore zëvendësimet sinonimike janë çështje të kulturës gjuhësore. Këtë e shfrytëzojnë edhe shkrimtarët. Por, përgjithësisht në shkrimet letrare, përdorimi ose mospërdorimi i fjalëve të njëjta shikohet në aspektin stilistik. Për të arritur efektin e menduar, shkrimtarët mund t'i përsërisin fjalët, por mund të përdorin edhe trope. P.sh. pasi është dhënë një herë *harabeli*, rimarrja vetëm me përemrin *ai* është e pamjaftueshme, kështu që autori kalon më tej te: *zogu, shpendi i vogël* dhe më pas: *zemërdridhuri, i ngrati* etj. Tashmë nga sinonimet leksikore kalohet te sinonimia kontekstuale.

Një dukuri e shpeshtë në shqipen është prania e sinonimeve në togje, në çift, të cilat kanë rol përforcues: *shend e verë, një herë e një kohë, çikë e thërrime, u qorroftë e u verboftë, paç ymër e jetë, fuqi e kuvet, halle e derte* etj. Kjo dukuri solli përngjitjen e disa fjalëve ose formime të tjera, si *lakadredhë* (lak e dredhë), *turravrap* (turr e vrap), *rrip kaishi, insan njeri* etj. Edhe tek autorët tanë përdoren dendur çiftet sinonimike, si *vaj e gjamë, i mbaruem e i sosome, kemi folë e ligjruem* (P. Budi); *digjem e përvëlohem, jam i gjallë e jam në jetë; lyer e ngjyer; janë të verbuar e s'shohin; kraharorë e kam shpuar – e kam bërë vrima-vrima* (Naimi).

Nga vargjet sinonimike, autori synon të zgjedhë fjalën më të përshtatshme për të shprehur përkatësinë dialektore, profesionale, shoqërore e kulturore të personazheve.

10.2. BAZA NYJËTIMORE E SHQIPES STANDARDE DHE E FOLËSVE TË SHQIPES

Shqipja standarde për bazë ka toskërishten dialektore e letrare. Por, në të janë përfshirë edhe jo pak elemente të gegërishtes dialektore e letrare, sidomos fjalë e forma fjalësh që nuk i ka toskërishtja, po edhe sinonime leksikore e frazeologjike. Mirëpo, ajo tani me zhvillimin, rritjen, lëvrimin, përsosjen e pasurimin gati 60-vjeçar nga kodifikimi (1972) nuk përputhet as me toskërishten e as me gegërishten, sepse ajo tani është më e pasur, e përpunuar, e intelektualizuar, duke u bërë gjuhë e shkencës, e teknikës, e administratës, e artit, e kulturës. Ajo është e denjë për të përmbushur të gjitha nevojat e jetës bashkëkohore brendashqiptare si dhe e aftë të përballet me gjuhët më të zhvilluara të botës.

Po rikujtojmë se **shqipja standarde ka për bazë nyjëtimore sistemin fonetik të toskërishtes**, d.m.th. të nëndialektit toskë që flitet mes Vjosës dhe Shkumbinit. Por, sistemi fonetik i shqipes standarde është më i gjerë se sistemi fonetik i toskërishtes. Përgjithësisht mund të themi se shprehur nyjëtimore të gegëve janë: shqiptimi i ndërhumshëm i disa zanoreve, shqiptimi i zanoreve të

gjata, theksimi parafundor i disa orientalizmave etj.; ndërsa shprehi të përgjithshme nyjëtimore të toskëve janë: nyjëtimi i zanoreve vetëm si gojore, mungesa e zanoreve të gjata, theksimi fundor i disa orientalizmave etj.

Ashtu siç u tha edhe në kreun e dytë (Fonetika nyjëtimore), shqiptimi i tingujve të gjuhës amtare bëhet sipas shprehive të fituara, ashtu siç dëgjohet në familje, në mjedisin e në territorin ku jeton njeriu, sidomos gjatë periudhës së fëmijërisë.

Kur mësojmë ndonjë gjuhë të huaj, për tingujt që nuk i ka gjuha amtare, nevojitet përkushtim e trajnim për artikulimet e reja. Kjo vlen edhe për përvetësimin e variantit standard të gjuhës amtare, sidomos në mënjanimin e shprehive territoriale nyjëtimore dhe përvetësimin e artikulimit letrar. P.sh. shumica e pjesëtarëve të gegërishtes duhet përpjekur që të bëjnë dallimin shqiptimor të mesgjuhoreve [q], [gj] nga afrikatet [ç], [xh]; mënjanimin e shprehisë së nyjëtimorit të zanoreve hundore, të zanoreve të gjata me vlerë fonologjike, përpjekjen për shqiptimin e zanores [ë] në rrokje të theksuar e të patheksuar, përdorimin e formave me rotacizëm në vend të formave me -n-ndërzanore etj. Tërësia e të gjitha artikulimeve të nevojshme për nyjëtimin e tingujve në një gjuhë apo dialekt quhet *bazë artikulative*. Po të krahasohet baza artikulative ndërmjet gjuhëve të veçanta standarde, vërehet se ajo pak a shumë është e ndryshme. **E dallueshme është edhe baza artikulative e varianteve territoriale të një gjuhe të përbashkët.**

Në pikëpamje gjuhësore, në përgjithësi mund të themi se gegët dhe toskët dallojnë paksa edhe në bazën artikulative të tyre. Baza artikulative dallohet e identifikohet jo vetëm ndërmjet folësve gegë e toskë, por edhe ndërmjet pjesëtarëve të nëndialekteve, grupeve të folmeve e të folmeve të një krahine. Fjala vjen, shprehi nyjëtimore tipike e pjesëtarëve të gegërishtes qendrore është zhbuzorëzimi i [y]-së në [i], diftongimi i zanoreve të ngritjes së lartë [i] dhe [u] në diftongje dytësore, qiellzorëzimi i [g]-së në [gj] etj. Pikërisht, në saje të shprehive nyjëtimore ne me saktësi (relative) mund të identifikojmë përkatësinë territoriale të folësit, aq sa përcaktojmë jo vetëm cilit dialekt i përket, por lokalizojmë edhe krahinën a zonën, bile edhe rrethin; po të jemi të asaj zone, me saktësi mund të përcaktohet edhe katundi i folësit. Këtë identifikim territorial të folësit e bëjnë jo vetëm gjuhëtarët, sidomos dialektologët, por edhe njerëzit e profesioneve të tjera.

Edhe në jetën e përditshme shpeshherë themi: nga mënyra si flet kuptova se je tetovar, strugan, dibran, shkodran, tepelenas, vlonjat, arbëresh... apo se je shqiptar që jeton në Gjermani, në Amerikë, në Turqi etj., të fundit për shkak të ndikimit të gjuhëve të huaja të mjedisit. Edhe njerëzit që nuk janë gjuhëtarë kur udhëtojnë nga një vend në një vend tjetër ku flitet shqipja hetojnë se banorët e një vendi flasin më ndryshe nga banorët e një vendi tjetër. Madje, shprehitë nyjëtimore krahinore dalin në pah edhe në ligjërimin letrar të shqiptarëve.

Kohëve të fundit po dëgjojmë edhe sintagmat: shqipja e Shqipërisë, e Kosovës, e Maqedonisë; për të dalluar të njëjtën gjuhë (shqipen) me ngjyrimë

territoriale, përkatësisht shtetërore, sipas modelit anglishtja e Anglisë, e ShBA-së, Skotlandës, Nigerisë etj. S’do mend se një përcaktim i tillë shtetëror i përdorimit praktik të shqipes standarde është i pambështetur. Zbatimi praktik i normave standarde ka të bëjë me nivelin individual të shkollimit, të kulturës së gjuhës e të ngritjes së përgjithshme intelektuale e jo me përkatësinë shtetërore të shqiptarëve. Ka folës krahinash e shtetesh të ndryshme që ose e zotërojnë mirë shqipen standarde ose nuk e zotërojnë ose flasin në dialekt.

Thjesht, variantin dialektor e mësojmë shpejt, vetvetiu (spontanisht), pa mund, në shtëpi, duke dëgjuar e duke folur; ndërsa standardin e përvetësojmë në shkollë me leksione, përpjekje e mund. Një fjalë e urtë popullore thotë: “Përtacia është burimi i të gjitha të këqijave.” Mendoj se pikërisht përtacia është arsyeja kryesore e mospërvetësimit të shqipes standarde nga të rinjtë e të rejtat tona. Fatkeqësisht, shumica prej tyre janë përtacë. Duan të mbarojnë shkollë pa mësuar, të dinë pa lexuar, të flasin e të shkruajnë si t’u vijë më lehtë, të jetojnë pa punuar, të pasurohen pa fituar...

Dihet se çdo njeri në të folmen e tij popullore, të quajtur edhe “gjuhë e zemrës” flet e shkruan shumë lehtë, natyrshëm, pa e lodhur mendjen, pa u shkolluar, pa lexuar asnjë libër. Me këtë rast, ne po duam të flasim pikërisht për këtë bazë nyjëtimore dialektore të shqiptarëve. Lidhur me këtë, për të dëgjuar e shijuar ligjërimin e shqipes popullore me nanca të shumëllojshme fonetike mjafton të zbritni nga Interneti e të ndiqni ndonjë nga episodet e komedisë së serialit televiziv “O sa mirë”, emetuar nga Digitalb, ku aktorë krahinash të ndryshme shqiptare, çdonjëri nga ta flet në të folmen vendore të tij. Larminë e bazës nyjëtimore të shqiptarëve mund ta dëgjoni edhe nga incizimet zanore të 137 varianteve dialektore të shqipes në dhjetë shtete ku ajo flitet, incizuar e postuar në Internet nga albanologu Robert Elsie në sitin e tij zyrtar, në faqen www.albanianlanguage.net.

Në këtë kuptim, shumëllojshmëria e shqiptimit të tingujve ka bazë gjeografike, pra është e lidhur me prejardhjen krahinore të folësve. Në një vështrim përgjithësues, mund të thuhet se **gegët** dhe **toskët**, përveç shumë **shprehive nyjëtimore të përbashkëta**, kanë edhe disa **shprehje nyjëtimore dalluese**:

1. Theksi dinamik te gegët është më i fuqishëm sesa te toskët (si në mbarë shqipen edhe në toskërishte theksi është dinamik, por toskërishtja ka më shumë elemente të theksit muzikor).
2. Gegët dallohet me zgjatjen e zanoreve të theksuara, mosshqiptimin e zanoreve të patheksuara, me shqiptim më të hapur të zanoreve krahasuar me toskët.
3. Gegët karakterizohet me shqiptim më të përparmë të bashkëtingëlloreve (tipike është afrikatizimi i mesgjuhoreve [q, gj] në [ç, xh]).
4. Gegët shquhet me prirje më të shprehur për të ekonomizuar të folurit, për të lehtësuar shqiptimin, me një shkallë më të lartë të përshtatjes nyjëtimore (akomodimit) të tingujve sesa toskët etj., dhe përgjithësisht

5. Gegët flasin më ngadalë sesa toskët dhe janë më të kursyer në fjalë.

Natyrisht, në çdo përgjithësim ka edhe përjashtime. Këto çështje deri më sot nuk janë trajtuar. Do të përpiqemi të japim pak shpjegime e supozime lidhur me disa pohime të mësipërme. Meqë dukuritë gjuhësore janë të ndërlydhura njëra me tjetrën, ato edhe gjatë shpjegimit të tyre vështirë se mund të ndahen veç e veç.

Siç dihet, shqipja standarde, por edhe variantet dialektore (gegërishtja e toskërishtja) kanë theks dinamik, të lirë e të palëvizshëm në paradigmën e eptimit. Te gjuhët me theks dinamik, forca është elementi mbizotërues që e dallon rrokjen e theksuar nga të tjerat. Por, duhet pasur parasysh se rrokja e theksuar dallohet jo vetëm për forcë më të madhe, por edhe për gjatësi më të madhe, ton më të lartë etj. Pra, theksi i shqipes karakterizohet nga katër tipare që bashkëveprojnë: intensiteti, gjatësia, lartësia dhe cilësia e zanores. Të gjitha këto elemente veprojnë së bashku, prandaj është e vështirë të dallojmë ç'rol luan njëri ose tjetri tipar i marrë veças. Theksi dinamik i shqipes duket:

- a) në ndryshimet kuantitative ndërmjet zanoreve të theksuara e të patheksuara: zanoret e theksuara janë më të gjata sesa të patheksuarat;
- b) në tkurrjen, por edhe në rënien e zanoreve të patheksuara;
- c) në krijimin e një zanoreje të rrëgjuar [ë], nga zanoret e patheksuara;
- ç) në krijimin e fjalëve të patheksuara brenda fjalisë (trajtat e shkurtra, parafjalët, pjesëzat etj.).

Në gjuhët e dialektet që kanë theks dinamik ose intensiv (i quajtur nganjëherë edhe eksplorator) rrokja e theksuar dallohet nga të tjerat për fuqinë dhe intensitetin e shqiptimit; domethënë rrokja e theksuar shqiptohet më fuqishëm sesa rrokjet e patheksuara (të patheksuarat shqiptohen më dobët). Theks muzikor (theks tonik apo kromatik) kanë gjuhët e dialektet ku rrokja e theksuar dallohet nga të patheksuarat për nga numri i dridhjeve në sekondë, domethënë nga toni më i lartë (nga lartësia e tonit); me të cilin shqiptohet zanorja e theksuar, në krahasim me zanoret e patheksuara; duke krijuar kështu, me ngritjet dhe uljet e tonit, elemente të melodive muzikore.

Por, ndërmjet këtyre dy tipave të theksit (theksit muzikor dhe theksit dinamik) nuk ekziston një dallim i prerë. Ata nuk e përjashtojnë njëri-tjetrin, pasi fuqia më e madhe e shqiptimit kushtëzon rritjen e numrit të dridhjeve, që përcaktojnë lartësinë e tonit; ashtu si edhe tonet më të larta çojnë në rritjen e intensitetit. Për këtë arsye mund të flitet për gjuhë, në të cilat mbizotëron njëri ose tjetri tip theksimi (theksi dinamik apo muzikor). Kështu, në gjuhën shqipe rrokja e theksuar jo vetëm që është më e fortë, por edhe me ton më të lartë, më e gjatë dhe më e qartë sesa rrokja e patheksuar.

Nga shpjegimet e mësipërme, mund të nxirret si përfundim se **gegërishtja ka theks dinamik më të spikatur, ndërsa toskërishtja ka theks dinamik me elemente të theksit muzikor**. Këtë pohim e mbështesim edhe në faktin se:

Gjuhët e dialektet me theks muzikor i ruajnë mirë të gjithë tingujt zanorë në çdo pozicion, të theksuar e të patheksuar. Në këtë kuptim, toskëtrishtja i ruan më mirë tingujt zanorë në çdo pozicion të theksuar e të patheksuar.

Në gjuhët e dialektet me theks dinamik dallimi në gjatësi i zanoreve të theksuara ndaj zanoreve të patheksuara është më i madh sesa në gjuhët me theks muzikor. Zanoret e theksuara në gegërishte janë dy herë më të gjata sesa të patheksuarat, ndërsa në toskërishte të theksuarat janë fare pak më të gjata sesa të patheksuarat. Pra, zanoret e theksuara në gegërishte shqiptohen më të gjata sesa në toskërishte. Në toskërishten dhe në shqiptimin letrar përpjesëtimi në gjatësi ndërmjet zanoreve të theksuara e të patheksuara është 10 : 7; ndërsa në gegërishte ky raport është 2 : 1. Me metodën e fonetikës eksperimentale, prof. Bahri Beci në të folmen e Shkodrës ka analizuar një numër të madh fjalësh njërrrokëshe e shumërrrokëshe në rrethime të ndryshme të zanoreve. Sipas kësaj monografie, zanoret e shkurtra shqiptohen në intervalin prej 20 deri më 8 të qindta të sekondës, ndërsa të gjatat midis 42-20 qs. Vlerësim i përgjithshëm është se raporti i gjatësisë fizike të zanoreve të gjata përkundër zanoreve të shkurtra në të folmen e Shkodrës, si edhe në të folmet e tjera të gegërishtes, është 2:1.²⁸² Po i njëjti dialektolog konstaton se në shqipen standarde raporti ndërmjet zanoreve të theksuara e të patheksuara është 10/7.²⁸³

Në të folmet e gegërishtes rrëgjimi i zanoreve të patheksuara është më i madh sesa në të folmet toske. Zanoret e patheksuara në gegërishten jo vetëm që kanë prirje të tkurren, por shpeshherë edhe bien, si p.sh. *flútur > flútër, përrállë > prrá:ll, móllë > mó:ll, shtëpí > shpí, shtëllúngë > shllú:ng, bashkëtingëllore > bashktingllore, bashkëkohór > bashkohór* etj. Shembujt e dhënë dëshmojnë se ndonjëherë nuk shqiptohen jo vetëm zanoret e patheksuara, por edhe gjithë rrokja e patheksuar. Tani më është përdëftuar përgjithësisht se shkalla e rrëgjimit deri në rënie të plotë të zanoreve të patheksuara në të folmet e gegërishtes është më e madhe sesa në të folmet e toskërishtes dhe në shqipen standarde. Këtë pohim më së miri e mbështet mosshqiptimi i [ë]-së fundore, jo vetëm në fundin absolut të fjalës, por shpeshherë edhe në mes të fjalës (jo vetëm: *mo:ll, shko:ll, na:n, lo:p, mi:r* ‘mollë, shkollë, nënë, lopë, mirë’; por edhe *përmirsim, msu:s, anta:r* ‘përmirësim, mësues, anëtar’ etj.).

Shprehni nyjetimore e gegëve është që togjet e zanoreve e të bashkëtingëlloreve të mos i shqiptojnë të plota, përkatësisht të bëjnë monoftongimin e togjeve të zanoreve dhe përngashmimin e togjeve të bashkëtingëlloreve. Për shkak të lehtësimit të shqiptimit, në vend të formës fonetike të plotë, në gegëri kemi forma të përngjashmuara (asimiluara), si *arsy;*, *fy:ll, kry;*, *ly:j, py:s, thy:j* a *the:j; dëgju:s, msu:s, i lexu:shëm, i pajtu:shëm, i*

²⁸² Bahri Beci, *Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës*, Tiranë, 1995, f. 232.

²⁸³ Bahri Beci, *Sistemi fonologjik ...*, SF 1, Tiranë, 1985, f. 93-109.

vazhdu:shëm; i arsy:shëm, i pathy:shëm (< arsyë, fyell, krye, lyej, pyes, thyej; dëgjues, mësues, i lexueshëm, i pajtueshëm, i vazhdueshëm; i arsyeshëm, i pathyeshëm). Zanorja që mbetet gjatë monoftongimit shqiptohet gjithmonë e gjatë ([ye] > [y:], [ue] > [u:]) (përkatësisht në /y:/ dhe /u:/ të gjata). Edhe togjet e bashkëtingëlloreve toskët përgjithësisht i shqiptojnë të plota, ndërsa gegët i përngjashmojnë, si *maj* (< mbaj), *kumëll* (< kumbull), *nimoj* (< ndihmoj), *fun* (< fund), *nat* (< ngat) etj.

Dihet se nyjëtimi themelor i tingujve merr nuanca plotësuese, varësisht nga rrethimi tingullor, pra tingujt përshtaten me mjedisin fonetik në të cilin gjenden ose siç thuhet ndryshe akomodohen. Sa i përket ndikimit të kontekstit tingullor të drejtpërdrejtë ndaj ngjyrës së zanoreve, në shqipen janë të njohura disa dukuri, si: *ndryshimi i lartësisë së nyjëtimimit, zhvendosja nyjëtimore para/prapa, qiellzorëzimi, buzorëzimi, velarizimi, hundorëzimi* i zanoreve etj. Në shumicën e rasteve, modifikimet në shqipen, në thelb, janë ndërlidhje të nevojshme gjatë nyjëtimimit të fonemave në rrjedhën e të folurit. Toskërishtja (dhe shqipja standarde) bëjnë pjesë në grupin e gjuhëve pa përshtatje të madhe të tingujve, pra janë joakomoduese. Gegërishtja krahasuar me toskërishten është më shumë akomoduese, pra bën përshtatje nyjëtimore më të madhe të tingujve të kushtëzuara nga rrethimi tingullor ose nga pozicioni. Alofonia e fonemave zanore është më e madhe sesa e bashkëtingëlloreve.

Dukuri akomoduese mjaft e shpeshtë në gegërishte është **qiellzorëzimi**, përkatësisht nyjëtimi i bashkëtingëlloreve me një timbër qiellzor, kur gjenden në kontakt me ndonjë zanore të përparme. Kështu, prapagjuhoret /k, g/ shqiptohen si më të përparme kur ndodhen para zanoreve të përparme /i, y, e/, duke u afruar me qiellzoret, si *gisht* [g'isht] (në gegërishten qendrore *gjisht*), *kemi* [k'emi]. Në disa të folme të gegërishtes /e/-ja bëhet edhe më e përparme, përkatësisht nis me tingullthin [i], kur vjen pas një bashkëtingëlloreje qiellzore: *qeth* [q'eth], *lepur* [l'epër], *gjeth* [gj'eth], *gjel* [gj'el] etj.

Edhe **buzorëzimi** (labializimi), që është shqiptimi i tingujve jobuzorë me nuanca buzorëzuese e që ndodh gjatë kontaktit të ndonjë bashkëtingëlloreje ose zanoreje jobuzore me një tingull tjetër buzor, është shumë e shpeshtë në të folmet e gegërishtes, veçmas të shndërrimit të [ã]-së hundore në [o], sipas tipit *nāna* > *na^ona*, *nona*; *hāna* > *ha^ona*, *hona* etj.

Po kështu, **hundorësia** e zanoreve (nazalizmi), që është dukuri fonetike e shqiptimit të ndërhumshëm të zanoreve, është shprehur nyjëtimore geqe, e papranishme te toskët. Hundorëzimi i zanoreve, pasojë e përngjashmimit prapavajtës në takim (asimilimit regresiv në kontakt), ka ndodhur kur zanoret janë gjetur apo edhe sot gjenden para bashkëtingëlloreve hundore /m, n, nj/, si *hû, sÿ, pê, frê; hûni, sÿni, pêni, frêni* etj. Shkalla e hundorësisë së zanoreve në të folmet geqe është e larmishme: në veri është më e lartë, ndërsa sa më në jug që shkohet, hundorësia e zanoreve zvogëlohet. Kjo dukuri nuk i ka përfshirë të gjitha të folmet e gegërishtes: diku kemi zanore hundore me vlerë fonologjike, ndërse diku hundorësia është defonologjizuar

dhe dëgjohen zanore të hundorëzuar. Në toskërishten (dhe në shqipen standarde) zanoret hundore nuk bëjnë pjesë në inventarin e fonemave zanore.

Shkalla e alofonisë së fonemave, veçmas e zanoreve, te gegët është shumë më e madhe sesa te toskët (dhe në shqiptimin letrar): gegërishtja ka trashëguar nga shqipja e moçme dhe ende e ruan shqiptimin e ndërhundshëm të zanoreve; dukuri fonetike shumë të shpeshta te folësit gegë janë: buzorëzimi i zanoreve në shkallë të ndryshme (zāni > za^oni > zoni), diftongimi i zanoreve të ngritjes së lartë [i, u] (mirë > mâir, nuse > nāuse - vetëm në të folmet e gegërishtes qendrore), shqiptimi i zanoreve të mirëfillta si diftongoide (lepur > l'epër), nyjëtimi më i përparmë dhe më i mbyllur i disa zanoreve të patheksuara (flutur > flutër), qiellzorëzimi i bashkëtingëlloreve (gojë > gjo:j - në gegërishten qendrore), afrikatizimi i bashkëtingëlloreve mesgjuhore (qen > çen, gjak > xhak - në shumicën e të folmeve të gegërishtes veriore), përngjashmimi i grupeve të zanoreve e të bashkëtingëlloreve (mësues > msu:s, mbaj > maj - në shumë të folme të gegërishtes veriore), metateza (lëshoj > shloj - dukuri më e përhapur në të folmet e gegërishtes) etj.

Sa më i madh të jetë dallimi ndërmjet artikulimit vendor (krahinor, dialektor) **dhe normës shqiptimore letrare, aq më të mëdha janë vështirësitë e përvetësimit të shqiptimit letrar, që ka për pasojë edhe vështirësi në drejtshkrimin e shqipes standarde.**

10.3. TË FOLURIT DHE TË SHKRUARIT ËSHTË PROCES I NDËRLIKUAR

Në saje të gjuhës (në formën e folur dhe të shkruar) njeriu e ka zhvilluar të menduarit apo mendjen, ka zhvilluar shprehitë e punës si dhe shkencat nga të cilat ka përfituar dhe përfiton gjithnjë. Pa gjuhë nuk ka as zhvillim mendor, as intelektual, as arsimor, as kulturor, as shkencor, as teknik.

Të folurit është proces i ndërlikuar

Kur dëgjojmë ndonjë gjuhë të huaj që nuk e dimë, na duket se folësi flet shumë shpejt, aq shpejt sa që valën tingullore nuk mund ta përkapim (perceptojmë) në njësi gjuhësore: as në tinguj, as në morfema e as në fjalë e fjali. Në të vërtetë, gjuhët nuk dallojnë shumë në shpejtësinë e lëvizjeve nyjëtimore. Bie fjala, shpejtësia mesatare e shqiptimit të rrokjeve në sekondë në kroatishen është 5.2 rrokje, në anglishtes 5.9, në rusishten 6.1 rrokje/sek.

Ndërlíkueshmërinë (kompleksitetin) e valëve tingullore të të folurit e kuptojmë edhe më mirë kur mësojmë ndonjë gjuhë të huaj, duke 'e thyer' gjuhën për të artikuluar ndonjë tingull që nuk e ka gjuha jonë amtare. Edhe atëherë kur arrijmë që të flasim rrjedhshëm gjuhën e huaj, do të hetohet se atë nuk e kemi gjuhë amtare si nga shqiptimi, ashtu edhe nga gabimet gramatikore e leksikore që bëjmë.

Të folurit realizohet me bashkërendimin (koordinimin) e lëvizjeve të organeve të të folurit. Vetëm gjatë një sekonde aktivizohen qindra muskuj. Duke pasur parasysh se nuk aktivizohen të gjithë muskujt njëkohësisht, lipset harmonizimi i tyre kohor për fillimin, pjesën e mesit dhe të përfundimit të nyjetimit të tingullit. Në të folurit shfaqen shumë tipare individuale të folësit. Të folurit përkufizohet (definohet) si realizim tingullor i kodit gjuhësor.²⁸⁴

Programi motorik i të folurit

Me program motorik të të folurit nënkuptojmë urdhrat që i dërgon truri muskujve të aparatit të të folurit, kur dhe si duhet të kontraktohen që të kryhet një lëvizje e nevojshme artikulative. Në pikëpamje informatike, ato janë procedura të cilat mundësojnë që porosia, e formësuar në tru në rrafsh të ndryshme në kod njësisht të kuptimshme, të dekodohet në formën e impulseve tingullore dhe të lëvizjeve artikulative. Rol të rëndësishëm në këtë proces luan mbamendja. Padyshim se në mbamendjen e njeriut nuk ekziston “fjalor” me fjalë e fjali të gatshme, të cilat njeriu do t’i ftonte nga mbamendja (memorja) dhe do t’i thoshte.

Modelimi i prodhimit të ligjërimit mund të ndahet në pesë faza: 1) përcaktimi i mendimit që do ta themi, 2) zgjedhja e radhitjes së fjalëve në fjali (sintaksa), 3) zgjedhja e fjalëve kuptimplota (emrave, foljeve, mbiemrave, ndajfoljeve), 4) zgjedhja e fjalëve shërbyese dhe e formës morfologjike të fjalëve; dhe në fazën e fundit 5) përcaktimi i segmenteve tingullore. Pasi të jetë planifikuar edhe faza e pestë, programi ligjërimor përfundon dhe mund të realizohet të folurit.

Duke filluar fjalinë, folësi e ka idenë e përgjithshme të kumtimit (përmbajtjes se çfarë do të thotë), por jo edhe të hollësive të tij. Mirëpo, gjatë procesit të të folurit e konkretizon dhe e formëson fjalinë. Një program artikulativ i përgjigjet një tërësie kuptimore (një mendimi të përfunduar).

Me qenë se qëllimi i folësit është që dëgjuesi ta kuptojë, folësi përpiket që mendimet t’i thotë sa më qartas, duke u kujdesur edhe për shqiptimin e drejtë, me qëllim që bashkëbiseduesi ta dekodojë ligjërimit.

Planifikimi dhe realizimi i të folurit

Për ligjërim të rrjedhshëm njeriu duhet të planifikojë çfarë do të thotë e si do ta thotë. Folësi duhet të synojë ligjërimit ideal. Po marrim një shembull:

Profesori i fonetikës e mbajti provimin të premtën në orën dhjetë.

²⁸⁴ Damir Horga, *Obrada fonetskih obavijesti*, Hrvatsko filološko društvo, Znanstvena Biblioteka, Zagreb, 1996, f. 11-16.

Së pari konceptohet (planifikohet) mendimi që duam ta shprehim: kush?, çfarë? kur?. Kjo strukturë plotësohet me pjesët (përbërësit): Kush? – *Profesori i fonetikës. Çfarë? - e mbajti provimin. Kur?- të premten në orën dhjetë.*

Pra, realizimi i të folurit varet shumë nga shkalla e planifikimit konceptual dhe gjuhësor. Vështirësitë në planifikimin e përmbajtjes së kumtimit që duam ta themi (me gojë ose me shkrim) janë të shumta. Ndër problemet më të shpeshta është ndërlikueshmëria kuptimore (përmbajtjesore) që folësi do ta thotë. Për planifikimin konceptual (mendor, kognitiv) të gjërave më të komplikuar lipset kohë më e gjatë e angazhim mendor më i madh. Në shkaqet kognitive të vështirësive bën pjesë edhe problemi i gjetjes së fjalëve të përshtatshme.

Që të prodhohet të folurit, duhet kryer dy procese: a) së pari duhet planifikuar atë e pastaj b) duhet realizuar. Sado që të folurit njëherë planifikohet në tru e pastaj realizohet, ligjërimi ynë nuk është i përkryer. Andaj, edhe në të dy fazat gabojmë. Gabimi bëhet pikërisht për shkak se folësi njëkohësisht edhe planifikon edhe flet. Kjo shfaqet me pasaktësi shqiptimore, ndërprerje të shpeshta gjatë të folurit (pa folur asgjë, ose duke lëshuar ndonjë zë - rëndom me ëëëë, pasthirmë), hamendësime, përsëritje, fillim të pasaktë, përmirësime, fjali të paqarta, ngatërime kuptimore e sintaksore etj.

Të folurit ideal i përafrohen lexuesit e shkathtë, folësit profesionistë si dhe aktorët e mirë; falë shkathtësisë dhe përvojës në ligjërim, ashtu edhe planifikimit të mirë paraprak të të folurit. Si duket, folësit dallojnë midis tyre më shumë në saje të aftësisë së planifikimit të të folurit sesa në shkathtësinë e realizimit të tij. Folësit e ngadalshëm kanë më shumë hamendësime sesa ata që flasin shpejt. Është konstatuar se folësit mesatarisht 40-50% të kohës së ligjërimit e humbasin në ndërprerje ligjërimore. Te njerëz të ndryshëm edhe bjerrja (humbja) e kohës gjatë të të folurit është e ndryshme. Ka folës që kur flasin humbasin vetëm 5% të kohës, por edhe folës që 65% të kohës ligjërimore e kalojnë pa thënë asgjë.

Folësi duhet të harmonizojë procesin biologjik të frymëmarrjes me prodhimin e të folurit në mënyrën më të mirë, ashtu që nevoja biologjike e frymëmarrjes së trupit të mos pësojë për shkak të të folurit e anasjelltas. Në të folurit pauzat do të ishte mirë të bëhen në ato vende dhe në atë ritëm që është më i përshtatshmi edhe për organizimin konceptor (konceptual, mendor, logjik) edhe për realizimin e të folurit. Siç dihet, kur nuk flasim cikli i frymëmarrjes dhe frymëqitjes mesatarisht zgjat 5 sekonda. Gjatë kësaj kohe të tri aktiviteteve: ai biologjik, gjuhësor dhe konceptual mund të kryhen në të njëjtën kohë. Kjo ndërprerje në ligjërim është e domosdoshme dhe nuk konsiderohet mangësi ligjërimore.²⁸⁵

²⁸⁵ Damir Horga, *Obrada fonetskih obavijesti*, Hrvatsko filološko društvo, Znanstvena Biblioteka, Zagreb, 1996, f. 24.

Uniteti i përkapjes (perceptimit) së të folurit

Të folurit është mjeti kryesor i komunikimit. Të flasësh mirë është çelësi për komunikim të mirë mes njerëzve. Të folurit është akt komunikimi që folësi e shpreh mendimin nëpërmjet valëve tingullore e ato i përkap (percepton) bashkëbiseduesi. Sinjalet zanore të të folurit gjatë përkapjes dëgjuesi i përpunon në tri rrafshë: a) dëgjimor, b) fonetik dhe c) fonologjik.

Detyra kryesore e dëgjuesit gjatë përkapjes së valëve tingullore të të folurit është që të zbulojë informatat fonologjike, të kuptojë mesazhin. Prodhimi i të folurit është proces motorik i koordinuar, me lëvizje të harmonizuara të aparatit të të folurit për krijimin e rrjedhës tingullore. Hulumtimet kanë dëshmuar se procesi neuromotorik i prodhimit të tingujve është shumë i ndërlikuar.

Në kuadrin e vlerësimit të karakteristikave segmentore dhe prozodike të të folurit dallohen:

1. Shqiptimi i drejtë i periudhave, fjalive, sintagmave, fjalëve e tingujve si dhe theksi dhe intonacioni sipas standardit shqiptimor;
2. Rregullsia e shqiptimit të rrokjeve;
3. Vlera interpretative dhe afektive e të folurit, që përfshin zërin laringal dhe shprehshmërinë e të folurit;
4. Tendosja fonemore dhe
5. Rrjedhshmëria e të folurit.

Të gjithë këto elemente shfaqen përnjëherë gjatë aktit të të folurit dhe në bazë të tyre vlerësohet cilësia (kualiteti) e të folurit të dikuajt.²⁸⁶

Teoria akustike zgjidh çështjen e analizës e të sintezës së të folurit, meqë konsiderohet se vala e të folurit është e zërthyeshme në njësi, por edhe njësitë e saj të bashkueshme në tërësi. Të folurit shpjegohet si vargua tingujsh me të cilët formohen njësi më të mëdha: rrokje, fjalë, fjali e periudha të shoqëruara me theks e intonacion.

Në ritëm (tempo) të shpejtë të të folurit zanoret shkurtohen ose edhe humben (nuk shqiptohen), ndërsa në ligjërimin e ngadalshëm ato zgjaten. Bashkëtingëlloret pothuajse nuk ndryshojnë në gjatësi as në ligjërimin e shpejtë e as të ngadalshëm. Përgjithësisht mund të thuhet se stërzgjatja e ritmit të të folurit bëhet nëpërmjet zgjatjes së zanoreve, të afrikateve dhe fërkimoreve, ndërsa më pak në mbylltoret e sonantet.²⁸⁷

Njerëzit flasin me ritëm (tempo) të ndryshëm. Kryesisht njihen tri tempo ligjërimi: a) ligjërimi normal, b) ligjërimi shumë i shpejtë dhe c) ligjërimi shumë i ngadalhtë.

²⁸⁶ Damir Horga, *Obrada fonetskih obavijesti*, Hrvatsko filološko društvo, Znanstvena Biblioteka, Zagreb, 1996, f. 311.

²⁸⁷ Damir Horga, *Po aty*, f. 59.

10.4. NDËRLIDHJA E SHQIPTIMIT ME SHKRIMIN

Të folurit dhe shkrimi janë dy forma të veçanta të realizimit të një gjuhe të vetme. Ato nuk respektojnë kurdoherë rregulla të njëjta, që do të thotë se gjuha e shkruar nuk është paraqitje besnike e gjuhës së folur. Përgjithësisht, gjuhët edhe gjatë zhvillimit mbeten në baraspeshë. Deri më tani asnjë gjuhë nën veprimin e ndryshimit të brendshëm historik nuk është zhdukur, d.m.th. nuk e ka humbur aftësinë e funksionimit si mjet më i rëndësishëm komunikimi. Gjuhët sikur “nga natyra” janë të pajisura me mekanizmin e vetërregullimit, të ngjashëm sipas funksionit me një termostat të rëndomtë, që pengon procesin e ndryshimeve: të mos shkojë në skajshmëri që të shkatërrojë sistemin. Në dinamikën e ndryshimeve midis formës së folur dhe formës së shkruar të shqipes baraspesha kryesore arrihet me harmonizimin e dy prirjeve:

a) tendencës për thjeshtimin e formave, që zvogëlon mundin në ligjërimin e folur (prirjes fonetike), dhe

b) nevojës që të ruhet e pandryshuar në shkrim secila morfemë në të gjitha rastet e përdorimit të saj (prirjes morfologjike).

Në të vërtetë, shqipja shkruhet sipas **parimit fonologjik** e atij **morfofonologjik**. Pra, **drejtshkrimi i shqipes mbështetet në parimin morfonologjik**. Sipas parimit fonologjik shënohet përbërja fonemore e fjalëve. Me zbatimin e këtij parimi drejtshkrimor, marrëdhënia e grafemave dhe e fonemave në fjalë të veçanta paraqitet në raportin 1 : 1, që është pothuajse ideal kur alfabeti është fonologjik, e që, me një numër të vogël përjashtimesh, mund të thuhet edhe për drejtshkrimin e gjuhës standarde shqipe.

Drejtshkrimi morfonologjik shënon përbërjen fonemore të morfemave të veçanta e jo mënyrën e shqiptimit të fjalëve. Në drejtshkrimet e gjuhëve që zbatojnë parimin fonologjik dhe morfologjik (parimin morfonologjik), më së shpeshti realizohet një ndërthurje (kombinim) i këtyre dy parimeve.

Dikush ka mendim të gabuar se shqipja shkruhet sipas shqiptimit individual a krahinor, meqë kështu e kërkon parimi fonetik. Po ta shkruanim qoftë edhe shqipen e ligjërimin letrar vetëm sipas parimit fonetik, atëherë nuk do të kishim sistem e rregulla shkrimi, por transkriptimin e formës së folur, ngjashëm me transkriptimin e materialit dialektor (me shenja të posaçme për gjatësi, hundorësi, ndërrime tingujsh, alofoni fonemash; duke ndarë fjalët në njësi fonetike e jo në njësi leksikore etj.).

Siç dihet, në rrjedhën e të folurit tingujt ndikojnë mbi njëri-tjetrin, duke bërë që çdo fonemë në pozicione të caktuara të ketë realizime të ndryshme fonetike (alofone). Pra, ligjërimi i folur realizohet nëpërmjet alofoneve të fonemave në rrethime fonetike të ndryshme, ndërsa shkronjat shënojnë fonemat pavarësisht modifikimeve tingullore. Është përdëftuar se në gjuhë ka aq variante fonemash sa ka edhe kombinime të mundshme fonemore.

Në shkrim synohet pasqyrimi i shqiptimit letrar e jo shqiptimi individual, krahnor apo dialektor i folësve. Nga kodifikimi shkrimor i shqipes tanimë kanë kaluar rreth 60 vjet, ndërsa shqiptimi brenda këtij gjysmëshekulli ka evoluar dukshëm, si rrjedhojë e ndryshimeve të reja gjeo-politike, ekonomike e kulturore të shqiptarëve. Hapja e kufijve të shteteve ballkanike ku jetojnë shqiptarët, takimet e komunikimi ynë i derjpërdrejtë nëpërmjet teknologjisë informatike, biznesi, shkollimi, martesat krahnash të ndryshme, globalizimi si dhe shumë faktorë të tjerë sociolinguistikë sollën edhe zhvillime e ndryshime në gjuhë. Ndryshime vërehen në të gjitha nënsistemet gjuhësore: në fonetikë, në morfologji, në sintaksë e në leksik.

Gjithnjë e më tepër edhe forma e folur e shqipes po shkon drejt konvergjencës: toskët po flasin me nuanca geqe, ndërsa gegët me nuanca toske. Në këtë kuptim, shpeshherë, në ligjërimin e toskëve dëgjojmë paskajoren geqe, pjesore të reduktuar, monoftongimin e togjeve të zanoreve, forma shumësi tipike geqe e gegizma të tjerë; ndërsa në ligjërimin e gegëve tipare toske, si përdorimin e fjalëve me forma toske (vënt, kuvënt), përdorimin e grupit /ua/, folje në variantin toskë (punonja, do punoj) etj.

Dukuri e përbashkët ligjërimore e gjithë shqiptarëve, folësve gegë e toskë, është mosshqiptimi i /ë/-së së patheksuar (në fundin absolut të fjalës dhe në trup fjalësh, sidomos te fjalët e formuara me kompozim e përngjitje). Pikërisht mosshqiptimi i /ë/-së së patheksuar dhe ruajtja e saj në shkrim përbën hendekun më të madh ndërmjet formës së folur dhe formës së shkruar të shqipes së sotme. Rreth kësaj edhe thyhen shtizat ndër gjuhëtarë: të ruhet shkrimi i /ë/-së, pavarësisht se ajo tanimë nuk shqiptohet, apo drejtshkrimi të ndryshohet që të pasqyrojë me besnikëri shqiptimin e sotëm.

Në shkrim synojmë ligjërimin libror, ndërsa në të folur rëndom mbetemi në ligjërimin bisedor e rrallëherë përpiqemi të zbatojmë ligjërimin libror. Nga kjo pikëpamje, drejtshkrimi i shqipes përcakton normat e shkrimit të shqipes në ligjërimin libror (letrar), që është më i përpunuari në pikëpamje të normës.

Në shkrimin e shqipes nuk i shënojmë tingujt e ligjërimin, por fonemat e gjuhës. Në qoftë se do ta shkruanim shqipen e ligjërimin letrar vetëm sipas parimit fonetik, atëherë nuk do të kishim sistem e rregulla shkrimi, por transkriptimin e formës së folur, ngjashëm me transkriptimin e materialit dialektor (me shenja të posaçme për gjatësi, hundorësi, ndërrime tingujsh, alofoni fonemash; duke ndarë fjalët në njësi fonetike e jo në njësi leksikore etj.).

Siç dihet, në rrjedhën e të folurit tingujt ndikojnë mbi njëri-tjetrin, duke bërë që çdo fonemë në pozicione të caktuara të ketë realizime të ndryshme fonetike (alofone). Pra, ligjërimi i folur realizohet nëpërmjet alofoneve të fonemave në rrethime fonetike të ndryshme, ndërsa shkronjat shënojnë fonemat, pavarësisht modifikimeve tingullore. Është përdëftuar se në gjuhë ka aq variante fonemash sa ka edhe kombinime të mundshme fonemore.

Për të shkruar shqipen standarde zbatojmë shkrimin fonematik, që do të thotë se 36 fonemat e shqipes standarde i shkruajmë me 36 grafema (njëshe ose dyshe). Në shkrimin e shqipes nuk bëjmë transkriptimin fonetik të të folurit; pra, nuk japim shqiptimin e saktë të fjalëve ose të teksteve të tëra, por shënojmë fonemat me prirjen për të ruajtur edhe përbërjen morfematike të fjalës.

Transkriptimin fonetik e përdorin fonetikanët dhe dialektologët me qëllim që të japin në hollësi shqiptimin e tingujve, duke përdorur shenja diakritike (plotësuese) që vihen poshtë, lart ose pas shkronjave të alfabetit të zakonshëm. Ka sisteme të ndryshme shenjash transkriptimi, por më i njohuri është Alfabeti Fonetik Ndërkombëtar (angl. IPA = I(nternacional) P(honetik) A(lphabet), i cili ka karakter universal.

Drejtshkrimi i njësuar i gjuhës shqipe kurorëzon një etapë të gjatë përpjekjesh për formimin e një gjuhe letrare të vetme e të përbashkët për gjithë popullin shqiptar dhe çel rrugën për ta përmirësuar më tej normën drejtshkrimore të kësaj gjuhe në pajtim me zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës dhe kulturës sonë kombëtare.²⁸⁸

Dihet se abc-ja është inventar i shenjave grafike, ndërsa drejtshkrimi (ortografia) është përmbledhje rregullash për kombinimin e këtyre shenjave. ***Drejtshkrimi është sistem rregullash që kodifikon shkrimin e fjalëve në të gjitha trajtat e tyre gramatikore, shkrimin e fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes, ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit, shkrimin e datave, shkurtesave, përdorimin e shkronjave të mëdha, transkriptimin e emrave të huaj dhe përdorimin e shenjave të pikësimit.***

Nëse zbatohen normat drejtshkrimore, atëherë komunikimi me shkrim ndërmjet njerëzve do të realizohet në shkallën më të lartë të mundshme. Alfabeti dhe drejtshkrimi janë çështje ujdje (marrëveshjeje, pëlqimi) ndërmjet pjesëtarëve të shoqërisë që e flasin dhe e shkruajnë atë gjuhë. Ndonëse për shkrimin e gjuhëve të botës më së shumti përdoret alfabeti latin, por prapëseprapë nuk mund të gjenden dy gjuhë me rregulla drejtshkrimore të njëjta. Kur stabilizohen alfabeti dhe drejtshkrimi, krijohet bazë për konstituimin e gjuhës letrare a standarde.²⁸⁹

Drejtshkrimi i shqipes ka rëndësi praktike për gjithë shoqërinë shqiptare dhe përdoruesit e tjerë të shqipes, sepse ndihmon për një këmbim më të shpejtë dhe më të përpiktë të mendimeve në formën e shkruar të gjuhës standarde. Për këtë arsye përvetësimi i normave të drejtshkrimit është në interesin e gjithë kombit. Normat drejtshkrimore janë të detyrueshme për të gjithë dhe askush nuk ka të drejtë t'i shkelë e as të krijojë rregulla të tjera "vetjake". Përvoja e zbatimit dhe e shkaqeve të moszbatimit praktik të drejtshkrimit nga viti 1972 e deri sot ka treguar se rregullat e drejtshkrimit të

²⁸⁸ IAP, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974, f. 35-36.

²⁸⁹ Në Kongresin i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe, mbajtur në Tiranë prej 20 deri më 25 nëntor 1972 u vendosën rregullat e drejtshkrimit të gjuhës standarde shqipe.

shqipes mund të thjeshtëzohen e të përmirësohen në tërësi. Hapa duhet bërë në radhë të parë në një afrim më të madh me gegërishten, veçmas në pakësimin e <ë>-ve në pozicione të ndryshme, duke reduktuar kështu një karakteristikë të toskërishtes.

Problemi themelor i drejtshkrimit është marrëdhënia midis formës së folur dhe formës së shkruar të ligjëritimit. Në këtë marrëdhënie, ligjërimi tingullor është parësor (primar), kurse shkrimi është dytësor (sekondar).²⁹⁰

10.5. DREJTSHQIPTIMI

Shqipja standarde ekziston në formën e folur dhe në formën e shkruar. Ajo mbështetet në norma leksikore, gramatikore, drejtshkrimore; por edhe në norma drejtshqiptimore. Gjuha standarde duhet të jetë e njësuar si në të shkruar ashtu dhe në të folur. Gjuha e shkruar ka normat drejtshkrimore, që rregullojnë mënyrën e njëjtë të të shkruarit për të gjithë. Gjuha e folur ka normat e drejtshqiptimit, që synojnë të njësojnë shqiptimin letrar.

Termi drejtshqiptim (ortoepi) përkufizohet në mënyra të ndryshme. Në kuptimin më të gjerë, me drejtshqiptim kuptojmë rregullat e përdorimit të fonemave si dhe rregullat e shqiptimit të alofoneve të tyre. Në kuptimin e ngushtë, drejtshqiptimi përfshin vetëm rregullat e përdorimit të fonemave. Përkufizimi më i plotë është se: drejtshqiptimi është realizim normativ i njësive segmentore (fonemave) dhe i njësive mbisegmentore (theksit dhe intonacionit). Rregullat drejtshqiptimore mbështeten në sistemin e fonemave dhe në përndarjen (distribucionin) e tyre dhe në një lloj shqiptimi që është i standardizuar si i përbashkët për një bashkësi të caktuar folësish.

Drejtshqiptimi (ortoepia) përfshin nyjëtimin normativ të tingujve, theksimin e drejtë të fjalëve dhe intonacionin e fjalive. Drejtshqiptimi quhet edhe fonetikë e zbatuar (aplikative), sepse ajo përcakton shumicën e normave shqiptimore.

Norma letrare e shqiptimit përfshin dy aspekte të lidhura ngushtë me njëri-tjetrin:

- a) përcaktimin e përbërjes fonemore të fjalës që është normative, duke konsideruar të gabuar një përbërje tjetër fonemore, dhe
- b) realizimin e fonemave në pozicione të ndryshme si edhe përcaktimin e vendit të theksit në fjalë.

Drejtshqiptimi mbështetet në shqiptimin më të përgjithshëm letrar dhe jo te shqiptimet e veçanta dialektore. Midis drejtshqiptimit dhe drejtshkrimit të gjuhës shqipe ekziston një lidhje e ngushtë; ata ndikojnë te njëri-tjetri.

Normat e drejtshqiptimit kanë për trajtën e folur të gjuhës standarde po atë rëndësi që kanë normat e drejtshkrimit për trajtën e shkruar të saj. Në

²⁹⁰ Anastas Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 235-236.

fazën e sotme sfera e përdorimit të gjuhës letrare të folur është zgjeruar shumë, prandaj krahas nevojës për vendosjen e normave drejtshkrimore shtrohet edhe nevoja për vendosjen e normave të njëjta drejtshqiptimore.

Drejtshqiptimi është pjesë e kulturës së të folurit dhe pjesë e pandashme e normave të gjuhës letrare. Edhe rregullat e drejtshqiptimit, si edhe ato të drejtshkrimit, kanë vlerë praktike shoqërore. Rëndësia e shqiptimit të njëjtë në shoqëri rritet krahas me sasinë e përhapjes së fjalës publike, domethënë të shkollës, radios, televizionit, mbledhjeve, konferencave, teatrit etj. Të gjitha këto forma, ku paraqitet fjala e gjallë, kërkojnë që fjalët të shqiptohen sipas rregullave të gjuhës standarde që të kapen e të kuptohen me lehtësi nga mijëra e qindra mijëra dëgjues.²⁹¹

Vendosja e normave të njësuara kombëtare bëhet në të gjitha hallkat e sistemit të gjuhës letrare; por, ndërsa për gjuhën e shkruar shqipe pas shumë përpjekjesh dhe pas një pune të vijueshme u arrit që të vendosen e të zbatohen nga të gjithë rregulla të njësuara, që pasqyrohen në “Drejtshkrimin e gjuhës shqipe”, në gjuhën e folur normat e shqiptimit letrar po vendosen e po përgjithësohen më ngadalë. Në krahasim me njësimin e shkrimit, njësimi i shqiptimit arrihet më vonë. Ai është një proces i gjatë dhe i ndërlikuar.

Normat e shqiptimit letrar përgjithësisht janë përcaktuar, megjithëse në hallka të veçanta të tij, vihen re disa lëkundje. Ende nuk kemi një vepër kodifikuese të drejtshqiptimit,²⁹² siç nuk e kanë edhe disa gjuhë të tjera, si p.sh. maqedonishtja. Rregullat themelore të drejtshqiptimit janë paraqitur në tekstet universitare të *Fonetikës së gjuhës shqipe* (A. Dodi, Prishtinë, 1970 dhe A. Dodi – J. Gjinari (maket), Tiranë, 1983, A. Dodi, Tiranë, 2004); në doracakun *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, Tiranë, 1976; në librat e Rami Memushajt, *Fonetika e shqipes standarde*, Tiranë, 2009; *Shqipja standarde – si ta flasim dhe ta shkruajmë*, Tiranë, 2017; Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005; 2011, 2020) etj. Megjithëkëtë, detyra e vënë nga Kongresi i Drejtshkrimit për hartimin e *Rregullave të drejtshqiptimit* ka mbetur pa u përmbushur.

Problemet e gjuhës letrare të folur kanë lidhje shumë të ngushtë me kushtet shoqërore të folësve. Zhvillimi i gjuhës dhe zgjerimi i funksioneve të saj varen në një shkallë të madhe nga shkalla e zhvillimit të vetë shoqërisë, i shkencës, kulturës dhe teknikës. Formimi i kombit lidhet ngushtë me krijimin e shtetit kombëtar dhe të gjuhës letrare. Disa popuj kanë pasur fatin që në periudhat e hershme të krijojnë shtetin e vet, ndërsa shqiptarët arritën të formojnë në shekullin e njëzet (më 1912) një shtet në gjysmën e përhapjes së shqiptarëve. Ata që nuk u përfshinë brenda kufirit të Shqipërisë patën kushte më të pavolitshme gjuhësore sesa ata që mbetën brenda kufijve. Historia e zhvillimit të shqiptarëve dhe e gjuhës letrare shqipe përbën një shembull, ku

²⁹¹ Anastas Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 210.

²⁹² Emil Lafe, *Gjuha e medias sot – probleme dhe detyra*, Gjuha jonë 1-2/2000, Tiranë, f. 13.

duken qartë ndikimi i fuqishëm i faktorëve shoqërorë mbi fatet e gjuhës letrare.

Ashtu si edhe në vendet e tjera, kryeqyteti, si qendra më e rëndësishme ekonomike-politike dhe kulturore, gëzon një prestigj të njohur lidhur me përhapjen e modelit të gjuhës së folur. Por, edhe në gjuhën e kryeqytetit vihet re edhe komponenti gjysmëdialektor ose dialektor. Siç dihet, Tirana ndodhet në arealin e të folmeve geqe, por që kur u caktua kryeqytet, më 1920, popullsia e saj filloi të përzihej edhe me banorë të ardhur nga jugu. Duke pasur popullsi të përzier prej krahinash të ndryshme, Tirana ka shërbyer dhe do të shërbejë si një fonderi, ku shkrihen dhe marrin formë edhe tiparet e gjuhës standarde të folur. Ajo shërben si një qendër për rrezatimin e normës letrare.²⁹³

Standardi i drejtshqiptimit po arrihet më fort në mënyrë të vetvetishme, duke lënë mënjanë tiparet dialektore, duke e zhveshur formën e folur të gjuhës letrare jo vetëm nga karakteristikat fonetike të dialekteve, po edhe nga timbri dallues i të folmeve.

Normat e shqipes standarde. Ndër veçoritë kryesore të gjuhës standarde është karakteri normativ. Kjo do të thotë që, ndër disa fjalë a trajta fjalësh me të njëjtin kuptim, njëra prej tyre zgjidhet si normë dhe bëhet e detyrueshme për t'u përdorur prej gjithë folësve. Për shembull, e pakryera e foljeve del me trajta të ndryshme dialektore: *shkonja, shkoja, shkonjam* (në toskërishte); *shkojsha, shkojshna* (në gegërishte); por është ngritur në normë forma *shkoja*.²⁹⁴

Me normë duhet kuptuar jo vetëm trajtat, fjalët, ndërtimet dhe gjedhet fjalëformuese e sintaksore më të përhapura që janë të detyrueshme për t'u përdorur nga gjithë folësit e një gjuhe, por edhe rregullat për përdorimin e tyre. Tërësia e rregullave për normat e një fushe të gjuhës përbëjnë një kod normativ. Kode të tilla janë: "Drejtshkrimi i gjuhës shqipe", "Rregullat e pikësimit në gjuhën letrare shqipe" etj. Çdo nënsistem i gjuhës ka normën e vet letrare, apo kodin e vet. Kështu, në çdo gjuhë standarde veprojnë norma fonetike, norma morfologjike, norma sintaksore dhe norma leksikore.²⁹⁵

Shqiptarët sot janë një komb, që kanë një histori, një kulturë dhe një gjuhë standarde. Norma gjuhësore, nga pikëpamja e detyrimit për t'u zbatuar, mund të ndahet në dy grupe:

a) **norma kategorike** (të detyrueshme), që paraqiten si varianti i vetëm normativ,

b) **norma të këshillueshme**, kur ka më shumë se një variant të lejueshëm ose të pranueshëm.

²⁹³ Anastas Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 211-212.

²⁹⁴ Rami Memushaj, *Shqipja standarde – si ta flasim dhe ...*, f. 17, 42.

²⁹⁵ Vepra e cituar, f. 43.

E detyrueshme është p.sh. norma drejtshkrimore (fjala *rresht* duhet të shkruhet kështu e vetëm kështu, as *rrjesht*, as *resht*; forma normative janë *kam shkruar*, *shkrova* dhe jo *kam shkruajtur*, *shkrojtur*, *shkruajta* etj.). Në fushën e leksikut norma nuk është tërësisht kategorike (ka sinonime, ka fjalë që sot janë pak të njohura, por nesër bëhen të mirënjohura, ka fjalë të huaja që duket sikur e kanë fituar të drejtën e qytetarisë, ka neologjizma të qëlluar etj.). Në këtë fushë lëvizja është e vijueshme dhe veprat normative nuk kanë fuqi të plotë kodifikuese si drejtshkrimi ose si gramatika.²⁹⁶

10.6. SHKAQET E THYERJES SË NORMËS GJUHËSORE

Thyerja e normës ka shumë shkaqe. Gabimet rrjedhin ngaqë nuk njihen rregullat drejtshkrimore dhe fjala shkruhet sipas shqiptimit vetjak të individit. Ata që pohojnë pamjaftueshmërinë e strukturës dhe varfërinë leksikore të shqipes standarde, në të vërtetë nuk e njohin atë dhe parapëlqejnë një arsytim të tillë vetjak.

Problemet që lidhen me drejtshkrimin janë jo vetem pasojë e një mosangazhimi personal të individit, por kjo vetëdije e ulët gjuhësore vjen edhe si pasojë e shumë faktorëve të tjerë që kanë të bëjnë edhe me programin shkollor, sa vend zënë problemet drejtshkrimore e zbatimi praktik i shqipes në programet e në tekstet shkollore etj. Përveç padijes e injorancës, ndër shkaqet kryesore të thyerjes së normës së shkrimit dhe të shqiptimit letrar janë:

- a) *veçoritë dialektore të folësit,*
- b) *ndikimi i gjuhëve të huaja në leksikon dhe në gramatikën e folësve,*
- c) *ligjërimi i shkujdesur, dhe*
- ç) *shqiptimi shkronjë për shkronjë i fjalëve të shkruara.*

Për gjendjen e sotme të shqipes standarde shkaku i parë përbën problemin kryesor për vendosjen e normave të drejtshqiptimit dhe paraqet vështirësi më të mëdha për t'u kapërcyer.

Veçoritë dialektore të shqiptimit folësi zakonisht i mëson që në fëmijëri, prandaj duhet një punë e gjatë dhe këmbëngulëse për të shmangur ato dhe për të përvetësuar shprehitë e shqiptimit letrar. Te shumica e shqiptarëve ndihet nënshtresa e së folmes krahinore; mjerisht disa as që bëjnë përpjekje për të njohur e zbatuar rregullat e shqiptimit letrar.²⁹⁷ Pas Kongresit të Drejtshkrimit (1972) e deri më tani u pa shumë qartë se si gjuha standarde shqipe, sidomos në formën e saj të folur, shkon në dy kahe afërsisht sipas dy arealeve të ditura dialektore: njëra, arealja gege, mëton ta zbatojë gjuhën letrare, porse me një ngjyresë fonike gegizuese (p.sh. shqiptimi i /ë/-së si /ê/: *bêj*, *nê:n*, *bêra*, *rêra*, *zêri* etj.); tjetra, arealja toske, që nuk kënaqet me ndonjë “qethje” sado të pjesshme të bëra nga “Rregullat e drejtshkrimit”, tërheq nga

²⁹⁶ Emil Lafe, *Gjuha e medias sot – probleme dhe ...*, f. 11.

²⁹⁷ Emil Lafe, *Po aty*, f. 15.

hipertoskizmi (p.sh. shqiptimi me [ë] të prapme i fjalëve me [e]: *vënt, kuvënd, mëndje, mëndoj, qëndër, fëmër, zëmër* etj).²⁹⁸

Përvetësimi i përbërjes fonematike të gjuhës standarde paraqitet më i vështirë sesa përvetësimi i formave morfologjike. Larmia e ndryshme tingullore e fonemave nëpër të folmet shqipe e ka lënë ende të papërcaktuar si duhet drejtshqiptimin e shqipes. Si përfundim, për fazën e sotme të shqipes standarde, timbret dialektore në realizimin e fonemave cilësohen si të tolerueshme, ndërsa mungesa e fonemave të caktuara është e papranueshme. Disa nga rregullat e drejtshkrimimit dhe të drejtshqiptimit të varianteve themelore të zanoreve e të bashkëtingëlloreve si dhe të togjeve të tyre do të paraqiten në krerët përkatës.

Shpeshherë hetohen edhe shkelje të normës gramatikore (morfologjike e sintaksore). Si p.sh., emrat e huaj vetjakë, si *Klinton, Ollbrajt, Bler* etj. po përdoren në formë të ngurosur, edhe pse funksioni i tyre sintaksor kërkon që të jenë në formë të caktuar rasore dhe në trajtën e shquar: *u takua me Klintonin*; përdorimi i formës së shumësit pa /ë/ fundore, si *shqiptar* (në vend *shqiptarë*), *arsimtar* (në vend *arsimtarë*) etj.; në vend të përemrave vetorë *ne, ju* përdoren trajtat e tyre të dhanores *neve, juve* (*neve* kemi punuar, *juve* jeni të zellshëm); gabime në përdorimin e nyjës së rasës gjinore: Ministri i Punëve të jashtme të Maqedonisë (në vend *i* Maqedonisë); përdorimi i kohës së ardhme pa pjesëzën të (*do lexoj, do punoj*; në vend *do të lexoj, do të punoj*); ndikime të sintaksës së huaj në ndërtimin e fjalive dhe të periudhave; përdorimi i panevojshëm i periudhave të gjata e të ndërlikuara, ku përshtjellohet mendimi deri në moskuptim; përshtatja e gabuar e fjalëve përcaktuese me emra mashkullorë që e formojnë shumësin me *-e* dhe *-ra* etj.

Shkelje të normave të shqipes standarde paraqet edhe përdorimi i panevojshëm i fjalëve të huaja. Siç dihet, varësisht nga shtrirja gjeografike, përkatësia administrative nëpër disa shtete ballkanike, kontakti shumëshekullor përfshirë lidhjet historike, ekonomike, kulturore me gjuhë të tjera etj., ka laramani sasiore të huazimeve leksikore nëpër të folmet shqipe. Thënë ndryshe, si në shqipen me vazhdimësi tokësore e gjuhësore, ashtu edhe në shqipen e diasporës diku ka më pak e diku më shumë fjalë të huaja: greke, turke, sllave, neolatine etj.

Disa nga këto fjalë të huaja janë mishëruar thellë në të folmet dialektore, kanë përhapje të përgjithshme në tërë shqipen dialektore. Një numër i konsiderueshëm fjalësh të tilla janë bërë edhe pjesë e leksikut të gjuhës standarde shqipe. Këto më vështirë zëvendësohen me fjalë të shqipes, edhe pse ekziston një mundësi e tillë. Por, ka edhe të tilla që kanë përhapje të ngushtë territoriale (në një krahinë, në një grup të folmesh, në disa të folme, në një të folme). Fjalët e këtilla nuk janë të pranueshme për normën leksikore letrare. Përveç ndikimit të vijueshëm të italishtes (*sidomos* në Shqipëri), kohët

²⁹⁸ Gjovalin Shkurtaç, *Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi në mediat e sotme të shkruara dhe të folura*, Gjuha jonë 1-2/2000, Tiranë, 2000, f. 39.

e fundit në shqipen letrare vërehet një ndikim gjithnjë e më i madh i anglishtes. Rritja e numrit të fjalëve angleze dhe në përgjithësi e fjalëve të huaja është thyerje e normës leksikore e stilistikore të shqipes.²⁹⁹ Parimisht, sa më pak fjalë të huaja të përdorim në ligjërimin tonë, do të ishte aq më mirë.

Për ta parandaluar përmbytjen e shqipes me fjalë e me gjedhe të huaja, duhet të kushtrimohen të gjithë përdoruesit e kësaj gjuhe, në radhë të parë gazetarët, publicistët, shkrimtarët, shkencëtarët, profesorët, arsimtarët, studentët, nxënësit etj., që t'u vënë pritë fjalëve të huaja të panevojshme dhe formimeve të tjera të çoroditura... Në shqipen e sotme të intelektualizuar veprojnë dy forca çekuilibruese: folësi ka prirje të përdorë sa më shpesh fjalë të huaja dhe të përsërisë të njëjtat fjalë, kurse dëgjuesi si rregull i përgjithshëm, kërkon qartësi sa më të madhe dhe variacion sa më të madh të fjalorit.

Ligjërimi i shkujdesur është karakteristik për ligjërimin bisedor, d.m.th. për të folurit e rëndomtë, kur shqiptimit i kushtohet më pak vëmendje a flasim në mënyrë të shkujdesur. Në këtë stil tingujt shpeshherë rrëgjohen, shkurtohen, shkrihen, ndërrohen me ndonjë tingull tjetër apo nuk shqiptohen fare. Për qëllime të caktuara stilistike (për individualizimin e personazheve), përdoret në raste të veçanta shqiptimi i të folmes së personazhit, ai krahinor a dialektor.

Shkaku tjetër i shmangies nga shqiptimi letrar lidhet me shkrimin. Mendimi se shqiptimi i drejtë përputhet plotësisht me shkrimin dhe rregullat e tij drejtshkrimore nuk është i drejtë. Shkrimi dhe shqiptimi kurrë nuk përputhen në mënyrë absolute. Siç dihet, drejtshkrimi i gjuhës sonë, përveç parimit fonetik, sipas të cilit fjalët shkruhen siç shqiptohen, mbështetet edhe në parimin morfologjik e historik, kështu që shkrimi nuk përputhet gjithnjë me shqiptimin. P.sh., sipas rregullave të drejtshkrimit shkruajmë *pjesëtoj, ditëlindje, dhjetëvjetor, kallëzot, kallëzore* etj., por zanoren [ë] të këtyre fjalëve zakonisht nuk e shqiptojmë. Drejtshkrimi i [ë]-së në këto raste mbështetet në parimin morfologjik dhe historik-tradicional.

Nga ana tjetër, të gjitha zanoret, pa marrë parasysh a janë në pozitë të theksuar a të patheksuar, shkruhen njësoj; por ato nuk shqiptohen njësoj. Dihet se zanoret e patheksuara nyjëtohen të rrëgjua në gjatësi dhe në cilësi. Por edhe te të tillat ka dallim: nga të gjitha zanoret e patheksuara të shqipes rrëgjim më të madh në gjatësi pëson [ë]-ja. Ky rrëgjim shkon gjer në zhdukjen e saj të plotë në shqiptim. P.sh. [ë]-ja e patheksuar fundore dy rrokje larg theksit në shqipen e sotme nuk shqiptohet. Këtë dukuri e ka pasqyruar edhe Drejtshkrimi, që ka vendosur të shkruhet *i hekurt* (por i gurtë), *i katërt* (por i dytë), *pjesëz* (por vezë) etj. Nuk dëgjohet <ë>-ja as në shqiptimin letrar në fjalët e përbëra dhe të përngjitura, si *botëkuptim [botkuptim], pikëpamje [pikpamje], mirëdita [mirdita], mirëmëngjes [mirmëngjes], bukëpjekës [bukpjekës]* etj.,

²⁹⁹ Hajri Shehu, *Rreth anglicizmave në mjetet e sotme të informimit masiv*, Studime filologjike nr. 3-4, 2002, Tiranë, f. 92-100

megjithëqë drejtshkrimi ndjek parimin morfologjik, d.m.th. i ruan format e fjalëve edhe gjatë bashkimit të tyre për formimin e një fjale të re.

Edhe në disa raste të tjera drejtshkrimi i <ë>-së mbështetet në parimin historik-tradicional. Fjalëformat drejtshkrimore të tilla si *dëllir, këqyr, kërrus, bërryl* etj., nga pikëpamja e normës së sotme të shqiptimit janë historike. Këtu do të përfshiheshin edhe emra të tillë si *atë* (ati), *ballë, djalë, kalë, dyllë, drithë, brumë* etj., ku <ë>-ja fundore nuk dëgjohet fare as në shqiptimin letrar.

Fonema /ë/ në gjuhën shqipe ka shumë larmi timbresh, në rrokje të theksuar nuk e gjejmë në gegërishte, ndërsa në pozicion të patheksuar shtrihet në tërë arealin e shqipes. Në shqiptimin letrar është zanore e mesme gjysmë e hapur. Disa modifikime të saja të nyjetimit (pak më e hapur ose pak më e mbyllur) janë të lejueshme. Në shkrim, grafema <ë> sidomos fundore është një shenjë që tregon se zanorja e rrokjes para saj nuk duhet shqiptuar e shkurtër. Kështu, p.sh. shqiptimi i fjalës së shkruar <bukë> si *buk* (me [u] të shkurtër) cilësohet i papranueshëm, *bu.k* (me [u] të mesme) i tolerueshëm, ndërsa *buk^ë* do të përfaqësonte shqiptimin normativ.³⁰⁰

Për t'u shmangur leximi si një fonemë e vetme (/gj ose nj/), Drejtshkrimi kërkon që fjalët e këtij tipi të shkruhen me <i>, por shqiptohen me /j/, si p.sh.: *djegje* [djeg-je] *lagje* [lag-je], *biologia* [biolog-ja]; *kundërthënie* [kundërthënje], *parathënie* [parathënje], *shkupjania* [shkupjanja] etj. Edhe fjalët me prejardhje të huaj që kanë *-ia, -ie, -io, -iu* me /i/ të patheksuar në trup të tyre, shkruhen kështu, por shqiptohen përgjithësisht me *-ja, je, -jo, -ju*: *material* [materjal], *ambicie* [ambicje], *agresion* [agresjon], *studioj* [studjoj] etj.

10.7. PARIMET E PËRGJITHSHME TË DREJTSHKRIMIT TË SHQIPES

Është e njohur se drejtshkrimi i gjuhës shqipe mbështetet në dy parime kryesore, përkatësisht në:

- a) *parimin fonetik*, dhe në
- b) *parimin morfologjik*.

Marrë në përgjithësi, asnjë drejtshkrim i gjuhëve të botës nuk është plotësisht fonetik, morfologjik ose etimologjik. Çdonjëri, krahas elementeve mbizotëruese të një tipi të caktuar, ka edhe elemente të tipave të tjerë drejtshkrimorë. Natyra e drejtshkrimit të një gjuhe varet pikërisht nga parimi themelor.

Drejtshkrim fonetik sot ka shqipja, maqedonishtja, serbishtja, kroatishtja, sllovenishtja, italishtja, turqishtja etj. Drejtshkrimi i bullgarishtes është i përzier: ai është etimologjiko-fonetik. Drejtshkrimi i rusishtes është morfologjik; ndërsa frëngjishtja, anglishtja, gjermanishtja, greqishtja etj. kanë

³⁰⁰ Emil Lafe, *Shqipja standarde në vështrim strukturor ...*, f. 12.

drejtshkrim etimologjik. Sot përparësi ndaj tipave të tjerë ka drejtshkrimi fonetik, meqë mbështetet mbi shqiptimin bashkëkohor të gjuhëve. Me drejtshkrim fonetik ligjërimi i folur shkruhet më lehtë dhe ai përvetësohet më shpejt.

Në shkrimin e shqipes standarde më shumë zbatohen parimi *fonetik* si dhe parimi *morfologjik*; ndërsa më pak parimi *historik-tradicional*. Parimi *fonetik* kërkon që fjalët dhe pjesët e tyre të kuptimshme të shkruhen ashtu si shqiptohen. Parimi *morfologjik*, i quajtur ndryshe *morfematik*, kërkon që të ruhet në shkrim njësia e morfemave në të gjitha rastet e përdorimit të tyre. Parimi *historik-tradicional*, ose *etimologjik*, nënkupton ruajtjen e mënyrës tradicionale të shkrimit, ndonëse shqiptimi është larguar mjaft prej tij, d.m.th. sot fjalët nuk shqiptohen më ashtu siç shkruheshin dikur.³⁰¹

Dy parimet e para ndonjëherë i kundërvihen njëri-tjetrit, por në shkrimin e shumë fjalëve përputhen e bashkëveprojnë, duke synuar që drejtshkrimi të jetë sa më sistemor e i qëndrueshëm dhe sa më i thjeshtë. P.sh. shkrimi i fjalëve si *lis, njeri, mal, gur, diell, lexoj, punoj, i ri, dal...* dhe mijëra fjalëve të tjera, që mbështen në shqiptimin, ndjek jo vetëm parimin fonetik, por edhe parimin morfologjik, sepse të dy parimet në fjalët e këtilla bashkëpërputhen.

Përveç këtyre parimeve kryesore, në drejtshkrimin e shqipes, ashtu si në drejtshkrimin e gjuhëve të ndryshme, ndiqen edhe parime të tjera ndihmëse, si parimi *semantik*, që zbatohet në shkrimin e fjalëve njësh, ndaras ose me vizë në mes; dhe parimi *simbolik*, në të cilin mbështetet përdorimi i shkronjave të mëdha.

1. Parimi fonetik. Parimi themelor i drejtshkrimit të shqipes është parimi fonetik: në përgjithësi fjalët dhe pjesët e tyre të kuptimshme shkruhen ashtu si shqiptohen në ligjërimin letrar. Pra, fonetik është drejtshkrimi që për çdo tingull themelor – fonemë ka një shkronjë të veçantë (të thjeshtë ose të përbërë), d.m.th. shkruhet ashtu siç flitet në ligjërimin letrar dhe lexohet ashtu siç është shkruar.

Parimi fonetik synon vendosjen e një lidhjeje sa më të ngushtë midis trajtës së shkruar dhe trajtës së folur të gjuhës letrare. Prandaj, kur në shqiptimin letrar ka variante të lejuara nga norma e sotme, drejtshkrimi mbështetet tek ajo trajtë që është më e përgjithshme dhe që pajtohet me prirjen e zhvillimit të sistemit fonetik të shqipes letrare.

Parimi fonetik zbatohet dendur edhe gjatë trajtëformimit, duke thyer parimin morfologjik në shumë raste, sidomos në rënien e <ë>-së në lakimin e emrave dhe të mbiemrave që mbarojnë me *-ël, -ër, -ërr* dhe të emrave që mbarojnë me *-izëm, -azëm*, kur pas këtyre fundoreve vjen një zanore. Në këtë rast [ë]-ja bie, kështu që e njëjta morfemë nuk shkruhet gjithnjë njëlloj, nuk ruhet njëtrajtshmëria grafike e saj, si p.sh.: *dimër - dimr-i, dimr-it, dimr-in;*

³⁰¹ Rami Memushaj, *Shqipja standarde – si ta flasim dhe ta shkruajmë*, Infbotues, Tiranë, 2017, f. 134.

vjehërr - *vjehërr-i, vjehërr-it, vjehërr-in*; i vogël - *të vogël-i, të vogël-it, të vogël-in* etj.; në drejtshkrimin e fjalëve të prejardhura: *vepër - veprim, letër - letrar, i sotëm - e sotme, natyrë - i natyrshëm*; te përemrat e pacaktuar, ndajfoljet dhe lidhëzat e përngjitura: *gjithë - gjithçka, kurrë - kurrfarë, kurrgjë*; te fjalët e përbëra të tipit *bashkë+autor - bashkautor*; gjatë fjalëformimit, veçmas në shkrimin e tri varianteve fonetike të të njëjtës parashtesë *sh-/zh-/ç-*: *shfaqje, shfaqjesoj, zhdëmtoj, çlodhem; s-/z-*: *skuq, zbardh* etj.³⁰²

2. Parimi morfologjik. Krahas parimit fonetik, drejtshkrimi i njësuar i shqipes mbështetet gjerësisht edhe në parimin morfologjik. Parimi morfologjik kërkon që morfemat (rrënjët, parashtesat, prapashtesat, mbaresat) të shkruhen gjithnjë njëlloj, pavarësisht se mund të shqiptohen ndryshe për shkak të ndërrimeve pozicionale dhe kombinatore të fonemave. Ndërsa parimi fonetik përafrohet shkrimin me shqiptimin letrar, parimi morfologjik ruan në shkrim strukturën morfologjike të fjalës. P.sh. shkruajmë *pjesëtim* (pjesë+tim), *përpjesëtim* (për+pjesë+tim), sepse shkruajmë *pjesë* (me <ë> fundore); shkruajmë *gjellëtore* (gjellë+tore), sepse shkruajmë *gjellë* (me <ë> fundore). Në këto raste zbatohet parimi morfologjik, sepse e njëjta morfemë në fjalë të ndryshme grafikisht paraqitet njëlloj, pavarësisht nga shqiptimi.³⁰³

Parimi morfologjik zbatohet kryesisht në ato raste, kur zbatimi i veçuar i parimit fonetik do të çonte në errësimin a në prishjen e strukturës morfologjike e fjalëformuese; ai ndihmon kështu për ta ruajtur sa më të qartë në shkrim këtë strukturë, si edhe njësinë e trajtave. Duke pasur si bazë analogjitë morfologjike, parimi morfologjik lejon rrafshimin e thjeshtimin sa më të madh të rregullave drejtshkrimore të shqipes dhe ndihmon që këto rregulla të pasqyrojnë në mënyrë sa më organike zhvillimin e bashkëlidhur të strukturës fonetike, morfologjike e fjalëformuese të shqipes. Bie fjala, parimi morfologjik zbatohet në drejtshkrimin e formave rasore të emrave të gjinisë mashkullore, që e formojnë shumësin me *-ë*; tema e shumësit me *-ë* ruhet në të gjitha format rasore, paraqitet grafikisht njëlloj, pavarësisht se *-ë*-ja në rrokje të hapur të patheksuar zakonisht këtu nuk shqiptohet: *fshatar - fshatarë - (i, e) fshatarëve, fshatarësh*; shkrimi i *ë*-së fundore në vetën e parë dhe të tretë shumës të dëftores dhe të lidhores: *(të) punojmë, (të) punojnë*; dallimin e vetës së parë nga veta e tretë e lidhores: *(unë) të punoj - (ai, ajo) të punojë* etj.

3. Parimi etimologjik (historik-tradicional). Etimologjik është ai drejtshkrim që pasqyron format gjuhësore të së kaluarës. Parimi fonetik dhe parimi morfologjik, që janë mbizotërues në drejtshkrimin e shqipes, plotësohet edhe nga *parimi etimologjik*, apo siç quhet ndryshe edhe parimi *historik-tradicional* etj. Fusha e zbatimit të këtij parimi është më e ngushtë. Fjalët e shkruara sipas parimit tradicional a historik bazohen: 1) në traditën e shkrimit të gjuhës shqipe të periudhave të mëparshme dhe 2) në disa raste në drejtshkrimin e gjuhëve nga janë huazuar fjalët.

³⁰² Anastas Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 240-241.

³⁰³ Po aty, f. 251.

Parimi tradicional zbatohet në drejtshkrimin e disa fjalëve të veçanta, të tilla si: *dëllir; i, e dëllir, këqyr, mbikëqyr, bërryl, gërryej, kërrusem, kërrabë, tëharr, tëholl* etj. Në këto raste, megjithëse ë-ja është në rrokje të parë, në shqiptimin letrar nuk dëgjohe më. Drejtshkrimi i këtyre fjalëve pasqyron traditën e shkrimit dhe shpjegohet me historinë e gjuhës. Ky parim zbatohet edhe në shkrimin e emrave të gjinisë mashkullore (dikur shumica të gjinisë asnjane) që shkruhen me -ë fundore, të tipit: *atë, ballë, burrë, djalë, kalë, lumë, lëmë*. Megjithëse sot këta emra përdoren vetëm në gjininë mashkullore dhe shqiptohen pa -ë fundore, drejtshkrimi i tyre me -ë është ruajtur kryesisht në saje të traditës.

Po kështu, sipas parimit etimologjik me -ë fundore shkruhen edhe një kategori emrash të gjinisë mashkullore, që tregojnë lëndë: *brumë, djathë, drithë, dyllë, dhallë, dhjamë, gjalpë, mjaltë, ujë* etj. Këta emra kanë qenë të gjithë të gjinisë asnjane, por sot përdoren kryesisht në gjininë mashkullore. Në shqiptimin letrar ë-ja fundore këtu nuk shqiptohet, megjithatë drejtshkrimi ka ruajtur traditën e shkrimit të tyre me <ë>.

Mbështetet në parimin tradicional a historik drejtshkrimi i fjalëve me prejardhje të huaj kur ato kanë grupet e zanoreve -ia-, -ie-, -io-, -iu- të patheksuar në trup të tyre ose po të njëjtat grupe zanoresh me theks mbi zanoren e dytë. Grupet e tilla zanoresh shkruhen me -i-: *australian, diagonale, financier, imperialist, material, materie, aksion, bankier, malarie, kamion*; por shqiptohen me -j-: -ja-, -je-, -jo-, -ju-: *australjan, djagonale, financjer, impejalist, materjal, materje, aksjon, bankjer, malarje, kamjon* etj. Ky parim zbatohet edhe te fjalët që janë huazuar nga gjuha latine ose nga gjuhët neolatine dhe që në këto gjuhë kanë -rr-, të cilën e kemi ruajtur edhe në drejtshkrimin e shqipes, si: *territor, terracë, korrelacion, korrespondencë, irracional*; megjithëse -rr-ja në një numër fjalësh shqiptohet -r-. Kështu, pavarësisht nga shqiptimi, në raste të tilla ruhet drejtshkrimi me <rr> i gjuhëve nga janë huazuar fjalët.³⁰⁴

Duke u mbështetur në shqiptimin e sotëm, për të njëzuar shqiptimin me shkrimin, mendojmë se më fatlume do të ishte të heqim dorë nga parimi historik i shkrimit të disa fjalëve me <rr> dhe të pranojmë për normative format me <r> të disa huazimeve kryesisht nga gjuhët romane: jo *territor, korridor, korrigjoj, terracë, korrespondencë* etj., por *teritor, koridor, korigjoj, teracë, korespodencë* etj.³⁰⁵

³⁰⁴ Anastas Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 256-258.

³⁰⁵ Asllan Hamiti – Ajten Qamili, *Shtrirja dialektore e fjalës dhe përzgjedhja e formës normative*, Konferenca Shkencore Mbarëshqiptare “Shqipja në etapën e sotme dhe politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit”, Durrës, 15-17 dhjetor 2010.

10.8. PARIMI FONETIK DHE MORFOLOGJIK BASHKËVEPROJNË

Përgjithësisht mbizotëron mendimi se parimi fonetik zbatohet më shumë sesa parimi morfologjik në shkrimin e shqipes. Ky konstatim mbështetet nga të dhënat sasiore që nxjerr prof. Androkli Kostallari nga analiza që i bëri “Fjalorit të gjuhës shqipe” të vitit 1954. Sipas tij, 76,7% e fjalëve të këtij fjalori shkruhen sipas parimit fonetik, ndërsa 23,2% sipas parimeve të tjera (parimit morfologjik e historik-tradicional).

Për gjendjen e sotme, është e pamundur të përcaktohet me saktësi matematikore sa fjalë në shqipen shkruhen sipas parimit fonetik, sa sipas parimit morfologjik e sa fjalë sipas parimit etimologjik për shumë arsye: pasuria leksikore e shqipes është e pafundme, ajo ndryshon vazhdimisht në rrjedhë të kohës; pjesët e ndryshueshme të ligjëratës shfaqen në shumë forma (emri në 8 e folja në 251 forma paradigmatiche); në shkrimin e shumë fjalëve bashkëpërputhen të dy parimet (ai fonetik e morfologjik) etj.

Në shqipen shumë fjalë shkruhen sipas parimit fonetik, por edhe sipas parimit morfologjik. Te një sasi e madhe fjalësh të dy parimet bashkëpërputhen. P.sh.:

- a) *shkruhen sipas parimit fonetik*: lis, laps, shok, njeri, libër, nxënës, student, fakultet, besim, mosbesim, gjysh, stërgjysh, punoj, mësoj, miredukoj, zejtari, arsimtar, vazhdimisht, gjysmanalfabet, përjetoj, kundërajror, zemërhapur, parashkollor, juglindje, kryetar, shqiptar, kryeqytet, kompjuter, fletarrest etj.
- b) *shkruhen sipas parimit fonetik në përputhje edhe me parimin morfologjik*: përjetoj, paramendim, parashikoj, duhanpirje, paqeruajtje, brenda-shkruaj, paradreke, parapëlqej, pushtetmarrje, drugdhendje, bregdet, grushtshtet, planveprim, ligjhartues, qytetpushtues, keqdrejtoj, i suksesshëm, bindshmëri, katërkubikësh, projektprogram, kryekujdestar, mendjeçiltër, radiotaksi, radiokomunikim, kryepolic, drugdhendje etj.
- c) *shkruhen sipas parimit morfologjik*: shkollë, mollë, aftësi, ujësjellës, gjellëbërës, mirëqenie, mirëdita, ditëlindje, mirëmbërës, gjellëbërës, luftënxitës, besnikëri, fletëvotim, farëveshur, botëkuptim, paraardhës-e, besëlidhje, pasdite, mesditë, abstrakt, absolut, ekzistoj, jashtëshkruaj, fletëdalje, frymëmarrje, fjalëformim, megjithëkëtë, paudhësisht, shumëfjalësi, i shumëfrytshëm, i mirëplanifikuar; baltëhedhje, fjalëmbajtje, punëdhënës, punëkërkues, projektplatformë, politikëbërës, i shumëçmuar, shumëdimensional, bashkëqeveris, keqmirëmbajtje, shumëmujo, fshehtësiplotë, dorëzgatje, çfarëdoqoftë etj.³⁰⁶

³⁰⁶ Rami Memushaj, *Sintetizmi si tipar i proceseve fjalëformuese në gjuhën shqipe*, në

Shqipja ka shkrim pothuajse fonetik, d.m.th. shumica e fjalëve shkruhen ashtu siç shqiptohen. Me fjalë të tjera, në shqipen shumicën e fjalëve i shkruajmë ashtu siç i shqiptojmë, duke e ruajtur edhe strukturën e morfematike të tyre: 36 tingujt themelorë (fonema) shënohen me 36 shkronja (grafema), sipas parimit “çdo fonemë me një grafemë dhe çdo grafemë vetëm për një fonemë.” Fjalët e tilla nuk përbëjnë vështirësi as drejtshkrimore e as drejtshqiptimore.

Vështirësi na paraqiten te fjalët ku nuk kemi përputhje të shqiptimit me shkrimin. Të tilla janë fjalët që shkruhen sipas parimit morfologjik dhe atij historik-tradicional. Fatmirësisht, as fjalëformat e shkruara me parimin morfologjik ose etimologjik nuk largohen shumë nga shqiptimi i sotëm letrar. Pra, shqiptimi nuk është larguar shumë nga shkrimi, siç ka ndodhur në shumë gjuhë të tjera, si në anglishten, gjermanishten, frëngjishten etj. Por, ka edhe gjuhë që kanë bashkëpërkim më të ngushtë sesa shqipja midis formës së folur dhe formës së shkruar: e tillë është maqedonishtja.

Në të vërtetë, nga kodifikimi shkrimor i shqipes tanimë kanë kaluar rreth 60 vjet, ndërsa shqiptimi brenda këtij gjysmëshekulli ka evoluar dukshëm, si rrjedhojë e ndryshimeve të reja gjeo-politike, ekonomike e kulturore të shqiptarëve. Hapja e kufijve të shteteve ballkanike ku jetojnë shqiptarët, takimet e komunikimi ynë i derjpdrejtë nëpërmjet teknologjisë informatike, biznesi, shkollimi, martesat krahinash të ndryshme, globalizimi si dhe shumë faktorë të tjerë sociolinguistikë sollën edhe zhvillime e ndryshime në gjuhë. Ndryshime vërehen në të gjitha nënsistemet gjuhësore: në fonetikë, në morfologji, në sintaksë e në leksik.

Pra, krahasuar me vitet e 70-ta të shekullit të kaluar me gjendjen e sotme, forma e folur e shqipes është ndryshuar dukshëm. Gjithnjë e më tepër edhe forma e folur e shqipes po shkon drejt konvergencës. Në këtë kuptim, shpeshherë, në ligjërimin e toskëve dëgjojmë paskajoren geqe, pjesore të reduktuar, monoftongimin e togjeve të zanoreve, forma shumësi tipike geqe e gegizma të tjerë; ndërsa në ligjërimin e gegëve tipare toske, si përdorimin e fjalëve me forma toske (vënt, kuvënt), përdorimin e grupit /ua/, folje në variantin toskë (punonja, do punoj) etj.

Dukuri e përbashkët ligjërimor e gjithë shqiptarëve, folësve gegë e toskë, është mosshqiptimi i /ë/-së së patheksuar (në fundin absolut të fjalës dhe në trup fjalësh, sidomos te fjalët e formuara me kompozim e përngjitje). Pikërisht mosshqiptimi i /ë/-së së patheksuar dhe ruajtja e saj në shkrim përbën hendekun më të madh ndërmjet formës së folur dhe formës së shkruar të shqipes së sotme. Rreth kësaj edhe thyhen shtizat ndër gjuhëtarë: të ruhet shkrimi i /ë/-së, pavarësisht se ajo tanimë nuk shqiptohet, apo drejtshkrimi të

ndryshohet që të pasqyrojë me besnikëri shqiptimin e sotëm. Më poshtë po sjellim disa fjalë të cilat /ë/-ja e patheksuar shkruhet, por nuk shqiptohet:





<i>shkruhet</i>	<i>shqiptohet</i>	<i>shkruhet</i>	<i>shqiptohet</i>
			
këmishë	[kmi:sh]	fjalëpakë	[fjalpak]
mushkëri	[mushkrí]	dorëmbarë	[dormba:r]
dërrasë	[drr:as]	pavarësisht	[pavarsisht]
anëtar	[anta:r]	bukëpjekës	[bukpjekës]
drejtësi	[drejtssi:]	punëtorë	[punto:r]
malësor	[malsor]	njëmbëdhjetë	[njëmbdhje:t]
bashkëpunoj	[bashkpunoj]	të rinjtë	[t'rinjt]

Tabela 22. Shkrimi e shqiptimi i disa fjalëve

10.9. Të shkruarit drejt nuk është transkriptim i të folurit

Mospërputhje të normave drejtshkrimore dhe drejtshqiptimore vërehen edhe në ndërlidhje fjalësh (sand'hi). *Gjuha e folur respekton fonetikën sintaksore*, duke i ndarë fjalët grupe-grupe, sipas ritmikës së fjalisë; ndërsa *drejtshkrimi respekton ndarjen morfologjike të fjalëve*. Gjatë lidhjes së fjalëve në fjali ose gjatë fjalëformimit disa fjalë bëhen të patheksuara (në-shtëpí), ndonjë shqiptohet me theks të dobët (*rrqtull* shtëpísë) e ndonjë me theks dytësor (bótë+kuptím=*botëkuptím*). P.sh. shkruhet *E mora librin për të lexuar*, ndërsa thuhet *Emora librin/përtëlexuar//* Kur hyjnë në lidhje të ngushtë me fjalë të tjera për të formuar një sintagmë, zakonisht fjalët shërbyese (parafjalët, lidhëzat, pjesëzat, nyjat, trajtat e shkurtra etj.) e humbin theksin (zanoret rrëgjohen) dhe lidhen me fjalën akcentogjene. Këtyre ndryshimeve u nënshtrohen edhe fjalët emërtuese. Khs. sintagmat *ai djalë [aidjalë]*, *im bir [imbir]*, *një lis [njëlis]*, *mish qengji [mishqengji]* etj.

Siç u tha edhe në këtë libër, gjatë shtjellimit të çështjeve të tërësisë theksore (unionit theksor), ndryshimet e fjalëve, që ndodhin në ligjërimin e gjallë, nuk pasqyrohen gjithnjë në gjuhën e shkruar. Si rrjedhim, gjuha e shkruar, duke synuar ngulitjen e normës, vepron si një frenues ndaj prirjes për ndryshime të fjalëve e sintagmave në gjuhën e folur, dhe rrjedhimisht, ruan të mos priset kufiri morfologjik i fjalëve. Për këtë mjafton të kihet parasysh se mosnjohësit e rregullave të shkrimit të shqipes (të pashkolluarit, gjysmanalfabetët) që në përgjithësi, shkruajnë sipas fonetikës sintaksore, duke i shkruar fjalët e sintagmat grupe-grupe (në tërësi shqiptimore e theksore), sipas ritmikës së fjalisë. Shkrimi i tillë është një lloj transkriptimi i të folurit.

Rrjetet sociale të komunikimit mbushullojnë me këtë substandard shkrimi, me tejbartjen (transkriptimin) e të idiolektit në formë të shkruar, zakonisht duke shkruar njësh fjalët sipas shqiptimit e unitetit theksor e jo me ruajtjen e nevojshme e të domosdoshme të kufirit morfologjik të fjalëve.

Për të sjellë shembuj se si po shkruajmë komente në Facebook, kopjova disa sosh dhe po i paraqesim në formën origjinale.³⁰⁷ Ky lloj shkrimi mund të quhet transkriptim i keq i idiolektit:

po mire qe ka ,por cfar duen,per asnise nuk vlejne,jemi mesuar ce 20 vite jemi qene ne pushtet por vetem korupsion dhe hajni,shqiptari nuk lufton per vendin e vete,por vetem per karike,mos te gezohemi se kemi aq ministra sepse jemi mesuar ,krejte jan ti futish menji thes dhe ti hudhish ne vardare se per kurxha nuk i vlejne popullit.

Oimadhizot ojloke ty tidhsht gjith temirat eatyre djelvetu turp jukoft.

Amoj nene e mjere fajin stakan nuset po djeme e tu po harrame e pacin ate qumeshte qe kan pire ke ti turpe tu vije se nane nuke te behet njeri gjalla ne bote po turpe te ken

ishalla un sjom nat list xhi zdo me ipa fjal me vend

jupas boe mire caste te kendshme

Po bash mir po bajn qe po qesin serjale se juve spo dojm meju pa kah boni selfie neper vashington more injoranta se poju duket qe keni be shum pun te madhe analfabeta politik!!!!

Kuepa at rast historik Selmanaj vall mospo thu per palen serbe se ju goditi si deshi vuqiqi heke ket edhe ket e qasje nujman mini shengenin neser qasje ntrepq e nkomuna serbe ju bini fyllit ndaqi surles tesh skeni ba veq pritni pak doshifni qfar pasoja do keni

Po rajoni duhet televiz lirshem edhe ekonomija Te jet po ne at nivel pse qysh po mendon ti je si aj kusha jot don met shku jeta tuj lecu vjersha si aj kusha jot

sjeni shku me diskutu njojen e Kosoves nga Serbijs se kishi pa qa ka pas ne valigje o i padishem

Kadal Shoq .En katun mjellin shume specia edhe jane njerz puntore .Nqoftse tka ra mi ndegju nje anektod "Gazi ma i madhe bohet kur tbin rasadi ".Ishalla kjo marrveshje ashte e mire edhe na kfill pak punt en Kosove .

Në shkrimet e dhëna pasqyrohen shumë gjëra: kultura e dobët e përgjithshme dhe ajo gjuhësore, gjuha e urrejtjes, moskuptueshmëria e disa teksteve etj. Në pikëpamje të normave gjuhësore në to hetohen gabime të mëdha drejtshkrimore, jo vetëm në shkrimin e fjalëve njësh dhe ndaras, por

³⁰⁷ Tekstet e dhëna u kopjuan më 07. 09. 2020 nga ora 15.00.

edhe në përdorimin e shkronjës së madhe, mospërdorimin e shenjave të pikësimit, mospërdorimin e /ë/-së etj., etj.

Kjo mënyrë e të shkruarit, pa respektuar kufirin morfologjik të fjalëve, sot përbën problemin kryesor në shkrimin e drejtë të shqipes. Kështu shkruajnë jo vetëm të paarsimuarit, por edhe jo pak nxënës të shkollave fillore e të mesme, disa studentë, analfabetë me diplomë e gjysmëintelektualë.

Shkruhet sipas parimit morfologjik dhe ruajtjes së kufirit të fjalëve::

<Bora gjithkund kishte mbuluar tokën, kafshët e egra nëpër mal silleshin të gjenin ndonjë send për të ngrënë. Një lepur i ri zemërak u ul nga mali në fushë dhe hyri në një pemishtë, ku gjeti të gjitha të mirat>.

Periodha e mësipërme lexohet me fjalë të lidhura grupe-grupe, duke i ndërliður fjalët në njësi shqiptimore e unitet theksor, si:

[Bóra gjithkúnd kishte mbulúar tókën/ káfshët e egra nëpër mál silléshin të gjénin ndonjë send për të ngrënë// Një lépur i ri zemérák u ul nga máli në fúshë dhe hýri në një-pemíshhtë/ ku gjéti të gjitha të mírat//]

Edhe përskaj rregullave të përgjithshme, grupimi i fjalëve në ligjërim nuk bëhet përherë njëloj. Siç modifikohen fonemat në fjalë, ashtu modifikohen edhe fjalët në fjali e fjalitë në periodha. Kjo varet nga shumë faktorë, veçmas nga ritmi i të folurit, qëllimi i thënies, theksi logjik, konteksti i ligjërimet etj. Shikuar nga ky këndvështrim, edhe fjalët në periudhën e dhënë nga folës të ndryshëm mund të ndërliður në fjalë fonetike (tërësi theksore) në mënyra të ndryshme.

Ndonjëherë, duke dashur të respektojë me korrektësi të tepruar formën e shkruar, ndonjë lexues nuk i respekton rregullat e tilla të fonetikës sintaksore, por bën shqiptim të fjalëpërfjalshëm, pa i bashkëliður si duhet ato në njësi më të mëdha, përkatësisht në tërësi theksore, togfjalësha, fjali.

10.10. SHQIPJA STANDARDE NUK TRASHËGOHET – MËSOHET

Nuk ka as gjuhë, as dialekte e as të folme të pasistemuara, të parregullta. Mendimi se gjuha e letërsisë artistike është varianti më i mirë i një gjuhe, se të gjitha varietetet e tjera janë të parregullta, jogramatikore e të pasistemuara nuk është i drejtë. Në të vërtetë, të gjitha format e shfaqjes së një gjuhe në hapësirë e në stile funksionale janë të mira, të drejta e të rregullta. Çdonjëra prej tyre ka sistem të mëvetësishëm dhe normat e veta të përcaktuara nga folësit.

Në çdo gjuhë ka laramani gjeografike, sociale e stilistike. Ato nuk janë gjuhë të veçanta, por, variante të ndryshme të një gjuhe të përbashkët. Dialektet janë dukuri shoqërore që shfaqen për shkak të ndryshueshmërisë territoriale të gjuhëve. Gjuha standarde është fryt i marrëveshjes mes një grupi njerëzish në një kohë dhe në rrethana të caktuara historike. Edhe gjuha dialektore dhe ajo standarde kanë varietetet e tyre. Dialektet shfaqen të larmishme nëpër vende të ndryshme, ndërsa gjuha standarde shfaqet e larmishme në ligjërime (të shkruar e të folur: në ligjërimin e shkujdesur, bisedor dhe në ligjërimin libror) dhe në stile funksionale (në stilin shkencor, shtetëror-administrativ, politiko-shoqëror, stilin e letërsisë artistike dhe në stilin fetar).

Siç dihet, gjuha standarde është mbikrahinore, varianti më i plotë, i përpunuar, i normuar dhe mbarëkombëtar, që shërben për të shprehur shkallën më të lartë të komunikimit, të civilizimit, të kulturës, të shkencës dhe të artit letrar. Ajo është bërthamë me strukturë të qëndrueshme, ndërsa realizimet e saj historike e të sotme janë variante. Variacioni është i nevojshëm për vetë ekzistencën e gjuhës.

Shqipja standarde nuk është variant i lindur i askujt. Për ta zotëruar atë, duhet ta mësojmë. Gjuhët e varietetet e të njëjtës gjuhë që i flet një individ ndahen në:

- a) gjuhë që trashëgohen nga prindërit (gjuhë amtare) dhe në
- b) gjuhë që mësohen me vetëdije (gjuhë të huaja).

Gjuhët në mjedise shoqërore (veçmas në familje) barten vetvetiu (spontanisht) brez pas brezi. Fëmija e përvetëson gjuhën që e dëgjon nga lindja e më vonë.³⁰⁸ Për ta mësuar këtë gjuhë a variant dialektor të prindërve nuk

³⁰⁸ Me përdorimin e tepruar të teknikës e të teknologjisë informatike (telefonave celularë e televizorit) edhe nga fëmijët, fjalët e para që i mësojnë e i thonë ata nuk janë të gjuhës amtare, por të anglishtes. Kam parë e dëgjuar disa fëmijë të tillë familjesh të pastra shqiptare që thonë jo shqip, po anglisht: *yes, no, apple, cirle* etj. Nëse prindërit e fëmijët nuk flasin përditë që nga lindja e gjatë rritjes, druaj se nuk do të dihet se cila është gjuhë amtare edhe kur dy prindërit janë shqiptarë e jetojnë në atdhe: gjuha e nënës apo ndonjë gjuhë tjetër që e dëgjon fëmija me orë të tëra në celular a televizor.

duhet shkollë e veçantë, sepse mësohet me të dëgjuar e me të folurit spontan. Çdo njeri lind në një pikë dialektore dhe trashëgon të folmen vendore apo variantin territorial të një gjuhe të caktuar. Ky variant i gjuhës i mësuar që nga lindja për njeriun është më i lehti, më i afërti, më i dashuri; përdorimi i të cilit nuk kërkon angazhim të madh mendor. Edhe ata që nuk dinë shkrim-lexim flasin shkëlqyeshëm në gjuhën e nënës, në gjuhën e parë, në gjuhën e zemrës.

Në dallim nga përvetësimi i variantit dialektor (gjuhës së nënës), varianti i shqipes standarde si dhe gjuhët e huaja mësohen. Varianti i shqipes standarde është mbikrahinor, d.m.th. askush nuk e trashëgon nga nëna që nga lindja. Përvetësimi i shqipes standarde, si edhe i çdo gjuhe tjetër standarde, në njëfarë mënyre ngjan me mësimin e gjuhës së huaj.

Në këtë kuptim, të gjithë ne jemi folës të ndonjë të folmeje, andaj me vetëdije duhet të përpiqemi ta mësojmë dhe ta zbatojmë çdo gjë që shqipja standarde dallon nga e folmja jonë. Gjuhëtarët pohojnë edhe se **“gjuha letrare (standarde) nuk është gjuhë amtare³⁰⁹ e askujt”**, andaj gjithë folësit e saj gjenden në pozitë të njëjtë (të barabartë). Në rastin e shqipes, meqë baza dialektore e shqipes standarde është toskërishtja, del se folësit toskë e kanë më të lehtë ta përvetësojnë shqipen standarde sesa gegët. Vështirësi më të mëdha në përdorimin praktik të shqipes standarde (në formën e folur dhe të shkruar) kanë folësit e nëndialektit të gegërishtes veriore sesa folësit e gegërishtes jugore.

Megjithëkëtë, ka toskë që nuk e ka zotëruar shqipen standarde, që ka mbetur në kuadrin e të folmes vendore; por edhe gegë që flasin e shkruajnë për lakmi në standard. Kjo nuk mund të shpjegohet me pak fjalë, por kujtojmë se përvetësimi dhe zbatimi i standardit është tregues i shkallës arsimore e kulturore të njeriut. Zotërimi i formës standarde të shqipes kërkon shkollim cilësor; vullnet, përkushtim e kujdes të vazhdueshëm për ta mësuar atë, kulturë leximi e kulturë gjuhe si dhe ndjenjën se jemi një komb, kemi një histori, një gjuhë e një standard.

Po ua rrëfej një situatë të përdorimit të ligjërimit dialektor e ligjërimit libror nga përvoja ime: Me rastin e përrurimit të një monografie për të folmen e katundit tim (Gjilan, Kosovë, korrik, 2019), me bashkëfshatarët para e pas përrurimit bisedonim në të folmen vendore, ndërsa fjalimin e rastit e mbajta në ligjërimin letrar. Sapo mbaroi promovimi, njëri nga të pranishmit më pyeti: *Pse nuk fole çysh folim na, po me gramati:k?*

Përgjigjja ishte kjo: Për ligjërimin bisedor ndërmjet njerëzve të afërt nga gjaku e folmja e tyre është shumë e përshtatshme. Biseda zhvillohet spontanisht, nuk dallohet shkalla e arsimimit të folësit e as kultura e gjuhës dhe nuk kërkon angazhim të madh mendor. Kjo formë e ligjërimit është e ngrohtë, gjuhë e lindur e bashkëbiseduesve dhe gjuhë e zemrës. Por, për përrurimin e librit kalova nga ligjërimi dialektor në atë letrar për shkak se e

³⁰⁹Termi “gjuhë amtare” është përdorur në kuptimin “e variantit gjuhësor që fëmija e dëgjon dhe e mëson nga nëna.”

folmja jonë nuk do të më mjaftonte që të shprehja mendimet dhe vlerësimin për këtë vepër. Mbi të gjitha do të më mungonin disa terma që nuk i ka as e folmja jonë, por as edhe të folmet e tjera, si: *përrurim, promovim, monografi, sentencë, gjenezë, financë, përpunues teknik, veprimtari, filozofi, profesionist, kontribut* etj.

Gjuhën e krijon populli, e studiojnë dhe e kodifikojnë gjuhëtarët; e përpunojnë, e përsosin dhe i japin larmi e fuqi shprehëse shkrimtarët. Secili folës i pashkolluar (geg apo tosk) ose me arsimim të dobët mbetet vetëm në caqet e gjuhës së vet krahinore, pa e zotëruar shqipen letrare, variantin e kodifikuar e të përpunuar. Dihet mirëfilli se varianti i shqipes standarde është shumë më i gjerë, më i pasur, më i përpunuar sesa çdo e folme e dialekt. Në variantin standard të shqipes ka shumë fjalë të reja që nuk janë as gege e as toske, të krijuara mbi modelet fjalëkrijuese të shqipes, të njohura si neologjizma; janë krijuar ose huazuar nga gjuhë të huaja edhe shumë terme shkencore që dialektet nuk i kanë. Leksiku i shqipes standarde është pasuruar edhe me kalke, ndërkombëtarizma, me gjedhe të reja sintaksore. Varianti standard është zhvilluar e ngritur në ligjërimin libror (në formën e folur e të shkruar) si dhe në pesë stile funksionale të veprimtarisë njerëzore, përfshirë këtu edhe stilin letrar artistik.

10.11. SI TA PËRVETËSOJMË LIGJËRIMIN LIBROR

Të gjithë fëmijët e marrin gjuhën e tyre shumë shpejt, me kompetencë dhe pa nevojën e një instruktore a të një mësuesi të veçantë. Shkencëtarët mendojnë se truri i njeriut është i programuar gjenetikiisht dhe tiparet bazë të gjuhës janë prezent në tru që në lindje. Prindërit bëjnë pak përpjekje për t'ua mësuar gjuhën fëmijëve të tyre; fëmijët kanë sistemin e tyre të marrjes gjuhësore dhe vetë e mësojnë gjuhën, bazuar në modelet gjuhësore që i kapin me intuitë dhe në rrugën e hipotezës.

Mendohet që në moshën 5-6 vjeçare, merren deri në 90% të formave bazë të gjuhës. Deri në këtë moshë fëmija njih të gjitha modelet që janë në gjuhë dhe është në gjendje të plotësojë të gjitha nevojat komunikative, në përshtatje me kontekstin e përdorimit. Realiteti gjuhësor, me të cilin fëmija ballafaqohet (dialekti apo standardi), është premisa e parë gjuhësore e fëmijës, ndonëse procesi i pjekurisë gjuhësore plotësohet nga përvoja e mëpastajme shoqërore.

Çdo njeri flet një dialekt të veçantë. Dialekti lind për shkaqe hapësinore ose shoqërore. Dallimet dialektore mbi baza gjeografike varen nga shkalla e largësisë dhe e izolimit. P.sh. dallimet dialektore të shqipes janë më të pakta, sepse janë relativisht të reja dhe të një shkalle jo aq të largët izolimi, krahasuar me ato të anglishtes ose gjermanishtes që janë më të mëdha, për arsye të shtrirjes dhe ndarjeve më të thella.

Nga shpjegimet e mësipërme mund të konstatohet se ligjërimin bisedor dhe ligjërimin e shkujdesur të shqipës e mëson çdo shqiptar që lind e rritet në familje ku flitet shqip ose në familje dygjuhëshe shqip-gjuhë e huaj. Mirëpo, për të përvetësuar ligjërimin libror duhet

Dihet se ligjërimet e gjuhës sonë (në variantin e shkruar dhe të folur) janë:

- a) **ligjërimi i shkujdesur**,
- b) **ligjërimi bisedor** dhe
- c) **ligjërimi libror**.

Ligjërimi i shkujdesur (apo ligjërimi i thjeshtë, thjeshtligjërimi) është të folurit e përditshëm të njerëzve që nuk i përmbahen në të folur normës standarde, e shkelin ose e shtrembërojnë atë. Kjo është shkalla më e ulët e respektimit të normës letrare. Ndikimi dialektor në këtë ligjërim është i madh, por dallohet nga e folmja krahinore a vendore.

Rastet më të shpeshta të ligjërimin të shkujdesur paraqiten te njerëzit e paarsimuar ose analfabetë. Liria e fjalës shpërdorohet edhe nga disa individë të pakulturuar që flasin ose shkruajnë fjalë të ndyra, fyese e fjalë të pahijshme shqiptohen me zë të lartë në rrugë, autobus e në lokale publike. Fjalë të huaja të panevojshme ose të ndyra ndonjëherë përdoren edhe në fjalosjet e njerëzve, në zënkat e politikanëve, polemikat e botuara në shtyp, në disa përkthime etj. Një ligjërim të shkujdesur përdorin edhe ata që hedhin poshtë tërësisht gjuhën standarde.

Ligjërimin bisedor e përdorim gjatë bisedës sonë në jetën e përditshme, në familje e punë, në tregti, argëtim, lojëra, udhëtime etj. Njeriu i njëjtë varësisht nga rrethanat, mund të përdorë herë ligjërimin libror e herë ligjërimin bisedor. Bie fjala, në një mbledhje pune pjesëmarrësit priren drejt të folurit letrar, po të njëjtit njerëz pas mbledhjes duke pirë kafe rëndom flasin në ligjërimin bisedor.

Në ligjërimin bisedor mbizotërojnë temat e jetës së përditshme, por flitet edhe për çështje të tjera që u interesojnë bashkëbiseduesve. Në këtë lloj ligjërimi zbatohet shumë parimin e ekonomizimit të gjuhës dhe prirjen për lehtësimin e shqiptimit. Ai udhëhiqet nga parimi “sa më pak mund”, sipas të cilit me sa më pak mund synohet të arrihen efektet e duhura.

Ligjërimi i shkujdesur dhe bisedor janë spontan dhe organizohen aty për aty. Njerëzit në këtë ligjërim flasin pa menduar shumë, pa e planifikuar të folurit, pa ndonjë kujdes të veçantë çfarë do të thonë e si do ta thonë. Për ligjërimin e shkujdesur e bisedor nuk kërkohet që folësi të jetë i shkolluar e as t'i njohë rregullat drejtshkrimore, drejtshqiptimore e as gramatikore, sepse atë e mësojmë me të dëgjuar që nga lindja në familje e në mjedisin ku jetojmë.

10.12. LIGJËRIMI LIBROR PËRVETËSOHET ME PËRKUSHTIM

Për fat të keq, jo pak njerëz edhe pse kryejnë shkollë, disa edhe fakultet nuk arrijnë të përvetësojnë ligjërimin libror, por mbeten në caqet e ligjëritimit bisedor. Detyrë e shkollës është jo vetëm që të zbatojë ligjërimin libror, por edhe t'ua mësojë atë nxënësve e studentëve. Ligjërimi libror (letrar) është më i përpunuari në pikëpamje të normës. Në këtë ligjërim norma letrare ruhet më shumë se në ligjërimet e tjera. Ky në përgjithësi zbatohet në gjuhën e shkruar, por edhe në gjuhën e folur.

Përdorimi i ligjëritimit libror kërkon përgatitje paraprake arsimore e kulturore si dhe përvojë të nevojshme gjuhësore. Formës së shprehjes i kushtohet kujdes i veçantë, ndërsa përmbajtja jepet në imtësi, duke u mënjanuar përsëritjet dhe çdo gjë që është e panevojshme. Interpretimi i fakteve është logjik dhe i saktë, duke mos lejuar mundësi për keqkuptime. Ky lloj ligjërimi ka prirje të përgjithshme për të përdorur trajta më të plota e më të zgjeruara, me fjali e periudha më të ndërlikuara. Mendimet ndërtohen me periudha që kanë fjali me marrëdhënie bashkërenditëse e nënrenditëse të shkallëve të ndryshme. Ky ligjërim kërkon shqiptim të saktë të zanoreve e të bashkëtingëlloreve, të grupeve të tyre, theksim të drejtë e intonacion të duhur. Edhe rregullat gramatikore zbatohen me një rreptësi të dukshme, ku ruhen format normative të fjalëformimit.

Nevojat e ligjëritimit libror shpeshherë plotësohen me anë të fjalëve të reja të krijuara (neologjizme) si dhe huazimeve. P.sh. *brendashkruaj, nëndetëse, jashtëmartesor, i shumëkuptimshëm, gjysmërrafsh, keqtingëllim, përngjashmim* etj. Shumë fjalë e shprehje të leksikut abstrakt që karakterizojnë këtë ligjërim, përdoren edhe si terma në fusha të ndryshme të shkencës. Si rrjedhim, në këtë grup ka edhe fjalë të huaja e ndërkombëtare, si termat e teknikës, të mjekësisë, të filozofisë, të ekonomisë, të gjuhësisë etj. Në leksikun e ligjëritimit libror nuk zënë vend krahinorizmat e arkaizmat, as fjalët e zhargoneve ose mjetet e tjera që nuk pajtohen me normën letrare.

Në ligjërimin libror (të shkruar e të folur) me përpikëri ndiqen trajtat morfologjike të përcaktuara nga kodifikimi gramatikor. Gjatë fjalëformimit ndiqen modelet e shqipes. Përmbajtja u nënshtrohet rregullave të logjikës e të gramatikës. Gjithë teksti është i lidhur e i sistemuar. Sintaksës i kushtohet vëmendje e madhe për rrjedhshmërinë dhe ndërlidhjen e fjalive. Mendimet kanë rrjedhshmëri jo vetëm në fjali e periudha, por edhe në tërësi më të mëdha, si në paragrafë, nëntituj, tituj e kapituj, që veprën e bëjnë të përfunduar e të formësuar. Pra, me korrektësi zbatohen të gjitha rregullat e gramatikës normative.

Në këtë ligjërim (të shkruar e të folur) edhe fjalët përdoren me përpikëri që të mos lihet shteg për keqkuptime. Për nevojat e veta çdo fushë e specializuar (si mjekësia, gjuhësia, letërsia, ekonomia, politika, drejtësia, sporti, feja,..., po edhe nëndegët e tyre), përveç leksikut të përgjithshëm që përdorin,

kanë krijuar terma të tjera të duhura. Burimet për ta plotësuar këtë kërkesë janë të shumta: me brumin e shqipes janë krijuar fjalë të reja, janë kalkuar fjalë, përdoren mjaft ndërkombëtarizma e fjalë të huaja (sidomos nga gjuhët neolatine e anglishtja) etj. Ndonjëherë hetohet edhe ndikimi i gjuhëve të huaja në ndërtimet sintaksore.

Si të flasim dhe si të shkruajmë bukur?

Siç dihet, çdo njeri është në gjendje ta rrëfejë një ngjarje para të tjerëve, t'u përcjellë një informatë. Mirëpo, disa këtë punë e bëjnë më bukur, më shkathët e disa më dobët. Dikush mund ta ketë përjetuar një ngjarje dhe kjo t'i ketë bërë përshtypje të madhe, por ai mund të mos jetë në gjendje ta shprehë këtë përjetim as me një përqindje të vogël. Dikush tjetër, me mjeshtërinë dhe aftësinë e vet, arrin që edhe ngjarjet e rëndomta t'i përjetojë e t'i shprehë estetikisht, kështu që rrëfimi i tij bëhet më interesant. Atëherë themi se njeriu i tillë është artist i fjalës.

Për të folur e shkruar mirë, përveç njohurive gramatikore, duhet të kemi parasysh edhe disa kushte të tjera. Ja disa prej tyre:

- Para se të fillojmë të flasim ose të shkruajmë, duhet të bëjmë një plan se çfarë duam të themi ose të shkruajmë.
- Të jemi të vëmendshëm dhe me kujdesin më të madh të shfrytëzojmë gjithë imagjinatën dhe aftësitë tona krijuese.
- Mendimet duhet t'i shprehim në mënyrë të qartë dhe të drejtë.
- Të jemi real dhe bindës në atë që e shprehim.
- Të mos përdorim fjalë fyese.
- Të flasim qetë e me zë të ulët, jo shumë shpejt as shumë ngadalë.
- Fjalitë duhet t'i ndërtojmë sipas aftësive tona.
- Të respektojmë rregullat e drejtshqiptimit dhe të drejtshkrimit, të zgjedhim fjalët dhe të krijojmë fjali sipas natyrës së shqipes.
- Shkrimi të jetë i lexueshëm dhe i bukur; shqiptimi të jetë normativ.
- Tekstin e shkruar ta rilexojmë disa herë dhe ta përmirësojmë.
- Të lexojmë sa më shumë dhe të ndjekim modelet e mira të të folurit e të shkruarit. Kështu kanë vepruar edhe shkrimtarët e mëdhenj.
- Duke lexuar autorë që shkruajnë mirë, mësojmë të shkruajmë e të flasim mirë.

Format gojore publike, pra fjala përpara auditorit është lëvruar qëmoti nga gojëtaria (oratoria). Që të flitet bukur, Rexhep Qosja përmend disa kërkesa:

- gojëtari duhet të ketë njohuri dhe kulturë të përgjithshme,
- ta mendojë që më parë atë për të cilën do të flasë dhe të përgatitet,
- t'i besojë vetë asaj që thotë, ta njohë çështjen që shtjellon,
- të komunikojë me auditorin duke e nderuar atë, si dhe

- të zotërojë mirë gjuhën shqipe, pasuritë e saj e mjeshtërinë stilistike.

Duke pasur parasysh këtë, shumë njerëz i parapërgatitin fjalimet. P.sh. U. Çerçilli i ushtronte fjalimet e veta parlamentare në kopshtin e shtëpisë. Sh. de Goli i përgatiste diskutimet para pasqyrës, siç përgatisin rolet artistët. Me një specialist si regjisor ka punuar një muaj Xh. Bushi për fushatën elektorale kur do të rizgjidhej.

Gojëtaria kërkon ndikimin si me forcën e logjikës, të argumentit e të faktit, ashtu edhe me emocionalitetin e shqiptimit, duke e përvetësuar auditorin edhe me artin e fjalës.

10.13. SI TË PREZANTOJMË ME GOJË NJË PUNIM

Nxënësve, studentëve të ciklit të parë, të dytë, të tretë; mësimdhënësve, kumtuesve në konferenca, trajnuesve në seminare si dhe shumëkujt gjatë veprimtarisë intelektuale u bie për detyrë të prezantojnë me gojë para publikut diçka (punim diplome, referat, projekt, hulumtim etj.).

Më poshtë po sjellim disa këshilla si të prezantoni me gojë një punim para publikut:

- **Folni me diksionin e duhur.** Të folurit në publik është i vështirë. Përpiquni të flisni rrjedhshëm, me logjikë të shëndoshë, me shqiptim letrar, me theksim të rregullt fjalësh e intonacionin e duhur, me lartësi zëri siç e diktojnë kushtet hapësinore e teknike, jo shumë shpejt as shumë ngadalë. Kur prezantimi ynë përkthehet, duhet pasur kujdes edhe më shumë për ritmin (tempon) e të folurit. Folni siç ju vjen natyrshëm, pa e sforcuar veten, sepse nëse flisni duke qenë të shqetësuar ose të emocionuar, gjasat për të dështuar janë më të mëdha.
- **Duhet të ndjeheni sa më komod gjatë prezantimit.** Nëse keni mundësi për të zgjedhur se si do të qëndroni gjatë një prezantimi: në këmbë, ulur apo duke lëvizur; zgjidhni atë që ju bën ju të ndjeheni komod.
- **Përgatiteni punimin për prezantim në Power Point.**³¹⁰ Ky do t'ju ndihmojë që të paraqitni sa më mirë diturinë (punimin) tuaj. Këshillohet që ta ilustroni prezantimin tuaj vetëm në disa pika më të rëndësishme me Power Point, por jo ta shfaqni tërë tekstin në ekran (me formatin Word) dhe vetëm të lexoni. Është mirë që prezantimin ta ilustroni me grafikone, materiale hulumtuese e shembuj të jetës së përditshme, pasi kjo e mban publikun më të përqendruar.³¹¹

³¹⁰ <https://www.monitor.al/arti-te-folurit-ne-publik/>, shkarkuar më 12. 09. 2020

³¹¹ Udhëzimet teknike si përgatitet Power Pointi për prezantim nga Bashkim Sylaj, i gjeni në linkun: http://kub-pz.weebly.com/uploads/1/0/5/9/10591655/_powerpoint.pdf, shkarkuar më 10. 10.

- **Kontakti sy më sy është shumë i rëndësishëm**, edhe nëse ju po flisni para një audience të vogël edhe në rastin kur ajo i ka kaluar 500 veta në një sallë.
- **Ushtrojeni mirë prezantimin**. Edhe aktorët më të mirë të teatrit edhe nëse shfaqja është e njëjta nuk mund të dalin përpara publikut pa e përsëritur skenarin disa herë. Kjo është një ndër këshillat më të rëndësishme sepse, nëse e përsërisni tekstin disa herë, ju do të ndjeheni më të sigurt, do ta bëni tekstin tuajin dhe prezantimi do të vijë shumë natyrshëm. Në rastin e kundërt, kur e keni lexuar vetëm një herë tekstin, do të ngjani përpara publikut si një “papagall” që di të lexojë, por që nuk ka aspak aftësi të mira që të flasë para publikut. Kjo e bën që të folurit tuaj të jetë i bezdisshëm e të mos përcillet me vëmendje nga të pranishmit
- **Keni kujdes për gjuhën e trupit**. Mbajeni trupin drejt. Qëndroni natyrshëm, ashtu siç jeni. Mos e mblidhni trupin, por edhe mos u krekosni. Mos i futni duart në xhepa apo mos i vini prapa. Mos ia ktheni shpinën publikut. Mbani kontakt pamor të mirë gjatë prezantimit. Mos e ngulitni shikimin vetëm në mjetet pamore ose veç te një njeri. Mundohuni të shikoni secilin në sy të paktën një herë gjatë prezantimit, por fokusohuni të individët që duken më të interesuar.
- **Pamja (dukja) e jashtme**. Vishu me rroba të përshtatshme për rastin e caktuar (solemn, serioz etj.). Të jesh i pastër, i rregulluar. Ana emocionale të jetë në përputhje me rastin e tubimit. Mos u frikëso dhe bëhu i qetë. Mos qesh shumë, po as mos rri i zyrtë.
- **Mbaj llogari për kohën që e ke në dispozicion**. Përshtate prezentimin për audiencën dhe kohën në diaspozicion. Shfrytëzoje kohën e caktuar për prezantim, por mos e tepro. Mos fol shumë shkurt, po as shumë gjerësisht. Jep shpjegime të qarta. Mbeshteti mendimet, tezat me prova, me fakte, me shembuj si dhe me arritjet paraprake në atë fushë (mbështetur në literaturën e konsultuar). Jep përfundime të qarta.
- **Krijoni bindjen se e njihni materien**. Gjatë kohës së prezantimit para të tjerëve duhet të krijoni bindjen se e njihni materien më mirë se gjithë të tjerët. Në pyetjet eventuale që mund të të bëjnë të pranishmit, përpiku të japësh përgjigje të sakta, të argumentuara; por mos i mbroni me këmbëngulësi të tepruar tezat tuaja.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

Agalliu, prof. dr. Fatmir - Angoni, dr. Engjëll - Demiraj, prof. Shaban - Dharmo, prof. dr. Ali - Hysa, as. prof. dr. Enver - Lafe, prof. dr. Emil - Likaj, prof. dr. Ethem, *Gramatika e gjuhës shqipe (vëllimi I), Morfologjia*, Tiranë, 1995.

Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, *Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1983.

AShSh, *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, vëllimi I, Napoli, 2007; vëllimi II, Napoli, 2008.

Antosh, Antica, *Osnove lingvističke stilistike*, Zagreb, 1974.

Babić, Zrinka, *Fonetika i fonologjia hrvatskoga jezika (udžbenik)*, Školska kniga, Zagreb, 1995.

Badallaj, Imri, *Disa veçori fonetike të së folmes së Zhurit*, Gjurmime albanologjike, SShF V, 1975, Prishtinë, 1976.

Badallaj, Imri, *Nazalizimi i zanoreve si veçori qenësore e dialektit gegë*, ZA, nr. 10, Eianina (Cs), 1977.

Badallaj, Imri, *E folmja e Hasit*, Prishtinë, 2001.

Basha, Naim, *E folmja e qytetit të Dibrës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 137-221.

Beci, Bahri, *Sistemi fonologjik i gjuhës së sotme letrare dhe norma fonetike*, Studime filologjike nr. 1, Tiranë, 1985, f. 93-109;

Beci, Bahri, *Fonetika*, Libri shkollor, Prishtinë, 2004.

Beci, Bahri – Topi, Ermira, *Vëzhgime për dendurinë e përdorimit të fonemave zanore e bashkëtingëllore në gjuhën e sotme letrare shqipe*, Studime filologjike nr. 1, Tiranë, 1986, f. 61-76.

Beci, Bahri, *Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës*, Tiranë, 1995.

Beci, prof. dr. Bahri, *Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë*, Prishtinë, 2001.

Besho, Faruk, *Mbi mundësinë e rritjes së shpejtësisë së transmetimit të njoftimeve në telegrafi duke marrë parasysh probabilitetin e përdorimit të shkronjave dhe fonemave të ndryshme në gjuhën shqipe*, Buletin i USHT, SShN 2, Tiranë, 1969, f. 113-120.

Божковска, Стојка – Минова - Ѓуркова, Лилјана - Пандев, Димитар - Цветковски, Живко, *Македонски јазик за средното образование*, Просветно дело АД, Скопје, 2001.

Boriçi, Lumnie, *Intonacioni dhe funksionet e tij në gjuhën shqipe*, Studime

filologjike nr. 2, Tiranë, 1987.

Boriçi, Lumnie, *Kontribut mbi aspektin akustik të zanoreve të shqipes e të disa zanoreve të frëngjishtes*, Studime filologjike nr. 1, Tiranë, 1977, f. 103-118.

Bugarski, Ranko, *Uvod u opštu lingvistiku*, Beograd – Novi Sad, 1991.

Canaj, Afërdita, *Mbi dendurinë e përdorimit të fonemave në gjuhën shqipe, përqsasur me frëngjishten*, Studime filologjike nr. 1-2, Tiranë, 1999, f. 103-118.

Çabej, dr. Eqrem, *Studime gjuhësore I-IX*, Prishtinë, 1977; ribotuar më 1989.

Çeliku, Mehmet - Domi, Mahir - Floqi, Spiro - Mansaku, Seit - Përnaska, Remzi - Prifti, Stefan - Totoni, Menella, *Gramatika e gjuhës shqipe (vëllimi II), Sintaksa*, Tiranë, 1996.

Dako, Niko - Jashari, dr. Ali, *Gjuha shqipe për studentët*, Korçë, 1998.

Delarte, P., *Un triangle acoustique des voyelles orales du français*, The French Review, May, 1948.

Demiraj, Shaban, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996.

Demiraj, Shaban, *Rreth disa çështjeve thelbësore të shqipes standarde*, Studime filologjike nr. 3-4, 2002, Tiranë, f. 92-100.

Demiraj, Shaban – Prifti, Kristaq, *Kongresi i Manastirit*, AShSh, Instituti i Historisë, Tiranë, 2004.

Dika, Agni, *Kodi optimal për alfabetin e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 21. 07. 1984.

Dodi, Anastas, *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë, 1970.

Dodi, Anastas - Gjinari, Jorgji, *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe I, Fonetika (maket)*, Tiranë, 1983.

Dodi, Anastas, *Fusha e shpërndarjes së zanoreve dhe problemet e normës së shqiptimit*, Gjuha jonë nr. 1- 4, Tiranë, 1986.

Dodi, Anastas, *Intonacioni në gjuhën shqipe, komponentët dhe funksionet e tij gjuhësore*, Shqyrtime albanologjike 6, Shkup, 2000.

Dodi, Anastas, *Kundërvëniet e bashkëtingëlloreve të shqipes sipas tipareve akustike e qartë/e zbehtë (strident/mat)*, Studime filologjike nr. 1-2, Tiranë, 1999, f. 97-101.

Dodi, Anastas, *Theksi dhe shkallëzimi i tij në gjuhën shqipe*, Gjuha jonë 2, Tiranë, 1990.

Dodi, Anastas, *Shqipja si gjuhë ballkanike në vështrimin e gjuhësisë sasiore*, Seminari XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare, Tiranë, 1996, f. 759-765.

Dodi, Anastas, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004.

- Filipović**, dr. Rudolf, *Suvremena lingvistika nr. 1*, Zagreb, 1966; *Suvremena lingvistika nr. 3*, Zagreb, 1964.
- Gërmizaj**, Shukrane, *Sfidat dhe rezultatet e kontakteve të shqipes me anglishten*, Studime 20, AShAK, Prishtinë, 2013.
- Gokaj**, Nuri, *Baza të Gjuhësisë së Përgjithshme*, Shkodër, 1997.
- Guberina**, Petar, *Zvuk i pokret u jeziku*, Zagreb, 1967.
- Gjinari**, Jorgji, *Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme*, Tiranë, 1976.
- Gjinari**, Jorgji, *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989.
- Gjinari**, Jorgji, *Rotacizmi në dialektet dhe në gjuhën letrare*, Gjuha jonë 2, Tiranë, 1986.
- Gjinari**, Jorgji – Shkurtaç, Gjovalin, *Dialektologjia*, Tiranë, 1997 (ribotuar më 2000).
- Hajdari**, Ahmet, *Doracak i gjuhësisë*, Shkup, 1988.
- Hamiti**, Asllan, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Interdiskont, Shkup, 2005; Sak-stil, 2011.
- Hamiti**, Asllan – Qamili, Ajten, *Shtrirja dialektore e fjalës dhe përzgjedhja e formës normative*, Konferenca Shkencore Mbarëshqiptare “Shqipja në etapën e sotme, politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit”, Durrës, 15-17 dhjetor 2010.
- Hamiti**, Asllan, *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit*, Logos-A, Shkup, 2014.
- Hamiti**, Asllan – Qamili, Ajten, *Dialektologjia e gjuhës shqipe*, UIShM, Shkup, 2014.
- Horga**, Damir, *Obrada fonetskih obavijesti*, Hrvatsko filološko društvo, Znanstvena biblioteka, Zagreb, 1996.
- Hysa**, Enver, *Probleme të drejtshkrimit të ë-së*, Studime filologjike nr. 3-4, 2002, Tiranë, f. 76-80.
- Ibrahimi**, Zeqirija, *Planifikimi gjuhësor në Maqedoninë e Veriut*, Doracak i nëpunësve administrativë lidhur me zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, Shkup, 2020.
- Instituti Albanologjik** i Prishtinës, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974.
- Ismajli**, Rexhep, *Artikuj mbi gjuhën shqipe*, Prishtinë, 1987.
- Kostallari**, Androkli (kryetar) - Lafe, Emil - Totoni, Menella - Cikuli, Nikoleta, *Gjuha letrare shqipe për të gjithë (elemente të normës së sotme letrare kombëtare)*, Tiranë, 1976.
- Kostallari**, prof. Androkli, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*, Tiranë, 1973.

Kostallari, A. - Thomaj, J.- Lloshi, Xh. - Samara, M. - Kola, J. - Daka, P. - Haxhillazi, P. - Shehu, H. - Leka, F. - Lafe, E. - Sima, K. - Feka, Th. - Keta, B. -

Hidi, A., *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, A-M; N-Zh*, Prishtinë, 1981
(ribotuar sipas botimit të Akademisë së Shkencave të RPSSH – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1980).

Kuifen, Shjao, *Kongresi i Manastirit – një nga ngjarjet më të rëndësishme për formimin e gjuhës letrare të përbashkët shqipe*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998.

Lafe, Emil, *Alfabeti i Kongresit të Manastirit i vështruar nga koha e sotme*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998.

Lafe, Emil, *Një analizë matematike të formimit të fjalëve shqipe prej rrokjeve*, në Studime filologjike 3, Tiranë, 1969.

Lafe, Emil, *Gjuha e medias sot – probleme dhe detyra*, Gjuha jonë nr. 1-2, 2000, Tiranë, f. 9-21.

Lafe, Emil, *Shqipja standarde në vështrim strukturor dhe funksional*, Studime filologjike nr. 3-4, 2002, Tiranë, f. 10-21.

Lyons, John, *Hyrje në Gjuhësinë Teorike*, Londër, 1968 (përkthyer dhe botuar në gjuhën shqipe, Dituria, 2001).

Lloshi, Xhevat, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999.

Malmberg, Bertil, *Fonetika*, Sarajevo, 1974.

Martine, Andre, *Elemente të gjuhësisë së përgjithshme*, Prishtinë, 1983.

Memushaj, Rahmi, *Morfonologji e eptimit të gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1989.

Memushaj, Rami, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002.

Memushaj, Rami, *Diftongjet e shqipes standarde*, Eqrem Çabej dhe kultura shqiptare, Universiteti Eqrem Çabej, Tiranë, 2004, f. 233-244.

Memushaj, Rami, *Gjuhësia gjenerative*, ShBLU, Tiranë, 2003.

Memushaj, Rami, *Fonetika e shqipes standarde*, Toena, Tiranë, 2009.

Memushaj, Rami, *Për shqipen standarde I - çështje të normës morfologjike dhe drejtshkrimore*, Infbotues, Tiranë, 2012.

Memushaj, Rami, *Studime gjuhësore*, Akademia e Studimeve Albanologjike, IGjL, Tiranë, 2017.

Memushaj, Rami, *Shqipja standarde – si ta flasim dhe ta shkruajmë*, Infbotues, Tiranë, 2017.

Minović, dr. Milivoje, *Uvod u nauku o jeziku*, Sarajevo, 1985.

Muljačić, dr. Žarko, *Opća fonologija i fonologija suvremenoga talijanskog jezika*,

Zagreb, 1972.

Munishi, mr. Zijadin, *Gjuha shqipe dhe kultura e të shprehurit* (për klasën III-IV të arsimit të mesëm të orientuar), Prishtinë, 1984.

Munishi, Shkumbin, *Shqipja në epokën e globalizimit*, Zeroprint, Prishtinë, 2015.

Murati, dr. Qemal, *Gramatika e gabimeve – Kulla babilonike dhe përzierja e shqipes*, Shkup, 2000.

Ndreca, Mikel, *Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja*, Prishtinë, 1986.

Nesimi, Remzi, *Gramatika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme* (fonetika, leksikologjia dhe morfologjia) I, Shkup, 1997.

Nushi, dr. Pajazit, *Sistemi i grafisë së tingujve të shqipes dhe vetitë perceptive e përmasat e lexueshmërisë së shkronjave të alfabetit të gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1988.

Osmani, Zihni, *E folmja shqipe e Prespës*, Shkup, 1996.

Osmani, Zihni, *E folmja shqipe e Manastirit dhe e qarkut të tij*, Shkup, 1997.

Qosja, Rexhep, *Kongresi i Drejtshkrimit – tridhjetë vjet pas*, Studime filologjike nr. 3-4, 2002, Tiranë, f. 31-36.

Rosandić, dr. Dragutin, *Osnove fonetike i fonologije hrvatskog književnog jezika*, Zagreb, 1977.

Rrokaj, Shezai, *Strukturalizmi klasik në gjuhësi*, ShBLU, Tiranë, 2002.

Sadiku, Zeqir, *Fonetika e gjuhës së sotme letrare ruse*, Prishtinë, 1981.

Савицка, Ирена - Спасов, Људмил, *Фонологија на современиот македонски стандарден јазик*, Скопје, 1997.

Sakib, Ebu, *Hyrje në shkronjat e Kur'anit*, Prizren, 2000.

Silić, dr. Josip - Rosandić, dr. Dragutin, *Osnove fonetike i fonologije hrvatskog književnog jezika*, Zagreb, 1977.

Simeon, Rikard, *Enciklopedijski rječnik lingvističkih naziva*, Zagreb, 1969.

Simeon, Rikard, *Opća enciklopedija 5*, Zagreb, 1979.

Sulejmani, mr. Fadil, *Praktikumi i gjuhës së sotme letrare shqipe*, Prishtinë, 1984.

Shehu, Hajri, *Rreth anglicizmave në mjetet e sotme të informimit masiv*, Studime filologjike nr. 3-4, 2002, Tiranë, f. 92-100.

Shkurtaaj, Gjovalin, *Sociolinguistika*, Tiranë, 1999.

Shkurtaaj, Gjovalin, *Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi në mediat e sotme të shkruara dhe të folura*, Gjuha jonë nr. 1-2, 2000, Tiranë, f. 31-40.

- Тилков**, Димитър – Бояджев, Тодор, *Българска фонетика*, Софија, 1977.
- Topalli**, Kolec, *Sonantet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2001.
- Topalli**, Kolec, *Theksi në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1995.
- Topalli**, Kolec, *Fërkimoret e afrikatet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2003.
- Topalli**, Kolec, *Bashkëtingëlloret dyfishe të gjuhës shqipe*, Eqrem Çabej dhe kultura shqiptare, Universiteti “Eqrem Çabej”, Tiranë, 2004.
- Trubeckoi**, N. S., *Parime të fonologjisë*, Prishtinë, 1985.
- Ullman**, S., *The Principles of Semantics*, Glasgow – Oxford, 1957.
- Xhaferi**, Hajredin, *Leksione dhe ushtrime për fonetikën*, Elbasan, 2008.
- Ymeri**, Haki, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997.
- Ymeri**, Haki, *Për një sistem grafik më ekonomik të gjuhës së sotme shqipe*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998.
- Зиндер**, Л. Р., *Общая фонетика*, Москва, 1979.

Burime nga interneti:

- <http://albanologjia.com> <https://sot.com.al/kultura/p%C3%ABr%C3%A7ahen-akademik%C3%ABt-p%C3%ABr-ndryshimet-n%C3%AB-gjuh%C3%ABn-shqipe-bojkotohet-k%C3%ABshilli-nd%C3%ABrakademik-nga>
- <https://sot.com.al/kultura-intervista/ethem-likaj-ndryshimet-n%C3%AB-gjuh%C3%ABn-shqipe-vet%C3%ABm-p%C3%ABr-p%C3%ABrmir%C3%ABsimin-e-standardit>
- <http://shekulli.com.al/albanologia-ne-politike-dhe-ne-internet-pobanalizohet-gjuha/>
- <http://www.faktinews.com/aktualitet-2/analiza/a-po-e-prish-interneti-gjuhen-shqipe/>
- Berisha, dr. Skender, *Procesi i globalizimit*, në <http://www.scribd.com/doc/12982581/Procesi-i-Globalizimit>.